

# ENVER HOXHA

VEPRA

55



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE



ENVER HOXHA



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

V E L L I M I

55

QERSHOR 1975 – TETOR 1975

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1987



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 55-TË

*Materialet e këtij vëllimi janë shkruar gjatë muajve qershor-tetor 1975. Shumë prej tyre botohen për herë të parë.*

*Libri përmban një varg bisedash të shokut Enver Hoxha me punëtorë, kooperativistë e kuadro të rretheve Pogradec, Korçë e Elbasan. Këto takime flasin për atë afrim aq të madh me popullin, midis të cilit udhëheqësi ynë i laudishëm, si shok e mik i ngushtë i macave, konsultohet me to, njihet drejtpërdrejt gjendjen e punëve dhe merrte forca të reja.*

*Duke e parë me optimizëm situatën e krijuar pas spastrimit të veprimtarisë armiqësore në disa sektorë të jetës së vendit, Partia dhe shoku Enver Hoxha përcaktuan detyra të reja, që u pasqyruan në planin e gjashtë pesëvjeçar. Ky vëllim përmban analiza të hollësishme të një sërë problemesh, zgjidhja e të cilave ndihmonte fuqizimin e ekonomisë dhe të mbrojtjes së atdheut.*

*Autori orienton të shfrytëzohen në maksimum të gjitha mundësitë e rezervat për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, në tërësi, dhe, veçanërisht, të asaj të minierave e mekanike. Në kuadrin e hartimit të planit, ai poroset punonjësit të diskutojnë, madje të bëjnë debate pune, për të shtuar prodhimin, për të rritur cilësinë*

e për të ulur koston e tij. Si metoda frytdhënëse, midis të tjerash, rekomandohet zhvillimi i kooperimit në industri, që dikton përdorimin maksimal si të mjeteve, ashtu edhe të lëndëve me të cilat punohet, dhe organizimi i aksioneve masive.

Synimet largpamëse të shokut Enver Hoxha për ecjen përpara të bujqësisë pasqyrohen edhe në faqet e këtij vëllimi. Ai shprehet kundër «vetëkënaqësisë me pak», që mbyll perspektivën e kësaj dege bazë të ekonomisë. Në disa shkrime analizohen faktorët që e çojnë bujqësinë drejt rrugës së ngjijtes, si: përmirësimi i tokës dhe shtimi i pjellorisë së saj, kryerja me rregull e në afat e shërbimeve bimëve etj. Punonjësve të bujqësisë u ritheksohet detyra bazë e rritjes së rendimenteve të drithërave, por edhe të blegtorisë, të pemëtarisë etj. Për plotësimin e këtij objektivi hidhet ideja e dërgimit në masë të të rinjve nga qyteti në fshat.

Shoku Enver Hoxha kritikon të metat e gabimet e disa drejtuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe tërheq vëmendjen për një organizim më të shëndoshë të punës dhe të drejtimit. Ai nënvizon rolin e rëndësishëm të specialistëve, sidomos të agronomëve e financierëve, në kooperativat e në ndërmarrjet bujqësore dhe i udhëzon ata të ndjekin hap pas hapi, me metoda shkencore, çdo proces punë. Si në bujqësi, ashtu edhe në industri vlerësohet dobia e madhe e përhapjes së përvojës së përparuar të punëtorëve, kooperativistëve e brigadierëve që kanë arritur rendimente të larta.

Në materialet e këtij vëllimi shtrohet çështja se nuk mund të ecë përpara ekonomia pa njerëz të ngritur nga ana politike e ideologjike, por edhe nga kualifikimi tek-

nik. Autori porosit të studiohen mirë materialet e Partisë e të zbatohen këto në mënyrë krijuese në punë, në shoqëri e kudo. Në diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 26 shtator, çmohet puna e organeve të shtypit lidhur me edukimin e masave. Krahas detyrave që u ngarkohen atyre për një trajtim më të gjerë e më të thellë të problemeve, vihet si kërkesë e domosdoshme bashkëpunimi i ngushtë i organizatave të masave në frontin unik të edukimit.

Në krye të kësaj pune, porosit shoku Enver Hoxha, të jenë organizatat e Partisë. Kjo realizohet kur të gjithë komunistët e luajnë rolin pararojë jo në mënyrë formale, por efektivisht dhe realisht.

Duke u ndalur në disa norma të jetës së Partisë, udhëheqësi i saj vë në dukje se parimet leniniste duhet të zbatohen në mënyrë dialektike e me ndërgjegje të pastër. Veçanërisht i kushton kujdes forcimit të kritikës dhe të autokritikës ndaj atyre që gabojnë, pavarësisht nga funksionet.

Tërheq vëmendjen e çdo organizate-bazë orientimi për një punë më të mirë me direktivat. Autori shtron nevojën e ballafaqimit të tyre me zbërthimin e zbatimin në praktikë. Në mënyrë të veçantë thekson domosdoshmërinë e një kuptimi të thellë të vigjilencës, jo vetëm teorikisht, por edhe në praktikë, gjë që mishërohet në zbatimin me korrektësi të vijës e të direktivave të Partisë, duke ecur me kujdes, pa rënë as në liberalizëm, as në sektarizëm. Për të mos u lënë shteg shtrembërimit, shkeljes ose sabotimit të direktivave, në vëllim nënvizohet rëndësia e forcimit të kontrollit punëtor-fshatar. Masat punonjëse orientohen ta ushtrojnë këtë kontroll

kudo, duke goditur, sidomos, shfaqjet e burokratizmit e duke kontribuar që të bëhen ndryshime thelbësore në stilin e në metodën e punës dhe në mentalitetin e njerëzve.

Një drejtim kryesor të punës së Partisë shoku Enver Hoxha konsideronte sektorin e ushtrisë. Edhe në shkrimet e këtij vëllimi duket qartë kujdesi i udhëheqësit për përgjegjësinë dhe detyrat e Partisë në ushtri. Ai porosit: «Të marrë fund situata e rrezikshme e vënies së komandës mbi Partinë». Forcimi i rolit udhëheqës të Partisë vlerësohet si kusht vendimtar për zhdukjen e «njollave» që lanë armiqtë, si dhe për të arritur rezultate pozitive qoftë në edukimin ideopolitik, qoftë në zbatimin gjatë stërvitjeve të parimeve të Artit Ushtarak të Luftës Popullore.

Nga kthesa në metodën e punës edukative me ushtarakët autori këshillon të mos përjashtohen punonjësit e organeve të Sigurimit të Shtetit, prej të cilëve kërkohet të punojnë me partishmëri të lartë dhe të luftojnë shfaqjet e mungesës së vigjilencës.

Në këtë vëllim botohen edhe dy diskutime të shokut Enver Hoxha për hartimin e projektkushtetutës së RPSSH. Duke qenë në krye të komisionit të posaçëm të Kuvendit Popullor që diskutoi dhe miratoi Kushtetutën e re, me mësimet konstruktive e me vërejtjet e vlefshme, udhëheqësi ynë i laudishëm dha një kontribut të madh për sanksionimin e vijës shumëvjeçare të Partisë e të fitoreve të socializmit në ligjin themeltar të RPSSH.

Vazhdimi i politikës së drejtë e të pavarur të vendit tonë del në pah në një varg materialesh. Në artikullin e mirënjohur për Konferencën e Helsinkit autori afirmon

edhe një herë se problemi i paqes dhe i sigurisë në botë mund të zgjidhet vetëm nga popujt, me një luftë konsekuente kundër imperializmit e revizionizmit. Në këtë kuadër rithekson qëndrimin revolucionar marksist-leninist të vendit tonë, që «nuk e ul flamurin as para shantazhit e frikës dhe as përpara rublës e dollarit», por lufton e kontribuon për emancipimin e vërtetë të popujve, për lirinë e demokracinë e të gjitha vendeve.

Shoku Enver Hoxha shpreh me forcë kundërshtimin ndaj dy superfuqive dhe instrumenteve në duart e tyre, duke vënë në dukje ndryshimin e madh me «teoritë» kineze të ndarjes së botës më tresh e të përcaktimit të revizionizmit sovjetik si superfuqia më e rrezikshme. Në një sërë shënimesh ai nxjerr konkluzionin se politika e Kinës është e gabuar, jorevolucionare, në një kohë kur kërkohej që çdo çështje të shihej nga ana klasore dhe theksi t'i vihej luftës kundër armiqve të popujve.

Njohja me rrethin e gjerë të problemeve që trajtohen në këtë vëllim, për zgjidhjen e të cilave udhëheqësi ynë i paharruar na ka lënë mësimë shumë të vlefshme, do t'u shërbejë masave të gjera të popullit, të udhëhequra nga komunistët, që të gjejnë rrugë e mundësi të reja për të realizuar detyrat e caktuara nga Partia.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



# KUADROT T'I PËRGATITIM SIPAS NEVOJAVE AKTUALE E PERSPEKTIVE TË VENDIT

Shënime

4 qershor 1975

Vërejtjet e shokut Kahreman Ylli<sup>1</sup> në relacionin «Mbi disa probleme të kuadrit të lartë» janë të drejta, por atyre nuk duhet t'u bëhet një vlerësim «në këmbë» dhe të mos na heqë zvarrë rutina.

Orientimet e Partisë, që vazhdimisht ka thënë se proporcionet midis kuadrove me arsim të lartë dhe atyre me arsim të mesëm duhet të jenë të balancuara, nuk janë zbatuar si duhet. Kuadri me arsim të mesëm ka rëndësi shumë të madhe, megjithatë është anuar në përgatitjen e sa më shumë kuadrove me arsim të lartë. Etja e fillimit, kur na mungonin krejt kuadrot me arsim të lartë, dhe mentaliteti mikroborgjez për të përgatitur sa më shumë njerëz për zyra, memurë, për të marrë rroga të mira, për të siguruar një jetë më të

---

1. Në atë kohë anëtar i KQ të PPSH, që ndiqte problemet e arsimit në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë.

begatshme dhe jo me shumë mundime, nuk lejuan që, me kalimin e kohës, me shtimin e kuadrove me arsim të lartë, të mendohej seriozisht për të plotësuar nevojat e vendit edhe me kuadro me arsim të mesëm, sipas kërkesave reale të planeve perspektive dhe të specialiteteve të nevojshme e të domosdoshme.

Por ushqehej edhe opinioni se të gjithë nxënësit duhej të sulmonin për në shkollat e larta, pak ose jo si duhej përgatitej opinioni se pa teknikë me arsim të mesëm të kualifikuar nuk ka prodhim të kualifikuar në çdo drejtim. Në këto kushte kuadri me arsim të lartë është si oficeri që shkon në luftë me ushtarë dhe me kuadro me arsim të mesëm të pastërvitur dhe jo të edukuar.

Kjo frymë e sëmurë dhe pa përgjegjësi është vënë re në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës e në Komisionin e Planit të Shtetit. Të dy këto institucione kanë faje të rënda, pse as kanë bërë llogari reale, as kanë ndjekur gjendjen, nevojat, planet aktuale dhe perspektive. Ato as kanë menduar dhe as kanë propozuar, gjithashtu, masa të drejta frenuese dhe rregulluese, siç është çështja e pranimeve si studentë, në cilat drejtime, ç'kushte duhej të viheshin për ata me shkëputje dhe për ata pa shkëputje nga puna, numri i bursave që duhej të jepeshin, të zëvendësoheshin kriteret e vjetra që i ka kapërcyer koha etj., etj.

Tash do t'i vëmë në rrugë këto gjëra apo do të vazhdojmë kështu? Sigurisht që nuk do të vazhdojmë kështu. Ky është një problem i shumanshëm politik dhe ekonomik. Baza e përgatitjes së kuadrove duhet të jenë nevojat që kanë ekonomia, kultura dhe ushtria për



specialistë me arsim të mesëm dhe të lartë. Prej këtej duhen nxjerrë përpjesëtimet shkencore, të bazuara në gjendjen aktuale dhe në nevojat e perspektivës së vendit, të cilat duhet të jenë të ekuilibruara, të llogaritura sipas planeve perspektive dhe reale. Këtu të mos harrohet se problemi nuk është vetëm për kuadro me arsim të lartë, por edhe për specialistë me arsim të mesëm.

Duhet të punohet politikisht dhe ideologjikisht që njerëzit të duan zanatin, punën, jo titujt, jo rrogat e mëdha dhe rehatinë. Ne askujt nuk ia mbylлим dyert e universitetit dhe të shkollave të larta, por në to do të hyhet sipas kushteve dhe nevojave që ka atdheu. Askush nuk i pengon njerëzit që s'plotësojnë kushtet për në universitet dhe për në institutet e larta të mësojnë për të shtuar dituritë, për të perfeksionuar zanatin.

Njerëzit ne duhet t'i drejtojmë në shkollat profesionale; atyre me 8-vjeçare t'u bëjmë kurse nga tre deri në gjashtë muaj e një vit për specialitete të ndryshme. Dhe ky mësim u shërben atyre për atestim kualifikimi.

Tash vihet si detyrë e madhe që kuadrot me arsim të lartë, që kanë dalë, të çohen në vendet e përshtatshme. Për ata që do të përgatiten, që tash duhet të parashikohet se ku do të venë kur të mbarojnë. Gjithashtu, të rishikohet regjimi aktual i atyre që ngelin në klasë në shkollat e larta. Atje ku janë të tepërt dhe mbeten në klasë, të mos ngulim këmbë për t'i mbajtur me pahir dhe pastaj të na dalin krunde e me pretendime si «endë». Ata t'i përjashtojmë pa hezitim dhe t'u themi të venë në prodhim. Kështu duhen parë edhe shumë masa të tjera, deri në mbylljen e degëve të disa

specialiteteve për ndonjë pesëvjeçar, kur na rezultojnë kontingjente të mjafta.

Siç thashë, do të jetë gabim i madh që këto probleme të zgjidhen në këmbë ose t'u lihen në mënyrë burokratike atyre që i kanë ndjekur dhe i kanë zgjidhur me kritere burokratike, mundet edhe me qëllime armiqësore, e kam fjalën për ndonjë element në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës dhe në Komisionin e Planit të Shtetit.

Unë mendoj se duhet formuar një komision partie dhe shtetëror i kualifikuar (ky komision s'ka të bëjë me komisionin e shkollave pranë Komitetit Qendror të Partisë), që të studiojë hollësisht gjendjen, normat aktuale, normat e reja që duhet të vendosen, kriteret që duhen ndjekur, orientimet më të sakta si në sasi, në cilësi dhe në lloje të specialiteteve. Këtë punë, natyrisht, ai do ta bëjë duke u bazuar në të dhënat e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe të Komisionit të Planit të Shtetit, por jo të punojë dhe të vendosë vetëm koka e Thoma Delianës apo e ndonjë tjetri.

Studime të tilla janë shumë të nevojshme e të domosdoshme të bëhen dhe të jenë gati për planin e ri pesëvjeçar që do të vendosim. Ky plan duhet të paraqesë realisht nevojat e perspektivës për këtë problem të madh. Edhe në punën e komisionit, edhe në vendimet që do të na propozojë ai, duhet të duken të theksuar mendimi, stili dhe metoda revolucionare.

Më parë se t'i vihet punës, komisioni duhet të studiojë gjendjen, të kritikojë çdo gjë burokratike dhe armiqësore, të shfaqur në forma, në mendime, në metoda e në veprime, dhe t'i dënojë ato, t'i fshijë me fshesë

të madhe nga tavolina e punës së tij, ndryshe do të bëhet diçka jo e shëndoshë dhe jo ashtu si e kërkon Partia.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# TË LUFTOJMË PËR CILËSI NË PRANIMET NË PARTI

Shënime<sup>1</sup>

5 qershor 1975

Rritja e Partisë çdo pesëvjeçar nuk ka qenë shumë e ekuilibruar dhe, pra, jo e studiuar si duhet.

Kuptohet, ishte e nevojshme që, me daljen nga Lufta Nacionalçlirimtare, të dilnim edhe nga sektarizmi në shtimin e radhëve të Partisë. Rindërtimi i vendit, zhvillimi i ekonomisë, zhvillimi i luftës së klasave lypnin zgjerimin e radhëve të Partisë dhe është e arsyeshme që efektiviteti i Partisë të vinte vazhdimisht duke u rritur.

Nga viti 1950 deri më 1960, domethënë brenda 10 vjetëve, efektiviteti i Partisë u rrit, por kjo periudhë tregon njëfarë frenimi në pranime. Kurse nga viti 1960 deri më 1970, si dhe nga viti 1970 deri më 1974, janë bërë më shumë pranime.

---

1. Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka bërë pasi lexoi një studim të përgatitur nga sektori i Statutit pranë aparatit të KQ të PPSH lidhur me pranimet në Parti nga një pesëvjeçar në tjetrin.

Si konkluzion, me këto rritje ne kemi ecur ca si tepër në 10-vjeçarin 1960-1970. Mëndet që këlë na e ka kërkuar edhe lufta kundër revizionizmit modern dhe bllokadës armike. Kurse gjatë periudhës nga 1970 deri më 1974, shtimi është i madh dhe duhet frenuar. Të luftojmë për cilësi dhe jo për sasi. Shtimi, pra, në periudha 5-vjeçare duhet të bëhet më i studiuar dhe më i motivuar nga nevojat e një studimi shkencor më të thelluar të rritjes.

Për të treguar cilësinë e pranimeve le ta krahasojmë atë me përjashtimet. Numri i këtyre të fundit dëshmon se në disa periudha është luftuar për numër dhe jo për kualitet. Shumë elementë të padëshirueshëm ishin futur në Parti. Numri i të përjashtuarve duhet të mbahet në konsideratë, jo nga pikëpamja se ata nuk duheshin përjashtuar, por të na lërheqin vëmendjen pranimiti jociësor dhe puna e pamjaftueshme për ngritjen politiko-ideologjike dhe të ndërgjegjes së tyre revolucionare. Nga ana tjetër, kjo shifër duhet të na orientojë dhe për zhvillimin e pandërprerë të luftës së klasave edhe brenda në Parti. Natyrisht, të përjashtuarit nuk kanë qenë të gjithë armiq, por fakti që ata s'ishin të denjë për në Parti dëshmon për refleksin e mbeturinave të klasave të përmbysura në ndërgjegjen e komunistëve, si dhe për synimin e elementëve çfarëdo për t'u pranuar në radhët e Partisë edhe pa i pasur konditat.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PËR KONTROLLIN

Shënime

6 qershor 1975

Fakt është se kontrollin shtetëror e kemi të dobët. Të gjithëve u kemi vënë detyra kontrolli, por këto nuk kryhen si duhet. Ka kryqëzime kontrollesh: partie, punëtore, shtetërore, dikasteriale, në rang rrethi, në rang ndërmarrjeje etj., etj., por faktet tregojnë se kontrolli i zbatimit të vendimeve, kontrolli i prodhimit, kontrolli financiar etj. janë të dobëta. Kemi dëmtime, harxhe të pakontrolluara, vjedhje, prishje, deficite, suficite etj., etj. Të gjitha këtyre gjërave të dëmshme duhet t'u vëmë fre, pse na dobësojnë ekonominë dhe prishin ndërgjegjen e njerëzve. Për t'i bërë ballë kësaj situatë duhet jo vetëm të forcohet edukata ideopolitike, edukata teknike, por duhen vendosur edhe kontrole të rrepta dhe efikase.

Në dritën e eksperiencës së deritanishme duhen studiuar një nga një të gjitha format e kontrollit shtetëror nëse janë drejt apo duhen perfeksionuar nga ana organizative, nga ana e lidhjeve dhe e varësisë së tyre,

nga ana e sferës së punës që bëjnë, e llojeve të kontrollit që duhet të ushtrojnë në drejtime të ndryshme, e metodës, e normave, e rregullave etj. që duhet të kenë dhe të kohës e të afateve të kryerjes së detyrave etj. Mendoj të rishikojmë nëse e kemi mirë organizimin aktual të Inspektimit të Shtetit, i cili është një organ që varet nga qendra dhe që ngarkohet të kontrollojë çështje në bazë, por që qëndron i shkëputur organizativisht nga baza, nga format e tjera të kontrollit që ekzistojnë në ministritë e në rrethet.

Këto probleme duhen studiuar, pa krijuar në rrethe forma kontrolli në shembullin e kontrollit të qendrës, pse atëherë jo vetëm do të shtonim burokracinë, por do të krijonim konfuzion e përplasje dhe s'do ta merrte vesh i pari të dytin.

Kontrollin punëtor, që e kemi futur në jetën dhe në ndërtimin e socializmit, ne duhet ta organizojmë mirë, se ka ngelur ca si fakultativ dhe i rastit. Sipas Leninit, ky kontroll duhet të jetë edhe punëtor, edhe fshatar. Gjithë masat punonjëse, burrat, dhe sidomos gratë, duhet të marrin pjesë në të, në inspektimin punëtor-fshatar, siç thotë Lenini. Pra, ky kontroll kërkon një organizim të posaçëm dhe jo të bëhet i rastit. Duhet të hartohen lista me shumë pjesëmarrës (duke përjashtuar nëpunësit, na mëson Lenini). Pjesëmarrja në kontrole inspektimi të ndryshojë sipas shkallës së zhvillimit të pjesëmarrësve. Pensionistët me specialitet e tyre të marrin pjesë gjallërisht në kontrollet punëtorë.

Për këto komisione kontrolli punëtor e fshatar, ku duhet të marrë pjesë një masë e madhe njerëzish dhe

në drejtime të ndryshme, të caktohen rregulla sa më të përpikta për llogaritjet e produkteve, për mallrat, për depot, për materialet dhe lëndët djegëse (mensat, restorantet) etj., etj. Komisionet duhet të organizohen në mënyrë të atillë që të punojnë me turne, pse do të jenë shumë. Në to të marrin pjesë aq veta sa të shihet e nevojshme për të realizuar kontrollin që u caktohet të bëjnë. Për të metat që konstatojnë kontrollet duhet të raportojnë ekzaktësisht, që të merren masa nga organet kompetente. Cilat janë organet ku të raportojnë këto kontrole është një çështje që kërkon studim, por mua më duket se duhet të raportojnë në organet shtetërore.

Partia dhe bashkimet profesionale të ndihmojnë në organizimin e kontroleve (të mos harrohen elementët e paorganizuar në Parti dhe shumica gra, pa iu zënë këtyre shumë kohë të vlefshme të punës), të eliminojnë nga këto komisione elementët e padëshirueshëm, t'i frymëzojnë anëtarët e komisioneve dhe t'i ndihmojnë në kryerjen mirë të detyrave.

Kuadrot e pushtetit duhet t'u bëjnë instruktive pjesëtarëve të këtyre komisioneve se si të veprojnë e si të kontrollojnë dhe t'i konsiderojnë ata siç janë, një levë tjetër e madhe vullnetarësh që u krijon bindjen konkrete punonjësve se marrin pjesë gjallërisht dhe efektivisht në drejtimin e shtetit të tyre. Shteti i proletariaut, në mënyrë të organizuar dhe për t'u ardhur në ndihmë formave të tjera të organizmave të tij, krijon edhe këtë kontroll masiv të punonjësve, që kontribuon për eliminimin sa më shpejt e sa më thellë të të këqijave që



---

shfaqen në ndërtimin e socializmit nga mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve dhe nga elementi armik.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## GJAKU I DERDHUR ÇIMENTON THEMELET E ATDHEUT

*Nga biseda me një delegacion kamboxhian*

16 qershor 1975

*Në fillim të bisedës shoku Enver Hoxha u uroi mirëseardhjen miqve kamboxhianë dhe, pas përgjigjeve që mori, vazhdoi:*

Falemnderit për përshëndetjet që më sollët në emër të princit Sihanuk. Kur të ktheheni në atdhe, ju lutem t'i transmetoni atij përshëndetjet më të përziermërta të miat dhe të popullit shqiptar. Populli ynë u gëzua shumë kur mësoi se forcat e armatosura popullore kamboxhiane, bashkë me popullin, e mposhtën armikun më të urryer të njerëzimit, imperializmin amerikan dhe, më në fund, arritën fitoren, çlirimin e vendit prej armiqve. Fitorja juaj është edhe fitorja jonë.

Në këto momente të gëzueshme ne i kuptojmë edhe vështirësitë me të cilat do të ndesheni, sepse kemi kaluar në të njëjtën rrugë që po kaloni edhe ju. Ne luftuam vite me radhë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, derisa fituam. Kur mbaruam luftën, ishim në gjendje të mjerueshme ekonomike, bile as bukë nuk

kishim, por, megjithëkëtë, qëndronim lart për sa u përket ndërgjegjes politike dhe shpirtit revolucionar. Vitet e para pas Çlirimit nuk na u dha asnjë ndihmë me kredi. Edhe Jugosllavia, që hiqej si fqinja jonë mike, në vend që të na ndihmonte, na grabiti mjaft prodhime bujqësore e blegtorale. Me gjithë vështirësitë e shumta që iu krijuan, populli ynë, i cili ishte i vendosur të rindërtonte gjithçka, e filloi punën me shumë besim në forcat e veta dhe e rindërtoi vendin.

Edhe ju luftuat pesë vjet me radhë kundër push-tuesve e armiqve të brendshëm dhe fituat. Ju, ashtu si ne, e keni popullin trim e punëtor, keni luftëtarë trima që dolën akoma më të fortë nga lufta. Tani do t'i përvisheni me të gjitha fuqitë punës si për ndërtimin e vendit, ashtu edhe për të ruajtur pavarësinë e tij.

Shokët e mi dhe unë jemi të gëzuar që presim miq nga Kamboxhia, prandaj do të dëshironim të na thoshit diçka rreth situatës aktuale në vendin tuaj.

*Miku kamboxhian që e mori fjalën, falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe për ndihmën e mbështetjen që RP e Shqipërisë i kishte dhënë luftës së popullit kamboxhian kundër imperializmit amerikan dhe klikës së Lon Nolit. Ai bëri një ekspozë të shkurtër të gjendjes në vend dhe foli për detyrat që caktoi kongresi i mbajtur në Kamboxhia për mbrojtjen e pavarësisë kombëtare dhe për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. Mbase trajtoi edhe disa çështje të tjera, fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:*

Faleminderit për shpjegimet që na dhatë. Ne i kemi ndjekur çdo ditë me interesim luftimet tuaja dhe ishim të sigurt se do të fitonit. Ne, gjithashtu, kemi

lexuar njoftimet e dhëna për kongresin tuaj, që u zhvillua në Kamboxhia, dhe për vendimet e tij të rëndësishme.

Është e vërtetë se vuajtjet e popullit dhe dëmet e luftës në materiale, e në radhë të parë humbjet në njerëz, janë të mëdha, por vendi nuk mund të çlirohet pa derdhur gjak. Gjaku i derdhur çimenton themelet e atdheut.

Siç thashë, ju po përshkoni atë rrugë që kemi përshkuar edhe ne. Vendi juaj u pushtua nga imperializmi amerikan me përkrahjen e kukullave të brendshme, ashtu siç u pushtua Shqipëria nga fashistët italianë e nazistët gjermanë, të përkrahur nga tradhtarët e vendit, ballistët e zogistët. Populli ynë u ngrit në këmbë të çlironte vendin dhe për këtë qëllim ishte i vendosur të bënte sakrifica. Pas Çlirimit, ne filluam punën nga e para për të ndërtuar çdo gjë që ishte shkatërruar nga lufta.

Çlirimi i Kamboxhias është një fitore e madhe që u arrit në sajë të luftës së vetë popullit kamboxhian. Populli derdhi gjakun rrëke, luftoi kundër një armiku të armatosur me armët më moderne. Ky armik ka bërë dëme të mëdha, ka shkatërruar edhe monumente të kulturës suaj të lashtë. Por lufta juaj për çlirim kombëtar i ka kushtuar shtrenjtë imperializmit amerikan; ajo ka ndikuar në disfatën e tij politike dhe ushtarake, në thellimin e krizës që ka goditur imperializmin në përgjithësi. Populli kamboxhian e ka shpejtuar krizën e imperializmit, sepse ai e vazhdoi luftën dhe nuk bëri kompromis me pushtuesin.

*Duke shprehur pikëpamjen e tij për marrëdhëniet*

e Kamboxhias me vendet e tjera, për të cilat foli miku kamboxhian, shoku Enver Hoxha, midis të tjerave, theksoi:

Atë që mendojmë ne e themi hapur, sepse i duam sinqerisht miqtë dhe nuk duam t'u krijohet asnjë vështirësi. Ne jemi marksistë-leninistë dhe i njohim si ata që bëjnë vepra të mira, që sillen në mënyrë shoqërore, ashtu edhe ata që janë dinakë e u krijojnë vështirësi ose kryejnë akte armiqësore ndaj miqve. Nga ana jonë ne i dënojmë këto veprime. Llogaritë e mira bëjnë miq të mirë. E vërteta duket e hidhur ndonjëherë, por drejtësia e gjykimit mbi bazën e kësaj të vërtete nuk duket asnjëherë e tillë kur njerëzit kanë mendim të qartë dhe zemër të pastër. Kjo veti përbën një forcë të madhe për njeriun e për një popull.

Ne nuk i trembemi së vërtetës, as zbulimit të shkaqeve që sjellin një fenomen ose ngjarje. Ky është parimi ynë. Këtë gjë ia kemi shpjeguar edhe princit Sihanuk. I kemi thënë atij se, si komunistë që jemi, në interpretimin e realitetit objektiv ne nisemi nga teoria materialiste dialektike e njohjes.

Popujt e Vietnamit të Veriut e të Jugut, të Laosit, të Kamboxhias dhe të Tajlandës e dinë mirë që imperializmi francez ka sunduar egër mbi ta, mizoritë e tij janë një histori e vjetër dhe e dhimbshme. Sado i pamëshirshëm dhe gjakatar ka qenë sundimi i urryer kolonial, vendet janë çliruar e po çlirohen, po rindërtohen në sajë të gjakut e të djersës që kanë derdhur e po derdhin popujt. Ne kemi shpresë dhe besim të plotë se vështirësitë me të cilat po luftoni, janë të përkohshme, se Kamboxhia do të bëhet një vend i lulëzuar.

Të jeni të sigurt se populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë do ta ruajnë gjithmonë me kujdes miqësinë me popullin kamboxhian. Ne gjithmonë kemi qenë e do të jemi përkrah tij. Ai do të ndiejë nga afër përkrahjen dhe besnikërinë tonë në çdo moment.

I urojmë me gjithë zemër përparim e lumturi popullit tuaj kurajoz e punëtor, që do ta bëjë jetën e tij të gëzueshme. Përgëzime për fitoren dhe urimet më të mira, të miat dhe të të gjithë shokëve, për suksese të mëtejshme në kapërcimin e vështirësive që ju ka krijuar lufta.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

# KINA PO FUTET NË INGRANAZHIN E LOJËS POLITIKE TË TË DYJA SUPERFUQIVE

Shënime

21 qershor 1975

Kina tregohet pro dhe mbështet Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar».

Cili është synimi strategjik i Kinës dhe a mbështetet ky në parimet marksiste-leniniste? Që ta përcaktojmë këtë, duhet të përcaktohen qëllimet e vetë këtyre organizmave që mbron ose mbështet Kina.

Tregu i Përbashkët Evropian, kur u krijua, kishte për qëllim zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare në mes pjesëtarëve, të cilët në fillim ishin 6 dhe pastaj u bënë 9. Qëllimi i këtij institucioni ishte të përfitonte sa më shumë borgjezia kapitaliste e çdo vendi pjesëmarrës, si edhe forcimi i ekonomisë kapitaliste të çdo shteti në veçanti e i të gjithëve në përgjithësi. Natyrisht, tok me rregullimin e problemit të marrëdhënieve doganore, u sistemuan edhe një sërë çështjesh të tjera, si problemi i çmimeve, problemet monetare e të tjera marrëdhënie dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Në fillim Tregu i Përbashkët Evropian nuk kishte

se si të mos e llogariste ekonominë e fuqishme amerikane dhe ta hidhte çapin gjoja si të veçuar prej saj, por, në fakt, të bashkërenduar me çapin e imperializmit amerikan. Ky i fundit, fill pas Luftës së Dytë Botërore, me «ndihmat» që dha, kontribuoi në mëkëmbjen ekonomike të Evropës Perëndimore, por për asnjë çast ai nuk harroi interesat e tij, të cilët ishin dhe u bënë të mëdhenj. Pra, me krijimin e Tregut të Përbashkët Evropian, vazhduan, nga njëra anë, përpjekjet e imperializmit amerikan për t'i diktuar këtij institucioni politikën e tij ekonomike dhe, nga ana tjetër, vazhduan përpjekjet e pjesëtarëve të Tregut të Përbashkët Evropian për t'u çliruar nga tutela amerikane. Lindën kështu kontradikta midis tyre, të cilat erdhën duke u thelluar.

E ashtuquajtura luftë e ftohtë i mbulonte ca këto kontradikta, sepse pjesëtarët e Tregut të Përbashkët Evropian, edhe në qoftë se fillonin seriozisht të tregoheshin të pavarur ekonomikisht, nga ana e mbrojtjes ishin të detyruar të rronin nën ombrellën atomike amerikane. Natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dinin të shfrytëzonin në favor të tyre ndjenjën e frikës që u lindte vendeve të Tregut të Përbashkët Evropian nga një luftë me sovjetikët.

Tradhtia e hrushovianëve largoi nga borgjezia kapitaliste frikën nga revolucioni dhe nga komunizmi, ndihmoi kapitalin botëror, i dha këtij mundësi të merrte frymë. Tradhtia hrushoviane përçau forcat revolucionare në të gjithë botën, largoi revolucionin proletar, ndihmoi shfaqjet nacionaliste dhe u dha kohë e mundësi borgjezëve kapitalistë të forconin pozicionet e dobëta të tyre të brendshme në kurriz të revolucionit pro-



letar dhe të ndërmerrnin veprime dhe kombinime të tjera ndërmjet shteteve në arenën ndërkombëtare. Hrushovianët socialimperialistë, të fryrë me ndjenja nacionaliste, aspironin për ta kthyer Bashkimin Sovjetik nga një shtet socialist në një superfuqi imperialiste atomike dhe punuan derisa ia arritën këtij qëllimi. U bënë këshu dy superfuqi, të cilat konkurrojnë për hegjemoni botërore. Ligji i të dyve, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i Bashkimit Sovjetik, është ligji i luftës për grabitje, është ligji i skllavërimit të popujve. Ky ligj shoqërohet me realizimin e «aleancave» të përbindshme, me zaptimin me forcë të maskuar të pikave strategjike, për t'i përdorur ato për përgatitjen e luftës, me armatosjen deri në dhëmbë dhe me shtimin e armatimeve atomike, çdo ditë e më moderne, shoqërohet me grabitjen dhe gllabërimin ekonomik dhe politik të shumë shteteve me anën e frikës, shantazhit, kredive e «ndihmës» dhe të subversionit.

Në këto situata koniunkturale, Evropa Perëndimore mori më tepër kurajë. Franca me Dë Golin zhvilloi një politikë më të pavarur nga amerikanët dhe në përgjithësi nga anglosaksonët. Dë Goli doli nga NATO-ja, duke respektuar vetëm traktatin. Sigurisht, edhe Dë Goli ëndërronte një Treg të Përbashkët Evropian dhe një «Evropë të Bashkuar», ku, pa neglizhuar Gjermaninë e Adenauerit, të dominonte Franca. Dë Goli ishte i fryrë me një nacionalizëm të madh, gjë që e kërkonte edhe nga partnerët e tjerë të tij, por të kanalizuar në një të tillë Evropë, siç e ëndërronte ai. Natyrisht, synimet e Dë Golit nuk mund të arriheshin, pse edhe partnerët e tij kishin qëllimet, synimet dhe frikën e tyre. Këto

shtete nuk e konceptonin të tërë njësoj rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë dhe në botë. Gjermania Perëndimore, në radhë të parë, aktualisht e ndarë nga pjesa tjetër e vendit, preferon t'u bëjë disa koncesione Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fusha të tjera, pa ndjekur rrugën e Francës në shkëputjen nga mbrojtja amerikane. Gjermania dhe partnerët e tjerë nuk e vlerësojnë «forcën atomike» jo vetëm të Francës, por as atë të Anglisë, bile as të Anglisë dhe të Francës të marra së bashku. Kjo forcë, mendojnë ata, është një «shkurtabiq» përpara forcës bërthamore sovjetike ose amerikane.

Të gjitha këto fuqi imperialiste, qofshin dy superfuqitë, qoftë «Evropa e Bashkuar», qoftë Japonia, aspirojnë për hegjemoni. «Evropa e Bashkuar», që kur filluan kriza e rëndë e dollarit dhe disfatat ushtarake amerikane në Azinë Juglindore — në Vietnam, në Kambodhia e gjetkë, ka filluar të rforcojë pozitat politike të brendshme dhe të aspirojë më shumë, që, si një organizëm më vete, të kthehet në një superfuqi të re kapitaliste dhe imperialiste. Ja, pra, këtë «Evropë të Bashkuar» inkurajon dhe ndihmon Kina e Mao Ce Dunit. Këtë «Evropë të Bashkuar» inkurajon dhe ndihmon Franca e Pompidusë dhe më pas ajo e Zhiskarit, e cila jo vetëm përpiqet ta ruajë dhe ta zhvillojë më tej forcën e saj bërthamore, por ka filluar më aktivisht të ringjallë politikën e vjetër kolonialiste me petka neokolonialiste në Afrikën frankofone, në Lindjen e Mesme dhe në Lindjen e Largme. Forcat e saj ekonomike nuk e lejojnë Francën të konkurrojë të tjerët, por, me aq sa mundet, ajo këtë e bën. Qëndrimi i Francës ndaj Shte-

teve të Bashkuara të Amerikës nuk është më si ai i kohës së Dë Golit dhe të Pompidusë. Tani ky qëndrim është ca më i zbutur, por, megjithatë, në të duket pavarësia e saj. Edhe Anglia vazhdon të forcojë disi ndikimin e humbur ekonomik në vendet e Komonuelthit, kurse Boni po ndërhyr ekonomisht në Evropën Qendrore, në Ballkan (përveç Shqipërisë), në Turqi dhe kudo ku mundet rreth e rrotull.

Të gjitha këto përpjekje të tyre mund ta shtojnë potencialin ekonomik të përbashkët, i cili duhet të jetë një faktor për të qenë një superfuqi. Por, për t'u bërë superfuqi, nuk mjafton vetëm ky faktor. Kësaj «Evropë të Bashkuar» i mungon forca bërthamore që kanë dy superfuqitë. Nga ana tjetër, në këtë «Evropë të Bashkuar» ekzistojnë kontradikta të mëdha politike dhe ekonomike ndërmjet shteteve që e përbëjnë, saqë as për dhjetëra vjet nuk mund të arrihet prej saj ai potencial ekonomik dhe ushtarak që kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. «Shtetet e Bashkuara të Evropës» nga shumë pikëpamje nuk u ngjasin Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Është zor që këto shtete evropiane të asimilohen, siç janë asimiluar ato shtete të kontinentit amerikan, nga të cilat u formuan Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çdo shtet në Evropë ka personalitetin e tij si komb, të formuar historikisht, me shekuj. Gjithsecili prej tyre ka historinë e vet, ka zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të ndryshëm prej të tjerëve. Çdo shtet kapitalist e revizionist evropian në vetvete ka brendapërbrenda kontradikta të forta klasore, të cilat e bëjnë të zorshtëm jo vetëm unitetin e jashtëm, por edhe atë të brendshëm.

Pra, të mbështetësh, siç po bën Kina, një rrugë të kapitalizmit evropian, i cili aspiro për hegjemoni, aspiro për të bëhet një superfuqi, parimisht nuk është e drejtë. Të veprosh kështu do të thotë të lësh në harresë rrugën e revolucionit dhe të futesh në ingranazhin e lojës politike të dy superfuqive, duke luftuar dhe duke manovruar nga pikëpamjet e politikës së tyre, duke mbivlerësuar manovrimet e superfuqive në situatat koniunkturale të kontradiktave që kanë dhe duke nënvleftësuar revolucionin proletar botëror, duke nënvleftësuar luftën e popujve kundër superfuqive dhe shteteve kapitaliste borgjeze. Kina gabon kur predikon se «armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë më pak të rrezikshme». Shtetet e Bashkuara të Amerikës është e vërtetë që kanë pësuar disfata, por ato mbeten fuqi imperialiste. Të dobësosh luftën kundër tyre do të thotë të dobësosh revolucionin dhe të ndihmosh imperializmin amerikan. Të njëjtin gabim do të bëjnë kinezët në rast se Shtetet e Bashkuara të Amerikës «do t'u ngrihen qimet e ujkut»; atëherë Kina do të fillojë të thotë se «Bashkimi Sovjetik është më pak i rrezikshëm, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bënë më të rrezikshme». Kina gabon kur vihet në pozitat e Don Kishotit ndaj Evropës së vjetër kapitaliste, gjoja sepse kjo do të bëhet një kundërpeshë për sovjetikët nga njëra anë dhe për amerikanët nga ana tjetër, kurse «Kina do të fitojë», meqenëse ajo mbështet «Evropën e Bashkuar».

Kontradiktat ndërmjet imperialistëve duhen thelluar dhe shfrytëzuar në dobinë tonë, por vetëm nga pozitat klasore, nga pozitat e revolucionit proletar. Këtë

Kina nuk e bën, por bën të kundërtën, duke u thënë popujve të Evropës, të Amerikës dhe të «botës së tretë»: «Mbështetni borgjezinë tuaj kapitaliste dhe imperialiste, sepse armiku kryesor është socialimperializmi sovjetik». Kjo rrugë nuk është leniniste, kjo nuk nxit revolucionin, por mbron atë oportunizëm që mbrojtë Internacionajla e Dytë, të cilën e ka demaskuar Lenini. Ne, pra, nuk mund të pajtohemi me këtë strategji dhe taktikë të Kinës. Për ne lufta kryesore kundër superfuqive imperialiste dhe kapitalizmit botëror është lufta e popujve, lufta e proletarëve, është revolucioni proletar botëror. Në këtë prizëm dhe duke i mbështetur këto luftëra të drejta, ne duhet të manovrojmë dhe të përfitojmë nga koniunkturat, duke ndihmuar në thellimin e kontradiktave.

Kontradiktat dhe krizat në gjirin e imperializmit, të socialimperializmit dhe të kapitalizmit botëror e kanë burimin në shtypjen e popujve nga kapitalistët dhe në luftën që bëjnë këta popuj kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist. Atëherë duhet nxitur dhe ndihmuar lufta e popujve kundër kapitalistëve, apo duhen ndihmuar këta të fundit që të manovrojnë për t'u majmur e për t'u bërë luftë njërit ose tjetrit imperialist, duke u thënë popujve «Shkoni e vrituni ju për mua»? Marksistë-leninistët duhet të nxitin, të ndihmojnë dhe të bashkojnë forcat e tyre me luftën e popujve, me luftën e proletarëve kundër superfuqive imperialiste dhe kapitalizmit botëror. Këtë rrugë ka ndjekur dhe do të ndjekë Partia jonë e Punës.

Politika e jashtme e gabuar e Maos, në këtë drejtim, të jep përshtypjen se është simpliste. Në këtë poli-

tikë kinezët jo vetëm që nuk nisen nga pozitë klasore proletare, por, pa e thënë, bile edhe duke e mohuar me fjalë, ata ecin në rrugën e një fuqie të madhe. Kina nuk është një superfuqi, po ndikimi i saj në çështjet botërore është dhe mund të jetë i madh. Kina mund të luajë dhe do të luajë një rol në botë në njërën nga këto dy rrugë: ose në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e revolucionit, ose në rrugën borgjezo-kapitaliste, me një nuancë të re revizioniste. Vetëm duke milituar në rrugën marksiste-leniniste revolucionare, Kina do të fitojë besimin e popujve, të cilët duan dhe luftojnë për revolucionin.

Kina, aktualisht, përpigjet të bindë vendet kapitaliste se «rreziku atyre u vjen nga Bashkimi Sovjetik». Se mos Kina po u mëson ndonjë gjë të re kapitalistëve të botës! Por armik kryesor kapitalistët kanë komunizmin dhe revolucionin. Në rast se Kina ecën në rrugën revolucionare, thënia e saj se «Bashkimi Sovjetik revizionist është armiku kryesor» jo vetëm që nuk do të bindë njeri, por gjithë kapitalistët, të çdo ngjyre qofshin, do t'i drejtojnë goditjet kundër Kinës. Në rast se aktualisht ata nuk ia kanë frikën Kinës, kjo ka disa arsye: ose sepse Kina është komuniste vetëm me fjalë dhe jo me vepra, ose sepse ende është e dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht, ose sepse është një faktor anti-sovjetik që duan ta përdorin deri në fund për të dobësuar agresivitetin e sovjetikëve kundër tyre.

Politika e të dyja palëve, e kinezëve dhe e amerikanëve, ka për qëllim të luftojë Bashkimin Sovjetik, por, ndërsa kinezët duan të ndërsejnë amerikanët kundër Bashkimit Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Ame-

rikës dhe aleatët e tyre duan të ndërsejnë Kinën kundër Bashkimit Sovjetik. Të dyja palët e zhvillojnë këtë *chassé-croisé*<sup>1</sup> nga të njëjtat pozita dhe me të njëjtat shpresa. Por veç Bashkimi Sovjetik nuk rri me duar lidhur. Ai përpiqet të evitojë luftën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të dominojë mbi popujt që mund të shtypë vetë, të prishë aleancën e NATO-s dhe të izolojë Kinën, mundësisht edhe ta nënshtrojë atë. Dhe të gjitha këto synime ai i zhvillon nën maskën e socializmit.

Kapitalizmi botëror, dhe veçanërisht ai evropian, ka kaluar një sërë luftërash botërore, që e kanë pasë burimin në natyrën e tij të egër. Kështu që «Evropa e Bashkuar», ose Franca e Zhiskar d'Estënit, ose Gjermania Perëndimore nuk gënjehen kollaj nga politika e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit. Ato nuk futen në luftë me sovjetikët pse u fryn në vesh Ten Hsiao Pini. Jo, ato përpiqen ta evitojnë përplasjen me Bashkimin Sovjetik, derisa atë e gjykojnë më të fortë se veten e tyre, përpiqen ta krimbin kalanë nga brenda, pastaj të përgatitin goditjen. Të gjithë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Franca, Republika Federale e Gjermanisë etj., përpiqen t'i dobësojnë sovjetikët, t'i dobësojnë në aleancat që kanë me Poloninë, me Rumaninë, me Çekoslovakinë etj., por ashtu siç do Kina, ata nuk ecin. Ujqit e vjetër i dinë mirë taktikat e sulmit, prandaj është zor t'i çosh në ato shtigje nga të vjen për mbarëty, pse të tilla plane i kanë përdorur dhe vazhdojnë t'i

---

1. Frëngjisht — ndërrim reciprok dhe i njëkohshëm i vendeve të të dyja palëve.

përdorin vetë, pikërisht edhe në drejtim të Kinës. Presidenti i Francës me siguri e ka dëgjuar me një vesh të shurdhër përrallën e «rrezikut sovjetik». Sigurisht Zhishtar d'Estëni i ka thënë Ten Hsiao Pinit se ne dëshirojmë ta zhvillojmë miqësinë me Kinën, por jo kundër Bashkimit Sovjetik, sepse duam të evitojmë konfliktin. Por, nga ana tjetër, D'Estënët me shokë indirekt nxitin Tenin të shkojë kundër sovjetikëve, të nxjerrë gështenjat nga zjarri dhe ata të bëjnë shir.

Borgjezia evropiane është dinake e vjetër. Ajo është e regjur në dredhi dhe në intriga. Vetëm lufta revolucionare e proletariatit dhe e popullit i vjen hakut asaj. Në këtë terren lufte ajo demaskohet dhe thyhet, e humbet forcën e intrigës dhe të dredhisë. Nga ky terren duhet të luftojë edhe Kina, e cila duhet të niset nga parimi që njohjet diplomatike dhe tregtia me vendet kapitaliste të Evropës t'i shërbejnë një strategjie të shëndoshë revolucionare, e jo të përpiqet të ndërsejë Evropën Perëndimore kundër sovjetikëve. Këtë rrugë të gabuar të Kinës e kanë përdorur më parë Anglia dhe Franca për të nxitur Hitlerin kundër Bashkimit Sovjetik dhe Bashkimin Sovjetik kundër Gjermanisë. Ne e dimë rezultatin e këtyre manovrave. Stalini nuk ra në këto gabime, nuk ra as në pozitat e anglo-amerikanëve, as në ato të hitlerianëve.

Duke qëndruar në pozita të forta revolucionare, edhe kontradiktat e armiqve mund t'i shfrytëzosh më mirë, edhe t'i dobësosh, në radhë të parë, më të rrezikshmit, por pa harruar as ata që për një moment mund të jenë dobësuar e që mund të ringjallen. Po t'i gjykosh ngjarjet dhe situatat nga pozita revolucionare, e shih



gartë se nuk ke si mbështetje një faktor koniunktural, por ke një potencial shumë të fuqishëm dhe të qëndrueshëm në luftën kundër kapitalit, ke proletariatin e çdo vendi dhe në tërësi proletariatin ndërkombëtar, si edhe popujt që duan lirinë dhe revolucionin. Revolucionin duhet bërë duke luftuar edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe kundër Bashkimit Sovjetik.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Superfuqitë», f. 396*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Superfuqitë»,  
f. 396*

# LUFTA KUNDËR BUROKRATIZMIT — PROBLEM I MASAVE TË GJERA TË POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 qershor 1975

Para se të fillojmë mbledhjen dëshiroj që, në emrin e shokëve dhe në emrin tim, t'u uroj anëtarëve dhe kandidatëve të rinj të Byrosë Politike<sup>2</sup>, që u zgjodhën nga Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të Partisë, punë të mbarë e të suksesshme për të mirën e Partisë dhe të atdheut tonë socialist.

Zgjedhja juaj në këtë forum do të jetë një ndihmë e madhe për Byronë Politike dhe për gjithë udhëheqjen,

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Kryesia e Këshillit të Ministrave të RPSH «Për përfundimet e deritanishme në luftën kundër burokratizmit dhe në veçanti në drejtim të thjeshtimit të aparateve shtetërore dhe ekonomike».

2. Është fjala për shokët Hekuran Isai e Pali Miska, anëtarë të Byrosë Politike të KQ të PPSH, dhe për shokët Llambi Gegprifti e Qirjako Mihall, kandidatë të Byrosë Politike të KQ të PPSH.

sepse me elementë relativisht të rinj në moshë, por të vjetër në radhët e Partisë dhe me eksperiencë të madhe pune në bazë, udhëheqja forcohet. Byroja Politike ka pasur dhe do të ketë kurdoherë nevojë për eksperiencë nga baza.

Siç e dini, shokë, në forumet e Partisë, dhe veçanërisht në forumet kryesore, duhet të zotërojnë uniteti në mendime e në veprime. Ky unitet i shëndoshë ka ekzistuar kurdoherë në Partinë tonë, duke filluar që nga organizata-bazë e deri lart në Komitetin Qendror të Partisë e në kongreset e saj.

Nuk është nevoja t'ju them se qenia në Byronë Politike kërkon, ashtu si kurdoherë, zbatimin me përpikëri të normave marksiste-leniniste të Partisë sonë, marrëdhënie të çiltra e të sigjerta në mes gjithë shokëve të Byrosë Politike dhe shpirt revolucionar.

Rëndësi ka që kurdoherë të gjithë shokët të shprehin në Byronë Politike mendimet e tyre në mënyrë të hapët për çdo problem dhe për çdo person. Duke e ndier veten plotësisht të barabartë me shokët, secili prej nesh të ushtrojë pa asnjë dallim të drejtat dhe të zbatojë detyrat që i kanë caktuar Kongresi i Partisë dhe Komiteti i saj Qendror.

Përpara detyrave të mëdha që na dalin dhe situatave të vështira që na krijohen e mund të na krijohen përsëri nga shkaqet që dimë, këtej e tutje puna jonë do të vazhdojë më me vrull, më me hov revolucionar. Partia nuk ka pasur kurrë frikë nga lufta dhe nga ndeshjet me dredhitë e armiqve të brendshëm e të jashtëm, që nuk qëndrojnë në pozitat marksiste-leniniste.

Jemi të bindur se shokët e zgjedhur rishtas do të

na japin një ndihmë shumë të madhe. Ne të vjetrit eksperiencën që kemi ta bashkojmë me atë të shokëve të rinj dhe, në unitet të çeliktë me ta, të përpiqemi të japim ndihmën tonë modeste për mbarëvajtjen e punëve. Ka shumë rëndësi që në udhëheqje, siç theksova më lart, të ekzistojë një unitet i çeliktë marksist-leninist. Ky është kushti i parë e i domosdoshëm për t'i drejtuar kolegjisht Partinë dhe shtetin e për t'i kryer secili me sukses detyrat në vendin ku e ka caktuar Partia.

Tani fillojmë nga çështja e parë e rendit të ditës. Shokët mund të bëjnë pyetje rreth materialit që ka përgatitur Kryesia e Këshillit të Ministrave, pastaj të shprehin edhe mendimet e propozimet për korrigjime, në qoftë se ka, lidhur me masat që do të merren. Studimi për këtë problem është kryer që nga baza e deri këtu në qendër.

*Pasi diskutuan edhe pjesëmarrësit e tjerë të mbledhjes, shoku Enver Hoxha tha:*

Jam dakord me raportin që na ka paraqitur Kryesia e Këshillit të Ministrave, me diskutimet që bënë shokët, si dhe me vërejtjet e shokëve të aparatit të Komitetit Qendror lidhur me këtë raport.

Lufta kundër burokratizmit është një çështje me rëndësi të madhe politike dhe ideologjike, të cilën nuk mund ta shpjegojmë me një bisedë që bëjmë në Parti, as me një, me dy ose edhe me pesë mbledhje. Nevoja e luftës kundër burokratizmit duhet të ngulitet thellë, si me çekan, në ndërgjegjen e njerëzve. Të kuptohet mirë se kjo luftë shtrihet në një terren mjaft të gjerë, që përfshin shumë sfera, prandaj duhet zhvilluar në disa aspekte. Pikërisht kjo anë e problemit, më duket mua,

nuk konceptohet në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Edhe në qoftë se kemi folur kaq shumë në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë ose në fjalimet tona për luftën kundër burokratizmit e për shfaqjet e tij, të gjitha këto nuk janë marrë gjithmonë seriozisht e ndonjëherë janë përdorur edhe si slogane.

Unë përsëri ngul këmbë që me këtë problem kaq të madh është e domosdoshme të merret jo vetëm një rreth i kufizuar njerëzish, që punojnë në sektorin e agjitacionit dhe të propagandës së Partisë, por edhe sekretarët e komiteteve të Partisë në rrethe dhe gjithë kuadrot e tjerë. Këta e kanë për detyrë të thellohen e të vrasin shumë mendjen në këtë drejtim, në mënyrë që lufta kundër burokratizmit të bëhet nga Partia, nga organizata e Bashkimeve Profesionale, e Bashkimit të Grave, e Bashkimit të Rinisë etj., pra të bëhet problem i masave të gjera të popullit.

Që të mund të dalim me studime sa më të plota, të qarta e të kuptueshme për shfaqjet e burokratizmit dhe për luftën kundër tyre, duhet të shfletohen veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit e dokumentet e Partisë sonë, si dhe të njihet tërë eksperiencia e saj e madhe tridhjetë e ca vjeçare. Nuk është fjala këtu për studime të ndërlikuara filozofike, po për materiale të përgatitura mirë, konkrete, praktike e të kuptueshme nga anëtarët e Partisë dhe nga gjithë të tjerët.

Lufta kundër burokratizmit nuk ka të bëjë vetëm me shkurtimin e organikave, por me punën e vazhdueshme e të pandërprerë për ndryshimin e një botëkuptimi të tërë të gabuar, të formuar për një kohë të gjatë. Në radhë të parë ajo duhet shtruar politikisht dhe ideo-

logjikisht, domethënë të ekspozohet rreziku i madh i burokratizmit, si çështje koncepti e praktike antimarksiste, si stil dhe metodë pune e gabuar, e cila ka krijuar shtimin e drejtorive, të degëve, të administratave, të nëpunësve, ka gjymtuar zërin e masës etj., etj. Mund të punohet shumë me njerëzit për të sqaruar teorikisht të këqijat e burokratizmit, por kjo punë nuk do të ketë vlerë në qoftë se vazhdojmë të udhëhiqemi në praktikë nga koncepte, stil e metodë burokratike, antimarksiste. Edhe sikur të shkurtohet deri në minimum organika, asgjë e dobishme nuk do të dalë në qoftë se ata që mbeten vazhdojnë të punojnë sipas koncepteve të vjetra burokratike. Në një rast të tillë do të hiqen këmbët zvarrë dhe puna do të mbetet prapë në mes të rrugës.

Udhëheqja të ketë parasysh që konceptet e njerëzve s'duhet të ndryshojnë vetëm në përmbajtjen e tyre filozofike; ky ndryshim është i domosdoshëm të pasqyrohet edhe në veprimtarinë praktike të secilit, pse vetëm kështu do të shkojmë në rrugën e drejtë me të vërtetë marksiste-leniniste të Partisë. Në qoftë se nuk do të kuptohet thellë dhe drejt ideologjikisht nevoja e luftës kundër burokratizmit, atëherë, me masat që po merren, njerëzit që do të lëvizin, mund të mbeten edhe të pakënaqur. Për problemin që ngre shoku Manush [Myftiu] lidhur me vështirësitë e sistemimit në punë të atyre punonjësve që shkurtohen nga organikat, Partia duhet të luftojë me kokë dhe me gjoks për ta çuar punën përpara. Unë kam folur në mënyrë të veçantë se si duhet t'i kuptojë Partia këto probleme.

Të qarkullosh nuk do të thotë se vete në bazë vetëm për tre vjet, por me një afat të pacaktuar, për të punuar

rregullisht, ndoshta edhe tërë jetën, në detyrën që të është besuar. Mirëpo, siç del, ka raste që qarkullimi nuk është kuptuar drejt. Ne nuk e bëjmë qarkullimin për arsye se njëri ose tjetri ka qëndruar gjatë këtu në Tiranë. Ky bëhet, në radhë të parë, në dobi të punës dhe të vetë atij që qarkullon. Në qoftë se nevoja e kërkon që një kuadër të shkojë për të punuar, ta zëmë, nga Gjirokastra në Tropojë, ai duhet të jetë i gatshëm të nisat atje sa më parë. Ne do të përpigemi, sa të jetë e mundur, t'i evitojmë lëvizjet pa vend e të mos lejojmë vajtje-ardhje të kota. Por, ama, kur e do puna të qarkullohet, secili duhet të bindet dhe të shkojë sa më parë në krye të detyrës.

Studimi i bërë, natyrisht, nuk mund të thuhet se është i plotë. Ne duhet t'u futemi akoma më thellë këtyre çështjeve. Bile, lypset të merren masa që të rishikohen tërë ata njerëz që janë futur në forma jo të rregullta në detyra nëpunësie. Ata mund të jenë sistemuar në vende që tash ne do t'i shkurtojmë, si, bie fjala, nëpër hozrashote etj., etj. Një fshatari që ka punuar në qytet, në qoftë se nuk është specialist, që shteti të ketë nevojë për punën e tij atje ku është, mund t'i bëjmë thirrje të kthehet përsëri në fshatin e vet për të punuar në kooperativën bujqësore. Ne e kuptojmë se nuk është aq e lehtë që një djali 28-vjeçar, për shembull, i cili ka zënë punë këtu në Tiranë, t'i thuash sot: «Hajde tani, shko në fshat!», por këtë gjë duhet ta bëjmë, se s'kemi rrugë tjetër. Për këtë qëllim kërkohet një punë e thellë politike, që tek ai që do të ikë nga qyteti në fshat të krijohet bindje për domosdoshmërinë e këtij veprimi.

Shumë djem të rinj kanë zënë vende pune nëpër ndërmarrje e institucione këtu në Tiranë, në të cilat mund të punojnë fare mirë edhe gratë. Këta mund të nisen për në ndërmarrjet bujqësore dhe në punët e tyre të vendosen gra. Për realizimin e lëvizjeve të tilla apo për zënien me punë të njerëzve që kanë qenë në marrëdhënie pune e vazhdojnë të marrin rrogë, duhet të kemi një kufi, se afatet ikin kollaj. Ne mund ta shtyjmë edhe një muaj, fjala vjen, por jo 4-5 muaj, që njerëzit edhe të rrinë pa punë, edhe rrogën ta marrin. Kjo nuk duhet lejuar, ndryshe duhet të caktohen shuma pagash kolosale për ata që nuk punojnë. Afatin e japim që të bëjmë një punë politike të thelluar dhe me qëllim që burrat e aftë për punë të lënë qoshet e ngrohta e të rehatshme që kanë zënë e të ngrihen të shkojnë në fshat ose në minierë, dhe në vend të tyre të vendosen gra që aktualisht janë të pazëna në punë.

Krahas kësaj, të punojmë që të rinjtë dhe të rejat, që kanë mbaruar shkollat e mesme, të sqarohen politikisht dhe ideologjikisht e ta kuptojnë se për ta nuk është vendi vetëm në qytet. Në qytete do të vendosen në punë aq njerëz sa vende pune ka, të tjerët do të dërgohen për të punuar anembanë Shqipërisë, kudo që të ketë punë. Prandaj të luftojmë konceptin e shtrembër, sipas të cilit atij që është me banim në Tiranë duhet t'i jepet punë doemos po në Tiranë. Ta kemi të qartë se, po të veprohet kështu, në të ardhmen do të kemi vësh-tirësi për vende pune në qytete, prandaj do t'i drejtojmë njerëzit për punë edhe në bujqësi, në fshat, në minierë, në sharra.

Në fillim ai që shkon në bujqësi apo në minierë, do



të ketë disa vështirësi, por, megjithatë, duhet të vejë sa më parë në punë, sepse nesër do të vijmë në situatë të atilla që çështja do të shtrohet: «Ose do të shkosh të punosh e të djersish atje ku ka nevojë shoqëria dhe të realizosh normën e punës, ose ndryshe nuk ke si rron, se nuk jemi në gjendje që t'u gjejmë të gjithëve punë pranë familjes». Situatat e zhvillimit na i krijojnë këto kushte. Në socializëm puna i sigurohet vërtet çdo njeriu, sipas Kushtetutës, por kjo e drejtë realizohet duke vajtur secili atje ku ka nevojë atdheu. Sa njerëz paraqiten për punë, të tërëve nuk mund t'u plotësohen dëshirat për të punuar atje ku duan. Njëri thotë «dua punë të lehtë»; tjetri kërkon të punojë në tornio; një i tretë kundërshton punën, fjala vjen, në Valias, «duke arsyetuar» se nuk mund të punojë në qymyr. Po t'u tregosh minierën disa njerëzve, që shumë mirë mund të punojnë në tokë, bëhet kiamet i madh! Kjo do të thotë se parulla e Partisë «Të punojmë kudo ku ka nevojë atdheu» nuk është kuptuar drejt nga të gjithë. Atyre që kanë arritur moshën 45 ose 50 vjeç nuk u thotë njeri «Shkoni tani nga Tirana në Tropojë!», por, ama, edhe tek mikroborgjeze të disa njerëzve të përkëdhelur nuk mund të plotësohen! Konceptin e punës së rehatshme ne duhet ta kritikojmë e këtë qëndrim të drejtë t'ia bëjmë të njohur secilit.

Mua më kanë ardhur edhe letra, ku disa njerëz ankohen për lëvizjet që u bëhen, ndonëse këto janë me vend. E tillë është letra e një gjeologu, që më shkruan: «Shoku Enver, ju lutem shumë, ndërhyjni që të qëndrojmë në Tiranë, se këtu kam gruan dhe mëmën 69 vjeçe!». Këtij gjeologu, që më drejton një letër të tillë, i përgji-

gjem: «Nuk ke turp që më shkruan një letër si kjo? Nuk ka në Tropojë gra që jetojnë me burrat e tyre? Nuk ka edhe atje mëma që rrojnë nga 100 vjet? Po nevojat e atdheut nuk të shqetësojnë ty? Partia dhe shteti të kanë mësuar që të zbulosh minerale, kudo ku gjenden ato, nëpër male, nëpër shpella etj.». Ja, pra, çfarë konceptesh! Po nuk u luftuan koncepte të tilla antisocialiste, ata që mendojnë si gjeologu që sapo përmenda, do të mbeten të pakënaqur nga lëvizjet që do t'u bëhen. Prandaj duhet të vazhdojë me këmbëngulje puna bindëse. Këtë përfundim e nxjerr duke gjykuar nga fakti që gjeologu dhe disa të tjerë si ky, megjithëse janë njohur me orientimet e Partisë për këto çështje, përsëri e quajnë «të padrejtë» largimin nga Tirana! Na duhet të luftojmë me këmbëngulje kundër këtyre koncepteve frenuese e të dëmshme të rrënjosura thellë në ndërgjegjen e njerëzve.

Për fryrjen e aparateve, për shtesat e organikave e të listorganikave kanë faje edhe shokët drejtues të Partisë e të shtetit që kanë lejuar anomalitë e vërtetuara. Në shkolla të larta disa herë janë dërguar studentë pa kritere të studiuara mirë. Shpesh është dhënë porosia: «Oburra, të dërgohen sa më tepër njerëz në shkollat e larta!». Dhe, pasi vërehen teprime të mëdha, atëherë kujtohen se ç'bënë dhe thonë: «More, ku po shkojmë kështu? Ku do t'i çojmë këta mijëra njerëz?». Tani na duhet t'i rishikojmë me shumë kujdes të gjitha dobësitë e punës, po zgjidhjet që do të praktikojmë duhet të jenë në rrugë të drejtë e jo të mbyllen shkolla, siç thotë Thoma Deliana! Si mund t'i mbyllim shkollat, kur njerëzit tanë, për t'i shërbyer sa më mirë atdheut,

në radhë të parë, duhet të jenë të mësuar? Së dyti, kur shqyrtojmë dhe zgjidhim këto probleme, duhet të kemi parasysh edhe shtimin e popullatës.

Të tëra këto çështje t'i studiojmë një nga një e me kujdes. Po kush do t'i studiojë? Shteti ynë. Unë jam dakord që kjo detyrë t'i ngarkohet Komisionit të Planit të Shtetit, po ky nuk mund të bëjë asgjë në qoftë se çdo komitet ekzekutiv rrethi nuk ndjek me vëmendje të vazhdueshme zhvillimin e demografisë dhe të ekonomisë, me qëllim që të krijohet një pasqyrë e qartë, për shembull, se sa nxënës e studentë ndjekin sivjet shkollat e rrethit dhe sa vitin që vjen, sa njerëz dalin në pension dhe sa mbeten në punë, sa janë të sëmurë e sa të shëndoshë, sa të rinj mbarojnë shkollat e mesme e të larta dhe sa vende vakante hapen për t'i futur këta në punë, sa të rinj kemi në punë, sa mesoburra e sa mesogra, pleq e të tjera. Në qoftë se nuk veprohet kështu, mendoj se studimet e Komisionit të Planit të Shtetit do të jenë të kufizuara e mekanike, me të cilat do të harrohet një planifikim pa baza, që mund të na çojë në situata të vështira.

Unë kam folur edhe herë të tjera për rolin dhe për detyrat e zyrave të punës pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Me aq sa kam mundur, kam orientuar se si duhet të veprojnë këto zyra, si të organizohen e si t'i studiojnë çështjet që përmenda më sipër. Tash nuk them dot çfarë bëhet konkretisht në këto drejtime, por kam përshtypjen që akoma nuk po bëhet gjë. Në qoftë se zyrat e punës akoma nuk bëjnë një punë shkencore dhe nuk ia komunikojnë medoemos rezultatet e kësaj pune Komisionit të Planit të Shtetit,

kjo do të thotë se nga ana e tyre nuk është vënë uji në zjarr për këto probleme kaq të mprehta ekonomiko-shoqërore.

Tash po u dërgohen rretheve ata punonjës që shkurtohen nga Tirana për t'i sistemuar në punë. Por, siç marrim vesh, thonë se nuk kanë ku t'i sistemojnë, se u kanë mbetur pa u sistemuar në punë punonjësit që kanë shkurtuar vetë etj. Bile, ka ndodhur që edhe kur janë dërguar kuadro me eksperiencë, rrethet kanë thënë se nuk kanë nevojë për ta! Po si nuk paskan nevojë atje për kuadro me arsim të lartë? Shokët e rretheve kundërshtojnë t'i pranojnë ata që u dërgohen nga Tirana, jo se nuk kanë nevojë për punën e tyre, por sepse nuk kuptojnë drejt direktivat e Partisë, se pengohen nga disa koncepte të gabuara. E kanë më zor shokët t'i thonë një punonjësi në rreth që të vejë, fjala vjen, nga Gjirokastra në Lazarat<sup>1</sup>, sesa t'i thonë një kuadri me arsim të lartë, që ka qenë deri dje drejtor në ministri: «Shko, vëlla, nga ke ardhur, se nuk kemi nevojë për ty!». Këto nuk janë qëndrime të drejta.

Për këto arsye mendoj që në rrethe duhen studiuar me shumë vëmendje këto probleme me karakter të mprehtë ekonomik dhe shoqëror. Duhet pasur kujdes për problemin e edukimit, për të cilin janë të interesuara të gjitha dikasteret që kanë të bëjnë me kurset e specializimit në ndërmarrjet etj. Mua më duket se një problem i tillë duhet përqendruar, por jo në një organizëm të vetëm, siç është Qeveria, se kjo ka në varësi të gjitha ministrinë dhe komitetet ekzekutive të rretheve.

---

1. Fshat afër Gjirokastrës.

Do të them diçka edhe për kontrollin shtetëror. Çështjen e kontrollit e kemi studiuar në Komitetin Qendror më 1966. Pastaj i rekomanduam Qeverisë të përgatiste dhe të paraqiste njëfarë projekti për këtë problem. Më vonë kjo çështje u la dhe nuk e di pse u la, por ndoshta për arsye se në atë kohë kemi pasur Komisionin e Kontrollit të Shtetit, siç quhej atëherë Inspektimi i Shtetit që kemi sot, ngritur në rangun e një ministrie. Ish-Komisioni i Kontrollit të Shtetit, nga mënyra si vepronte në atë kohë, ka qenë një apendicit pranë Qeverisë, ndërsa tani nuk ekziston më<sup>1</sup>.

Qeveria, siç i thashë edhe shokut Spiro Koleka, ka një organ të madh kontrolli, Inspektimin e Shtetit, ku punon një grup punonjësish, të shumtë në numër dhe me eksperiencë, që dërgohen atje ku sinjalizohet se ka ndodhur diçka që meriton të shikohet. Veç këtij Inspektimi, Qeveria ka edhe drejtoritë e kontrollit e të revizionit nëpër ministritë e ndryshme, seksionet e kontroll-revizionit nëpër rrethe, zyrat e kontrollit financiar në ndërmarrjet ekonomike e në kooperativat bujqësore, pra tërë ata organizma që u përmendën këtu. Mbi të gjitha këto kontrole qëndron kontrolli i Partisë.

---

1. Duke u udhëhequr nga direktivat e Kongresit të 9-të të PPSH për forcimin e mëtejshëm të kontrollit dhe të disiplinës shtetërore, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi Popullor i RPSSH, më 21 shkurt 1987 miratoi ligjin nr. 7103, në bazë të të cilit u krijua Komisioni i Kontrollit të Shtetit, organ kolegjal vendimor në shkallë ministrie, me objekt kryesor të veprimtarisë së tij kontrollin e zbatimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe të masave për miradministrimin dhe ruajtjen e pronës socialiste.

Këto organe kontrolli ka rrezik të përplasen me njëri-tjetrin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, prandaj, për të evituar paralelizmat, duhet të rakordohen. Po kush do t'i rakordojë? Unë mendoj se këtë punë duhet ta bëjë Qeveria me organet e saj. Komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, kur është rasti, duhet të merren vesh drejtpërdrejt me Qeverinë dhe t'i kërkojnë kësaj që t'u dërgojë kontrollin shtetëror për të kontrolluar për këtë apo për atë problem.

Tani të flasim pak për kontrollin punëtor që Partia e ka organizuar sipas mësimëve të Leninit. Ne e dimë se në ç'gjendje e kemi këtë kontroll. Ndodh shpesh që ai nuk është i organizuar dhe sistematik, por bëhet me hope. Sipas Leninit, ka dy variante për ushtrimin e kontrollit punëtor. Njërin ai e kishte menduar më 1917, kur në Rusi kishte kaos dhe ndihej nevoja për të vendosur kudo një kontroll të fortë; tjetrin e kishte menduar më 1923. Për këtë qëllim atëherë Lenini i dha porosi edhe Stalinit që të bënte ndryshimet e duhura sipas situatës. Te ne situata aktuale nuk është ajo e të dy rasteve të kohës së Leninit. Megjithëkëtë, parimi leninist i ushtrimit të kontrollit punëtor qëndron.

Te ne ekziston kontrolli shtetëror i diktaturës së proletariatit, që është i stabilizuar mirë, por që mund ta përmirësojë edhe më tej punën e tij, ndërsa kontrollin punëtor nuk e kemi në këtë shkallë. Prandaj duhet ta forcojmë edhe këtë, në bazë të mësimëve të Leninit. Kjo kërkon që të mos lihet kështu siç është aktualisht, por të mendohet se si mund të organizohet më mirë një numër sa më i madh kontrollesh të tilla, ashtu siç tho-

shte Lenini, me pjesëmarrjen e grave dhe të burrave. Por mendoj që në to të jenë më tepër gra.

Mendimi im është që grupi i kontrollit punëtor, i formuar prej rreth 10-12 vetash, të dërgohet përnjëherësh për të bërë kontrole të befasishme në këtë apo atë dyqan, magazinë apo ndërmarrje, për gjendjen fizike të mallrave, për dokumentacionin etj. Një herë tjetër ky grup kontrolli mund të shkojë, për shembull, në uzinën «Traktori», ku të kontrollojë mënyrën e përdorimit dhe kursimin e materialeve, realizimin e planit të prodhimit në sasi, cilësi, asortiment etj., etj. Ne kemi shumë mundësi të veprojmë kështu, sepse tash kemi me mijëra specialistë të profesioneve të ndryshme dhe një-rëz të thjeshtë, e sidomos gra, me ndërgjegje të lartë politike, që mund të ndihmojnë.

Lenini e kishte shumë drejt kur shtronte detyrën që me punën e kontrollit të merreshin më shumë gratë. Një ndër arsyet që ua ngarkoi këtë detyrë krejtësisht grave mund të ishte dhe fakti se atëherë shumë gra në Bashkimin Sovjetik mund të ishin të pazëna në punë, por kjo nuk qe arsyeja kryesore. Sot te ne gati të tëra gratë janë të zëna me punë. Megjithatë, është e nevojshme që t'i dërgojmë për të kontrolluar ata sektorë ku këto paraqiten më tepër kompetente nga burrat, siç janë ndërmarrjet e prodhimeve tekstile, ushqimore, furrat e pjekjes e sektorë të tjerë të prodhimit, të tregtisë, të shëndetësisë, të shërbimit etj. Gratë janë të përshtatshme për kontrollin e disa sektorëve të punës e të jetës, se ato jo vetëm janë më kompetente e më të vëmendshme, por edhe më korrekte dhe «i nxjerrin vaj» punës. Për këto kontrole duhet të aktivizohen, veç

punonjësve të administratës dhe specialistëve, edhe pensionistë e të tjerë.

Po të formojmë grupe njerëzish për kontrollë, ashtu siç thotë Lenini, nën drejtimin e Partisë, punët do të na venë mirë. Kur të krijohen, ta zëmë, në Durrës, nja 30 ose 40 grupe të tilla, me nga 10-20 veta secili, dhe kur të vihen në lëvizje të gjithë këta si duket, duke u ndihmuar edhe nga komiteti ekzekutiv, si organ i këshillit popullor, me siguri që do t'u shtrëngohet «rripi» vjedhësve, shpërdoruesve e dëmtuesve të pasurisë socialiste.

Mua më duket se ajo që është vendosur në Qeveri për të pasur pranë aparatit të çdo komiteti ekzekutiv rrethi një deri në tre veta për kontroll, mund të na dëmtojë, sepse këta njerëz do të mendojnë sikur janë «epigendra e kontrollit», kurse epigendër në rreth, si kudo, s'janë këta, por në radhë të parë është Partia, është, gjithashtu, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit me aparatit e tij të kontrollit, siç janë seksionet, e sidomos ai i kontroll revizionit; pastaj janë edhe dikasteret qendrore. Çfarë kontrolli mund të bëjë në gjithë rrethin një njeri i vetëm ose qoftë edhe tre njerëz? Këta nuk do të jenë më të zotë nga ata që punojnë në organet dhe në aparatet e kontrollit që përmendëm. Prandaj, sado të aftë të ishin, nuk mund të merrnin përsipër të kryenin me sukses gjithë këtë kontroll të madh që do të ushtrojnë punëtorët dhe fshatarët. Nga ana tjetër, përse u dashka ta marrin përsipër dy-tre njerëz një detyrë kaq të rëndësishme kontrolli që i përket vetë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit? Përveç kësaj, po të pranohen shtesat që propozohen, do



të kufizohet shumë kontrolli, nuk do të jemi në gjendje t'i evitojmë vjedhjet, shpërdorimet e dëmtimet e pasurisë socialiste dhe nuk do të ngremë lart ndërgjegjen e komunistëve e të punëtorëve. Prandaj kam mendimin që problemin ta zgjidhim në format që thashë, ashtu siç na mëson Lenini. Të tilla forma kontrolli do të krijojnë bindjen te njerëzit se zot i pasurisë socialiste është vetë populli. Kjo bindje do t'i bëjë masat të gatshme që, me thirrjen e komitetit të Partisë, të shkojnë menjëherë për të kontrolluar dyqanin, magazinën etj. Cilido që të jetë personi përgjegjës që kontrollohet, ai duhet t'i japë llogari detyrimisht kontrollit të popullit, që është ngarkuar me ushtrimin e mbikëqyrjes.

Ne mund ta studiojmë problemin që grupet e kontrollit të kenë dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar mbikëqyrjen. Këto të drejta mund t'u jepen edhe me ligj. Për shembull, kur të shikojnë një rast flagrant të shkeljes së ligjshmërisë socialiste, kontrollorët të kenë të drejtë të vendosin deri edhe pushimin nga puna të fajtorit, apo t'ia denoncojnë menjëherë çështjen për veprim komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose organeve të hetimit, kur mendohet se është kryer ndonjë krim. Kështu duhet të bashkërendohen të tëra këto kontrole e kompetenca.

Ne duhet ta organizojmë mirë këtë mënyrë kontrolli, e cila do të na ndihmojë edhe për përmirësimin e dukshëm të punës me organikat. Duke bërë një kontroll për këtë çështje, ata që kontrollojnë do të shtrojnë pyetjen: «Ç'është ky funksionar që na rrika këtu «për kontroll» mbi funksionarët e tjerë?! Ne erdhëm këtu dhe ju kontrolluam brenda ditës, mirëpo po shohim që te

ju rrinë me muaj të tërë, pa bërë asgjë, një ose dy kontrollorë, që marrin rrogën vazhdimisht. Për çfarë arsye qëndrojnë këta këtu?». Kështu do të veprojnë njerëzit e popullit për të parandaluar edhe shumë gabime e të meta të tjera që ne dikur i kishim pranuar, duke menduar se janë gjëra të mira. . .

Nuk kam pse zgjatem më. Jam dakord me të gjitha diskutimet e shokëve. Më duket se fryma, pikëpamjet dhe metoda e punës që shtroi shoku Pali Miska kur diskutoi këtu, janë nga më të drejtat. Në qoftë se Partia në bazë mobilizohet në këtë frymë, ne do të kemi suksese. Duhet t'i kapërcejmë vështirësitë e përkohshme që na kanë dalë. Pakënaqësi të njerëzit e paformuar e të paqartë edhe mund të krijohen, por ne duhet të përpiqemi pa u lodhur që t'i sqarojmë e t'i bindim dhe ta mbajmë kursin gjithmonë në rrugë të drejtë.

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

# NË EDUKIMIN USHTARAK TË RINISË TË KEMI PARASYSHI VEÇORITË PSIKOLOGJIKE TË MOSHËS SË SAJ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 qershor 1975

Në fillim kisha disa pyetje. Ku bazohen mendimet që janë dhënë lidhur me përgatitjen ushtarake në shkollat e arsimit të përgjithshëm? Nuk e kam të qartë se përse nxënësit e këtyre shkollave duhet të bëhen të tërë këmbësorë. Në materialin që na është paraqitur shkruhet: «Mendojmë që në të ardhmen të forcojmë më tepër elementët e përgatitjes ushtarake, veçanërisht në klasat e 8-ta. . .». Por se ku do t'i çoni këta nxënës për t'i stërvitur, këtë nuk e marrim vesh. Mos kërkohet aprovimi ynë që të arrihet në një shërbim ushtarak njësoj si për ushtrinë edhe për këta kalamanë?! Këtu nuk është punë qitjeje, por është fjala për marshime

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën që bëhet për rritjen e nivelit të përgatitjes dhe të gatishmërisë luftarake të nxënësve, studentëve dhe paraushtarakëve.

të gjata, nëpër ballë, natën, në vapë etj. Po për shkollën tetëvjeçare ka kuadro ushtarakë?

Koha e përgatitjes ushtarake është llogaritur mekanikisht apo e lidhur edhe me lëndët e tjera mësimore? Mos është parë vetëm interesi i komandës dhe i oficerëve, pavarësisht se ndërpritet mësimi në shkollë, pa ndonjë kriter të caktuar? Unë e kuptoj që kjo punë duhet të jetë bërë e organizuar dhe e përcaktuar se cila klasë do ta bëjë stërvitjen në shtator, cila në shkurt e kështu me radhë, po e kam fjalën në lidhje me mësimet. Është mirë që të mos ndërpritet mësimi në një vend që nuk duhet të ndërpritet. Unë nuk e kam fjalën se mbas disa muajsh ndërpritën mësimet, po desha të di nëse Ministria e Arsimit dhe e Kulturës e ka bërë këtë ndërprerje me kritere të drejta apo e ka bërë në mënyrë mekanike. Shokët që merren me këto punë duhet ta kuptojnë mirë këtë çështje dhe të rregullojnë programet.

Gjatë kohës së stërvitjes ushtarake të nxënësve dhe të studentëve, duke përfshirë këtu edhe kursin që bëjnë studentët kur mbarojnë fakultetet, a plotësohet mirë stërvitja ushtarake e kësaj pjese të rinisë? Barazohet e gjithë kjo punë për edukimin ushtarak me shërbimin e ushtrisë aktive?

Nga gjithë kjo përvojë, që kur kemi futur këtë program pune në shkollë, a është analizuar çështja nëse kjo punë ka penguar përgatitjen teknike dhe arsimore të nxënësve? E kam fjalën jo vetëm për edukimin ushtarak, por edhe për punën në prodhim. Janë nxjerrë konkluzione për këtë çështje? Në qoftë se nuk është studiuar kjo punë, nuk është nevoja të na peri-

frazoni. Kur them se a është bërë studim, kam parasysh që Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të ketë udhëzuar dhe të ketë kërkuar të dhëna për këtë problem. Çdo shkollë e çdo kategorie i jep asaj të dhëna, jo vetëm disa shifra, nëse kaluan kaq apo aq, por edhe vlerësimin me nota. Këto nota a pasqyrojnë gjithmonë realitetin? Nxënësit shkollohen si duhet apo jo? Këtë desha unë, në qoftë se mund të na thuhet ndonjë gjë e bazuar.

Të kemi parasysh që nxënësit të cilët pas mbarimit të shkollës së mesme shkojnë në universitet, nuk bëjnë shërbim ushtarak. Për këtë edhe pyeta se si duket kjo gjë në praktikë. Studentët, pasi kanë mbaruar gjithë fazat e stërvitjes, qoftë ato gjatë vitit shkollor, qoftë atë pas mbarimit të shkollës së lartë, a janë të përgatitur si duhet nga ana ushtarake? Çështja është që të rinjtë të cilët mbarojnë shkollën e mesme, të përgatiten si ushtarë, ndërsa ata të universitetit si oficerë. Jo vetëm kaq, por studimi që mund të bëhet, duhet çuar edhe më tej, në të mund të konkludohet, për shembull, se studentët që mbarojnë fakultetet e shkencave të natyrës për fizikë, kimi etj., janë më të përgatitur nga ata që kanë studiuar kur nuk ishte vendosur akoma ky sistem i ri arsimor, për arsye se në këtë kompleks të formimit të studentëve ndihmon edhe ana ushtarake.

Është mirë që, lidhur me këto pyetje, t'i bëhet një raport Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë. Por ky raport të jetë i argumentuar me fakte, me mendime të sakta e i mbështetur në analizën e notave që janë marrë në lëndët e ndryshme mësimore, për të na vërtetuar se, në krahasim me vitet e mëparshme, niveli

teorik i nxënësve e i studentëve ka pasur ulje apo është ngritur etj., etj.

Përveç këtyre, për të cilët folëm deri tani, kemi edhe nga ata që nuk venë në shkollë të mesme, po mbarojnë vetëm tetëvjeçaren, sidomos në fshat. Këta të rinj punojnë derisa bëhen 19 vjeç dhe pastaj shkojnë ushtarë. Por ato kontingjente që vijnë nga shkollat e mesme janë më të përgatitura për ushtarë. Kjo të kihet parasysh kur i nisim për në ushtri. Sigurisht, shoshitja duhet bërë kur fillon mobilizimi.

Nga ju shokët e ushtrisë<sup>1</sup> desha të di se si është situata tani nëpër reparte. Studiohen mirë materialet e Partisë? Ju, si punëtorë partie, reflektoni mbi to, bëni konspekte, ua zhvillonit ushtarakëve duke u folur më tepër nga çfarë është thënë atje? U hapni atyre horizonte të tjera ushtarake? Bëhet një punë më konstruktive apo jo? Po niveli i punës së komiteteve të Partisë të reparteve është ngritur në krahasim me punën që bëhej më parë? Ju si i gjykoni në përgjithësi këto çështje? Komiteti i Partisë tani është më luftarak, është më mirë në krye të detyrës?

A bëhet ndonjë punë përgatitore e veçantë me oficerët që stërvitin studentët e shkollave të larta dhe nxënësit e shkollave të mesme? Pyes për arsye se ata kanë të bëjnë me elementë të rinj, që nuk janë të inkuadruar në ushtri si ata që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak. U lini kohë oficerëve që, para se të fillojë stërvitja, t'u punojë mendja për programin që

---

1. U drejtohet disa kuadrove ushtarakë, të ftuar në këtë mbledhje.

është caktuar? E them këtë se shokët vërtet i kanë direktivat e Komitetit Qendror, por a punojnë ata për t'i zbërthyer ato, duke përdorur edhe eksperiencën që kanë? Direktiva e Partisë mund të jetë shënuar vetëm në një paragraf, por ai që do të bëjë zbërthimin do të flasë më gjatë. Si përgatiteni për këtë zbërthim?

Në gjithë punën me të rinjtë, nxënës dhe studentë, a bie në sy gjallëria e organizatës së rinisë në ushtri? A ndihet ndihma e komitetit të rinisë, posaçërisht të terrenit? Organizata e rinisë, fjala vjen, a e di se në cilin muaj të rinjtë e të rejtat do të shkojnë në stërvitje? Keni parë ndonjë interesim të tillë te drejtuesit e organizatës së rinisë apo ata kanë menduar vetëm kaq: «Të venë e të vijnë shëndoshë e mirë, se s'është ndonjë punë e madhe»?

Këto pyetje i bëj që edhe të informohemi ne, por edhe për t'i pasur ju parasysh kur të vini në reparte.

*Mbasi iu dhanë përgjigje pyetjeve të bëra e pasi folën edhe pjesëmarrës të tjerë të mbledhjes, shoku Enver Hoxha tha:*

Kur i dërgojmë të rinjtë në stërvitje, duhet ta vlerësojmë këtë njësoj sikur t'i dërgonim në luftë. Por, ama, jo t'u thuhet: «Unë ju mësoj të veni në luftë», por «Të mësojmë që të vemi së bashku në luftë!».

Dëshiroj t'u rekomandoj shokëve të ushtrisë që edukimin ushtarak të nxënësve e të studentëve ta konsiderojnë me rëndësi të madhe, pse kjo masë të rinjsh, që përbën një pjesë të mirë të ushtrisë, përgatitet pa kryer shërbimin ushtarak të detyrueshëm. Prandaj duhet të bëhet një kthesë në mentalitetin e të gjithë ofi-

cerëve dhe të komandave, që të kuptohet drejt se ushtrinë tonë nuk e formojnë vetëm ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, por edhe nxënësit e studentët, që nga fillimi i stërvitjes e më pas, si dhe rezervistët dhe gjithë pjesëmarrësit e shkollave të lira ushtarake.

Kjo kthesë që përmenda duhet të bëhet absolutisht, se ndryshe një pjesë e rëndësishme e ushtrisë sonë do të kalojë në stërvitjet e rezervistëve të Shkollës së Lirë Ushtarake pa pasur baza të shëndosha. Por ne duam që stërvitja të bëhet sa më e efektshme, pra, duhet të arrihet që shkalla e njohurive ushtarake të nxënësve dhe e studentëve të barazohet me atë të ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm.

Çështja e dytë është ajo që oficerët dhe komandat të kenë një konsideratë të veçantë për rininë, sidomos kur ajo vjen për herë të parë në radhët e ushtrisë. Dashuria për këta të rinj duhet të jetë më e ngrohtë, marrëdhëniet më miqësore dhe kërkesat për disiplinën të shtohen shkallë-shkallë, gjersa të arrihet në disiplinën e plotë ushtarake. E kam fjalën që në edukimin ushtarak të rinisë të respektojmë kërkesat pedagogjike dhe psikologjike të të riut. Pra, oficerët tanë, duke pasur parasysh veçoritë psikologjike të moshës së rinisë, duhet të veprojnë me takt pedagogjik e ushtarak.

Me studentët, me maturantët e shkollave të mesme të moshave 17-18 e 19 vjeç, të bëhet punë intensive ushtarake. Por me të rinjtë e tjerë të moshave më të reja puna për edukimin ushtarak të vijë duke u rritur gradualisht. Derisa të vijë koha për të shkuar ushtarë, ata do të bëjnë mësim e stërvitje paraushtarake që të



mësojnë disa gjëra të vogla. Këtë duhet ta kenë parasysh oficerët kur zhvillojnë mësim me të rinjtë.

Çështja tjetër është që, krahas kujdesit për edukimin politik, ushtarak, moral, për forcimin e rregullit, të disiplinës, për mbajtjen e pastërtisë etj., duhet të tregohet interesim i veçantë edhe për higjienën në reparte e njësi, si dhe për ushqimin e ushtarëve, me qëllim që të mos lejojmë në asnjë mënyrë përhapjen e epidemive të tilla, si dizenteria etj. Kur të zë dizenteria, mezi të shqitet mjeku nga shtëpia; ai të mban nën kontroll edhe dy-tre muaj pasi ke dalë nga spitali, dhe bën mirë. Ky interesim ca më tepër duhet të tregohet te gjithë kjo masë të rinjsh, kur dihet se sëmundja ngjitetëse lë pasoja po të mos luftohet shpejt. Këto gjëra, në pamjen e parë, mund të duken si të parëndësishme. Nuk është e drejtë të mendohet: «Hajde, more, se turmë e madhe studentësh janë këta, le të hanë ç'të hanë!». Jo. Në kuzhina duhet vendosur një disiplinë e rreptë, atje të ketë pastërti shembullore! Kuzhinierëve t'u shpjegohet politikisht rëndësia e detyrës. Të ushtrohet kontroll i madh nga ana e pedagogëve dhe e oficerëve, të cilët kanë përgjegjësi të madhe për shëndetin e rinisë sonë, pse në thelbin e stërvitjes së tyre qëndron kalitja fizike. Në qoftë se nxënësit e studentët nuk janë të shëndoshë fizikisht, ata nuk mund t'i përballojnë vështirësitë e stërvitjes. Organizmi i tyre nuk do të jetë në gjendje t'u bëjë ballë sëmundjeve, të ftohtit etj., etj. dhe kështu nuk do të kemi një ushtar të kalitur e të fortë siç duhet. Edukoje sa të duash nga ana teorike e politike ushtrinë, po qe se ajo nuk është në gjendje të zbatojë ato që mëson, qëllimi ynë nuk mund të arrihet. Ushitari ka detyrë

të vështirë, prandaj me këtë element të ri, të njomë e patriot duhet treguar kujdesi më i madh.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbal: i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# KËRKESAT PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE SYNOJNË NË PËRGATITJEN POLITIKO-USHTARAKE TË USHTARËVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 qershor 1975

Në fillim desha të na thoni nëse e mban mirë rinia në ushtri armatimin apo jo. A u bëni ndonjë leksion të rinjve për mirëmbajtjen e teknikës? U është folur atyre, për shembull, për rëndësinë e pushkës? U keni thënë ndonjëherë, fjala vjen, që pushka është baras me kokën, me lirinë e atdheut, se po nuk pate pushkën në rregull, të vrau armiku dhe, po të vrau, atdheu nuk ka liri?! Edhe kalemën duhet ta ruajë i riu dhe të mos e lërë t'i prishet, se kjo është arma e tij në kohën kur mëson. Por kalem mund të blejë dhe një tjetër, kurse pushkë nuk ka; atë duhet ta mbajë pastër e mirë, se ndryshe e vret armiku. E keni trajtuar ndonjëherë këtë problem

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për gjendjen dhe masat që duhen marrë për forcimin e rolit të organizatës së rinisë në ushtri.

kështu? Unë e di që punoni në këtë drejtim, por si punoni? Mendoj se këto çështje duhet të trajtohen në një radhë leksionesh.

Takohen sekretarët e komitetit të rinisë të rrethit me sekretarët e rinisë të reparteve? Kanë ndonjë program pune të përbashkët për këto çështje, apo si t'u qëllojë? Atyre mund t'u bjerë rasti që të takohen, por është fjala për çështje pune e jo sa për të pirë ndonjë kafe. Në komitetin e rinisë të repartit bën pjesë edhe sekretari i komitetit të rinisë të rrethit ose në komitetin e rinisë të rrethit bën pjesë edhe sekretari i komitetit të rinisë të repartit. Por desha të di se çfarë rezultatesh ka dhënë kjo. Unë e di anën teorike të saj, por e kam fjalën për anën praktike. Vërtet se koha që kur është vendosur ky bashkëpunim është e paktë, por rezultatet e para ndoshta i ka dhënë.

*Pas përgjigjeve të pyetjeve të bëra e diskutimeve, shoku Enver Hoxha tha:*

Në përfundim të diskutimit të këtij problemi kam mendimin se analiza ka qenë e mirë, sepse është bërë në mënyrë të tillë që paraqet sukseset e të metat në punën e rinisë në ushtri, në stërvitjet ushtarake të të rinjve. Sukseset e të meta në këtë drejtim vihen re edhe në organizatat e Partisë e në komandat. Kjo analizë, më duket mua, do t'i shërbejë shumë edhe udhëheqjes, Sekretariatit dhe Byrosë Politike, për t'i parë dhe për t'i pasur më të qarta situatat në ushtri, shkallën e zbatimit të direktivave të Partisë dhe përvetësimin e këtyre direktivave nga masa e kuadrove dhe e ushtarëve.

Në përgjithësi kam përshtypjen se shokët që morën fjalën diskutuan me një frymë shumë konstruktive,

këta thanë realitetin ashtu siç është, që ka gjëra të mira, por edhe të meta. Dobësitë që vërehen janë mbeturinë e stilit dhe e metodës së sëmurë dhe e veprimtarisë armiqësore që ishte zhvilluar në ushtri. Nuk dua të zgjatem në këtë drejtim, se çdo gjë është e qartë, por theksoj se duhet të bëhet kthesë në hartimin e programeve të reja të punës në ushtri, të spastrohen materialet ekzistuese nga gjërat e tepërta. Të bëhet kthesë në luftën konkrete për zbërthimin si duhet të këtyre programeve, prandaj të futen në to problemet që nxjerrin jeta, koha, praktika.

Në zbatimin e programeve të miratuara nuk duhet vepruar në mënyrë shabllone. Natyrisht, programet të zbatohen me përpikëri, por në intervale kohe duhet të futen në to edhe ato gjëra që në momente të caktuara i nxjerr jeta. Për këtë kërkohet iniciativë krijuese nga ana e organizatave-bazë të Partisë në ushtri dhe nga komanda, duhet zotësi nga kuadrot, të cilët të mos veprojnë në mënyrë dogmatike, por me shkathhtësi. Shkathhtësia në kuptimin dhe në zbatimin e detyrave vjen kur ata e zotërojnë mirë lëndën ushtarake ose politike që zhvillojnë. Në qoftë se oficerët kanë dashuri e pasion për punën e profesionin, do të jenë në gjendje që programin e caktuar ta realizojnë si duhet, por edhe ta lidhin atë me çështjet që nxjerr jeta dhe që nuk kanë qenë parashikuar. Për sa u përket shfaqjeve të gabuara që manifestojnë disa oficerë të rinj, kjo tregon se me ta nuk është bërë si duhet puna politike në shkollat që kanë mbaruar. Atje duhet ta gjejmë shkakun e këtyre shfaqjeve.

Në të kaluarën ishte futur një frymë e tillë që

leksionet jepeshin shkel e shko, duke u nisur nga koncepti i gabuar: «Oburra të mbarojmë shpejt e të ngrihemmi të ikim!». Kuadrot e kanë pasur zor të takoheshin me ushtarët, të punonin veç e veç me ta, të merrnin mendimet e tyre etj., etj. Të punosh me secilin, kokë më kokë, është e vështirë, por atje ku nuk kuptohet problemi, është e domosdoshme të ulesh e të bisedosh me secilin ushtar. Shembulli i përgjithshëm duhet të jetë një mësim për individët. Po ta edukosh të gjithë trupën me një frymë të lartë për mirëmbajtjen e armës, atëherë është e lehtë që me ndonjë të ri që ka të meta të punohet në mënyrë të veçantë.

Juve ju merr shumë kohë çështja e disiplinës, sepse kjo ka rëndësi të madhe kudo, por sidomos në ushtri. Në qoftë se komiteti i Partisë i repartit shikon, për shembull, se nuk mbahen mirë armët, atëherë ai të bëjë një sqarim të posaçëm, të ilustruar me shfaqjet që duken këtu apo atje, të nxjerrë konkluzione dhe mësim. Kështu mendoj se duhet të veprohet, për të mos ndodhur ngjarje të jashtëzakonshme. Edhe për këto çështje duhet të mbështetemi në dokumentet e Partisë, siç ka porositur Komiteti Qendror. Pra, të analizojmë gjendjen dhe të shohim se ku janë zbatuar përciptazi orientimet e direktivat e Partisë.

Shokët që morën fjalën këtu, na dhanë edhe shembuj pozitivë që tregojnë se, kur asistojnë në mbledhje ushtarët e thjeshtë, të cilët përbëjnë forcën e ushtrisë, ata aktivizohen, se janë njerëz me tru, që kanë mendime politike të drejta, të formuara edhe më përpara se të vinin në ushtri.

Problemet e ushtrisë, kërkesat për plotësimin e

detyrave ndaj komandës e kuadrove synojnë në përgatitjen politiko-ushtarake të ushtarëve. Pa këtë synim nuk ka kuptim puna e kuadrove ushtarakë.

Në qoftë se Komiteti Qendror i Partisë jep udhëzime për disa çështje ose sqaron situatën e krijuar, këto materiale, natyrisht, u jepen oficerëve, por nuk përjashtohet që për to të marrë njohuri edhe masa e ushtarëve. Ushtarëve këto materiale do t'u shpjegohen e do t'u zbërthehen nga një shok i caktuar dhe i përgatitur mirë për këtë punë. Kështu çdo ushtar «do të hajë» një «gjellë» të shijshme dhe nuk do të mbetet «pa ngrënë», duke shtrënguar rripin. Në qoftë se komandantët e komisarët nuk do ta bëjnë si duhet këtë punë, atëherë ata nuk do ta kryejnë detyrën e ngarkuar dhe nuk do të ndihmojnë që të kemi një ushtri të përsosur.

Ju, shokë të ushtrisë, duhet të kenë kujdes që këto materiale të Partisë të shkojnë në bazë dhe t'u bëhen të njohura dhe ushtarëve, por çështja është që dokumenti të ruhet dhe të mos bjerë në dorë të armikut. Ne ia themi popullit këto çështje dhe kjo metodë punë ka sukses të jashtëzakonshëm, sepse tek ai forcohet akoma më shumë besimi ndaj Partisë. Në letrën që dërgojmë për punimet e Plenumit të Komitetit Qendror dhe për masat që u morën aty, popullit ia bëjmë të njohura. Po atëherë ushtrisë, që është një masë e organizuar, pse të mos ia themi? Vetëm duhet të kemi parasysh që dokumenti për përdorim të brendshëm është sekret dhe duhet ruajtur.

Partia dhe komanda të kenë parasysh që, në përgjithësi, ta vënë në korent ushtrinë. Ka disa çështje

për të cilat komanda dhe Partia e kuptojnë që, në fillim, akoma janë në fazën sekrete, domethënë se këto nuk mund të bëhen muhabetë të të gjithëve. Por, kur themi të informojmë masën e ushtrisë, e kemi fjalën për ato gjëra që duhet t'i dijë medoemos ushtari, sepse, pa i ditur, ai nuk mund të kryejë mirë detyrën për mbrojtjen e atdheut. Bile, edhe në mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë ka probleme, në diskutimin e të cilave mund të thërriten edhe ushtarë e jo pastaj sekretarë të rinisë, ushtarë të vendosur e të guximshëm. Atyre t'u thuhet që të vijnë në mbledhje e të dëgjojnë, po të duan edhe të diskutojnë.

Prandaj ne i porositim punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, që lidhen me shokët sekretarë të Komitetit Qendror, t'i shohin mirë këto probleme dhe të interesohen seriozisht. Unë bisedova edhe me shokun Ramiz për çështjet e edukimit politiko-ushtarak. Këto probleme i njihja në përgjithësi, por shoku Hysni më ka vënë në korent vazhdimisht e veçanërisht për to.

Edhe nga sektori i edukimit ka interesim për çështjet e ushtrisë. Siç kemi vendosur në Sekretariatën e Komitetit Qendror, pavarësisht se në aparatën e Komitetit Qendror kemi një sektor të veçantë që ndjek punën e Partisë në ushtri, nga kjo punë nuk mund të jenë të shkëputur edhe shokët e sektorit të edukimit. Shokët e ngarkuar nga aparati me punët e Partisë në ushtri duhet të bashkëpunojnë me sektorin e edukimit në lidhje me vërejtjet, sugjerimet e përpunimet që bëhen. Natyrisht, konkluzionet që arrihen nga kjo



punë të jenë të gjithanshme dhe pastaj të veprohet në të gjitha drejtimet.

Ne kemi bindjen se, me bashkëpunimin që do të sigurohet, puna e Partisë në ushtri do të ecë mirë. Na gëzon fakti që tani gjendja në ushtri ka ndryshuar. Atje është bërë një kthesë rrënjësore. Të meta ekzistojnë, të mos harrojmë se vështirësi do të ketë përsëri, prandaj të mos na mbulojë euforia, por t'u shkojmë çështjeve deri në fund, duke ngulur këmbë në zbatimin e porosisë së Partisë që në ushtri të krijohet një situatë më e shëndetshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# BALLKANI, SUPERFUQITË, KINA DHE NE

Shënime

2 korrik 1975

Politika ballkanike ka hyrë në fazën dhe në gjendjen e gjysmës së shekullit të 19-të. «*Questions balkaniques, Les Balkans poudrière de l'Europe*»<sup>1</sup>.

Fuqitë e mëdha po lëvizin sijet e tyre në prapaska. Shqipëria socialiste, për veten e saj, ua ka prerë sijet me gërshërë të madhe. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglinë ajo s'i qasi as te pragu i derës, që kur u çlirua, sovjetikët i shporri me forcë dhe të turpëruar. Kështu ua bëri edhe titistëve jugosllavë, që «ua vuri, siç thotë populli, kufinë te thana».

Pra, në disa vende ballkanike mbretëron kaosi i brendshëm, kaos politik, ekonomik, kulturor. Nuk ekziston asnjë stabilitet, qoftë edhe borgjezo-kapitalist. Çfarë sallatë ruse! Këto vende trumbetojnë se bëjnë «një politikë të pavarur», se «janë independente», se «luajnë një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombë-

---

1. Frëngjisht — «Çështjet ballkanike, Ballkani fuçi baruti e Evropës».

tare», gjoja njëri «në botën e të paangazhuarve», njëri me qëndrimet pseudoantisovjetike, tjetri me politikën prej lakeu të sovjetikëve, ndonjëri gjoja ka kundërshtime me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me NATO-n etj.

Në këtë «çorbë derri», Bullgaria, si pion i sovjetikëve, reklamoi diplomacinë, me një fjalë i bën presion dhe shantazh Jugosllavisë që të vejë të lidhet te grazhdi i sovjetikëve. Po këtë punë bën edhe me Rumaninë, por duke i kënduar kësaj një avaz tjetër: «miqësinë e madhe dhe të sinqertë» nën ombrellën e djadja Ivanit. Krerët e të dyja këtyre vendeve venë e vijnë, priten me popull, betohen për miqësi, por, siç thotë populli, që të dy ia kanë njëri-tjetrit me lesh në bark.

Çaushesku ka dalë në arenën ndërkombëtare si «një figurë e madhe». Ai bredh nga të katër anët e botës, mbledh dekorata, firmos deklarata bajate e stereotipe dhe nënshkruan me dhjetëra marrëveshje me çdo vend ku vete, marrëveshje që nuk realizohen, pse Rumania është një shtet i falimentuar, mufliz. Por Çaushi do ta ngrejë në «një piedestal antisovjetik» Rumaninë, gjë që është një bluf. Politika e Rumanisë është një politikë me shumë dashnorë.

Gjendja politike dhe ekonomike në Rumani është plotësisht e korruptuar dhe e rëndë, ndërsa udhëheqja e falimentuar rumune, me paturpësinë më të madhe, flet fjalë të mëdha, lëshon parulla ndërkombëtare, shpall projektpropozime në OKB për çarmatimin, bën amendamente për çështjen e «sigurimit evropian», për mbledhjet e partive revizioniste që predikon sovjeti

etj. As që i skuqet faqja. «Vija» e saj është «të veshim politikën me rroba të bukura», «të mbulojmë falsitetin me mendjemadhësinë», me mburrjen, me arrogancën, me gënjeshtërinë dhe me blofin. Vetëm me shqiptarët ajo nuk e ka mirë dhe as i duron, as i gënjen dot, prandaj ka urdhëruar që me ne të pengohen marrëdhëniet në çdo fushë. Dhe me këtë shtet revizionist-kapitalist, me këta aventurierë antimarksistë, «miku» Çu En Lai na këshillon të bashkëpunojmë ngushtë, të bashkohemi kundër sovjetikëve.

Këto janë këshilla të neveritshme dhe katastrofike të një personi që nuk e njeh gjendjen, që nuk arrin të bëjë sinteza të drejta dhe të nxjerrë konkluzione reale nga gjendja, pse është një person armik, që mendon e vepron si armik, e që çdo gjë do ta vërë të ecë në rrugën e strategjisë së tij të gabuar globale. Sidoqoftë, në të dyja rastet, ne nuk i hamë kollaj «këshillat» e tij, ne nuk shkelim në dhogë të kalbur, pse jep mendje Çu En Lai, kryeministri i një shteti të madh. Ne jemi në gjendje të mendojmë dhe të gjykojmë me kokën tonë, ne i marrim në konsideratë edhe këshillat, edhe eksperiencën e mirë të shokëve dhe të miqve, por kurrë nuk mund të rrezikojmë interesat e popullit dhe të atdheut tonë socialist, duke u vënë veshin broçkullave të njerëzve të dyshimtë.

Për sa i përket Bullgarisë kjo është e tëra e integruar te Bashkimi Sovjetik. Vetëm emri dhe format e jashtme, natyrisht edhe emrat e fshatrave dhe të maleve, i kanë mbetur bullgare, se çdo gjë tjetër bie erë e qelbët revizioniste sovjetike. Administrata bullgare është e tëra në duart e sovjetikëve. Çdo nëpunës i lartë

dhe i mesëm bullgar ka hijen e tij sovjetike, e cila është «hija» që sundon manekinin. Toka bullgare, vendet strategjike, aerodromet, portet, ushtria, të tëra janë në duart e sovjetikëve. Kuadrot, armatimet e divizioneve dhe të korparmatave sovjetike janë të ngritura në Bullgari. Në momentin e sulmit, efektiviteti sillet me avionë brenda një nate. E ashtuquajtura ushtri bullgare është një kuverturë «*couleur locale*» e komanduar nga këshilltarë sovjetikë. Ekonomia bullgare atë çka mund ta ketë më të mirë, domatet e hershme, perimet, frutat i ka për Bashkimin Sovjetik. Ata palo motorë që bën, mund t'i shesë ku të dojë, për këta ka liri të plotë, kurse metalet e rralla, siç është uraniumi, duhet të marrin rrugën e Moskës, e «aleatit në shekuj». Dhe Bullgaria quhet e lirë, e pavarur dhe sovranë. Por hiqet dhe «e fuqishme». «Ëndërron» të marshojë mbi Stambollin. «Ëndërron» për Thrakën, pretendon për Maqedoninë, gërthet se ushtritë e saj të Borisit çliruan Jugosllavinë etj. Jo po, ato mend thyen tërë Gjermaninë! Këto «ëndrra» të Bullgarisë së Todorit s'janë hajale, po veprime me sy hapur.

Bullgaria e Zhivko hrushovianit është në pararojë për të shpënë kudo mendimin dhe dëshirën e sovjetikëve. Kasneci i këtyre të fundit është Zhivkoja, veçse të gjithë e dinë: në qoftë se grinden ose përqafohen me Zhivkon, këtë e bëjnë një manekin tragjik. Ai është njëkohësisht fitili i barutit në duart e sovjetikëve. E tillë u katandis Bullgaria e Dimitrovit. Për kinezët dhe për Çu En Lain hëpërhë kjo Bullgari prosovjetike nuk hyn në «politikën gjeniale ballkanike të tij». S'ka se si, duhet të jetë antisovjetike, që të jetë prokineze, duhet

të jetë proamerikane, që të jetë prokineze dhe proballkanike.

Jugosllavia po, kjo i plotëson kushtet paraprake për Kinën. Me Jugosllavinë «mund të merreni vesh dhe mund të bashkoheni e të bashkëpunoni shumë mirë, pavarësisht se keni mosmarrëveshje», thotë Çu En Lai. Këtë gjë na këshillon ai ta bëjmë. Gjellë e helmatisur! «Marksist-leninisti» Çu En Lai na këshillon të shkelmojmë parimet dhe të puthemi me Titon e me titistët! Po kush janë këta? Njihen botërisht dhe për arsye se njihen botërisht, nuk mund të mendohet për asnjë çast se Çu En Lai gabohet në pikëpamjet e tij politike. Ai është i ndërgjegjshëm për atë që thotë.

Jugosllavia e Titos ka ardhur në buzën e humnerës, të katastrofës. Është e arsyeshme pyetja që bën sot gjithë bota: Ç'do të bëhet Jugosllavia pas vdekjes së Titos? Të kuptohemi, të gjithë e dinë që Titoja, në krye të klikës së tij antimarksiste dhe agjente e borgjezisë, e solli Jugosllavinë në këtë bankërutë kolosale shtetërore, politike, ekonomike, ushtarake, kombëtare. Pra këtu nuk është çështja e krizës së një personi, nuk është çështja se kush do ta zëvendësojë këtë person kur të vdesë, por është çështja e një shteti të tërë të bërë lesh e li nga një klikë antipopullore. Jugosllavinë as aktualisht nuk e mban dot Titoja në këmbë, por janë koniunkturat politiko-ekonomike të fuqive të mëdha nga jashtë dhe të klikave të brendshme që përplasen njëra me tjetrën. Të gjitha këto kanë interesat e tyre në Jugosllavi, koncesionet e tyre, kapitalet e tyre që duhet t'i mbrojnë. Atyre u leverdis të gjithave që ustai i këtyre koncesioneve që ka shitur Jugosllavinë t'u rrojë edhe ca, por

gjithsecila ka njerëzit e vet, zonat e influencës dhe këta veprojnë. Titoja arbitron si një politikan «i madh», megjithëse është i falimentuar.

Brenda ai i ka larë duart, çdo gjë e ka marrë lumi. Titoja dozon grindjet prosovjetike dhe ato proamerikane, balancon sa mundet kontradiktat e atyre që janë në fuqi rreth tij dhe të atyre që duan t'i rrëzojnë ata. Titoja, në pamundësi të bashkojë tendencat armiqësore në mes serbëve nga një anë dhe kroato-slllovenëve nga ana tjetër, përpiket të balancojë «fuqinë» e tij me republikat e tjera, Maqedoninë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi dhe krahinën e Kosovës. E tërë kjo punë është një mishmash politik «ballkanik», një supë ku kanë futur duart të gjitha shtetet imperialiste, social-imperialiste dhe kapitaliste, që e mbajnë gjallë Jugosllavinë me lëmosha e me kredi rrjepëse.

Këto kredi dhe të ardhurat e popujve të Jugosllavisë janë vënë në haraç, me përjashtim të asaj pjese që u takon investitorëve të huaj, të cilët e mjelin rregullisht «lopën» jugosllave. Resti bëhet rrush e kumbulla nën drejtimin e sistemit të vetadministrimit. Ky vet-administrim titist u krijua që të grabitej pasuria shtetërore nga shtresat e larta dhe të mesme të regjimit titist. Renegatëve të marksizëm-leninizmit u duhej një sistem i tillë si urë për të kaluar nga fillimi i ndërtimit të socializmit në kapitalizëm. Duhej rikthyer prapa, të ndërrohej mentaliteti që krijoi në popull lufta nacionalçlirimtare, të organizoheshin vjedhjet dhe korrupsioni me lezet e të krijoheshin instrumenti përkatës dhe borgjezia e re që ta bënte këtë kthesë. Borgjezia e re titiste u krijua, ajo u lidh me borgjezinë kapitaliste dhe me

flamurin e antistalinizmit u rreshtua në një shtet agjente në shërbim të imperialistëve amerikanë, në radhë të parë, pastaj në shërbim të mafias së zezë ndërkombëtare.

Kuptohet që Jugosllavia është në krizë të rëndë politike dhe ekonomike. Çmimet atje ngrihen çdo ditë në kurriz të masave, të cilat çdo gjë e blejnë me kredi. Punëtori atje vë në ankand pagën, djersën, ai punon për borgjezinë e brendshme dhe për padronët e saj të jash-tëm.

Grindjet dhe kontradiktat në mes nacionaliteteve po shtohen, acarohen. Titoja, me gënjeshtër e me demagogji, përpiqet të mbajë në këmbë Federatën. Por forcat centrifugale veprojnë, veprojnë dhe fuqitë e mëdha që, në pamundësi të vendosin hegjemoninë, do të preferojnë të vendosin zonat e influencës. Dhe këto zona influence po duken: amerikanët mbështetin Kroacinë e Slloveninë, rusët Serbinë dhe Malin e Zi, kurse Maqedoninë ata ia rezervojnë Bullgarisë, ndërsa Kosovën, si ngaherë, e bëjnë pre të serbëve.

Jugosllavisë mund t'i përshtatet si një dorashkë fjala e urtë e minoritetit grek në Shqipëri «*okso lilia, mesa kaka*»<sup>1</sup>. Titoja ka zënë një rrugë «për të ndritur» politikën e jashtme dhe brenda politikën e «kakës». Ai hiqet dhe e trumbetojnë si një «politikan të madh», që e «dredh vallen» si të dojë, por janë të tjerët që e dredhin atë si të duan. Fjalimet e tij janë «të modës», me poza «matamori»<sup>2</sup>, ç'thotë sot, nuk thotë nesër, ai ka

1. Jashtë me lulka, brenda me m.

2. Nga spanjishtja — mburravec.



një mënyrë jetese që ia kalon asaj të mbretëreshës së Anglisë, e cila ka hapëset e kashtës, kurse Titoja vë në ankand Jugosllavinë. Titoja dhe rezidencat e tij janë qendrat e vajtje-ardhjeve të «njerëzve të mëdhenj». Ai jep e merr, bie e shpie ku duhet, hiqet «lideri» i «botës së tretë», është i lidhur pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por flet nganjëherë si i pavarur. Të njëjtën gjë bën edhe me Bashkimin Sovjetik. Një kloun «i shkëlqyer», një iluzionist i mbaruar. Ky njeri i ka hyrë në qejf edhe Çu En Lait, i cili ka filluar ta imitojë e na këshillon edhe ne ta ndjekim në këtë valle makabre.

Te Titoja venë shumë njerëz, ai hiqet si «njeri me vlerë të madhe politike». Nuk mund të thuhet se nuk ka fare-fare vlerë, po me vite të tëra i është organizuar një tamtam i tillë nga specialistë të regjur, saqë çdo kryetar shteti ka qenë dhe është kurioz ta njohë këtë «kafshë» të çuditshme, që bluan si mulliri pa kokrra. Ç'të mirë mund të presë njeriu nga një person i tillë, nga i cili vetë vendi i tij është në kaos e po vuan e do të vuajë nga kjo politikë e Titos: «Ha të hamë me të dyja duart». Por, siç thotë populli, megjithëse në rastin e Titos kjo nuk përshtatet plotësisht, më mirë të të dalë syri sesa nami. Titos i doli nami si antistalinist, si ndër-mjetës, si shembull për të likuiduar socializmin në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore. Duke iu vënë të gjithë kësaj pune nga brenda Hrushovët, Gomulkat, Ulbrihtët, Novotnët, Zhivkot, Dozhët e Çausheksët dhe imperialistët amerikanë me Titon, Toliatin, Torezin e Marshenë nga jashtë, ia arritën qëllimit.

Socializmi në këto vende është histori «e lashtë».

Jugosllavia e kralëve dhe e Titos në çdo kohë ka genë armike e betuar e Shqipërisë. Kralët dhe fuqitë imperialiste të kohës na i shkëputën Kosovën, Dibrën dhe toka të tjera shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi. Po kralët serbë rrëmbyen më vonë edhe një pjesë të krahinës së Vermoshit dhe Shën-Naumin, si shpërblim që sollën Zogun në fuqi me anën e vrangelistëve. Titoja deshi që Shqipërinë gjatë kohës së luftës e më vonë ta kishte në zap. Edhe pas Çlirimit ai manovroi me skena e prapaska të na bënte republikë të shtatë të Jugosllavisë. Pasi dështoi, vazhdoi luftën subversive të na shkatërronte nga brenda dhe, duke shpresuar, filloi gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës, të cilët i persekutoi, i burgosi, i vrau e me qindra mijë i shpërnguli në Turqi.

Çu En Lai na sugjeron t'i harrojmë të gjitha këto, gjoja «për të shpëtuar» Jugosllavinë e gjoja edhe Shqipërinë nga rreziku sovjetik. Rreziku sovjetik është real, po atë e shkaktojnë rreziku dhe kaosi titist. Çuja, me mendjen e tij «të hollë», mendon se ne, po të futemi në këtë furrë, do të dalim të padjegur. Rreziku për Shqipërinë shtohet njëqind herë po të ndjekim rrugën e Çusë. Ne jemi të vendosur të luftojmë social-imperialistët sovjetikë me armë në çdo rast, reziston ose jo Jugosllavia. Po rezistoi, ca më mirë, po nuk rezistoi, ne do të luftojmë. Por rezistenca e Jugosllavisë nuk është plotësisht e sigurt. Nga ana tjetër, Jugosllavia as që pyet për Shqipërinë, ajo e di që ndonjë e keqe prej saj nuk i vjen, dhe kjo është e vërtetë për sa i përket qëndrimit tonë. Për sa i përket qëndrimit të titistëve ndaj vendit tonë, s'ka asnjë siguri e garanci. Ne nuk e

hamë atë që thotë Çuja «të bashkohemi» dhe të bëhemi mish për top për kralët e rinj të Serbisë që bëjnë një mijë dredhira si me Lindjen, si me Perëndimin. Në lojën e shahut ne nuk bëhemi pionë as të Titos, as të Çu En Lait. Shqiptari nuk e ka pasë e nuk e ka kurrë zakon të ulë kokën para armiqve ose atyre që ia kanë me hile. Ne do të ndjekim këtë politikë që po ndjekim me Jugosllavinë dhe titistët të ndihen të kënaqur. Për sa u përket shqiptarëve të Kosovës, ata kanë të drejtë të kërkojnë e të mbrojnë të drejtat e tyre kombëtare e shoqërore të njohura me kushtetutë. Çuja po nuk qe i kënaqur, le të pijë uthull.

Dikush në Kosovë, titist deri në lidhëset e këpuçëve, në një fjalim televiziv, sulmoi shqiptarët e Kosovës, duke thënë se, meqë janë shumica, rrezik në ta është shovinizmi shqiptaromadh, rrezik më i madh nga ai serbomadh etj. Kjo tregon armiqësinë e titistëve kundër shqiptarëve, të cilët akuzohen si shovinistë-nacionalistë në një oqean të madh të shovinizmit serbo-kroat etj.

Mund të merret me mend ç'qëllime kanë këta armiq kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Politika «ballkanike» e Çu En Lait ka rënë në veshin «e mirë» titist jugosllav dhe tash gazetat jugosllave kanë filluar të shkruajnë artikuj se «Shqipëria u pajtua me Jugosllavinë, se të dy vendet kanë interesa të përbashkët, se tregtia me Jugosllavinë vjen pas asaj me Kinën» etj. I njohim mirë ne këto blofe jugosllave. I gjithë qëllimi është që të krijojnë opinionin se Shqipëria socialiste ka ndërruar rrugë dhe Partia e Punës e Shqipërisë nuk është më në

vijën e saj të parë, por pajtohet me atë jugosllave dhe kineze.

Jugosllavët edhe mund të kenë të dhëna për qëndrimin e kinezëve kundër nesh, por edhe vetë ata nxjerrin konkluzione që Kina ka kontradikta me ne dhe nderin «shkopin» të kapemi, pse mendojnë që u mbytëm. Por, me qëndrimet tona, ne do t'u tregojmë titistëve dhe indirekt kinezëve se janë mbytur ata dhe jo ne. Ne qëndrojmë të patundur në vijën tonë të drejtë marksiste-leniniste. Jugosllavët dhe njerëzit e Çu-së kanë ardhur në një konkluzion të përbashkët se «ne rrojmë të lirë në sajë të Jugosllavisë titiste», e cila është, sipas tyre, «bastioni kryesor kundër sovjetikëve». Kjo nuk ka qenë ndonjëherë, nuk do të jetë edhe tash. Shqipëria i ka bërë llogaritë të luftojë dhe të fitojë edhe vetëm kundër një armiku eventual. Ne as jugosllavët, as Çu En Lai nuk do të mundin dot aspak, as edhe me metodat propagandistike, të na ngatërrojnë në llumin e tyre.

Qëllimi i kinezëve injorantë është «bashkimi i Ballkanit» nën drejtimin e Rumanisë «antisovjetike» dhe Jugosllavisë «proamerikane». Kështu që, sipas tyre, Greqia dhe Turqia do të bashkohen me «Shqipërinë prokineze» dhe me Bullgarinë prosovjetike. Shikohet qartë ç'sallatë ruse mendojnë të gatuajnë kinezët dhe gjithë këtë «bashkim» ta vënë kundër sovjetikëve. «Të zgjuarit» e Pekinit e formuan bllokun evropian kundër sovjetikëve. Po kush i dëgjon dhe kush i ndjek në këto ëndrra të çmendura? Të gjitha vendet e Ballkanit e dinë që kjo nuk bëhet kurrë dhe është një lodër kalamanësh. Vendet e Ballkanit kanë kontradikta të thella

me njëri-tjetrin, kanë interesa të kundërt, kanë aleatë të ndryshëm, dhe ka prej tyre që bëjnë një politikë pazari; përveç Shqipërisë klikat e tyre janë të shitura te fuqitë e mëdha. «Kundërshtimet» që mund të duken herë pas here në mes tyre dhe fuqive të mëdha janë koniunkturale. . .

Jo, këshillat dhe mendimet e Çu En Lait për politikën që ky predikon për Ballkanin janë të gabuara, antimarksiste, antisocialiste. Ne as e pranojmë një politikë të tillë dhe do të vazhdojmë në politikën tonë të drejtë, do të bëjmë që të duket se politika jonë s'ka të bëjë me këtë politikë revizioniste-reaksionare.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# KINA KA HYRË NË VALLEN POLITIKE TË BORGJEZISË

Shënime

4 korrik 1975

Është tragjike që Kina kaosin e lufton me kaos. Kina e Mao Ce Dunit të jep përshtypjen sikur brenda vendit bën një politikë «socialiste», por, po të futesh në thellësi, qoftë edhe aq sa të lejojnë shfaqjet e jashtme, do të konstatosh se politika «marksiste-leniniste» që trumbetohet prej saj, është një politikë maoceduniste, një diçka e përzier me qëndrime e parime të dyshimta. Vihen re vazhdimisht dy vija, të cilat herë ecin paralelisht, herë jo, sepse njëra ia hipën tjetrës. Një paqëndrueshmëri e tillë shikohet vazhdimisht edhe për shumë probleme kapitale. Propaganda bëhet në atë mënyrë që njerëzit të mendojnë se çdo qëndrim dhe çdo veprim i Kinës është «i drejtë, parimor, marksist-leninist, antiimperialist dhe sidomos anti-socialimperialist».

Në politikën e jashtme, Kina e Mao Ce Dunit hiqet si një vend socialist dhe që bën një politikë socialiste. Në realitet nuk është kështu. Edhe pse Kina nuk mund

të vihet në një radhë me dy superfuqitë, politika e saj nuk është një politikë marksiste-leniniste.

Derisa Kina e deklaroi veten si një shtet që bën pjesë në «botën e tretë», në parim ajo ndjek edhe politikën e kësaj «bote të tretë», e cila nuk ka asgjë socialiste. Kuptohet se Kina në «botën e tretë» konfondon politikën e saj me politikën borgjezo-kapitaliste dhe revizioniste të kësaj «bote të tretë».

Politika e Liu Shao Çisë, e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit para Revolucionit Kulturor ishte: «Aleancë me të gjitha shtetet e botës, edhe me revizionistët sovjetikë». Aktualisht politika e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit është: «Aleancë me të gjitha vendet e botës, edhe me imperializmin amerikan kundër sovjetikëve». Po Mao Ce Duni me cilën vijë është? Lihet të kuptohet se ai i aprovon dhe më vonë i dezaprovon këto vija, por, në fakt, ai është me to dhe kontribuon në këtë rrugë që ndjek Kina. Kjo është një politikë me shumë konsekuenca për vetë Kinën dhe për botën. Bota revolucionare dëshiron të shohë politikën klasore, revolucionare të Kinës, por ajo nuk e sheh atë, sepse në realitet nuk ekziston dhe duhet ta imagjinojë se si duhet të jetë.

Kina bën një politikë prej zigarejc. Ajo është hapur, ka lidhje diplomatike me të gjithë, do që të afirmohet në botë. Edhe ne e kemi dashur dhe ia kemi sugjeruar këtë. Por si duhet të afirmohet Kina në botë? Si një vend socialist, apo si një vend i «botës së tretë»? Natyrisht, Kina duhet të afirmohet si një vend socialist. Mirëpo këtë ajo nuk e bën. Ajo po afirmohet në botë si një shtet kundër Bashkimit Sovjetik. Për Kinën Spa-

nja e Frankos, Kili i Pinoçetit apo Rodezia e Jan Smitit janë miqtë e saj, kurse «sovjetikët janë më të rrezikshmit, sepse hiqen sikur janë marksistë-leninistë». Ky qëndrim nuk është parimor. Lufta e Kinës kundër sovjetikëve nuk zhvillohet në platformën ideologjike dhe nga kjo platformë të demaskohet politika e tyre social-imperialiste. Jo, këtë Kina nuk e bën aspak si duhet. Po pse nuk e bën? Sepse politika e saj nuk bazohet në teorinë marksiste-leniniste. Kina ka hyrë në vallen politike të bërëzisë, në politikën e koniunkturave dhe është e bindur se kjo politikë është më e drejta. Kina harron se politika që ajo bën pa dallim me presidentët e me mbretër, me princër e me princesha, me fashistë e me revanshistë të Bonit, me imperialistë amerikanë apo me të tjerë si Pinoçeti, nuk është ndonjë politikë origjinale. Një politikë të tillë e ka praktikuar gjerësisht bërëzja kapitaliste botërore dhe ca më përpara e kanë praktikuar monarkitë e trashëgueshme dhe aristokracia. Kina kërkon miqësinë e klikave sunduese «për t'u futur në popuj», në vend që të futet në zemrën e popujve duke i bindur këta se ajo është plotësisht me kauzën e tyre.

Ç'ndihmë u jep Kina popujve dhe revolucionarëve kilianë ose filipinas, apo revolucionarëve gjermanë, kur ajo afishohet në mënyrë skandaloze me Pinoçetin, me Markosin dhe me të tjerë si këta? Asnjë ndihmë nuk u jep, veçse i dekurajon. Kina, me këtë politikë që bën, inkurajon reaksionin më të zi. Kina lë që revolucionarët të supozojnë se kjo është një «manovër politike». Në fakt, kjo është një manovër kundër-revolucionare, sepse revolucionarët, po të ndjekin poli-



tikën e Kinës, duhet të mos luftojnë kundër reaksionit. Mirëpo revolucionarët nuk mund të jenë me dy faqe, të luftojnë kundër reaksionit dhe njëkohësisht të jenë me reaksionin.

Kinezët përpigën të japin përshtypjen se ndihmojnë fshehtazi foreat revolucionare. Kjo nuk është aspak e vërtetë dhe nuk mund të jetë e vërtetë, sepse Kina preokupohet ta ketë mirë, për shembull, me shtetin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe me firmat e saj, e jo me komunistët marksistë-leninistë gjermanë. E ashtuquajtura ndihmë për revolucionarët marksistë-leninistë është vetëm një përkrahje që u bën Kina atyre, në qoftë se e mburrin Kinën dhe politikën e saj në Bon, në Paris, ose në Romë. Mirëpo të veprosh kështu do të thotë të jesh mik me reaksionin e këtyre vendeve. Natyrisht, marrëdhënie diplomatike, tregtare dhe kulturore Kina duhet të ketë me këto vende, por këto marrëdhënie duhet të bazohen në teorinë marksiste-leniniste dhe t'i shërbejnë revolucionit.

Kina u jep kredi disa shteteve, midis të cilave jemi edhe ne. Këto kredi, veçanërisht ajo që na jepet neve, marrin ngjyrën e politikës që ndjek Kina brenda dhe jashtë vendit. Kur situata brenda në Kinë është revolucionare, domethënë kur nga të dyja vijat ajo revolucionarja dominon mbi regresiven, atëherë ndihma për ne ndjek një rrugë dashamirëse, miqësore, kinezët i kuptojnë drejt nevojat dhe vështirësitë tona. Ne nuk mungojmë t'u tregojmë mirënjohjen tonë të sinqertë dhe ata na thonë se «ndihma që na jepni ju shqiptarët, është shumë e madhe, kurse ajo që ju japim

ne, është shumë e vogël. Ne duhet t'ju ndihmojmë më shumë, dhe do t'ju ndihmojmë më shumë në të ardhmen».

Mirëpo, siç duket, kur thuheshin këto fjalë, vija regresive e Çu En Lait ishte në inferioritet, e dobët. Tash ajo duhet të ketë fituar supremacinë dhe ndjekësit e saj flasin krejt ndryshe.

Shoku Adil, që u kthye nga Pekini, ku kishte vajtur për marrëveshjen ekonomike, konstatoi një frymë të hapët arrogante, përbuzëse dhe të akullt, bile armiqësore nga ana e njerëzve të grupit të Çu En Lait e të Li Hsien Nienit. Li Hsien Nieni ia tha gati hapur Adilit: «Edhe ato ndihma që ju kemi dhënë, kemi bërë gabim dhe jam kritikuar për këtë». «Unë, — i tha Li Hsien Nieni, njeriu me sëpatë të madhe, — jam për të shkurtuar investimet». Me fjalë të tjera, kjo do të thotë: «Ju shqiptarët, mendoni çfarë të doni, por unë jua pres me sëpatë kërkesat tuaja». Kërkesat tona janë të arsyeshme, por, për kinezët, mendimet dhe vija jonë politike janë «të paarsyeshme». Kinezët duan që edhe ne të mendojmë dhe të veprojmë si ata, të kemi një politikë të jashtme oportuniste dhe joparimore, të kemi një qëndrim liberal brenda vendit kundër armiqve të popullit dhe të Partisë, të cilët ne i dënojmë, kurse kinezët i kthejnë në fuqi. Kinezët kërkojnë që Partia dhe shteti ynë të humbasin personalitetin që kanë fituar me gjak e me sakrificë dhe të bëhen një satelit i tyre. Ata dëshirojnë që, për çdo gjë, sahati ynë të bjerë në një kohë me sahatin e Pekinit. Kjo nuk do të ngjasë kurrë, në rast se sahati i Pekinit nuk bie si sahati i Marksit, i

Engelsit, i Leninit dhe i Stalinit, të cilin e ndjek me besnikëri e konsekuencë Partia e Punës e Shqipërisë.

Është e qartë se grupi i Çu En Lait bën presion mbi ne dhe dëshiron që vija jonë e drejtë marksiste-leniniste të mos i bëjë hije dhe të mos e vërë në pozita të vështira vijën e tyre, e cila nuk është marksiste-leniniste, por që ata bëjnë të gjitha përpjekjet për ta kaluar në histori si vijë «marksiste-leniniste revolucionare». Ky qëndrim i tyre armiqësor është përhapur anekënd. Ambasadorë të ndryshëm kinezë flasin për ne me gjuhën e Li Hsien Nienit. Sovjetikët, rumunët dhe jugosllavët i kanë rënë në erë këtij qëndrimi dhe kanë rirforcuar presionet e tyre kundër nesh. Realiteti kështu është, por presionet as na lëkundin dhe as na frikësojnë. Grupi i Çu En Lait gabohet rëndë kur mendon se do të na gjunjëzojë, ashtu sikundër u gabua edhe grupi i Hrushovit. Ne do ta mundim edhe këtë grup në arenën ndërkombëtare. Bota dhe popujt do të shohin se një popull, sado i vogël që të jetë, kur udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, nuk mposhlet; përkundrazi, ai ecën me guxim përpara dhe fiton. Populli vëlla kinez do ta shohë edhe ai një ditë politikën shoviniste që bën udhëheqja e tij kundër Shqipërisë socialiste dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat, në çdo moment dhe veçanërisht në kohët më të rënda për Kinën, kanë qenë pranë tij, e kanë mbrojtur dhe e kanë ndihmuar me të gjitha forcat.

Ne do të jemi kurdoherë me çështjen e drejtë të popullit kinez, do të jemi kurdoherë me rrugën e revo-

lucionit dhe të marksizëm-leninizmit. Politika e shtetit të madh nuk mund të fshihet për shumë kohë prapa maskave.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Shënime për Kinën»,  
vëll. II, f. 128*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha. «Shënime për  
Kinën», vëll. II, f. 128*

## PRESIONET E LAJKAT E REVIZIONISTËVE NUK SHKOJNË NË SHQIPËRI

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

25 korrik 1975

Ka kohë që në shtypin sovjetik dhe të revizionistëve të tjerë po dalin mjaft shkrime kushtuar Shqipërisë. Disa reklamojnë «përfitimet» që ne paskemi pasur në të kaluarën nga marrëdhëniet ekonomike me vendet e KNER-it dhe sugjerojnë «zgjerimin e tregtisë» me to. Të tjerë mburrin përfitimet që do të kishte vendi ynë po të mund të gjente një «gjuhë të përbashkët» me këtë ose atë shtet, po të ndryshonte këtë ose atë qëndrim «të ashpër». Ndonjë përpiqet bile të tregojë se cila duhet të jetë politika jonë e mbrojtjes dhe ku duhet të mbështetemi.

Se ç'fshihet pas këtyre «dëshirave» populli ynë e di mirë. Ai është ndeshur jo një herë me politikën e urryer e djallëzore të revizionistëve, si me atë të buzëqeshjeve e të lajkave, ashtu edhe me atë të presioneve e të bllokadave. Përgjigjja jonë ka qenë e prerë dhe e vendosur. Shqipëria i ka dërrmuar të gjitha taktikat e veprimet e tyre armiqësore dhe ka korrur suksese madhështore në

mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së saj, në ndërtimin e socializmit.

Ajo e ka provuar dhe ua ka treguar vendin Hrushovit dhe Mikojanit, që njihen në historinë e politikës ndërkombëtare si udhëheqës tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe që me anë të bllokadave ekonomike e politike kërkuan t'i mbyllnin gojën dhe ta mbytnin Shqipërinë socialiste, pse pati guximin dhe mbrojtji me vendosmëri marksizëm-leninizmin.

Shqipërinë e njeh, e nderon dhe e respekton gjithë bota. Miqtë e dashamirësit e saj, që janë me miliona në të gjitha kontinentet, shtohen e shumohen. Pozitat e saj ndërkombëtare janë të palëkundshme dhe të pathyeshme.

Politika e Partisë sonë është një politikë revolucionare marksiste-leniniste, që nuk mbështetet as në koniunkturaturat, as në nevojat e ditës. Ajo është politika e një vendi të lirë e të pavarur socialist, që mbron me guxim e me vendosmëri interesat e tij të lartë, që lufton e kontribuon me të gjitha forcat për përparimin e emancipimin e vërtetë të popujve, për lirinë e demokracinë e të gjitha vendeve.

Ne respektojmë dhe nderojmë ato qeveri e ato vende që ndjekin një politikë të pavarur e sovrane, në përputhje me interesat e popujve të tyre dhe të paqes e të sigurisë së përgjithshme, që nuk përulen përpara dëshirave dhe diktateve të dy superfuqive. Republika Popullore e Shqipërisë mbështet të gjitha qëndrimet e drejta në arenën ndërkombëtare të shteteve ose të vendeve që luftojnë për ruajtjen e lirisë, të pavarësisë e të sovranitetit, për çlirimin e tyre kombëtar ose shoqëror.

Por ka shtete të vogla e të mesme, të cilat, në fakt, nuk kanë një politikë indipendente dhe mbështeten në kreditë që japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bashkimi Sovjetik, si dhe në luhatjen e politikës së dy superfuqive.

Vendi ynë ka një politikë krejt të kundërt me këtë. Politika e tij nuk varet as nga kreditë, as nga tregtia. Kreditë që ka marrë Republika Popullore e Shqipërisë dhe tregtia që ka zhvilluar ajo nuk kanë influencuar për asnjë çast dhe për asnjë çështje në politikën e saj të drejtë, parimore e revolucionare.

Kush mendon se Shqipëria e ndryshon politikën e vet marksiste-leniniste pse i shitka një mijë tonë më shumë krom ndonjë shteti ose njëqind tonë duhan më pak një tjetri, i bën llogaritë shumë gabim dhe i nxjerr sytë vetes.

Gjithashtu, kush mendon se politika e Shqipërisë në përgjithësi dhe, në mënyrë të veçantë, politika shqiptare e mbrojtjes, e cila është bazuar në analizën e vërtetë marksiste-leniniste për të përcaktuar drejt e saktë se cilët janë armiqtë e saj, mbështetet në luhatjen e politikave të shteteve të ndryshme revizioniste, edhe ai ka futur gishtat në sytë e vet dhe është qorrur.

Mbrojtja e Shqipërisë socialiste mbështetet në armatosjen e gjithë popullit ushtar, në vendosmërinë e tij për të bërë çdo sakrificë e çdo vetëmohim për të ruajtur me çdo mjet e deri në fund lirinë e pavarësinë e tij, fitoret e revolucionit popullor dhe ndërtimin e socializmit.

Shqipëria ndjek një politikë të fqinjësisë së mirë me shtetet e ndryshme, në bazë të parimeve të mosndërhyrjes, të barazisë dhe të bashkëpunimit me leverdi reciproke.

Këtë politikë marksiste-leniniste e të drejtë Republika Popullore e Shqipërisë nuk e vë në ankand dhe nuk e bën çështje diskutimi. Ajo nuk e prish për asnjë arsye ekuilibrin e politikës së vet, por nuk lejon që ndonjë shtet, i njohur nga propaganda e tij false, të lërë të interpretohet sikur qëllimet e fqinjësisë së mirë të vendit tonë janë rezultat gjoja i një shkrirjeje të qëndrimeve tona, i ndonjë ndryshimi politik apo ideologjik të vijës së shtetit të diktaturës së proletariatit në Shqipëri. Aq më tepër nuk duhet të kenë iluzione ata që s'i duan të mirën Shqipërisë dhe që ëndërrojnë se asaj lehtë mund t'i imponohen me një politikë revizioniste tregtare. Ne kemi deklaruar se politika jonë përputhet me interesat e popujve dhe jo të klikave e të ideologjive që i shtypin këta popuj. Ajo kërkon miqësinë e këtyre popujve dhe jo atë të shtypësve të tyre. Ajo nuk është politikë e koniunkturave, por politikë e parrimeve proletare, ajo nuk buron nga një diplomaci e fshehtë e kulisave, e tratativave misterioze, e shitjes në ankand të interesave të vendit të vet dhe të vendeve të tjera. Politika e vendit tonë nuk është politikë e shteteve me njëqind flamurë në xhep. Republika jonë Popullore nuk e ul flamurin e saj as përpara shantazhit e frikës dhe as përpara rublës e dollarit.

Shqipëria e re, edhe kur ishte akoma e njomë dhe e pamëkëmbur mirë, mundi t'u bënte ballë rrebesheve revizioniste, ndërhyrjeve e presioneve të gjithanshme të armiqve të ndryshëm. Tani ajo është forcuar shumë ekonomikisht, pale politikisht e ideologjikisht. Prandaj ajo ecën krenare në rrugën e vet, e bindur në drejtësinë e saj dhe e sigurt se s'ka forcë që ta mposhtë ose ta



bëjë të ndryshojë kursin e saj politik e ideologjik.

Si në të kaluarën, edhe tani asaj nuk do t'i shuhet kurrë fryma internacionaliste dhe nuk do t'i mungojë kurrë ndjenja e solidaritetit luftarak me të gjithë ata që luftojnë për revolucionin, socializmin, çlirimin kombëtar e demokracinë. Shqipëria ka dhënë kurdoherë prova se i mbron miqtë marksistë-leninistë me besnikëri, duke e konsideruar këtë si një detyrë që forcon çështjen e madhe e të përbashkët të komunizmit. Vendi ynë, me gjakun e bijve më të mirë të tij, që i dërgoi për të ndihmuar në çlirimin e popujve vëllezër, e ka provuar se deri në ç'skallë është solidar me popujt që luftonin kundër fashizmit dhe si e mbështeti kauzën e përbashkët antifashiste. Ai edhe në të ardhmen do të vazhdojë të ecë në këtë rrugë, me të njëjtën vendosmëri dhe me të njëjtën konsekuencë.

Imperialistët, revizionistët dhe aleatët e tyre duhet ta dinë mirë se populli shqiptar dhe Partia e tij nuk janë gënjyer e nuk do të gënjehen kurrë nga kurthet ku ata duan të na tërheqin për të na mbytur më mirë. Ata kanë qenë dhe mbeten armiqtë e betuar të vendit tonë dhe të socializmit në Shqipëri, armiq të leninizmit, të revolucionit e të çlirimit të popujve. Partia jonë e ka bërë të qartë se kurrë nuk do të pajtohemi me ta, kurrë nuk do të jemi miq me ta, por armiq do të jemi kurdoherë.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 176 (8407), 25 korrik 1975*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern 1971-1975», (Përmbledhje veprash) f. 587*

## KONFERENCA E PASIGURISË SË EVROPËS

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

29 korrik 1975

Pas dy vjet bisedimesh të mundimshme, pazarllëqesh dhe kombinacionesh në prapaskenë, u vendos të thirret në fund të këtij muaji në Helsinki ajo që quhet Konferenca e Sigurimit Evropian. Një numër jo i vogël dokumentesh, të mbushura me fjalë të bukura e me premtime të ëmbla, do t'u vihen përpara më 30 korrik kryetarëve të shteteve evropiane, për të hedhur mbi to nënshkrimet e tyre.

Shfaqja është pompoze, por zhurma e saj nuk mund t'i mbulojë rreziqet që përbën për popujt evropianë dhe për gjithë botën kjo ndërmarrje e rrezikshme sovjeto-amerikane. Ajo nuk mund t'i largojë dyshimet e druajtjet që Konferenca e Helsinkit ka ngjallur te njerëzit e thjeshtë të kontinentit tonë, tek të gjithë ata, të cilëve me të vërtetë u dhimbsen paqja e siguria në Evropë.

Pyetja që shtrohej përpara se të fillonin bisedimet për Konferencën e Sigurimit Evropian, që bëhet sot e do të bëhet gjithnjë, është një dhe e vetme: kush e kërcënon Evropën? Nga kush duhet të sigurohen popujt

evropianë? Mos vallë paqen e sigurinë në Evropë e rrezikojnë Belgjika apo Zvicra, Finlanda apo Austria dhe prandaj del nevoja që ato, apo vende të tjera të tilla evropiane, të zotohen zyrtarisht se heqin dorë nga «kërcënimi dhe përdorimi i forcës»?

Përgjigjja nuk është e vështirë, ajo është e ditur dhe nuk kërkon zbulimin e ndonjë të panjohure. Paqja dhe siguri i Evropës kërcënohen drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të përhershme nga imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, nga politika e tyre agresive e ekspansioniste, nga blloqet e tyre ushtarake, nga ushtritë dhe bazat që mbajnë në vendet e tjera. Lirinë e pavarësinë e popujve evropianë e kërcënojnë dhe e rrezikojnë politika e zonave të influencës që ndjekin superfuqitë, praktikat imperialiste të klientelave politike dhe të ndërhyrjeve në punët e brendshme të të tjerëve, kursi neokolonialist dhe etja e tyre e papërmbajtur për të nënshtruar dhe për të sunduar vendet e kombet. Evropën e rrezikojnë dhe e kërcënojnë shantazhi atomik sovjeto-amerikan, aventurat e tyre ushtarake, përgatitjet e tyre të ethshme për një luftë të tretë botërore.

Nga ato pjesë të dokumenteve, që deri tani i janë bërë të njohura publikut, duket sikur letrat që do të nënshkruhen në Helsinki nuk përmbajnë kushte të detyrueshme politike, angazhime ushtarake etj. Nga ana e jashtme, nga pikëpamja formale, duket sikur asnjë nuk merr ndonjë detyrim konkret dhe se askujt nuk i janë lidhur duart. Por në realitet kushdo e sheh se nëpërmjet Konferencës së Helsinkit Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u imponuan të

tjerëve një dokument ndërkombëtar, ku njihet dhe pranohet faktikisht statukuoja e sotme e Evropës, domethënë njihen e pranohen zonat e influencës, njihet e pranohet sundimi politik, ushtarak e ekonomik i shumë vendeve të kontinentit tonë nga ana e imperialistëve amerikanë dhe e socialimperialistëve sovjetikë.

Nga zhvillimi i bisedimeve të gjertanishme rezulton fare qartë se Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk i ka preokupuar sigurimi i vërtetë i Evropës, por sigurimi i zonave të tyre të influencës, i bazave të tyre politike e ushtarake, heqja e atyre barrierave që pengojnë zgjerimin e hegjemonisë së tyre politike e ekonomike, qetësimi i prapavijave, për t'u drejtuar më me forcë dhe me peshë më të madhe në zona ku krijohen «boshllëqe» ose ku zhvillohen revolucioni e luftërat çlirimtare të popujve.

Cili është përfitimi i popujve evropianë dhe cila është dobia për paqen e përgjithshme?

Vallë mos u bë më i lehtë tani, me «sigurimin evropian», sundimi i revizionistëve sovjetikë në vendet e Evropës Lindore, mos u larguan trupat sovjetike prej andej, mos u ndërpre integrimi i tyre politik, ekonomik e ushtarak në Bashkimin Sovjetik, mos u pakësuan presioni i Moskës mbi kulturën nacionale të këtyre vendeve dhe sulmi ndaj traditave kombëtare?

Mos vallë me konferencën evropiane do të zbuten presionet mbytëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi vendet e Evropës Perëndimore, mos do të pushojë ndërhyrja e monopoleve të përtej Atlantikut në punët e tyre të brendshme, mos do të shpëtojnë ato nga inflacioni e kriza e importuar nga Amerika?

Përveç fjalëve tingëlluese dhe iluzioneve të rreme, Konferenca e Helsinkit nuk sjell asgjë tjetër. Ndo-dhi ajo që ne patëm lajmëruar me kohë dhe që në deklaratën e Qeverisë së RPSH ishte thënë në mënyrë të qartë, se Konferencën e Sigurimit Evropian superfuqitë do të përpiqen ta kthejnë në një mjet për të përhapur frymën e tyre liberalo-pacifiste, se sot të gjitha problemet botërore, konfliktet klasore ndërkombëtare gjoja mund të zgjidhen me anë të bisedimeve «paqësore» e «kontakteve personale», se krerët e tanishëm sovjetikë e amerikanë janë njerëz të paqes e punojnë për paqen.

Tavolina e Helsinkit është amerikano-sovjetike, të tjerët paguajnë harxhet. Dokumentet që do të nënshkruhen atje nuk pasqyrojnë as për së largu interesat, dëshirat ose shqetësimet e popujve evropianë. Shpresa e atyre njerëzve që mendonin se Konferenca e Sigurimit Evropian do të forconte pavarësinë e disa vendeve që ndodhen nën sundimin dhe influencën e Bashkimit Sovjetik apo të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, se do të nxiste disa të tjera për autonomi, rezultoi se ishte vetëm një iluzion, një shpresë boshë. Faktet provuan se në caklimin e objektivave të konferencës, në hartimin e projekteve, në formulimin e tezave e të koncepteve pesha e shteteve të tjera pjesëmarrëse ka qenë fare e vogël dhe roli i tyre fare minimal. Për konferencën superfuqitë bisedonin e vendosnin jashtë saj, në takimet dypalëshe, jo vetëm larg syve e veshëve të tjerë, por edhe kundër interesave të të tjerëve. Bile edhe data përfundimtare e mbledhjes u vendos vetëm pas bisedimeve të Gromikos e Kisingerit në Gjenevë.

Tani kur të dyja superfuqitë janë përfshirë nga kriza të rënda dhe kanë pësuar dështime të gjithanshme, kur në botë ka filluar të ngrihet vala antiamerikane e antisocialimperialiste, ato e ndiejnë shumë nevojën e përkrahjes së njëra-tjetrës. Këtë e ndien sidomos klika e Brezhnjev, iniciatorja e kësaj konference, e cila «sigurimin evropian», «uljen e tensionit» i ka lidhur me fatin politik personal. Asaj i duhet të dalë në Kongresin e 25-të të partisë revizioniste sovjetike, të parashikuar për në fillimin e vitit të ardhshëm, me një «sukses», të tregojë se politika e saj e jashtme «dëgjohet» e «respektohet». Me anë të manovrave diplomatike ajo synon të konsolidojë pozitat e saj brenda dhe në vendet satelite, të marrë një hov të ri për të ndjekur politikën hegjemoniste në rajone të tjera.

Përfundimi i Konferencës së Helsinkit shikohet nga Brezhnjevi, gjithashtu, si një kusht i favorshëm për të thirrur së shpejti konferencën e partive revizioniste të Evropës dhe për ta shndërruar atë në një mjet për të forcuar sundimin mbi to, për t'i lidhur edhe më fort pas qerres së politikës së jashtme sovjetike.

Jo më pak nevojë për një «sukses» diplomatik ka edhe SHBA. Pas disfatave të turpshme në Vietnam e Kamboxhia, pas falimentimit të Kisingerit në Lindjen e Mesme, pas rënies së madhe të besimit ndaj saj nga ana e aleatëve, imperializmi amerikan ka nevojë ta ngrejë prestigjin politik të rënë dhe, nëpërmjet frikës së bashkëpunimit sovjeto-amerikan, të vërë rregull në aleancat e lëkundura.

Fordi i hapi dritën e gjelbër Konferencës së Sigurimit Evropian, sepse ai do që të ndihmojë grupin

proamerikan brezhnjevian në Moskë, sikurse edhe klika që sundon aktualisht në Kremlin preferon që vija niksoniane e afrimit me Bashkimin Sovjetik, që ndjek Fordi, të vazhdohet edhe nga administrata e re që do të zgjidhet vitin e ardhshëm.

Dihet mirë se çdo sigurim është i lidhur ngushtë me aspektet ushtarake, me atë se çfarë kushtesh reale ofron ai për të evituar ose për të mbrapsur agresionin eventual. Po përse superfuqitë nuk pranuan të diskutoheshin anët ushtarake të sigurimit, me gjithë insistimin e disave nga pjesëmarrësit? Ato e bënë këtë sepse duan që popujt evropianë të jenë të pasiguruar e të dobët, me qëllim që t'u imponojnë më lehtë vullnetin e diktatit e vet, pse duan t'u heqin mundësinë e forcën e vetëmbrojtjes, aftësinë për të kundërshtuar ligjin që ato duan të bëjnë në Evropë. Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë kërkojnë t'i detyrojnë vendet e tjera të qëndrojnë të çarmatosura ose me një armatim të kufizuar e jo të efektshëm përpara fuqisë ushtarake gjithnjë në rritje të dy superfuqive, të qëndrojnë pasive e të pafuqishme përpara perfeksionimit gjithnjë e më të madh të armatimeve, përpara shtimit të bazave ushtarake e të buxheteve të luftës.

Aspektet ushtarake të sigurimit u lanë jashtë në Helsinki, sepse superfuqitë duan të ruajnë me çdo kusht te popujt psikozën e frikës e të luftës. Sigurimin ushtarak të vendeve evropiane superfuqitë duan ta vënë nën dy ombrellat e tyre, të cilat kanë për qëllim që popujt e vendet të mos kenë alternativë tjetër përveç asaj që shpëtimin ta shohin të lidhur ose me njërin ose me tjetrën superfuqi, të mos mendojnë me kokën e tyre,

që vullneti dhe liria e tyre të jenë të lidhur me këto dy kuçedra.

Marrëveshjet e sigurimit evropian janë një rrjetë e re merimange e dy superfuqive për të pleksur edhe më keq alcatët e tyre dhe të tjerët. Ky është spekulimi më i madh që është bërë ndonjëherë me dëshirën e popujve evropianë për paqe e siguri, bashkëpunim e fqinjësi të mirë. Si mund të flitet për Evropë të siguruar kur ajo është e mbushur me baza ushtarake të huaja e bomba atomike të superfuqive, me qindra mijë ushtarë, me tanke e aeroplanë të panumërt sovjetikë e amerikanë? Superfuqitë nuk deshën të diskutoheshin problemet ushtarake, sepse ato duan të ruajnë të paprekur xhandarmërinë e tyre në Evropë, duan të ruajnë presionin e shantazhin e përhershëm ushtarak, duan ta mbajnë Evropën të rrethuar e të izoluar nga pjesët e tjera të botës.

Si mund të flitet për sigurim të saj pa Mesdheun, pa Lindjen e Mesme, pa Afrikën Veriore? Historia e ka provuar më se një herë se, edhe kur konfliktet që kanë shpërthyer në Evropë nuk janë bërë për Mesdheun, për Afrikën Veriore apo për Lindjen e Mesme, këta janë përfshirë kurdoherë në flakët e tyre. Fatet e këtyre zonave janë të lidhura shumë ngushtë me ato të Evropës dhe ndarja që u bëri Konferenca e Sigurimit Evropian duket se është artificiale e qëllimkeqe.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik e kundërshtuan me tërbim lidhjen e sigurimit evropian me atë të Mesdheut, të Afrikës Veriore dhe të Lindjes së Mesme, sense ndryshe do të dilte problemi i largimit të flotave të tyre nga Mesdheu, do të demas-



kohet politika barbare e kanonierave që ata zbatojnë ndaj brigjeve të këtij pellgu, do të zbulohet edhe më keq ndërhyrja brutale në konfliktin arabo-izraelit, do të dilte edhe më në dritë ai rivalitet i egër i tyre në këtë zonë, i cili rrezikon paqen e sigurinë e të gjithë popujve. Qëndrimi i superfuqive në këtë çështje ishte një provë se ato duan që sundimin e tyre në këto zona ta shtrijnë më tej, që ai të bëhet i plotë dhe i përhershëm.

Prandaj pjesëmarrësit e mbledhjes së Helsinkit të mos shpejtohen për të kënduar «fitoret» e paqes e të sigurisë, të uljes së tensionit në Evropë.

Marrëveshjet, traktatet, lëshimet e kompromiset, që manipulohen e përfundohen nën drejtimin e Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk mund të kontribuojnë kurrë për forcimin e paqes e të sigurisë, as në plan rajonal, as në plan ndërkombëtar.

«Sigurimi evropian» jo vetëm nuk zhduk rivalitetin ndër imperialist, që përbën edhe një nga burimet kryesore të shpërthimit të luftërave agresive, por, duke qenë produkt i politikës ekspansioniste e hegjemoniste të superfuqive, ai do të influencojë në rritjen e kontradiktave e të tensioneve ekzistuese në të gjitha zonat e kontinentet.

Superfuqive u krijohen mundësi të veprojnë më lirshëm në kontinentet e tjera, të shtojnë presionet e intrigat për të përçarë dhe për të ngritur popujt kundër njëri-tjetrit me qëllim që të gllabërojnë tregjet, të akaparojnë zona të reja influence dhe të shtrijnë hegjemoninë. Që tani ato kanë filluar të hyjnë në Oqeanin Indian dhe të shtrihen në Afrikë, të lakmojnë pasuritë

e Gjirit Arabik dhe t'u tregojnë kthetrat Azisë e Amerikës Latine.

Kështu koniunkturat ekzistuese bëhen më të pasigurta dhe rritet kudo mundësia e grumbullimit të elementeve të reja shpërthyes, rriten kërcënimet e rreziqet ndaj interesave të popujve e të kombeve.

Propagandistët e zellshëm të sigurimit evropian flasin tani shumë se me anë të tij do të ndalohet cenimi i kufijve dhe do të evitohet përdorimi i forcës. Si garanci për këtë ata japin deklaratat «solemne» të Fordit dhe fjalën «e nderit» të Brezhnjevit. Por a mund ta mbështetin popujt e Evropës sigurimin e tyre në të tilla pallavra? Ata kanë vuajtur shumë nga agresionet imperialiste e nga pabesitë e superfuqive dhe s'mund ta lënë veten të mashtrohen me disa copa letre, me marrëveshje e traktate demagogjike.

Hitleri kishte vënë dhjetë firma se nuk do t'i thyente kurrë kufijtë e Francës, Belgjikës, Holandës dhe me lot në sy ishte betuar se pas marrjes së Sudetëve nuk do ta prekte as për së largu Çekosllovakinë. Të gjithë e dinë se ç'ndodhi më vonë. Brezhnjevi, gjithashtu, as një muaj më parë se të dërgonte tanket e tij në Pragë, kishte nënshkruar në Bratislavë një dokument të gjatë, ku mospërdorimi i forcës ngrihej në qiell. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jo vetëm nëpërmjet Kartës së OKB-së por edhe në një numër të pafund traktatesh, janë zotuar të mos prekin kufijtë e të mos përdorin forcën. Por ata s'kanë munguar të ndërhyjnë në Greqi dhe të sulmojnë Korenë, të pushtojnë Vietnamin dhe të rrbarkojnë në Liban, të ndërhyjnë në Santo-Domingo dhe të luftojnë kundër popullit kamboxhian. Vetëm

naivët dhe miopët mund të besojnë në fjalët e bukura dhe në premtimet për paqe të imperialistëve, vetëm ata mund të shpresojnë në fuqinë e deklaratave, të marrëveshjeve të përgjithshme ose në moralin fals të agresorëve. Por popujt nuk u besojnë fjalëve dhe nuk mashtrohen nga demagogjia imperialiste e revizioniste.

E ashtuquajtura politikë e uljes së tensionit, për të cilën tani bëjnë shumë zhurmë imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, është vazhdim i «luftës së ftohtë», por në një formë tjetër, është politika e vjetër e forcës, por e maskuar me buzëqeshje e nanurisje.

Bashkekzistenca paqësore, siç e kuptojnë dhe e interpretojnë imperialistët e revizionistët, është një ideologji e praktikë kundërrivolucionare e antikombëtare, ajo është antipopullore dhe deri në fund antidemokratike. Si shprehje e politikës ekspansioniste e hegjemoniste të superfuqive, ajo përfaqëson një instrument të rrezikshëm për të vënë nën zgjedhë popujt, për t'i nënshtruar e për t'i kolonizuar ata. E ashtuquajtura «frymë e uljes së tensionit», të cilën e propagandojnë sidomos revizionistët, është fryma e nënshtrimit dhe e pasivizimit, e cila synon të dobësojë vigjilencën revolucionare të popujve, t'i detyrojë ata të heqin dorë nga mbrojtja e interesave të tyre jetikë kombëtarë, t'i lërë të çarmatosur politikisht e shpirtërisht përpara sulmeve të dy superfuqive.

Ka pasur një iluzion të vjetër në Evropë, të cilin ajo e ka paguar shtrenjtë. Shumë politikanë kanë menduar se mund t'u bëhen koncesione agresorëve në këtë kontinent, për ta shtyrë luftën drejt rrugëve të largëta. Por historia ka provuar se paqja nuk është e ndashme.

Në kushtet e botës së sotme kjo është bërë edhe më e vërtetë. Agresorët as janë ndalur dhe as do të ndalen kurrë me koncesione e lëshime e, aq më tepër, me iluzione. Tërheqja u ka ngjallur kurdoherë më shumë oreksin atyre që kanë dashur të sulmojnë e të push-tojnë.

Ulja e vërtetë e tensionit, largimi i rrezikut të luftës nuk arrihen me iluzione e me shpresa të bazuara në «arsyen» e «realizmin» e imperialistëve amerikanë e të socialimperialistëve sovjetikë. Ata përbëjnë një objektiv që duhet arritur nga vetë popujt, duke luftuar politikën hegjemoniste e ekspansioniste të superfuqive, duke demaskuar e duke penguar manovrat e tyre diplomatike mashtruese, duke luftuar psikozat e rreme pacifiste që ato përhapin, duke forcuar ndjenjat e mbrojtjes së lirisë dhe të dinjitetit kombëtar të popujve e të shteteve të pavarura, duke forcuar, para së gjithash, frymën revolucionare dhe unitetin ndërkombëtar të proletariatit e të punonjësve në të gjithë botën.

Që para një viti ne kemi deklaruar: Ku qëndron sigurimi i popujve të Evropës ose i popujve të botës? Në udhëtimet e hapëta dhe misterioze të njëfarë Kisingeri, të njëfarë Gromikoje, apo në dallaveret e një Brezhnjevi, që gjakos popullin sovjetik dhe të tjerë, në udhëtimet e një Niksoni që mbyty botën në gjak dhe udhëheq mafian amerikane në skandalin më të turpshëm të Uotergejtit, që tronditi gjithë Amerikën? Këtyre t'u lihet të sigurojnë të ardhmen e botës? E ardhme e bukur do të jetë!

Natyrisht, ata që u besojnë iluzionistëve tragjikë janë të lirë të venë në mbledhjet e Vjenës, të Helsinkit

dhe ku të duan. Le të bëjnë pallavra me njëri-tjetrin! Por edhe në jemi të lirë të mos vemi në ato mbledhje dhe nuk vemi. Në ato mbledhje dhe konferenca mungojmë jo vetëm ne, por edhe popujt. Kjo ka rëndësi për ne.

Ky qëndrim i qartë i Partisë, i Qeverisë dhe i popullit tonë, lidhur me sigurimin evropian, u përgjigjet jo vetëm interesave të lartë të Shqipërisë, por edhe çështjes së forcimit të paqes e të sigurisë në kontinentin evropian. Ne në mënyrë të hapët e të sigurtë kemi vënë në dukje se shtetet sovraane nuk duhet në asnjë mënyrë të tërhiqen nga planet e revizionistëve e të imperialistëve, mbasi ato janë në dëm të sovranitetit të tyre kombëtar dhe të sigurisë së popujve.

Tashmë shumë vende pjesëmarrëse, që shkuan në bisedime me shpresën se atje do të zhvillohej një dialog i barabartë midis shteteve për rregullimin e problemeve evropiane e botërore, mbetën të zhgënjyera. Por ato hynë në vallen e hequr nga sovjetikët e amerikanët dhe nuk mundën të dilnin dot. Bile edhe mjaft përpjekje të tyre për çështje procedurale dhe kërkesa për disa formulime të zbutura u hodhën poshtë me arrogancë dhe u shtypën me brutalitet nga super të mëdhenjtë.

Paqja dhe siguri i vërtetë i Evropës nuk është një gjë që mund të dhurohet nga superfuqitë, të sigurohet nga disa copa letre pa vlerë, nga deklaratat demagogjike e premtime mashtruese të imperialistëve amerikanë dhe të socialimperialistëve sovjetikë. Para së gjithash duhet të largohen bazat ushtarake dhe trupat e huaja që ndodhen akoma në mjaft vende të Evropës, duhet luftuar e kundërshtuar politika e armatimeve, e

kërcënimeve dhe e shantazheve ushtarake të superfuqive, duhet të prishen blloqet agresive dhe marrëveshjet e tjera që shfrytëzohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik për të ndjekur politikën e tyre të sundimit e të nënshtrimit ndaj popujve evropianë.

Sigurisht, kërcënimet e rreziqet janë të mëdha, por ato nuk duhen parë në një frymë fataliste si të pashmangshme. Përpjekjet do të jenë të ashpra, po ato mund të fitohen në qoftë se hidhen poshtë me forcë iluzionet pacifiste, gënjeshttrat e mashtrimet imperialisto-revizioniste, në qoftë se priten me shpatë zinxhirët me të cilët superfuqitë duan të lidhin popujt e Evropës. Ulje tensioni midis popujve, nga njëra anë, dhe imperialistëve e socialimperialistëve sovjetikë, nga ana tjetër, nuk mund të ketë kurrë, ashtu siç nuk mund të ketë paqe e siguri të vërtetë përderisa do të ekzistojë politika aktuale hegjemoniste e superfuqive.

Paqja e siguria, ulja e tensionit e bashkëpunimi janë probleme që duhet të zgjidhen dhe mund të zgjidhen vetëm nga popujt me anë të një lufte të përherëshme konsekuente e të vendosur kundër atyre forcave imperialiste e ekspansioniste që duan t'u grabitin vendeve e kombeve atë çka ata kanë më të shtrenjtë, lirinë e pavarësinë, perspektivën e së ardhmes së tyre.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 179 (8410), 29 korrik: 1975*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern 1971-1975» (Përmbledhje veprash), f. 592*

# POLITIKA KINEZE NUK KA BOSHT KLASOR PROLETAR

Shënime

31 korrik 1975

Nuk duhet të harrojmë se Bashkimi Sovjetik, si një shtet socialimperialist, te Kina e Maos sheh një rrezik të madh, prandaj edhe përpiqet ta krimbë, mundësisht edhe ta sulmojë. Por, si shtet socialimperialist që është, mendon se edhe Kina mund ta sulmojë Bashkimin Sovjetik. Kina, mendoj unë, nuk do të arrijë ta bëjë këtë, por strategjikisht synon që të fitojë kohën e humbur për t'u bërë ekonomikisht dhe ushtarakisht një fuqi e madhe me bujqësi dhe me industri shumë moderne. Në qoftë se Kina ia arrin këtij objektivi pa luftëra, ajo do të bëhet një fuqi kolosale, e treta fuqi e madhe botërore. Po çfarë fuqi e madhe botërore? Socialiste apo imperialiste? Kjo varet nga qëndrimet politiko-ideologjike të Partisë Komuniste të Kinës. Në qoftë se Kina do të vihet në pozita të forta e të palëkundshme marksiste-leniniste, ajo do të bëhet një fuqi e madhe socialiste, shtylla e revolucionit botëror, armike e betuar e dy superfuqive imperialiste, Bashki-

mit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përndryshe, edhe Kina do të bëhet një fuqi socialimperialiste. Dhe atëherë të tria këto fuqi do të sundojnë mbi popujt me luftëra grabitqare, do të zhvillohet lodra e aleancave imperialiste dhe e luftërave të padrejta për hegjemoni e rindarje të zonave të influencës etj.

**Aktualisht në ç'pozita qëndron Kina në arenën ndërkombëtare? Për mendimin tim, ajo nuk mban qëndrime revolucionare, nuk ndjek një politikë të parë si duhet nga këndi klasor i revolucionit. Kina konsideron se armiku kryesor i botës është Bashkimi Sovjetik. Kjo s'është plotësisht kështu. Sot armiqtë kryesorë në botë janë dy: Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për Kinën, strategjikisht, mundet që Bashkimi Sovjetik të jetë armiku më imediat, por në politikën botërore nuk mund ta bësh këtë ndarje, këtë dallim, sepse atëherë del sikur Kina mendon vetëm për vete, dhe nuk mendon edhe për popujt e tjerë që vuajnë dhe duan të çlirohen. Po nga kush duan të çlirohen? Vetëm nga Bashkimi Sovjetik? Po nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Sigurisht, popujt duan të çlirohen nga të dyja këto superfuqi dhe nga të gjithë kapitalistët e botës që të tërë së toku u pinë gjakun atyre.**

Politika aktuale ndërkombëtare e Kinës dallohet nga thirrja për «unitet të të gjithëve»: të imperializmit amerikan, të fuqive të tjera të mëdha kapitaliste, të «botës së tretë», në të cilën publikisht është futur edhe vetë, të «botës së të paangazhuarve», dhe, më në fund, të popujve, marksistë-leninistëve dhe gjithë revolucionarëve. Pra të gjithë këtyre, pa dallim, u bën thirrje për «unitet» kundër Bashkimit Sovjetik socialimperialist.



Kjo politikë e hapët dhe jomarksiste e Kinës u thotë të gjithëve: «Lëreni mënjanë luftën e klasave, harrojeni për një kohë revolucionin (sa të bëhem unë, Kina, një fuqi e madhe), proletarë të të gjithë hotës, bashkoni përpjekjet tuaja me borgjezinë që ju shtyp, sepse (dëgjomëni dhe ndiqmëni mua), ne duhet të shkatërrojmë më parë armikun numër një, Bashkimin Sovjetik social-imperialist, pastaj shohim e bëjmë».

Kjo lloj politike e Kinës, që ndihmon imperializmin amerikan dhe fuqitë kapitaliste botërore, po çorodit dhe po përçan forcat revolucionare dhe komunistët në mbarë botën. Këtë punë bënë edhe hrushovianët. Ç'thanë ata? «Bashkekzistencë paqësore, miqësi me të gjithë e veçanërisht me amerikanët; luftë kundër marksistë-leninistëve, kundër luftërave revolucionare; revolucion në rrugën paqësore» etj., etj. Ç'thotë tani Kina? Të gjitha këto që përmenda dhe që tash njihen, por në adresë të Bashkimit Sovjetik e kundër tij. «Kundër» Shteteve të Bashkuara të Amerikës flet në surdinë edhe Kina, ndërsa Hrushovi në kohën e tij fliste «me bomba të mëdha». Kontradiktat e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë, si të thuash, në gjumë.

Kina mendon, me një naivitet të habitshëm, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera, të cilave u bën thirrje për unitet, «do të marshojnë» kundër Bashkimit Sovjetik, ashtu siç e do ajo dhe kur të dojë ajo. Sa larg është dëshira e saj nga realiteti! E kundërta ngjet në jetë. Imperializmi amerikan dhe aleatët e tij e pranojnë dhe e mbështetin politikën dhe thirrjen e Kinës, sepse kanë fitime kolosale, ata ndihmohen shumë nga kjo politikë në veprimtarinë e tyre për ço-

rientimin e revolucionarëve e shtypjen e tyre, për zbutjen e luftës së klasave dhe nxitjen e të gjitha forcave kundër Bashkimit Sovjetik dhe partive të tjera revizioniste, në çdo vend qofshin ato. Në strategjinë e tyre globale imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre nxitin Kinën, sa më shumë të jetë e mundur, kundër Bashkimit Sovjetik dhe bëjnë çmos që këtë ta trembin me rrezikun kinez për të realizuar më lehtë qëllimet e tyre, për ta dobësuar dhe për ta krimbur akoma më mirë dhe sa më shpejt Bashkimin Sovjetik, dhe pastaj t'i kthehen edhe Kinës me forca të shumëfishuara. Kjo është e qartë për çdo njeri me pak mend, kurse për kinezët «marksistë-leninistë-maoedunistë» jo. Udhëheqësit kinezë me politikën e tyre mburren se dobësojnë Bashkimin Sovjetik dhe thellojnë kontradiktat në mes tij dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por ata harrojnë se ekziston edhe mundësia tjetër për të cilën ata s'reflektojnë fare, që kjo politikë është në dobi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me naivitete kinezët mendojnë se me politikën e tyre dobësojnë të dyja superfuqitë, Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kina socialiste mund të luajë me të vërtetë një rol vendimtar në botë, në rast se politika e saj e jashtme do të jetë një politikë klasore, marksiste-leniniste, që mbështetet në forcën, në dëshirat dhe në aspiratat e popujve. Kjo gjë me fjalë nga kinezët thuhet lehtë e shpesh, por me vepra jo. Kina vendos marrëdhënie diplomatike me shumë shtete në botë, deri edhe me shtete fashiste. Ajo po zhvillon tregti të madhe ndërkombëtare, mundet që jep edhe kredi, por kudo shihet qartë se në mënyrë të veçantë ajo u kushton shumë rëndësi dhe

përpiqet të vërë në dukje lidhjet e saj me krerët e regjimeve të këtyre vendeve. Duhet thënë se lidhjet ndër-shtetërore nuk mund të evitohen, por që të veprohet «kaq miqësisht» me krerët e borgjezisë sunduese, ashtu siç bën Kina, do të thotë fare qartë se ajo ka harruar anën klasore të marrëdhënieve midis shteteve. Nga politika kineze popujt dhe revolucionarët e këtyre vendeve pësojnë deziluzione të hidhura.

Populli është e vetmja bazë e vërtetë e luftës kundër socialimperialistëve sovjetikë, imperialistëve amerikanë dhe borgjezisë së vendit. Ky faktor nuk duhet harruar kurrë, në asnjë rast. Mirëpo këtë kinezët e harrojnë. Aleanca dhe shpresat e tyre mbështeten në krerët borgjezo-kapitalistë. Kinezët mendojnë se këta janë «aleatë besnikë» të revolucionit, në rast se tregojnë qoftë edhe shenjë më të vogël të antisovjetizmit. Regjimi fashist i Kilit është antisovjetik dhe proamerikan në palcë, por për kinezët është një aleat dhe bashkudhëtar.

Kinës nuk i vjen aspak mirë që Laosi, Koreja e Veriut e ndonjë tjetër tregohen prosovjetikë. Dhe për këtë ka të drejtë. Por ama edhe këtyre s'u vjen mirë që Kina tregohet proamerikane. Të dyja palët bëjnë një politikë joparimore, joklasore, jomarksiste. Qëndrimet e tyre janë oportuniste dhe të mbarsura me rreziqe për të gjithë. Revizionistët sovjetikë përpiqen të dominojnë në Indokinë. Kina, kuptohet, do që të hyjë medoemos në konkurrencë joparimore. Në qoftë se gjendet në inferioritet përballë Bashkimit Sovjetik, ajo ose do ta prishë me vendet e Indokinës, ose do të thërresë tërthorazi në ndihmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Edhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare këtë

punë po bën Kina. Në fillim të lindjes së partive komuniste marksiste-leniniste ajo nuk u interesua shumë, më vonë aspak, kurse tash interesohet më tepër dhe bën thirrje për bashkim joparimor të grupeve të ndryshme nën parullën «luftë kundër Bashkimit Sovjetik në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e me borgjezinë kapitaliste të vendeve të tyre». Natyrisht, kjo politikë ka ngjallur pështjellim dhe pakënaqësi të madhe dhe reale në radhët e shokëve tanë në botë, por si ata, edhe ne nuk duam që të flasim hapur kundër kësaj politike të Kinës. Mirëpo ne me gojë mbyllur nuk mund të rrimë dhe as mund të bëhemi gramafoni i politikës së gabuar kineze.

Ne, haptazi dhe me forcë, afirmojmë qëndrimet dhe politikën tonë për çdo gjë, për çdo ngjarje, për çdo kombinacion politik që luhet në kurrizin e popujve. Dhe për të gjitha këto arsye shohim se politika jonë me atë të Kinës ndryshon në shumë çështje parimore. Kjo është mirë, mendojmë ne, sepse popujt dhe marksistë-leninistët janë në gjendje të gjykojnë vetë kush mendon dhe vepron drejt dhe kush gabim, pastaj u takon atyre të ndjekin rrugën marksiste-leniniste dhe ta adaptojnë këtë në situatat konkrete të vendeve të tyre.

Partia jonë shumë herë ka dashur dhe dëshiron që të ketë bisedime shoqërore me shokët kinezë për këto probleme jetike parimore, por kinezët nuk i duan këto bisedime; ata u shmangen këtyre. Bile ata e shprehin haptazi këtë mendim, duke shtyrë deri edhe vajtjen e delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë sonë, në një kohë kur në vendin e tyre s'lënë reaksionar pa prituri. Për ne është e qartë se ata nuk janë dakord me qëndri-

met tona të drejta dhe nuk duan të ballafaqohen në diskutime, sepse pozitat e tyre s'janë marksiste-leniniste.

Një politikë e tillë e gabuar e Kinës në arenën ndërkombëtare është rezultat i pikëpamjeve jomarksiste, të afirmuara në Kinë. Është e zorshme të përcaktojmë me saktësi ç'po ngjet në këtë vend, por një gjë mund ta themi: atje nuk duhet të ketë stabilitet, atje duhet të ketë grupe rivale të fuqishme, që, nën flamurin e Maos, kërkojnë kush e kush të fitojë pozita zotëruese në parti dhe në shtet. Elementët që u dënuan nga Revolucioni Kulturor po rehabilitohen dhe po zënë postet e humbura. Sigurisht, këta do të hakmerren kundër atyre që bënë Revolucionin Kulturor. Revolucioni Kulturor zyrtarisht vazhdon të jetë flamur për çdo veprim e hap që bëhet atje, por ky është një flamur që po shqyhet. Ata që bënë Revolucionin Kulturor nuk mund të pajtohen me këtë kurs që po marrin ngjarjet, që rehabilitohen kundërshtarët e tyre të djeshëm, që ndiqet një politikë e tillë e butë kundër imperialistëve amerikanë dhe që devijohet nga rruga e drejtë: luftë kundër Bashkimit Sovjetik revizionist dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këta, njerëzit e kësaj rruge, janë quajtur pasues të Lin Biaos, i cili u shpall se ishte «agjent sovjetik». Tash flitet se në Hanxhou, në Shangai dhe në qytete të tjera të Kinës ka trazira në ushtri. Thuhet se këta janë «partizanët e Lin Biaos». Ata edhe mund të jenë partizanë të Lin Biaos, por rëndësi ka fakti se cilat janë mendimet e tyre të vërteta politike dhe ideologjike.

Festa e ushtrisë sonë u bë shumë e zbehtë në Pe-

kin. Organizatori i festimit zyrtar, një nëpunës i protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, pas një ore, tha: «Festa mbaroi». Në sallë me këtë rast udhëheqës kryesorë gati nuk kishte fare.

Pse ngjasin këto? Pse ngjet që artikullin tonë kundër Konferencës së Helsinkit kinezët nuk po e përmendin fare, në një kohë kur përpiqen të gjejnë fraza në çfarëdo lëvere që flet kundër Bashkimit Sovjetik lidhur me këtë konferencë? Në qoftë se flitet me të vërtetë me forcë kundër Bashkimit Sovjetik, fiitat në artikullin tonë. Atëherë përse nuk zihet në gojë ky artikull nga shokët kinezë?! Për ne arsyeja është e qartë: në këtë artikull flitet po aq fort edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kurse kinezët nuk duan që opinionin e tyre të brendshëm të njihet me të. Nuk gjejmë dot asnjë shpjegim tjetër për këtë ndodhi politike me rëndësi.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 136*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 136*

## TOKËN DIJE PRODHIMET E SAJ T'I NDJEKIM NË ZHVILLIMIN E TYRE SHKENCOR

*Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit  
të Partisë dhe me drejtuesit e organizatave të masave  
të rrethit të Pogradecit<sup>1</sup>*

16 gusht 1975

*Pasi u përshëndet me pjesëmarrësit në këtë takim,  
shoku Enver Hoxha zhvilloi me ta një bisedë të përze-  
mërt.*

*Jeni të gjithë mirë me shëndet? (Të gjithë për-  
gjigjen se janë mirë.) Gëzohem shumë!*

*Nuk po ju ftoj të uleni «si në shtëpinë tuaj», se ju  
në shtëpinë tuaj jeni, kurse ne që kemi ardhur këtu  
për pushime jemi mysafirë. (Të qeshura.)*

*Më parë dua të them se shoku Hysni dhe unë gë-  
zohemi që po bëjmë këtë takim me ju, shokë drejtues  
të punëve të Partisë, të pushtetit e të organizatave të  
masave të rrethit të Pogradecit. Siç e dini, Partia kë-  
saj radhe nuk na ka dërguar këtu për punë, ne kemi ar-*

---

1. Në këtë takim merrte pjesë edhe shoku Hysni Kapo, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH.

dhur të pushojmë disa ditë, se Pogradeci është një vend shumë i bukur për pushime, por megjithëkëtë, neve nuk na rrihet pa u takuar me ju, shokë, dhe pa biseduar për problemet me të cilat merret Partia.

Shoku Hysni dhe shokët e tjerë të Byrosë Politike, ç'është e vërteta, vijnë më shpesh këtu dhe marrin kontakt të drejtpërdrejtë me masat, kurse unë më rrallë. Dëshira ime është që të vij sa më shpesh dhe të takohem jo vetëm me ju shokët me përgjegjësi të rrethit, por edhe me punonjësit e bazës, sepse, siç na porosin kurdoherë Komiteti Qendror i Partisë, ne duhet të jemi të lidhur sa më ngushtë me bazën, se ajo është themeli ynë. Sa më e ngritur politikisht dhe sa më e vendosur në vijën e Partisë të jetë baza, sa më mirë dhe në mënyrë revolucionare t'i zbatojë ajo direktivat e Partisë, aq më i fortë, më i lulëzuar e më i begatshëm do të bëhet atdheu ynë socialist.

Prandaj, pavarësisht se këtë herë nuk do të marrim dot takim edhe me anëtarët e ndonjë kooperative bujqësore ose me punëtorët në ndonjë ndërmarrje, ky takim me ju Hysniut dhe mua do të na shërbejë për të formuar më nga afër një ide për punën e Partisë e të pushtetit në rrethin e Pogradecit.

Me shokun Maksut<sup>1</sup> dhe me shokun Bexhet<sup>2</sup> kemi biseduar dy herë, ata na kanë informuar për zhvillimin e punëve në Pogradec. Shokët instruktorë të aparatit

1. Maksut Selenica, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Pogradecit.

2. Bexhet Zagorçani, në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Pogradecit.



të Komitetit Qendror të Partisë, që vijnë këtu, gjithashtu na informojnë për shumë probleme, prandaj udhëheqja e Partisë, në përgjithësi, është e njohur dhe e kënaqur me punën që bëjnë Partia dhe pushteti në këtë rreth. Sukseset që keni arritur dëshmojnë për atë që organizatën e Partisë këtu e kemi të fortë, të bashkuar dhe në unitet të shëndoshë me popullin. Ky tregues vërteton se gjendja politike dhe morale e rrethit është e mirë. Sipas mendimit tonë, edhe industria, edhe bujqësia në rrethin tuaj i plotësojnë detyrat, bile mund edhe t'i tejkalojnë ato. Ne besojmë që ju do t'i përmbushni me sukses detyrat e planit pesëvjeçar.

Pra, Hysniu dhe unë, në përgjithësi, i dimë arritjet e rrethit në fushat politike, ekonomike etj., por do të donim që ju, shokë, të na shtroni ndonjë problem që ka shqetësuar rrethin në tërësi ose ndonjë sektor të veçantë të jetës e të punës suaj. A mund të na flisnit me pak fjalë për ndonjë problem në Parti, në rini, në rradhët e punëtorëve, të kooperativistëve, të ushtarëve etj.? Një gjë e tillë do të na ndihmonte të shkëmbejmë mendime të vlefshme.

*Pasi folën shokë të byrosë së Komitetit të Partisë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

E dini, shokë, se për ç'arsye e bëra pyetjen për mundësinë e shtimit të prodhimit bujqësor në rrethin tuaj, duke përjashtuar Gurin e Kuq dhe Alarupin? E bëra për të theksuar rëndësinë e madhe që ka për ne zhvillimi i bujqësisë. Kjo rëndësi nuk është e panjohur për ju, se Partia ka lëshuar me kohë direktiva të qarta për këtë qëllim; por çështja është që t'i kuptojmë mirë këto direktiva dhe t'i zbatojmë me përpikëri.

Unë zura në gojë Minierën e rëndësishme e me perspektivë të madhe të Gurit të Kuq, por, sado që këtu kemi një industri me të ardhme, prapëseprapë pesha e saj sot në këtë rreth është e vogël. Kjo do të thotë se aktualisht dhe më pas, ne, jo vetëm këtu në Pogradec, por në të gjithë Shqipërinë duhet t'i vëmë rëndësi të madhe bujqësisë, pse, siç e dini, bujqësia është baza e ekonomisë.

Në goftë se nuk e zhvillojmë bujqësinë me ritme të shpejta dhe me një sedër marksiste-leniniste për interesat e mëdhenj të atdheut, ne nuk do të sigurojmë as mbrojtjen tonë nga armiqtë. Duhet të kemi synime të mëdha për bujqësinë. Ta kemi të qartë se, për kush-tet tona, bujqësia ka një rëndësi të dorës së parë. Toka, klima jonë janë pasuri të paçmueshme, por në goftë se nuk ka tokë të punuar e të trajtuar në mënyrë shkencore, nuk ka as prodhime të mjaftueshme. Në raste të tilla nuk përballohet dot shtesa e popullsisë, fuqia jonë bie, mbrojtja e vendit dobësohet. Nuk duhet të kënaqemi që e tejkaluam diçka planin ose që bëme një plan një çikë më të lartë, se kjo «vetëkënaqësi me pak» të mbyll perspektivën.

Ne, për sa i përket zhvillimit tonë të përgjithshëm, kemi ecur dhe do të ecim shumë përpara, ndërsa në vendet kapitaliste e revizioniste kriza po bën kërdinë, ajo ka shkaktuar inflacionin, papunësinë e miliona njerëzve, ngritjen e çmimeve dhe pasigurinë politike të brendshme. Këto pasoja negative e shkatërrimtare, që janë pjellë e sistemit ekonomik të kapitalizmit, janë të paevitueshme. Në këtë lëmsh, që ka përfshirë botën dhe Evropën, po ndeshen njëra me tjetrën klikat

sunduese borgjezo-revizioniste të shteteve të ndryshme.

Këtë kaos në tërë botën dhe në Evropë e shkaktojnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë me politikën e tyre të ndyrë që bëjnë për ndarjen e sferave të influencës dhe të hegjemonisë. Këto situata vërtet nuk ndikojnë drejtpërdrejt mbi ne, pse vendosmëria e Partisë dhe e popullit tonë për përparimin dhe për mbrojtjen është e madhe, por në mënyrë të tërthortë kriza e thellë botërore ndikon edhe te ne. Natyrisht, Shqipëria mbështetet fort në forcat e brëndshme, që janë faktori kryesor për ndërtimin e socializmit, por, sidoqoftë, nuk është e shkëputur nga bota në disa drejtime, siç janë, për shembull, marrëdhëniet e tregtisë së jashtme.

Në këto situata parulla e Partisë «Të mbështetemi në forcat tonat!» kërkon një kuptim të thellë politik nga tërë masa e komunistëve. Për të vënë në jetë këtë porosi nuk mjafton një kuptim i saj i përgjithshëm, as kënaqja me tejkalimin e një plani, duke mbajtur mjaft rezerva. Parullën e madhe të mbështetjes në forcat e veta duhet ta kuptojmë në platformën e gjerë politike ndërkombëtare, të lidhur ngushtë me rolin që do të luajë vendi ynë në këtë politikë.

Shqipëria duhet të synojë pikësëpari forcimin e vetvetes, sepse, po të jetë e fortë, nuk kanë g'ji bëjnë armiqtë. Miqtë e revolucionarët shohin se politika e Partisë sonë është e drejtë e parimore, se ndërtimi i socializmit bëhet mbi bazat e marksizëm-leninizmit, në përputhje me kushtet e vendit tonë. Prandaj qëndrimet e Shqipërisë janë të respektuara në botë, autoriteti i saj ndërkombëtar rritet gjithnjë.

Çështja është që të kuptohet nga Partia dhe nga të gjithë punonjësit se hartimi i planeve tona duhet të bëhet në frymën mobilizuese revolucionare. Kjo do të thotë të shfrytëzohen në maksimum të gjitha mundësitë ekzistuese dhe të krijohen mundësi të reja për ecjen tonë përpara. Të mos kënaqemi kurrë vetëm me këto mundësi që kemi krijuar, por të bëhen përpjekje nga të gjithë njerëzit që, gjatë punës, të zhvillojnë kapacitetet e tyre mendore, fizike e organizative dhe të krijojnë mundësi të reja, që janë pa fund.

Në disa sektorë të zhvillimit tonë socialist mundësitë që krijohen, sidomos në bujqësi, por edhe në industri, nuk kanë fund. Në qoftë se çështjet që përmendëm kuptohen politikisht dhe sipas mësimëve të Partisë, rrugët e përparimit gjenden. Po u bënë njerëzit të ndërgjegjshëm politikisht se ndërtimi i socializmit, zhvillimi i bujqësisë dhe i industrisë duhet të jenë të tillë që të sigurojnë në çdo moment mbrojtjen e atdheut, atëherë në të gjithë sektorët e punës dhe të jetës së vendit tonë do të shpërthejë një punë e vrullshme.

Kur themi t'i kuptojmë politikisht materialet e Partisë, nuk shtrohet çështja që këto dokumente të lexohen shkel e shko dhe të mendohet se kështu u kuptuan, por duhet që këto materiale të Komitetit Qendror të PPSH, të Byrosë Politike, të komiteteve të Partisë të rretheve etj. të asimilohen nëpërmjet thellimit për çdo problem. Ky thellim duhet të jetë fryt i mendimit e i gjykimit vetjak e kolektiv i të tërë komunistëve në organizatat-bazë, i punëtorëve nëpër ndërmarrje, i kooperativistëve nëpër koope-

rativa etj. Njerëzit, kur lexojnë dhe studiojnë materialet e Partisë, duhet të reflektojnë thellë mbi disa probleme kyç, sepse pikërisht për këto probleme jepen orientime, të cilat, siç na mëson Partia, duhet të zhvillohen më tej. Ky zhvillim të mos qëndrojë vetëm në sferën intelektuale të personave të veçantë apo të kolektivit, pra, të mos kufizohet vetëm në diskutime e debate, por të shtrihet edhe në sferën e organizimit të punës për vënien në jetë të orientimit, të direktivës.

Po të veprohet kështu, siç na mëson Partia, ne do të arrijmë medoemos të hapim perspektiva të mëdha për çdo problem, të shohim qartë edhe ato situata që nuk i shikojmë dot, se na duket sikur kemi përpara një mur, tej të cilit nuk mund të kalohet. Natyrisht, nuk jemi të gjithë të rinj në radhët e Partisë, prandaj e dimë se mjaft situata të vështira, që dukeshin të pakapërcyeshme më parë, janë kapërcyer me sukses. Tani, pas dhjetëra vjet pune e lufte revolucionare që ka bërë e po bën Partia, kuadrot, punëtorët dhe fshatarët në çdo sektor janë mësuar t'i hedhin hapat shumë të mëdhenj, ata janë bërë të ndërgjegjshëm politikisht e ideologjikisht dhe të aftë organizativisht që të krijojnë, të ndërtojnë, të drejtojnë. Prandaj, i bazuar në këto suksese, Komiteti Qendror i Partisë mendon se, me mundësitë dhe me forcat që janë krijuar, ne mund të hedhim një hap të madh përpara. Ky hap, që do të sanksionohet nga Kongresi i ardhshëm i Partisë, është i domosdoshëm të bëhet në këtë situatë ndërkombëtare. Ne duhet të futim në popull një frymë patriotike të shëndoshë, frymën e njeriut që mendon për të ardhmen qoftë kur është koha e turbullt, qoftë kur qielli

është pa re. Edhe atëherë kur qielli është i qartë, pa futur frymën alarmuese, ne duhet të mendojmë si t'i ruajmë atdheun e socializmin, sepse, derisa janë në botë kapitalizmi e revizionizmi, ekzistojnë edhe rreziqe ndaj nesh dhe gjithë botës revolucionare e përparimtare.

Partia duhet të krijojë bindje te njerëzit për nevojën që të bëhen përpjekje jashtëzakonisht të mëdha për të ruajtur aftësinë mbrojtëse të vendit tonë dhe, në të njëjtën kohë, për të mos e ulur nivelin e jetesës së popullit. Ne synojmë që, edhe në momentet kur vështirësitë të jenë të mëdha, të vazhdojmë të ngremë nivelin e jetesës së masave punonjëse.

Ne duhet të shtojmë prodhimin e drithit brenda vendit si për të përballuar nevojat e popullit me bukë, edhe për të krijuar rezerva. Në qoftë se një ditë armiqët do të na sulmojnë, të gjithë jemi të bindur se do t'i dërrmojmë ata. Neve do të na duhet të luftojmë dhe të punojmë nën goditjen e bombave të aviacionit armik për të mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë atdheun. Ne nuk do ta lejojmë armikun që të hyjë në Shqipëri, por, edhe po qe se ai do të futet në tokën tonë, do ta dërrmojmë. Qëndresa jonë, veç të tjerash, kërkon furnizimin e prapavijave të ushtrisë dhe të popullit.

Mund të biem edhe në vështirësi, por Partia i ka bërë llogaritë që të mos e lërë kurrë popullin pa bukë. Buka në tregun ndërkombëtar paraqit një deficit të madh dhe çmimi i saj, ashtu si i disa sendeve të tjera ushqimore, është ngritur jashtëzakonisht shumë. Në qoftë se nuk vëmë kujdes për të bërë vetë bukën, atëherë ne do të detyrohemi ta blejmë atë jashtë dhe kështu të lëmë pa importuar gjëra të tjera, që medoemos

do të na krijojnë një disnivel në furnizimin e popullit. Prandaj duhet të synojmë të bëjmë bukën në vend<sup>1</sup> dhe të krijojmë edhe rezerva.

Populli ynë duhet të bëhet i ndërgjegjshëm për vështrësitë që krijohen. Në qoftë se është punuar si duhet politikisht me popullin, ai e kupton këtë situatë. Për këto arsye, shokë, thashë pak më parë që bujqësia edhe në rrethin tuaj duhet të arrijë rezultate të larta.

Faktet tregojnë se, jo vetëm këtu te ju, por në të gjithë vendin tonë, këto vitet e fundit janë arritur suksese të mëdha në prodhimin e grurit, të misrit dhe të të gjitha llojeve të tjera të bimëve bujqësore. Këto arritje, që janë inkurajuese, kuptohet se nuk kanë ardhur vetvetiu, por janë rezultat i luftës që bëni ju çdo ditë e çdo orë për realizimin e detyrave dhe të direktivave të Partisë. Sukseset kanë ardhur nga një kuptim i lartë politik i atyre problemeve që thashë më përpara, nga ngritja e nivelit ideologjik, kulturor e teknik të punëtorëve e të kooperativistëve, nga përdorimi me zotësi i mekanizimeve që janë shtuar, nga bonifikimi dhe ujëtja, nga zgjedhja me kujdes e farës etj. Edhe në blegtori kemi suksese, disa raca të bagëtive janë përmirësuar dhe metodat e përdorura për trajtimin e tyre janë perfeksionuar.

Pra, siç e shikoni, janë një kompleks i tërë faktorësh, që, në përgjithësi, kanë ndikuar pozitivisht në

---

1. Nga tribuna e Kongresit të 7-të të Partisë shoku Enver Hoxha dha shtatoriqin se në vitin 1976 u realizua me sukses plani i prodhimit të drithërave, duke siguruar për herë të parë gjithë bukën në vend.

zhvillimin tonë progresiv. Por le t'i lëmë një herë rezultatat inkurajuese të përgjithshme dhe të mendojmë veçanërisht për secilin nga faktorët që e kanë shpënë bujqësinë tonë përpara. Le të diskutojmë, pra, për çdo faktor në veçanti dhe të bëjmë pyetjen: E kemi plotësuar ne detyrën tonë për rritjen e prodhimit, duke u udhëhequr nga një sedër marksiste-leniniste për interesin e socializmit, sikundër na ka orientuar Partia? Po ta shikojmë çështjen në këtë drejtim, do të na dalë se kemi suksese, por kemi edhe të meta të mëdha. Roli udhëheqës i Partisë duhet të konsistojë në atë që këto të dhëna t'i shohë një nga një dhe t'u futet në thellësi, që të jetë në gjendje të marrë masa për t'i përmirësuar në mënyrë të harmonishme të tërë komponentët e prodhimit. Për të siguruar një ngjitje të përhershme të prodhimit industrial e bujqësor, të produktit të përgjithshëm shoqëror dhe të të ardhurave kombëtare, të fondit të akumulimit dhe atij të konsumit, mund të mos mjaftojë një vit. Ne vërtet hartojmë planin për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës me afat pesëvjeçar, por Partia na porosit të jemi ambiciozë që të parashikojmë një perspektivë edhe më të largët, pra të bëjmë një parashikim perspektiv me afat dhjetëvjeçar.

Organizata-bazë e Partisë duhet ta inkurajojë çdo ekonomi kooperativiste që, kur të hartojë planin pesëvjeçar, të vrasë mendjen që ky plan të tejkalohet. Të merren masa organizative për të ujitur të gjitha tokat e kooperativës, të mbillen me pemë frutore të gjitha kodrat dhe të bëhen parashikime realiste që kooperativa të mbajë kaq dele, kaq dhi etj. Kur të parashikohet, për shembull, mbjellja e pemëve, duhet menduar ku



është toka më e përshtatshme për këtë qëllim, çfarë lloje pemësh bën më shumë kjo tokë, dardhë apo mollë, kumbulla apo qershi, rrush apo fiq e të tjerë. Pasi e vendosim një çështje dhe e vëmë në plan, të mos na zërë gjumi pa ia arritur qëllimit. Për të zbatuar planin që u miratua për pemët, së pari, ato duhet të mbillen, t'u bëhen shërbimet e nevojshme dhe, më pas, të merren kokrrat që të jenë të mjaftueshme jo vetëm për të kënaqur konsumin e popullit tonë, por të kemi edhe për eksportin, për t'i krijuar shtetit të ardhura në devizë, se kemi shumë nevojë për të. Pse kemi nevojë për devizë? Kemi nevojë sepse do të na duhet të ngremë fabrika moderne për zhvillimin e ekonomisë. Po me se do t'i sigurojmë këto fabrika? Me devizë, të cilën, veç të tjerave, do ta nxjerrin molla, kumbulla e dardha.

Ne eksportojmë fruta në tregun e jashtëm. Kërkesat e borgjezisë për cilësinë janë të jashtëzakonshme. Kërkohej, përveç të tjerave, që fruta të jetë e pastër, se një pikë të zezë po të ketë, për shembull, dardha, nuk e pranojnë.

Po të gjykojmë më thellë për dobinë e frutave, ne do ta realizojmë jo vetëm këtë plan pesëvjeçar, por do të punojmë edhe për perspektivën. Duke u ulur shtruar dhe duke bërë llogari të sakta që për 10-15 vjet t'i mbushim kodrat me pemë, ne, shkallë-shkallë, do të arrijmë të marrim prodhime.

Ne kemi bërë hartat pedologjike dhe kimike, por, në përgjithësi, këto qëndrojnë në sirtarë! Por ne duhet të njohim, shokë, se këto harta janë baza e punës me tokën. Tokën duhet ta njohim si është, që të dimë ta

shndërrojmë, sepse ajo nuk i ka të gjitha ato veti ushqyese e prodhuese që kërkojmë ne. Në qoftë se nuk punojmë për shndërrimin e tokës, kjo do të mbetet e mbërthyer në këto ose në ato rendimente. Përkundrazi, në qoftë se marrim masa për ta përmirësuar, ajo do të bëhet më shumë pjellore, prej saj do të marrim rendimente shumë të mëdha në grurë, në misër, në lupolë<sup>1</sup>, në fiq e në çdo lloj tjetër. Këto synime nuk arrihen me hamendje, por me llogari të sakta matematike.

Kërkesat për përmirësimin e tokës dhe për shtimin e pjellorisë së saj janë të shumta, ajo do ujë, pleh organik, pleh kimik të llojit që i përshtatet më shumë dhe të llogaritur në sasinë e duhur. Natyrisht, jashtë mundësive konkrete nuk mund të sigurojmë asgjë, por çdo ekonomi kolektive e ka për detyrë ta studiojë mirë këtë problem, se, po e studioi me të vërtetë shkencërisht, atëherë Ministrisë së Bujqësisë, Qeverisë dhe Komitetit Qendror të Partisë do t'u vijë të dhëna reale dhe konkluzione të drejta që në rrethin e Pogradecit, për shembull, për 5, 10 apo 15 vjetët e ardhshëm do të zhvillohet frutikultura në mënyrë maksimale, por i duhet ky lloj plehu, në këtë sasi e cilësi etj. Mbi këtë bazë planet tona do të jenë me të vërtetë reale, mobilizuese e revolucionare. Kur Qeveria të shikojë raportet tuaja, të Vlorës, të Tiranës etj. dhe të njihet me kërkesat e domosdoshme për pleh, atëherë mund të nxjerrë përfundime se ne duhet të bëjmë edhe dy fabrika të reja për plehra kimike.

---

1. Bimë nga e cila nxirret majaja e blurrës dhe që rritet në Pogradec.

Duhet t'u vëmë rëndësi akoma më shumë nga ç'u kemi vënë deri sot ujitjes, zhvillimit të lopëve dhe faktorëve për shndërrimin e tokës. E njëjta gjë duhet thënë edhe për frutikulturën dhe prodhimet e tjera bujqësore. Ju keni shembullin e Çërravës, që, siç na e thanë shokët drejtues të Partisë e të pushtetit në rreth, arriti që në një parcelë të marrë 72 kuintalë grurë për hektar. Ky rast duhet të bëhet objekt i një studimi. Pse ngjau atje ky fenomen, si u arrit prodhimi që u mor, si është ajo tokë nga ana pedologjike, kinitike etj.? Janë studiuar apo jo këto probleme? Unë, pra, vë pyetjen: Janë pasur parasysh hartat pedologjike kur u hartuan planet, janë bërë studime pedologjike dhe agroteknike? Në rast se nuk e bëjmë studimin e këtyre faktorëve me një kujdes të veçantë, sikundër thashë, ne nuk mund t'ia arrijmë asaj që kërkon Partia. domethënë që edhe nivelin e jetesës ta rritim, edhe mundësi ekonomike të disponojmë në devizë dhe klering, që të përballojmë nevojat e tjera.

Sedër revolucionare është ajo që na nxit të mos kënaqemi kur tejkalojmë planin me 5 kuintalë. Ne duhet t'u futemi thellë e në detaje çështjeve të prodhimit. Në qoftë se morëm 45 ose 50 kuintalë për hektar në këto ose ato parcela, atëherë të mos na zërë gjumi nga kënaqësia, por të shfrytëzojmë mundësitë që të marrim prej tyre 60 ose 70 kuintalë për hektar, kurse në parcelat e tjera prej nga morëm 20, 22 ose 23 kuintalë për hektar, të rritim prodhimin në 28, 29, 30 kuintalë për hektar. Këto rezultate do të arrihen duke e njohur mirë tokën, duke ditur se çfarë do kjo tokë, çfarë pune duhet t'i bëhet etj., prandaj Partia dhe gji-

thë specialistët t'i kuptojnë mirë këto nevoja dhe të jenë në këmbë për t'iu përgjigjur në mënyrë korrekte kërkesave që shtrohen.

Të mos kënaqemi, shokë, duke menduar se tani që mbollëm grurin e misrin, të bëjmë dhe një apo dy prashitje, të bëjmë edhe këtë apo atë punë e shko tutje. Jo, tokën dhe prodhimet e saj ne duhet t'i ndjekim në zhvillimin e tyre shkencor. Të gjykojmë që, në qoftë se në këto toka kemi arritur të marrim këtë prodhim të mirë, kjo do të thotë që ta ndjekim bimën në zhvillim, të njohim nevojat e saj dhe mënyrat më të përshtatshme për t'ia kënaqur këto nevoja. Këtë punë duhet të bëjnë specialistët dhe kuadrot, të cilët e kanë për detyrë t'i mësojnë të gjithë kooperativistët që të bëhen specialistë në këtë drejtim. Vetëm duke vepruar kështu, ne do të arrijmë t'i zhvillojmë më tej të gjithë faktorët që ndikojnë në prodhim dhe t'i lidhim mirë me njëri-tjetrin. Ju e dini mirë se edhe kur bima mund të mbijë e shëndoshë, ka shumë faktorë negativë, duke filluar që nga krimbat e nga sëmundjet e tjera, që e dëmtojnë atë. Në qoftë se nuk i parashikojmë dhe nuk u rrimë mbi kokë këtyre rreziqeve, në qoftë se nuk njohim ndikimin e faktorëve pozitivë e negativë, për të favorizuar të parët e për të luftuar të dytët, atëherë prodhimi do të na ikë nga duart. Për të mos ndodhur kështu, veç të tjerash, të zbatojmë me përpikëri atë që ngremë nga herë me forcë, kodin agroteknik.

Agroteknika ka marrë një zhvillim të madh dhe ky zhvillim shikohet në diferencimet e theksuara që vihen re në rendimentet e ndryshme që merren, qoftë edhe brenda një are, lëre pastaj në rreth. Nuk mund të kemi

pretendime që, meqenëse ne i dimë dhe i kemi zbatuar rregullat e përcaktuara në kodin agroteknik, s'kemi ç'bëjmë tjetër. Rregullat e kodit agroteknik janë të drejta, por nuk përjashtohet që ato, në disa rrethana, të ndikojnë edhe negativisht për shkak të veprimit të shumë faktorëve. Prandaj, në qoftë se nuk zbatohen në mënyrë krijuese rregullat e agroteknikës, mbikëqyrja e të cilave është detyrë kryesisht e agronomëve, atëherë nuk do të arrijmë kurrë atje ku dëshirojmë.

Agronomët dhe specialistët e tjerë të bujqësisë nuk duhet të qëndrojnë vetëm me ato dijeni që kanë mësuar në shkolla dhe të mos bëjnë përpjekje të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm në praktikë të njohurive të tyre agroteknike. Njohja e tyre teorike duhet të bazohet edhe në empirizmin, në praktikën e madhe të rritjes dhe të zhvillimit të bimëve në shi, në borë, me sëmundje, me dëmtues etj., etj. Duke njohur zbatimin e teorisë në praktikë, specialisti i bujqësisë formon me të vërtetë koncepte shkencore të drejta dhe është në gjendje ta kryejë më së miri detyrën. Kështu ai do të ketë mundësi të aktivizojë gjallërisht edhe të tjerët. Partia duhet t'i bëjë të gjithë të ndërgjegjshëm për këtë detyrë.

Bimët janë si kalamajtë. Pse kemi vdekje në fëmijët? Për arsye se nënat dhe ambienti përreth e lënë foshnjën pa kujdesin e duhur, nuk e ruajnë që ajo të mos ftohet, të mos bëhet rakitike etj. Edhe bima është një qenie e gjallë e natyrës, e cila do disa kushte që të rritet. Zhvillimi i mirë ose i keq i saj varet nga fakti se me çfarë kujdesi do ta rritim, do të lejojmë të zhvillohet «rakitike» apo do të punojmë që të rritet e shëndetshme.

Çështja tjetër e rëndësishme është që këto prodhime bujqësore e blegtorale dhe zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë të bëhen në baza ekonomike të leverdishme. Kjo do të thotë që prodhimet me shumicë t'i kemi me kosto të ulët. Kostoja e ulët është e pandarë nga shtimi i prodhimit. Partia vazhdimisht na ka porositur që një nga detyrat kryesore për shtimin e prodhimit bujqësor është ajo që njerëzit, të cilët merren me financën, tok me agronomin, me ndihmësit e tij dhe me të gjithë kooperativistët, të ndjekin me rreptësi detyrat e planit, zhvillimin e bimëve.

Ekonomistët e kooperativave bujqësore, në qoftë se duan një bujqësi të përparuar, nuk duhet të pranojnë të veprohet në këto ekonomi socialiste pa një diskutim shkencor e me llogari të problemeve. Ata nuk duhet të lejojnë të vihen në jetë dëshirat e njërit e të tjetrit, qoftë ky agronom apo veteriner, kryetar i kooperativës apo sekretar i organizatës-bazë të Partisë, për sa kohë që mendimet e shprehura nuk do të jenë në përputhje me rregullat bujqësore e me ligjet financiare. Kur sekretari i organizatës-bazë të Partisë ose kryetari i kooperativës, për shembull, thotë që në këtë tokë të mbjellim një lloj bime, që sipas shkencës bujqësore dhe sipas llogarive nuk ka leverdi, ekonomistët dhe financierët duhet të kundërshtojnë e të thonë: «Nuk lejohet! Ti je kryetar i kooperativës apo sekretar i organizatës-bazë të Partisë, por kjo që thua nuk duhet bërë, se nuk pajtohet me këto ose ato të dhëna apo mundësi». Në qoftë se kryetari i kooperativës ose sekretari i organizatës-bazë të Partisë mendon të shpenzohen kaq fonde për të bërë, bie fjala, një ndërtesë luksoze socialkulturore më

të mirë nga ajo që është, ekonomisti t'i thotë: «Unë nuk jap asnjë grosh pa vendosur më parë mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të kooperativës, që është kompetente për të ndryshuar planin financiar vjetor që vetë ka miratuar. Ne, kur miratuam në mbledhje planin vjetor të prodhimit dhe atë financiar, kemi thënë që plani duhet të realizohet me këtë sasi, kurse, po të veprohet siç thoni ju, ky plan nuk plotësohet». Këtë qëndrim duhet të mbajë ekonomisti që administron llogaritë e kooperativës. Në rast se është planifikuar që në një sasi toke të dërgohet, ta zëmë, një kamion me pleh, aty të mos dërgohen pa arsye pesë dhe të lihet kështu fare pa pleh një sipërfaqe tjetër toke, sepse nuk duhen shkelur llogaritë që janë bërë në mënyrë të drejtë e të saktë për sigurimin e të gjitha prodhimeve.

Po të veprohet në tym, pa llogari, sipas mendjes së njërit apo të tjetrit, kostoja e prodhimit do të na dalë e lartë. Në një ekonomi socialiste të përparuar këto gjëra parashikohen absolutisht drejt. Kudo mund të parashikohet të lihet edhe një rezervë e arsyeshme, por ajo që vendoset duhet të realizohet, ndryshe nuk mund të ecet. Në hartimin e planit perspektiv, të planit vjetor të prodhimit dhe të atij financiar merret parasysh çdo gjë: mekanizimet, plehrat, forcat e punës etj., etj. Të gjithë këta faktorë studiohen në mënyrë metikuloz<sup>1</sup> dhe, pasi vendoset për ta, punohet politikisht që të vihen në zbatim.

Të kihet kujdes që, krahas zhvillimit të mirë të ekonomisë bujqësore, të mos bëhen shpenzime në ku-

---

1. Këtu ka kuptimin shumë të kujdesshëm.

rriz të zhvillimit të prodhimit. Të mos harxhohet asgjë që nuk është e domosdoshme, që nuk është prodhuese. Investimet në bujqësi duhet të jenë sa më shumë prodhuese, prandaj të bëhen sa më pak investime joprodhuese. E theksoj këtë çështje se, përgjithësisht, vihet re një megalomani e theksuar për të ndërtuar objekte socialkulturore luksoze që vijnë në kundërshtim të hapët me mundësitë tona reale. Mundet që këtu të ju kjo prirje nuk ekziston, por në disa rrethe të tjera shfaqje të tilla ka. Për këto shfaqje kemi lexuar edhe në gazeta. Në Lapardhanë e Beratit, megjithëse kishte dy shtëpi kulture, filloi puna për të ndërtuar edhe një tjetër, me salla secila nga 200-300, bile edhe nga 400 vende! Kjo është një prirje shumë e gabuar dhe e dënueshme, sepse këto ndërtime, që s'janë të domosdoshme, bëhen në kurrizin e fshatarësisë kooperativiste. Kur u bëhen vërejtje kuadrove për gabime të theksuara në këtë drejtim, ata të përgjigjen: «Po si mund të ndërhyjmë ne për të shkelur normat e demokracisë kooperativiste?!», duke lënë të kuptohet me këto fjalë, sikur paska vendosur mbledhja e përgjithshme e kooperativistëve për këto ndërtime dhe këta nuk paskan ndërhyrë dot për hir të demokracisë! Nuk është mirë që, për të bërë menjëherë diçka të madhe, të krijojmë një situatë të tillë në ekonominë e fshatit kur vlera e ditës së punës të shënojë vazhdimisht 11 lekë. Pse të mendojmë për të marrë 11 lekë për ditë-punë e jo 15 lekë? Kur kooperativisti të ketë mundësi të marrë para më shumë, ai ka mundësi edhe të blejë më shumë.

Thuhet se dyqanet janë plot me mallra. Dhe me të vërtetë kështu është, por le të mendojmë një çikë pse



nuk zbrazen këto dyqane. Dyqanet rrinë plot ose se ne kemi hedhur në shitje më shumë mallra nga sa duhen dhe nuk kemi bërë shpërndarje të drejtë ku mund t'i shesim, ose cilësia e tyre është e dobët dhe prandaj nuk pëlqehen nga konsumatorët, ose për arsye se konsumatori vërtet dëshiron të blejë më shumë nga sa blen tani, por nuk ka mundësi të blejë. Kjo tregon se duhet të rritet fuqia blerëse sidomos në fshat. Unë i kritikova drejtuesit e rrethit tuaj, kur ata më thanë se sasinë e fondit të paprekshëm të kooperativave e paskan caktuar në masën 20 për qind, bile në ndonjë kooperativë, si, bie fjala, në Mokër, paska vajtur deri në 30 për qind, për të ndërtuar shkollat, për të ndërtuar këtë e atë! Mirë është të ndërtohen shkollat e objektet e tjera socialkulturore, por për këto qëllime nuk mund të bëhen shpenzime pa kufi nga të ardhurat e përgjithshme të kooperativës bujqësore. Në qoftë se fondi i krijuar është i pamjaftueshëm, atëherë le të përdoret për nevojat dhe për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit. Për shkollën të mjaftohemi me ato fonde që janë parashikuar sipas Statutit të Kooperativave Bujqësore.

Unë kam vizituar shkolla në Skrapar, por kam vizituar shkolla edhe në Pragë. Mund të them me gjithë mend se nuk kishte asnjë ndryshim shkolla e mesme e përgjithshme «Ramiz Aranitasi», që është ndërtuar në Çorovodë, me shkollat e kësaj kategorie që kam parë unë në Çekosllovakë. Shkolla e mesme e Çorovodës ishte shumë e bukur, me dy-tri kate, e pajisur me laboratorë të pasur e me të gjitha të mirat, por nuk prishej ndonjë punë sikur të ishte pak më e thjeshtë. Shkollat dhe objektet e tjera socialkulturore mund të bëhen edhe

më të thjeshta. Nuk është kryesore paraqitja e jashtme, por ajo si punohet në to, si jepet mësimi etj.

Në këto drejtime duhen shumë punë shkencore, shumë durim, shumë shpjegime dhe imagjinatë realiste. Njerëzit e Partisë duhet të zhvillojnë mendimin e tyre për perspektivën. Nga të dhënat që kemi unë di se lopët e Mokrës ishin nga më të dobëtat, por me punën e madhe të Partisë e të pushtetit u arrit që raca e lopës «Shtirake» e Mokrës të përmirësohet dhe të merren prej saj 1 500, 2 000 edhe 2 500 litra qumësht në vit. Kjo ka ndodhur se në këtë drejtim është punuar duke pasur parasysh perspektivën, pra ka një përparim të madh. Me sa di unë, atje ka vend për t'u mbajtur edhe bagëti të imëta.

Në qoftë se ne e shikojmë mirë perspektivën e rrethit të Pogradecit për drithërat, për frutikulturën e për blegtorinë, do të bindemi se bujqësia do të arrijë shumë më tepër të ardhura sesa arrin sot. Natyrisht, kjo nuk do të arrihet brenda një viti, por pas 7-8 vjetësh, në qoftë se i zbatojmë detyrat me një ritëm më të shpejtë.

Të gjitha rrethet duhet t'i vënë rëndësi të madhe zhvillimit të drithërave, të frutikulturës edhe të blegtorisë. Në sektorin e blegtorisë t'u kushtohet vëmendje shtimit të lopëve, mbajtjes mirë të racave që kenë, por në të njëjtën kohë të zhvilloni edhe bagëtinë e imët. Zhvillimi i bagëtisë së imët varet shumë nga koha kur bëhen planifikimi e llogaria, pra kur organizohet diskutimi i thellë i këtyre problemeve. Kur shtrojmë çështjen nëse kemi mundësi të mbajmë ose jo dhi, duhet të qëndrojmë të tërë që të diskutojmë gjatë e gjerë për këtë çështje, të shohim në cilat vende mund ta mbajmë

dhinë, për sa kohë kemi ushqim etj. Pasi bëhen llogaritë për dhinë, vjen llogaria e deleve dhe bisedohet se cilat na leverdisin më shumë për t'u mbajtur: kaç dele apo kaç dhi? Kështu duhet të diskutojmë për shtimin e lopës, për derrin e për të tjerat me radhë, duke shikuar interesin ekonomik.

Në rrethin tuaj mos harroni gjuctinë e peshkut, që siguron një të ardhur të mirë. Në qoftë se hidhen në liqen rreth 1 milion rasate, kjo nuk është ndonjë gjë e madhe. Përse të mos hidhen disa milionë? Përse të mos e bëjmë këtë gjë, duke parashikuar në plan edhe fondet që nevojiten për këtë qëllim? Për këtë çështje ne mund të organizojmë në aksion, për shembull, rininë e Starovës, që mund të bëjë një punë shumë të mirë brenda 15 ditëve, se stacionet e rritjes së rasateve nuk janë gjë tjetër veçse disa mure brenda të cilave është futur ujë. Të tilla mund të bëhen në fshatin Lin e kudo që ka burime. Të tëra këto burime që kemi, t'i shfrytëzojmë për të rritur rasate peshqish, për të pasur edhe koran, edhe lloje të tjera. Në këtë drejtim ne i lejojmë vetes neglizhenca të pafalshme.

Rëndësi të madhe t'i vini industrisë që keni këtu në rrethin tuaj, por, shokë, bujqësinë mos e lini pas dore, sepse nëpërmjet saj ne synojmë që të ngrihet më shumë niveli i jetesës së fshatarëve. Ky nivel nuk mund të ngrihet vetëm duke çuar oriz apo ndonjë send tjetër nga qyteti, por duke shtuar prodhimin brendapërbrenda në fshat. Po të shtojmë prodhimin bujqësor, ne do të kemi mundësi t'i japim fshatarit edhe grurë më shumë. Me grurin ai do të bëjë edhe peta më shumë. Kështu ai nuk do të ketë shumë nevojë për oriz, megjithë-

që ne edhe orizin, edhe sheqerin dhe të gjitha për çka ka nevojë fshatari do t'i gjejmë.

Le ta marrim një çikë shtruar çështjen e perspektivës së zhvillimit tonë ekonomik. Pemët dhe prodhimet e tjera bujqësore duhet të shtohen shumë brenda këtyre 20 vjetëve, se do të na shtohet edhe popullsia. Që të shtohet popullsia, pra që të lindin më shumë kalamanë, duhet të rritet mirëqenia në çdo familje, të përmirësohet mënyra e jetesës. Kështu, për t'u zhvilluar në përpjesëtimet e duhura bujqësia, duhet që fshati të ketë forca pune, pra të ketë popullsi edhe për të prodhuar grurin, edhe për të mbajtur bagëtinë, edhe për të zhvilluar frutikulturën. Duke e rrahur gjatë e gjerë këtë problem, dalim në terrenin e demografisë.

Demografia është një nga problemet që duhet të kihet kurdoherë parasysh nga Partia dhe nga pusheti. Kjo do të thotë se ne duhet të dimë sa rritet popullsia jonë, sa duhet të shtohet kjo dhe si duhet ndihmuar rritja e popullsisë, jo vetëm duke pakësuar vdekjet, por duke shtuar më shumë lindjet. Ky është një problem jetik për vendin tonë, se lidhet me prodhimin, prandaj duhet të vejë krah për krah me problemet e tjera të perspektivës.

Çështja tjetër me shumë rëndësi që na shtrohet është lufta kundër burokratizmit. Ne, me gjithë këto masa që morëm për shkurtimin e aparateve, për bashkimin e shumë ndërmarrjeve e shumë hozrashoteve të shpërndara pa kriter, për shkurtimin e organikave të fryra etj., nuk mund të themi kurrsesi se e çrrënjosëm burokratizmin. Lufta duhet të vazhdojë e pandërprerë. Në këtë proces del një problem që duhet

zgjidhur. Me shkurtimin e organikave janë krijuar njaft forca të lira që kanë ikur nga zyrat. Këto forca duhen sistemuar në punë, sepse në socializëm, sikurse sanksionohet edhe në Kushtetutën tonë, puna u sigurohet të gjithëve nga shteti. Kështu, pra, asnjë nuk duhet të mbetet pa punë. Kjo gjë do të arrihet, se ne kemi nevojë për forca pune.

Në qytete, por edhe në fshatra, ka ekzistuar mentaliteti prapanik që dallimet e theksuara midis fshatit e qytetit janë të natyrshme e të pranueshme, se mirëqenia në fshat nuk mund të vijë me të njëjtin ritëm si në qytet dhe kështu s'ka gjë pse fshatari kooperativist merr një pagë më të vogël se punonjësi i qytetit! Ky mentalitet bënte që fshati të mos shikohej me sy të mirë nga të gjithë, dhe që qytetari ta shikonte fshatarin vetëm nga larg. Ky koncept duhet të ndryshojë, sepse zhvillimi demografik i qyteteve është i tillë që njerëzit duhet të venë për të punuar e për të jetuar edhe në fshat. Popullsia jonë sa vjen e shtohet.

Po ku do të punojnë të rinjtë e qyteteve? Ne nuk kemi aq shumë uzina e fabrika sa t'i sistemojmë të tërë në qytet, prandaj këta do të venë të punojnë atje ku është fronti i punës, në miniera, si dhe në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore. Kështu në të ardhmen do të kemi për punë shumë të rinj, një pjesë e të cilëve do të punojnë e do të jetojnë në qytete, kurse pjesa më e madhe e tyre në fshatra. Ky fenomen është pozitiv, sepse niveli i jetesës së fshatarësisë është ngritur, arsini dhe kultura socialiste lulëzojnë e zhvillohen edhe atje, pra fshati ynë zbukurohet. Perspektivat e fshatit janë akoma më të mira.

Në miniera të punojnë sa më pak fshatarë, sepse për ta ka nevojë bujqësia jonë socialiste. Unë nuk them të dërgohen në miniera ata qytetarë që janë nga 45 ose 50 vjeç, por të tjerët që janë 20 a 25 vjeç. Edhe qytetari të punojë në minierë si fshatari, kurse ky i fundit të qëndrojë në fshat.

Industria jonë vërtet do të zhvillohet, por edhe ajo do të ketë një kufi, sepse nuk mund të rritet në atë shkallë sa të përballojë me punë të gjitha ritmet e rritjes së popullatës së qytetit. Ne duhet të përpiqemi që proceset e punës në uzinat e në fabrikat tona të jenë automatike dhe me kosto të lirë, sepse kështu e kërkojnë interesat e zhvillimit tonë, por duke automatizuar prodhimin, nuk ka nevojë për shumë njerëz.

Për realizimin e këtyre qëllimeve duhet të bëhet një luftë e madhe dhe e thellë politike e sqaruese, në radhë të parë me prindërit dhe me të rinjtë, të cilët lypset të orientohen drejt që të venë e të punojnë atje ku ka punë shteti, sepse në qytet nuk mund të ketë punë për të tërë dhe puna kudo është nder.

Për të edukuar të rinjtë që të shkojnë për të punuar atje ku ka nevojë atdheu dhe për të bindur prindërit e tyre që të mos bëhen pengesë në këtë drejtim, duhet të luajë një rol të madh sidomos Partia. Flas këtu për bindjen e prindërve, se ka raste që ata bëhen pengesë. Sekretari i parë i komitetit të Partisë të një rrethi tregonte se njëzet apo njëzet e pesë të rinj kishin shprehur gatishmërinë të shkonin menjëherë për të punuar në fshat. Të nesërmen sekretarit të parë i vajti nëna e njërit prej tyre. Ajo i tha shokut sekretar se kishte ardhur për djalin, të cilin e kishte të vetëm e nuk donte ta

çonte në fshat. Duke iu përgjigjur disa pyetjeve të sekretarit të komitetit të Partisë, ajo tha, midis të tjerash, se burri i saj kishte qenë partizan, kurse vetë ajo kishte ndihmuar luftën. «Po mirë atëherë, në qoftë se djali yt dhe të tjerët nuk venë në fshat, kush do të punojë atje? Shqipëria nuk mbahet vetëm me industrinë, po edhe me bujqësinë, se ndryshe do të mbeteshim pa ngrënë. Nuk duhet menduar se këto punë do të na i bëjnë vetëm fshatarët. Nuk je vetëm ti që ke një djalë, se ka dhe të tjerë. Yt bir, si edhe shokët e tij, do të krijojnë familje dhe do të kenë fëmijë. Ti dhe burri, që keni rrogat tuaja, shkonë po të doni të bashkëjtoni me djalin, por edhe po nuk vajtët ju në fshat, djali do të vijë t'ju vizitojë herë pas here». Pasi i foli kështu sekretari, ajo u bind, qeshi e tha: «Mirë, shoku sekretar, ti ke të drejtë» dhe u largua.

E tregova shembullin e sipërm për të argumentuar se në gatishmërinë revolucionare të të rinjve për të punuar atje ku paraqitet nevoja ndikon edhe mentaliteti i prindërve, prandaj duhet të bëjmë një punë të durueshme me ta.

Byroja Politike dhe shokët sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë kanë nxjerrë konkluzionet e duhura nga puna e mirë që bëhet tani në rrethin e Korçës për shmangien e pasojave të breshërit në grurë, si dhe në rrethin e Elbasanit për duhanin etj. Partia nxori konkluzione me karakter përgjithësues edhe nga eksperiencia e mirë e rrethit të Dibrës, ku u dukën shenjat e para të aksioneve me goditje të përqendruar. Ky lloj aksioni, që u zbatua gjerësisht, na dha rezultate të mëdha. Tërë Partia u ngrit në këmbë dhe mobilizoi po-

pullin për problemet e mëdha të bujqësisë. Në të gjitha drejtimet mobilizoheshin forca të mëdha prej 10 000 vetash, të cilët e mbaronin brenda dy ditësh kanalin që kërkonte disa muaj punë. Edhe fatkeqësia që ngjau këto ditë në Korçë nga breshëri që ra, bëri që qytetarët atje të ngriheshin me mijëra e të venin nëpër ara që të mbledhnin grurin e dëmtuar.

Për të ndihmuar me raste fushatash bujqësore, është menduar që të vazhdojë mobilizimi i punonjësve të qytetit për pesëmbëdhjetë ditë ose për një muaj. Kjo ndihmë e punonjësve të qytetit për fshatin do të bëhet e studiuar, e organizuar dhe pa u penguar prodhimi industrial. Kështu, për shembull, në kohën më të nevojshme, studiohet sa forca pune i duhen, fjala vjen, Starovës, Çërravës e Mokrës. Pastaj studiohet sa forca pune të afta mund të japë secila ndërmarrje për të plotësuar nevojat e fshatit dhe për të mos ndërprerë prodhimin e saj sipas planit. Bisedohet se në cilat procese pune, si prashitje, korrje etj., do të dërgohen punonjësit nga qyteti në fshat. Me t'u zgjidhur paraprakisht këto çështje, atëherë nisen njerëzit në fshat për dhjetë ose pesëmbëdhjetë ditë apo për një muaj.

Për kohën e punës në fshatrat malore punëtorëve e nëpunësve do t'ua paguajë rrogën qendra e tyre e punës, kurse kooperativa duhet t'u sigurojë ushqimin dhe do t'u kërkojë zbatimin e normës së caktuar, ndërsa në zonat fushore do ta paguajë vetë kooperativa<sup>1</sup>. Në

---

1. Me udhëzime të veçanta të Këshillit të Ministrave shpërblimi i punës së punëtorëve në ndihmë të kooperativave bujqësore të zonës fushore përballohet 40 për qind nga shteti



fund të punës këtyre duhet t'u komunikohet realizimi i normës kolektivisht dhe individualisht për secilin. Ata që nuk e kanë plotësuar normën, do të paguhen në përpjesëtime me plotësimin e saj. Kështu fshati do të ndihmohet, por edhe ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave etj. nuk do t'u mbelet puna pas, se atë do ta plotësojnë ata punonjës që nuk kanë vajtur në fshat.

Kjo metodë punë, përveç ndihmës ndaj prodhimit, ka dhe një dobi tjetër shumë të madhe. Qytetari që vete në fshat, do të edukohet me pjesëmarrjen në çfarëdo punë dhe do të formohet më mirë shpirtërisht. Ai do të mendojë: «Pa dale, se edhe puna në fshat paska bukurinë e vet». Ne, shokë, kur u kthyem nga Voloreka, i pamë me kënaqësi vajzat kooperativiste që punonin duke prashitur misrin e panxharin. Ato gjatë pushimit të drekës bënin banjë dhe pas saj visheshin shpejt e rifillonin punën.

Çërrava nuk laget nga ligeni, por ajo ka bukuri të tjera. Kur kam vajtur në ato fshatra, para disa vjetësh, kam parë shtëpi të bukura, hijet për të ndenjtur pas punës nëpër kopshtije etj. Tani atje bukuritë janë situar. Unë kam kohë që s'kam qenë.

Pra e kisha fjalën që, duke vajtur në fshat, duke u njohur me punën dhe me jetën e tij, njerëzve nga qyteti u krijohet një ndjenjë dashurie për fshatin. Në qoftë se dërgimi i punonjësve nga qyteti në fshat bëhet në

---

dhe 60 për qind nga vetë kooperativat, në kooperativat bujqësore të zonës kodrinore përballohet 70 për qind nga shteti dhe 30 për qind nga vetë kooperativat, ndërsa për kooperativat malore përballohet 100 për qind nga shteti.

mënyrë të organizuar, atëherë, nesër, kur t'i thonë djalit nga qyteti: «Nisu sa më parë në fshat!», ai do të shkojë pa ngurrim, bile me dëshirë. Për ta organizuar sa më mirë këtë gjë do ta studiojnë çështjen shokët.

Këto çështje kuptohen nga rinia dhe nga populli ynë, por, për t'i bindur njerëzit të veprojnë, duhet punë politike për njëfarë kohe, sa të thyhen konceptet përçmuese për fshatin. Përfytyroni pak gjithë luftën e punën e madhe që ka bërë Partia. Sukseset që shikojmë, nuk janë arritur përnjëherësh. Kooperativat bujqësore nuk u krijuan në një kohë të shkurtër. Ne vetë e dimë se çfarë kemi hequr për ta bindur fshatarin për të mirat e kolektivizimit. Këto vështirësi ishin të natyrsme, sepse fshatari ynë, siç dihet, ka qenë shumë i lidhur me tokën. Për të toka ishte jeta, por Partia punoi me durim dhe ia arriti kolektivizimit. Pas Reformës Agrare, kur toka ishte akoma në pronësi të personave, ne merrnim detyrimet nga bujqit privatë, duke u shpjeguar se pa këto punëtorë nuk ka të hajë. Këto situata të një bujqësie primitive, kur bujku ynë nuk përballonte dot as nevojat e tij, tani janë kapërcyer. Gjërat që më parë dukeshin tepër të zorshme për t'u arritur, tani janë bërë realitet.

Partia kurrë nuk duhet të tërhiqet para vështirësive; ajo, duke vështruar perspektivat e ndritura, duhet të punojë me këmbëngulje që të edukojë e të bindë njerëzit, të cilët, në mos sot, nesër, do të shkojnë në rrugën e drejtë që u mëson Partia. Këtë na ka treguar eksperiencia jonë tridhjetenjëvjeçare. Në këtë drejtim kuadrot dhe komunistët duhet të dinë t'i njohin dhe t'i shfrytëzojnë mundësitë e mëdha që krijohen për

zhvillimin e bujqësisë, të industrisë etj. dhe për forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut.

Për sa i përket detyrës për mbrojtjen e atdheut, ajo duhet të na futet në gjak të gjithëve. Kurrë të mos mbyllim sytë para rreziqeve që mund të na kanosen. Partia ka bërë sqarime të plota për veprimtarinë armiqësore që kanë ushtruar grupi i tradhtarëve në ushtri, i përbërë nga Beqir Balluku, Petrit Dumja, Hito Çakoja e të tjerë, grupi i sabotatorëve të naftës e armiq të tjerë, të rrezikshëm, si: Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Kiço Ngjela e të tjerë.

Për punën armiqësore të Kiço Ngjelës nuk do të hyj në detaje, por mund të them se të gjitha parashikimet dhe analizat që i ka bërë Komiteti Qendror i Partisë kësaj veprimtarie janë vërtetuar plotësisht.

Armiqtë e tradhtarët kanë pohuar në hetuesi se kjo punë e ndyrë ishte e organizuar në bashkëpunim ndërmjet tyre. Të gjitha sa thoshin Petrit Dumja e Hito Çakoja, sikur këto apo ato ligësi i bëri vetëm Beqir Balluku, kurse ata gjoja nuk dinin gjëkafshë, janë hedhur poshtë me prova të pakundërshtueshme. Faktet që i mohonin dje këta armiq, i kanë pohuar tani dhe deklarojnë se të tërë kanë qenë në dijeni të plotë për veprimtarinë armiqësore që zhvillonin, se kanë marrë vendime si të punonin kundër Partisë dhe shtetit. Në momentin e rrezikshëm kur veprimtaria e zezë e tyre u zbulua, Petrit Dumja me shokë u përpoqën t'ia hidhnin tërë fajet Beqir Ballukut! Me këtë dredhi kujtuan se shpëtuan nga vigjilenca revolucionare e Partisë, por Partia nuk flinte, siç menduan ata, prandaj nuk i la të livadhësinin për shumë kohë. Tani procesi hetimor është

gati në përfundim dhe këta armiq së shpejti do të japin llogari para gjyqit.

Për sa u përket sabotatorëve të sektorit të naftës, krimet e tyre janë vërtetuar nga dëshmitë e shumë njerëzve. Puna sabotuese e këtij grupi armiqësor ishte organizuar në mënyrë të tillë që, nga njëra anë, Shqipërisë të mos i jepeshin fusha naftë dhe, nga ana tjetër, të harxhoheshin sa më shumë fonde investimesh. Ata kanë arritur gjer në atë shkallë sa të jepnin pika shpimi atje ku nuk kishte aspak shenja të pranisë së naftës nën tokë. «Ne, deklaroi në hetuesi njëri nga këta armiq, jepnim pika shpimi atje ku nuk kishte naftë. Kur bënim shpime atje ku gjendej naftë, përnjëherë kemi devijuar drejtimin e shpimit, duke dalë në një vend tjetër».

Nga analiza komplekse e veprimtarisë së tërë këtyre grupeve armiqësore del qartë se të gjitha këto orientoheshin në punën e tyre shkatërrimtare nga revizionistët sovjetikë. Qëllimi i armiqve, siç e ka analizuar Komiteti Qendror i Partisë, ishte dobësimi i mbrojtjes sonë, demoralizimi i ushtrisë, degjenerimi i kadrove të saj dhe koordinimi i punëve me grupin e sabotuesve në fushën ekonomike e, në radhë të parë, me atë në sektorin e naftës.

Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi i kishin thënë Lipe Nashit: «Hë, more, shiko të realizosh planin e këtij viti, se nuk të duhet ty të mendosh për vitet e tjera!». Kjo do të thotë: «Oburra, mbyti puset me ujë, ç'mendon për të ardhmen!». Beqir Balluku në një rast i ka thënë Lipe Nashit: «Ti, Lipe, je kryesor në shtabin tim të ushtrisë!». Ç'punë kishte Lipe Nashi në shtabin e ushtrisë?!

Për sa i përket tradhtarit Pirro Gusho, duhet thënë se ai ishte një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Beqir Ballukut. Qendra kryesore e aktivitetit të këtij të fundit (pa folur për sektorët e tjerë të veprimtarisë armiqësore) ishte në Fier, së pari, sepse atje ka naftë, që është shpirti i gjithë ekonomisë, së dyti, sepse atje është edhe Semani, që lidhet me zbarkimin e me shumë probleme të tjera të rëndësishme nga ana ushtarake.

Komiteti Qendror i Partisë ka nxjerrë konkluzionin se lidhur me punën armiqësore, sidomos në radhët e ushtrisë, ka munguar vigjilenca e duhur. Në ushtri ne kemi me mijëra e mijëra kuadro patriotë, njerëz të vendosur të Partisë, por armiqtë gjer në njëfarë shkalle kishin arritur të krijojnë një mentalitet të sëmurë për rolin udhëheqës të Partisë në ushtri. Të tërë oficerët, me përjashtim të tradhtarëve, e donin dhe e duan Partinë, por ata duhej t'i kuptonin e t'i zbatonin më mirë direktivat e Partisë dhe të ndesheshin me të gjithë ata që i shkelnin. Kështu, mjaft oficerë, të cilët janë njerëz të mirë, patriotë, nuk i shikonin me vigjilencën e duhur dobësitë e punës në ushtri.

Pasi u zbulua puna armiqësore, shokët ushtarakë i thanë të gjitha sa dinin për armiqtë, po pse nuk folën kështu edhe më përpara? Nuk folën për arsye se tradhtarët kishin krijuar në ushtri një situatë të sëmurë, duke e hequr veten sikur vepronin në bazë të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë, në një kohë që udhëheqjes i kanë fshehur gjithçka.

Disa nga raportet që i paraqiteshin Komitetit Qendror nga baza, kanë pohuar në njëfarë mënyre për gje-

ndjen e rëndë e të rrezikshme, por të gjitha këto materiale i konsultonin paraprakisht në mes tyre Beqir Balluku, Petrit Dumja, Hito Çakoja, Rahman Perllaku dhe Sadik Bektashi, të cilët, pasi u hiqnin të dhënat kritike, pasi i zhvishnin nga ato që «nuk duheshin thënë», na i dërgonin neve të qethura.

Megjithatë, siç vërtetojnë edhe dokumentet, ne i qortonim, u thoshim pse bëhen këto ose ato veprime etj. Kur vinte Beqir Balluku për të dhënë llogari dhe ne e kritikonim me rreptësi, ai thoshte: «Po, ju keni të drejtë, shoku Enver, por për këto punë ne tashti kemi marrë masa, kjo çështje do të zgjidhet shpejt» e të tjerë. Shumë herë në Byronë Politike i kemi kritikuar, bile ashpër, të metat e dobësitë e punës në ushtri, por armiqtë kishin krijuar një situatë të tillë të turbullt atje, ata kishin kultivuar njëfarë megalomanie te kuadrot, duke predikuar se në ushtri, në forcat tona të armatosura, s'ka asgjë të gabuar, përkundrazi, çdo gjë shkon mirë. Mirëpo e vërteta nuk ishte kështu. Kjo frymë, që futej në ushtri, nuk na pëlqente, prandaj disa herë ua vinim në dukje këtë defekt të madh që dukej në punën e tyre. Gjer në këtë kohë, për të cilën po flas, ne akoma nuk kishim të dhëna për punë armiqësore.

Letra me ankesa, kërkesa e sugjerime të interesit të përgjithshëm ose vetjak na vinin shpesh nga populli. Ka pasur e ka raste që na vijnë ankesa edhe për kuadro të Partisë e të shtetit dhe ne këto i dërgojmë për t'i verifikuar. Në ushtri kjo ndodhte rrallë. Kur dërgohej letër nga ndonjë kuadër ushtarak, që ankohej për padrejtësi dhe ne docmos interesoheshim për çështjen, Beqir Balluku hidhej përprjetë e thoshte: «S'është e

vërtetë kjo, ky është i padisiplinuar, llafazan, dembel, i paafte, është kështu e është ashtu», e të tjera si këto. Kur dërgoheshin instruktorët e Komitetit Qendror të Partisë për ta verifikuar ankesën, dilte e vërteta në shesh, por nganjëherë ndodhte që padrejtësia interpretohej edhe si diçka e rastit, që «mund të ngjasë ndonjëherë me ndonjë kuadër».

E keqja është se nga ushtria vinin letra rrallë. Po të na vinin më shumë ankesa me të dhëna konkrete, jo vetëm për rrezikun kryesor që armiqtë po përgatiteshin të goditnin udhëheqjen e Partisë, që të shkatërronin pastaj tërë Partinë dhe t'i hapnin rrugën invalidit armik etj., por edhe për qëndrimin e tyre të neveritshëm nga ana morale, për orgjitë e këtyre njerëzve të korrumpuar, Komiteti Qendror do të kishte marrë masa me kohë. Imagjinoni, shokë, për një moment, njerëzit më vagabondë që mund të njihni dhe mendoni se këta të poshtër kanë qenë pikërisht të tillë. Ishte e pamundur të merrej me mend që këta kishin arritur gjer atje sa jo vetëm të organizonin dreka e darka në kurriz të ekonomisë, por edhe nga ana morale të kishin rënë shumë poshtë.

Partia kurdoherë ka thënë se në radhë të parë e mbi të gjitha vijnë interesat e popullit, në shërbim të të cilëve janë edhe udhëheqësit, që duhet të zbatojnë vijën e Partisë. Cilido, punëtor, fshatar apo intelektual goftë, në rast se shikon që ky apo ai udhëheqës gabon, përnjëherësh duhet të lajmërojë Komitetin Qendror të Partisë. Këtë porosi e ka dhënë vazhdimisht Partia, prandaj duhet absolutisht të vihet në jetë që të ruhet pastërtia e radhëve të Partisë dhe të shtetit nga ata që

s'janë të denjë për besimin e dhënë, që të ruhet pavarësia e atdheut socialist.

Nga këto gjëra që ndodhën si rezultat i dobësimit të vigjilencës kemi nxjerrë mësim të gjithë. Tani është detyrë e secilit që të mos lejojë të na përsëritet më kjo situatë. Të mos mendojmë, shokë, se tani nuk kemi më armiq. Armiq do të kemi përsëri, se, për sa kohë që të dyja superfuqitë luftojnë për hegjemoni dhe revizionizmi bën një punë të madhe përçarëse në radhët e revolucionit e të revolucionarëve, lufta e klasave, që është në zhvillim, do të ashpërsohet edhe brenda, edhe jashtë.

Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi ishin organizatorë të sabotimit ekonomik. Këta armiq, tok me të tjerë, përgatitnin shkatërrimin e socializmit në Shqipëri. Prirja e këtyre dy armiqve ishte ajo e vetadministrimit jugosllav. Abdyl Këllezi punonte për decentralizimin e ekonomisë, për dhënien e kompetencave e të fondeve të pakufizuara çdo ndërmarrjeje, në mënyrë që secila prej tyre të vepronte gjoja me hozrashot. Me «hozrashot» Abdyl Këllezi kuptonte vetadministrimin titist, që është një formë organizimi kapitalist i ekonomisë i veshur me rroba gjoja socialiste. Edhe në marrëdhëniet tregtare me botën e jashtme ai ishte për vetadministrimin, domethënë donte që të shitej e të blihej sipas qejfit dhe me çmimet që krijoheshin spontanisht në treg. Kështu do të administroheshin fondet e shtetit pa përgjegjësi etj.

Këta armiq kishin kultivuar edhe kultin e personave të tyre. Beqir Balluku përpiquej të kishte rreth vetes oficerët e vet, domethënë admiruesit e tij. Petrit Dumja e Hito Çakoja, gjithashtu, kishin oficerët e vet.



Secili prej tyre i bënte daulle tjetrit. Nga këta admirues servilë kishin dalë llafe sikur Beqir Balluku na qenkësh «teoricien në fushën ushtarake», Petrit Dumja «ushtaraku më i madh me energji e dinamizëm», por në qoftë se ka pasur injorantë në ushtri, më tipikët në këtë drejtim kanë qenë këta të dy.

Tradhtarët na kanë dëmtuar rëndë ushtrinë, duke prishur përpjesëtimet e drejta midis llojeve të armëve. Këta armiq, që hiqeshin sikur diçka ishin, e kanë sabotuar mbrojtjen e vendit tonë.

Tani ne po u futemi një nga një dhe në thellësi çështjeve të ushtrisë. Shokëve ushtarakë, që janë të rinj në moshë, por që kanë një stazh jo të vogël në Parti, u bie detyra t'i marrin në dorë një nga një këto probleme dhe të marrin masa efektive që brenda një kohe të shkurtër në radhët e ushtrisë të zhduket çdo plagë, jo vetëm nga ana ideologjike e politike, por edhe nga ana organizative.

Abdyl Këllezhi e sabotonte sistematikisht ekonominë. Ai ka luajtur një rol të madh negativ në industrinë e naftës, në tregti dhe në fushën e financës. Në këta sektorë ka gjetur përkrahjen dhe miqësinë e Kiço Ngjellës, i cili kishte grumbulluar në ministri edhe agjentë në shërbim të të huajve. Këta agjentë që na kanë sabotuar në marrëdhëniet e tregtisë së jashtme, në import dhe në eksport, duke na mashtruar për të mbuluar veprimtarinë armiqësore, shpesh na thoshin se filan vend nuk na i merr reçelet dhe konservat tona. «Kurrë mos i marrtë! Ka të tjerë që i marrin», u përgjigjeshim ne.

Këto e të tjera veprime bëheshin me qëllim armi-

qësor dhe ishin të organizuara, por vigjilenca e Partisë i zbuloi dhe i demaskoi.

Tani shumë gjëra duhet t'i vëmë në vend. Së pari, duhet të luftojmë akoma që ushtria dhe oficerët e saj besnikë të jenë të qartë në punën e tyre. Partia duhet të luftojë me të gjitha forcat në ushtri që oficerët të fitojnë një temp dhe stil pune të kundërt me atë që ishte vendosur nga elementët armiq. Të luftohet, gjithashtu, që në ushtri të sigurohet udhëheqja e Partisë, të cilën ata e kishin vënë në bisht. Të marrë fund sa më parë situata e rrezikshme e vënies së komandës mbi Partinë. Partia duhet të urdhërojë komandën. Komandantët janë njerëz partie. Kuadri politik në ushtri ka po ato detyra partie e shtetërore që kanë edhe komandantët. Këta të gjithë synojnë që ushtria të bëhet e aftë në çdo moment që të jetë në gjendje të përballojë çdo rrezik. Prandaj në stilin e punës së kuadrove ushtarakë duhet të bëhet kthesë.

Drejtimit kryesore të punës për ndryshimin e metodës e të stilit në punë juve ushtarakëve jua ka dhënë Partia, prandaj ju mbetet detyrë të thelloheni. Përpiquni të kuptoni mirë thelbin politik të stërvitjeve ushtarake dhe të mësimëve politike. Këtë kuptim, si ushqim i madh shpirtëror, e përhapni në gjithë masën e ushtrisë, duke filluar që nga ushtari më i thjeshtë e deri tek oficeri i instancës më të lartë.

Punën e edukimit mos e bëni në mënyrë automatike, vetëm duke lexuar materialet e Partisë. Mësimet e Partisë t'i zbërthejmë, t'i përpunojmë e t'i sqarojmë mirë, me qëllim që ato të nguliten në trurin e secilit, dhe nga truri individual të shkojnë në trurin kolektiv.

Kjo realizohet nëpërmjet një stili e metode me të vërtetë revolucionare.

Këtë stil e metodë, të përpunuar me të gjitha hollësitë e veta, është e pamundur t'i japë të diktuar Partia. Po të veprohej kështu, do të bënim siç bënin armiqtë që e futën drejtimin e Partisë në ushtri në një rrugë pa krye. Ata, për të treguar se gjoja kishin punuar shumë për edukimin, mburreshin me ato shtëpitë e oficerëve në muret e të cilave shkruanin disa formula e citate të marra andej-këtej dhe ua mësonin mekanikisht ushtarakëve. Natyrisht, oficerët tanë nuk qëndronin në ato parulla që lexonin atje, se ata lexonin edhe materiale të tjera të Partisë, si Historinë e saj etj., por dua të them se ajo metodë që impononin tradhtarët, siç u vërtetua në jetë, ishte e gabuar. Prandaj në këto drejtime duhet të bëhet një kthesë e madhe në ushtri.

Edhe në metodën e punës edukative me civilët duhet të bëhet kthesë:

Nga kjo kthesë, me gjithë përparimet e bëra, nuk përjashtohen as punonjësit e organeve të Punëve të Brendshme, të cilët janë njerëz me devotshmëri, punojnë e luftojnë me partishmëri në mbrojtje të fitoreve, të interesave të popullit e të atdheut. Edhe në punën e drejtuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka të meta. Ka raste që në këto organe vihet re mungesë vigjilence, ekziston edhe njëfarë familjariteti i sëmurë. Komiteti i Partisë i rrethit ka të drejtë ta kritikojë dogën e Punëve të Brendshme në rreth kur shikon që një punonjës i saj nuk punon me ndërgjegje të lartë, sillet keq ose nuk është vigjilent etj. . .

Njerëzit tanë të mrekullueshëm, punëtorët e të

gjithë punonjësit e tjerë, kanë treguar vendosmëri në zbatimin e detyrave të vëna nga Partia. Ata, duke e kuptuar politikisht zhvillimin e ngjarjeve, kanë realizuar planet e të tjera, e të tjera. Ndaj disa njerëzve që kanë bërë gabime, Partia kurdoherë është treguar e matur dhe e drejtë. Natyrisht, ata që kanë gabuar rëndë, ulen në përgjegjësi. Partia duhet t'i sqarojë dhe t'i ndreqë ata, t'i ndihmojë që të japin prova se po korrigjohen. Ata që kanë kryer krime, do të japin llogari.

Partia, si kurdoherë, do t'i sqarojë të gjitha çështjet me durim dhe drejt. Populli ka besim te Partia, se e ka provuar drejtësinë e veprimeve të saj. Ai ka kërkuar dënimin e tradhtarëve, të armiqve e të sabotatorëve dhe e di mirë që Partia do t'u japë dënimin e merituar. Nga urrejtja e madhe që ushqejnë për ta, shumë njerëz pyesin: «Po hë, ç'po bëhet?». «Prit, thotë tjetri, ki një çikë durim, se Partia i ka mbërthyer mirë dhe nuk i lëshon». Atyre që kanë bërë ndonjë faj të vogël, Partia u thotë: «Shikoni, mos bëni më!». Ajo e praktikon shumë herë këtë gjë, sepse njerëzit në punë e sipër edhe gabojnë, por Partia, si mëmë e urtë, i këshillon, i qorton dhe i paralajmëron. Ju i dini këto punë, se në bazë të direktivave të Partisë keni vepruar e veproni.

Lind pyetja: A është e lidhur puna armiqësore brenda vendit me veprimtarinë e huaj armiqësore? Me siguri është e lidhur. Pikërisht kjo është arsyeja që na shtyn të jemi shumë më tepër vigjilentë. Është një fakt i pamohueshëm që, megjithëkëtë veprimtari të rrezikshme armiqësore, në Partinë tonë nuk ka pasur

lëkundje. Të gjitha organizatat-bazë të Partisë, forcat revolucionare marksiste-leniniste e kanë kuptuar drejt dhe e kanë dënuar rreptë veprimtarinë armiqësore.

Partia jonë po i përballon me sukses të gjitha intrigat dhe komplotet e revizionistëve nga jashtë edhe nga brenda. Brenda vendit duhet të jemi vigjilentë dhe t'i godasim armiqtë pa mëshirë. Nü qoftë se jemi të fortë brenda, armiku vërtet mund të na godasë, por, para se të ndër marrë ndonjë akt të poshtër kundër nesh, do t'i duhet të mendohet shumë, për arsye se te shqiptarët, tek atdheu ynë socialist, do të gjejë një rezistencë të pathyeshme.

Armiqtë, pavarësisht se i mohojnë e i zvogëlojnë me qëllim sukseset tona, e dinë mirë që ne kemi bërë përparime edhe ekonomikisht e jo vetëm ideologjikisht e politikisht. Ata e dinë, gjithashtu, që Partia jonë ka unitet të çeliktë brenda radhëve të saj dhe në marrëdhëniet me popullin. Mbi bazën e këtij uniteti, që atyre u vret sytë, ne jemi në gjendje të zbulojmë e të spastrojmë plehrat e tyre. Po të mos kishte unitet të çeliktë marksist-leninist midis komunistëve, nga njëra anë, dhe këtyre e popullit, nga ana tjetër, armiqtë do të kishin zënë vend në radhët tona dhe do të na kishin infektuar tërë Partinë.

Synimet tona janë që të punojmë me vrull për zhvillimin e ekonomisë dhe të mbrojtjes së vendit. Këto synime duhet të na udhëheqin në çdo mendim, në çdo punë, në çdo veprim.

Qëndrimet tona të drejta kanë bërë që ndikimi i Partisë sonë dhe i Republikës Popullore të Shqipërisë

në botë të jetë i madh me tërë kuptimin e fjalës. Revolucionarët, në radhë të parë, pastaj elementët përparimtarë, duke përfshirë edhe njerëz të borgjezisë, thonë se mendimet e Partisë së Punës të Shqipërisë janë të drejta. Gazetat më të mëdha e më me influencë të botës kanë botuar gati plotësisht fjalimet tona. Diplomata të huaj u thonë diplomatëve tanë jashtë shtetit: «Këto që thoni ju, janë plotësisht të drejta». Mendimet tona për Konferencën e Helsinkit të huajt i kanë gjetur të drejta, në biseda me përfaqësuesit tanë diplomatikë ata kanë thënë se ajo konferencë është pikërisht ashtu siç thoni ju shqiptarët.

Disa gazeta të mëdha të borgjezisë në shumë vende të botës e mbështetin artikullin tonë<sup>1</sup> për Konferencën e Helsinkit. Po përse e mbështetin? Për arsye se, sikurse thonë vetë ata, në të analizohen problemet realisht dhe në kohën e duhur. Ato, natyrisht, nuk janë dakord me mënyrën tonë dialektike marksiste-leniniste të analizës së ngjarjeve dhe të fenomeneve shoqërore në botë, por disa konkluzione të pakundërshtueshme janë të detyruara t'i pranojnë. Ne themi që Konferenca e Helsinkit manipulohet nga superfuqitë, kurse disa diplomatë të huaj shprehen: «Ju shqiptarët thoni të vërtetën, por ne rezervohemi të flasim kundër superfuqive». Mendimet tona në disa drejtime u interesojnë të huajve, të cilët për këtë arsye botojnë tërësisht ose pjesërisht, aq sa u leverdis atyre, ndonjë lajm tonin.

---

1. Është fjala për artikullin e datës 29 korrik 1975, me titull «Konferenca e pasigurisë së Evropës». (Shih në këtë vëllim, f. 84.)

Ky opinion pozitiv ka rëndësi të madhe. Kuptohet që neve nuk na intereson opinioni i mirë ose i keq i klrikave reaksionare, por opinioni publik, mendimi i popujve, që kur dëgjojnë pikëpamjen shqiptare, miratojnë plotësisht qëndrimin tonë.

Nga të gjitha sa thashë, duket qartë që ne kemi krijuar jashtë një opinion shumë të mirë: që shqiptarët janë të zgjuar e të ndershëm, që ata nuk i nderin dorën askujt dhe nuk shiten, janë trima e të guximshëm dhe s'kanë frikë nga kurrkush, nuk janë «satelitët e Kinës» (siç thotë propaganda famëkeqe borgjezo-revizioniste), por kanë mendimet e tyre.

Këto që përmenda i theksova në platformën që Republika Popullore dhe Partia e Punës e Shqipërisë kanë krijuar në botë një opinion të shëndoshë rreth vetes. Kjo situatë është në favorin tonë, sepse opinioni ndërkombëtar luan një rol të madh në situatën e brendshme dhe të jashtme të çdo vendi. Le të kujtojmë, për shembull, se opinioni ndërkombëtar për skandalin e Uotergejtit rrëzoi nga kolltuku presidentin Nikson të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjesti i këtij presidenti të urryer ishte një banditizëm i madh politik, kundër të cilit u ngrit tërë opinioni përparimtar amerikan.

Krijimi i opinionit pozitiv botëror për Republikën Popullore të Shqipërisë ka një rëndësi të madhe për mbrojtjen tonë dhe për njohjen e Shqipërisë në botë. Vihet re se tani ka një interesim të madh jo vetëm për politikën, por dhe për zhvillimin kulturor të Shqipërisë. Shumë dijetarë, shkencëtarë, përgjithësisht opinioni intelektual, si dhe punëtorë e njerëz të tjerë, tregojnë shumë interes dhe janë të entuziazmuar nga

kontaktet që kanë pasur me ekipet tona të kulturës, ose nga ekspozitat tona, që janë organizuar në vende të ndryshme. Shqipëria, që dikur armiqtë s'donin ta njihnin as si nocion gjeografik, sot është shndërruar në një vend me ekonomi e me kulturë të përparuar; për vendin tonë shkruajnë komente të shumta gazetat e vendeve të ndryshme.

Partia punon për forcimin e situatës brenda vendit, sepse, siç thamë, kjo ndikon shumë në situatën e jashtme. Sot Shqipëria ka ç't'i thotë e ç't'i tregojë botës për mbrojtjen e vet. Tani ne po i vihemi detyrës për hartimin e planit të gjashtë pesëvjeçar. Ky plan mund të mos e parashikojë zhvillimin industrial me atë ritëm që e kemi pasë gjatë pesëvjeçarit të pestë. Ne kemi për të kryer disa detyra të mëdha, që akoma nuk janë përfunduar, duhet të mbarojmë Kombinatin Metalurgjik, i cili është për ne një vepër kolosale që do të na ndihmojë në shumë drejtime, por sidomos për prodhimin e çeliqueve në vend në mënyrë që në të ardhmen ta evitojmë importimin e tyre.

Ne kemi krijuar një industri mekanike të tillë, që nuk mund të imagjinohej për vendin tonë, por e vërteta është që nuk kemi arritur ta shfrytëzojmë akoma në maksimum këtë industri. Me gjithë këto uzina mekanike që kemi ndërtuar dhe që kemi në plan të ndërtojmë, si uzinën e hekur-nikelit, të çeliqueve etj., ne jo vetëm do të plotësojmë nevojat për prodhimin e veglave të ndërrimit, por do të jemi në gjendje të ngremë me forcat tona edhe fabrika. Kështu, për shembull, mund të ndërtojmë vetë një fabrikë sode, fabrika më të mëdha çimentoje etj.



Ne kemi për të mbaruar, gjithashtu, Hidrocentralin e Fierzës, do të fillojmë punimet për hidrocentralin e Komanit, që do të jetë shumë më i madh nga ai i Fierzës. Ky hidrocentral do të projektohet plotësisht nga inxhinierët tanë. Përveç Azotikut dhe Fabrikës së Uresë që i kemi, ne do të ndërtojmë dhe një fabrikë tjetër të uresë. Në të ardhmen, me forcat tona, mund të ndërtojmë edhe një fabrikë si ajo e Superfosfatit të Laçit etj.

Pesëvjeçari i ardhshëm do të jetë i ngjeshur, sepse kemi një sërë objektesh të tjera të rëndësishme që do të ndërtojmë. Po të kishim mundësi më të mëdha, ne mund të bënim më shumë për zhvillimin e industrisë sonë, sidomos për zhvillimin e mëtejshëm të minierave. Por edhe këto që kemi në plan për të bërë, kërkojnë një punë kolosale, prandaj në hartimin e planeve tona duhet t'i vëmë rëndësi, si kurdoherë, zhvillimit të industrisë, në tërësi, e të industrisë së minierave, në veçanti, që të arrijmë kohën e humbur në naftë. Armiqtë, përveç shpenzimeve të mëdha që kanë bërë, na kanë detyruar të humbasim pesë vjet kohë në naftë. Në këto kushte duhet të punojmë me shpejtësi në këtë drejtim që të zbulojmë fusha të reja naftë, se është e sigurt që Shqipëria naftë ka dhe ne atë do ta gjejmë.

Edhe objektet e tjera industriale do t'i shfrytëzojmë në maksimum me të gjitha mënyrat dhe rrugët që na këshillon Partia, pra me më pak punëtorë, me rendiment e me cilësi të lartë, me kursim të materialeve etj. Kjo është një luftë që duhet të bëhet absolutisht në mënyrë të vazhdueshme. Të punohet nga Partia që në ndërgjegjen e çdo punëtori të rrënjoset ideja se çdo

prodhim i nxjerrë nga duart e tij, për shembull, një artikull trikotazhi, të jetë me atë cilësi që të konkurojë edhe në tregjet e shumë vendeve të Evropës. Kjo mund të arrihet tashti, për arsye se makineritë tona janë moderne dhe eksperiencë të pasur në përdorimin e tyre në kemi. Prandaj të bëhet kujdes më i madh në mënyrë që me reçelet, konservat e pijet e fabrikave tona, me tekstilet e çdo artikull tjetër t'i mbajmë të qëndrueshme tregjet që kemi zënë dhe që i kërkojnë këta artikuj.

Për t'ia arritur kësaj në industri, në radhë të parë, duhet të bëhet një luftë e madhe politike, që të kuptohet drejt politikisht nga gjithë punonjësit situata në të cilën ndodhemi. Secili ta vërë interesin e përgjithshëm mbi atë personal, ndryshe nuk mund të arrihen këto synime që kërkon Partia, domethënë që çdo prodhim të dalë me çmim të arsyeshëm, me cilësi të lartë dhe me kosto të ulët. Ju keni arritur suksese në sektorin e industrisë dhe për këtë ju përgëzojmë, por këto probleme duhet t'i mbani vazhdimisht në mend të ditës para klasës punëtore.

Juve, shokë, desha t'ju them se fabrika e pasurimit të hekur-nikelit që po ndërtohet këtu në Pogradec duhet të mbarohet sa më parë e sa më mirë<sup>1</sup>. Unë e pashë dje kur kalova andej, por nuk m'u duk i përshtatshëm vendi. Ku e kanë gjetur atë vend ashtu? Edhe unë që nuk jam gjeolog, nuk do ta bëja kurrë atje. Pse të harxhohen aq punë e shpenzime? Në qoftë se tani është gjetur tabani i përshtatshëm, kjo është një gjë e

---

1. Fabrika e pasurimit të hekur-nikelit në Pogradec, e para e këtij lloji në vendin tonë, filloi punën në vitin 1979.

mirë, por duhet të mbarojë shpejt, se është objekti rëndësishëm.

Ne kemi perspektiva edhe në krom, mjafton të mobilizohemi me të gjitha forcat për të vajtur në shtresat e dyta, që janë shtresat e mëdha të kromit. Perspektiva të mëdha kemi edhe në bakër dhe në mineralet e tjera.

Të gjitha degët e industrisë do t'i zhvillojmë, energjinë elektrike të nevojshme për këtë qëllim ne e sigurojmë, por, sikurse përmenda edhe më parë, kryesorja tani është të forcojmë bujqësinë, që, krahas industrisë, përbën bazën e ndërtimit të socializmit. Pësëvjeçarin që vjen duhet t'i vëmë rëndësi veçanërisht bujqësisë, që kjo të ngrihet në një nivel të lartë. Partia dhe populli kanë besim të plotë se bujqësia jonë do të përparojë. Të tërë duhet të jemi të bindur se nga toka jonë, po të punohet si duhet, mund të merret shumë e më shumë prodhim. Njerëzit gjykojnë se, derisa morëm kaq prodhime sivjet, po të punojmë më mirë, pse të mos marrim më shumë vitin e ardhshëm? Kështu është, perspektivat janë shumë të mira për vendin tonë. Përparimet në ekonomi do ta forcojnë situatën tonë të brendshme dhe të jashtme.

Të gjitha sukseset sigurohen nga udhëheqja e drejtë e Partisë. Sa më e fortë të jetë Partia dhe sa më i çeliktë të jetë uniteti i Partisë me popullin, aq më shpejt dhe më mirë do të plotësohen aspiratat tona. Uniteti në Parti sigurohet në radhë të parë nga kuptimi i drejtë dhe nga asimilimi si duhet i teorisë sonë revolucionare, i marksizëm-leninizmit, dhe nga përgjithësimi i eksperiencës së Partisë sonë në zbatimin konkret të kësaj teorie.

Partia jonë, që po lufton për disa dekada, duke e zbatuar në jetë marksizëm-leninizmin, ka fituar një eksperiencë të pasur. Miqtë e shokët tanë që vijnë e shikojnë me sy realizimet tona, ose që i lexojnë këto nga materialet e Partisë sonë, na thonë se «rruga juaj është e drejtë, ajo të çon me siguri në socializëm. Rrugë tjetër s'ka». Ne mendojmë se vërtet kjo eksperiencë që ka grumbulluar Partia e Punës e Shqipërisë është e madhe, por duhet të përpunohet dhe të zhvillohet më tutje në ato drejtime që thamë.

Në rrethin e Pogradecit keni një numër të konsiderueshëm agronomësh, veterinerësh e të tjerë, aftësitë e të cilëve duhen shfrytëzuar në maksimum. T'u nxirret «vaj» atyre dhe ata të jenë të lumtur që punojnë për lumturinë e popullit e për begatinë e atdheut të tyre socialist. Për t'u arritur kjo, është nevoja që sekretari i organizatës-bazë të Partisë, kryetari i kooperativës bujqësore dhe cilido komunist të dijë t'i organizojë e t'i tërheqë mendimet e vlefshme të specialistëve. Kjo është një mënyrë për pasurimin dhe për përgjithësimin e eksperiencës.

Unitetin e Partisë e sigurojmë jo duke fjetur, por me luftë. Pa luftë klasash nuk zhvillohet dhe nuk ecën përpara shoqëria jonë socialiste. Ka njerëz që nuk i kuptojnë drejt këto mësimë të Partisë, ka dhe disa të tjerë që venë kundër në mënyrë të ndërgjegjshme. Partia secilit duhet t'ia vërë festen sipas kokës, atij që e ka kuptuar gabimin, i bën punë sqaruese dhe e bind të përmirësohet, kurse atë që kundërvihet me qëllim të keq, e hedh jashtë Partisë dhe i tregon vendin.

Uniteti i popullit me Partinë është shpëtimtar. Po-

pulli e shikon çdo ditë udhëheqjen e tij ashtu siç është, me të mirat dhe me të metat e saj. Në punë e sipër populli provon besnikërinë e Partisë ndaj çështjes së tij, ai e shikon Partinë kur ajo dhe njerëzit e saj veprojnë mirë dhe kur ata veprojnë keq. Partia u ka dhënë të drejtë masave të popullit që, kur ajo gabon, ato t'i thonë: «Këtu nuk e ke mirë». Kjo demokraci duhet të zbatohet e të thellohet vazhdimisht.

Ne dëshirojmë që Pogradeci kurdoherë të lulëzojë. Mos harroni se qyteti juaj, veç të tjerave, është edhe një vend i bukur, ku pushojnë punëtorë dhe punonjës të tjerë të vendit tonë. Pogradeci duhet të bëhet një qendër me të vërtetë turistike, me qëllim që këtu të vijnë njerëz jo vetëm në kampin e pushimit, por edhe nëpër shtëpi me dhoma, se ka njerëz që duan të marrin dhoma për të kaluar familjarisht pushimet.

Me këtë rast do t'ju bëj një vërejtje, se nuk i keni bërë edhe rrugët e tjera të Pogradecit si rrugën kryesore. Kalova edhe nëpër rrugët e tjera dhe vura re se, natyrisht, përparime ka, por mirëmbajtja dhe blerimi si në rrugën kryesore mungojnë. Nuk është e drejtë të justifikoheni duke thënë se drurët e gjelbërimit të rrugicave jua prishin njerëzit. Po të ishte kështu, ata do të prishnin edhe drurët e rrugës kryesore. Kështu, njerëzit që pushojnë këtu, nuk do të kënaqen duke shëtitur vetëm në rrugën kryesore, por atyre do t'u pëlqejë të shijojnë edhe bukurinë e rrugëve të tjera të qytetit.

Unë jam nga ata njerëz që ndiej kënaqësi kur futem në rrugët e rrugicat e brendshme dhe shikoj ato shtëpitë e vogla që më pëlqejnë aq shumë. Nuk jam

shumë sevdalli për shtëpitë me katër-pesë kate, këto duhen bërë se populli ka nevojë të strehohet, por mua më duken më të bukura shtëpitë e ndërtuara me stilin e vjetër, siç janë shtëpitë e fshatrave, megjithëse edhe këto tani po bëhen standarde.

Shtëpitë që janë ndërtuar në qytete para 60-70 vjetësh, që nuk pengojnë planimetrinë e qytetit, të mbahen mirë, të lyhen, të pastrohen rreth e rrotull etj., që të mos na dëmtohen e të mos na zhduken. Të ruhen me kujdes, për arsye se si ato nuk do të ndërtohen më. Këto shtëpi, që sot nuk vlerësohen nga të gjithë, nesër do të jenë thesar i çmuar. Këto antikitetet kanë rëndësi për të gjithë, prandaj duhen ruajtur me kujdes. Edhe jashtë shtetit i vënë rëndësi të jashtëzakonshme ruajtjes së sendeve antike, sepse ato tregojnë për mjeshhtërinë e madhe të popullit në të kaluarën, për artin popullor të mrekullueshëm.

Miqtë tanë të huaj, që venë si vizitorë në Gjirokastrë, në Shkodër, në Berat etj., kënaqen kur shikojnë artin tonë të ndërtimit të banesave. Atyre nuk u bëjnë përshtypje ndërtesat me pesë e gjashtë kate, se ata vetë kanë edhe ndërtesa me 20, 30, 40 e më shumë kate të ngritura me beton.

Kjo ishte vërejtja që kisha sivjet, sepse për ato që kam bërë vitet e tjera, e shoh që ju i keni marrë masat.

*Shoku Enver Hoxha, pasi shkëmbeu disa mendime me shokët e pranishëm, vazhdoi:*

Keni ndonjë vërejtje ose mendim për planin, ndonjë kritikë për ne lidhur me mënyrën si i kemi parë këto çështje për të cilat biseduam? Na thoni shoqërisht

ndonjë vërejtje apo këshillë në adresën tonë. Në mbledhjet tona bëjmë edhe ne autokritikë dhe kritikojmë shoqi-shoqin, se kritika na bën mirë të gjithëve. Kur kritika vjen nga poshtë-lart, bën akoma më mirë.

Vija e Partisë sonë për lidhjen me masat është një forcë e madhe, që shërben për çimentimin e unitetit të saj me popullin, prandaj vënia në korent e masave të popullit për vendimet e Partisë dhe informimi i Partisë për mendimin popullor, janë të domosdoshme. Kritika përpara masës ndaj njerëzve që gabojnë dhe marrja e këshillave të vazhdueshme nga masat për ato probleme që e shqetësojnë më shumë Partinë, krijojnë afrimin aq të nevojshëm në mes Partisë e popullit.

Për çdo veprim që do të bëni, shokë, për organizimin e aksioneve, për hartimin e planit, për mobilizimin e masave me raste të ndryshme, për të gjitha të këshilloheni me masat. Partia të jetë e lidhur ngushtë me masat, ajo t'i japë zgjidhjen edhe problemit më të vështirë, duke tërhequr mendimin e masave dhe duke siguruar bashkëpunimin e tyre. Kurrë të mos e harrojmë këtë këshillë që na jep Partia!

Borgjezia e kritikon demokracinë tonë, duke thënë se gjoja kjo na qenkësh një demokraci jo për popullin. Ky është një falsitet trashanik që i bëjnë armiqtë klasorë demokracisë sonë socialiste. Ata quajnë «demokraci» atë të tyre, «duke arsyetuar» se atje ekzistojnë shumë parti dhe secila prej tyre ka të drejtë të kritikojë tjetrën. Kritika e partive të ndryshme politike të borgjezisë në adresë të njëra-tjetrës nuk është kritikë për të mirën e popullit, por synon për të mbrojtur interesat e grupeve të shfrytëzuesve që përfaqësojnë.

Ne, në kundërshtim me predikimet boshe të borgjezisë, kemi demokracinë më të thellë dhe më popullore. Ne i themi popullit: «Kritiko kë të duash, me qëllim që të ndreqen punët e të mos shkelet vija e Partisë». Dhe populli i lirë nga shtypja e nga shfrytëzimi kritikon me guxim në mbledhje, me fletërrufe, me letra që drejton në organet më të larta etj. Te ne liria e kritikës për popullin është e pakufizuar, kurse për armiqtë, për njerëzit që degjenerojnë moralisht e politikisht dhe duan të shpifin e të minojnë fitoret që populli i ka arritur me gjak e sakrifica, demokracia jonë, duke ushtruar funksionet e diktaturës së proletariatit, godet rreptë dhe drejt sipas fajit. Në raste të tilla masa e popullit ngrihet me fakte dhe i thotë armikut të klasës: «Ti je i poshtër dhe ne nuk të lëmë të marrësh nëpër këmbë vijën e Partisë e ligjet e shtetit!».

Ku ka demokraci më të madhe se ajo që është e pakufizuar për interesat e popullit dhe e shtrënguar për armiqtë e tij? Komunistët duhet të kuptojnë se nuk jemi të imunizuar nga gabimet, prandaj, kur të na kritikojnë, të mos na vijë thartë. Në qoftë se kuptohet drejt kjo e vërtetë e pamohueshme, atëherë demokracia jonë, si demokraci e thellë e masave të popullit, do të zhvillohet ashtu si do Partia. Kur je i mirë dhe i pastër, nuk ka arsye të kesh frikë për asgjë nga masat. Kur, gabimisht, ke bërë diçka që nuk përputhet me vijën e Partisë, thuaje sinqerisht, se as Partia, as masat nuk ta presin kokën, po do të të thonë: «Mos vepra më kështu, se nuk është mirë!». Në një rast të tillë, në qoftë se je me të vërtetë komunist, nuk do të të vijë hi-



dhur, por do ta ndiesh veten të lehtësuar shpirtërisht dhe do të ecësh përpara me siguri.

Mirëpo njerëzit nuk mendojnë e nuk veprojnë gjithmonë drejt, se disave prej tyre u zihen këmbët nga mbeturinat që kanë në ndërgjegje. Kundër këtyre mbeturinave Partia duhet të luftojë me anë të edukimit ideologjik konkret. Kur dikush mendon ose vepron keq, i duhet thënë: «Ty, shok, të erdhi hidhur për këtë ose atë gjë, por nuk e ke drejt. Ne duhet të punojmë siç na thotë Partia jonë, siç na kanë mësuar Marks, Engelsi, Lenini e Stalini, prandaj lexoji pak ata, reflekto dhe në shtëpi e pastaj do të bisedojmë përsëri». Ai që është i ndershëm, komunist, pasi të thellohet, do të vijë të thotë: «Keni të drejtë!». Kështu, pra, me bindje, duhen luftuar mbeturinat.

Letrat që na shkruan populli, janë një thesar që nuk duhet nënvleftësuar. Unë, kur kam shkruar për letrat, kam bërë vlerësimin e tyre. Në fillim, pasi njerëzit u njohën me konsideratat e mia për letrat, neve na erdhën shumë të tilla, që na ndihmuan, se një pjesë e mirë e tyre na zbuluan shumë gjëra për njerëz që kishin gabuar dhe s'kishin punuar mirë, që mbanin qëndrime jomarksiste etj. Ne, pasi i vërtetuam të gjitha, morëm masa ndaj atyre që s'ishin në rregull. Ju, shokë, i dini mirë këto gjëra. Mirëpo disa njerëz të pandërgjegjshëm dërguan letra duke shkruar edhe për gjëra të paqena, duke shpifur për kuadrot, për të cilët qimen e bënin tra. Këta njerëz ne dhe vetë populli i demaskuam dhe do t'i demaskojmë. Për verifikimin e përmbajtjes së letrave shumë herë ne i drejtohem popullit: «Shikoni, shokë, çfarë na shkruan ky, a janë të

vërteta këto?». Kur populli, që e di mirë çështjen, shikon se letërshkruesi ka shpifur, ngrihet e thotë se ky që paska bërë këtë letër qenka i poshtër etj.

Tani na vijnë letra të mira, që ngrenë probleme për interesa shoqërorë dhe personalë. Kjo është gjë e mirë, por ka edhe një të keqë, se ata që nuk kanë guxim, që s'janë shumë të qartë, e mbajnë brenda në vetvete çështjen për të cilën shqetësohen. Partia ka kërkuar nga secili që të thotë çfarë mendon ai për punën e për njerëzit, prandaj dërgimi i shumë letrave nga populli është një masë për forcimin e demokracisë socialiste.

Shoku Hysni do të ikë, kurse unë do të rri këtu edhe disa ditë. Prej këtej kam ndër mend të vete një çikë edhe nga miqtë e mi të vjetër korçarë, se edhe ata kam nja tre vjet që nuk i kam parë. Në Korçë kam ca miq, që janë pleq tani. Edhe Korça ka bërë përparime. Megjithëqë i ngjau ajo fatkeqësi tashti, se breshëri që ra ka bërë dëme të mëdha, me siguri Korça do ta realizojë planin e drithit.

Mirë, shokë, falemnderit shumë për vëmendjen dhe mikpritjen. Ju uroj suksese në punë!

Mirupafshim, shokë, qofshi mirë!

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e  
fjalime 1974-1975», f. 224*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**TË GJYKOJMË MË GJERË, TË VËSHTRIJMË MË  
LARG, TË SHOHIM INTERESAT E LARTË  
TË ATDHEUT**

*Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit  
të Partisë dhe me kuadro të tjerë drejtues të organeve  
të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave  
dhe të ushtrisë të rrethit të Korçës<sup>1</sup>*

19 gusht 1975

*Shoku Enver Hoxha, pasi u përshëndet me pjesëmarrësit në këtë takim, zhvilloi me ta një bisedë shumë të ngrohtë e të përzemërt.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, shokë? (Të gjithë përgjigjen se janë mirë.)

Si je ti, shoku Ilo<sup>2</sup>? Si shkojnë punët në ndërmarrje? Kur pyeta njëherë nëse Iloja punon akoma në Ndërmarrjen Bujqësore, më thanë: «Nuk heq dorë ai nga ndërmarrja derisa të plaket». (Të qeshura.)

---

1. Në këtë takim merrnin pjesë edhe shoku Pilo Peristeri, në atë kohë kandidat i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, dhe anëtarja e Komitetit Qendror të Partisë, shoqja Nexhmije Hoxha.

2. Ilo Prifti, në atë kohë drejtor i Ndërmarrjes Bujqësore të Malikut.

Por ne tani duhet të përgatitim kuadro të rinj, se ata janë e ardhmja. Të rinjtë e sotëm janë të ditur, ata kanë edhe energjitë e moshës.

Nga shokët që punojnë në rrethin e Korçës, ka edhe të ardhur nga rrethet e tjera. Edhe të pranishmit në këtë takim nuk janë të gjithë nga Korça, se Partia na ka mësuar të punojmë jo vetëm në vendin ku kemi lërë, por në të katër anët e atdheut, kudo që të ketë nevojë Shqipëria.

Shoku Pilo, Nexhmija dhe unë erdhëm këtu që të vizitojmë Korçën dhe të takohemi me shokët e Partisë, në radhë të parë.

Unë kam një kohë pak të gjatë që nuk kam ardhur në Korçë. Kjo ka ndodhur për shumë arsye: së pari, për shkak të zënies sime me punë, se na u vërtetuan ngjarjet që të tërë i dimë. Por, pavarësisht nga mungesa ime, shokët e tjerë udhëheqës të Partisë e të shtetit vazhdimisht ju kanë ardhur këtu në rreth, kanë marrë takime me ju, kanë dëgjuar raportet tuaja dhe i kanë zgjidhur problemet së bashku me ju.

Bashkëpunimi dhe këshillimi i udhëheqësve me drejtuesit e punës së Partisë e të pushtetit në rreth e në bazë, si dhe me masat e popullit, janë shumë të mirë dhe të domosdoshëm. Edhe ne, duke shfrytëzuar pushimet, kemi ardhur këtu, në radhë të parë, që të mësojmë nga ju, e pastaj, mundësisht, t'ju themi edhe ndonjë gjë që mendojmë se mund t'ju vlejë në punën tuaj. Shumë gjëra për të thënë nuk kemi, për arsye se metoda e punës së Partisë është e tillë që ajo çdo çështje me rëndësi që ka ua bën të njohur me kohë para së gjithash anëtarëve të saj, duke u shpjeguar e duke u sqar-

ruar përse ka ndodhur diçka, ç'duhet bërë për ndreqjen e situatës, si duhet parë perspektiva etj.

Problemet kryesore të Partisë janë bërë të njohura edhe për popullin, se pa popullin Partia nuk mund të bëjë asnjë çap përpara. Pa u lidhur me popullin dhe pa u mbështetur fort në të, vetëm prapa mund të bëhet. Shkëputja e Partisë nga populli do të ishte katastrofë për atdheun socialist, por Partia jonë, që i ka rrënjët te populli, e ka kuptuar mirë këtë të vërtetë, prandaj zbaton një vijë të drejtë masash të bazuar në marksizëm-leninizmin.

Në Parti duhet të bisedojmë shoqërisht, sepse në radhët tona komuniste nuk duhet të ketë as bisedime, as qëndrime të ndikuara nga fryma e zyrtarizmit. Bisedat midis komunistëve të vërtetë janë të hapëta e të sinqerta. Ne nuk ndiejmë asnjë druajtje për të thënë shqip ato që ndiejmë ose mendojmë, sepse jemi shokë e miq të ngushtë, jemi anëtarë të një partie dhe të lidhur përjetë nga ideali ynë i përbashkët. Unë jam i bindur që, në bisedën me ne, ju nuk mbani asnjë rezervë, prandaj ky takim do të jetë shoqëror.

Ju, shokë, sigurisht keni shumë për të më thënë, por unë do t'ju lutesha që, sa të jetë e mundur, të më flisnit për ndonjë problem të rëndësishëm që shqetëson me të vërtetë organizatën e Partisë këtu në rrethin tuaj, veçanërisht në sektorët ku punoni. Në këtë bisedë do të isha i kënaqur të na jepnit ndonjë këshillë, të na bënit vërejtje dhe sugjerime, pse tashti, siç e dini, jemi përpara problemeve të mëdha që dalin për hartimin e planit pesëvjeçar.

Ju bëtë planin e vitit që vjen, por duhet të hartoni

edhe planin pesëvjeçar të ardhshëm. Ky plan ka rëndësi të madhe, prandaj le të flasim një çikë për të. Kush nga ju të ketë ndonjë vërejtje, sugjerim ose propozim për ne, do të jetë mirë të na e thotë.

*SHOKU PILO PERISTERI:* Të na flasim njëherë shokët e rrethit, se ju, shoku Enver, do të flisni më pas. Edhe ne kemi nevojë të mësojmë nga shokët e rrethëve, por edhe këta kanë nevojë të dinë çfarë këshillon udhëheqja për kryerjen e detyrave.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Është e vërtetë që edhe këta kanë nevojë të mësojnë diçka nga ne, megjithëse duhet të na thonë më shumë neve, sepse i njohin problemet e bazës. Baza përbëhet nga mijëra dhe dhjetëra mijë njerëz që kanë eksperiencën e punës, ndjenjat, dëshirat, mendimet etj.

Ato që na porositin Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë, edhe ato që themi ne udhëheqësit, duhet ta kuptoni, shokë, se nuk kanë dalë nga koka e Zeusit, po janë nxjerrë nga eksperiencia e punës së Partisë dhe nga përgjithësimet e saj.

Unë desha të dëgjoja sidomos shokët që merren me bujqësinë, se për këtë jemi aktualisht të interesuar të dimë si po punohet e ç'mund të bëhet më shumë.

Ju, sigurisht, keni marrë pjesë në një konferencë kombëtare<sup>1</sup> që u mbajt në Tiranë për tokat, për farërat, për prodhimet bujqësore e për çështje të tjera. Unë nuk asistova atje, por u njoha me të gjitha materialet dhe kam mbajtur një tog shënimesh. Ajo që

---

1. Është fjala për Konferencën kombëtare të shkencave bujqësore, e cila u mbajt në Tiranë nga 29-31 janar 1975.

një mbledhje serioze, e përgatitur mirë e më pëlqeu shumë, sidomos nga problemet interesante që shtruan atje shokët specialistë. Mund të them me plot gojën se ne, aktualisht, kemi shumë specialistë të lartë e të kualifikuar, që, sipas mendimit tim, shtruan me kompetencë të madhe çështjet lidhur me çdo sektor që ata njohin mirë.

Specialistët folën në atë konferencë për gjendjen në çdo sektor dhe bënë parashikime të drejta për të ardhmen. Të gjitha ato të dhëna, studime dhe këshilla që u dhanë atje, duhet të përpunohen mirë nga Ministria e Bujqësisë dhe, në bazë të tyre e të eksperiencës së fituar, të hartohet plani i ardhshëm pesëvjeçar për bujqësinë.

Metoda e hartimit të planit pesëvjeçar duhet të dallojë fort jo vetëm nga forma, por sidomos nga mënyra shkencore e shtrimit të detyrave dhe nga rezultatet që synohen të arrihen. Në konferencë u shtjelluan mirë metodat shkencore, prandaj ju thashë që këtu duhet të bazoheni dhe këtej të nxirrni eksperiencën për të hartuar planin bujqësor.

Unë dua të di nga ju, shokë, nëse ju kanë thirrur ndonjëherë në Ministrinë e Bujqësisë që të bisedojnë, për shembull, se lopa do të zhvillohet edhe në bazë të atyre mendimeve që shprehu në konferencë shoku Tartari<sup>1</sup>, i cili foli shumë mirë për gjedhin. Jeni thirrur ndonjëherë në ministri për problemin e veçantë të lopës ju, që keni peshën kryesore dhe që jeni të dalluar për rritjen e saj? Më parë se t'ju vinin udhëzimet për

---

1. Profesor T'eki Tartari.

planin e vitit 1976 që hartuat, ju kanë ardhur shokët e ministrisë që t'ju thoshin se, në bazë të konkluzioneve që ka nxjerrë ministria për shërbimet e lopës, të patates, të foragjereve etj., etj., të bazohet plani i vitit 1976 dhe ai pesëvjeçar? Ju kanë porositur shokët e ministrisë se, që të keni rendimente sa më të larta, duhen kryer këto ose ato shërbime dhe duhen pasur parasysh rreziqet eventuale që mund t'i kanosen prodhimt? Ju erdhën ata për t'ju ndihmuar se si mund t'i kaloni vësh-tirësitë, ju orientuan konkretisht që të parashikoni shtesë: lopë kaq për qind, grurë kaq për qind etj., apo ju udhëzuan si zakonisht? Ka ndryshime në stilin e në metodën e punës së tanishme të Ministrisë së Bujqësisë për sa i përket ndihmës ndaj bazës, apo jo? Më kup-toni, shokë, se çfarë kërkoj të di unë?

**SHOKU ILO PRIFTI:** Ata po mundohen, shoku Enver, por e vërteta është se akoma nuk e kanë marrë veten si duhet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Qëllimi ynë është të dimë të vërtetën, që, kur t'u themi pse nuk e keni kryer kështu këtë ose atë detyrë, të jemi të bazuar diku. Kur e mësojmë të vërtetën nga baza për dobësitë e punës së ministrisë, i kritikojmë shokët, ta zëmë, për arsye se kanë dhënë një udhëzim që nuk është i saktë e i bazuar në të dhëna shkencore, u vëmë në dukje atyre se konkluzionet nuk duhen nxjerrë vetëm nga librat, por edhe nga eksperiencia, pra, nga librat dhe nga empirizmi i njerëzve të bujqësisë.

Pa më thoni ndonjë gjë interesante nga eksperiencia juaj. Përfytyroni për një moment sikur unë të isha një nëpunës i Ministrisë së Bujqësisë dhe të kisha ar-



dhur këtu te ju që «të më lani një çikë kokën», se nuk ju kam ardhur shumë herë për t'ju ndihmuar në vend dhe nuk ju jam përgjigjur me kohë e si duhet kërkesave tuaja për disa probleme kapitale. Këtu, natyrisht, nuk është fjala t'ju zgjidhen nga dikasteri ato probleme që e keni për detyrë t'i zgjidhni ju vetë, se, po të pretendonit kështu, atëherë edhe nëpunësi i ardhur nga Ministria e Bujqësisë ka të drejtë të kthehet e «t'ju lajë kokën» juve.

Sigurisht, duke kritikuar të metat e ministrisë, ju nuk do të rrini pa folur edhe për disa nga të metat tuaja, por unë them se është mirë të bisedojmë për disa probleme që ju ju shqetësojnë më tepër, si edhe për punën përgatitore që keni bërë për t'i dhënë një hov zhvillimit të bujqësisë gjatë vitit të parë të pesëvjeçarit.

Edhe për gjithë pesëvjeçarin mund të na thoni ndonjë gjë.

**SHOKU ILO PRIFTI:** Na zure një çikë si ngushtë, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** (Me shaka.) Je një «ujk i vjeiër» ti, Ilo (të qeshura) e njeh mirë bujqësinë, prandaj nuk të kam zënë aspak ngushtë.

*Pastaj mjaft nga shokët drejtues të rrethit dhanë mendime dhe eksperiencë të vlefshme. Shoku Enver Hoxha dëgjonte me vëmendje dhe interesohej të mësonte sa më shumë, bënte pyetje, ndërhynte për të ndihmuar dhe vazhdoi:*

Më fal, se kam një vërejtje, shoku Ilo. Është i drejtë mendimi se ajo që miratohet, duhet të zbatohet, por nganjëherë janë vërtetuar në praktikë edhe raste kur

janë dhënë premtime e janë miratuar disa gjëra të pamenduara mirë, pa ditur se çfarë kemi në xhëp.

Abdyl Këllezi, për shembull, e paraqiste situatën shesh me lule. «Çfarë do ti, mjete për të shkukur pataten? — thoshte ai. — Posi, vëmë në plan të sjellim kaq makina». Në plan mund të shënojmë shumë gjëra, po çfarë mundësisht konkrete kemi për të siguruar ato që planifikojmë, është një çështje me shumë rëndësi.

Sikur të vijmë këtu ne shokët e udhëheqjes e për çdo kërkesë të të themi ty: «Po, po, jemi dakord me të tëra ato që kërkon ti, shoku Ilo, se sezoni është vërtet i ngarkuar» etj., etj., dhe të bëjmë të njëjtën gjë edhe me të tjerët në të tëra rrethet e republikës, atëherë i merr lumi edhe planin, edhe ekonominë.

Kuptohet që bujqësia është dega e ekonomisë që shtrihet kudo në sipërfaqen e tokës së hapur. Shumë kërkesa të saj vijnë në periudha të caktuara kohe që duan punë intensive. Sa më shpejt duhet të mbillet, sa më shpejt duhet të korret, sa më shpejt të shihet, sa më shpejt të grumbullohet etj., etj. Kur vjen koha e marrjes së prodhimit të patates, kërkohet që ajo sa më shpejt të futet në vende që të mos priset. Puna e bujqësisë nuk ka kohë për ngadalësi, se është absolutisht e domosdoshme që çdo gjë të kryhet shpejt.

Në një takim që pata me shokët drejtues të Partisë e të pushtetit në Pogradec, u thashë se toka me prodhimin janë në të njëjtin raport si nëna me fëmijën. Në qoftë se nëna nuk është me shëndet të mirë, kalamani që do të lindë nuk vjen i shëndetshëm. S'ka prodhime të shëndosha pa tokë të shëndoshë, s'ka buj-

qësi pa tokë. Këtë e ka thënë vetë populli. Në qoftë se këtë tokë nuk e marrim që ta studiojmë nga se përbëhet, çfarë të mirash ka dhe çfarë gjërash i mungojnë, si mund t'i zëvendësohen mungesat etj., është lehtë të kuptohet se prej saj nuk do të merret prodhimi i dëshiruar. Po e hodhëm farën në tokën që nuk e kemi studiuar, ajo do të mbijë keq dhe, natyrisht, prodhimi që do të merret nuk do të jetë i bollshëm.

Partia ka punuar në këtë drejtim, duke udhëzuar për përgatitjen e hartave pedologjike e agrokimike, duke krijuar laboratorët, duke përgatitur edhe agronomët, që janë specialistë të bujqësisë. Kur hartohet plani i bujqësisë, agronomi, duke marrë me vete edhe hartat, duhet të shkojë në kryesinë e kooperativës bujqësore që t'u thotë shokëve drejtues të kooperativës: «Unë mendoj që këto toka t'i mbjellim me misër, këto me panxhar, të tjerat me patate etj., për arsye se gjendja e këtyre tokave është e tillë, këto kanë këtë përbërje, janë argjilore, këtyre u mungon gëlqerja, atyre të tjerave u mungon diçka tjetër etj. Në qoftë se duam që këtë tokë ta destinojmë për misër, atëherë duhet t'i hedhim këtë lloj plehu, meqenëse kësaj toke i mungon humusi, kaq për qind të kashtës së misrit duhet të mos e marrim për silazh, por ta grijmë e t'ia hedhim tokës; që të marrim këtë rendiment, kësaj toke i duhet azot, asaj i duhet fosfat; në qoftë se tokën e misrit duam ta mbjellim me luledielli, atëherë duhet t'i shtojmë kaq pleh të këtij lloji dhe t'i bëjmë këto shërbime» e të tjera e të tjera. Agronomi duhet të arrijë në një nivel të tillë që, në bazë të njohjes së tokës, të japë mendimin e tij shkencor për prodhimin, të udhëzojë për për-

mirësimin e tokës etj. Kryesia e kooperativës, mbledhja e përgjithshme etj. do ta dëgjojnë agronomin jo thjesht për faktin se ai ka diplomën e universitetit, por sepse do të binden prej tij nga ana shkencore.

Pasi jep mendim agronomi, bëhen llogaritë e plehut që nevojitet, shikohet sa pleh ka tani dhe sa do të grumbullohet më pas nga bagëtitë e kooperativës etj. Të tëra këto të dhëna hidhen mbi tavolinë dhe pastaj, mbi bazën e tyre, mendohet si do të bëhet, duke shtrirë këmbët aq sa është jorgani. Të gjitha këto punë bëhen me plan.

Kur flitet për plehurat ose për sendet e tjera, llogaritari është aty, ai mban llogaritë e treguesve ekonomikë dhe diskuton e pyet se cili lloj bime, ka interes ekonomik më shumë për ne dhe për shtetin, me qëllim që t'i jepet një zhvillim më i madh prodhimit. Pasi t'i jepet përgjigje kësaj pyetjeje, atëherë vendoset sa pleh duhet t'i hidhet, për shembull, tokës së misrit, vihet detyra që ujitja të bëhet më sistematike e në mënyrë më shkencore, caktohen jo dy, por tri prashitje për këtë bimë etj.

Në diskutim e sipër dikush mund të ngrihet e të thotë: «Po ku t'i gjej unë këto forca pune për të bërë tri prashitje?». Dhe argumenton nevojën për më shumë forca pune. Kështu zien diskutimi, rrahja e mendimeve për hartimin e planit në mënyrë realiste e shkencore dhe arrihet në konkluzione sa më të drejta. Kështu, kur shikohet që u morën 35 kuintalë misër për hektar, shtrohet pyetja: Po sikur të merren edhe 3 kuintalë më shumë? Pasi diskutohet edhe kjo pyetje, atëherë merret vendimi, për drojtësinë e të cilit të tërë janë të bindur.

Eksperienca aktuale e bujqësisë është e pasur, kjo duhet të na shërbejë për arritje më të mira në të ardhmen. Veçse këtë eksperiencë duhet ta perfeksionojmë dhe ta futim në rrugën shkencore. Në rrugë shkencore të futim tokën, rritjen e bimëve, luftën kundër sëmundjeve të bimëve, blegtorinë dhe frutikulturën. Në qoftë se Partia në bazë e në qendër e studion dhe e gjykon këtë çështje jetike për vendin tonë në tërë gjerësinë e madhe që ka, në kuptimin që të mos lërë të dëmtohem nga «qoshet e errëta», domethënë nga paragjykimet e disa njerëzve, ne mund të ecim dhe do të ecim me siguri përpara.

Të luftohen mendime të tilla, si: «Ç'na duhet misri neve, sa kohë që arritëm të marrim 35 dhe 40 kuintalë grurë për hektar!». Këto mendime nuk janë të drejta, se nuk mund të lihet pas dore misri, kur nga ai mund të merren edhe 60-70 e më shumë kuintalë për hektar.

Ju kanë ardhur ekipe nga qendra që të këshillohen me ju e të mësojnë për rritjen e patates? Besoj se jo. E kam fjalën për tashti, se përpara, kur çështjen e patates e ngritëm me të madhe në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror të Partisë, besoj se ju kanë bezdisur të dërguarit e shumtë nga qendra. Ne kishim blerë jashtë me devizë mijëra e mijëra tonë patate, megjithëkëtë vërejtëm që, më pas, ra prodhimi i patates. Kaluan nja dy vjet pas fushatës së madhe që u organizua nga Partia për rritjen e patates dhe meqenëse kjo porosi e Partisë nuk u shndërrua kudo në bindje, u shua si zjarr kashte. Rëndësinë e saj nuk e kuptuan të gjithë.

Korça e ka traditë rritjen e patates dhe prodhon patate të mira, pavarësisht që ndonjëherë i takon të mos dalë me rezultate të kënaqshme.

Patatja është bukë dhe ushqim, është një nga llojet më kryesore të zarzavateve. Ne duhet të luftojmë për shtimin e prodhimit të patates, se për këtë çështje kemi vendosur me kohë. Nga justifikimet boshe duhet hequr dorë. Në qoftë se e kanë mbjellë pataten për shumë vjet në të njëjtën sipërfaqe, le ta mbjellin në sipërfaqe të tjera, të bëhet qarkullimi bujqësor, të përgatitet toka për mbjelljen, se, siç thamë, patatja është një bimë me rëndësi të madhe.

Shoku Hysni bën mirë që interesohet jashtëzakonisht për këtë gjë, por duhet të interesohet po kështu edhe shoku Pirro Dodbiba<sup>1</sup>, i cili ka faj si ministër i Bujqësisë që është. Ai duhet të bëjë përpjekje jo vetëm që t'i kuptojë detyrat në teori, por t'i zbatojë edhe në praktikë, me punën konkrete, duke e ndjekur problemin këmba-këmbës me të gjitha mënyrat e mjetet. Për nënvleftësimin e patates kanë faje të rënda, veç Ministrisë së Bujqësisë, edhe rrethet, që, me përjashtim të rrethit tuaj, e kanë braktisur krejtësisht këtë detyrë. Është shumë neglizhent qëndrimi që kanë

---

1. Ish-kandidat i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe ministër i Bujqësisë. Plenumi i 9-të i KQ të PPSH, që u mbledh në 19-20 korrik 1976, e përjashtoi nga Byroja Politike dhe nga Komiteti Qendror dhe e shkarkoi si ministër për dobësi të theksuara në Ministrinë e Bujqësisë, dhe veçanërisht për dëmet e mëdha që i shkaktoi ekonomisë sonë duke vepruar në kundërshtim me vijën, me vendimet dhe me orientimet e Partisë.

mbajtur ato. Gjithë ajo propagandë që u bë për pataten, u shua si kandili që s'ka vaj. Nuk është e arsyeshme që Korça të mbajë tërë Shqipërinë me patate.

E filluam rritjen e patates në Shishtavec, por na thanë që atje nuk u bëka kjo bimë, se është ftohtë dhe e zë bora! Po Polonia dhe Gjermania, që kanë shumë patate dhe janë vende me klimë kontinentale e me shumë reshje bore, si e prodhojnë me shumicë pataten? Si e shkulin pataten këto kur toka është e mbuluar me borë? Patatja ka qenë një ushqim shekullor i popullit polak edhe kur ai nuk ka pasur makineri. Këtë nuk e them vetëm nga literatura, por e di mirë, se jam informuar hollësisht për këtë çështje. Ja, pra, kur e shtrojmë problemin kështu, duket qartë sa pa vend janë arsyetimet: «Na e zuri bora në Shishtavec», «nuk ka rrugë në Shishtavec» etj.

Rrugën që e paraqitnin si pengesë të madhe për transportin, e hapi ushtria, e cila mbolli edhe patate. Hito Çakoja na thoshte neve atëherë: «Mirë do të mbjellim patate në Shishtavec, po si do t'ia bëjmë për transportin?». Tërë ata automobila kishte në dispozicion ushtria dhe ky hiqej sikur donte t'i ruante, gjoja, për gatishmërinë. Kur e shohim këtë çështje tani, na del se automjetet e ushtrisë, që duhej të mbaheshin në gatishmëri për destinacionet e caktuara, janë shpërdoruar jashtëzakonisht nga këta armiq.

Kështu si Shishtavec i ka edhe vende të tjera që duhet të merren me rritjen e patates. Përse nuk mbjell Kolonja patate në tokat e reja që hapi? Të mendohet seriozisht për të gjetur njerëz që të merren me këtë punë e jo t'i lihet rritja e patates vetëm rrethit të Korçës.

Ndihma materiale, që ka rëndësinë e vet, varet jo nga dëshirat tona, por nga mundësitë reale që kemi për dhënien e saj. Në qoftë se janë marrë vendime, ato nuk janë zbatuar të gjitha, për arsye se mundësitë e vënies së tyre në jetë nuk kanë qenë të studiuara nga lart. Po të kishin qenë studiuar, duhej t'ju ishte thënë juve korçarëve që «ne, shokë, nuk kemi mundësi t'jua miratojmë këto kërkesa, prandaj të mobilizohen masat për arritjen e rezultateve duke u mbështetur në mundësitë që kemi». Kështu bëtë ju që mobilizuat me dhjetëra mijë njerëz kur ngjanë dëmtimet e breshërit.

Ne kemi bërë gabime të mëdha në administrimin e makinerive që kemi sjellë, se nuk kemi ditur t'i shpërndajmë. Kemi lejuar të dërgohen makineri, si bie fjala, kombajna etj., në disa vende ku nuk duheshin çuar. Ne i kemi shpërndarë makineritë andej-këtej për të grumbulluar disa «thërrime», duke i lënë gjetkë prodhimet në diell, që të na i hanë zogjtë!

Gabimet e sipërme që janë të dënueshme, natyrisht, nuk i kanë bërë të gjithë shokët, por i kanë bërë Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e disa të tjerë, që kanë pasur qëllime armiqësore. Shokët e tjerë që nuk i kanë pasur këto qëllime, kanë vepruar duke pasur një besim naiv.

Prandaj, shokë, të jemi më prudentë e të bëhemi më të ndërgjegjshëm. Me këto mundësi që kemi dhe me forcat tona duhet t'i mbajmë mirë mjetet e t'i përdorim si duhet. Të mos e çojmë kombajnën që të përdoret nga të katër anët, për shembull, deri në gërshet e Skraparit, ose në Sheper të Zagorisë. Nuk është e drejtë të veprohet kështu dhe të mbetet bujqësia



prapa. Unë ju këshilloj ju, shokë, që merreni me bujqësinë, «të mbathni këpucët» e të shkoni në Ministrinë e Bujqësisë për të biseduar lidhur me planin e vitit 1976. Për këtë gjë mund t'ju thërresë edhe vetë ministria.

Rrethi do të paraqesë kërkesat e tij, për shembull, për panxharin, kërkesat e kooperativës bujqësore të Bilishtit për lulediellin apo për pataten e të tjera. Të gjitha këto kërkesa ai që do të shkojë në ministri i ka në xhëp dhe në mënyrë të arsyeshme e të argumentuar do të thotë: «Shoku ministër, ky është plani ynë, për zbatimin e të cilit kemi edhe këto kërkesa ndaj jush». «Po mirë, t'i shikojmë e pastaj të vendosim për to», do të thotë ministri. «Bukur, do të vendosni, por para kësaj ne kërkojmë të diskutojmë një çikë së bashku», do të thoni ju. Në qoftë se shoku ministër shprehet para jush duke thënë: «Nuk di unë më gjatë, por kam 150 milionë lekë për këto ose ato kërkesa», atëherë ju duhet të sqaroni se nuk doni t'i shpenzoni të tërë këta 150 milionë për të sjellë vetëm kombajna ose vetëm traktorë, por doni të sillni me ta edhe një tip të përshtatshëm makine për panxharin dhe një tjetër për pataten. Me këtë rast caktoni edhe numrin e makinave që ju nevojiten.

Gjatë bisedës ju keni të drejtë t'i thoni shokut ministër se nuk ju vjen aspak mirë që tani ai t'ju premtojë me lehtësi, kurse nesër të mos ju japë asgjë. Ju do të kërkonit që këto porosi të drejta tuajat të kihen mirë parasysh, se ju nuk vini kot në Tiranë, por flisni si përfaqësues të organizatës së Partisë të rrethit të Korçës që jeni ngarkuar me ekonominë, prandaj kër-

kesat tuaja t'i parashtrohen Qeverisë kur të vijë koha e diskutimit të planit pesëvjeçar. Përfundimisht ju do të kërkonte të dini me saktësi sa makina ju caktuan për panxharin dhe sa për patatën etj. Këto juve duhet t'ju thuhet, se pret përgjigje baza, populli e Partia në rreth. Prandaj ju nuk duhet të largoheni nga ministria pa mësuar definitivisht se çfarë ju janë caktuar.

Nuk përjashtohet që kërkesat e bazës të jenë edhe të fryra, për këtë çështje do të flas një çikë më vonë, por, kur ato nuk merren parasysh, organi kompetent duhet të arsyetojë përse nuk i ka pranuar, ashtu sikurse edhe baza duhet të argumentojë qartë kërkesat e saj.

Duke biseduar rreth kërkesave, shoku ministër duhet të arsyetojë me llogari e me defter në dorë. Për shembull, ai thotë se në këtë ose në atë drejtim ju, shokë të rrethit, jeni zbuluar për makineri. Atëherë si mendoni, më mirë t'ju sjellim kaq traktorë apo më mirë kaq makina për të mbledhur patatën? Ju do të thoni: «Meqenëse s'ka mundësi për t'u furnizuar me të dy llojet e makinave, atëherë më mirë na sillni traktorë».

Kështu mendoj unë se duhet të merreni vesh me shokët e ministrisë.

Baza duhet të jetë e arsyeshme në kërkesat e saj, të cilat nuk mund të dalin jashtë kuadrit të mundësive të shtetit tonë. Mundësitë tona, natyrisht, shtohen dita-ditës dhe, me shtimin e tyre, do të përmirësohet edhe plotësimi i kërkesave të bazës. Mundësitë dhe koha janë të lidhura. Kjo i ngjet atij fenomeni që në kimi quhet osmozë, domethënë përzierja me kalimin e

kohës të dy solucioneve, kur këto ndodhen të veçuara nga njëri-tjetri prej një membrane poroze. Kështu edhe sipas dialektikës marksiste-leniniste, zhvillimi nuk njeh kurrë mbarim, e mira nuk ka kurrë kufi. Por zhvillimi duhet arritur realisht e jo me fjalë, prandaj asnjë shok, qoftë ky dhe udhëheqës, nuk ka të drejtë që, nga njëra anë, të thotë «dakord» kur i bëhen kërkesa nga baza dhe, në anën tjetër, të mos i plotësojë ato. Çfarë thotë udhëheqja, duhet të kihet parasysh, por, ama, edhe çfarë mendon baza, gjithashtu, duhet të kihet parasysh. Kështu do të arrihet një përfundim i arsyeshëm për kërkesat e bazës dhe vendimet e qendrës për këto kërkesa do të jenë të drejta.

Nga këto që po na thuhën këtu, na lindin disa ide dhe mendime, të cilat, në vend që t'i themi të gjitha në fund, mund t'i shprehim me njëri-tjetrin edhe kështu pjesë-pjesë, në formë bisede. Ne nuk kemi mundësi t'i plotësojmë të gjitha nevojat tona me ndihmën nga jashtë, prandaj të përqendrojmë vëmendjen brenda vendit, ku kemi shumë mundësi të pashfrytëzuara. Masat e popullit, Partia, baza na japin mësim të shkëlqyera në këtë drejtim. Në qoftë se udhëheqja nuk i kap iniciativat që vijnë nga baza, nuk i përkrah me forcën e duhur dhe nuk e organizon punën si duhet e me shpejtësi për t'i përgjithësuar në shkallën kombëtare, bën një gabim të madh.

Tashti ka hyrë në praktikën e punës sonë organizimi i aksioneve me goditje të përqendruar. Këtë shembull për herë të parë, siç dihet, na e dha rrethi i Dibrës. Me metodën e aksionit ne kemi realizuar gjëra kolosale në kohë rekord. Një vepër, që në kushtet e

punës normale mund të kërkonte tre-katër muaj kohë për t'u përfunduar, me aksionin me goditje të përqendruar është bërë në një ditë, sepse kanë vajtur për të punuar atje jo 150, por 20 000 njerëz me shata e me lopata nëpër duar.

Kjo metodë pune jashtëzakonisht me vlerë ka hyrë kudo, pa folur këtu për veprën e madhe historike të rinisë sonë, që duhet ta ngremë në pedestalin e vërtetë të saj. Rinia jonë jep një kontribut kolosal në ndërtimin e socializmit, se ajo e ka kuptuar mirë direktivën e Partisë që socializmi ndërtohet për rininë. Brezat i lëshojnë vendin njëri-tjetrit. Më të vjetrit u përgatitin dhe u lënë trashëgim veprën e tyre më të rinjve. Secili brez do t'ia lërë vendin më të bukur atij që vjen pas. Me kalimin e kohës vendi ynë do të zbukurohet akoma më shumë. Mbi të gjitha aksionet që përmenda, në radhë të parë, janë ato të rinisë sonë heroike. Të tëra hekurudhat e Shqipërisë janë vepër e rinisë, pa zënë në gojë sa e sa vepra të tjera.

Korça na dha një shembull tjetër aksioni në kohë rreziku. Breshëri që ra këtu, shkaktoi fatkeqësi, por, për të mënjeluar dëmtimin e mëtejshëm, u ngrit populli në këmbë. Të gjithë ishin gati të bënin sakrificat më të mëdha për të shpëtuar prodhimin. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon patriotizmin e lartë dhe gatishmërinë e madhe të masave të gjera të popullit për mbrojtjen e ekonomisë socialiste. Kjo tregon, gjithashtu, se masat e popullit në këtë rreth janë ngritur politikisht. Këtë iniciativë që mori Korça për të përballuar dëmet nga breshëri, shokët sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë kanë menduar ta përgjithësojnë, por në

mënyrë të organizuar. Përse duhet të presim fatkeqësitë ne e pastaj të organizojmë masat në punë, kur këtë gjë mund ta bëjmë edhe pa pasur fatkeqësi? Mobilizimi i madh i punonjësve në punët bujqësore duhet të vazhdojë, sepse punët në bujqësi janë zinxhir. Kjo është e qartë.

Partia bën thirrje dhe 10 mijë veta përnjëherësh hidhen në aksion! Nga ky qëndrim me një kuptim të madh politik, ne duhet të nxjerrim mësim të rëndësishme. Kur punohen me kujdes direktivat e Partisë, këto përkrahen fuqimisht dhe pa asnjë ngurrim nga masat. Kjo është një nga arsyet që masat punonjëse i kanë përkrahur pa rezervë orientimet e Partisë për të luftuar burokratizmin e për të likuiduar punën armiqësore të tradhtarëve Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako në ushtri, për të luftuar sabotatorët në industrinë e naftës, si Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Pirro Gusho, Lipe Nashi e ndonjë tjetër.

Direktiva e Partisë që, në kuadrin e luftës kundër burokratizmit, të shkurtohen organizmat e tepërt e të panevojshëm dhe njerëzit të gjejnë vendin e tyre, të lehtësohet administrata e mbi të gjitha të ndryshojnë stili dhe metoda e punës, gjithashtu është përkrahur fuqimisht nga populli.

Si të kuptohet direktiva ashtu edhe zbatohet. Kur nuk punohet për kuptimin e saj, njerëzit bëjnë gabime. U ngrit në Tiranë një pulari e madhe moderne me një kapacitet prej 20 milionë vezësh. Rrethi i Tiranës, që deri dje kishte vetëm vezët nga pulat e kooperativave, meqenëse tashti siguroi pularinë me një kapacitet të tillë, i braktisi pulat dhe vezët në kooperativa!

Që të vijnë në vete dhe ta ndjejnë shumë gabimin që bënë në Tiranë, mund t'ua merrnim të tëra vezët e pularisë e t'ua jepnim rretheve të tjera, por Partia dhe shteti ynë nuk mund të veprojnë kështu, ata edhe në një rast si ky duhet të bindin dhe të edukojnë. E shikoni, pra, se si vërtetohen nganjëherë edhe veprime të gabuara kur punohet keq me direktivën e Partisë?

Tani duhen ndryshuar metoda e stili i punës sonë, që këta të bëhen me të vërtetë të zhdërvjellët e revolucionarë. Një nga mjetet që e favorizon shumë këtë ndryshim, është të shkuarit për të punuar e për të jetuar në fshat. Kjo çështje është problem për ne jo vetëm për sot, por edhe për të ardhmen. Mirë se u rregulluan e do të rregullohen në punë këta 12, 13 apo 15 mijë veta që u shkulluan nga organikat, por çështja është, shokë, si do të veprohet në perspektivë? Çdo vit ka nga 20, 25 e 30 mijë djem të rinj e vajza të reja në qytete që arrijnë moshën për punë. Ku do t'i dërgojmë këta, të tërë do t'i futim të punojnë në fabrika? Sado që të ndërtohen fabrika, prapëseprapë këto nuk mund të thithin të tëra forcat e afta për punë.

Orientimi i Partisë është i tillë që uzinat e fabrikat tona të kenë rendiment sa më të lartë, prodhimi i tyre të jetë me kosto sa më të ulët dhe mallrat e prodhuara të jenë sa më të bukura. Që të arrihet ky orientim, është e domosdoshme që proceset e prodhimit në uzina e në fabrika të jenë sa më të automatizuara. Kjo do të thotë që këto të kenë nevojë për më pak punëtorë, ndërsa sistemimi i një pjese të fuqisë punëtore dhe shfrytëzimi i saj në dobi të atdheut e të socializmit do të bëhen në qytet, kurse pjesa tjetër do të punojë,

në radhë të parë, në bujqësi e pastaj në minierat tona.

Rininë ne duhet ta orientojmë politikisht dhe ta drejtojmë në mënyrë të organizuar nga fshati. Duhet t'i lëshohet një kushtrim rinisë sonë, duke dhënë edhe shembuj konkretë për iniciativat revolucionarë të punës në fshat, siç bëtë ju tani me rastin e dëmtimit nga breshëri. Të krijohet dëshira për të jetuar në fshat e për të punuar në bujqësi, se bujqësia është baza e ekonomisë sonë socialiste.

Vajtja për të punuar e për të jetuar në fshat e të rinjve dhe e të rejave, marrja e masave për strehimin e tyre atje është detyrë me rëndësi. Nuk mund t'i themi të riut: «Hajde, shko në fshat!», kur nuk i sigurojmë dot strehimin. «Po si të vete unë në fshat, kur atje s'kam vend ku të fut kokën?», mund të thotë me të drejtë i riu. Prandaj, shokë, duhet të bëjmë shtëpi banimi në fshatra. Për këtë gjë ne nuk po shqetësohemi fare. Më parë mendojmë të ndërtojmë shtëpi banimi për t'u zgjeruar familjet e strehuara në qytete, se diku martohet djali e diku rritet çupa, sesa shqetësohemi që të strehojmë në fshat njerëzit që shkojnë për të jetuar atje! Kur çupa dhe djali të venë në fshat, në vend që ta ndërtojmë shtëpinë për ta këtu në qytet, le ta ndërtojmë atje ku ata do të jetojnë. Kështu do të bëhet. Në këtë drejtim Partia do të lëshojë direktivë.

Kur po vija bashkë me Nexhmijen në Korçë, shikoja fshatrat anës rrugës, duke filluar që nga Çërrava e këtej më të poshtë. I thashë Nexhmijes: «Sikur të kisha mundësi të kthehesha edhe një herë në moshën 20 vjeç, do t'i lutesha Partisë të më dërgonte për të

punuar në fshat. Shiko se ç'kopshte me lule janë bërë, sa ara të bukura shtrihen buzë xhadosë! Në kohën e Partisë çdo gjë e bukur gjendet edhe në fshat».

Ka 30 e ca vjet që është vendosur pushteti popullor. Në fshatin tonë socialist tani kemi njerëz me kulturë (nuk e kam fjalën këtu vetëm për ata që kanë mbaruar universitetin, por edhe për të tjerët që kanë nxjerrë mësim nga jeta). Kemi vajza e djem të zgjuar e të shkathët që jetojnë e që punojnë në fshat. Një ditë isha në fushat e Rrogozhinës, qëndrova pak atje dhe nga arat u derdhën e më erdhën pranë me vrap vajzat e fshatit. Unë fillova bisedën me to. Nuk kishte asnjë prej tyre që të mos kishte mbaruar shkollën 8-vjeçare. Qenë vajza të zgjuara dhe secilës prej tyre i shkëlqenin syltë e i ndryste fytyra. Ato jo vetëm flisnin serbes (se sot kështu flet kushdo), por bisedonin me një qartësi politike të tillë sa m'u gëzua zemra.

Në goftë se njeriu vete me dashuri në fshat, atje af gjen mundësi të mëdha jo vetëm për punë, që është kryesorja, por edhe për mësim e edukim. Në fshat njeriu mund të lexojë e të studiojë sa të dëshirojë; ai ka mundësi që atje të zgjerojë horizontin politik e kulturor. Fshati është një qendër e bukur pune e jetese në vendin tonë socialist.

Natyrisht, ngritja e banesave për strehim në qytete nuk do të ndalohej, por do të kufizohet. Kur të ngremë banesat në fshatra dhe t'i kemi çelësat në xhep, do t'i themi të riut: «Do punë, more djalë? Shko në fshat, se atje je mirë, gjeje dhe nusen atje dhe qëndro përgjithmonë. Urdhëro edhe çelësin e banesës, ke apar-



tamentin tënd me një apo dy dhoma e kuzhinë, sipas përbërjes familjare». Këtë gjë duhet të bëjmë ne.

Përveç punës për edukimin e të rinjve me dashurinë për fshatin, duhet të bëhen edhe llogaritë në çdo rreth se sa forca pune të afta ka në qytete, qofshin këto të sistemuara ose jo me punë. Kjo të bëhet për të rinjtë gjer në njëfarë moshe që do të caktohet; në rast se ka nevojë për të ngritur e për të shkoqur misrin etj., do të dërgohen forca pune nga qyteti, si nga ato që janë të pasistemuara në punë, ashtu edhe nga të tjerat që punojnë në ndërmarrje, në institucione, në organizata etj. Punën e atyre që largohen përkohësisht nga ndërmarrjet, do ta kryejnë ata që mbeten aty dhe që nuk u dërguan në fshat.

Vajtja e punëtorit për një muaj ose 15 ditë në vit që të punojë në bujqësi realizon parullën «Bujqësia — çështje e të gjithë popullit». Kur bujqësia do të ketë nevojë me raste fushatash, bie fjala, për të grumbulluar kallinjtë, mund të dërgohen për 3-4 ditë edhe nxënësit e të rinjtë nga qyteti.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Në këtë drejtim mendoj se edhe shkollat janë një rezervë e madhe. Në vend që nxënësit ta bëjnë punën prodhuese në qytete, që disa herë e katandisin duke ngritur hekurishte, shumë mirë mund të venë që të punojnë në bujqësi, duke vajtur e ardhur brenda ditës, kur fshatrat janë afër, kurse në zona më të thella mund të organizohet puna ashtu si ajo e të rinjve që shkojnë për të punuar në hekurudhë, domethënë të qëndrojnë në fshat, duke ngritur atje çadra e mensa të thjeshta, natyrisht duke

realizuar e duke tejkaluar normat, që të mos u rëndën shtetit, ndërmarrjeve e kooperativave bujqësore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Atyre që venë për të punuar, kooperativa do t'u sigurojë vetëm ushqimin dhe fjetjen, duke u kërkuar zbatimin e normës ashtu siç i kërkohet kooperativistit. Çdo ditë të shënohet plotësimi i normës për secilin. Kur të mbarohet puna, kooperativa do t'i dërgojë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor përkatës evidencën e plotësimit ose jo të normës dhe komiteli nga ana e tij do t'ua shpërnda-jë qendrave përkatëse të punës me porosi që secilit t'i paguhet paga në raport me zbatimin e normës në bujqësi. Kooperativa nuk do të paguajë asgjë për shpërblimin e punës, se punonjësit që dërgohen në raste të tilla janë vullnetarë, ata që janë në marrëdhënie pune, pra do të paguhen nga shteti.

Në qoftë se këta vullnetarë nga qendrat e punës së qytetit shkojnë në kooperativën bujqësore që të bëjnë llogje, duke pretenduar se gjoja kanë vajtur atje më shumë për të bërë punë politike dhe e plotësojnë normën vetëm 30 për qind, t'u paguhet vetëm 30 për qind e rrogës, kurse 70 për qind e saj t'u ndalohej. Punën politike le ta bëjnë pas plotësimit të normës, se këshlu tregohet patriotizmi dhe kryhet me të vërtetë detyra ndaj atdheut.

Dobia e këtyre aksioneve nuk qëndron vetëm në anën ekonomike, por edhe në anën ideologjike. Këtë gjë, përveç të rinjve, duhet ta kuptojnë edhe prindërit. Edukimi i prindërve qytetarë me ndjenjën e patriotizmit ka rëndësi, se, kur të bëhet djali 20 vjeç e të

mbarojë shkollën e mesme, ata nuk do ta përkëdhelin si «djalin e mamasë», por do ta këshillojnë të vejë shpejt për të punuar në Plasë e në Panarit, se edhe atje është e bukur jeta etj. Duhet të punojë shumë Partia në mënyrë që korçari, gjirokastriti, shkodrani, dibrani e të tjerë, kur t'i këndojnë kalamanit në djep, t'i futin në shpirt dashurinë për bukurinë e fshatit dhe të punës në bujqësi. Po të ecet kështu, kur të rriten fëmijët, do të jenë të edukuar në mënyrë të tillë që të shkojnë pa hezitim në fshat.

Ne nënat e baballarët të mësohem! që të mos na vijë rëndë kur na ikën djali apo vajza në fshat. Pra, pse të ngulet këmbë që të martohet vajza patjetër në qytet, gjersa prindi pranon se ajo ka të drejtë ta gjejë vetë burrin? Pse të mos u vijë mirë prindërve në qytet kur vajza e tyre dashurohet me një djalë kooperativist, që është patriot, punëtor, i zgjuar, i shëndetshëm etj.? Sepse i pengojnë mbeturinat e së kaluarës, të atyre kohëve kur fshati përbuzej. Po t'i edukojmë me themel prindërit, këta do t'i thonë së bijës: «Shko në fshat, moj vajzë, e puno atje me ndershmëri si të mëson Partia!». Vajzës nuk ia ruan dot nderin prindi, duke u bërë çoban i saj. Në qoftë se ajo nuk është e edukuar të jetë serioze dhe e ndershme, në qoftë se nuk është e formuar politikisht, «do ta luajë bishtin». Djali po ashtu, bile ca më keq, nuk ruhet. Ombrella e babait dhe e nënës nuk janë kaq mbrojtëse sa ombrella e Partisë.

Shqipëria nuk është vetëm qyteti i Gjirokastrës apo ai i Korçës, por është tërë atdheu i shtrenjtë, pra

janë edhe fshatrat e Lunxhërisë e të Kukësit, prandaj prindi, i edukuar nga Partia, t'i thotë së bijës apo të birit: «Ngrihuni, ti vajzë e djalë, vishni këpucët e shkoni atje ku ka nevojë atdheu!». Që ta bëjnë prindërit këtë, duhet ta kenë edhe për vete këtë gatishmëri. Eksperienca e Korçës duhet të na shërbejë si shembull për ta përgjithësuar dhe për ta organizuar kudo, që të mund t'i plotësojmë mungesat për forca pune në fshat, derisa të bëjmë të mundur vendosjen e rinisë në fshatra, që ajo të punojë e të jetojë, duke krijuar edhe familje alje.

Ne tani do të ecim me plan, me perspektivë që të krijojmë bollëkun në fshat. Bujqësia duhet të jetë një nga burimet me rëndësi për eksportin tonë, kështu do të jemi në gjendje të kemi devizë të mjaftueshme për ekonominë. Kur të kërkojnë nga rrethet disa makina, që janë të nevojshme, atëherë edhe shteti do të thotë: «Posi, jua blejmë ato makina, se valutë kemi». Tani nuk kemi devizë të mjaftueshme për të blerë gjithçka që na nevojitet, sepse jemi të detyruar të importojmë bukën, kohë përpara, siç e dini, ishim të detyruar të sillnim edhe vezë nga jashtë.

Detyrat e mëdha që zëmë në gojë, duhet t'i kuptojmë thellë dhe të organizojmë njerëzit për t'i vënë në jetë. Po nuk bëjmë kështu, nuk e përballojmë dot pikun e prodhimit ose të punëve bujqësore.

Kooperativistët, nga ana e tyre, kur shikojnë që vëllezërit e vet punëtorë e nëpunës nga qyteti, duke shprehur ndjenjat e solidaritetit dhe të aleancës klasore dhe duke u përpjekur për rezultate ekonomike më të mira, vijnë e punojnë me vrull revolucionar në

fshat, duhet të kuptojnë se është nevoja që edhe vetë ata ta rritin sa më tepër rendimentin e punës e të shfrytëzojnë sa më shumë e më mirë kohën e punës.

Janë të drejta këto që ju them, more shokë, si thoni ju? (*Përgjigje njëzëri: «Janë shumë të drejta».*)

Unë doja të dija se ç'bëhet në kooperativën e Plasës me atë studimin që pamë edhe në Byronë Politike. Këtu nuk paska ndonjë nga kooperativa e Plasës, por, sidoqoftë, diçka mund të na thuhet.

*Pasi u fol për eksperiencën e kooperativës së Plasës, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Në industri kooperimin ne do ta zhvillojmë më shumë. Unë mendoj se ka mundësi që të studiohet edhe kooperimi në mes brigadave. A mendohet ndonjëherë në kooperativa se ekziston edhe kooperimi? Unë do t'ju këshilloja ju e, nëpërmjet komitetit të Partisë e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, shokët e Plasës, që çdo gjë, të cilën nuk e vërteton jeta ose që nuk përputhet me atë që kemi vendosur për metodën e punës, për qarkullimin e bimëve e për të gjitha të tjerat në studimin e Plasës, të na sinjalizohet. Pasi të sinjalizohemi, ne do t'ju japim përgjigje si të veproni. Këtë e them jo vetëm për punët në bujqësi, por për të gjitha gjërat e tjera.

Kanë rëndësi marrja e sinjalizimeve nga baza dhe përgjigjja e shpejtë nga qendra. Në qoftë se ju sinjalizoni dhe aparatet e organeve qendrore i marrin e i mbyllin në sirtar sinjalizimet tuaja pa ju dhënë përgjigje, atëherë drejtohuni deri edhe te sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë, të cilët do të vënë dorë me-

njëherë e do të kërkojnë llogari se çfarë bëhet për këtë gjë. Këto çështje janë serioze për Plasën, por edhe për ekonominë e tjera.

Kjo tani ka kaluar, por unë po i them këto vërejtje dhe perspektiva të përafërta ashtu si i mendoni ju.

Me këtë disbalancim që shikohet në rreth, si dhe me pasojat që rrjedhin, duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Bujqësisë dhe Komitetit Qendror të Partisë me një relacion të veçantë, pse edhe në lart kemi nevojë të informohemi që të kontrollojmë zbatimin e vendimeve ose të orientimeve.

Koço Theodhosi i merrte rregullisht informacionet për dështimet në naftë, ai ishte në dijeni të plotë për sabotimet që bënte grupi armiqësor i naftës, sepse vetë ky e drejtonte, por, kur shkonte në Qeveri, raportonte sikur të gjitha punët shkonin në rregull! Këtij armiku i bëheshin kritika në Qeveri që të përmirësonte punën, por as udhëheqja e Partisë, as Qeveria nuk dinin për situatën e vërtetë që ishte krijuar në naftë.

Ju bëtë studimin, por ne nuk mendojmë që ai të mbetet vetëm në Korçë. Në qoftë se ne vendosëm ta përhapim kudo eksperiencën e rrethit tuaj, si metodën më të mirë e më moderne të bujqësisë, Ministria e Bujqësisë duhet të interesohet se ç'del nga kjo eksperiencë dhe si mund të përballohet kjo situatë në tërë Shqipërinë. Po nuk veproi kështu ministria, atëherë mund të shkojmë me sy mbyllur. Prandaj ju duhet të jepni kurdoherë relacione të veçanta për këtë eksperiencë, e cila do të përhapet në të gjithë vendin.

Mos u kënaqni me një informacion të thjeshtë që mund t'i bëni shokut Miti Bozo<sup>1</sup>, kur ai ju vjen këtu, se nuk duhet të harroni që nganjëherë «*verba volant, scripta manent*»<sup>2</sup>. Është e domosdoshme që për çdo problem të rëndësishëm t'i bëhen informacione të rregullta udhëheqjes, sepse nëpërmjet tyre gjykohet për gjendjen e nxirren detyra.

Kështu, kur u mor vendim që kooperativa e Vloçishtit të merrte destinacion të caktuar për të zgjidhur ato nevoja që ka ekonomia për prodhimin e mishit dhe për t'u bërë intensive në këtë drejtim, unë nuk qeshë në Tiranë, por kur u ktheva morarelacionin që kishin bërë shokët, e lexova dhe isha dakord me vendimin e Byrosë Politike. Ana ekonomike është parë shumë mirë, vetëm se ajo duhet të realizohet.

Pse them që duhet të realizohet? Sepse kemi edhe eksperiencë të hidhur në këtë drejtim, se mbaj mend që shumë studime të tilla na kanë ardhur, kemi marrë vendime për këto studime, kemi investuar edhe miliona e miliarda lekë si, për shembull, për sistemimin e kullimin e tokave e për tharjen e moçaleve, por krahas sukseseve, si në Maliq e gjetkë, kemi pasur edhe mosrealizime. Edhe për ato çështje që sot kanë ngelur në mes të rrugës, natyrisht propozimet na kishin ardhur të shoqëruara me dokumente e me preventiva të llogaritur, sa njeriu bindej që propozimi duhej pranuar.

---

1. Në atë kohë punonjës në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë, që ndiqte çështjet e bujqësisë.

2. Latinisht: fjalët i merr era, e shkruara qëndron.

Kështu ndodhi edhe me Hoxharën, për të cilën Maço Çomoja<sup>1</sup>, në relacionin që bënte, «arsyetonte» kështu e ashtu dhe thoshte se «brenda tre vjetëve Hoxhara përfundon dhe ne do të nxjerrim shpenzimet e bëra». Por kanë kaluar kaq vjet dhe Hoxhara akoma nuk ka mbaruar.

Ose të marrim problemin e shkripëzimit të kënetës së Durrësit. U morën shumë masa për këtë qëllim, u bë në kanalizime, stacione pompimi e punime të tjera, duke na u thënë se nxjerrja e shpenzimeve do të bëhet në kaq e aq vjet etj. Ndërmarrjes Bujqësore në Sukth i janë dhënë në administrim tokat e kënetës së Durrësit. Kur vendosëm ne për t'i shfrytëzuar tokat e asaj kënete, unë i kisha flokët të zinj, tani mua këta më janë zbardhur, por akoma tokat nuk janë shkripëzuar! Po pse? Sepse këtë tokë e mori Ndërmarrja Bujqësore e Sukthit, e cila nuk e trajtoi mirë. Kjo tokë patjetër duhet shkripëzuar.

E thamë kënetën e Nartës, por kjo duhet shkripëzuar. Plane kemi bërë për këtë qëllim, bile kemi caktuar edhe kohën, por nuk po shkripëzohet, se nuk po vihet uji në zjarr.

Prandaj thashë unë që vendimi i marrë për Vloçishtin është i mirë, nga ai nuk besoj të humbasim, pra duhet zbatuar. Siç u tha këtu, atje paska disa vesh-tirësi, por këto duhen zgjidhur. Të mos ndodhë si për ato vendimet që përmenda, të cilat janë marrë shumë kohë më parë dhe nuk po realizohen. Për këto proble-

---

1. Ish-ministër i Bujqësisë, që më vonë u dënua nga gjyqi për krime kundër shtetit.



me këtej e tutje duhet vënë mirë uji në zjarr, se në dëmtimet që zumë në gojë kanë gisht armiqtë.

Ju thatë se në Bilisht ka katër kooperativa bujqësore. Emri i Bilishtit lidhur me punën është i mirë, atje punojnë shumë. Disa prej tyre kanë shkuar në Sukth. Nuk mund të them se këta që vajtën në Sukth nuk punojnë, por nuk më ka ardhur mirë kur dëgjova që atje nuk ka një organizim si duhet në punë.

Unë kam qenë disa herë në Bilisht dhe ruaj kujtime të mira nga një takim me disa kryetarë kooperativash bujqësore që u mblodhën në Vranisht<sup>1</sup>. Kemi ndenjur nën një tendë atje dhe biseduam shtruar me njëri-tjetrin. Besoj se që nga ajo kohë në Bilisht janë bërë përparime të mëdha.

Për sa i përket farës së patates, standardet duhen respektuar, por prodhimi nuk duhet penguar me pretendime absurde si ato të Kiço Ngjelës. Këtyre qëndrimeve u ngjet edhe kërkesa për prodhimin e patates standard. Me të vërtetë jashtë shtetit kërkojnë prodhime bujqësore standarde, por ka edhe atje prodhime që nuk i arrijnë standardet dhe, megjithëkëtë, ata i përdorin si ushqim. Në qoftë se bëjmë tregti si duhet e me një ndjenjë të lartë përgjegjësie për mallin dhe për djersën e popullit, atëherë punonjësit tanë të tregtisë, që kemi jashtë shtetit, duhet të përpiqen t'i shesin këto mallra. Natyrisht, ata nuk i shesin dot me çmimin e caktuar për mallin standard, por me një çmim një gikë më të ulët.

E mira është të krijojmë llojet tona të farërave,

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 44, f. 102.

prandaj, pasi të blejmë një elit, të mos blejmë më tjetër për çdo vit. Atyre që duan të blejnë çdo vit jashtë. t'u themi: «Puthuni me Milon!». Kjo nuk do të thotë të bëhemi autarkikë, por ne duhet të bëjmë kursime e të mos shpresojmë të rrojmë gjithmonë me farëra të jashtme që duan devizë çdo vit. Ekonomia jonë nuk mund të ecë në këtë rrugë.

Po punonjësit e industrisë si i kanë punët? Besoj se mirë. Keni shumë të dalluar të tjerë në këtë sektor si shoferin Spiro Lera<sup>1</sup>? Po në përgjithësi si duket industria? Keni ju këtu uzina të vogla për riparimin e traktorëve? Ku i keni ofiçinat stabël?

E dini pse pyes për këto çështje? Se ka ndodhur, jo vetëm këtu, por edhe në rrethe të tjera, që Ministria e Bujqësisë i ka shpërndarë tornot, pjalat, frezat e plot mjete të tjera nëpër kooperativa. Kjo ka qenë një mënyrë veprimi shumë e gabuar.

*SHOKU PILO PERISTERI*: Një ofiçinë e vogël, e pajisur me një morsë, mengene, një trapano e me ndonjë gjë tjetër duhet edhe nëpër kooperativa, por fjala është të mos mbahen makineri të rënda. Edhe atje ku i kemi makineritë e mëdha duhet t'i shfrytëzojmë mirë, se ato për atë punë duhen.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Drejt e ka shoku Pilo, çështja është që të shfrytëzohen mirë makineritë që kemi. Nuk mund të lejohet të kemi makineri dhe ato të mos shfrytëzohen si duhet. Në qoftë se shfrytëzimi nuk bëhet i plotë, atëherë këto duhen grumbulluar dhe puna e tyre të planifikohet. Mirë u tha këtu, ja tek janë

---

1. Hero i Punës Socialiste.

Korça me Dishnicën, atëherë pse duhet të kemi dy ofiçina kaq pranë njëra-tjetrës?

Lushnja ka gjashtë ofiçina të mëdha, po përse të ketë kaq? Unë mund të gabohem, ju, që punoni në bujqësi, e njihni më mirë problemin, por mendoj se do të ishte më mirë e më e leverdishme që në tri ditë një herë të vihej në dispozicion një «Gaz» e të shkonte në një ose në dy ofiçina për të marrë veglat e ndërrimit që janë në plan. Mua më duket se nuk ka përse të jenë gjashtë ofiçina, se këto nuk shfrytëzohen të gjitha si duhet.

Meqenëse po flasim për shfrytëzimin e mjeteve që kemi, dua të them se ne disponojmë një fuqi të madhe motorike traktorësh, që, natyrisht, duhen riparuar e duhen mbajtur në gjendje të mirë, por, që të arrihet kjo gjë, duhet njëkohësisht t'u përgatitim këtyre traktorëve edhe veglat e ndërrimit. Për veglat e ndërrimit kemi uzinën «Traktori» në Tiranë që e drejton shoku Pilo. Kjo uzinë ka arritur disa rezultate shumë të mira në shtimin e asortimenteve. Sa për qind të pjesëve të ndërrimit për traktorë bëni ju, shoku Pilo?

*SHOKU PILO PERISTERI:* Si numër bëjmë akoma pak, por si volum bëjmë një sasi të konsiderueshme të peshës së traktorit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pra, megjithëse bëjmë një sasi të konsiderueshme të peshës së traktorit, tani, përveç riparimeve, shtrohet çështja të bëhen akoma edhe shumë vegla të tjera ndërrimi. Ne duhet ta shfrytëzojmë në maksimum këtë uzinë që kemi për të riparuar traktorët dhe veglat e tjera të nevojshme për bujqësinë. Ky problem shtrohet tani, se nuk kemi mun-

dësi të sjellim vegla nga importi, mbasi nuk jemi kaq të pasur. Veç kësaj, duhet të përdorim mirë makinat që kemi. Nuk është e drejtë të sjellim makina të reja për të hedhur andej-këtej këto që kemi. Jo, këtyre që kemi, para se t'i zëvendësojmë, duhet «t'u nxjerrim vaj», siç u nxjerrin automjeteve që drejtojnë Spiro Lera, Shyqyri Kanapari<sup>1</sup> e të tjerë punonjës të dalluar.

Shpërndarja e uzinave dhe e ofiçinave që kemi të rishikohet me sy kritik, politik, patriotik dhe ekonomik. Pra, kërkohet të bëhet një shpërndarje e racionalizuar e makinerive dhe të kihet parasysh që shfrytëzimi i tyre të bëhet me dy e tri turne, që këto të jenë në gjendje t'u dalin mbanë të gjitha riparimeve dhe prodhimit të veglave për makineritë bujqësore.

Një problem shumë i madh është edhe ai i shfrytëzimit të industrisë sonë mekanike. Ju, shokë, mund ta dini gjendjen për rrethin tuaj, por unë mund t'ju them se në tërë Shqipërinë kemi një industri mekanike të fuqishme të pajisur me makineri moderne. Industrinë që kemi dhe këtë që po e ndërtojmë tashti, si edhe përtëritjen e zgjerimin e mjaft uzinave që kemi, duhet t'i shfrytëzojmë në maksimum për të përmbushur nevojat e ekonomisë sonë. E vërteta është se te ne ka uzina që punojnë me një turn ose me një turn e gjysmë, ka që punojnë me dy turne, por fare pak ka nga ato që punojnë me tri turne. Me këtë fuqi mekanike që kemi dhe me specializimin shumë të mirë të punëtorëve tanë, ne do të arrijmë suksese të mëdha.

Industria mekanike kërkon punëtorë të speciali-

---

1. Traktorist, Hero i Punës Socialiste.

zuar për kategori të ndryshme pune. Sa më i kualifikuar të jetë punëtori, aq më e mbaruar del vegla e ndërrimit.

Ne do të luftojmë që, këtë pesëvjeçar, të ndërtojmë fabrika edhe me forcat tona. Kështu, është në projekt që, me ndihmën e kësaj industrie që kemi, të ndërtojmë vetë fabrikën e sodës. Ne tani jemi në gjendje të ndërtojmë fabrika çimentoje etj. Punëtorët tanë mund të ndërtojnë fabrika. Ne kemi mundësi ta bëjmë të tërë traktorin këtu, por kjo gjë sot për sot nuk na leverdis, prandaj bëjmë pjesët e ndërrimit dhe do të punojmë për arritjen në një shkallë të atillë të zhvillimit të uzinave tona, sa të shtojmë në një përqindje të lartë prodhimin e pjesëve të ndërrimit në vend. Ne kemi fuqi mekanike të mjaftueshme për këtë qëllim dhe do ta organizojmë punën që të pakësojmë sa të jetë e mundur më shumë importimin e pjesëve të ndërrimit dhe të disa fabrikave.

Për të arritur sa thashë, na ndihmon Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, që do të jetë për ne buka e industrisë mekanike. Ai do t'u japë një hov kolosal zhvillimit dhe përparimit të ekonomisë sonë, për arsye se ne, duke i bërë në vend shumë gjëra që tash i sjellim nga jashtë, do të rikuperojmë shumë devizë. Nga provat që janë bërë rezulton se çeliqet që do të dalin nga ky kombinat, do të jenë të një kualiteti shumë të mirë.

Prandaj themi ne se perspektiva e zhvillimit tonë ekonomik është e mirë, por duhet të dimë t'i shfrytëzojmë racionalisht të gjitha këto burime materiale mekanike. Të mos shkojmë me mendimin që këto makineri t'i kemi këtu si rezervë dhe të mos i shfrytëzojmë

si duhet, por të gjykojmë më gjerë, të vështrojmë më larg, të shohim interesat e lartë të atdheut.

Për ushtrinë doja të thosha që të gjitha direktivat dhe udhëzimet e Partisë të kuptohen thellë dhe të zbatohen me përpikëri. Të keni parasysh se këto direktiva do të vihen në jetë edhe në momentet më të rrezikshme, kur ka mundësi që njerëzit edhe të hutohen etj. As ushtari, as oficeri, qoftë aktiv apo rezervist, nuk do të hutohet në rast lufte, po qe se këto direktiva dhe udhëzime që jepen nga Komiteti Qendror i Partisë kuptohen e zbatohen thellë qysh tani.

Në rast se ju e krijoni si duhet Shkollën e Lirë Ushtarake dhe ajo bëhet me të vërtetë themeli i punës suaj, atëherë sukseset e ushtrisë kompakte të popullit, e cila njihet armët, taktikën, strategjinë e luftës, dhe vendin pëllëmbë për pëllëmbë, do të jenë më të mëdha.

Njohja e terrenit ka rëndësi të jashtëzakonshme në kohë lufte. Armiku, që vjen për të na pushtuar, e njihet vendin me hartë, kurse ne e njohim më mirë atë, se e kemi shkelur mijëra herë me këmbë. Në këtë drejtim epërsia është në anën tonë. Ne e dimë ku është edhe ferra, kurse armikut, që nuk e di, siç thotë populli, «i duket Ibrahim».

Prandaj të gjithë këta faktorë, që janë në favorin tonë, të marrë në tërësinë e tyre, siç na mëson Lenini, e bëjnë ushtrinë me të vërtetë popullore. Ne kemi gjithë popullin ushtar, që njihet strategjinë dhe taktikën, zotëron përdorimin e armëve, shfrytëzon në maksimum terrenin dhe kohën. Prandaj ju oficerët, që jeni në pararojë të artit ushtarak, keni përgjegjësi të jashtëzakon-

shme për përhapjen e tij, se të tërë e në çdo kohë duhet të jemi gati.

Oficerët tanë të mos bazohen vetëm në njohjen individuale të terrceneve, por ata duhet të përdorin harta sa më të përsosura dhe t'i studiojnë ato me vëmendje të madhe që ta njohin vendin me pëllëmbë. Oficerët duhet të mësojnë përdorimin e hartave ushtarake dhe të dallojnë shenjat konvencionale të tyre, që të kuptojnë, për shembull, se këtu, në këtë gjerësi e gjatësi, në këtë kuadrat, qenka ngritur një bllok me shtëpi, këtu qenka një fabrikë e vogël etj., që ju i dini mirë.

Këto që përmenda unë me një frazë, nuk duhet të mësohen në formë libeske, sa për të kaluar radhën dhe për të thënë: «I kuptuam». Nuk mjafton kuptimi vetëm në libër, duhen bërë përpjekje serioze që këto çështje të kuptohen e të zbatohen në terren. Të ngulet këmbë për zbatimin konkret të atyre direktivave të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Mbrojtjes Popullore që lëshohen për ushtrinë.

Në kuptimin e direktivave për ushtrinë të punohet shkencërisht e me perspektivë për koordinimin e anëve të ndryshme të çështjes. Të studiohen problemet jo formalisht dhe shkel e shko, siç bënin për qëllime armiqësore Beqir Balluku, Petrit Dumja e Hito Çakoja, por Ministria e Mbrojtjes të punojë sistematikisht që t'ua bëjë të qarta oficerëve tanë, në radhë të parë, taktikat që do të përdorë armiku kundër nesh, metodat e luftës dhe strategjinë e tij.

Oficerët tanë janë njerëz të Partisë, të dalë nga Lufta Nacionalçlirimtare ose nga ajo e ndërtimit të socializmit, dhe nuk bien në panik nga forca mekanike

dhe armatimet e armikut. Them vetëm forcë mekanike, se forcë morale armiku ynë nuk ka. Megjithëkëtë, armiku nuk duhet nënvleftësuar, por ne jemi të fortë, terreni ynë është i favorshëm dhe i njohur nga ne, morali ynë është i lartë dhe, përveç këtyre, ne do të zbatojmë si duhet parullën e Partisë «Tërë populli ushtar». Këta faktorë që janë në favorin tonë dhe në dëm të armikut, duhet t'i njohim.

*Pasi foli për taktikën që mund të përdorë armiku kundër nesh, si dhe për taktikën tonë në rast agresioni, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Organizata e Bashkimeve Profesionale ka shumë detyra. Për to u fol edhe këtu. Unë doja të thosha pak gjëra për kontrollin punëtor. Udhëzimet e reja të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë nuk e kanë formuluar përfundimisht mënyrën se si do të organizohet më mirë ky kontroll. Lenini është gjeniu i madh i proletariatit botëror, prandaj, për të mos gabuar, ne duhet të bëjmë përpjekje ta studiojmë veprën e tij jo radhë më radhë, por fjalë për fjalë dhe germe për germë. Një fjalë e tij duhet të zgjojë te ne ide të shumta për kuptimin e madh ideologjik dhe organizimin sa më të përsosur të zbatimit të një problemi në kushtet e vendit tonë. Lenini nuk e ka ditur se si dhe kur do të bëhej Shqipëria komuniste, por gjenialiteti i teorisë së tij dhe i asaj të Marksit qëndrojnë në vlerën universale që kanë ato për t'u zbatuar sipas realitetit të çdo vendi.

Parimet e teorisë marksiste-leniniste nuk duhen shkelur kurrë. Ato, sikurse na mëson Lenini, duhen zbatuar në përputhje me kushtet që krijohen. Në veprat e Leninit ekzistojnë dy materiale të rëndësishme,



në bazë të të cilave Partia jonë e ka trajtuar çështjen e kontrollit punëtor. Lenini, duke udhëzuar Stalinin lidhur me këtë çështje, ka hapur perspektiva të mëdha. Kur flet ai për kontrollin punëtor, thotë se ky kontroll duhet të jetë i përhershëm dhe jo të ngrihet e të veprojë si të qëllojë, jo të organizohet me pjesëmarrjen e pesë ose dhjetë vetave, por të marrin pjesë në të me mijëra veta dhe më shumë. Në këto kontrolle, porosit Lenini, të tërhiqen me shumicë gratë, të cilat të organizohen dhe të udhëzohen nga bashkimet profesionale, nën udhëheqjen e Partisë.

Kur kontrolli i klasës, i drejtuar nga Partia, vete në një dyqan dhe thotë: «Tani do të kontrollojmë të gjithë dyqanin, prandaj të pezullohet shitja», urdhri i tij është i detyrueshëm për cilindo. Ky kontroll është i gjithanshëm dhe shtrihet jo vetëm në anën teknike, por edhe në atë financiare, të zbatimit të planit etj. Kontrolli i klasës ka të drejtë të hapë për kontroll dokumentacionin dhe të japë udhëzime të detyrueshme për zbatim. Pasi arrin në konkluzione për punën dhe njerëzit që kontrollojnë, kontrolli i klasës i raporton komitetit të Partisë për detyrën që i është ngarkuar dhe i parashtron mendimet e tij, bie fjala, se në këtë ndërmarrje puna është në rregull, kurse në atë institucion nuk është në rregull, pasi ky dhe ai nuk punojnë mirë, prandaj të zëvendësohen dhe në vend të tyre të vihen këta punonjës, se pamë që ishin revolucionarë, punëtorë dhe të aftë.

Kur e shtroi Lenini problemin e kontrollit të klasës, kolkozet sapo ishin ngritur dhe, ndonëse ishin akoma në fillim, ai rekomandonte që të futeshin në kon-

trolle edhe fshatarët, kurse ne nuk i kemi futur fshatarët, megjithëse tashti kooperativat tona janë shumë më përpara nga ç'ishin kolkozet atëherë. Pra, është e domosdoshme që në kontrollin punëtor të marrin pjesë, përveç punëtorëve e grave, edhe fshatarët. Nuk përjash-tohen as intelektualët, por jo zyrtarë, pra, jo ata që kanë në dorë drejtimin, sepse këta mund të fshehin të metat e vetes.

Nën udhëheqjen e Partisë masat duhet të ushtrojnë në kontrollin. Kjo formë e organizuar kontrolli klasor, natyrisht, do të vijë më e konkretizuar me kalimin e kohës, kur të fitojmë më tepër eksperiencë, se tashti na qëllon që shkohet për të kontrolluar këtë ose atë sektor pune jo në të tëra drejtimet, por në disa sfera të përcipta dhe vetëm me pesë veta, në vend që të aktivizojmë me dhjetëra e qindra veta.

Partisë kurdoherë i janë paraqitur detyra të mëdha për të zgjidhur dhe ajo i ka plotësuar me nder këto detyra. Klasa punëto-re, fshatarësia kooperativiste dhe shtresa e inteligjencies, në unitet të plotë me njëra-tjetrën dhe nën udhëheqjen e Partisë, çdo vit, çdo pesëvjeçar kanë bërë përparime të mëdha në industri, në bujqësi dhe në ngritjen e kulturës së popullit. Arritjet tona janë të dukshme. Niveli kulturor i masave dhe veçanërisht niveli ideopolitik, që ka rëndësi të madhe, janë ngritur shumë. Megjithëkëtë puna e Partisë duhet ngritur në një nivel akoma më të lartë, sepse kështu e kërkojnë situatat e brendshme dhe ato ndërkombëtare.

Vetëm atje ku në fuqi është klasa punëto-re dhe Partia e saj marksiste-leniniste, ka stabilitet dhe ai

vend e ka situatën e brendshme të fortë. Populli e do dhe çdo ditë e më shumë e forcon Partinë. Sa më afër popullit të jetë Partia, sa më shumë t'i dëgjojë ajo këshillat e tij, duke i bërë këto gjakun e vet dhe duke i vënë në jetë, siç po i vë, aq më tepër situata jonë e brendshme jo vetëm do të jetë e qëndrueshme, por do të forcohet e do të mbetet e pathyeshme, sikurse është edhe tashti. Nuk ka armiq që të jenë në gjendje ta tronditin sadopak Partinë tonë.

Dy gjëra kryesore kërkohen në këtë drejtim: së pari, të forcojmë situatën brenda vendit, duke zhvilluar ekonominë, si industrinë dhe bujqësinë; së dyti, të forcojmë mbrojtjen. Këto dy kërkesa janë të lidhura. Në qoftë se i kuptojmë këto dhe vëmë të gjitha forcat, atëherë punët do të na ecin mirë e do të shkojmë gjithmonë përpara.

Në vendin tonë klasa punëtore është në fuqi. Kjo udhëhiqet nga Partia e saj, që është maja e mprehtë e shpatës së klasës. Partia, siç e dini, udhëheq klasën dhe masën sipas parimeve të Marksit. Unë nuk dua t'ju bëj këtu një kurs teorik, se këto ju i dini. Teorinë e Marksit e të Leninit ka ditur ta zhvillojë në mënyrë të shkëlqyer Partia. Tërë komunistëve që përbëjnë Partinë, qofshin në bazë a në qendër, u takon merita që kanë ditur ta zbatojnë e ta zhvillojnë në teori e në praktikë këtë doktrinë të fuqishme revolucionare të proletariatit. Partia jonë nuk e ka lënë në mes të rrugës dhe nuk e ka tradhtuar marksizëm-leninizmin siç e tradhtuan revizionistët në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera ku janë në fuqi renegatët. Klasa punëtore, me partinë e saj, duke qenë në udhëheqje, e kanë

ngritur popullin në një nivel të atillë politik dhe ideologjik, kanë forcuar aq shumë demokracinë e vërtetë proletare, sa masat punonjëse marrin pjesë gjallërisht në qeverisjen e vendit, në zbatimin krijues të direktivave të Partisë.

Pa pjesëmarrjen e gjerë të masave punonjëse në jetën politike të vendit, pa eksperiencën e tyre të pasur në ndërtimin tonë socialist, nuk mund të zbatohet me sukses teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit. Ja, të tërë e dimë se çfarë ngjau në Bashkimin Sovjetik, ku revizionistët mënjanuan dalngadalë masat popullore prej punëve të shtetit dhe prej politikës. Nuk ishte vetëm punë prej një grupi konspiratorësh ajo që shkaktoi tragjedinë e Bashkimit Sovjetik, por ajo që shkaktoi katastrofën atje ka qenë, në radhë të parë, lënia pas dore në mënyrë sistematike e parimeve marksiste-leniniste, që bëhej pa dijeninë e Stalinit. Po si ishte e mundur të ndodhte kjo gjë pa dijeninë e Stalinit? Po, ishte e mundur. Stalini që njeri i madh, marksist-leninist i shquar, por kishte përreth edhe tradhtarë, që jo vetëm nuk ia thoshin të vërtetën, por në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër dredharrake i mbulonin poshtërsitë që bënin.

Tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e të tjerë përpiqeshin të bllokonin Komitetin Qendror të Partisë, që Partia jonë të mos e merrte vesh si duhej se ç'po bënin ata. Gjersa një veprimtari e tillë nën rrogos u zhvillua edhe në Shqipëri, ca më tepër ajo mund të zhvillohej në Bashkimin Sovjetik, ku konspiratorët u ishin shmangur, në radhë të parë, zbatimit të

të gjitha parimeve leniniste, teorisë së partisë e luftës së klasave.

Partia jonë për të gjitha këto arsye ka nxjerrë shumë mësim nga disfata në Bashkimin Sovjetik. Eksperienca jonë në luftën kundër armiqve është e madhe, por, sado e pasur të jetë eksperienca, përsosmëria nuk ka kufi. Dita-ditës ne gjejmë forma të reja lufte e pune dhe e pasurojmë gjithnjë eksperiencën tonë. Në Bashkimin Sovjetik ishte arritur të krijohet një situatë e tillë ku agjentët e KGB-së nuk pyesnin fare për komunistët, bile anëtarët e partisë atje kishin frikë të hapnin gojën, lëre pastaj të kritikonin. Pëshpëritej kudo vesh më vesh në masat punonjëse dhe në organizatat-bazë: «Ruaju nga KGB-ja, se partia nuk ka si të mbron!», «Ne jemi partia!», thoshin me mendjemadhësi punonjësit e KGB-së.

Komiteti Qendror, nëpërmjet materialeve të plenumeve të tij, ju ka vënë në korent për veprimtarinë e armiqve të Partisë, të cilët organizuan një komplot kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Ky komplot u likuidua pa asnjë lëkundje brenda një kohe të shkurtër. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon forcën e madhe të Partisë, forcën e madhe të popullit, kuptimin e lartë politiko-ideologjik të detyrës për mbrojtjen e diktaturës së proletariatit dhe për zhvillimin e luftës së klasave. Populli ynë e di se te ne në fuqi është klasa, ai di, gjithashtu, se në procesin e ndërtimit të socializmit, rrugës dalin edhe armiq, nga të cilët ne nuk tundemi, por i kapim, u kërkojmë llogari dhe i dënojmë sipas ligjeve të diktaturës së proletariatit.

Ky ishte një komplot i madh dhe tepër i rrezikshëm. Veprimtaria e tij, ku më shumë e ku më pak, shtrihej edhe në ekonomi e sidomos në industrinë e naftës, se armiqtë e dinë që nafta është një sektor jetik i vendit tonë.

Beqir Balluku me grupin e tij kishin arritur të vepronin gjer në atë shkallë sa në raportet që u kërkonin herë pas here Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria, t'u kalonin anash shumë çështjeve. Armiqtë organizonin kështu heshtjen për ato probleme që mund t'i demaskonin. Në radhët e oficerëve patriotë ata kishin krijuar përshtypjen e rreme sikur çdo gjë që thoshin ata, e kishte miratuar udhëheqja!

Ne nuk dinim gjë për këtë komplot, për arsye se nuk kishim të dhëna, por kishim vënë re se në raportimet që bënin Beqir Balluku e grupi i tij, binin në sy edhe të dhëna që nuk dukeshin shumë reale. Në ushtri kishin ndodhur shumë ngjarje të jashtëzakonshme, aksidente të ndryshme, që mund të evitoheshin etj. Kur na erdhi në Byronë Politike një raport vjetor, ku thuhej që në ushtri ishte rritur numri i aksidenteve, ne u shqetësua shumë. «Ku po shkojmë kështu? — pyetëm. Pse nuk e nxirrni vetë konkluzionin se në radhët e ushtrisë nuk ka rregull e disiplinë, për sa kohë që ndodhin gjëra të tilla?». «Është e drejtë vërejtja juaj, këto janë gabime të mëdha, por ne ju sigurojmë se kemi marrë e do të marrim masa», thoshin me një gojë Beqir Balluku, Petrit Dumja e Hito Çakoja. Këto ishin gjëra konkrete që flisnin për një situatë jo të shëndoshë në ushtri.

Direktivat e Komitetit Qendror të Partisë dhe Te-

zat e Këshillit të Mbrojtjes synonin për ta bërë ushtrinë tonë një ushtri me të vërtetë popullore, me qëllim që të likuidohej fryma e kastës së ushtrisë hrushoviane revizioniste. Këto direktiva dhe teza, për aq sa njihe-shin, se armiqtë i mbanin të mbyllura në kasaforta, u përqafuan nga shumica dërrmuese e ushtarakëve tanë. Vetëm krerët e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore ishin kundër ideve të Partisë për ushtrinë, por duke mos pasur kurajë të dilnin hapur, se kështu do të zbuloheshin, ata hiqeshin sikur ishin dakord. Në raportet që i vinin udhëheqjes së Partisë armiqtë shkruanin sikur punonin për të vënë në jetë direktivat e Partisë. Këto aspekte ishin vetëm njëra anë e çështjes.

Ana tjetër e saj ishin përpjekjet e armiqve për të demoralizuar ushtrinë dhe për të futur një frymë borgjeze në marrëdhëniet midis oficerëve e ushtarëve. Edukimi ideopolitik dhe ushtarak, që bëhej në ushtri, ishte aq formal, aq i shkëputur nga çështjet ushtarake, sa në radhët e ushtrisë ishte krijuar një gjendje apatie. Në marrëdhëniet epror dhe deplor ishin kultivuar arroganca dhe mendimi që si eprori nuk ka të tjerë. Kjo gjendje nuk shfaqej në të njëjtën shkallë tek të gjithë oficerët, por vinte me gradacione: sa më larg bazës të shkoje, aq më tepër arrogantë e prepotentë, impozantë, të favorizuar e të degjeneruar do të ndeshje. Organizatat-bazë të Partisë, ku bënë pjesë këta armiq, nuk ishin çerdhe revolucionarësh, por qenë shndërruar në organizma amorfë.

Tradhtarët kishin futur ndjenjën e frikës te kuadri. Ushtarakët, kur shikonin që drejtuesit e tyre kryesorë në ushtri, të cilët ishin anëtarë të Komitetit Qe-

ndror të Partisë, kryenin veprime që vinin ndesh me vijën e Partisë, mendonin: «Të tërë këta shokë nuk duhet të jenë të këqij, ndoshta ne mund të jemi të gabuar!». Për t'iu imponuar vartësve, armiqtë praktikonin të folurit me arrogancë dhe marrjen e masave të shpejta disiplinore.

Unë mund t'ju them më pak gjëra nga sa dinë shokët ushtarakë që i kanë jetuar situatat drejtpërdrejt. Nga analizat që janë bërë, ka rezultuar që armiqtë në ushtri kanë qenë jo vetëm tradhtarë, por edhe të pazotë. Beqir Balluku përgatiste prej kohësh antitezat e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes. Ne, që në fillim, kur i ramë në gjurmë kësaj veprimtarie, e dinim se ai nuk ishte i vetëm, por ishte taktika e Komitetit Qendror ajo që të krijohej përshtypja tek armiqtë sikur udhëheqja mendonte që Beqir Balluku ishte vetëm në këtë veprimtari të ndyrë.

Ne, sa pamë, kur i thonë fjalës, «majën e veshit», menjëherë hodhëm dorën. Petrit Dumja, Hito Çakoja hiqeshin sikur nuk kishin qenë në marrëveshje me Beqir Ballukun, sikur nuk kishin kuptuar se ç'po bënte ai. Beqir Balluku, nga ana e tij, nuk i denoncoi bashkëpunëtorët, se donte t'i mbronte që të vazhdonin nën rrogos veprimtarinë armiqësore. Ne ishim të sigurt që ata ishin bashkëpunëtorë të komplotit, se këta kishin vendosur bashkërisht të rishikoheshin Tezat, domethënë, të korrigjoheshin ato dhe të hartoheshin antitezat.

Kur u bë mbledhja e oficerëve në Durrës, Petrit Dumja e Hito Çakoja kapardiseshin si shpëtimtarë të situatës. Të tërë këta ishin shumë të poshtër, se të tërë



ishin pjesëtarë të komplotit të organizuar. Edhe Muhamet Prodani e Vaskë Gjinoja dhe disa nga ish-oficerët kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes ishin dakord me antitezat. Në momentin kur ne e zbuluam Beqir Ballukun, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja nxituan të shkonin e t'u thoshin bashkëpunëtorëve: «Ne jemi kundër Beqirit». Të tëra këto fakte zbulohen tashti, kur ata i pohojnë edhe vetë në hetuesi. Komiteti Qendror i Partisë i parashikoi drejt lidhjet midis armiqve. Me gojën e tyre këta tradhtarë po vërtetojnë ato konkluzione që nxori Partia për veprimtarinë e tyre.

Drejtimit e veprimtarisë armiqësore nuk ishin vetëm këto që përmendëm. Ne vërejmë se në radhët e oficerëve armiqtë kishin nxitur neglizhencën në mirëmbajtjen e armatimit, kishin përhapur frymën e moszbatimit të direktivave të Këshillit të Mbrojtjes. Tashti shokët tanë oficerë po i ndjekin një nga një këto çështje për t'i kontrolluar mirë edhe për ato punë që janë kryer, por që s'janë bërë si duhet.

Nuk duhet të mohojmë se ka dhe gjëra që janë bërë mirë në ushtri. Për këto të mira kanë ndikuar shokët oficerë që kanë pasur mendimet e tyre të drejta, strategjike e luftarake. Këta shokë, që janë aq të zotë sa dinë të parashikojnë nga do t'u vijë armiku dhe ku duhet përqendruar mbrojtja etj., e kanë kuptuar drejtësinë e vijës së Partisë në ushtri. Por është fakt se në ushtri kanë komanduar armiqtë. «Hajde, hajde, të bëjmë kështu, se kështu duhet. E dimë ne këtë gjë», thoshin Petrit Dumja e Beqir Balluku. Dhe bëhej si thoshin ata, se ishin përkatësisht zëvendësministër e shef i Shtabit dhe ministër i Mbrojtjes.

Përveç neglizhencës për edukimin e efektivit nga ana politike e morale, në ushtri që neglizhuar edhe vendosja e një përpjesëtimi të drejtë midis llojeve të armëve, për shembull, të artilerisë, këmbëtorisë, tankeve, aviacionit, xhenios etj., etj. Armiqtë i kishin shkatërruar me qëllim armiqtësor këto përpjesëtime. Në zbatimin në kompleks të të gjithë sabotimit të mbrojtjes, në momentin që do t'u jepnin urdhër padronët e tyre (që, siç del, kryesorë ishin sovjetikët), shpërpjesëtimi i llojeve të armëve do të ndikonte në dëmin tonë. Pra, veç teorisë së kundërtzave, që predikonte tërheqjen në male në momentin e agresionit armik, për të mos e mbrojtur vendin në formë të organizuar etj., ishin gjetur e ishin praktikuar edhe mënyra të tjera sabotimi. Mirëpo armiqtë nuk ia arritën dot qëllimit.

Krahas veprimtarisë armiqtësore në ushtri, ka ekzistuar edhe ajo në ekonomi. Sabotimi ekonomik ishte i bashkërenduar me atë ushtarak.

Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi janë dy sabotatorë kryesorë të ekonomisë sonë popullore. Ata ishin për vetadministrimin jugosllav. Abdyl Këllezi ishte për decentralizimin e ekonomisë sonë dhe gjer diku, në ndonjë drejtim, ia kishte arritur këtij qëllimi.

Pra, armiqtë, në të njëjtën kohë kanë përdorur dy taktika kundër nesh: Njëra është ajo e organizimit të puçit ushtarak, që synonte bllokimin e Komitetit Qendror të Partisë, shkëputjen e tij nga ushtria, dhe tjetra ishte taktika e sabotimit ekonomik. Që të dyja këto udhëhiqeshin nga një qëllim i vetëm: Të invadohej Shqipëria.

Abdyl Këllezi me të gjithë njerëzit e tij, nën eti-

ketën e «përpjekjeve» për gjoja zhvillimin e ekonomisë sonë, hiqej si specialist i madh i ekonomisë dhe bridhte nga të katër anët për të dhënë «udhëzime». Ai na thoshte shpeshherë: «Këtë ta bëjmë kështu e atë ta bëjmë ashtu, unë mendova kështu ose ashtu». Por ne nuk i hanim dredhitë e tij dhe disa herë i ishim kundërvënë megalomanisë së tij të shfrenuar. Megjithatë, ai prapëseprapë përpiqej të decentralizonte ekonominë. Kështu arriti të krijonte një numër të madh institutesh dhe linjash që nuk ishin rentabël dhe të mbushte aparatet me njerëz që rrinin kot.

Taktika e armiqve ishte pritmëria, decentralizimi i ekonomisë dhe krijimi i një situatë euforike. «Si ne nuk ka vend tjetër, ne kemi naftën e dynjasë», thoshin ata. Plani që bënte Abdyl Këllezi për shpimin e puseve parashikonte miliona lekë shpenzime, por puset e hapura përmbyteshin nga uji. Sabotatorët e naftës kanë pohuar se ata kishin planifikuar, sipas urdhrave të sovjetikëve, që të mos i jepnin fusha të reja nafte Shqipërisë. Vendi ynë ka naftë dhe ne do ta gjejmë atë patjetër, por duhet të përpiqemi të fitojmë kohën e humbur.

Ndonjë mund të thotë: «Po mirë, si shpjegohet që ne kemi arritur suksese në ekonomi?». Është e vërtetë që kemi arritur shumë suksese, por kjo u detyrohet politikës së drejtë të Partisë, punës vetëmohuese të klasës punëtore e fshatarësisë kooperativiste, vrullit të tyre dhe jo vullnetit «të mirë» të armiqve.

Armiqtë nuk mund ta ndalonin menjëherë përparimin tonë, se ballë për ballë kundër nesh ata nuk dilnin dot, pasi akoma kishin nevojë të fshiheshin për

të krijuar organizmat që u duheshin për të futur një frymë të sëmurë në ekonomi, për të krijuar atë mentalitet, atë burokraci, që një mëngjes, kur tradhtarët në ushtri të bënin goditjen, edhe organizimi i ekonomisë të ishte i parapërgatitur për rrugën revizioniste.

Edhe Fadil Paçrami, Todi Lubonja e bashkëpunëtorët e tyre në fushën e ideologjisë e të kulturës kishin po këtë vijë. Tashti po dalin lidhjet e fshehta që kanë ekzistuar midis armiqve dhe po pasurohet tabloja e veprimtarisë armiqësore.

As populli, as komunistët nuk duhet të humbasin durimin e të thonë: «Çfarë bëhet me armiqtë, pse nuk po gjykohen sa më parë?». Partia do të zbulojë edhe rrënjët më të imëta, sado të thella që të jenë, që të mund t'i shkulë edhe ato. Armiku tashti dridhet nga frika dhe bën sikur fle, ai pret rastin që neve të na bjerë vigjilenca e të riaktivizohet.

Partia e ka për detyrë t'i zbulojë të gjithë këta armiq, prandaj ecën me kujdes dhe vepron me drejtësi të madhe. Ajo e di kush është i lig e kush është i gënjer, kush është i ndreqshëm e kush i pandreqshëm.

Neve na vijnë mjaft letra nga populli. Këto janë një thesar i madh. Nëpërmjet tyre Partia komunikon çdo ditë me masat. Kjo mënyrë komunikimi është një formë e demokracisë socialiste. Partia ka thënë nga-hera që njerëzit t'i shkruajnë deri edhe Komitetit Qendror të Partisë, duke shprehur haptazi çfarë kanë. Shumica e letrave që na kanë ardhur i kanë sjellë një shërbim të madh Partisë, se nëpërmjet tyre njerëzit na kanë vënë në dijeni, veç të tjerave, edhe për disa persona që veprojnë në kundërshtim me ligjet, me

rregullat dhe me udhëzimet e Partisë e të shtetit. Të gjitha aktet e parregullta populli i sheh dhe bën shumë mirë që i denoncon.

Ne duhet të jemi të lumtur që veprojmë nën dritën e «projektorëve» të popullit. Nuk është marksist i mirë ai që i vriten sytë nga «projektorët» e popullit. Në qoftë se punon në rregull, je i kënaqur që populli ta shikon punën tënde të ndershme, përkundrazi, në qoftë se ke gabuar, por je marksist i mirë, nuk do të kesh frikë kur të thotë populli se këtu s'je në rregull. Në një rast të tillë do t'i thuash popullit: «Falemnderit shumë për kritikën» dhe do të zotohesh sinqerisht se nuk do ta përsëritësh më gabimin. Po të jesh i lig, bën shumë mirë populli që t'i zbulon ligësitë. Nga letrat që kemi marrë, kemi zbuluar shumë gjëra jo vetëm për armiqtë në ushtri, por edhe për të tjerët jashtë ushtrisë.

Nuk përjashtohet që në disa nga letrat, që i janë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë, ka pasur edhe shpifje, por prapëseprapë forca e Partisë dhe e demokracisë sonë ka bërë që shpifësit të dridhen përpara popullit, duke dhënë llogari përse kanë shpifur në letër drejtuar Partisë. Populli i ka thënë shpifësit: «Ti i ke shkruar shokut Enver ose Komitetit Qendror të Partisë se kryetari i kooperativës është njeri i lig, duke kujtuar se ata, duke marrë llafet e tua për prova, pa bërë asnjë verifikim, do t'i presin kokën këtij. Tani hajde këtu para nesh, popullit të fshatit, dhe vërtetoji me fakte akuzat që ke ngritur, ndryshe do të përgjigjesh për shpifje!». Nga ky qëndrim i drejtë ballafaqimi para popullit, intrigantët dhe shpifësit e kuptuan se nuk u shkon dot ligësia dhe morën frikë. Ata që u

demaskuan publikisht si shpifës, populli i njohu se cilët janë e ç'qëllime kanë.

Nga ushtria dhe nga shokët oficerë, për të mos thënë kurrë, rrallë e tek merrnim letra. Disa letra që kemi marrë, kanë qenë të lidhura thjesht me çështje personale, duke pretenduar se më bënë këtë e më bënë atë. Nga këto ankesa disa ishin të drejta e disa të padrejta. Ne nuk i linim kurrë në heshtje këto letra. Ashtu siç dërgonim për verifikim letrat në terren, ne i dërgonim edhe në ushtri, mirëpo edhe ai që na shkruante për diçka personale, shumë herë dilte që kishte ndonjë të metë, ishte i padisiplinuar etj. Megjithëkëtë, nuk mund të mohohet fakti se edhe ndaj kuadrove të shëndoshë të ushtrisë armiqtë kishin mbajtur qëndrime krejt të paarsyeshme.

Situatat në botë janë të vështira. Dy superfuqitë, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, në veprimtarinë e tyre minuese e diversioniste përpiqen të përmbysin qeveritë që nuk u binden, duke ndërhyrë nga brenda. Qëllimi kryesor i tyre është të aktivizojnë agjentura dhe të rekrutojnë tradhtarë në vende të ndryshme për t'i përdorur në grushtet e shtetit që organizojnë. Ata nuk mungojnë të sulmojnë edhe nga jashtë, në disa koniunktura kryejnë edhe akte të hapura agresive, siç bënë revizionistët sovjetikë me Çekoslovakinë, por kjo rrugë u kushtoi shtrenjtë, prandaj kësaj gjëje i ruhen deri në njëfarë shkalle. Bashkimi Sovjetik ndërhyri brutalisht në Çekoslovakia, se atje nuk pati kundërshtim me armë. Po të kishte krisur pushka në Çekoslovakia, kjo do të kishte shkaktuar

një katastrofë për Bashkimin Sovjetik, por populli çek nuk luftoi, se Partia «Komuniste» e Çekoslovakisë, që duhej ta organizonte, kishte ngritur duart me kohë përpara udhëheqjes revizioniste sovjetike.

Armiqtë imperialistë amerikanë dhe revizionistët sovjetikë e dinë mirë se kush është Shqipëria socialiste, sa e fortë është situata në Shqipëri, prandaj duhet të maten shumë para se të ndërmarrin një aventurë të tillë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik, secili për vete, duan të sundojnë botën. Ata kanë antagonizma e rivalitete në mes tyre, por kanë edhe marrëveshje e bashkëpunim. Në këtë përpjekje ata duan t'i vënë këmbën njëri-tjetrit, por njëkohësisht nuk duan të ballafaqohen, pse ballafaqimi midis tyre do të shkaktonte shpërthimin e luftës atomike, që është e rrezikshme për secilën palë. Pra, luftës atomike ata i shmangen, duke mos i futur duart njëri aty ku i ka vënë më parë tjetri. Megjithëkëtë, as njëri, as tjetri nuk heqin dorë nga synimi për hegjemoni, për të zënë tregje, për të mbajtur popujt nën zgjedhë politikisht dhe ekonomikisht.

Në Evropë imperialistët dhe revizionistët duan të likuidojnë pushtetin popullor të Shqipërisë socialiste. Këtë duhet ta kemi shumë të qartë. Në radhët e para të armiqve të Shqipërisë qëndrojnë klikat sunduese të Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shqipëria ka një pozitë strategjike me rëndësi në Ballkan dhe vendeve të Evropës Perëndimore u intereson që ky vend të jetë i pavarur, sepse kështu, për disa, do të jetë një luftëtar kundër socialimperializ-

mit sovjetik, kurse për të tjerët kundër imperialistëve amerikanë.

Shqipëria është një vend me të vërtetë i pavarur dhe socialist. Ajo, pavarësisht se ka armiq të mëdhenj e të fuqishëm, ka guxim të thotë të vërtetën copë. Ky guxim i Shqipërisë rrjedh nga udhëheqja e drejtë e Partisë sonë, nga pozitat e forta të kësaj Partie të klasës punëtore dhe nga zbatimi me përpikëri i teorisë së Marksit e të Leninit. Marksizëm-leninizmi e bën Partinë tonë që t'i gjykojë realisht e drejt situatat ndërkombëtare, të kuptojë saktë qëllimet që ka gjithsecili në marrëdhëniet me të, të çmojë mirë tratativat dhe të parashikojë ç'rezultate do të nxjerrë njëra apo tjetra.

Opinionin botëror revolucionar dhe ai borgjez përparimtar ka respekt për ne që i themi haptazi e në kohën e duhur mendimet tona për të vërtetën dhe të drejtën. Ky opinion, që admiron trimërinë e Shqipërisë, përpiket ta mbrojë këtë vend. Edhe pa qenë komunist, ai borgjezi që është përparimtar, shikon shumë gjëra që i leverdisin në qëndrimet e Partisë sonë. Meqë ai nuk flet dot vetë për ato që ndien, për shembull, kundër Bashkimit Sovjetik si shtet agresor, i pëlqen guximi i shqiptarit. Duke vepruar kështu, domethënë duke i demaskuar haptazi superfuqitë, ne i thellojmë kontradiktat në mes tyre dhe njëkohësisht ndihmojmë shtetet relativisht të vogla që duan të këputin zinxhirët që i lidhin me këto superfuqi. Kështu krijojmë një opinion të drejtë ndërkombëtar dhe një simpati të madhe për atdheun tonë.

Pra, nga të gjitha këto del se opinionin botëror për



vendin tonë mendon që Shqipëria ka një politikë të sajën të pavarur e sovrane, se ajo nuk është satelite e askujt. Ai dëgjon me interesim se ç'thotë Shqipëria për problemet kryesore ndërkombëtare dhe ky opinion është në favorin tonë.

Kur u bë Konferenca e Helsinkit, artikulli i «Zërit të popullit» pati një sukses të jashtëzakonshëm. Me pikëpamjen tonë ishin dakord tërë revolucionarët e botës. Në këto situata autoriteti i Shqipërisë në opinionin botëror është ngritur jashtëzakonisht. Kjo gjendje përbën një siguri të madhe për ne. Në qoftë se i ngjet ndonjë gjë vendit tonë, ne do të kemi një opinion të madh përkrah vetes dhe kundër agresorëve të mundshëm. Këtë faktor e llogaritin armiqtë, por, megjithëkëtë, ne nuk vihemi në gjumë. Ne përgatitemi vazhdimisht që ta përballojmë vetë rrezikun që mund të na kanoset dhe t'i japim armikut grushtin vdekjeprurës.

Bashkimi Sovjetik do që të ketë qetësi këtu në Evropë. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjithashtu duan të ketë qetësi. Të dy superfuqive u duhet Evropa e qetë, se si njëra, edhe tjetra po kalojnë një krizë të madhe, jo vetëm brendapërbrenda vendeve të tyre, por edhe në aleancat që kanë krijuar me të tjerët, e sidomos me satelitët e tyre.

Në partnerët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës vërehet pakënaqësi ndaj politikës amerikane. Franca kundërshton nganjëherë, por shtetet e Evropës Perëndimore duan që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të vazhdojnë t'i mbajnë forcat ushtarake në Evropë, se kanë frikë të mbeten në kontinent vetëm me Bashkimin Sovjetik, që mund t'i sulmojë. Të rrinë këtu në

Evropë forcat ushtarake të Amerikës, thonë ata, që, së bashku me ne, të jenë në gjendje të përballojnë ndonjë sulm eventual. Qëllimi tjetër i tyre është që, nëpërmjet politikës, ideologjisë, tregtisë, turizmit etj., të ndërhyjnë në Çekosllovakë, në Gjermani, në Poloni, në Rumanë dhe në Bashkimin Sovjetik. Kur vjen puna për t'i zbatuar vendimet, atëherë dalin pengesa. «Jo, thotë Bashkimi Sovjetik, ne vërtet vendosëm të lejojmë turizmin, por duhet t'i konkretizojmë marrëveshjet e përgjithshme me disa marrëveshje të veçanta, me klauzola më të hollësishme, për shembull, në qoftë se do të dërgojmë turistë te njëri-tjetri, të merremi vesh sa do të dërgojmë, kur, ku, qysh e tek». Kurse perëndimorët thonë: «Po ne, kur kontraktuam, nuk e shtruum çështjen kështu, ne thamë që të hapëshin portat e turizmit». Kështu në kuadrin e marrëveshjes lind edhe mosmarrëveshja.

Bashkimi Sovjetik është i krimbur në borxhe, ai u detyrohet shumë disa shteteve kapitaliste, të cilat, sigurisht, nuk i kanë dhënë kot dhe pa interes kreditë e tyre. Në Jugosllavi pjesa më e madhe e aksioneve, që arrijnë miliarda, u përket kapitalit amerikan dhe atij botëror. Në shembullin e padronit të tyre sovjetik këta të tjerët, si bullgarët, rumunët, çekët, gjermanët e polakët, po nxitohen të marrin sa më shumë kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat do t'u japin kredi edhe këtyre dhe do t'i krimbin në borxhe.

Bashkimi Sovjetik e ka parashikuar këtë proces, që edhe nuk i pëlqen fort, por nuk mund ta ndalojë, për arsye se ai vetë ka dhënë shembullin e keq në këtë drejtim. Për të siguruar sundimin e tij ndaj këtyre ve-

ndeve Bashkimi Sovjetik ka ushtrinë e tij brenda territoreve të tyre. Në fakt ai i ka pushtuar këto vende. Në fushën politike dhe ideologjike pozitat e tij janë shumë të lëkundura, prandaj në marrëdhëniet me to mbështetet në forcën ushtarake. Tani Bashkimi Sovjetik po përpiqet të futet në Lindjen e Mesme e në Afrikë.

Për disa nga çështjet kryesore ne kemi mendime që ndryshojnë me ato të kinezëve. Kinezët thonë se duhet punuar që të thellohen kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Edhe ne jemi dakord, dhe bile luftojmë për këtë gjë, por kemi mendim të ndryshëm nga ata për rrugën që duhet ndjekur në këtë drejtim. Kina e mbron Tregun e Përbashkët Evropian, se mendon që kështu dobësohet Bashkimi Sovjetik. Ndërsa ne mendojmë që ky është tregu i borgjezisë kapitaliste evropiane, i koncerneve të mëdha. Ky treg është si KNER-i i sovjetikëve, që u dikton ligjin satelitëve që nga Rumania e deri te Polonia. Në shtypin tonë ne kemi shkruar që Tregu i Përbashkët Evropian është një organizëm kapitalist, antipopullor dhe duhet ta luftojmë njëjloj si edhe KNER-in. Që të dy këta organizma shfrytëzues janë njësoj të këqij, ashtu siç janë njësoj të këqij imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik.

Politika e jashtme e Kinës është në favor të Evropës së Bashkuar, se, sipas kinezëve, kështu do të dobësohet Bashkimi Sovjetik, por për Evropën e Bashkuar janë klikat sunduese të kapitalit të madh evropian. Lenini në kohën e tij e ka analizuar çështjen e Evropës së Bashkuar dhe e ka dënuar. Ai ka thënë që

një bashkim i tillë, po të realizohet nga klikat sunduese, është në dëm të popujve. Në themi që jemi kundër Evropës së Bashkuar, se nuk mund të pranojmë që të bashkohet Evropa nën diktatin kapitalist.

Duhet të kontribuojmë që të zgjohen popujt e Evropës dhe të luftojnë kundër revizionizmit sovjetik, kundër imperializmit amerikan dhe kundër kapitalit. Popujt duhet ta bëjnë luftën në radhë të parë kundër dy superfuqive dhe pastaj të manovrojnë edhe kundër borgjezisë kapitaliste evropiane. Aleancat duhen bërë me baza leniniste, për këtë ne jemi dakord.

Partia jonë mendon se qëndrimet e saj në këto çështje janë të bazuara në teorinë leniniste për luftën kundër imperializmit dhe kapitalizmit.

Politika jonë synon të ndihmojë popujt që të ngrihen në revolucion e të fitojnë jo vetëm të drejtat ekonomike, por edhe ato politike. Këtë politikë, që përkrasht nga revolucionarët dhe marksistë-leninistët, ju e dini, sepse bashkërisht po e zbatojmë çdo ditë, prandaj nuk po zgjatëm më tej.

Konferenca e Helsinkit, ashtu siç e kemi thënë edhe në artikullin e botuar në «Zërin e popullit», nuk ka siguruar gjëkafshë. Kontradiktat midis shteteve kapitaliste e revizioniste brenda në Evropë do të vazhdojnë dhe do të acarohen. Jashtë Evropës armiqtë duan ta bëjnë luftën me duart e të tjerëve, duke thurur intriga e poshtërsi nga më të ndryshmet.

Rivalitete të mëdha duken në Oqeanin Indian, në Lindjen e Afërt, në Gjirin Persik dhe në kontinentin amerikan. Kush u jep fund një herë e mirë këtyre rivaliteteve, intrigave etj.? Kryengritja e armatosur e

popujve, por kjo nuk mund të bëhet në një ditë. Forca që luftojnë kundër kapitalistëve e revizionistëve ka. Imperializmi e socialimperializmi, megjithëse kanë forca ekonomike dhe ushtarake të mëdha, si fashistë e agresorë që janë, kanë rënë në pozita të dëshpëruara. Ata e kuptojnë se tani kaloi koha e perandorive të dikurshme, si ajo angleze para Luftës së Dytë Botërore.

Partia nuk na e thotë vetëm sot se vendin tonë duhet ta kemi të fortë ushtarakisht dhe ekonomikisht, se, që ta kemi të fortë në këto dy drejtime, duhet ta kemi të fortë edhe politikisht e ideologjikisht. Forcat e Partisë duhen orientuar, në radhë të parë, që të ngrenë lart moralin, ndjenjat politike dhe ideologjike të masave. Çështja e edukimit politiko-ideologjik, në radhë të parë të masës së Partisë dhe pastaj të masave popullore, përbën kyçin e të gjitha fitoreve. Fitoret sigurohen kur Partia është monolite, marksiste-leniniste. Në qoftë se ecim dhe kalitemi sipas parimeve të Partisë, sipas normave të Partisë dhe ideologjisë së Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, Partia jonë do të jetë e fortë, betonarme, ajo do të jetë një grusht çeliku që asgjë nuk do të mund ta lëkundë.

Forcimi dhe kalitja e Partisë nuk janë të shkëputur nga problemet e mëdha të ndërtimit socialist, prandaj të mos na gënjejë mendja se gjithçka mund të arrihet me një leksion, me dhjetë apo me pesëmbëdhjetë leksione. Forcimi i Partisë është një problem i madh dhe jetik. Në këtë «kazan» të madh revolucionar, ku ziejnë tërë këto probleme të ndërtimit të socializmit, duhet të shquajnë uniteti i Partisë dhe i klasës, zgjuarsia dhe zotësia e tyre, me qëllim që çdo problem

të zgjidhet në rrugë të drejtë, që socializmi të forcohet dhe Shqipëria të ecë shkallë-shkallë, por pa u ndalur, drejt komunizmit.

Partia duhet të udhëheqë, ajo duhet të qëndrojë në krye të punëve jo në mënyrë formale, por efektivisht dhe realisht. Ka njerëz që pretendojnë se e dinë shumë mirë teorinë e marksizmit, por në praktikë e zbatojnë gabim. Kjo «dijeni» e tyre nuk vlen. Ka edhe njerëz që nuk e dinë marksizmin, siç ishin dikur shumë nga shokët tanë, por ata e duan dhe e mësojnë atë në luftë e sipër. Ne, kur u ngritëm dhe morëm armët për lirinë e vendit, nuk e dinim të tërë marksizmin, por dinim shumë mirë një gjë: Që atdheu duhej çli-ruar nga pushtuesit dhe nga bejlerët e agallarët, nga shfrytëzuesit, sikurse na mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini.

Ne u frymëzuam nga kjo ideologji, e përvetësuam, e zbatuam dhe fituam. Duke u mbështetur në marksizëm-leninizmin, ne fituam jo vetëm në Luftën Nacionalçlirimtare, por edhe në ndërtimin socialist të vendit. Duke pasur si busull shkencën tonë të klasës, ne kemi qenë në gjendje të përballojmë me sukses të gjitha këto trazira që kanë ngjarë në vendin tonë. Këto trazira nuk kanë qenë të vogla. Ne, që i përkasim këtij brezi që bëri luftën, i kemi kaluar vetë që nga fillimi këto sëkëlldi. Vërtet populli thotë «të shkuara e të harruara», por këto të shkuara kanë qenë të rrezikshme.

Sa komplete ka kaluar vendi ynë, sa armiq të tërbuar ka pasur Partia jonë, sa spiunë e agjentë janë futur nga jashtë që t'i bënin varrin Shqipërisë! Por këtë vend e kanë shpëtuar gjithmonë kjo Parti e ky

popull. Ne, që e kemi mësuar marksizmin edhe nga librat, edhe nga puna e eksperiencë, nuk jemi trembur kurrë nga armiqtë e brendshëm e të jashtëm. Kështu do të vazhdojmë të ecim.

Ky qëndrimi ynë dhe kjo eksperiencë e Partisë sonë janë të vlefshme për brezat e rinj të tanishëm dhe për ata që do të vijnë, të cilët do t'i edukojmë që t'i shikojnë e t'i gjykojnë luftën dhe eksperiencën tonë të madhe nëpërmjet dokumenteve të Partisë. Të frymëzuar e të kalitur me këtë eksperiencë, që është nxjerrë nga zbatimi në jetë i teorisë sonë, ne do të mundim të zhvillojmë e të shtojmë potencialin politiko-ideologjik, ekonomik dhe atë të mbrojtjes së vendit.

Të gjitha këto suksese që kemi arritur, janë rezultat i kësaj pune e lufte që kemi bërë. Tashti na vihen përpara detyra të tjera të mëdha. Ne kurdoherë do të përgatitemi të shkojmë përpara me luftë, se jemi nga ata njerëz, nga ai brumë, që nuk mendojmë se çdo gjë do të na shkojë si në gjalpë. Fëmijët tanë, duke mos e njohur të kaluarën, mund të mendojnë se tani lufta ka mbaruar, por ne duhet t'i mësojmë se në jetë nuk shkon gjithçka urtë e butë. Jeta jonë do të shkojë përpara me luftëra e përpjekje të mëdha kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm. T'u mësojmë bijve tanë si duhet njohur e si duhet luftuar armiku i brendshëm dhe si duhet njohur e si duhet luftuar armiku i jashtëm. Që t'i kryejmë këto detyra, në radhë të parë, duhet të jemi vetë të fortë shpirtërisht, ekonomikisht e ushtarakisht. Prandaj çështjen e forcimit të ekonomisë dhe të mbrojtjes vazhdimisht duhet t'i kemi në qendër të vëmendjes.

Unë nuk do të zgjatem këtu për direktivat që ka dhënë Partia lidhur me ushtrinë, veçse po theksoj se tani që jemi duke hartuar planin pesëvjeçar në kushte shumë të mira, të kemi parasysh mirë nevojat e mbrojtjes.

Plani ynë pesëvjeçar bëhet në kushte shumë të mira, sepse faktori Parti, faktori opinion i masave të popullit për zhvillimin e ekonomisë, të kulturës dhe të mbrojtjes, zhvillimi i gjertanishëm i ekonomisë, si dhe lidhjet e popullit me Partinë janë të tërë pozitivë dhe me prirje drejt ngjitjes. Veçse kurrë nuk duhet harruar që këto kushte u krijuan me luftë klasore revolucionare dhe me vigjilencë të madhe kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, të cilët, siç e dimë dhe po e shohim, armët nuk i kanë hedhur.

Lufta e klasave do të vazhdojë deri në fitoren e plotë të komunizmit në shkallë botërore. Cila parti qëndron në rrugën marksiste-leniniste, cila arrin të përvetësojë e të zbatojë me besnikëri teorinë marksiste-leniniste të luftës së klasave, cila edukon dhe tërheq në këtë luftë masat e gjera të popullit, ajo do të sigurojë fitoren mbi armiqtë e klasës. Asaj partie që zhvillon me konsekuencë luftën e klasave nuk mund t'i lëvrijnë për shumë kohë armiqtë rreth e rrotull, se zbulohen, dhe zbulimi i tyre forcon pozitën e Partisë e të diktaturës së proletariatit.

Për sa i përket zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë na vihet detyrë të jemi ambiciozë në kuptimin marksist-leninist të kësaj fjale dhe të mos kënaqemi me pak, të mos kënaqemi me këto që kemi arritur. Planet tona, shokë, duhet të jenë reale, por edhe të guximshme. Në hartimin e tyre lypset të kemi imagji-



natë prej revolucionarësh, duke qëndruar në pozita me të vërtetë pararojë. Në këtë drejtim duhet të parashikojmë me përgjegjësi edhe mjetet e nevojshme, format e organizimit dhe propagandën për arritjen e parashikimeve. Lufta jonë e deritanishme për zhvillimin e ekonomisë ka treguar se ekzistojnë mundësi të fuqishme për realizimin e parashikimeve të planit, për arsye se rezervat tona të pashfrytëzuara janë të mëdha.

Të marrim, për shembull, bujqësinë. Më parë ne merrnim nga 11-12 kuintalë grurë për hektar, por rezerva kishte shumë dhe këto duheshin shfrytëzuar. Kur Franca, Italia, Gjermania e vende të tjera merrnin nga 35 e 40 kuintalë për hektar, kjo neve na dukej çudi dhe mendonim: Si është e mundur të merren nga 35 e 40 kuintalë grurë për hektar? Ja, tani arritëm të marrim edhe në këtë sasi gruri. Ato mekanizime e atë sasi plehu që ka kapitalisti francez ose gjerman, sot për sot ne nuk i kemi, sepse ata zhvillojnë një bujqësi intensive, kapitalisti atje ka fermën e tij dhe mund t'i marrë tokës edhe 60 ose 70 kuintalë grurë për hektar, por megjithatë mesatarja e prodhimit si vend tek ata del më pak.

Si arritëm ne ta rritim rendimentin e prodhimit për hektar? Unë nuk dua t'i analizoj të tërë faktorët në hollësi, kjo gjë nuk mund të bëhet tani, në këtë takim, sepse një reflektim i çdonjërit prej nesh që jemi këtu, do të nxirrte shumë e shumë faktorë pozitivë që kanë ndikuar në shtimin e prodhimeve. Si përfundim i tërë analizës del se vija e ndjekur nga Partia në lëmin e bujqësisë ka qenë e drejtë, mobili-

zimi dhe vrulli i masave në punë kanë qenë shumë të mëdhenj.

Tani na bie detyra që këto rezultate të mira t'i përgjithësojmë në tërë vendin. Që t'ia arrijmë këtë qëllim, në radhë të parë, duhet ta konsiderojmë bujqësinë jo thjesht si një degë të ekonomisë që mbështetet vetëm tek eksperiencën, pa njohuri teorike e pa arsytim shkencor, pra, jo si diçka empirike, por si një sektor të ekonomisë që mbështetet fort te shkencën. Në qoftë se ne kërkojmë vetëm nga kryetarët e kooperativave, nga sekretarët e organizatave-bazë ose nga kuadrot me arsim të lartë një përpunim në mënyrë shkencore të problemeve të bujqësisë, kjo nuk është e mjaftueshme. Duhet të arrijmë gjer atje sa edhe kooperativistët të mendojnë dhe të punojnë në mënyrë shkencore për rritjen e bimëve bujqësore në parcelat e tokës që ka brigada e tyre. Kjo ka rëndësi vendimtare për ne, për socializmin në vendin tonë, por edhe për pozitën e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Në këto kushte ne do të kemi një plan shumë të madh e të ngjeshur. Mundet që zhvillimi i industrisë gjatë pesë vjetëve të ardhshëm të mos jetë në një shkallë aq të madhe sa ky i pesëvjeçarit që po kalon, por megjithëkëtë do të jetë një zhvillim i kënaqshëm, për arsye se do të përfundohen së ndërtuari gjithë këto vepra të rëndësishme, si Hidrocentrali i madh i Fierzës, Kombinati Metalurgjik në Elbasan, Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh etj. Do të ndërtojmë hidrocentralin e Komanit dhe 20 a 30 ndërmarrje e uzina, si ajo e kromit e të tjera. Kështu që për pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të kemi punë kolosale për

të bërë edhe në industri. Pra, kjo është gjendja e industrisë që, mund të themi, paraqitet e kënaqshme. Minierat për ne janë një pasuri e madhe, prandaj do t'i zhvillojmë, duke i mekanizuar më tej ato që kemi dhe duke ndërtuar të tjera.

Për sa i përket bujqësisë çështja është që ne të mos qëndrojmë në stadin aktual të zhvillimit dhe të mos kënaqemi me këto që janë arritur. Bujqësia jonë duhet doemos të përparojë dhe të bëhet një bazë e fuqishme për fuqizimin e ekonomisë në tërësi. Kjo kërkon që ne të arrijmë doemos ta bëjmë bukën në vend.

Tashti ne e kemi stabilizuar farën e grurit dhe pak a shumë e dimë çfarë fare gruri kemi, ku duhet mbjellë kjo e ku duhet mbjellë ajo. Jemi duke zhvilluar edhe hibridin e misrit, bile po bëjmë hibridet tona, por, siç dihet, sjellim edhe nga jashtë. Për këtë qëllim duhet të bëjmë përsëri rajonizimin më shkencor të tyre. Të gjitha këto masa që kemi marrë, si, për shembull, për përhapjen e eksperiencës së Plasës dhe të tjera si këto, duhen vënë në zbatim. Në kemi përmirësuar racën e lopëve, kemi sjellë damazë që kanë kapacitete të mëdha.

Të gjitha këto, bashkë me mekanizimin e me ujitjen, kanë bërë që të rriten rendimentet e bimëve bujqësore. Por, po ta studiojmë çështjen me kujdes, do të na dalë: Vallë ua bëjmë të tëra shërbimet bimëve, duke i ujitur si duhet dhe kur duhet, duke treguar me kohë kujdesin e duhur ndaj farërave dhe duke kalibruar hibridin që na vjen? A mendojmë ne kurdoherë që hibridi e ka humbur fuqinë mbirëse dhe nuk jep më atë që duhet të japë? Në këtë drejtim ne

u jemi shumë borxhlinj bimëve bujqësore. Për këto raste duhet një kujdes i posaçëm, se kjo është buka e popullit dhe me të nuk mund të bëhet shaka. Nuk mund të kënaqemi me disa ekonomi, që s'janë të vogla dhe që marrin një prodhim prej 25, 28 apo 30 kuintalësh misër hibrid për hektar. Ne, në të gjitha tokat e ujëtshme të vendit tonë, duhet të marrim mesatarisht 50 kuintalë misër për hektar. Po kështu edhe për grurin duhet të marrim 30, 33 ose dhe 35 kuintalë për hektar. Të gjitha këto suksese që kemi arritur deri tani nuk kanë ardhur vetvetiu, nuk kanë rënë nga qielli, por janë arritur me punën e palodhur të njeriut tonë të ri, i cili ka përçafuar shkencën dhe është i bindur për vijën dhe për këshillat e Partisë, prandaj ne jemi të sigurt se do të ecim akoma më përpara.

Si konkluzion, shokë, them se në bujqësi duhet të bëjmë përpjekje shumë të mëdha. Këtë gjë kemi mundësi ta bëjmë, se kemi gjithë ata faktorë pozitivë që përmenda më përpara, por duhen organizimi dhe mençuria e Partisë dhe e njerëzve të saj. Po iu vumë punës me vrull, edhe bukën do ta bëjmë, edhe yndyrna, sheqer etj. më pak do të importojmë.

Të gjitha parashikimet në bujqësi do të arrihen, siç thashë, në sajë të ndërgjegjes së lartë politike të kooperativistëve. Njerëzit ta kuptojnë politikisht drejt këtë problem. Në qoftë se nuk plotësohen detyrat në bujqësi, mund të na krijohen vështirësi ekonomike. Për shembull, në qoftë se nuk realizohet prodhimi i panxharsheqerit, ne nuk kemi mundësi ta mbajmë në këtë nivel që e kemi konsumin e sheqerit për frymë.

Lulediellin e ullirin, që kanë prodhime të mira sivjet, nuk duhet t'i lëmë të na shpërdorohen, aq më tepër se nuk kemi mundësi të blejmë sasi të mëdha yndyrnash. Këto duhet t'i dimë, se i ka vënë në dukje edhe Plenumi i Komitetit Qendror.

Edhe vështirësitë që na krijohen, duhen kuptuar politikisht, që t'i kapërcejmë si duhet. Populli ynë është patriot dhe e kupton situatën, prandaj reagon me pjekuri. Ai vetë e kuptoi se shteti ishte ngushtë për vaj dhe po përdor atë sasi vaji që shteti ka mundësi ta furnizojë. Po kështu edhe konsumin për frymë të sheqerit ne e kemi shkurtuar pak, por populli nuk qahet, se e di sa është ngritur çmimi i tij në tregun ndërkombëtar. Në situata të tilla duhet të mësohemi të ecim me nikoqirllëk, por nuk duhet ta vështirësojmë gjendjen më keq, kur për këtë gjë nuk ka shkaqç objektive.

Tani ne duhet të përpiqemi të mbajmë këtë nivel jetese që kemi. Këtë duhet ta bëjmë pikërisht në një kohë kur në të gjithë botën niveli i jetesës së popujve është ulur, çmimet kanë vajtur në qiell dhe po ngrihen vazhdimisht. Të mos flasim vetëm për fqinjët tanë, Jugosllavinë e Italinë, ku ekonomia është futur në një kaos të madh, por ngado që të hedhim vështrimin, kriza ekonomike i ka hedhur njerëzit në fatkeqësi. Vetëm në vendin tonë çmimet kanë qenë të stabilizuara, por, që të vazhdojmë t'i mbajmë kështu, duhet të prodhojmë. Çmimet e qëndrueshme varen nga prodhimi i bollshëm, kurse vetë prodhimi varet nga ne, nga organizimi ynë dhe nga situata politike në të cilën jetojmë. Punëtorët, kooperativistët, nëpunësit, ushtarakët, të

rinjtë të bëhen të tërë të ndërgjegjshëm për këtë problem.

Më falni, shokë, se ju mbajta shumë e ndoshta ju lodha, por në hartimin e planeve duhet t'i kemi parasysh këta objektiva që përmendëm në bashkëbisedimin tonë. Të mbajmë parasysh kudo kursimin. Kursim nuk do të thotë të ulim prodhimin, por ka kuptim që shtimi i prodhimit të bëhet me sa më pak shpenzime. Kështu forcohet atdheu.

Falemnderit shumë që më dëgjuat me vëmendje dhe nuk u mërzitët. Tani i japim fund bisedës. Ne kemi besim që ju do t'i plotësoni të gjitha detyrat që ju kanë ngarkuar organizata e Partisë e rrethit të Korçës dhe Komiteti Qendror i Partisë. Rrethi i Korçës dhe klasa punëtore e tij kanë tradita revolucionare, prandaj duhet të qëndrojnë në pararojë. Mobilizohuni sidomos në bujqësi, kini mendjen se në këtë sektor vërtet keni qenë përpara, por tani sikur jua kanë kaluar myzeqarët, prandaj të viheni në garë me ta!

Qofshi mirë dhe dalshi faqebardhë!

*Botuar për herë të parë,  
me disa shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975»,  
f. 267*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjetet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## DY JANË ÇËSHTJET KRYESORE: MBROJTJA E ATDHEUT DHE FORCIMI I EKONOMISË

*Bisedë me kuadro e me punëtorë të uzinës  
së instrumenteve të precizionit «Petro Papi» dhe të  
uzinave e fabrikave të tjera të rrethit të Korçës*

20 gusht 1975

*Në hyrje të uzinës shoku Enver Hoxha u prit me  
brohoritje dhe duartrokitje entuziaste nga qindra pu-  
nëtorë, specialistë e kuadro. Pasi u përshëndet përze-  
mërsisht me ta dhe vizitoi disa reparte, ku takoi punëto-  
rë dhe u njoh me punën e tyre, në sallën e mbledhjeve  
të uzinës ai zhvilloi këtë bisedë:*

Më parë dëshiroj që ju, pjesën e gjallë e revolucio-  
nare të klasës punëtore të vendit tonë, të shtyllës kurri-  
zore të Partisë së Punës, t'ju përshëndes në emër të  
shokëve të Byrosë Politike e të Komitetit Qendror dhe  
t'ju shpreh me këtë rast respektin e madh që kanë ata  
veçanërisht për klasën punëtore korçare me tradita të  
vjetra revolucionare e lufte për hedhjen e bazave drejt  
formimit të Partisë dhe për përhapjen e marksizëm-  
leninizmit.

Siç e dini, shokë punëtorë të rinj, komunistë dhe

të paorganizuar në Parti, këtu midis jush ka edhe shokë të vjetër, ish-anëtarë të Grupit Komunist të Korçës, si veteranët më pleq nga të gjithë ne (nuk e kam fjalën nga moshë, por nga veprimtaria revolucionare), komunistët e orëve të para Pilo Peristeri, Miha Lako e të tjerë. Edhe unë kam qenë një nga ata të rinj që m'u hapën sytë në gjirin e kësaj klase, pse shokët që përmenda dhe të tjerë si këta më dhanë mësimet e para të komunizmit, që Partia më vonë na i zhvilloi të gjithëve, duke na treguar se si të luftonim me vetëmohim, deri në sakrificën e fundit, për lirinë e atdheut tonë të dashur, për interesat e popullit që kishte vojtur dhe të klasës punëtore që i takonte roli udhëheqës në shoqëri.

Nga këto ideale të mëdha u udhëhoqën komunistët shqiptarë në veprimtarinë e tyre për të themeluar një parti marksiste-leniniste që të mos shuhej gjersa të ndërtohej plotësisht shoqëria komuniste. Kjo parti do të ishte e mbryjtur me të vërtetë me mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit. E tillë u bë Partia jonë, e çeliktë dhe e fortë, për arsye se udhëheq në revolucionin socialist klasën punëtore, kockën e saj të pathyeshme, në emër dhe për interesat e së cilës bën çdo gjë. Në emër të klasës punëtore Partia ngriti tërë popullin në këmbë, organizoi dhe forcoi vazhdimisht aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë. Me mësimet, me vendosmërinë dhe me mençurinë e saj, Partia jonë krijoi unitetin marksist-leninist brenda radhëve të veta dhe unitetin e saj me popullin në Luftën Nacionalçlirimtare e në luftën për ndërtimin e socializmit.

Kemi nja tre vjet unë dhe Nexhmija që nuk kemi ardhur këtu në Korçë, prandaj ma donte zemra të vija



sa më parë, se më kishte marrë malli, për arsye se unë e ndiej veten si gjysmëkorçar! Nuk e di nëse ka ndonjë gjirokastrit këtu afër që të thotë: «More, po dale, se na e mohoi vendlindjen shoku Enver!». (Të qeshura.)

Kur kemi qenë në Korçë, kemi ardhur edhe në uzinën tuaj dhe jemi frymëzuar nga ju.

Unë, natyrisht, nuk kam ardhur këtu që t'ju shes mend, se udhëheqësit duhet të jenë modestë, sidomos para klasës punëtore, por do t'ju flas diçka në bazë të udhëzimeve të Partisë, të asaj që është zemra dhe truri ynë, që na hapi sytë, na mësoi dhe na orienton të ecim në rrugën e drejtë. Unë, shokë, kam ardhur midis jush që edhe të mësoj nga ju, nga klasa, nga populli, edhe t'ju informoj për çka mendon Partia aktualisht.

Dje pata një takim me shokët drejtues të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave dhe me kuadro të tjerë të rrethit tuaj, me të cilët bëmë një bisedë shumë të ngrohtë, revolucionare, marksiste-leniniste. Shkëmbyem bashkërisht mendime të vlefshme për t'i dhënë një hov më të madh përpara zhvillimit socialist të vendit, për ngritjen në një shkallë më të lartë të ekonomisë, si dhe për forcimin e pozitave ushtarake mbrojtëse të atdheut.

Dy janë çështjet kryesore, që, ditë dhe natë, duhet t'i kemi në zemrën dhe në mendjen tonë: mbrojtja e atdheut nga çdo rrezik që mund t'i turret, nga jashtë ose nga brenda, dhe forcimi i ekonomisë socialiste për të rritur mirëqenien e popullit dhe për të pasur mbrojtje të fortë. Në të dy këto drejtime shokët e rrethit më folën edhe për sukseset që janë arritur, edhe për të metat që ekzistojnë. E vërteta është që kemi edhe të

meta në punë. Këto të meta nuk ekzistojnë vetëm këtu në Korgë, por edhe në rrethe të tjera. Nuk ka aspak dyshim se karakteristikë e punës te ne në çdo drejtim është pozitivja. Gjendja e vendit tonë përgjithësisht është shumë e mirë, pavarësisht se na dalin edhe armiq, se kemi edhe të meta e gabime.

Si të moshuarit, edhe të rinjtë e të rejat e dinë që populli ynë në të kaluarën, para dhe pas pushtimit nga të huajt e deri tash, ka qenë vazhdimisht në luftë me armiqtë e brendshëm e të jashtëm, që kanë qenë të fortë, të egër e të organizuar, dhe ka dalë fitimtar. Armiqtë nuk kanë mundur të pengojnë ecjen e tij përpara nën udhëheqjen e Partisë. Lufta, siç na mëson Partia, derisa ekzistojnë imperializmi e revizionizmi, derisa ekzistojnë mbeturinat e klasave shfrytëzuese që ne likuiduam dhe derisa ekziston mentaliteti mikroborgjez që shfaqet në disa aspekte të jetës e të punës sonë, është e paevitueshme. Lufta e klasave do të vazhdojë, pse është forca kryesore lëvizëse që çon përpara socializmin dhe i hap rrugën komunizmit. Dhe në gjithë këtë luftë klasa jonë punëtore ka luajtur rolin e saj me të vërtetë të madh e historik. Ajo do të vazhdojë ta lozë këtë rol plot shkëlqim.

Siç e dini, industria është jetike për vendin tonë, ajo është dega drejtuese e ekonomisë, pa të cilën nuk mund të ndërtohet socializmi. Ne akoma nuk mund të themi që e kemi ngritur industrinë në nivelin e dëshiruar nga Partia. Duhet të kalojë një kohë që ajo të zhvillohet më tej dhe të modernizohet më shumë. Por po të kthejmë sytë prapa dhe të shikojmë rrugën që kemi përshkuar nga fillimi, pas Çlirimit e deri tash, do

të konstatojmë se industria jonë është fuqizuar mjaft. Këtë industri e kanë ngritur duart e arta dhe mendja e kthjellët e punëtorëve dhe e Partisë sonë.

Faktori i brendshëm është vendimtar, kryesor, bazë, ndërsa ndihma e jashtme për industrinë ka qenë e dorës së dytë. Sa kohë që kalon, aq më tepër mbarë vendi ynë, tërë ekonomia, dhe në radhë të parë industria, do të fuqizohen vazhdimisht.

Ne edhe në të ardhmen do të zbatojmë, si deri tash, parullën e Partisë «Të mbështetemi në forcat tonat!». Këto forca Partia tashmë i ka krijuar, ajo ka krijuar, në radhë të parë, vrullin e madh revolucionar, unitetin e çeliktë të të gjitha masave punonjëse, të të gjithë popullit, me klasën punëtore në krye, të cilën e kualifikoi dhe i dha në dorë jo vetëm armët e luftës, por edhe ato të punës. Këto armë tonat janë shumë të fuqishme.

Unë nuk dua t'i numëroj veprat që kemi ndërtuar, por mund të them se në vendin tonë kemi kombinatë, uzina e fabrika të shumëllojshme, kemi industri mekanike, industri kimike etj. Shpejt do të kemi edhe industrinë metalurgjike, që do të jetë baza e bazave të industrisë sonë. Ne i kemi forcat lëvizëse të kësaj industrie: energjinë elektrike, lëndët djegëse, naftën, qymyrin etj.

Uzina juaj është nga më modernet. Ju keni punuar për ta montuar vetë. Partia ju ka bërë të zotë, ju frymëzoi për të ngritur një uzinë të tillë për prodhimin e instrumenteve të precizionit, të cilat janë shumë të nevojshme për industrinë që kemi sot dhe për atë të ardhshmen.

Industria jonë do të jetë më e automatizuar, më moderne, atrecaturat e saj do të jenë edhe më precize. Organizata e Partisë këtu ju drejton që çdo gjë ta bëni të përsosur, prandaj edhe uzina quhet e precizionit.

Kualifikimi teknik është me shumë rëndësi, ai vjen përnjëherë pas kualifikimit politik-ideologjik, që është kurdoherë i pari. Në qoftë se nuk ngriheni politikisht dhe ideologjikisht e nuk e kuptoni çdo gjë në këtë prizëm, kualifikimi teknik, sado i përsosur qoftë, nuk mund të sigurojë atë cilësi prodhimi dhe atë rendiment që kërkon ndërtimi socialist i atdheut. Në këtë drejtim uzina juaj duhet të jetë model. Mua më kanë folur shumë mirë për punën tuaj. Natyrisht, këtu ka edhe të meta, të cilat, nën udhëheqjen e Partisë, përpiquni t'i zhdukni. Nuk ka dyshim se të metat janë edhe objektive, edhe subjektive. Për ato të karakterit objektiv të bëjmë përpjekje që, me forcat tona, të plotësojmë boshllëqet e të zhdukim gabimet që kemi pasur dhe që vazhdojmë të kemi edhe ne në qendër, edhe ju këtu në bazë, brendapërbrenda uzinës. Të metat objektive do të zhduken vetëm në rast se do të arrijmë (dhe patjetër duhet të arrijmë) të zhdukim të metat subjektive, të cilat luftohen nëpërmjet një ngritjeje të vazhdueshme politike dhe ideologjike.

Ç'do të thotë ngritje ideologjike dhe politike? Të ngrihesh ideologjikisht e politikisht nuk do të thotë të lexosh një herë apo disa herë materialet e Partisë sonë, veprat e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, por t'i studiosh me shumë vëmendje ato. Ky studim duhet bërë i lidhur ngushtë me eksperiencën tonë të madhe. Ato që studiojmë t'i bluajmë mirë në kokë dhe

pastaj t'i zbatojmë në mënyrë krijuese në punë, në jetën shoqërore, në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, në familje, në shoqëri e kudo. Kjo do të thotë që të ruajmë dhe të zhvillojmë më tej tiparet komuniste jo vetëm tek anëtarët e Partisë, por edhe në masat e popullit, se po të mos rrezatoheshin këto tipare edhe në masat, kjo do të thoshte që ne komunistët të izolohehim. Bukur thotë populli ynë: «Me një lule s'vjen behari», prandaj Partia jonë përbëhet prej rreth 100 mijë lulesh, që lëshojnë aromën komuniste midis 2 milionë e 300 mijë njerëzve. Kështu ideologjia e Partisë do të rrezatojë thellë në zemër të popullit.

Këto që them për uzinën tuaj vlejné edhe për të gjitha kombinatet, uzinat e fabrikat e qytetit dhe të rrethit të Korçës e të gjithë republikës. Ne dëshirojmë të kemi edhe më shumë fabrika, uzina e kombine dhe me siguri do të bëjmë të tjera në të ardhmen, por edhe këto që kemi aktualisht nuk janë pak. Kur mendon kovaçhanën fare të vockël të Pilo Peristerit apo dyqanin e mballomatarit Miha Lako ose kazanët e Petraq Katros, ku punonte shoku ynë i vjetër Sotir Gurra e të tjerë, dhe i krahason këta me objektet tona industriale, del se nga ajo kohë ne kemi bërë ndryshime kolosale.

*SHOKU PILO PERISTERI:* Sa kapital kishin Turtulli, Lakollarët me gjithë ish-tregtarët e mëdhenj të Korçës, të marrë së bashku, ka dy herë më shumë kjo uzinë, që i fut të tërë ata në një xhep.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është. Turtulli kishte shënuar mbi një gur në Shëndëlli këto fjalë: «Këndo për mua, se bëra këtë çezmë!». Mirëpo çezma

që ndërtoi ai afër kishës, nuk kishte fare ujë. I mbaj mend edhe unë këto, se i kam shëtitur të gjitha sokaqet. (Të qeshura.)

Pilo Peristeri kishte një krevat prej hekuri të ndryshkur në shtëpi, që e mbulonte me levenxe të kuqe. Kur venim në shtëpi të tij, ca uleshin në dhe, ca mbi këtë krevat. Kështu ishin kushtet e punëtorëve në ato kohë, kurse tash, që ndërtojmë socializmin, shtëpitë e punëtorëve dhe jeta e tyre janë përmirësuar, se kudo në Shqipëri është forcuar ekonomia popullore.

Këtu në Korçë kemi shumë fabrika moderne, por ajo që bie tepër në sy është se bashkë me fabrikat janë rritur edhe punëtorët, ata janë kualifikuar dhe kualifikohen vazhdimisht. Për sa i përket industrisë tani na vihet detyra që të shfrytëzojmë në maksimum dhe me kujdes të madh si mjetet që kemi në dorë, ashtu edhe lëndët me të cilat punojmë, pse duhet të dini, shokë punëtorë, që rrojmë në momente lufte.

Situata e brendshme e vendit tonë është e shkëlqyer, por megjithëkëtë Partia na mëson të hapim sytë, se jemi të rrethuar nga armiq të egër, me të cilët, për arsye të koniunkturave, mbajmë edhe marrëdhënie diplomatike, tregtare, nganjëherë edhe kulturore. Me këta armiq ne jemi në luftë për arsye se nuk jemi dhe nuk mund të jemi kurrë dakord me ta as ideologjikisht, as politikisht. Ne jemi kundër borgjezisë, kundër imperializmit, kundër revizionizmit dhe socialimperializmit. Këta duan të na fshijnë nga faqja e dheut, sikurse edhe ne përpiqemi t'i fshijmë nga fronti i sundimit të popujve. Kjo që zhvillohet midis nesh dhe armiqve tanë është një luftë e ashpër klasash në plat-

formën ndërkombëtare. Sado të mundohen armiqtë, nuk do të na fshijnë dot, pse, megjithëqë jemi një vend i vogël, gëzojmë përkrahjen e popujve të botës, se frymëzohemi nga një ideologji e madhe. Sot ne jemi nga vendet më të shquara që e mbrojmë dhe e zbatojmë si duhet ideologjinë marksiste-leniniste, prandaj jemi të fortë. Megjithatë jemi modestë, se e dimë që klasa jonë punëtore është e vogël përpara proletariatit të madh botëror, i cili lufton me këmbëngulje kundër imperializmit, kapitalizmit dhe socialimperializmit në shkallë ndërkombëtare.

Për të dhënë edhe ne kontributin tonë në këtë luftë të përbashkët, na vihet detyrë që, veç të tjerave, ta perfeksionojmë industrinë e të shfrytëzojmë si duhet çdo mundësi e rezervë të brendshme, që në vendin tonë janë të mëdha. Këto ju punëtorët i njihni më mirë nga kushdo tjetër. Rezervat nuk janë dhënë një herë e përgjithmonë, ato lëvizin. Le të marrim si shembull uzinën tuaj. Zhvillimi i përvitshëm ose pesëvjeçar krijon mundësi kolosale, që ju duhet t'i njihni, t'i zbuloni e t'i shfrytëzoni, që atdheu ynë të marrë nga uzina juaj, me mjetet e me materialet që dispononi, artikuj sa më të përsosur, me kosto gjithnjë e më të lirë dhe në sasi sa më të mëdha. Rezervat kurrë nuk duhet t'i mendoni si mjet që mund të shfrytëzohen sa për të qenë brenda. Nuk është qëllimi që të ruani mjete materiale, lëndë të parë e çdo gjë tjetër sa për të dalë me një plan të realizuar. Ju, natyrisht, duhet të luftoni që ta realizoni planin, por plani juaj duhet të jetë real, domethënë as i vogël, as jashtë forcave tuaja. Ai të jetë i menduar mirë në të gjitha drejtimet dhe jo me rezerva të panevojsh-

me. Atdheu kërkon sa më shumë prodhime që të kush-tojnë sa më lirë, pse kështu ai do të bëhet më i fortë. Duke mbajtur shumë rezerva dhe duke e hartuar planin, si të thuash, brenda çatisë së ndërmarrjes, pa shikuar më larg nga hunda jote, kjo do të ishte një shfaqje e dëmshme për ekonominë. I kam drejt këto që po ju them? (Në sallë dëgjohen zëra miratimi: «Shumë drejt!».)

Domethënë të tërë duhet të mendojmë në këtë mënyrë, prandaj ndërmarrjet ekonomike kudo të planifikojnë realisht.

Dihet që çdo uzinë e fabrikë ka nevojë për lëndë të parë. Të jemi të ndërgjegjshëm, shokë punëtorë, se duhet të luftojmë që këtë lëndë ta sigurojmë këtu, në vend. Atë që nuk kemi akoma mundësi për ta prodhuar në vend, do të bëjmë përpjekje ta importojmë. Për të siguruar importin kërkohet të prodhojmë, të realizojmë dhe të tejkalojmë planet. Këtë ta kemi mirë të qartë. Në qoftë se nuk prodhojmë, atëherë s'kemi me se të importojmë. Të zhvillojmë minierat tona, naftën etj., të prodhojmë sa më shumë minerale, të ngremë në një nivel më të lartë bujqësinë, kjo është rruga e zhvillimit tonë ekonomik. Ne nuk mund të importojmë sa të duam, se nuk jemi shtet me potencial të madh ekonomik, prandaj, duke e njohur këtë fakt, le të vrasim mendjen për zhvillimin e ekonomisë sonë. Sigurisht, ne do të importojmë edhe në të ardhmen nga bota e jashtme, por për aq sa do të na lejojnë mundësitë, dhe mbi bazën e këtyre mundësive do të llogaritim planin tonë, i cili duhet të jetë, siç thamë, sa më i ngjeshur. Të bëhen përpjekje që plani të realizohet me cilësi të lartë e me kosto të ulët dhe bile të tejkalohet nga klasa punëtore e



nga fshatarësia kooperativiste. Të gjitha këto përpjekje për realizimin e detyrave të planit të shtetit kanë vetëm një qëllim: ngritjen e nivelit material e kulturor të jetesës së masave punonjëse dhe forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut. Ky është ideali i madh i Partisë. Lufta po bëhet e fortë për ndërtimin e socializmit, për fuqizimin e atdheut, për lumturinë e popullit sot dhe për lumturinë e brezave të ardhshëm. Pikërisht për këtë ideal të madh duhen shfrytëzuar të gjitha mjetet e mundësitë e brendshme.

Është fakt që në këtë drejtim kemi pasur dhe kemi të meta. Nganjëherë te njerëzit tanë mungon vigjilenca dhe fryma e tyre revolucionare nuk qëndron në lartësinë e duhur. Në një përrallë të vjetër të Ezopit thuhet se «Syri i të zotit duhet të shohë kudo». Dhe kështu është, në qoftë se syri i të zotit shikon çdo qoshe, as gjëja më e vogël nuk shkon dëm. Kush është zot i vendit te ne? Është populli, i udhëhequr nga klasa punëtore. Atëherë syri i të zotit, pra i gjithë popullit tonë punonjës, duhet të jetë i atillë që të shohë çdo qoshe, çdo copë hekuri, çdo kalli gruri, që asgjë të mos na shkojë dëm, por t'i shërbejë interesit të përgjithshëm. Në këtë drejtim ne kemi shumë për të bërë.

Në planifikim kërkohet të bëjmë një revolucion të madh, sepse armiqtë Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi dhe një grup sabotatorësh na kanë dëmtuar rëndë. Ju e keni njohur Abdyl Këllezin, që ju ka ardhur disa herë këtu, ju ka folur për planin dhe ju është hequr si planovik i mbaruar. Abdyl Këllezi ishte edhe megaloman. Kur kthehej nga rrethet, vinte te ne dhe gjithë mençurinë e zotësinë e shokëve të rrethëve i paraqiste

si të vetat, i përvetësonte me paturpësi. Ai na thoshte në Byronë Politike: «Unë mendoj të bëhet kështu», «unë mendoj të bëhet ashtu», por qorra ne nuk ishim, ia njihnim atij aftësitë dhe e dinim sa i kishte këllqet, sa i mbanin trutë, prandaj e kishim të qartë që na vinte në mbledhje me bagazhet e të tjerëve.

Abdyl Këllezi ishte për të vendosur edhe në vendin tonë vetadministrimin jugosllav. Pra, ai kërkonte që vijën e drejtimit unik e të planifikuar të ekonomisë sonë ta shkatërronte, ta decentralizonte, prandaj bënte përpjekje që çdo ndërmarrje të bëhej e pavarur deri aty sa të kishte të drejtë të planifikonte dhe të realizonte sipas dëshirave të saj, të kishte bile edhe marrëdhënie tregtare të drejtpërdrejta me firmat e huaja, duke i vënë në një plan si marrëdhëniet me vendet mike, ashtu edhe ato me vendet kapitaliste, me të cilat vërtet ne bëjmë tregti, por një tregti të drejtuar nga politika ekonomike e shtetit. Abdyl Këllezi dhe shokët e tij, nën maskën e zgjerimit pa kufi të kompetencave të rretheve e të bazës në fushën ekonomike dhe në kundërshtim flagrant me vendimet që ka marrë për këtë qëllim Byroja Politike në rrugën marksiste-leniniste, u përpoqën të realizonin, në fakt, vetadministrimin jugosllav.

Këto prirje të tij ishin shumë të rrezikshme dhe armiqësore, sepse kapërcenin konceptin marksist të dhënies së kompetencave bazës dhe atakonin kështu drejtimin e planifikuar të ekonomisë. Partia nuk mund të lejonte të krijohesh një situatë e tillë. Ajo kurdoherë ka porositur që të përkrahen iniciativat nga punonjësit, të vlerësohet shumë mendimi i masave, pse puna kri-

juese e tyre është vendimtare, mirëpo, në të njëjtën kohë, na ka porositur të mos humbasim vigjilencën ndaj armiqve, të cilët, duke u hequr si zbatues të vijës së Partisë, i shtrembërojnë mësimet e saj të drejta marksiste-leniniste. Pikërisht kështu vepruan Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi me shokë. Ata përpiqeshin të krijonin përshtypjen sikur këto metoda të tyre praktikoheshin nga poshtë, sikur i dëshironte drejtori i ndërmarrjes etj., pavarësisht se as drejtori, as të tjerët nuk e përkrahnin rrugën armiqësore ku përpiqej t'i fuste Abdyl Këllezi.

Me veprimet që kryente ai donte t'u linte njerëzve të kuptonin sikur atij i ishin dhënë fuqi ekonomike të pakufizuara. «Sa dollarë të duhen ty?», i thoshte ndonjë kuadri. «Më duhen 15 000 dollarë për të blerë disa makina për këtë apo për atë qëllim», i përgjigjej ky. «T'i jap unë», thoshte menjëherë Abdyl Këllezi. Kur vizitonte ndonjë kooperativë bujqësore, pyeste drejtuesit e saj: «Po juve çfarë ju duhet për nevojat e punës?». «Na duhet një makinë», i thoshin këta. «Dakord, një makinë do t'jua japë Abdyl Këllezi», përgjigjej ai, duke rrahur gjoksin me mendjemadhësi. Abdyl Këllezi fliste para punëtorëve me qëllime armiqësore, që të krijonte bindje për t'u zbatuar edhe në ndërmarrjet tona ekonomike vetadministrimi titist.

Revizionistët jugosllavë thonë se në Jugosllavi janë punëtorët ata që vetadministrojnë, por punëtorët jugosllavë në të vërtetë nuk administrojnë asgjë, se atje e administron ekonominë klika në fuqi, borgjezia e re titiste që sundon. Deri në njëfarë shkalle Abdyl Këllezi arriti të bënte disa hapa shumë të rrezikshëm për vendin

tonë. Ai, me mënyra të djallëzuara, ndikoi të krijohej një burokraci që, po të mos luftohej nga Partia, një ditë do ta rrezikonte shtetin tonë.

Partia, nëpërmjet dokumenteve të saj, u ka tërhequr vëmendjen vazhdimisht komunistëve dhe popullit që të luftohet burokratizmi. Kjo arrihet jo vetëm duke likuiduar hallkat e panevojshme, jo vetëm duke hequr nga administratat njerëzit e tepërt, por sidomos duke bërë ndryshime thelbësore në stilin e në metodën e punës dhe në mentalitetin e njerëzve. Armiqtë që përmenda i shtrembëronin konceptet e drejta të Partisë për burokratizmin. Diktatura e proletariatit nuk mund të drejtojë pa organet shtetërore dhe pa administratat e tyre, që janë të nevojshme, por krijimi i hallkave të tepërta e të panevojshme pjell burokracinë, që bëhet e rrezikshme për vetë ekzistencën e diktaturës.

Armiqtë, nën mbulesën e gjoja zhvillimit tekniko-shkencor të vendit, krijuan një numër të madh institutesh. Krijimi i një instituti shkencor është një punë me rëndësi, por ky do të ketë vlerë po qe se do të studiojë me të vërtetë probleme kyç, aktuale dhe të perspektivës, zgjidhja e të cilave do t'i japë një hov të ri zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë. Shumë nga këto institute që u krijuan ishin vetëm sa për emër, prandaj nuk dhanë gjë, në to u mblodhën qindra veta, shumica e të cilëve kuadro me arsim të lartë, që u grumbulluan gjoja për të studiuar naftën ose diçka tjetër, kurse në fakt ajo u sabotua. Kështu u krijuan pa kriter edhe disa organizma që do të studionin për të zhvilluar bujqësinë, shëndetësinë etj., etj., por nuk e justifikuan qëllimin për të cilin u krijuan. Në

realitet grumbullimi i kuadrove specialistë në vende ku ata nuk jepnin asgjë, ishte taktikë e sabotimit nga ana e armiqve.

Çështjen e byrove teknologjike e ka vendosur Komiteti Qendror i Partisë, por armiqtë e shtrembëruan synimin e drejtë që kishte Partia për to. Ata dalngadalë i frynë këta organizma dhe shtrembëruan udhëzimet e Komitetit Qendror. Armiqtë grumbulluan në këto byro gjithë ato forca krijuese dhe i organizuan në forma burokratike pranë çdo uzine, fabrike, ndërmarrjeje ose disa instituteve apo zyrave, duke i orientuar të punonin në të atilla drejtime që t'i rëndonin sa më shumë me nëpunës aparatet dhe t'i bënin këto sa më të kushtueshme. Ata flisnin gjoja për zgjerim kompetencash, por asnjërit nuk i ishte dhënë kompetencë. Vetëm Abdyl Këllezi, që njihej si «njeri me kokë të madhe», i kishte dhënë vetes kompetenca. Ai përpiqej të krijonte te njerëzit mentalitetin dhe pasionin për zyrat, për postet dhe për rrogat e majme. Të gjitha këto synime ishin kundër vijës së Partisë, kundër socializmit. Por këto prirje armiqësore u zbuluan nga Partia dhe gjërat u vunë në vend.

Edhe ju, ashtu si gjithë të tjerët, morët gërshërët e mëdha dhe i bëtë një krasitje të ndjeshme burokratizmit. Shumë njerëz u larguan nga disa vende ku qëndronin kot. Masat u përgatitën më mirë për të kuptuar prirjet dhe shfaqjet burokratike. Kjo punë i dha hov ndryshimit të stilit dhe të metodës së punës dhe ngjalli sensin revolucionar të kritikës e të autokritikës ndaj cilitdo që gabon. Ishte krijuar pikëpamja e rrezikshme që janë të pakritikueshëm drejtori i ndërmarr-

jes, punonjësit e komitetit të Partisë, të komitetit ekzekutiv, të ministrive apo të organeve të tjera qendrore. Këto mendime i përhapnin armiqtë për ta shkëputur Partinë nga masat. Por nuk u eci gjatë kjo punë, se njerëzit përgjithësisht e kuptojnë më mirë se mund dhe duhet të kritikohen të gjithë ata që bëjnë gabime, pavarësisht se cilët janë dhe ç'punë bëjnë. Ne nuk mund të sakrifikojmë interesat e mëdhenj të popullit dhe të Partisë për «sytë e bukur» të njërit apo të tjetrit. Në qoftë se komunistët e kuptojnë drejt këtë çështje, Partia jonë do të bëhet e pavdekshme, socializmi do të vazhdojë të ndërtohet me sukses nga të katër anët e vendit dhe nuk do të ketë asnjë armik që t'u bëhet pengesë serioze Partisë sonë dhe ideologjisë së saj. Por në qoftë se nisemi nga mentalitete të sëmura, nga disa pikëpamje të huaja, sipas të cilave «të mos kritikohet eprori, se të bën gjëmën», atëherë ju siguroj se edhe më vonë do të përsëriten ngjarje si këto për të cilat folëm.

Në qoftë se për veprimet e padrejta që vërtetohen në jetë do të vëmë në lëvizje organizatat-bazë të Partisë dhe masat e popullit, kushdo që gabon, që nga sekretari i organizatës-bazë e deri te funksionari i lartë i Partisë, nuk mund t'i dëmtojë rëndë dhe për një kohë të gjatë Partinë dhe republikën. Kur gabojmë, të mos jemi foddullë, por të përkulim kokën përpara drejtësisë së Partisë. Në qoftë se e duam Partinë, kështu duhet të veprojmë, dhe, që të veprojmë kështu, duhet të jemi të pastër, pse po patëm kleçka, po patëm njolla në ndërgegje, nuk mund ta bëjmë dot luftën për mbrojtjen e vijës së drejtë të Partisë.

Gabime mund të bëjë kushdo, por çështja është që këto gabime të njihen botërisht. Duke pranuar gabimet e fajet në punë, asnjërit nuk i ulet autoriteti. Kuadrot dhe komunistët e formuar nuk i shqetëson aspak autoriteti personal, ata nuk punojnë për të, se mbi të gjitha vënë interesin dhe autoritetin e Partisë. Partia kërkon që komunisti apo kuadri që ka gabuar të dalë pa hezitim përpara organizatës-bazë apo, kur është rasti, edhe para masave punonjëse e të thotë: «Unë, shokë, kam gabuar». Atëherë autoriteti i Partisë do të ngrihet dhe anëtarit i saj do të japë siguri se do të korrigjohet shpejt. Në qoftë se nuk konceptohet nga çdo komunist që mendimet, shfaqjet, puna dhe jeta e tij janë të lidhura me interesat e Partisë në qoftë se nuk sakrifikohet sedra mikroborgjeze para interesave të Partisë, atëherë nuk do të zbatohen drejt normat e Partisë dhe komunisti nuk do të kalitet në mënyrë revolucionare.

Dëmin e madh që na shkaktuan armiqtë e tradhtarët që zbuluam e kemi theksuar edhe në analizat e bëra në mbledhjet e Byrosë Politike që keni dëgjuar e keni studiuar. Komiteti Qendror i Partisë ka meritën se i zbuloi këta armiq. Por ata mund të zbuloheshin edhe më parë në qoftë se vigjilenca e masës së komunistëve e të punonjësve do të ishte më e lartë dhe në qoftë se disa veprime të dyshimta të armiqve nuk do të ishin nënvleftësuar. Çdo gjë e dyshimtë duhet vënë në dukje përnjëherësh, që në fillim, me qëllim që të korrigjohet shpejt dhe, po që se nuk korrigjohet, atëherë e keqja, sipas rastit, të spastrohet me masa partie ose edhe shtetërore. Diktatura e proletariatit godet rreptë dhe drejt, ashtu siç do t'i godasë kurdoherë të gjithë

elementët armiq. Kështu duhet të ngjasë në të ardhmen.

Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi me shokë, si armiq dhe hipokritë që ishin, kur ju vinin këtu në bazë, përpigeshin t'ju linin përshtypje të mira. Koço Theodhosi e kishte mendjen më shumë te hekurosja, se kishte frikë mos i zhubroseshin pantallonat, sesa te puna. Nipi i Turtullit i shikonte punët jo si udhëheqës, se kurrë s'ka qenë i tillë, por si teknokrat. Ai nuk ishte teknokrat si ata të borgjezisë, sepse teknokrati borgjez e njeh mirë zanatin e vet, por ishte ca më i keq, se as zanatin nuk e njihte. Koçoja ishte kufkë<sup>1</sup> nga koka, kurse nga veprimtaria ishte armik bashkë me Abdyl Këllezin, bile mund të themi se ishte një apendicit i këtij të fundit.

Të dy këta armiq vinin në bazë dhe krijonin atje situata të rreme euforike, duke përsëritur: «Jemi mirë, jemi kështu e ashtu, do t'i rregullojmë këto punë, do t'ju japim kredi, do t'ju dërgojmë mjete, do t'ju dërgojmë makina» etj., etj. Ata e dinin se mjetet e makinat ne nuk i kishim me bollëk të madh, prandaj çdo gjë caktohet me kohë, por vepronin kështu me qëllim të keq. Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi bënë edhe hile të tilla: lejonin të ndryshohej plani, të shpërndareshin kreditë andej-këtej pa kriter, nuk kontrollonin aspak zbatimin e planit etj.

Ju e dini se Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave kanë vendosur metodologjinë e planifikimit, por nga analiza që i bëmë zbatimit të saj, del se Komisioni i Planit të Shtetit këtë nuk e përfillte

---

1. Bosh.



fare! Në vend që të vepronte në bazë të saj, Abdyl Këllezi bënte nga lart një planifikim formal. Ai jo vetëm nuk vinte për konsultime në bazë, por nuk udhëzonte as njerëzit që merreshin me këtë punë që të kontrollohej zbatimi i planit. Kur rezultonte pastaj që plani nuk realizohej, fajet për të gjitha ua ngarkonte juve. Ju bënit kërkesa për furnizime materialo-teknike mbi parashikimet, sepse një situatë të tillë jua krijonte vetë Abdyl Këllezi me qëndrimet që mbante dhe me orientimet që jepte. Komiteti Qendror i Partisë nuk këshilloi të bëhen kërkesa jashtë parashikimeve të planit, sepse shteti ynë nuk ka mundësi t'i përballojë këto. Abdyl Këllezi e dinte sa e kishim ne jorganin, por ndryshe i nxiste të vepronin njerëzit në bazë e në rrethe. Kur fliste para nesh, ai thoshte: «Unë u shkurtova rretheve 20 000 punëtorë, ndërmarrjet nuk janë në vete, na kërkojnë investime kolosale!». Po pse, nga një anë, i nxiste rrethet për kërkesa dhe, nga ana tjetër, i shkurtonte këto? Ai vepronte kështu që baza të mbetej e pakënaqur nga mosplotësimi i kërkesave.

Ju nuk e dini me hollësi gjendjen tonë ekonomike. Njerëzit tanë kanë imagjinatë, specialistët dëshirojnë të ngrenë edhe këtë linjë, të ndërtojnë edhe atë objekt, por për t'i bërë këto na duhen çelique, çimento etj. Ku t'i gjejmë ato, kur të gjitha mjetet dhe lëndët e para janë të peshuara me kandar? E shikoni, pra, çfarë pune armiqësore bënte Abdyl Këllezi, duke vepruar mbrapsht edhe në këtë drejtim? Nganjëherë ndodh që edhe masat ose drejtues të punës së Partisë e të pushtetit në rreth apo në bazë nuk e kuptojnë mirë ndonjë direktivë të Partisë dhe ka raste që kërkojnë edhe ndonjë gjë që

nuk është e mundur të bëhet. Kështu ndodhi me disa kërkesa të fryra.

Të gjitha këto së bashku krijuan një situatë mjaft të vështirë, që e detyroi Komitetin Qendror të shikonte seriozisht gjendjen e krijuar, sidomos në drejtim të shtrembërimit të vijës së Partisë nga armiqtë. Këta po i fshihnin këmbët, duke përfituar nga hovi i madh i popullit në punë, nga forca mobilizuese e vijës së Partisë që bënte të realizoheshin planet. Armiqtë mendonin: «Po të kapemi, do të themi se nuk kemi sabotuar, ja, planet ecin mirë». Puna armiqësore nuk mendoj të arrinte gjer atje sa ta ndalte hovin tonë të madh përpara, ajo nuk mund t'ju pengonte ju që të realizonit me nder detyrat, se klasa punëtore dhe Partia e saj ishin në pararojë dhe në luftë. Megjithatë, armiqtë përgatitnin terrenin që të krimbej situata e shëndoshë e vendit tonë dhe në një të ardhme ne të ndodheshim në momente krize.

Veprimtaria armiqësore e Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit e të tjerëve ishte e bashkërenduar me veprimtarinë armiqësore të tradhtarëve Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Rahman Perllaku e të tjerë. Aktiviteti i armiqve në ushtri ishte kryesori, por ishte i lidhur ngushtë edhe me sabotimin në industri e në radhë të parë në atë të naftës, ku ne kemi humbje edhe në materiale, por sidomos në kohë. Përveç këtij dëmi të madh, na duhet të ndreqim një numër njerëzish që kanë gabuar. Partia nuk i dënon të tërë, pasi ajo, si kurdoherë, i dallon të gabuarit nga armiqtë, njerëzit që kanë vepruar duke qenë të mashtruar, nga ata që kanë vepruar me ndërgjegje. Të gjithë nuk janë futur në

rrugën e armiqve. Në këtë rrugë kanë qenë vetëm disa armiq, kurse një numër tjetër njerëzish, që kanë qenë të gabuar, si në ushtri, ashtu edhe në ekonomi, nuk janë të armiqve.

Armiqtë që zbuluam në ushtri ishin të rrezikshëm. Çdo gjë që ka parashikuar Komiteti Qendror i Partisë dhe që ka dalë nga analizat që i janë bërë veprimtarisë së armiqve, është vërtetuar në hetuesi. Këta tradhtarë kanë qenë me kohë agjentë të revizionistëve sovjetikë dhe punonin sistematikisht, në mënyrë të fshehtë, duke u përpjekur të izolonin Komitetin Qendror, për shkatërrimin e Partisë, për likuidimin e udhëheqjes së saj marksiste-leniniste dhe për shndërrimin e vendit tonë në një shtet borgjezo-revizionist. Armiqtë tash po i pohojnë të gjitha krimet me gojën e tyre. Beqir Balluku me shokë kanë pasur lidhje me njerëzit e grupit të Abdyl Këllezit, me sabotatorët e naftës, që është sektor kryesor në ekonomi, të cilin ata arritën të na e sabotojnë, duke bërë të humbasim pesë vjet kohë në zbulimet e naftës.

Në një kohë normale, sikur të mos kishin vepruar armiqtë, ne do të kishim tani dy dhe tri fusha të reja naftë, pra do të bënim një plan pesëvjeçar që mund të na siguronte nga 2,5 deri në 3 milionë tonë naftë. Me gjendjen e rëndë që është krijuar në këtë sektor, do të prodhojmë më pak naftë. Armiqtë, agjentë të sovjetikëve, që punonin atje, po e pohojnë vetë se kishin marrë urdhra nga padronët e tyre që të mos zbulonin naftë e të sabotonin rendin tonë socialist. Të gjitha pusët, deklarojnë ata, janë caktuar për shpim në ato vende ku dihej se nuk kishte aspak naftë. Në fakt, në

vendin tonë naftë ka dhe ne patjetër do të arrijmë të zbulojmë fusha të reja në një kohë të shkurtër.

Partia, që ka qenë dhe është në këmbë atje në naftë, e ka vërtetuar këtë gjë në mënyrë të pakundërshtueshme, por, shokë e shoqe, zëri i punëtorëve komunistë neve nuk na vinte, se ai bllokohej që në Komitetin e Partisë të Rrethit të Fierit nga tradhtari Pirro Gusho dhe nga disa të tjerë përreth tij. Zëri i njerëzve të ndërgjegjshëm të bazës bllokohej edhe nga Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi, prandaj ne në udhëheqje, ngaqë nuk na raportohej drejt për gjendjen e punëve në sektorin e naftës, shpesh thoshim: «More, po çfarë bëhet, përse nuk kemi naftë?». Atëherë armiqtë, për të na mbushur mendjen se kjo gjë ka «arsye», vinin e na flitnin për një sërë «teorish», nga të cilat as bindeshim, por as Partia nuk u vu në gjumë. Më në fund një punëtor komunist mori guximin dhe lajmëroi Komitetin Qendror se në sektorin e naftës bëhej punë armiqtësore dhe kjo veprimtari u zbulua.

Tash gjithë Partia në sektorin e naftës është në këmbë, se u morën masa. Siç e dini, pas pastrimit që u bë nga tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dume, Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi, në Byronë Politike erdhën katër shokë të rinj, punëtorë, dy nga të cilët janë nga rrethi i Korçës, pa përmendur këtu shokët Pilo Peristeri dhe Rita Marko, që janë të vjetër në Byronë Politike.

Në krye të Ministrisë së Industrisë e të Minierave kemi sjellë shokun Pali Miska, që është nga Devolli. Pali është shok i mirë, ka qenë punëtor i thjeshtë në sharra, ka punuar vazhdimisht mirë. Edhe si sekretar komiteti partie në rreth ka punuar mirë, ai i ka ngjitur

shkallët një nga një. Shoku Pali më parë nuk e njihte tërë industrinë, por, siç thashë, njihte mirë industrinë e përpunimit të drurit. Me aq sa mund të kuptoj nga eksperienca e gjatë e punës që kam në udhëheqje të Partisë, jam i mendimit se Partia ka gjetur te Pali Miska një shok të mirë dhe energjik, i cili do ta çojë punën përpara. Ai, në bisedat që kam pasur me të, më ka lënë përshtypjen e një kuadri drejtues të sigurt, që nuk ka as mburrje, as mendjemadhësi, as pesimizëm.

Personalisht konstatoj se në Byronë Politike kanë ardhur shokë me kualitete të mira. Gjer tani vetëm një mbledhje të Byrosë Politike kemi bërë pas zgjedhjes së shokëve të rinj, se pastaj u larguam për pushime, por nga disa takime që kam pasur me shokët Pali Miska, Qirjako Mihali dhe Llambi Gegprifti, kam krijuar përshtypje shumë të mira.

Ata që e drejtonin më parë industrinë, na gënjenin duke na thënë: «Atje një pus na dha shenja naftë». Këto informata të rreme jepeshin apostafat për të ulur vigjilencën tonë, pse pas një muaji po ata vinin e na thoshin: «Nuk doli gjë nga ai pus!». «Pse nuk doli?», pyesnim ne. «Po ja, nuk dha», na përgjigjeshin. Kështu vepronin ata edhe për degët e tjera të industrisë. «Kromi na shkon shumë bukur, kemi gjetur burime e shtëresa të reja në thellësi», na thoshte Koço Theodhosi, mirëpo Miniera e Batrës nuk na ecte mirë, tuneli i Klosit nuk po përfundonte, Instituti i Kërkimeve Gjeologjiko-Minerare nuk punonte fare në këto drejtime etj.

Sabotimi në fushën e ekonomisë shoqërohej me sabotimin në ushtri, që është sektori kryesor dhe jetik për mbrojtjen e atdheut. Armiqtë mendonin që ush-

trinë, këtë forcë të madhe goditëse, ta përdornin në momentin e përshtatshëm që të likuidonin Partinë, udhëheqjen e saj dhe pushtetin popullor. Këtë goditje prapa shpinës ata do ta bënin me metoda trockiste e revizioniste. Tradhtarët që udhëhiqnin Ministrinë e Mbrojtjes kishin marrë masa që asnjë raport, asnjë e dhënë të mos kalonte nga ushtria drejtpërdrejt në Komitetin Qendror të Partisë, por gjithçka të shihej paraprakisht prej tyre. Ne merrnim raporte nga Ministria e Mbrojtjes për gjendjen në ushtri, por kjo gjendje paraqitej ndryshe nga ç'ishte në të vërtetë.

Kuadrot e ushtrisë në reparte ishin njerëz të mirë, por armiqtë kishin krijuar një situatë të atillë në ushtri që njerëzit të kujtonin sikur çdo gjë që bëhej atje, çdo urdhër që jepej etj., kishte vulën e Këshillit të Mbrojtjes, të Byrosë Politike. Komiteti Qendror kishte lëshuar direktiva të qarta për punën e Partisë në ushtri, duke porositur të mbaheshin parasysht demokracia dhe disiplina proletare, të kihej besim tek udhëheqja, por të mos harrohej motoja: «Beso e kontrollo» etj. Armiqtë, në kundërshtim me direktivat e Partisë, kishin krijuar një situatë të atillë në ushtri sa kuadrot të mendonin se po vepronin në rrugë të drejtë, se me atë metodë që kishin futur armiqtë në udhëheqje të Ministrisë së Mbrojtjes duhej punuar që të forcohej ushtria! Kjo ishte një situatë shumë e rrezikshme.

Raportet që na vinin neve ishin «të ujdisura», pra ndaj, kur i lexonim, dësa shfaqje të dobësive në punë i konsideronim si të meta e boshllëqe të natyrshme. Në realitet gjendja në ushtri ishte ndryshe. Sa nuhatëm se atje kishte diçka që fshihej, vumë menjëherë dorë për

të parë organizimin e punës që kishte bërë Beqir Balluku, dhe pastaj u shtur «filli i çorapit». Armiku deshi të manovronte përsëri.

Petrit Dumja, Hito Çakoja, Rahman Perllaku e ndonjë tjetër e kthyen fletën menjëherë, ia lëshuan Beqir Ballukut të tëra bateritë, të lëra fajet. Ky, duke dashur të ruante bashkëpunëtorët e komplotit, nuk foli fare kundër tyre, por i mori vetë përsipër të tëra fajet, sepse ishte armik i regjur dhe mendonte të linte pas bashkëpunëtorët, që kujtonte se nuk u zbuluan. Ai veprroi kështu me qëllim që këta të minonin Partinë. Petrit Dumja e Hito Çakoja na u bënë me fletë, se kujtuan që e fituan davanë. «Tani u bëra dhe ministër», mendoi me vete «agai i Kolonjës», Petrit Dumja. Por Byroja Politike nuk i hante këto dredhi të armiqve, ajo e zbuloi këtë komplot. Petritit dhe Hitos u ranë pendët, por prapë, duke mbajtur poste me rëndësi, e kishin zëmrën të ngrohtë, gjersa më vonë morën edhe grushtin tjetër. Tash këta kanë pohuar në hetuesi gjithë veprimtarinë e tyre armiqësore.

S'ka dyshim se puna armiqësore e zhvilluar në ushtri na ka dëmtuar, por zbulimi i saj ishte një fitore e madhe për Partinë, për popullin dhe për socializmin, sepse u qërua një gangrenë që, po të mos operohej, do të bëhej e rrezikshme. Kështu u spastrua koka dhe u hapën sytë e njerëzve të ndershëm që padashur kishin bërë edhe gabime. Partia tash përpiqet që edhe ata, të cilët me ndërgjegje kishin bërë gabime, por nuk kanë kryer krime, t'i ndreqë, duke i dërguar që të korrighohen e të kaliten në mengenenë e klasës. Ju në ndër-

marrjen tuaj keni plot mengene, kudhra etj. Kur doni të prodhoni një vegël, ju i shtrëngoni vidhat, pastaj i futni limën rreth e rreth derisa ajo të vijë në atë gjendje sa të shërbejë për destinacionin e caktuar. Kështu duhet bërë edhe me ata që kanë gabuar, të cilëve u duhet «larë koka» mirë. Prandaj mos na thoni «Pse na i dërgoni këtu këta njerëz?», se ne jua sjellim që ju shokët e klasës «t'u lani kokën» e «t'i zdrugoni», në mënyrë që të mos i lëmë t'i bëjnë keq atdheut as sa maja e thoit. Kjo është rruga e drejtë e Partisë për të ndrequr ata që kanë gabuar.

Armiqtë që kanë vepruar me ndërgjegje dhe kanë kryer krime të rënda kundër shtetit, do t'i jepen gjyqit për t'u gjykuar sipas ligjit. Ka disa njerëz që pyesin: «Çfarë bëhet me tradhtarët, pse nuk gjykohen?». Krimet e tyre janë të provuara, veprimtaria e tyre është e qartë, por i duhen shkukur rrënjët së keqes, duhet zbuluar gjithçka me kujdes e gjakftohtësi, se ajo që na ngjau tani, nuk duhet të na ngjasë më.

Këto ngjarje të hidhura që na u vërtetuan, ishin një shkollë e madhe që duhet të na shërbejë për t'u mobilizuar në rrugën e drejtë të Partisë, mësimet e së cilës lypset t'i lexojmë e t'i studiojmë vazhdimisht, jo si një literaturë pa fryt e pa qëllim, por si një eksperiencë të madhe të zbatimit në kushtet tona të ideve të mësuesve të mëdhenj të proletariatit botëror. Këtë duhet ta bëjmë për të kryer me nder të gjitha detyrat që na vihen. Dhe detyra kemi shumë, shokë.

Aktualisht kemi përpara planin e vitit 1976, që ju vetë po e përpunoni. Ai do të na vijë në Qeveri dhe në Komitetin Qendror, ku do të përpunohet gjithë



plani pesëvjeçar. Ne parashikojmë që plani i ri pesëvjeçar të jetë i ngjeshur. Synimi i tij është fuqizimi i mëtejshëm i ekonomisë dhe i mbrojtjes së vendit tonë. Ne kemi pasur suksese në realizimin e planit që po mbyllim, por kemi edhe boshllëqe. Shumë detyra do t'i realizojmë, ka edhe disa që nuk i'plotësojmë dot, për arsye objektive dhe subjektive.

Kemi në ndërtim e sipër disa objekte kryesore që duhet t'i mbarojmë këtë pesëvjeçar, disa objekte do të na kalojnë për pesëvjeçarin që vjen. Në plan ka objekte që pjesërisht do të mbaronin deri në fund të këtij viti, por një pjesë do të mbeteshin për t'u përfunduar edhe më pas, si për shembull hidrocentrali i Fierzës dhe kombinati metalurgjik, ndërsa rafineria e naftës në Ballsh mendoj se mund të mbarojë këtë vit, por mund të mbetet diçka për tremujorin e parë të vitit 1976. Si këto që përmenda ka edhe ndërmarrje të tjera që do të përfundojnë plotësisht pesëvjeçarin tjetër.

Ne do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e ri hidrocentralin e Komanit, që është me kapacitet më të madh se ai i Fierzës. Do të ndërtojmë, gjithashtu, një uzinë tjetër për prodhimin e uresë, një uzinë të madhe për të prodhuar makina që do të plotësojnë të gjitha nevojat e minierave, do të ndërtojmë një minierë qymyri të re e objekte të tjera, të cilat, bashkë me ato që kemi në vazhdim, do të përbëjnë një plan shumë të ngjeshur, për plotësimin e të cilit do të na duhet një mobilizim shumë i madh në punë.

Në vendin tonë ne kemi një industri mekanike të fortë, e cila, e organizuar dhe e drejtuar nga njerëzit e klasës dhe nga lart, me plane të qarta, e grumbu-

lluar dhe jo e shpërndarë fije-fije andej-këtej siç është tash, do të na japë mundësi jo vetëm të prodhojmë në vend vegla ndërrimi dhe të riparojmë makineri të ndryshme, por të prodhojmë edhe makineri. Kështu ne i kemi vënë në plan Ministrisë së Industrisë e të Minerave që të studiojë vetë mundësinë e prodhimit të motorëve në masën deri 80 për qind me forcat tona, kurse pjesën që mbetet prej 15-20 për qind të atyre motorëve që nuk do t'i bëjmë dot në vend, do ta sjellim nga jashtë. Kështu, për shembull, ne mund t'i prodhojmë vetë të gjitha makineritë e një fabrike sode me kapacitet sa ajo e Vlorës, sepse ky artikull ka interes shumë të madh, pasi na siguron devizë dhe punon me lëndë të parë që e kemi me bollëk në vend, siç janë kripa dhe gëlqerja. Sa më tepër uzina për prodhimin e sodës të kemi, aq më shumë të ardhura do të sigurojmë. Ne mund të parashikojmë, gjithashtu, ndërtimin e një uzine tjetër superfosfati si ajo e Laçit, ose fabrika çimentoje, por edhe të tjera të kësaj natyre, që tash mund t'i ndërtojmë vetë.

Rëndësi ka që industrinë mekanike ta marrin mirë në dorë specialistët punëtorë. Nuk mund të ecin përpara industria e minierat pa pjesëmarrjen e gjerë të punëtorëve të kualifikuar, ashtu sikurse nuk mund të ecë përpara bujqësia pa punën e madhe të kooperativistëve. Me këto që them nuk dua të nënvlerësoj aspak rolin e inxhinierëve e të agronomëve, se, natyrisht, edhe këta dhe gjithë të tjerët luajnë rolin e tyre në prodhim, por rolin kryesor e kanë punëtorët e fshatarët. Neve na duhen inxhinierët e klasës në një numër të arsyeshëm. Nuk është e drejtë prirja, sipas së cilës

«oburra të nxjerrim sa më shumë inxhinierë, që të bëhen të gjithë punëtorët inxhinierë!». Jo, kryesori në prodhim është tekniku i mesëm, se ai e vë në lëvizje makinerinë. Inxhinieri i rri mbi kokë teknikut, e këshillon dhe bën projektet, por projektet i zbaton punëtori teknik i mesëm, ky prodhon. Në qoftë se ju punëtorët nuk e zbatoni planin, atrecaturat dhe gjithë fabrikën i merr lumi. Industrinë që kemi ngritur duhet ta bëjmë një armë të fuqishme në duart tona për sot dhe për të ardhmen.

Ne po ndërtojmë një kombinat të madh metalurgjik, i cili është shpëtim ekonomik për Shqipërinë. Ai do të sigurojë «bukën» e gjithë industrisë sonë dhe do të ndihmojë edhe bujqësinë që të ecë përpara me ritme më të shpejta. Kjo vepër ka perspektiva edhe për zgjerim të mëvonshëm. Do të vijë koha që ta shtojmë kapacitetin e saj. Në kombinatin metalurgjik ne do të prodhojmë shumë lloje çeliqesh, të cilat sot i importojmë me devizë dhe me klering. Të dhënat e deritanishme tregojnë që çeliqet e prodhuara me mineralin tonë do të jenë me cilësi të lartë, më të forta dhe më të mira nga të shumë vendeve të tjera. Kjo degë e re e industrisë sonë është shumë premtuese për ne, siç janë premtuese gjithë minierat.

Sektor tjetër me rëndësi jetike është bujqësia, e cila përbën bazën e ekonomisë sonë. Ju korçarët mbase edhe për bujqësinë jeni pionierë. Unë nuk do të flas shumë për këtë çështje këtu te ju, por do t'ju them se aktualisht, në këto situata, na vihet detyrë ta ngremë në një nivel më të lartë bujqësinë tonë socialiste. Vitet e fundit ne kemi shembuj rendimentesh të shkëlqyera

në bujqësi. Rendimentet e grurit dhe të bimëve të tjera që merren Italia, Gjermania Perëndimore e Franca dhe që më përpara na habitnin, sot arritën t'i marrin edhe kooperativistët tanë. Si u arrit ky sukses? Së pari, për shkak të ngritjes politiko-ideologjike dhe teknike të kooperativistëve, pastaj për arsye se u dërguan shumë kadro me arsim të lartë e të mesëm në fshatra. Hapja e kurseve, e shkollave të mesme bujqësore, e fakulteteve në Institutin e Lartë Bujqësor, shtimi i mekanizmave, bonifikimet dhe sistemimi i tokave, proces ky që nuk ka mbaruar akoma, por është në vazhdim, ujitja, studimi pedologjik i tokave, zgjedhja e farërave, të tëra këto kushte që siguroi Partia për bujqësinë tonë, të marra në kompleksitetin e tyre, sollën gjithë këtë përparim.

Me mundësitë që ka krijuar Partia, çapin që hidhnim deri tani, këtoje e tutje duhet ta shtrijmë në tepër. Është një gjë e madhe që në një parcelë të mbjellë me grurë në kushte të vështira në kooperativën e Çërravës të merren 72 kuintalë për hektar. Gruri që bërë aq i mirë, sa nuk e çante dot as kombajna! Raste të tilla, siç më thanë shokët, keni edhe ju në Korçë. Në Devoll kanë marrë mesatarisht nga 40 dhe nga 50 kuintalë grurë për hektar. Ky është sukses i madh. Në vendet kapitaliste që përmenda më parë, pronarët privatë të tokave vërtet marrin rendimente të tilla, por ato i arrijnë në sipërfaqe të kufizuara, ku kanë futur shumë makineri dhe mjete të tjera automatike që u duhen.

Kam parë një film për bujqësinë e Holandës. Në ekran paraqiteshin toka që dikur ishin nën ujë dhe që tashti ata i kanë kulluar. Tregohet një fermë që kishte me mijëra hektarë tokë dhe prodhonte zarzavate.

Filmi paraqiste një sallë ku kishte vetëm susta. Spi-keri tregonte: «Tash do të shihni ujin», dhe shtypte një sustë. Dukej menjëherë një fushë e tërë e mbuluar nga shiu. Pastaj ai thoshte: «Tash do të shpërndahen insekticidet», shtypte një sustë tjetër e dallohej spërkatja e fushës me insekticide. Të gjitha proceset e punës atje bëheshin të automatizuara dhe, natyrisht, merreshin rendimente të larta. Mirëpo kjo ishte vetëm një ekonomi, sepse në vendet kapitaliste miliona e miliona hektarë tokë, për arsye që dihen, mbeten djerrë. Kapitalizmi i ka dhënë fshatarësisë një grusht të fortë kurri-zit. Ekonomitë bujqësore private kanë mbetur me pesë e me dhjetë hektarë tokë, ku fshatari mund të prodhojë sa për të mbajtur veten dhe një djalë, si në Kalabri, se nuk ka mundësi t'i mbajë fëmijët e tjerë, të cilët i dërgon të bredhin për bukë rrugëve të qyteteve, deri në shtete të tjera. Në këto vende ka papunësi të madhe. njerëzit sillen vërdallë, prandaj po zhvillohet sheshit një banditizëm që nuk ishte dëgjuar më parë. Kështu ndodh në Itali, në Francë etj.

Ne kemi shembuj interesantë që flasin për suksese në bujqësi, vetëm se për t'i shtrirë kudo këto suksese duhen akoma organizim më i mirë në punë, ngritje më shkencore dhe shfrytëzim racional i gjithë këtyre faktorëve që ka krijuar Partia. Në bujqësi duhet të bëjmë një plan ambicioz. Kjo do të thotë që, kur planifikojmë, të mos kënaqemi vetëm duke kaluar sivjet në një përqindje të vogël atë prodhim që realizuam vjet, por të ecim me hapa më të mëdhenj. Derisa kemi siguruar farë misri hibride dhe ujë të njaftueshëm për ujitje, duhen marrë jo 35, por 70 quintalë misër për hektar.

Ky rendiment ka mundësi të realizohet. Unë kam parë një vajzë brigadiere në kooperativën bujqësore të Lapardhasë në Berat që i rrinte misrit në kokë. Bashkë me shoqet e saj të brigadës ajo mori 75 kuintalë për hektar, atëherë pse të mos marrin kaq edhe të tjerat?

Dua të theksoj se, ashtu siç kemi specialistë të zotë në industri, si bie fjala inxhinierë, teknikë, teknologë e të tjerë, të tillë kemi edhe në bujqësi, si agronomë, veterinerë, biologë e të tjerë, që e dinë mirë zanatin e tyre. Shokët drejtues të Partisë e të pushtetit në rreth dhe në bazë duhet të mbështeten në këta specialistë dhe t'i dëgjojnë, t'u marrin mendimin e të diskutojnë me ta. Nganjëherë disa nga këta njerëz, për mungesë eksperience, mund të kenë imagjinatë të lepruar, sepse duan të arrijnë të gjitha rezultatet që gjejnë duke studiuar literaturë, por duhet të merremi vesh me ta që të jenë më realistë. Shkenca nuk ka mbarim, ajo mund të krahasohet me puset e naftës. Naftën mund ta gjesh edhe fare afër sipërfaqes, në thellësi 50 metra nën rërë, siç ndodh në emiratet e Gjirit Persik, por mund ta gjesh edhe në thellësitë 2 000, 5 000, 6 000 e deri në 10 000 metra. Mund të ndodhë të futesh në humnera të thella deri 1 500 metra, siç venë me batiskafe në dete, për të studiuar tokën, për shembull, për mineralet. E tillë, si pus i thellë, është shkenca, që nuk ka fund.

Librat nuk i japin të tëra dituritë shkencore. Me rëndësi në këtë drejtim është edhe eksperiencia praktike, prandaj duhet mbështetur fort në përvojën e punëtorëve, të teknikëve të mesëm, të brigadierëve. Eksperiencia e gjithë këtyre u hap horizont udhëheqjes së Partisë, inxhinierëve dhe vetë atyre për të marrë pro-

dhime të mëdha për Shqipërinë, për atdheun tonë socialist. Ne kemi nevojë të madhe për këto prodhime, sepse bollëku ndihmon forcimin e gjendjes së brendshme të vendit, e cila luan një rol të madh edhe për pozitën ndërkombëtare të atdheut.

Situata në botë sot është e turbullt, shokë. Kurrë të mos harrojmë rreziqet që mund të sjellë situata ndërkombëtare e ndërlikuar. Ne, në rast konfliktesh ndërkombëtare, nuk mund të shpëtojmë pa luftë. Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik përpiqen të vendosin kudo hegjemoninë e tyre. Po mbi kë? Mbi tërë botën. Dhe një nga vendet e kësaj bote është Shqipëria jonë, e cila është dyfish armike e tyre, për arsye se përfaqëson socializmin, komunizmin, prandaj armiq të tanë luftojnë që të na likuidojnë. Por këtë nuk e arrijnë dot. Ata mund të kenë fuqi të madhe ushtarake dhe ekonomike, por nuk kanë forcën morale dhe opinionin e gjerë botëror përkrah vetes.

Vendi ynë, me politikën e drejtë që ndjek, me rezultatet e arritura në ekonomi dhe në fushën e mbrojtjes, si dhe me mbështetjen pa frikë që u bën së drejtës, revolucionit dhe forcave përparimtare, ka krijuar një opinion të mirë në botë. Fjala e Partisë dhe e shtetit tonë dëgjohet me vërejtje të madhe nga revolucionarët, nga komunistët, nga njerëzit përparimtarë, bile edhe nga borgjezët. Deri edhe kapitalistë reaksionarë e dëgjojnë me respekt fjalën e Shqipërisë, pavarësisht se janë armiq të sistemit tonë shoqëror dhe të rendit tonë shtetëror. Po pse dëgjohet me respekt fjala jonë? Sepse të tëra ato që themi janë të vërteta, janë në përputhje të plotë me të drejtën dhe me qëndrimet tona mark-

siste-leniniste. Midis vendeve të botës kapitaliste ka kontradikta të mëdha, mirëpo, për arsye të pleksjes së shumë faktorëve, mjaft nga këto vende e mbajnë gojë të mbyllur dhe nuk flasin dot. Ngrihet Shqipëria këtu në Evropë dhe flet pa frikë për mbrojtjen e së vërtetës. Kapitalisti detyrohet të pranojë se drejt e ka Shqipëria, kështu si thotë ajo është, por meqë ai nuk ka kurajë të flasë edhe vetë, admiron trimërinë tonë. Ka vende në botë që nuk flasin dot kundër Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, megjithëse nuk janë dakord me shumë nga veprimet e tyre. Edhe ata që janë kundër politikës agresive të imperialistëve amerikanë ose kundër politikës së revizionistëve sovjetikë, thonë vesh më vesh: «Shqipëria e ka drejt, pse superfuqitë vërtet po na pinë gjakun», por asnjëri nga këta nuk thotë dot hapur një fjalë kundër superfuqive. «Vetëm ju shqiptarët flitni hapur kundër sovjetikëve e amerikanëve dhe thoni të drejtën kundër tyre. Ju lumtë! Po si është e mundur të mos keni frikë?», u thonë të huajt diplomatëve tanë jashtë shtetit. «Ne nuk kemi frikë, — u përgjigjen atyre njerëzit tanë, — se kemi Partinë që ndjek një vijë politike të drejtë marksiste-leniniste, kemi një popull që është i lidhur me Partinë si mishi me thoin dhe e ndjek atë deri në fund me besim të plotë. Ne shqiptarët jemi sovranë, nuk jemi të varur nga kurrkush dhe bëjmë politikën tonë».

Përpara na akuzonin sikur ne ishim satelitë të të tjerëve, por jeta i bindi të gjithë se, kur gjykonin kështu për Shqipërinë, gaboheshin. Tash është zhdukur kjo akuzë, deri dhe ata që ishin më të turbuarit kundër nesh tashitë kanë arritur të kuptojnë se shqiptarët jo ve-



tëm s'kanë qenë e nuk do të jenë satelitë të askujt, por janë në gjendje të bëjnë një politikë të tillë të drejtë e të pavarur sa nuk po e bën askush tjetër. Kështu si ne mund të veprojmë vetëm një popull i bashkuar me një parti që ka në krye një udhëheqje të qëndrueshme. Që kur është krijuar Republika Popullore e Shqipërisë, udhëheqja e saj qëndron e fortë dhe e palëkundur. Demokracinë tonë popullore është zor ta kuptojnë të tjerët, për arsye se demokracia e tyre është ndryshe nga jona, ajo është demokraci e pasanikëve.

Laburistët apo konservatorët mund të dalin e të flasin në Hajd Park të Londrës, ku ka shumë vende për të ndenjtur. Ndonjëri prej tyre mund të ngrihet, të hipë në fron dhe të bërtasë sa t'i venë afër disa dhjetëra vota e ta dëgjojnë kur thotë: «Poshtë Çerçilli!» apo «Poshtë Elli!» etj. E punë e madhe se folka ky borgjez, kush ia var atij? Borgjezia me aparatën e fuqishëm të diktaturës së vet të egër, kur ia do puna, të lëshon gazin, se ka forcën në dorë, ajo ka policinë, xhandarmërinë, ushtrinë dhe pompat e ujit, ka edhe fuqinë ekonomike dhe nuk pyet për atë që s'ka ç'i bën, prandaj i thotë: «Gri ti, po deshe, gjersa të lodhesh, se edhe ata që të dëgjojnë ta kanë pirë lëngun». Kësaj llogaritjeje llafazanësh që kanë vetëm fjalë, në vendet kapitaliste i thonë demokraci, prandaj ata nuk mund ta kuptojnë demokracinë tonë proletare, të cilën ne duhet ta zhvillojmë akoma më tepër, se është demokraci në kuptimin e plotë të fjalës.

Partia jonë i hap zemrën popullit dhe i thotë: «Gjy-

ko, fol e këshillomë si të punoj dhe të zbatoj më mirë vijën. Në qoftë se veprojmë mirë, lidhu më fort me mua, në qoftë se gaboj, hiq më veshin e më thua që e kam gabim». Ka demokraci më të gjerë se kjo? Këtë demokraci, që na mësojnë Partia dhe klasa, disa njerëz, bile edhe me poste drejtuese, nuk e kuptojnë si duhet, prandaj duan ta kufizojnë një çikë. Po për ç'arsye të kufizohet? Kush e realizon planin? Populli, masat punonjëse. Atëherë si të mos ketë të drejtë të flasë ai që punon për plotësimin e planit? Ju, shokë punëtorë, që bëni këto atrecatura kaq të përsosura, si është e mundur të mos keni të drejtë të shprehni mendimin tuaj për punën e të thoni: «Duhet ta bëj kështu këtë punë, se është më mirë?» Dhe mblidhen njerëzit tanë të diskutojnë për problemet që u interesojnë të gjithëve. Krihen mendimet e ndryshme, ballafaqohen pikëpamjet e kundërta dhe nxirret konkluzioni që i shërben punës. Ç'është kjo? Kjo është demokraci. Në qoftë se unë të them: «Futi këto vegla në furrë!» dhe nuk të lejoj të ma kundërshtosh këtë urdhër të dëmshëm, vallë demokraci është kjo? Jo, nuk është aspak demokraci, por detyrim me pasoja të rrezikshme. Demokracia jonë është kundër metodave të diktatit të personave të veçantë ndaj masave punonjëse, prandaj ajo është më e mira demokraci që ekziston në botë.

Në arenën ndërkombëtare Shqipëria zë një vend të rëndësishëm dhe luan një rol të madh. Me atë sa kemi mundësi, ne i ndihmojmë miqtë dhe shokët tanë, duke zbatuar një vijë marksiste-leniniste, revolucionare. Vendi ynë është i vogël, këtu njerëzit njihen të tërë në punë dhe në shoqëri. Ne i njohim dhëmbët e dhëmba-

llët njëri-tjetrit. Kjo është një anë shumë pozitive për vendin tonë të rrethuar nga armiq të egër imperialistë e revizionistë. Po të zbulohet me kohë që dhëmbi është i prishur, njeriu vete te dentisti dhe e ndreq më shpejt e me më pak dhimbje. Kështu është edhe me njerëzit. Në qoftë se Partia të njeh me të mirat e të këqijat, kjo është gjë e mirë, se të ndreq në kohën e duhur.

Ne komunistët shqiptarë mendojmë dhe jemi të bindur se armiqtë tanë janë edhe imperialistët amerikanë, edhe socialimperialistët sovjetikë, pra që të dy janë të rrezikshëm, kurse shokët kinezë kanë një nuanë të ndryshme nga ne në këtë drejtim dhe mendojnë se imperializmi sovjetik është më i rrezikshëm nga ai amerikan. Këtu kemi një ndryshim në mendim, që e themi botërisht. Këtë e dinë edhe vetë kinezët. Ne themi se duhet t'i luftojmë që të dy këta armiq të popujve tanë dhe të përpiqemi t'i thellojmë kontradiktat midis tyre. Kontradiktat thellohen duke ngritur në këmbë kundër klikave sunduese masat e popullit, sepse ato janë motori i revolucionit, që mund të shkatërrojnë makinën imperialiste dhe socialimperialiste. Të gjithë organizmat që ka krijuar kapitali botëror për interesat e tij ne duhet t'i sabotojmë në rrugën që na tregojnë Marks, Engelsi, Lenini e Stalini. Për këtë qëllim është e domosdoshme të organizohet klasa punëtore në aleancë me të gjitha masat përparimtare. Ajo, e lidhur me këto masa sup më sup si malet, siç thuhet në vjershën e një poeti, duhet t'i bjerë me grusht të hekurt murit kapitalist gjersa ta rrëzojë përtokë. Të mos lihet asnjë e çarë prej nga mund të futet bishti i imperializmit. Ne këtë rrugë ndjekim.

Kapitalizmi evropian ka krijuar për interesat e tij Tregun e Përbashkët me influencë botërore. Nuk ka asnjë dyshim se Tregu i Përbashkët Evropian është në kundërshtim me forcën ekonomike të imperializmit amerikan dhe me atë të KNER-it sovjetik, por, megjithëkëtë, ne mendojmë se ky mbetet prapëseprapë tregu i kapitalistëve që ka për qëllim të shtypë popujt dhe revolucionin në Evropë e kudo gjetkë. Për këtë arsye ne jemi kundër Tregut të Përbashkët Evropian, ndërsa kinezët edhe në këtë çështje kanë një nuancë të ndryshme nga ne, sepse e mbështetin Tregun e Përbashkët vetëm për arsye se ky është kundër sovjetikëve.

Një ndryshim tjetër mendimi me shokët kinezë kemi ne edhe lidhur me Evropën e Bashkuar. Ne jemi kundër një Evrope të Bashkuar, se nuk duam që Evropa kapitaliste të bëhet një fuqi e madhe ekonomike, politike dhe ushtarake kundër popujve. Lenini në kohën e vet ka thënë se duhet të jemi kundër Evropës së Bashkuar dhe popujt nuk duhet të lejojnë të bëhet një gjë e tillë. Duke e gjykuar situatën kështu, ne jemi kundër këtij bashkimi. Kinezët jo se nuk i njohin këto që themi ne, por shprehen në favor të Evropës së Bashkuar për arsye se kjo gjë është kundër Bashkimit Sovjetik. Natyrisht, vendet e Evropës Perëndimore janë kundër Bashkimit Sovjetik, por deri në njëfarë pike, sepse dihet që imperialistët kanë kontradikta me njëri-tjetrin, por ata edhe bashkëpunojnë që të bëjnë ligjin në sferat e tyre të influencës. Kryesore dhe parimore është çështja që çdo gjë duhet parë nga ana klasore, çdo veprim të gjykohet nëse është ose jo në interes të klasës e të revolucionit. Po që se mbrohen interesat

e klasës, ta çojmë çështjen përpara, po që se veprimi është vetëm koniunktural, atëherë duhet menduar me kujdes.

Shteti edhe Partia jonë bëjnë një politikë të drejtë; ata nuk heqin dorë për asnjë çast nga parimet marksiste-leniniste. Artikujt tanë për problemet ndërkombëtare i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi. Njerëz të borjezisë franceze kanë arritur të thonë se të gjitha ato që u bënë në Konferencën e Helsinkit janë përralla, janë një bluf, prandaj asnjë nuk i zbaton. «Keni të drejtë ju shqiptarët, — thonë përfaqësues të kapitalit të madh francez, — por ne do të dëshironim që ju të kishit ardhur në Helsinki dhe kundërshtimin që keni shprehur në shtyp ta thoshit në mbledhje, pastaj të ngriheshit e të iknit». Shokët tanë jashtë shtetit iu përgjigjën: «Jo, është më mirë t'i demaskosh superfuqitë nga jashtë dhe të mos pranosh të vesh e të marrësh erën e qelbur të planeve të ndyra që kurdisin ato». Edhe kapitalistëve të tjerë, veç atyre francezë, u vjen për hosh kjo gjë. Të gjitha shtetet kapitaliste të Evropës përpiqen ta krimbin Bashkimin Sovjetik, t'i shkëputin atij nga ndikimi Poloninë dhe pastaj, njërin pas tjetrit, edhe satelitët e tjerë. Këtu është qëllimi i tyre, mirëpo Bashkimi Sovjetik, duke dashur të ruajë gjendjen, u shtrëngon rripat «aleatëve» të vet.

Situata e vendit tonë është e shkëlqyer dhe shumë optimiste. Partia qëndron e fortë, me një unitet të çeliktë marksist-leninist të radhëve të veta dhe e lidhur ngushtë me popullin. Industria e bujqësia jonë po përpunojnë, por ne duhet të jemi akoma më tepër vigjilentë e vazhdimisht vigjilentë ndaj armiqve.

Të shtojnë më shumë përpjekjet për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë e të bujqësisë, të mos lejojnë të harxhohen kot materialet dhe fondet monetare, të mos na mbushen depot me mallra stoqe, se kjo është e rëndë dhe e dëmshme për ekonominë. Prandaj ju klasa punëtore duhet të vini dorë në këtë drejtim. Partia kërkon që kontrolli juaj të jetë i rreptë mbi ata që s'kryejnë detyrat. Haka askujt të mos i hahet, zotësia askujt të mos i mohohet, nderi askujt të mos i cenohet, por nga secili duhet kërkuar që të kryejë si duhet detyrën ndaj atdheut, pse vetëm kështu gjithkush do të meritojë respektin e dashurinë e Partisë dhe të popullit. Ne duhet të shkojmë nga parimi që si individ e si Parti nuk mund t'i shpërblejmë kurrë detyrimet që kemi ndaj popullit tonë të mrekullueshëm, që e do kaq shumë Partinë. Prandaj këto gjëra t'i mbajmë mirë parasysh në punën tonë kolektive dhe në veprimet vetjake.

Unë kaq kisha. Shoku Pilo po më thotë se mos kanë edhe shokët ndonjë fjalë për të thënë. Mbase keni ndonjë këshillë për të na dhënë, se ne kemi ardhur këtu pranë jush edhe për të mësuar e jo vetëm që të flasim e ju të na dëgjoni. Edhe ne dëshirojmë t'ju dëgjojmë të na thoni nëse i kemi drejt këto punë apo nuk i kemi. E vërteta është që punët na shkojnë mirë, por edhe ne kemi të meta që i kemi njohur. Edhe ju mund të na thoni gjëkafshë. Vetë shoku Pilo mund të na thotë diçka, se ka një eksperiencë të madhe për mekanizimet. Piloja është punëtor i vjetër, kovaç, dhe sot «kovaçhana» që drejton ky nuk është më si ajo që ishte dikur karshi kafe «Afrikës», prandaj, shoku Pilo, mund

t'u thuash shokëve të kësaj uzine ndonjë gjë për shkëmbim eksperience? Uzina «Traktori», që drejtoni ju, është një ndërmarrje e përparuar.

*SHOKU PILO PERISTERI:* Unë u kam dëgjuar gjithnjë zërin e mirë punëtorëve të këtij rrethi. Korça me të vërtetë nuk e turpëron veten, këto i them jo se jam korçar dhe më pëlqen të flas kështu, por se kudo punëtorët korçarë dëgjohen për të mirë. Ata kanë një kuptim të drejtë për problemet që shtrohen. Vijën e Partisë këtu e zbatojnë mirë edhe në industri, edhe në bujqësi.

Unë jam dakord me ju, shoku Enver, se rezerva ka kudo, këtë e shikojmë gjithandej, ato zbulohen dhe vihen në shërbim të interesit të përgjithshëm. Në këtë uzinë, me sa e njoh unë dhe siç më kanë thënë shokët, është realizuar jo vetëm ajo që kishim parashikuar ne të arrihej, por është ecur edhe më tej. Kolektivi i këtushëm pothuajse e ka dyfishuar prodhimin, edhe cilësinë e ka çuar përpara, sepse vërtet e harxhon materialin, por nxjerr instrumente të mira. Po bërë një vegël, e cila në vend që të të çojë 100 kilometra të çon 200, kjo do të thotë se ke fituar lëndën e parë dhe i ke kursyer remontet dhe shërbimet e tjera që do t'i bëheshin makinës. Kështu, pra, nga rritja e cilësisë kemi fitime të mëdha.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu siç bën, për shembull, shoferi i dalluar Spiro Lera, i cili nuk paska ardhur sot këtu. I bëni shumë të fala nga unë këtij shoferi shembullor. Si ai ka dhe shoferë të tjerë këtu në Korçë edhe gjetkë. Më fal, shoku Pilo, se të preva fjalën.

**SHOKU PILO PERISTERI:** Është ashtu siç thoni ju, shoku Enver, duhej kujtuar edhe Spiro Lera.

Kur filluan nga puna këtu, punëtorët qenë të rinj fare, por me besim e me optimizëm kanë shkuar gjithnjë përpara, duke prodhuar materiale të mira. Kështu këta nuk e kanë prishur kurrë dorën e shkathët të klasës. Ta ruajmë këtë veti të punëtorit e t'i nxjerrim prodhimet gjithnjë të mira e me cilësi të lartë, sepse kjo është kryesorja. Pastaj të gërmojmë në drejtimin që tha shoku Enver, sepse me zhvillimin e përparimin krijojnë vazhdimisht rezerva.

*Pastaj shoku Pilo Peristeri foli për uzinën «Traktori», tregoi për eksperiencën dhe rezervat e saj, për punën studimore që bëhet, për grumbullimin e mjeteve të shpërndara etj.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më fal se po të pres fjalën, shoku Pilo, por desha t'u them shokëve se Byroja Politike 10 deri 12 vjet me radhë i ka thënë Koço Theodhosit që ta studiojë problemin e grumbullimit të të gjitha mjeteve të shpërndara, megjithatë akoma nuk është zgjidhur gjë.

**SHOKU PILO PERISTERI:** Ne e dimë që klasa punëtoze lufton me optimizëm, me perspektivë, prandaj sukseset do të arrihen. Besoj se, po t'i realizojnë detyrat që thamë, shokët e kësaj uzine do të dalin shumë mirë. Gjithçka duhet ta lidhim me porosinë që dhatë ju, shoku Enver, për të kursyer, se sabotimet që na u bënë qenë të rënda.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, kështu është. Unë ju zura në gojë në fillim të bisedës përrallën e Ezopit, sipas të cilit «Syri i të zotit duhet të shohë kudo». Po



ju tregoj një shembull që më tregoi shoku Pali Miska pardje në Pogradec. «Vajta në Patos, — tha ai, — ku pashë një impiant të madh. Pyes: «Ç'është ky impiant?». Inxhinieri më tha: «Ne, shoku ministër, kemi tri të tilla. Këto nuk janë për ne, por për pasurimin e bakrit. Na kanë ardhur kot këtu». E shikoni, shokë, se çfarë ndodh? Impiantet e pasurimit të bakrit i kanë dërguar në Patos, në fushat e vajgurit, dhe Koço Theodhosi, Lipe Nashi e të tjerë, si Koço Plaku me shokë, i vendosin atje, bëjnë edhe ndërtime për to, megjithëse e dinë që nuk janë për naftën!

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Kjo bëhet në një kohë kur edhe punëtorët e Korçës kanë nevojë për një impiant të tillë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, mirë thotë Nexhmija, neve na tha shoku Pali që këtë impiant do ta transportojnë në Rechovë, se duhet atje. Pra, të tilla gjëra kanë ndodhur.

Tani ta mbyllim takimin, ne kemi dëshirë të rrimë me muaj, por koha nuk na premtan.

*SHOKU SKËNDER DHIMITRI<sup>1</sup>:* Shoku Enver, në emër të shokëve punëtorë, të komunistëve e kuadrave të uzinës sonë dhe të uzinave të tjera që janë këtu, dëshiroj t'ju falënderoj për vizitën që na bëtë dhe ju premtoj se do t'i vëmë në jetë të gjitha këshillat shumë të vlefshme që na dhatë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ju faleminderit shumë!  
Mbase këto që ju thashë nuk kanë ndonjë vlerë të

---

1. Në atë kohë drejtor i uzinës së instrumenteve të precizionit «Petro Papi».

madhe, por nuk do të ishte keq sikur bisedën tonë ta dëgjonin edhe punëtorët jashtë. Shokët nuk menduan që të merrnin masa më parë për të vendosur aparatura për këtë qëllim. Kur vajta njëherë në Elbasan, shokët që merreshin me instalimin e qendrës së zërit, treguan më shumë imagjinatë, se e kishin lidhur mikrofonin që kisha unë këtu përpara me altoparantët përjashta, kë-shtu gjithë punëtorët që qenë grumbulluar në oborr dë-gjonin pa vështirësi. Edhe këtu mund të ishte bërë një gjë e tillë, që të dëgjoheshin ato gjëra që ju thashë, për aq vlerë sa kanë. Punëtorëve dhe popullit të rrethit të Korçës nuk mund t'ua shpërblejmë dot gjithë këtë dashuri të madhe që kanë për Partinë.

Mbrëmë ishim në teatër, ku pamë pjesën teatrale «Zonja nga qyteti», e cila bënte fjalë për gruan korçare. Shfaqja ishte shumë e bukur. Mua më pëlqeu shumë. Ajo ishte e ndërtuar mirë politikisht e ideologjikisht dhe kishte vlerë shumë aktuale. Më pëlqeu, gjithashtu, shumë interpretimi i Dhorkë Orgockës, e cila e mbajti skenën peshë për plot 2 orë e 20 minuta. Mua Enver Halili<sup>1</sup> më tha se pjesa zgjat një orë e treçerekë, se kë-shtu ma bëjnë ngahera (të qeshura), por ajo që më e gjatë. Megjithatë, m'u duk sikur shfaqja zgjati një orë. Qesha fort, se pjesa është ndërtuar me një satirë të këndshme dhe u interpretua bukur nga Dhorka, të cilën e përgëzoj, se ka shumë talent. Po kështu interpreton bukur edhe Pandi Raidhi, që është një artist i madh. Krahas Dhorkës dhe Pandit, luan bukur gjithë kolektivi

---

1. Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

i teatrit tuaj, që nuk la të stononin talenti i Orgockës dhe i Raidhit.

Ajo që më ka prekur shumë është që populli priti jashtë teatrit dy orë e ca natën. Kjo sjellje, e përsëris, ishte shumë e preکشme për mua.

U duhet bërë një kritikë punonjësve të qendrës së zërit, të cilët, kur instalojnë aparaturat, të kenë kujdes që bisedat tona t'i dëgjojnë edhe punëtorët.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Kanë plan punëtorët, s'mund të largoheshin nga vendet e punës që të grumbulloheshin pranë qendrës së zërit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kanë plan, moj shoqja Nexhmije, por nuk po shohim të shfrytëzohet kaq shumë koha e punës.

*SHOKU PILO PERISTERI:* Po të jetë puna për planin, punëtorët do të punonin me kënaqësi edhe të dielën, vetëm të dëgjonin fjalën e shokut Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Për punëtorët mbase nuk do të ishte nevoja të lëviznin nga repartet ku punojnë, por mund të na dëgjonin duke qëndruar edhe pranë tornove e makinerive të tjera.

Duke përfunduar, doja t'ju thosha se na kënaqët shumë, na dhatë forca të reja. Kur të vete në Tiranë, do t'u raportoj shokëve për të gjitha ato që thashë dhe dëgjova këtu te ju, sidomos për entuziazmin e madh të punëtorëve dhe të qytetarëve të Korçës, për dashurinë e pakufishme që kanë ata për Partinë.

Ju uroj nga zemra suksese në kryerjen e detyrave. Ta forconi akoma më shumë dashurinë që keni për Partinë. Të gjithëve ju dhe familjeve tuaja, kalamanëve

veçanërisht, ju uroj edhe një herë jetë të lumtur e të  
gëzuar!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## TË THELLOJMË NJOHURITË SHKENCORE PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

*Nga biseda me kooperativistët e Pojanit  
të rrethit të Korçës*

21 gusht 1975

Sigurisht, këtu kemi shokë e shoqe të ftuar edhe nga kooperativat e tjera dhe kjo është një gjë e mirë. Kooperativistët e Korçës i organizojnë mirë takimet me miqtë dhe shokët.

Jam shumë i gëzuar që erdha këtu, në këtë qendër shumë të rëndësishme bujqësore, e cila është një nga kooperativat e dalluara të tipit të lartë jo vetëm në rrethin e Korçës, por edhe në mbarë vendin tonë.

Kooperativistët e rrethit të Korçës njihen si punëtorë të mirë dhe pararojë në bujqësi, për të cilën janë shembull në vendin tonë, dhe kjo na gëzon shumë. Më pas do të flas një çikë më gjerë për këtë problem, sepse shokët drejtues të Partisë të rrethit më thanë se kryetari i kooperativës së Pojanit, ku sot kemi ardhur të tërë miq, dëshiron të na flasë pak ai më parë për gjendjen politike, ideologjike dhe ekonomike të saj. Ti, shoku kryetar, mos u shqetëso fare nga prania jonë,

por fol rrogozçe, rri ulur dhe mu këtu pranë meje, se dua të të shoh jo vetëm nga puna, po edhe nga fytyra, që të të mbaj mend mirë. Ne do t'i dëgjojmë me kujdesin më të madh ato që do të na thuash.

*Pasi dëgjoi me vëmendje kryetarin e kooperativës bujqësore dhe shokë të tjerë që folën për rezultatet e arritura nga kooperativistët, shoku Enver Hoxha dhe pjesëmarrësit në këtë takim zhvilluan një bisedë të përzemërt.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shoku kryetar i kooperativës, si i keni punët me rendimentet e drithërave, do ta arrini dot Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit në këtë drejtim?

**SHOKU ANDON THIMJO:** Ndërmarrjes Bujqësore të Maliqit ne ia kemi kaluar që vjet. Por nga ajo kemi çfarë të mësojmë dhe do të mësojmë vazhdimisht.

**SHOKU PILO PERISTERI:** Qenke usta ti, Andon, për këto! (Të qeshura.)

**SHOKU ANDON THIMJO:** Këtu nuk ka ustallëk, shoku Pilo, kështu është realiteti. Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit ne na drejton edhe me rendimentet, por edhe me rregullin, me organizimin dhe me disiplinën e klasës punëtore, që punon atje. Nga ana tjetër, ne i kemi mundësitë më tepër se ndërmarrja për t'i rritur rendimentet, sepse kemi forca pune të lira.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa mund të merrni nga sipërfaqja që keni mbjellë drejtpërdrejt me fasule?

**SHOKU ANDON THIMJO:** Nga fasulet e mbjella drejtpërdrejt kemi parashikuar të marrim 13 kuintalë për hektar, por mendojmë ta kalojmë parashikimin dhe të marrim 15 kuintalë për hektar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po nga fasulet që keni mbjellë me misër sa parashikoni të merrni?

**SHOKU ANDON THIMJO:** Aty mendojmë të arrijmë 5 kuintalë për hektar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** I keni analizuar shkençërisht rezultatet e veçanta brenda brigadave dhe parcelave ku janë marrë rendimentet rekord në krahasim me ekonominë e përgjithshme bujqësore të vendit tonë? I keni studiuar ju se cilët janë faktorët kryesorë që kanë ndihmuar të arrihet në këto parcela një rendiment kaq i lartë? Unë nuk dua të më flisni në përgjithësi, duke numëruar faktorët e përgjithshëm agroteknikë, por diçka speciale që u është bërë nga ana juaj këtyre parcelave, si, për shembull, ndonjë trajtim i veçantë me plehra kimike, ndonjë shërbim i veçantë ose spastrim nga barërat e këqija, kullim më i mirë i tokës etj. Mund të më thoni, cili nga këta faktorë ka mbizotëruar në tërë faktorët e përgjithshëm agroteknikë?

**SHOKU ANDON THIMJO:** Nga studimet që kemi bërë mendojmë se faktori kryesor për grurin është mbjellja e tij në kohë, por mbi të gjitha kullimi i tokës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më fal se të pres fjalën, por më thuaj, të lutem, a bëjnë agronomët konferenca me kooperativistët, për shembull, për rëndësinë e kullimit, e kam fjalën për trajtimin e çështjes nga ana shkencore, përse duhet kullimi etj., sepse, në përgjithësi, edhe një kooperativist i thjeshtë e di rëndësinë e kësaj çështjeje, pse ai jcton me të.

**SHOKU ANDON THIMJO:** Ne kemi përgatitur edhe një program të kabinetit teknik për këtë punë. Midis problemeve të tjera aty janë parashikuar edhe

biseda për probleme shkencore me kooperativistët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Janë biseda shkencore këto apo thjesht urdhra e direktiva? Sepse mund të veprohet edhe kështu: «Pa hajdeni këtu, ju, shokë kooperativistë, të bëjmë kanalizimet në këtë formë!», por atyre para fillimit të punës mund t'u bëhet edhe një shpjegim shkencor për këtë çështje, që e kalon empirizmin, praktikën.

*SHOKU ANDON THIMJO:* Ne e bëjmë një gjë të tillë, shoku Enver, por, në nivelin që kërkohet kjo punë nuk bëhet sa duhet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shoqja Filloreta, po ju pyes ju si nënkryetare e kooperativës: keni vdekje të fëmijëve këtu në kooperativën tuaj?

*SHOQJA FILLORETA BAÇI:* Nga viti i kaluar këtë vit ka një kthesë të mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Gratë venë në maternitet për të lindur? Historia e lindjeve me ndihmën e plakave të vjetra besoj se tashmë ka mbaruar.

*SHOKU ANDON THIMJO:* Ka mbaruar, pse tani në të pesë fshatrat e kooperativës sonë kemi pesë maternitete.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë bukur, gjë e mirë shumë!

Numri i ditëve të punës që bëhen nga burrat dhe nga gratë gjatë vitit në ç'raport është?

*SHOKU ANDON THIMJO:* Shifra mund të luajë jo më tepër se 15-20 ditë në vit, që burrat bëjnë më tepër nga gratë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me kaq unë them: U lumtë grave, për arsye se ato bëjnë dhe nja 20 a 30



ditë-punë të tjera çdo muaj në shtëpi. Megjithatë tash edhe burrat punojnë e ndihmojnë në familje. Derisa ata punojnë në fushë, mund të punojnë edhe në shtëpi. Edhe më përpara në një pjesë të madhe të vendit tonë, në fshat, burri punonte edhe në shtëpi, se punët e rënda, si prerjen e druve, bluarjen në mulli etj., në fakt, ai i bënte më shumë.

Qytetarët, dhe në radhë të parë rinia e Korçës, duhet të marrin shembull nga fshatarësia e rrethit të vet. Devollinjtë, për shembull, kanë pasur një tokë pjellore, po ata ishin edhe punëtorë të zotë dhe me punë e fitonin bukën.

Kur bëri thirrje atdheu, në kohët më të vështira të Pasçlirimit, kur klasa punëtoresh nuk kishte bukë të hante (mos i harroni ato situata), devollinjtë u ngritën dhe shkuan kudo nëpër ndërmarrje, u vendosën në to, duke braktisur shtëpitë. Atje ku u vendosën, ata u shquan si punëtorë nga më të mirët. Edhe rinia korçare duhet t'i kuptojë bukurinë e fshatit dhe interesin e madh të Partisë dhe të popullit, prandaj le të vijë të punojë në fshat tok me vëllezërit e motrat e fshatit! Për këto çështje do të flas përsëri më vonë.

Unë jam me të vërtetë shumë i gëzuar për rezultatet e kënaqshme që keni arritur.

Po shoku kryetar i kooperativës bujqësore të tipit të lartë të Bilishtit mund të na japë disa të dhëna? Nuk kërkojmë që ai të zgjatet shumë, po të na flasë konkretisht nja 10 minuta, duke na paraqitur disa nga të dhënat kryesore për ekonominë që drejton, të na japë edhe ndonjë këshillë apo të na bëjë ndonjë vërej-

tje se çfarë mund dhe duhet të bëjmë tjetër në pesë-vjeçarin që vjen.

Keni ju, shokë, ndonjë sugjerim apo vërejtje që mund të na bëni neve për punën tonë? Edhe ju, shokë të Bilishtit, u dëmtuat nga breshëri që ra, megjithatë na kanë informuar se do ta realizoni planin, sidomos të drithërave, po edhe të bimëve të tjera.

*SHOKU VASKË KOLI:* Si urdhëron, shoku Enver, do ta realizojmë, bile edhe planin e misrit mendojmë se do ta plotësojmë. Ne u dëmtuam shumë nga breshëri. Megjithëqë në plan na qe vënë detyrë të realizonim 38 400 kuintalë drithë, mund të arrijmë shifrën 43 000 kuintalë, bile ka edhe ndonjë rezervë të vogël. Natyrisht, këto janë rezerva të lëmenjve, që mund të kapin edhe rreth 1 000 kuintalë të tjerë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Panxhari që te ju u dëmtua nga breshëri, nuk ka mundësi të rigjencrohet? Mund të na thoni një çikë konkretisht çfarë masash morët?

*SHOKU VASKË KOLI:* Menjëherë, që të nesërmen e rënies së breshërit, gjithë kooperativistët u ngritën në këmbë, bënë shpejt e shpejt spërkatjet e bimëve të dëmtuara me preparatet që rekomandon agroteknika. Në mënyrë të veçantë breshëri na preku më shumë fasulën kokërrmadhe. Ishte me të vërtetë diçka e rrallë trajtimi që iu bë kësaj bime, saqë, pas gjithë këtyre shërbimeve shumë të kujdesshme, ajo kishte marrë një bukuri të veçantë që të vinte qejf ta shikoje. Një ditë pas breshërit ne mezi e mbanim veten nga keqardhja e madhe që ndicnim, pse gjendja e bimëve ishte me të vërtetë e vajtueshme, por pas një

jave ajo ndryshoi. Prandaj them se ne kemi besim që rendimentin do ta tejkalojmë edhe në fasule.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë! Lopë keni ju? Sa qumësht merrni mesatarisht nga një lopë?

*SHOKU VASKË KOLI:* Kemi 500 krerë lopë. Marrim mesatarisht deri në 1 300 litra nga çdo lopë, gjë që do të thotë se nuk jemi mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mund t'ju them se, kur filluam të diskutonim planin pesëvjeçar, ne patëm debate për shifrat në Byronë Politike, bile diskutime shumë serioze. Donim të arrinim të merrnim në fund të pesëvjeçarit të paktën 23 quintalë grurë për hektar. Kishte shokë që ishin për këtë shifër, mirëpo kishte të tjerë që rezervoheshin një çikë dhe thoshin: «Si është e mundur të marrim një rendiment të tillë nga një nivel shumë i ulët i pesëvjeçarit të mëparshëm?». Po pa shikoni tash çfarë bëri fshatarësia jonë kooperative! Jo vetëm i realizoi, por edhe i tejkaloi parashikimet tona.

*SHOKU VASKË KOLI:* Është shumë e vërtetë kjo, shoku Enver. Ne kemi shokë me sedër në kooperative të tona.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo sedër është një prirej përparimtare, se këtë prodhim të madh tjetri nuk e do ta marrë për vete, por për gjithë shoqërinë.

*SHOKU VASKË KOLI:* Ju, shoku Enver, keni ardhur në Dëmbrovë të Poloskës dhe e dini se toka atje atëherë ka qenë shumë e varfër.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, kam ardhur, dhe ashtu është, e di, ajo ka qenë një tokë shumë e varfër.

*SHOKU VASKË KOLI:* Tashti ne Poloskës i the-

mi «Myzeqe», se sivjet na dha 2 000 kuintalë drithë mbi planin. Brigada e brigadierit që kam këtu pranë ka dhënë 600 kuintalë drithë mbi planin, por jo vetëm në grurë. Kësaj brigade gjysma e sipërfaqes së mbjellë me panxharsheqeri iu dëmtua, atëherë tërë brigada u mobilizua dhe i vuri detyrë vetes që me sipërfaqen që i mbeti pa u dëmtuar, të realizojë dhe të tejkalojë planin dhe, në fakt, në 10 hektarë mori 500 kuintalë panxharsheqeri për hektar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë, shumë mirë!

Pa ngrihu të të shikoj pak, shoku brigadier! Njeri i thjeshtë është, sikur nuk ta zë syri, po punën e bën të madhe! Pa shikojeni një herë ti, shoku Ilo, dhe ti, shoku Andon, ai në 10 hektarë mori 500 kuintalë panxharsheqeri për hektar! Kjo do të thotë që 500 kuintalë për hektar mund t'i marrim. Pa na thuaj një çikë ti, shok, si e arrite këtë prodhim të lartë?

**SHOKU HIQMET AGO:** Me punë, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Me punë, sigurisht, po si e bërë këtë punë? Si e ndoqe zhvillimin e panxharsheqerit?

**SHOKU HIQMET AGO:** U mobilizuan të gjithë pjesëtarët e brigadës. Kur pamë se na u dëmtuan 5 hektarë me panxharsheqeri, ne ndjemë një shqetësim të madh në brigadë, prandaj iu vumë një punë të madhe, i bëmë disa punime të diferencuara, siç është shërbimi më i mirë për bimët në sipërfaqen që na mbeti, plehërimi me pleh organik, me ujitje etj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çfarë mendimi ke ti për udhëheqjen e kooperativës suaj, për organizatën-

-bazë të Partisë? Na flisni edhe për specialistët që janë te ju.

*Pastaj, pasi folën edhe pjesëmarrës të tjerë, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Të dashur shokë, Komiteti Qendror dhe Byroja Politike janë në dijeni të zhvillimit të bujqësisë në rrethin e Korçës. Rrethi juaj është një nga rrethet pararojë në bujqësi. Duke studiuar para nja dy vjetësh statistikat, kam parë që Korça zë vendin e parë në republikë. Ky është një tregues që flet për ngritjen politike dhe ideologjike të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies së rrethit tuaj, si dhe për punën e tyre sistematike në ngritje. Për këtë nga drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit të rrethit tuaj herë pas here kemi pasur edhe raporte, këtu janë bërë edhe mbledhje, për të cilat jemi vënë në dijeni si për sukseset, edhe për dobësitë. Veç kësaj, sukseset te ju janë shumë më të mëdha nga të metat e gabimet. Por, pa i nënvleftësuar këto të fundit, mund të them se këtu te ju pozitivja është shumë më e madhe, dominuese. Për këtë, siç ju thashë më përpara, në emër të shokëve të udhëheqjes ju përgëzoj dhe ju uroj suksese të tjera më të mëdha.

Por si anëtar i Partisë dhe si sekretar i Komitetit Qendror të saj, unë dëshiroj t'ju them (këtë gjë ne ia përsëritim kurdoherë edhe vetes, po kështu edhe klasa punëtore që na udhëheq, gjithashtu ia përsërit vetes) se nuk duhet në asnjë mënyrë të kënaqemi me rezultatet që kemi arritur, për arsye se na bie detyrë të krijojmë në të gjithë sektorët një ekonomi me të vërtetë të zhvilluar, të përparuar, të denjë për rendin tonë socialist.

Partia ka bërë të gjitha përpjekjet e saj për të mobilizuar rreth vetes fshatarësinë, gjithë kooperativistët e vendit tonë, që bujqësia jonë të modernizohet, që të merren rendimente të larta në bimët bujqësore, pra, që të ndërtohet me sukses socializmi. Prandaj edhe sukseset e arritura janë premtuese. Të tërë ne këtu, të tërë miqtë e shokët, vëllezërit dhe motrat, që janë edhe jashtë kësaj salle, vijën e Partisë e kanë kuptuar dhe luftojnë për ta zbatuar drejt në jetë.

Të gjithë e mbajmë mend kohën e parë pas Çlirimit. Kemi pasur vështirësi ekonomike, vështirësi politike dhe vështirësi ideologjike në drejtim të formimit të njerëzve. Intrigat e mëdha dhe komplotet e brendshme e të jashtme të kurdisura nga armiqtë, mungesat e mjeteve të prodhimit, mungesa e industrisë dhe e mekanizmave etj., etj. i shtonin akoma më tepër vështirësitë tona. Të gjitha këto ne i kemi jetuar, por i kemi kapërcyer, dhe ky kapërcim është bërë me luftë e me vullnet të hekurt nga populli ynë, i udhëhequr nga Partia. Këto nuk i themi që të mburrim veten, se ne duhet të jemi kurdoherë modestë, ashtu siç duhet të jenë tërë revolucionarët dhe komunistët, që punë të bëjnë shumë dhe fjalë të kenë pak, por e kujtojmë bazën e nisjes për të matur drejt perspektivat. Realiteti është realitet, atë nuk mund as ta zmadhojmë, as ta zvogëlojmë.

Çështja është këtu, shokë, që rezultatet që kemi arritur në bujqësi, të mos na krijojnë ndjenjën e vetëkënaqësisë, por ndjenjën e nxitjes për të ecur gjithnjë përpara, të na krijojnë ndjenjën e sedrës revolucionare. E them këtë se akoma kemi mjaft boshllëqe në

furnizimin e popullit me prodhime bujqësore. Natyrisht, në pushtetin popullor buka popullit nuk i ka munguar asnjëherë dhe nuk do t'i mungojë. As të tjerat, gjithashtu, nuk i kanë munguar në atë shkallë sa të krijohen shqetësime, përkundrazi, në mënyrë graduale ato janë shtuar, por duhet të njohim se në mjaft prodhime herë pas here ka pasur dhe ka boshllëqe, si në mish, në qumësht, në zarzavate, në sheqer, në yndyrna etj. Mirëpo kush do të na i plotësojë këto boshllëqe? Vetë ne do t'i plotësojmë ato me punë e me djersë, duke zbatuar deri në një direktivat e Komitetit Qendror të Partisë. Zbatimi i direktivave të Komitetit Qendror të Partisë varet nga ne. Partia thotë se baza e plotësimit të detyrave janë kooperativistët, të cilët mund ta shndërrojnë situatën qind për qind. Kooperativistët janë në gjendje që direktivën e Komitetit Qendror të Partisë ta kuptojnë, ta zhvillojnë më tej dhe ta zbatojnë më së miri.

Zhvillimi i bujqësisë sonë, gati në të gjithë sektorët, sidomos këto vitet e fundit, na ka inkurajuar shumë. Jo vetëm kaq, por Partia, komunistët dhe tok me ta edhe populli kanë pasur besim se do të arrihen objektiva të mëdhenj në rritjen e rendimenteve të prodhimeve, natyrisht me një organizim më të shëndoshë të punës dhe të drejtimit. Pse e kanë pasur këtë besim Partia dhe masat punonjëse? Ky besim nuk ishte i pabazuar, kooperativat bujqësore, këto «pemë» të Partisë që sollën kaq rezultate, nuk i kishin rrënjët mbi ujë. Jo, ato i kishin rrënjët në tokën e atdheut, në shpirtin e popullit tonë revolucionar dhe «ujtëshin» me ideologjinë marksiste-leniniste. Partia i llogariti

mirë të gjithë faktorët, kushtet e mundësitë që kishim për zhvillimin e bujqësisë dhe filloi gradualisht organizimin e kooperativave në bujqësi. Për këtë çështje nuk do të zgjatem, pse të tërë e dimë, por krijimi i kooperativave ka pasur rëndësi të madhe, vendimtare, sepse këto ishin baza për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Krijimi i pronave kolektive të gjera e të përbashkëta, ku do të punonin në shkallë të gjerë mekanizmat që do të sillnim, të cilët nuk lëviznin dot në parcelat e kufizuara të pronës individuale të copëtuara, ka pasur rëndësi të jashtëzakonshme. Prandaj, së pari, duhej të shkatërroheshin gjerdhet që të mund të futeshin këta mekanizma, pastaj duhej të futeshin në përdorim në shkallë të gjerë plehrat organike në bujqësi, të krijoheshin mundësi edhe për ndërtim fabrikash që të prodhonin plehra kimike. Krahas gjithë këtyre masave, kooperativistët dhe kuadrot e bujqësisë, të organizuar ose jo në Parti, duhej të edukoheshin jo vetëm ideologjikisht e politikisht, por edhe teknikisht, të mësonin teknikën e vërtetë moderne bujqësore.

Që të ecë përpara prodhimi bujqësor e blegtoral duhet të vëzhgojmë me kujdes çdo punë e proces, të ndjekim hap pas hapi çdo masë që marrim në bujqësi dhe ta shënojmë. Kështu, fjala vjen, për plehun që hedhim në ara të vëmë re a është i mjaftueshëm apo nuk është, e shënon këtë gjë brigadieri në fletore, kur u hodh dhe ç' rezultoi me të. Të vëzhgohet nga ana teorike dhe praktike se në cilin moment plehu fillon të japë rezultatin. Gjatë vëzhgimit të shihet që kjo sasi plehu e hedhur sa e ngriti rendimentin e prodhimit, gjë që do të na japë mundësi të nxjerrim përfundimin



nëse i kemi hedhur sasinë që duhej, më shumë apo më pak. Në rast se del që pleh nuk kemi pasur në sasi të mjaftueshme, prandaj edhe rendimenti nuk ishte ai që pritej, kjo gjë duhet të shkruhet që të vlejë për më vonë si eksperiencë. Kur të vijë periudha e pjekjes së prodhimit, duhet parë nëse pjekja erdhi në kohë apo jo me shërbimet që u bënë dhe në rast se shihet që pjekja u vonua, të vritet mendja për të zbuluar arsyet, prandaj «defteri» duhet të mbahet në xhep.

Me këto dua të them se bimëve ju duhet t'ua bëni të gjitha shërbimet agroteknike dhe njëkohësisht të vëzhgoni me kujdes rezultatet që jep çdo proces, pra të mbani shënime dhe kjo është një punë shkencore. Brigadieri ose skuadërkomandanti duhet të vejë tek agronomi për t'u këshilluar me të për këto fenomene, ta njoftojë, t'i japë mendime, ashtu sikundër mund të vini tek unë për të më qarë hallet për një direktivë dhe të më thoni: «Shoku Enver, na duket se kjo direktivë nuk është lëshuar drejt për këtë apo për atë arsye, prandaj për të mirën e punës ne mendojmë të bëhet kështu, mendojmë që t'i shtohet asaj edhe kjo çështje etj.». Pikërisht këtë kërkon Partia nga të gjithë.

Kur keni vërejtje për punën, mund të vini edhe në komitetin e Partisë t'ia thoni ato edhe sekretarit. Është e natyrshme që brigadieri vetë duhet të vejë te kryetari ose te sekretari i Partisë në kooperativë ose në brigadë, të kërkojë një mbledhje tok me agronomin, ku të tregojë çfarë ka vënë re dhe të japë shpjegime. Ky është një shpjegim shkencor i bazuar në vërtetime të kujdesshme dhe në përfundime të matura, të cilat

ata duhet t'i marrin parasysh, se më pas mund t'u vejë edhe një tjetër e një tjetër akoma dhe udhëheqja ndihmohet për të dalë me konkluzione të drejta, ta zëmë se plehu ka qenë pak ose nuk është përdorur mirë, se duhej t'i jepej më shumë pleh kësaj bime ose parcele sesa asaj tjetrës, po kështu mund të diskutohet për ujitjen dhe për të gjitha shërbimet e tjera me radhë.

Me këtë dua të them se, kur kuadrot drejtues, agronomi, kryetari, sekretari i Partisë, grupi i të deleguarve e të tjerë bëjnë planin, duhet t'i kenë parasysh të tëra të dhënat shkencore dhe empirike të punonjësve, pse në bazë të tyre do të mundin ta përgatitin atë më mirë se çdo herë tjetër.

Unë nuk kam punuar ndonjëherë në bujqësi dhe këto që po them, ju m'i keni mësuar, si dhe takimet me shokët, me të cilët kam mundur të nxjerr disa konkluzione, ose ndonjë lexim literature, prandaj nuk është e thënë që të tëra këto që trajtova janë ashtu si them unë, pse ka çështje që mund të mos jenë kështu, por, sidoqoftë, diçka prej tyre mund të jetë e dobishme.

Të gjitha këto detyra Partia, dhe, kur themi Partia, duhet të kuptohet me këtë masa e madhe e dhjetëra mijë komunistëve anëtarë dhe kandidatë partie e jo vetëm udhëheqësit, i mori frontalisht për t'i zgjidhur dhe kishte besim të plotë në suksesin, sepse bujqësia është baza e ekonomisë sonë, pa të cilën nuk mund të ecet përpara në ndërtimin socialist. Industria është vërtet sektori drejtues, në të punon klasa që na udhëheq, e cila i jep një ndihmë të madhe edhe bujqësisë, por në qoftë se nuk prodhon bujqësi, atëherë fabrikat do të mbyllen, nuk mund të kryhet industrializimi i

vendit, që është fuqizimi ekonomik dhe politik i atdheut edhe nga ana e mbrojtjes. Ky objektiv nuk mund të arrihet pa bujqësinë, që duhet të ecë krah për krah me industrinë.

Siç e dini, me kohë ne krijuam edhe një formë të re organizimi në bujqësi, që na e diktoi eksperiencia e madhe e kooperativistëve tanë, ngritjen e kooperativave të tipit të lartë. Prona e bashkuar e disa kooperativave kërkonte që të shfrytëzoheshin më mirë tokat, forcat e punës, kuadrot, mekanizimi, plehrat, agroteknika. Është për këto arsye që Komiteti Qendror i Partisë mori vendimin për krijimin e të tilla kooperativave. Kjo është një fazë e ndërmjetshme në mes kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjeve shtetërore të bujqësisë, ku pronat është e gjithë popullit, kurse pronat e kooperativave të tipit të lartë është akoma pronë e grupit, e kooperativistëve, mirëpo në këto lloj kooperativash shteti investon, po përse? Ai investon për ta bërë kooperativën e tipit të lartë një shembull më të mirë të vijës së Partisë, që na çon drejt krijimit të pronës së përgjithshme të popullit. Qëllimi është që me këtë shndërrim të bëjmë që niveli i jetesës në këto lloj kooperativash të ngrihet në nivelin e klasës punëtore të ndërmarrjeve bujqësore dhe të asaj që punon në qytete e të bëhet shembull që edhe kooperativat e tjera të ecin në këtë rrugë. Ne nuk kaluam përnjëherësh në këtë formë organizimi.

Nga eksperiencia shumëvjeçare e Partisë sonë del që, për sa i përket zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë sonë socialiste, duhet të ecet me kujdes dhe kurdoherë kështu është vepruar. Në fillim ne ecëm me kujdes,

sepse na u desh që të përgatitej më parë terreni politik në mentalitetin e fshatarësisë, të bindej fshatarësia jonë patriote për dobinë e kolektivizimit. Them fshatarësia patriote, se pa fshatarësinë nuk mund të kishim Shqipëri të lirë. Fshatarësisë sonë iu desh të mbante në supet e saj peshën më të madhe të luftës, pse klasa jonë punëtore ishte e vogël. Fshatarësia edhe kur u çlirua Shqipëria, dha kontributin e vet kolosal, ajo u bë aleatja më besnike e klasës punëtore.

Shqipëria e re u ndërtua nga punëtorët, numri i të cilëve vazhdimisht po zmadhohej, por edhe fshatarët kanë rrugën përpara, ata i dhanë bukën klasës punëtore, duke e ndarë atë që kishin për vete e për fëmijët e tyre. Ju kujtohen vitet e para pas Çlirimit kur bëheshin grumbullimet? Ju atëherë nuk kishit bukë për të dhënë, bile e kishit shumë «me krëk», si thotë shprehja popullore, por Partia vinte e ju thoshte: «Vëllezër fshatarë, po ndërtojnë Shqipërinë, i kemi punëtorët duke punuar nëpër rrugë, nëpër ura, ata po ndërtojnë e po riparojnë fabrikat e vogla, do të ndërtojnë edhe fabrika të reja, po, që të bëhen këto për të mirën e atdheut, punëtorët duan bukë». Dhe ju e dëgjuat thirrjen e Partisë e dhatë bukën. Çfarë ishte kjo? Nuk mund ta harrojnë kurrë as Partia, as populli këtë kontribut të madh të fshatarësisë sonë patriote.

Pastaj erdhi koha për zbatimin e direktivës së Partisë për kolektivizimin që ju, gjithashtu, e përqaftuat dhe arritët këtu ku jemi sot. Në këtë rrugë ne kemi pasur edhe vështirësi të shumta, por ato u kapërcyen. U likuiduan kulakët si klasë që na pengonin, por jo vetëm kaq. Në këto përpjekje doli përsëri në shesh

patriotizmi i madh i fshatarësisë sonë që, në një kohë relativisht të shkurtër, e kuptoi se direktiva e Partisë për krijimin e kooperativave ishte shpëtimtare për të. U thyen kështu psikologjia dhe mentaliteti shekullor, ai mentalitet i ngushtë i fshatarit individual. Fshatarësia jonë u ngrit për lirinë e Shqipërisë, për tokën e saj dhe u përgjak me armiqtë për të mbrojtur tokën e vet, atdheun e vet. Ajo luftoi për këtë tokë që e ëndërronte në shekuj dhe e fitoi. Prandaj u bë Reforma Agrare që e gëzoi pa masë fshatarësinë. Mirëpo, kur Partia i tregoi rrugën e kolektivizimit dhe fshatarësia e bindur ndoqi këtë rrugë, u thye mentaliteti shekullor për pronësinë private mbi tokën.

Në vendet e tjera, që thuhet se janë «të përparuar», vazhdon të ekzistojë ky mentalitet i prapambetur, fshatarët e këtyre vendeve janë shumë prapa, bile me shekuj, nga kooperativisti ynë që e kuptoi shpejt rrugën e vërtetë të shpëtimit nga varfëria shekullore. Këtë rrugë të drejtë fshatarësia jonë e kuptoi me shpirt e jo me llafe, pse me llafe ajo mund ta pranonte ose mund të thoshte se po hynte në kooperativë nga zori, por nuk ndodhi kështu. Ne kemi zbatuar parimin leninist të vullnetarizmit për kolektivizimin. Marksizëm-leninizmi është shkencë e vetme e drejtë që udhëheq njerëzimin për në socializëm e për në komunizëm. Marksizëm-leninizmi është shkencë për një jetë të mirë e të begatshme për të gjithë. Këto ia tha dhe ia argumentoi Partia fshatarësisë sonë dhe kjo, që e nuhat shpejt ku është e mira e saj, u bind për rrugën e kolektivizimit.

Ne kemi një popull të mrekullueshëm, një klasë

fshatare të mrekullueshme, të ngritur politikisht e ideologjikisht dhe mjaft të zonjën edhe teknikisht. Sot kemi, gjithashtu, mjete të përparuara për të punuar tokën, kemi plehra, farë të zgjedhur etj., etj., prandaj na vihet detyrë që të bazohemi fuqimisht në to dhe në rezultatet e arritura dhe të hartojmë plane reale e të guximshme, bile shumë të guximshme në bujqësi. Frikë të mos kemi. Po t'i mbajmë këmbët në dhë, s'ka pse të kemi frikë. Gjithsecili, që nga kooperativisti më i thjeshtë e deri tek udhëheqësi më i lartë i Partisë dhe i shtetit, të mendojë që këto mjete që disponojnë njerëzit që i kanë nëpër duar, të përdoren e të shfrytëzohen me një frymë politike të lartë, me një kuptim ideologjik të shëndoshë, në mënyrë që t'i realizojmë planet që kemi përpara.

Po të pyesësh çdo kooperativist: «Ore, vëllai im, a mendoje ti pesë vjet më parë të merrje 45 kuintalë grurë për hektar?», «As ma merrte fiqiri!», do të thoshite ai. Po ja, shikoni si ngjau! Vetë ai me punën dhe me mençurinë e tij po merr sot një prodhim të tillë gruri që as në ëndërr nuk e kishte parë, prandaj kemi besimin e patundur, në zemrën dhe në mendjen e fshatarit tonë kooperativist, se çdo gjë mund të arrihet me punë të palodhur e të menduar mirë nga ana e tij.

Nuk them ndonjë gjë të re, se Partia na e ka thënë ngaherë që bujqësinë, shokë, duhet ta modernizojmë. Modernizimi i saj ka anën teorike, po ka edhe anën praktike, njëra anë pa tjetrën nuk mund të ecë, duhet të ecin paralelisht të dyja. Praktika ka rëndësi të jash-tëzakonshme e duhet të vërtetojë teorinë dhe teoria duhet të zbatohet në praktikë. Kjo do të thotë që ne

të mësojmë shkencën bujqësore dhe këtë ta zbatojmë duke bërë përpjekje që të krijojmë kushte për të modernizuar bujqësinë. Kjo ka shumë rëndësi.

Aktualisht njeriun tonë duhet ta shikojmë ashtu siç është. Po si është njeriu ynë? Shumë, shumë pozitiv, i zgjuar dhe punëtor, besnik i Partisë, ai sheh qartë të ardhmen dhe ka etje të madhe për mësim. Faktet tregojnë se jo vetëm djemtë dhe vajzat e reja venë në shkollë, por edhe ata që kanë mbaruar një shkollë, vazhdojnë të mësojnë më tej, ndërsa shumë njerëz që nuk kanë mbaruar shkollë, pa shkëputje nga puna vazhdojnë të mësojnë. Ç'do të thotë kjo? Vallë me zor venë këta njerëz të mësojnë? Jo, në asnjë mënyrë nuk venë me zor, por këtë gjë e kanë ndier si një nevojë të domosdoshme, ashtu si bukën që na ushqen dhe ajrin që duhet të thithim çdo çast. Po pse duhet shkolla? Po të pyesësh një kooperativist, ai përnjëherësh do të të përgjigjet se duhet për të marrë gjithnjë e më shumë grurë, panxhar, duhan etj., etj. Po pse të marrë më shumë prodhime? Edhe më të voglin apo njeriun më të thjeshtë të pyesësh, do të të përgjigjet: «Që të ketë Shqipëria, të ketë gjithë populli që të rrojë i lumtur, se kështu forcohet atdheu». Ky është njeriu ynë që ka krijuar Partia. Kjo prirje në shkallë të gjerë është diçka pozitive. Mos u bëni pesimistë pse del një, dalin pesë, shtatë, dhjetë, njëqind apo edhe një mijë njerëz qofshin, që nuk e kuptojnë këtë nevojë si duhet, masa e madhe e popullit tonë e ka kuptuar këtë dhe lufton në këtë rrugë.

Ne duhet t'i thellojmë njohuritë tona teorike për zhvillimin bujqësor që tash ka marrë një hov të madh.

Shkenca, siç u thashë edhe shokëve punëtorë, është një pus i madh i pambaruar. Agronomi, veterineri, me arsim të lartë ose të mesëm, kanë mësuar dhe dinë shumë gjëra. Ne u themi se ato që kanë mësuar në shkollë, janë një bazë e shëndoshë, por nuk janë gjithçka. Prandaj, kur vijnë këtu në kooperativë dhe bëjnë duart me baltë, atyre u hapet një horizont tjetër, në praktikë ata vënë re se disa parime, disa njohuri teorike që kanë mësuar në shkollë, vërtetohen. Dhe jo vetëm kaq, por shohin fenomene të tjera që nuk i kanë pasë mësuar në shkollë dhe pasurojnë kështu më tej dijet dhe eksperiencën e tyre me njohuri të reja.

Dihet se, ashtu siç është në proces zhvillimi tërë shoqëria, siç jemi në proces përmirësimi të vazhdueshëm në njerëzit, edhe toka është në një proces të pandërprerë zhvillimi, të cilin duhet ta ndjekin jo vetëm specialistët, jo vetëm drejtuesit e kooperativës dhe ata të Partisë a të pushtetit, por duhen bërë të ndërgjegjshëm ta ndjekin edhe gjithë kooperativistët, që ta kuptojnë këtë proces zhvillimi të tokës teorikisht, ta ndjekin me kujdes edhe në praktikë. Kur agronomi ndjek në praktikë prerjen që i bën plugu tokës, l'u thotë kooperativistëve: «E shikoni, shokë, ai atje është argjil, ky këtu është humus, këto janë kanalet e nëntokës nga hyn uji, kjo ose ajo gjë pengon ujin që të hyjë» dhe l'u shpjegojë pasojat që vijnë, përse duhet të bëhet toka qilizmë, përse duhet të sillen ajo «në formë» etj. Të gjitha këto duhen për të marrë sa më shumë prodhim, pse toka është si trupi i njeriut, shokë, asaj i duhen bërë të gjitha shërbimet që kërkon një bujqësi moderne etj., etj.



Përpara mendohej pak a shumë kështu: «Mjafton të kemi një çikë bukë dhe një kokërr qepë». Atëherë nuk kishte mundësi që njeriu të ushqehet me prodhime të tjera, se kishte varfëri e njerim të madh. Mirëpo organizmi i njeriut, që të mund të zhvillohet fizikisht edhe nga ana e intelektit, nuk ka nevojë vetëm për bukë dhe qepë, ai do edhe mish, qumësht, vezë, lakra, hudhra, karota, bile ka disa prodhime që duken të vogla, pa rëndësi, po bëjnë një efekt të jashtëzakonshëm në organizmin e njeriut. Kështu është edhe për tokën, pa të cilën nuk ka bujqësi. Pa tokë të përgatitur mirë e si duhet, nuk ka bujqësi moderne.

Këtu shokët na folën me të drejtë për rëndësinë që i është vënë kullimit të përsosur të tokave dhe unë pyeta nëse organizohen seminare shkencore jo vetëm për kullimin, por për pedologjinë dhe kiminë e tokave. Me të drejtë dhe haptazi u informuam se në këtë drejtim nuk bëhet sa duhet. Atëherë Partia na mëson, dhe mua më kanë dhënë porosi shokët t'ju them juve vëllezërve dhe patriotëve kooperativistë të Korçës, që t'u futeni thellë çështjeve të studimit të tokës. Ju e dini të gjithë që tash janë bërë kudo harta pedologjike dhe agrokimike, por, ama, jo për t'i mbajtur në dollapë, por për t'i studiuar.

Për nevojat e mbrojtjes ne u rekomandojmë ushtarëve e oficerëve që të mësohen se si t'i lexojnë hartat që mbajnë nëpër çanta. Një oficer që shërben në një repart këtu afër, mund të mos jetë nga Korça, ai mund të jetë nga Dibra, por, duke pasur hartën në dorë, ai edhe në errësirë, në furtunë, në shi e në mjegull e di që këtu pranë është një bregore kaq metra e lartë, më

tej një luginë e vogël, diku tutje një çezmë, një pemë e madhe, një kasolle etj., etj. Në ushtri i mësojmë ushtarët që hartën të jenë në gjendje ta lexojnë e ta studiojnë mirë, ta kenë kurdoherë në kokë, por edhe në goftë se nuk e mbajnë mend, me të ndezur llambushkën, të jenë në gjendje të marrin me mend ç'objekte kanë përpara. Në rast se ata ndodhen. fjala vjen, në Pojan, harta u tregon tërë relievin këtu rrotull, kështu që kurrë nuk e humbasin toruan, përkundrazi, do të marrin masa t'i zënë shtigjet mirë dhe në rast lufte të godasin armikun për vdekje nga çdo anë që t'u vijë, do të dinë se nga duhet ta rrethojnë, ku ta futin e ta asgjësojnë, si t'i shpëtojnë zjarrit të tij etj.

Ne u themi vazhdimisht ushtarëve dhe oficerëve tanë: «Të tërë në këmbë, shikoni vetë me sy terrenin!». Aktualisht ne e kemi ndërtuar ushtrinë sipas porosive të Leninit, që i gjithë populli të jetë ushtar. Një gjë e tillë lehtëson shumë shpejtësinë e mobilizimit në kohë rreziku, shpejton, gjithashtu, edukimin e tërë popullit që në çdo moment të rrokë menjëherë armët dhe të jetë në gjendje të qëllojë me to. Jo vetëm kaq, por atij i mësojmë edhe strategjinë, edhe taktikën e luftimit. Një plus tjetër për ne është fakti që ushtari ynë është vendës dhe, kur je i tillë, di se ku janë vrimat, ku është gropa dhe bregorja, ku është kanali dhe ku përroi etj. Vendësi edhe symbyllur mund të ecë, kurse armiku nuk e njeh terrenin, prandaj e zë në grykë, se ai nuk çan dot përpara, sado që të ndihmohet nga harta që ka.

Këto jua thashë mbasi dëshiroj t'ju argumentoj rëndësinë që ka njohja edhe e hartave pedologjike dhe

agrokimike të tokave, ashtu siç kanë për mbrojtjen hartat e ushtrisë. Pedologjia është një shkencë me rëndësi të madhe, të cilën duhet ta studiojmë që të çojmë gjithnjë e më shpejt përpara prodhimin bujqësor. Po në ç'mënyrë ta bëjmë këtë? Përbërjen dhe cilësitë e çdo parcele duhet t'i dijë agronomi, t'i dijë sekretari i Partisë, t'i dinë kryetari i kooperativës dhe brigadierët, por ato duhet t'i dinë sidomos anëtarët e çdo skuadre. Secili duhet të dijë, gjithashtu, që në këtë tokë që punojmë, po të mbjellim misër, po t'i hedhim këtë sasi plehu organik apo kimik, po ta ujitim një herë, dy herë apo tri herë, po ta prashitim një, dy ose tri herë ose për çdo shërbim që mund t'i bëjmë, do të na japë këtë rendiment. Çdo kooperativist duhet të dijë që, po të mbjellim në këtë tokë diçka tjetër, nuk do të na japë prodhim, ose mund të na japë, por duhet të shiojmë edhe më dozat e plehrave, shërbimet etj., sepse bashkë me tokën studiohen edhe bimët. Kështu shkenca na mëson se kjo ose ajo bimë kërkon këtë lloj toke, kaq shërbime, kaq plehra, duhet ujitur kaq herë etj. Të gjitha këto janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. I zbatojmë ne në jetë këto? I zbatojmë! Kemi ne qarkullime? Kemi! Kemi eksperiencë për misrin, për grurin dhe për bimë të tjera? Sigurisht që kemi! Partia na mëson që këto dituri dhe këtë eksperiencë t'i rrënjosim mirë në mendje, t'i zhvillojmë me studime teorike dhe t'i vërtetojmë në praktikë. Pas këtyre do të vijë me siguri çështja që nga masa e kooperativistëve do të bëhen propozime të guximshme. Po pse? Sepse unë, «komandanti» i skuadrës, e di që në hektarët që më janë ngarkuar toka është e tillë, prandaj mundësitë për shfrytë-

zimin maksimal të saj duhet t'i diskutojmë në mbledhjen e kooperativës, ku të merret vendim për masat që nevojiten dhe për shërbimet suplementare që duhen bërë.

Mbledhja e përgjithshme e kooperativës, që bëhet për të miratuar planin, shokë drejtues dhe kooperativistë, ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Natyrisht, ky plan nuk duhet të bëhet në mënyrë empirike, dua të them duke u mbështetur, ta zëmë, vetëm në atë se vjet morëm 20 kuintalë e sivjet të planifikojmë 22 kuintalë për hektar. Jo, ky nuk është plan i guximshëm, as shkencor, ky nisët vetëm nga një dëshirë. Prandaj, para se të caktojmë planin, duhet të njohim cilësitë dhe përbërjen e tokave që kemi, llojet e bimëve, mjetet në dispozicion, forcat e punës etj., etj.

Ne kemi një eksperiencë në rritjen e bimëve që mbjellim, edhe studimin e tokave e kemi bërë, atëherë fillon në mbledhje diskutimi. Toka ku punon filan brigadë ka marrë kaq misër, sivjet atje do të bëjmë qar-kullimin dhe thuhet çfarë lloji i ri bime do të mbillet, si na ka shkuar misri këtu ose atje, cilat kanë qenë shërbimet e zakonshme që i janë bërë, cilat kanë qenë shërbimet e tjera në raste të jashtëzakonshme (lagështirë e madhe, thatësi etj.), forcat e punës që janë përdorur, zotësia mendore dhe fizike e tyre, kështu, duke llogaritur të tëra këto, u arritën rendimentet e njohura. Atëherë diskutohet se si duhet të mbjellim sivjet në këtë tokë, çfarë duhet të bëhet më tej etj. Gjatë diskutimit mund të ngrihet agronomi të thotë: «Shokë, shumë gjëra u thanë drejt, po këtë ose atë çështje e keni gabim». «Pse e kemi gabim?», e pyesin

nga masa. «E keni gabim, për arsye se gjendja e tokës sivjet nuk është e tillë si u tha, po ndryshe, ajo kërkon këtë ose atë bimë. prandaj duhet të vendosim një qar-kullim të ri. Këtë, për të cilën po diskutohet, në qoftë se është e domosdoshme për interesat e kooperativës dhe ata të përgjithshëm të republikës, duhet ta plehë-rojmë në këtë masë dhe mënyrë, duhet kështu apo duhet ashtu etj.» Bile duhet diskutuar deri atje që, nëse është çështja për kooperativën e Pojanit, fjala vjen, ku, si kudo, ka brigada të dalluara, po ka edhe brigada që janë më pak të dalluara, dhe nëse për këtë ose për atë lloj bime në diskutim nuk kemi mundësi të japim tërë atë sasi plehu që kërkohet dhe t'i kryhen shërbi-met nëpërmjet një brigade të zakonshme, duhen marrë masa për të ndërruar brigadën, për të caktuar atje një brigadë të fortë, që të jetë në gjendje me punë t'i kapërcejë vështirësitë e mungesat materiale, të cilat për këtë vit kësaj toke nuk mund t'ia plotësojmë dot etj.

Të mos zgjatem, ju e merrni me mend, shokë, se hartimi i një plani me të vërtetë real që t'u sigurojë kooperativës dhe atdheut prodhime të mëdha, është ve-tëm fillimi i një pune të madhe të menduar e të rrahur mirë. Prandaj «miqtë e Tiranës», kuadrot e Ministrisë së Bujqësisë dhe ata të Komisionit të Planit të Shtetit, të mos na bëjnë plane nga zyrat, të mos na japin men-dje nga ministritë, por të urdhërojnë e të zbresin deri këtu në bazë, të marrin pjesë në diskutime së bashku me ju, të mësojnë shumë nga ju dhe jo të thonë: «Bëni kështu si themi ne!». Ata duhet të mendojnë se Shqipë-rinë nuk e kanë sjellë në këtë situatë një njeri, pesë apo njëzet njerëz. Jo, atë e kanë sjellë Partia, vija e saj

e drejtë, klasa punëtore, fshatarësia, prandaj ne atje lart mund të kemi një mendim të mirë, por ky mendim, para se të vihët në jetë, duhet të miratohet nga masa. Po nuk e miratoi masa një mendim, atëherë duhet vënë pyetja: Pse? E mund të dalë që ose s'kemi punuar mirë me masat për sqarimin e tyre, ose mendimi a vendimi ynë nga lart s'ka qenë i studiuar mirë, sepse nuk jemi konsultuar me masat. Kështu është e domosdoshme të dëgjojmë zërin e masës.

Në qoftë se nuk dëgjohet zëri i masës dhe nuk bazohemi në eksperiencën e saj, nuk mund të ecet përpara. Mendimet e disave si mendime të veçara nuk vlejné sa ato të masave. Këtë nuk e them për modesti të rreme, por kështu është e vërteta, këtë e vërteton jeta. Të gjitha këto që u thanë këtu janë vepra juaj, mendimi juaj, i masës dhe i komunistëve, ndërsa Komiteti Qendror e përgjithëson eksperiencën e masave, nxjerr esencën e saj dhe ua kthen përsëri masave në formë direktivash. Këtë masat e zbatojnë, por edhe e pasurojnë më tej dhe këtë pasuri duhet prapë ta marrë udhëheqja, ta përpunojë, të marrë vendimet përkatëse dhe të ecë tok me masat, t'i udhëheqë këto, por të dëgjojë edhe zërin e tyre gjatë zbatimit.

Pse i them këto, more shokë? I them se kemi pasur njëfarë Abdyl Këllezi, që kishte rreth e rrotuli një ekip armiqsh me të cilin na sabotoi ekonominë, duke përfshirë edhe sektorin e bujqësisë. Abdyl Këllezi nuk ishte në gjendje ta ndalonte dot hovin e Partisë dhe të popullit për ndërtimin e socializmit, por ai luftoi që të vinte gurë në rrotat e zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste. Po të flinin Partia, Komiteti i saj Qendror

dhe punonjësit, ai do të na kthente këtu bejlerët dhe agallarët, siç ka ndodhur në Jugosllavi, ku është krijuar një borgjezi e re, kanë lindur kulakë të rinj. I tillë ishte synimi i këtij sabotatori. Abdyl Këllezi krijonte disa situata që çorientonin. Natyrisht, ai bënte kujdes të madh, ishte shumë dinak, por Komiteti Qendror nuk i kishte mbyllur sytë përpara dinakërisë së tij. Ju e dini që Partia nuk merr masa të rënda me një e me dy të dhëna, ajo është parti e klasës punëtore, e pjekur, serioze, e guximshme, por, kur duhet, edhe e ashpër, prandaj i ndjek çështjet me durim, dhe atë që gabon padashur përpiket ta ndreqë, kurse atij që vepron me qëllim, pasi mbledh prova, i tregon vendin që meriton.

Pra, Abdyl Këllezi na krijonte disa situata të vështira, jepte andej-këtej premtime të mëdha, duke thënë: «Do t'ju japim këto, do t'ju bëjmë ato». Në realitet ai e dinte që mundësitë për shumë gjëra që premtonte në nuk i kishim, por me këtë donte të krijonte përshtypjen që ai vetë, Abdyl Këllezi, ishte një ekonomist i madh dhe kishte në dorë tërë ekonominë e Shqipërisë. «Doni ju traktorë apo makina për të shkukur pataten? Këto do t'ju japim, do të bëjmë medocmos përpjekje që t'i gjejmë!», premtonte. Po ku do t'i gjente ai? Nuk kishte ku t'i gjente, por vepronte kështu se te ndonjë mendjelehtë donte të krijonte pikëpamjen që në bujqësi çdo gjë mund të bëhet fare kollaj, dhe sidomos të nxiste njerëzit që të flisnin mirë për të. Një kredi e tillë i duhej atij, sepse, duke synuar të sabotonte ekonominë, në radhë të parë industrinë, ai e mbulonte më lehtë veprimtarinë armiqësore para masave.

Sabotimi i tij në industri konsistonte në shtre mbërimin e direktivave të drejta të Partisë. Komiteti Qendror ka lëshuar me kohë direktivën, sipas së cilës njerëzit të zbatojnë kompetencat, po të kenë edhe iniciativë, brenda mundësive ata duhet t'i shfrytëzojnë këto në maksimum dhe të shkojnë përpara. Mirëpo kompetencat Abdyl Këllezi i zhvillonte në rrugën e vetad ministrimit titist jugosllav, duke bërë përpjekje për decentralizimin e ekonomisë. Ai ishte për atë që ndërmarrjet tona, qoftë në sektorët e industrisë, apo në ata të bujqësisë, të mos orientoheshin nga udhëheqja qendrore. Kjo do të thotë ta lësh mënjanë udhëheqjen e shtetit, ta shndërrosh atë në diçka pa shpirt, me qëllim që direktivat e saj të mos zbatohen në bazë dhe çdo ndërmarrje të vetad ministrorjë jo vetëm pasurinë e përbashkët, por edhe mjetet financiare, bile secila të ketë edhe marrëdhënie tregtare me shoqëritë kapitaliste që të dëshirojë. Abdyl Këllezi përpigëj të krijonte pikëpamjen: Përse të merret tregtia shtetërore me tregtimin, për shembull, të fasules pllaqi që prodhoni ju këtu, merruni vetë me këtë çështje, prandaj ju, sipas tij, mund të dërgoni një njeri në Itali ose deri në Australi, po të doni, dhe ai t'u thotë kapitalistëve që merren me tregtimin e këtij artikulli, që ne kemi fasule pllaqi, i doni këto apo jo? Kështu veprojnë ndërmarrjet vetad ministruese jugosllave. E tillë ishte prirja e veprimtarisë së Abdyl Këllezit.

Një tjetër tendencë e këtij armiku ishte ajo që të boshatiste bazën nga kuadrot me arsim të lartë që ka përgatitur Partia, duke e justifikuar këtë se gjoja zbatonte direktivën e drejtë të Komitetit Qendror për



të pasur disa institute që të studiojnë me të vërtetë problemet që preokupojnë bazën. Çfarë bëri Abdyl Këllezi për zbatimin e kësaj direktive? Ai krijoi institute si kërpudhat pas shiut, ku mbloodhi me qindra kuadro, në vend që të zbatonte direktivën për krijim ekipesh gjeologjike nga të katër anët që të studionin nëntokën e vendit tonë, të pasur me minerale, për t'i zbuluar këto sa më parë. Të gjithë këta ai i grumbulloi në Tiranë. Po ç'bënin këta njerëz këtu? Veprimtaria e tyre kufizohej në disa supervizime të ekipeve gjeologjike që punonin në terren, por edhe kjo ishte një punë pa fryt. Përse e bënte këtë gjë Abdyl Këllezi? E bënte për të krijuar shtresën e burokracisë në kurriz të shtetit të proletarëve, që kuadrot të merrnin në këto vende rroga të majme, të hanin e të pinin e të mos bënin gjëkafshë, të krijonte edhe te ne atë kastë njerëzish që kanë krijuar në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik etj. Titoja, Hrushovi e Brezhnjevi.

Abdyl Këllezi e dinte se nuk është e mjaftueshme të krijosh vetëm aparate të tepërta, por duhet të krijosh sidomos koncepte burokratike, të ushqesh e të forcosh stilin dhe metodën burokratike në punën e njerëzve të aparateve, që të arrish synimet armiqësore. Në vend të metodës revolucionare të drejtimit të punëve që na mëson Partia, e cila na porosit të shkojmë në bazë, ku të futim duart në vaj e në baltë bashkë me masat, Abdyl Këllezi ishte për metodën burokratike të drejtimit. Dhe ai ka punuar mjaft në këtë drejtim.

Por puna armiqësore e Abdyl Këllezit dhe e Koço Theodhosit u zbulua dhe u demaskua. Bashkë me të tjerët edhe Abdyl Këllezi kishte gisht në sabotimin e

industrisë së naftës. Këta elementë armiq na kanë sabotuar shumë në këtë sektor. Ata na gënjenin, na jepnin të dhëna të gabuara. Parashikimet e Komitetit Qendror të Partisë, kur i zbuloi këta elementë, u vërtetuan të tëra. Këta armiq janë agjentë të të huajve, në radhë të parë të sovjetikëve.

Veprimtaria e tyre armiqësore ishte jashtëzakonisht e rrezikshme dhe e lidhur me tradhtinë e Beqir Ballukut, të Petrit Dumes të Hito Çakos. Këta ishin të kamufluar. Kamuflimi i tyre qëndronte në atë që izoluan në disa drejtime Komitetin Qendror dhe raportet që i dërgonin i deformonin, i falsifikonin. Kur venin shokët e Komitetit Qendror për të kontrolluar, ose kur dërgonim ekipe nga qendra, prapë këta tradhtarë e organizonin punën në mënyrë të atillë që të mos thuhej gjë, flitej për gjëra të zakonshme dhe në qoftë se ndonjëri merrte guximin të jepte ndonjë informata, atij i gjendej vendi nga kjo bandë armiqsh, sabotatorësh e tradhtarësh.

Duke vepruar kështu, ata u munduan ta pengonin Komitetin Qendror të shikonte si duhej komplotin që po organizonin dhe njëkohësisht të krijonin kudo në ushtri një frymë besimi sikur të gjitha këto që bëheshin kishin miratimin e Komitetit Qendror e të Komandantit të Përgjithshëm.

Vija e drejtë ka ekzistuar kurdoherë në Partinë tonë, por nuk ka qenë kuptuar e zbatuar gjithnjë si duhet. Puna armiqësore e tradhtarëve, sidomos në ushtri, kishte për qëllim të çorganizonte mbrojtjen, të linte hapur shtigjet, që armiku agresor të futej lehtë në territorin tonë dhe të shkatërronte mbrojtjen. Ata

janë përpjekur që të mos realizoheshin detyrat, ushtria të organizohej në mënyrë të tillë që të prisheshin përpjesëtimet e taktikës dhe të strategjisë që ka caktuar Komiteti Qendror dhe, mbi të gjitha, të zbatonin antitezat, të cilat u kundërviheshin Tezave të Këshillit të Mbrotjtjes, që shërbejnë për edukimin e Ushtrisë Popullore.

Përse i bënë armiqtë të gjitha këto veprime në ushtri dhe në sektorin ekonomik? Me veprimtarinë e tyre ata synonin të goditnin ushtarakisht Partinë, udhëheqjen e saj marksiste-leniniste, të merrnin fuqinë në dorë dhe ta bënë Shqipërinë një vend satelit të Bashkimit revizionist Sovjetik ose të Jugosllavisë titiste. Qëllimi i tyre ishte, pra, të sillnin në fuqi armiqtë e popullit. Por plani i tyre u zbulua dhe ky ishte një sukses i madh i Partisë dhe i popullit. Të gjitha ato që ka thënë Partia tashmë janë vërtetuar plotësisht nga hetuesia, bile kjo ka zbuluar fakte të tjera që armiqtë i kishin fshehur, ata kanë pohuar edhe për bashkëpunëtorë të tjerë që në fillim i fshihnin. Kështu logjika e fortë dialektike e Partisë, durimi i saj në zbulimin e rrënjëve të kësaj veprimtarie të rrezikshme i detyroi armiqtë që të pohojnë plotësisht tradhtinë e tyre, krimet që kanë kryer.

Në zbulimin dhe në analizën e kësaj veprimtarie armiqësore u vërtetuan edhe një herë aftësia e Partisë, e klasës sonë punëtore, drejtësia e tezës për luftën e klasave dhe besnikëria e kuadrove. Ky komplot, shokë, përbënte një rrezik të madh për atdheun, ai që i lidhur edhe me armiqtë e jashtëm. Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik përpiqen t'i marrin

kalatë nga brenda. Pjesëtarët e këtij komploti, siç po vërtetohet, kanë qenë agjentë të vjetër të tyre. Mirë, mund të thoni ju, po pse nuk i keni parë më përpara? Po të ndjekim me kujdes jetën e Partisë, dhe ne i kemi parë të gjitha protokollet me radhë, del se këta tradhtarë Partia i ka kritikuar rëndë, herë pas here, megjithatë ajo vazhdimisht u ka dhënë dorën që të vinin në rrugën e popullit, por ata e kanë fshehur punën e tyre armiqtësore.

Kur këta armiq e mbushën kupën, u degjeneruan, Partia i mbërtheu si duhej. Ky ishte një proces që ndoqi zhvillimin e vet dialektik. U degjenerua sidomos Beqir Balluku. Kur zbuluam ne një rast se grabiste pasurinë e popullit, i kërkua llogari, por e vërteta është se këto akte të tij të ulëta i pamë vonë edhe për faktin se nuk na informonte njeri. Vente Beqir Balluku bënte ahengje nga të katër anët dhe neve nuk na thoshte gjë njeri për sjelljet e tij. Po pse ndodhi kështu? Sepse u krijua ajo që thamë më parë, këta armiq kishin mbjellë në ushtri një frymë të atillë që, duke shfrytëzuar edhe autoritetin e Partisë, ca me arrogancë, ca me mënyra të tjera të ulëta, që tashmë i ka analizuar Partia, u impononin kuadrove mendimet e tyre. Kur vinte puna për të informuar lart për zgjidhjen e ndonjë problemi, thoshin: «E ç'është nevoja të shqetësoni Komitetin Qendror për këtë? E zgjidhim ne këtë punë!». Kështu vepronin në shumë drejtime të tjera, me qëllim që t'i frenonin dhe t'i korruptonin kuadrot. Dhe në fakt këta arritën të korruptonin mjaft njerëz.

Ju dëgjoni ç'po ngjet andej-këtej në shumë vende të botës. Imperializmi ka futur atje spiunët e vet dhe

mbështet e mban në fuqi klikat që janë në shërbim të tij në këto vende. Por Partia jonë është një parti e fortë, marksiste-leniniste, dhe të tilla gjëra nuk lejon të kalojnë. Pikërisht pse është kështu, prandaj edhe zbulohen e dalin mbi ujë të tillë elementë armiq, ndryshe do të vazhdonin gjatë brenda radhëve tona dhe do të na e krimbnin Partinë. Armiqtë nuk mundën dhe as do të mundin dot t'i krimbin Partinë dhe popullin tonë, t'i kthejnë ata nga rruga e drejtë e marksizëm-leninizmit, për arsye se ideologjia jonë ka hyrë në shpirtin e popullit dhe Partia këtë armë di ta përdorë më së miri në luftën e klasave, kështu që armiku, në mos u zbuloftë dot sot, do të zbulohet me siguri dhe absolutisht nesër, sikundër u zbuluan këto grupe armiqësore të rrezikshme për Partinë dhe atdheun.

Pasojat e veprimtarisë armiqësore po i riparojmë. Për shembull, puna armiqësore në sektorin e naftës solli një vonesë të madhe në zbulimin e vendburimeve të reja, por me siguri ne do ta marrim veten, do ta arrijmë objektivin tonë, se në këtë sektor me rëndësi ka një klasë punëtore të shëndoshë, e cila ndiqte dhe shihte çfarë po bënin armiqtë dhe më në fund mori guximin e na tha: «Vini dorën, shokë të Komitetit Qendror, se këtu ka punë armiqësore!». Pra klasa punëtore na i hapi sytë.

Ne do t'i riparojmë dëmet e mëdha që na shkaktuan armiqtë, por këta nuk arritën dot të vepronin siç kishin menduar në sektorët e tjerë, megjithatë një gjendje jo të shëndoshë krijuan edhe atje. Një frymë të sëmurë krijuan ata sidomos në kuadrot e ushtrisë, si dhe në disa kuadro të sektorëve civilë. Prandaj, që

të përmirësohej kjo situatë. u morën masa që të vihej në jetë çështja e madhe, e shtruar prej kohësh nga Partia, ajo e qarkullimit të kuadrove, për revolucionarizimin e tyre, që nuk bëhej si duhej.

Kudo në Parti dhe në masa, ashtu si edhe te ju këtu, u bënë mbledhje, u punuan materialet e Partisë, u bë kritikë dhe autokritikë, që i dhanë hov të madh punës. Gjithë kjo kishte për qëllim të pastronte plagën e hapur nga armiqtë, ngriti lart ndërgjegjen e komunistëve, u dha një goditje të fortë, të madhe armiqve dhe tash shohim se kudo kërkohet nga të gjithë që ata të dënohen pa mëshirë. Armiqve do t'u jepet dënimi i merituar. I duhen nxjerrë rrënjët së keqes dhe t'i shkulen këto rrënjë. Kur ju këtu, në ara, punoni për të mbjellë grurë, që të dalë prodhim i mbarë, çfarë bëni? E punoni tokën qilizmë, e ktheni përmbys, që të gjitha mikrobet e parazitët të dalin në diell dhe të ngordhin, hidhni farë të zgjedhur, shkulni nga rrënjët bimët e këqija, e kështu me radhë. Në këtë mënyrë punon edhe Partia. Këtë e do interesi i luftës së klasave.

Po si mendoni ju, mos vallë shpëtuan tashli nga të këqijat? Jo, do të ishte gabim, shokë, të mendonim kështu. Kërkohet vazhdimisht nga të gjithë vigjilencë e madhe. Hrushovi, ndër të tjera, e ka kritikuar Stalinin pikërisht se ky ka këshilluar me qenë kurdoherë vigjilentë ndaj armiqve. Stalini na mëson drejt se, edhe kur fiton e po ndërton socializmin, armiku i klasës kurrë nuk fle, prandaj sa më shumë të fortë të bëhemi, prapë ai do të përmbledhë forcat e do të ngrihet të na godasë. Po pse të na godasë edhe kur sheh që ne jemi forcuar? Sepse shikon pikërisht vdekjen me sy dhe, kur armiku

e shikon fundin të sigurt, mendon: «Më mirë të vdesë ky, se unë». Prandaj, pavarësisht se ne forcohemi dhe armiqtë gjithnjë e më shumë po demaskohen, ata prapë përpiqen të organizohen që të na godasin ne, të godasin rendin tonë socialist. Është për këtë arsye që duhet të jemi vigjilentë, sepse armiku, po të shohë që flemë, në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër do të ngrejë krye dhe do të përpiqet të kthejë të kaluarën.

Shokë, normat e Partisë duhen zbatuar në mënyrë dialektike me ndërgjegje të pastër. Të mos krijohet te njerëzit pikëpamja se është e pamundur të mos bëhen gabime. Partia na porosit të jemi vazhdimisht të vëmendshëm që të bëhen sa më pak gabime, por edhe kur të bëhet gabimi, ta njohim atë, se po e njohëm, tregojmë që do të shërohem, po të na mbetet hatëri pse na kritikoi shoku me të drejtë, atëherë nuk jemi në rrugë të drejtë. Shoku ka të drejtë të kritikojë dhe me këtë qëndrim ai i sjell shërbim shoqërisë. Kjo është një edukatë e tërë që te ne përhapet dita-ditës, teorikisht dhe në praktikë.

Puna është që ne, me forcat tona fizike, me mekanikën e me të gjitha mjetet e mundësitë e tjera që disponojmë dhe me një shpirt të pastër revolucionar, t'i vëmë shpatullat më mirë se kurdoherë bujqësisë, ta bëjmë këtë një sektor me të ardhura të mëdha për ekonominë e vendit tonë. Për t'ia arritur këtij qëllimi, duhet të punojmë që të marrim rendimente të larta në të gjitha llojet e bimëve, t'i rritim prodhimet bujqësore e blegtorale dhe në këtë drejtim rezervat janë të mëdha, prandaj të mos i lëmë ato pa i shfrytëzuar. Rezervat në bujqësi nuk janë në një drejtim të vetëm, ato

fshihen në të gjitha drejtimet: në prashitje, në ujitje, në përmirësimin e farës, në insekticidet etj., etj. Të gjitha këto ne duhet t'i zbulojmë e t'i llogaritim me stil revolucionar, asgjë të mos mbetet në harresë.

Rëndësi ka, shokë, që të mos harrohen për asnjë çast direktivat që ka lëshuar Komiteti Qendror për sa i përket fshatarësisë. Komiteti Qendror ka bërë kritika të ashpra kundër drejtuesve të planit, të cilët jo vetëm nuk kanë punuar për t'i zbatuar direktivat, por, në të kundërtën, i kanë shpërdoruar. Neve na bie detyra të luftojmë më shumë se deri tash për ngritjen e nivelit të jetesës së fshatit, që ky nivel të afrohet me atë të qytetit. Klasa jonë punëtore është e ndërgjegjshme për këtë dhe po jep një ndihmë kolosale për zhvillimin ekonomik e kulturor të të gjithë vendit, duke përfshirë edhe fshatin, dhe fshatarësinë e shikon si aleatën e saj më besnike. Prandaj, zemra dhe mendimi i klasës punëtore, që është dhe zemra e mendimi i Partisë, është që kjo aleatë besnike, fshatarësia, të mos ketë akoma për një kohë të gjatë një diferencë në jetesë me vetë klasën punëtore dhe me zyrtarët. Për këtë qëllim janë duke u marrë të gjitha masat që në fshatra të rritet me ritme akoma më të shpejta se deri tani niveli ekonomik dhe me kënaqësi të madhe po vërej se si këtu te ju, ashtu edhe në shumë kooperativa të tjera janë arritur rezultate shumë të kënaqshme. Tash kudo në fshatrat tona kemi shkolla, dyqane, banja, furra, lavanteri, maternitete, spitale, kemi edhe shtëpi kulture. Sidomos në drejtim të kulturës ka një zhvillim të mahnitshëm në fshat, saqë, kur mendon jetën tonë në të kaluarën, thua me habi: «More, ç'është bërë



këtu!». Këtë nuk e themi vetëm ne, por e thonë edhe miqtë e huaj që vijnë e vizitojnë Shqipërinë, e pohojnë edhe elementët borgjezë përparimtarë që kanë pasur raste të vijnë te ne, e thonë edhe kapitalistët, me të cilët bëjmë nga një çikë tregti. Të gjithë, pra, mbeten të habitur nga ato që shohin në vendin tonë. I tillë është zhvillimi që është arritur te ne!

I njëjti fenomen vërtetohet edhe në bujqësi. Kanë ardhur ca kohë më parë disa specialistë të huaj. Ne kemi lexuar artikujt e tyre në gazetat kryesore bujqësore të tyre, ku ata kanë shkruar se në Shqipëri (dhe duhet ditur se ata kanë qenë edhe më përpara dhe e kanë njohur gjendjen e vendit tonë) është krijuar një bujqësi moderne që nuk e shikon në shumë vende të Evropës. Dhe në fakt, shokë, mund t'ju them këtë: Përpara pesë a gjashtë vjetësh, kur merrnim rendimente të ulëta nga gruri dhe dëgjonim që në Itali, në Gjermani merrnin 35 ose 40 quintalë për hektar, çuditëshim se si arrinin rendimente kaq të larta. Por ja që edhe ne i arritëm ato dhe brenda ç'kohe? Në pesë vjet, bile dhe po i tejkalojmë. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon forcën e socializmit dhe drejtësinë e vijës së Partisë sonë.

Prandaj direktivat e Partisë për bujqësinë duhet t'i kemi mirë parasysh dhe të luftojmë me të gjitha forcat që t'i vëmë në jetë, me qëllim që ta ndryshojmë akoma gjendjen e furnizimit dhe të marrim masa që të kemi ç'duhet jo vetëm ne që jetojmë në qytet, por të ketë nga këto edhe fshati. Janë kooperativistët që prodhojnë sheqerin, mishin, gjalpin, vajin, vezët, perimet, frutat etj. Ju këtu prodhoni, fjala vjen, sheqer, po është e drejtë të mos keni të hani nga ai sa

duhet, kurse ne në qytet të hamë më shumë? Kjo nuk ecën dhe nuk është e drejtë. Ju rritni lopë, derra, dele, dhi, pula, prodhoni me to mishin këtu në fshat, po nuk është e drejtë që ne në qytet të hamë sa të duam mish, vezë, gjalpë, djathë, t'i gjejmë këto në dyqan çdo ditë dhe ju të mos gjeni kur doni të bleni. Jo, as kjo nuk është e drejtë dhe nuk duhet të lejohet një gjë e tillë! Ju rritni luledielli, nga i cili del vaji i ngrënshëm, po a duhet të lejohet që ne në qytet të kemi vaj sa të duam, kurse ju në fshat të keni më pak? Nuk mund të ecet kështu në socializëm, shokë, prandaj të merren masa që të ndryshohen proporcionet e furnizimit qytet-fshat. Orientimet drejt i ka dhënë Komiteti Qendror, por Abdyl Këllezi, Kiço Ngjela dhe armiqtë e tjerë i shtrembëronin me qëllim, pse ata dëshironin dhe punonin për një situatë tjetër.

E përsëris se duhet punuar me të gjitha forcat për zbatimin deri në fund të orientimeve, por në mënyrë të veçantë të punojë me një ndërgjegje të lartë revolucionare klasa punëtore për t'u dhënë popullit dhe fshatit, sidomos, të gjitha prodhimet që ajo nxjerr dhe jo vetëm në sasi të mjaftueshme, po edhe me cilësi të mirë e me çmime të lira. Të gjithë duhet të luftojmë për këto tri çështje, po klasa punëtore, në radhë të parë, e ka për detyrë të bëjë përpjekje të mëdha në këtë drejtim, pse kështu e tregon ajo besnikërinë e saj ndaj aleatës së vet, kështu tregohet nga ana e saj kuptimi i lartë i ndihmës reciproke. Por edhe fshatarësia duhet të kuptojë se e ka ajo barrën për të furnizuar gjithë popullatën e Shqipërisë me ushqime. Kjo do të thotë që, po të mos kemi drithëra me rendi-

mente të larta, po të mos kemi luledielli apo panxhar-sheqeri me rendimente të larta, e kështu me radhë për të gjitha bimët e tjera, nuk mund të kemi atë furnizim që dëshirojmë dhe atëherë vjen vetvetiu që njëri do të marrë më shumë e tjetri do të marrë më pak. Kur nuk kemi aq prodhime sa janë nevojat, pra, kur sasi të janë të vogla, atëherë duhet t'i ndajmë proporcionalisht prodhimet. Prandaj të mos kënaqemi me sasi të vogla prodhimesh, po të përpiqemi t'i ngremë këto sasi. Ky është qëllimi i luftës dhe i mobilizimit që kërkon Partia, i zbatimit të shkencës që porositi ajo, si kudo, edhe në bujqësi.

Ka shumë çështje të tjera që janë zbatuar gabim nga sipër, nga Qeveria dhe nga ne, por edhe nga ju, këtu në bazë. Komisioni i Planit të Shtetit kishte krijuar pikëpamjen e një «bollëku». «Ka bollëk të madh», bërtiste Abdyl Këllezi. Jo, shokë, bollëk të madh nuk ka akoma, dhe kur krijon përshtypjen e një situatë bollëku të madh, atëherë kur bëhet plani, tjetri do të kërkojë edhe materiale e mjete më shumë. Në këtë drejtim edhe ju keni faj. Natyrisht, baza ka mendime dhe i lumtë, kur këto i hedh në tavolinë, por asaj duhet t'i thuhet qartë: «Ja, ky është jorgani i shtetit tonë, prandaj brenda tij t'i zgjatim këmbët, pse, po i zgjatëm më tutje, atëherë fillon «pleviti»». Mirëpo Abdyl Këllezi, për të krijuar pakënaqësi në masat dhe në kuadrot e bazës, e zhvillonte situatën në të kundërtën, në vend që të bazohej te «jorgani», ai nxiste bazën duke e orientuar që mbi planin të bëhej edhe kjo, të bëhej edhe ajo, të ndërtonim edhe këtë objekt, edhe atë tjetrin e kështu me radhë.

Unë mund t'ju them se, që nga pesëvjeçari i kaluar, ka plot rrethe që kanë nga 50, nga 40 e nga 35 objekte që i kanë filluar, por nuk i kanë ndërtuar akoma. Të gjitha këto rrethet i kishin vënë në plan, u ishin caktuar për ndërtimin e tyre edhe fondet monetare e materiale e, megjithatë, ato kanë mbetur pa u ndërtuar. Po si ishin planifikuar këto? Ishin planifikuar pa u studiuar mirë, duke u nisur vetëm nga dëshira që hajde t'i bëjmë. Po pse t'i bëjmë? Komiteti Qendror kishte dhënë orientim për t'i vënë rëndësi më të madhe ndërtimit të gjitha atyre objekteve, prodhimet e të cilave popullit i duhen më shpejt.

Duke vepruar kështu, Komisioni i Planit të Shtetit hapej si vaji në lakra, prandaj këto objekte, në fakt, nuk u realizuan. Mirëpo ç'ngjet? Ngjet kjo që baza mbetet e pakënaqur dhe fillon të qahet, duke thënë: «E po pse na u premtuan, pse nuk na jepen fonde, pse nuk na jepen materiale, dërrasa, çimento etj., etj.?». E ku t'i gjejmë këto? Plani nuk i ka parashikuar dhe këto objekte janë vënë jashtë planit e mundësive tona për t'u ndërtuar. shokë. Prandaj në këtë drejtim duhet të jemi shumë të matur.

Shumë të matur duhet të jemi ne edhe në kooperativa. Investimet në to duhet të bëhen kryesisht në fushën e prodhimit dhe në ato drejtime e zëra që japin rendimente e të ardhura të mira, që janë të vlefshme për ushqimin e popullit dhe për gjithë republikën. E theksoj këtë sepse kam konstatuar që në malësi, ku akoma kooperativistët marrin pak të ardhura për ditë-punë, fondin e paprekshëm të kooperativës e ngrenë jashtë ligjit deri në 30 për qind dhe ndërtojnë me të

shtëpi kulture, banja, lavanteri dhe të tjera objekte të parakohshme për kushtet e tyre. Dhe ç'shikon pastaj? Të raportojnë se një qerdhe apo kopsht mban dhe paguan dy edukatore, kurse ata frekuentohen vetëm nga dy ose nga tre kalamanë! Kjo nuk duhet të lejohej, pse rëndon në kurriz të mirëqenies së kooperativistëve. Ose shikon që në një kooperativë të bashkuar me tre apo katër fshatra ngrihen tri shtëpi kulture të mëdha e me salla si ato të disa qyteteve me popullsi të madhe.

Ju, për shembull, po përdorni këtë shtëpi kulture ku jemi mbledhur, që më duket se është modeste, megjithëse jeni nga kooperativat e tipit të lartë me të ardhura të mira. Unë nuk mendoj që ju të mos bëni një shtëpi kulture tjetër, por dua të them që hëpërhtë e keni mirë këtë shtëpi kulture modeste, kurse kooperativa e Lapardhasë në rrethin e Beratit na paska dy me salla të mëdha prej 250 vetash dhe ka filluar ndërtimin e një tjetre me kapacitet 300 vetash, ajo e Poshnjës po në atë rreth ka bile një shtëpi kulture me sallë për 400 veta, lëre pastaj të tjerat ç'ka andej e këtej, anekset! Po daleni, more shokë, u themi ne, po sikur të pyesim një çikë masën e kooperativistëve e t'u themi: nuk është më mirë të merrni nga 16 apo 17 lekë për ditë-punë dhe aktivitetin kulturor ta bëni në lokalet modeste ekzistuese apo fundja edhe atje në shesh? Çfarë mendoni se do të thonë ata? Me siguri do të jenë dakord që të jenë më modeste e të marrin para më shumë. Ose në vend të shtëpisë së kulturës nuk është më mirë t'i përdorim më parë fondet për të mbushur me mollë tërë kodrat rreth e rrotull? Po t'i pyesim

köshtu, kooperativistët do të thonë me siguri: «T'i mbushim me mollë, dhe të vemi të kërcejmë e të këndojmë nën mollët hëpërhë, pse është edhe shumë bukur, pastaj, kur të kemi të ardhura më shumë, e bëjmë edhe shtëpinë e kulturës».

Prandaj investimet të maten e të peshohen mirë, shokë, se janë djersa e popullit. Për to duhet të pyetet medoemos populli, në mënyrë të hapët dhe shoqërisht, sepse këtë e kërkon demokracia jonë kooperativiste. Partia, sigurisht, synon që krahas me prodhimin të zhvillohet edhe kultura. Natyrisht, në çdo kooperativë ne duhet të kemi e do të kemi edhe shtëpi kulture, por këto t'i ndërtojmë sipas nevojës, sipas çapit dhe mundësive që krijohen. Të vjen mirë shumë që si në qytet, ashtu edhe në fshat t'i kemi këto të mira si çerdhen, kopshtin, shtëpinë e lindjes e të gjitha të tjerat me radhë, por veç gradualisht e sipas mundësive do të plotësohen nevojat e do të ngushtohen dallimet në mes fshatit e qytetit.

Byroja Politike më ka rekomanduar t'ju them se nevojat e atdheut për prodhime bujqësore e blegtorale kanë qenë dhe janë të vazhdueshme, ndërsa në pesëvjeçarin që vjen ato do të jenë akoma më të mëdha. Prandaj, në qoftë se në bujqësi, ashtu si edhe në industri, do të arrijmë rezultatet që parashikojmë, kjo do të përbëjë një faktor të madh për forcimin e mëtejshëm të atdheut, të cilin duhet ta lulëzojmë më tej, por, njëkohësisht, edhe ta mbrojmë.

Unë, shokë, këto kisha për t'ju thënë, mbase dhe u zgjata shumë për to. Takimet që pata me punëtorët, me ju, shoqe dhe shokë kooperativistë, me shokë drej-

tues të Partisë dhe të pushtetit në rreth, më gjallëruan akoma më shumë, më forcuan e më dhanë fuqi që t'u shërbej atdheut dhe Partisë edhe më mirë e me sa të mundem. Dhe e kam për detyrë ashtu si të gjithë komunistët, si ushtar i Partisë, që të përpiqem derisa të kem jetën për t'i shërbyer atdheut. Duke u takuar me ju, unë e ndiej veten të përtërirë, më shtohet jeta, sepse kudo në masat, në popull, në kooperativistë, në punëtorë, në kuadro shoh një entuziazëm të madh, një dashuri të madhe për Partinë. Kjo më bën që për këtë popull të sakrifikoj edhe jetën, dhe ky është nderi më i madh për mua.

Si përfundim, dëshiroj t'ju uroj personalisht edhe në emër të shokëve që kanë ardhur këtu, si shokët e vjetër veteranë Miha Lako dhe Pilo Peristeri, nga të cilët unë kam mësuar kur isha i ri, pastaj të Nexhmijes dhe të shokëve të tjerë, që janë anëtarë të Komitetit Qendror. Ne mbetëm shumë të kënaqur nga ky takim me ju, mësuaam shumë, prandaj jo vetëm në emrin tim dhe të shokëve që përmenda, por, në radhë të parë, në emër të Byrosë Politike ju uroj nga zemra suksese akoma më të mëdha. Ne jemi të bindur se vitin e ardhshëm, që do të jetë viti i parë i pesëvjeçarit të gjashtë, jo vetëm që do t'i plotësoni, por edhe do t'i tejkaloni planet, se ju do të hartoni një plan pesëvjeçar, që do të jetë me të vërtetë i guximshëm e revolucionar, për të realizuar të gjithë ata objektiva që thashë dhe që janë shprehje e orientimeve të Komitetit Qendror të Partisë. Unë ju lutem të gjithëve ju që jeni këtu, që t'u transmetoni tërë kooperativistëve e kooperativisteve, të rinjve e të rejave të Pojanit përshëndetjet revo-

lucionare të Komitetit Qendror dhe të miat. Kalitni zemrat e tyre, punoni që tek të gjithë të ngulitet e fortë si betonarme dashuria për Partinë!

Të rrojë Partia!

Të rrojë fshatarësia jonë kooperativiste!

Të rrojë klasa punëtore!

*Botuar për herë të parë,  
me disa shkurtime, në li-  
brin: Enver Hoxha, "Ra-  
porte e fjalime 1974-1975",  
f. 328*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



## TA DONI QYTETIN TUAJ DHE TË NDËRTONI ÇDO GJË ME SHIJE

*Bisedë me shokët Jorgji Profiri dhe Gjergji Kotmilo*

21 gusht 1975

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni, shokë, mirë?

Ne jemi shumë të kënaqur nga qëndrimi dhe nga vizitat që bëmë këtu në Korçë. E njohim edhe ne Korçën, por jo sa ju.

Unë jam partizan i përhapjes së të resë socialiste në art e në kulturë dhe i ruajtjes së të vjetrës që është përparimtare. Më pëlqejnë shumë shtëpitë e bukura që ndërtohen sot, por më pëlqejnë shumë edhe ato që janë ndërtuar nga mjeshtrit tanë të vjetër.

Ndërtesat e reja që shikojmë nuk ishin në kohën tonë të paraçlirimit, shoku Pilo. Këto i ka bërë dora e shkathët e njeriut të ri të socializmit. Ja, për shembull, aty ku dikur ka qenë qendra e haneve, tani është bërë zona e hotelit. Shikoji çfarë ndërtesash janë! (*Shoku Enver Hoxha tregoi tri variantet e urbanistikës së qytetit të Korçës, të ekspozuara mbi tryezë.*)

**SHOKU GJERGJI KOTMILO<sup>1</sup>:** Më lejoni, shoku

---

1. Arkitekt.

Enver, t'ju jap nja dy shpjegime rreth variantit të parë.

Këtu është bulevardi «Stalin». Kjo është ndërtesa ekzistuese e komitetit të Partisë. Këtu ndodhet monumenti dhe këtej janë disa shtëpi karakteristike korçare që do të ruhen. Afër monumentit të Luftëtarit Kombëtar është ndërtesa e shkollës së parë shqipe. Ja dhe shtëpia e Vangjush Mios. Ne kemi marrë në konsideratë zgjerimin e qendrës së qytetit të Korçës, por kemi pasur parasysh edhe vlerën historike të saj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shtëpia e Vangjushit ka vlera artistike. Unë kam pasë hyrë në atë shtëpi dhe mbaj mend kur më thoshte gjithnjë Vangjushi: «Hajde, kolopuç, kur do të vish të të bëj një portret?». Dhe ma bëri portretin.

*SHOKU GJERGJI KOTMILO:* Në qendër të qytetit mendojmë të ngremë pallatin e ri të kulturës, në krahun e djathtë muzeun e qytetit dhe galerinë e arteve.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Muzeu është këtu nga ana e shtëpisë së Pepos.

*SHOKU GJERGJI KOTMILO:* Po. Kurse këtej nga krahu i majtë mendohet të ngrihet ndërtesa e komitetit të Partisë të rrethit.

Këtu ka shtëpi banimi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, e shikoj që këto janë ndërtesa për banim, kurse këtu afër tyre ka qenë kinema «Mazhestiku».

Ju mendoni t'i fshini fare këto shtëpitë e vjetra, duke filluar që nga ish-dyqani i Bopit e deri këtu, sepse, sipas jush, kjo zonë nuk ka vlera muzeale. Unë jam

për zonën muze, por, natyrisht, jo për një zonë të veçuar. Për mua gjithë ana e djathtë e bulevardit, që ngrihet deri te kodrat, duhet të jetë e tëra zonë muze.

Shtëpitë e vjetra t'i prishim dhe në vend të tyre të bëjmë ndërtesa të reja, komode, por disa gjëra, që kanë bukurinë dhe vlerën e tyre artistike, historike etj., duhet t'i ruajmë. Në qoftë se është një shtëpi me vlera muzeale, këtë lypset ta ruajmë, për arsye se të tilla shtëpi nuk do të ndërtojmë më.

Edhe mua, edhe Nexhmijes na pëlqyen ndërtesat e reja që keni bërë. Ju keni gusto në këto punë, që i keni bërë me forcat tuaja dhe me ndihmën e arkitektëve të Tiranës. Ndërtesat prej betonarmeje në Elbasan nuk na kanë pëlqyer; edhe të huajt s'kanë se çfarë t'u pëlqejnë këtyre ndërtesave, se të tilla ata kanë, bile me shumë kate, prandaj në ndërtim duhet të ruajmë stilin karakteristik të ndërtimeve tona.

*SHOKU JORGJI PROFIRI<sup>1</sup>*: Këto vërejtje, shoku Enver, na i keni bërë edhe në vitin 1970 dhe ne jemi munduar t'i mbajmë parasysh në punën tonë. Do të përpiqemi t'i ruajmë shtëpitë që janë karakteristike, bile do të ndërtojmë edhe të tjera që të kenë karakteristikat e tyre të veçanta. Kështu do të kemi kujdes në rrugën «Gjergj Kastrioti», si dhe për ato ndërtesa që janë prapa komitetit ekzekutiv.

Por ka ndërtesa që janë shumë të vjetra dhe mjaft të amortizuara, pothuajse 42 për qind e tyre del që duhet të prishen.

---

1. Inxhinier ndërtimi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Që nga ish-kinema «Mazhestiku» e gjer te ndërtesa e Nuçi Mborjes do t'i lëmë pa prishur.

Në ndërtimet që bëhen duhet të ketë me të vërtetë diçka karakteristike dhe artistike. Të ngrihen ndërtesa e parqe që të paraqesin edhe stilin e mjeshtërinë e të parëve. Kështu, kur të vijnë vizitorë të huaj, të shikojnë që Berati, Gjirokastra, Tirana, Korça, Shkodra etj. kanë veçoritë e veta karakteristike, pamje të veçanta, interesante e kurioze. Pra, duhet pasur parasysh që të ruhen e të pasurohen këto karakteristika, sepse janë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me të ardhmen.

(*Duke treguar në maket.*) Kjo ndërtesë këtu çfarë do të jetë?

**SHOKU JORGJI PROFIRI:** Këtu mendojmë të ndërtojmë muzeun e madh.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtu ishte shtëpia e njërit nga Bitincka, të cilin e kam mirë parasysh. Pranë saj ishte edhe internati ynë, kurse kjo këtu ishte farka e Pilo Peristerit. Këtej ka qenë kafe «Afrika» dhe këtu ishte kazinoja.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Ku janë ato shtëpitë që na pëlqyen kur i pamë?

**SHOKU ENVER HALILI:** Ato janë ndërtuar të gjitha këtej.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Cili është sheshi kryesor, ku do të bëhen mitingjet?

**SHOKU GJERGJI KOTMILO:** Këtu te monummenti i Luftëtarit Kombëtar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë mund të jem i paditur në këto punë, por kam menduar që pallati i kul-

turës të bëhej në formën e gjysmës së harkut me një kolonadë që t'i jepte formë gjithë sheshit. Në mes të sheshit mund të vendosnim monumentin. Këtu të ishte fasada, pastaj, brenda, të bënim teatrin dhe anekset e tjera. Mendoj se këtu është vend i përshtatshëm për të qenë qendër artistike e kulturore.

Në Korçën e periudhës së socializmit shikojmë vetëm vija të drejta. Mos ma merrni të mirëqenë këtë që them, por mua më duket se do të ishte mirë të kishte një varietet me një stil më të bukur. Kur them për kolonadën, nuk kam parasysh atë të Vatikanit, as të kafe «Nuçit», por një vend që të jetë më i hapur, më i madh e me kolonada, megjithëse kjo gjë mund të mos luajë asnjë rol.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Unë nuk jam për ndërtesat me shumë kate, por mendoj se këtu mund të lartësohet një ambient kulturor me xhamllëk.

*SHOKU GJERGJI KOTMILO:* Puna është që me këto ndërtime të mos mbulojmë panoramën e bukur të malit të Moravës. Kemi mendimin të bëjmë ndërtesa me dy apo tri kate.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këtej dalim nga një shesh, që duhet t'i japim një bukuri të rrallë. Kam mendimin që në mes të këtij sheshi duhet të vendoset monumenti i Luftës Nacionalçlirimtare. Kështu do të pasqyrohen dy periudha kohe të lavdishme: koha e Rilindjes dhe koha e Partisë. Të dyja këto periudha historike janë të lidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet arterit «Lenin», pra do të kemi një lidhje dialektike nga koha e Rilindjes në epokën e Partisë. Prandaj mendoj të shikohet mirë kjo ide.

Rruga këtej lart merr një linjë të drejtë dhe pastaj fillon qyteti tradicional.

*SHOKU JORGJI PROFIRI:* Që sheshi të shërbejë për parakalimet, do ta lëmë në vijë të drejtë, prandaj kjo pjesa këtu duhet të priset.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ne mund të konsiderojmë se është më mirë që sheshi të ketë formë rrethi. Ju, si artistë, duhet të mendoni që ndërtesat të ngrihen në këtë shesh në formën e një rrethi, ku të shikohen gjëra të bukura dhe të mos duket diçka e krijuar artificialisht.

Kjo këtu është një ndërtesë e gjetur, që ka marrë formën e gjysmëharkut.

Këtu mund të jetë një shkollë e lartë, mund të ndërtojmë një bllok të bukur në formën e gjysmëharkut, që të duket si një portë e madhe, e cila del nga bulevardi «Lenin», dhe këtu të ishte një kolonadë e madhe. Kështu mendoj që i jepet sheshit hapësirë dhe varietet.

Pallati i kulturës mendoj të ketë një pamje të ndryshme me atë të ndërtesave rezidenciale. Meqenëse thoni se do të marrë formën e një luleje, mendoj që monumenti të jetë pistili i «lules». Këtu e kisha idenë.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Kjo ndoshta do të ngushtonte hapësirën. Këtu është muzeu, ku populli mund të futet edhe për t'u mbrojtur nga shiu. Unë mendoj të ketë formë arkadash.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Unë e njoh Korçën, këtu s'ka vende ku mund të futen njerëzit në raste të tilla.

Në Romë, ku gjendet sheshi «Shën Pjetër», vendo-

sja e ndërtesave është bërë në formë harku, por, kurrë në qoshe, të duket sikur janë në vijë të drejtë. Çështja është që të gjitha këto të lidhen me pallatin këtu. Mundet që kjo të mos jetë e tërë kolonadë, se për këtë qëllim mund të lihet kati i parë. Shikoni edhe gjelbërimin. Kjo është ideja ime.

Godina e re e komitetit të Partisë të mbetet këtu, mirë e keni menduar vendin e tij.

Ky qenka varianti ku mbrapa ndërtesës ekzistuese të komitetit të Partisë është parashikuar të bëhet parku me pasqyra uji.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Nuk mendoni të keni edhe një qendër patinazhi në akull?

*SHOKU JORGJI PROFIRI:* Po, e drejtë është kjo vërejtje, shoqja Nexhmije.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këto çfarë janë?

*SHOKU JORGJI PROFIRI:* Muzeu dhe galeria e arteve. Te varianti i parë këta janë zgjidhur më mirë. Ky muze do të jetë edhe i Luftës Nacionalçlirimtare, edhe i ndërtimit të socializmit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mendoj se varianti i parë është më i mirë.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Ndërtesa e komitetit të Partisë është mirë në këtë aks që është vendosur? Unë mendoj të kishte një aks tjetër.

*SHOKU GJERGJI KOTMILO:* Ne jemi nisur nga ideja që nuk duhet të krijohet perde midis qytetit të vjetër dhe atij të ri. Për këtë qëllim janë lënë edhe rrugicat, se është menduar të ruhen rrugët e vjetra.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Mendoj që kjo anë të jetë më e shtrembër, sepse ky pozicion rregullon

edhe harkun, meqenëse ana këtej është edhe balli i saj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo do të harmonizohet me ndërtesat e rrugës, kështu do të ketë një vazhdimësi.

Pse i bëni ndërtimet me faqe muri të gjata?

*SHOKU GJERGJI KOTMILO:* Se këto i thyejnë erërat nga veriu.

Këtej janë kuzhinat, kurse dhomat e tjera janë nga jugu.

Të çarat këtu i kemi lënë me qëllim që t'u hyjë dielli dhe drita edhe shtëpive të tjera.

Këto janë lagjet ekzistuese që nuk trazohen. Tendanca është të kalohet në qendër.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë vijmë nga Nuçi dhe ngjitemi lart. S'qenka më kjo shtëpia këtu? Plaku im i ndjerë e pagoi me gjysmë napoloni flori qiranë e dhomës ku rrija unë.

Këtu kemi mjaft gjelbërim. Ja xhamia, kurse më tej ka pak gjelbërim, por do të përmirësohet.

Nuk mund të ndërtohet një mapo e madhe që të likuideojë dyqanet e tjera të vogla të ngritura aty-këtu pa kriter? Të mendohet që të ngrihet një ndërtesë disa-katëshe për mapon dhe në katin e parë të jetë, bie fjalla, reparti i këpucëve, në të dytin, i konfeksioneve e kështu me radhë. Këtu duhet të jetë mapoja, sepse ka lëvizje të madhe, kjo dhe dritat që do të vendosen në të do t'i japin bukuri vendit. Kompleksi i madh atje i jep ndriçim gjithë bllokut dhe gjallëron jetën mbrëmjeve, se njerëzit do të venë në kinema, në teatër, në pallatin e kulturës etj.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Këtu është vendi



për shëtitje. Ja dhe parku, ku njerëzit mund të çlodhen pasi të kenë mbaruar pazarin ose punët e tjera.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pasi të blejnë në treg gjërat që u nevojiten, punonjësit, pensionistët e të tjerë do të kthehen edhe këtej për të bërë një shëtitje dhe për t'u çlodhur në park. Njerëzit grumbullohen nga bulevardi «Lenin» dhe hyjnë në mapo për të blerë diçka. Prandaj mendoj se kjo zgjidhje që jepet këtu për mapon, për shëtitjen dhe për parkun është e mirë.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Rruga që është lënë për parakalimet mendoj të zgjerohet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të hiqet edhe kjo shtëpia këtej që të mos ketë fare pengesë.

Për sa i përket gjelbërimit, mendoj se është parku i madh i qytetit, janë vreshtat dhe të gjitha të tjerat. Shtëpitë këtu, gjithashtu, kanë gjelbërim.

Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit mund të shfrytëzohet si ndërtesë rezidenciale. Mua më duket se vendi ku ndodhet është shumë i mirë, mu në qendër. Përpara tij ka gjithë atë shesh dhe hapësirë. Forma e dhënë në variantin e dytë nuk më pëlqen. Në qoftë se adaptohet mendimi që këtu të bëhet komiteti i Partisë, këtu komiteti ekzekutiv, me një aks në mes ku të jetë pallati i kulturës, është ndryshe, por këto që janë ndërtuar këtu pengojnë, prandaj mendoj se duhet të futen më brenda.

Pra, këtu kemi komitetin e Partisë, në mes pallatin e kulturës, kurse rreth këtij të bëjmë parterë me lule. Kështu, kur futesh në hyrjen këtu, shikon pallatin e kulturës, monumentin, komitetin e Partisë, lulet këtej dhe kjo zona e madhe që mbetet këtu të lidhet me ko-

mitetin. Qoftë në vijë të drejtë, qoftë në formë kurrizore, ky do të jetë aksi, kurse hapësira që do të mbetet do të jetë për lule.

Këtu sikur të bënit mapon, siç e keni, por kësaj mund t'i jepni një formë si të pjerrët, megjithatë çështjen gjykojeni vetë. Këto janë për perspektivën.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Nga cila anë do t'i jepni prioritet ngritjes së fasadave të shtëpive të qytetit? Mirë është të mos u duket shpina ndërtesave nga qendra apo nga rruga kryesore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Përveç kësaj, të merret parasysh edhe drejtimi i diellit, i fryrjes së erërave etj. Të kihet kujdes që fasadat të jenë të mira.

Ju përgëzoj që e keni menduar mirë rregullimin e Korçës. Duhet ta doni qytetin tuaj dhe të vazhdoni ta ndërtoni çdo gjë me shije për kënaqësinë e popullit, jo vetëm nga ana e bukurisë, por edhe nga ajo e komoditetit, duke pasur parasysh gjithmonë gjendjen tonë ekonomike.

Ne lypset të ndërtojmë për qindra vjet dhe të mos i bëjmë ndërtimet monotone. Ashtu si në çdo fushë të veprimtarisë, edhe këtu të përpiqemi të bëjmë gjëra të mira, të bukura, me shije, komode dhe të forta, që të rrojnë me dhjetëra vjet. Të mos shikohet vetëm ana arkitekturore, por edhe ajo e urbanistikës, e gjelbërimit dhe e rrugëve të komunikacionit, që kanë, gjithashtu, rëndësi të madhe.

Të gjitha këto që themi nuk do të bëhen për një vit, por në disa pesëvjeçarë. Si mendoni ju, sa do të vejë popullsia e qytetit të Korçës deri në vitin 2000,

po të vazhdojë shtesa e popullatës me këtë ritëm që ka filluar?

*SHOKU GJERGJI KOTMILO:* Do të shkojë rreth 70 mijë banorë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pa bëni një herë llogari që shtesa e popullatës mbi këtë shifër do të shkojë në fshat. Ju ndërtuesit e qytetit të Korçës duhet të keni parasysh që, në përgjithësi, në të ardhmen, ndërtimet nuk do të ecin me këtë ritëm që kanë qenë deri sot, sepse një pjesë e investimeve, e caktuar për qytetin, tani do t'i shkojë fshatit. Kjo gjë është e arsyeshme, sepse atje do të venë të punojnë e të jetojnë të rinj. E them këtë, se ju duhet të filloni nga puna me materialet e me fondet monetare për ato objekte që janë të nevojshme dhe që i japin më shumë bukuri e hijeshi qytetit.

Natyrisht, do të ketë vende që duhen prishur, por ka të tilla që s'duhën cenuar. Kështu ju duhet të zgjidhni vendet që janë për t'u mbrojtur hëpërhë dhe të filloni ndërtimet në ato objekte që i japin bukuri qytetit. Ku duhet të fillojë puna? Për mendimin tim mund të fillojë edhe nga gjelbërimi i madh, që të marrë frymë populli, që qyteti të ketë freskinë dhe ajrin e pastër. Ky është thjesht një mendim, por ju, në bazë të fondeve që do t'ju caktohen, duhet t'i mendoni e t'i zgjidhni këto çështje, duke parë nevojat dhe mundësitë që keni. Do t'ju krijohen edhe fonde monetare për ndërtimin më të mirë dhe më komod.

Fshatit do t'i jepen fonde për ndërtim shtëpish nga shteti, sepse atje do të shkojnë të rinjtë për të punuar e për të jetuar. Ndërtimet e banesave për shtesë na-

tyrore të popullsisë së fshatit i bëjnë vetë fshatarët, të cilët ua lënë bijve të tyre, por kur të shkojnë atje të rinjtë e qytetit, ata nuk kanë mundësi të ndërtojnë shtëpi, prandaj duhet t'ua ndërtojë shteti shtëpitë.

Këto mendime që dhamë ne për arkitekturën i merrni me rezervë. Aty ku nuk janë drejt. veproni sipas mendimit tuaj.

Ju edhe vetë e dini, por edhe ne të gjithë ju këshillojmë që ta ekspozoni maketin e qytetit në një sallë të pallatit të kulturës. Në një ditë e orë të caktuar të hyjnë aty rreth njëqind veta, një nga ju t'u japë shpjegime që të orientohen për gjërat që nuk kuptohen dhe t'i pyesë nëse kanë mendime ose vërejtje. Këto t'i shkruajnë në një bllok që të jetë aty për këtë qëllim. Mund të ketë edhe mendime ekstravagante, por s'ka gjë, mendimet që do të shfaqen atje do të kenë vlera, prej tyre ju të nxirrni konkluzionet më të mira.

Ju përgëzoj, shokë, urime të gjithëve: arkitektëve, ndihmësve të tyre dhe punonjësve të ndërtimit. I urori këta nga ana e shokut Pilo, nga ana ime dhe nga ana e shoqes Nexhmije, se ndërtimet në qytetin e Korçës i kanë bërë me shije, të bukura e të mira. Nga kjo punë e tyre duhet të përfitojnë edhe punonjësit e rretheve të tjera.

*Notohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

# NE TË GJITHA PUNËT KËRKOHEN DISIPLINË PROLETARE DHE MOBILIZIM

*Nga biseda me disa kundro drejtues të rrethit  
të Elbasanit*

23 gusht 1975

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, shokë? Si shkoni me punët?

Ne andej nga Pogradeci e Korça e kaluam shumë mirë, vizitat në këto rrethe na dhanë kënaqësi të madhe dhe na çlodhën.

Në Pogradec koha ishte shumë e bukur. Bëmë atje një mbledhje me shokët drejtues të rrethit dhe, nga biseda me ta, doli se përgjithësisht gjendja politike është shumë e mirë. Plani në drithërat e bukës do të tejkalohet, mirë paraqiten ata edhe me prodhimin e qumështit, me fasulen, misrin etj. Me pak fjalë, të gjitha prodhimet bujqësore e blegtorale në rrethin e Pogradecit do t'i realizojnë e do t'i tejkalojnë. Shokët më relatuan edhe për Mokrën, ku situata, gjithashtu, është e mirë, se në atë zonë kanë të ardhura edhe nga miniera.

Edhe në Korçë kaluam mirë. Atje biseduam me

shumë kuadro e punonjës dhe u gëzuam për rezultatet që kishin arritur. Të ketë bukë populli dhe të jetë mirë ai, kjo është çështja më e rëndësishme. Takimi me punëtorët në uzinën e instrumenteve të precizionit «Petro Papi» gjithashtu na vajti shumë mirë. Unë që e njihja edhe më parë atë uzinë, vura re se ishin bërë mjaft përparime.

Ishim edhe në kooperativën bujqësore të Pojanit. Edhe atje kishte një gjendje të shëndoshë. Ata pësuan dëme të mëdha nga breshëri që ra, se do të merrnin nga 40 kuintalë grurë për hektar.

Pojani është kooperativë bujqësore e tipit të lartë, është ekonomi e përparuar socialiste. Atje në më shumë se 40 për qind të sipërfaqes morën për çdo hektar 45 kuintalë grurë, 350 kuintalë panxharsheqeri, 22 kuintalë fasule të drejtpërdrejtë, 3-5 kuintalë fasule të shoqëruar me misër. Edhe rendimenti i fasuleve pllaqi që i mirë.

Gëzim i madh vërthej në popull, jo vetëm se vajta unë, por sepse njerëzit ishin të sigurt që do t'i arrinin rezultatet e parashikuara edhe në panxhar edhe në misër. Dukej që misri ishte shumë i mirë.

Duke biseduar me Nexhmijen, menduam të qëndrojmë edhe këtu te ju.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Shoku Enver don-te të bënte një mbledhje me kuadrot edhe këtu, por unë nuk isha e një mendjeje me të, se kështu programi i vizitave të tij do të rëndohej shumë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë kam qenë në Elbasan dhe mund të vij prapë në vonë. Këtu kanë ardhur edhe shokë të tjerë të udhëheqjes.

*Pastaj shoku Jashar Menzelxhiu, që në atë kohë ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit, foli për gjendjen moralo-politike në rreth, si dhe për punët e ditës, sidomos në bujqësi.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa pambuk për hektar do të merrni këtë vit?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Do të marrim 11 kuintalë për hektar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si ndodh që tani do të merrni këtë prodhim?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Kësaj here e kemi mbjellë pambukun një muaj më përpara nga herët e tjera. Kemi mbjellë edhe panxharsheqeri.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa kuintalë panxhar parashikoni të merrni për hektar?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** 250 kuintalë për hektar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe kooperativistët e Bilishtit kaq merrnin, por ata, siç më tha një brigadier që kishte ardhur në kooperativën e Pojanit, do të luftojnë për më shumë. Në dhjetë hektarë kishin marrë nga 500 kuintalë. Eksperienca e tyre është e mirë.

Sa hektarë tokë keni mbjellë me panxhar?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** 350 hektarë. Si-vjet cilësia e panxharit është më e mirë, jep 3 për qind më shumë sheqer, se kemi farë nga ajo e Korçës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po fasule të drejtpërdrejtë keni ju?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Kemi edhe të drejtpërdrejtë, edhe të mbjellë bashkë me misrin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Lexova një informacion

për Shmilin dhe, duke bërë krahasimin me të kaluarën, kur ishte shumë keq, u habita me rezultatet që janë arritur. Orenja, Gurakuqi e fshatra të tjera, që janë andej, kanë qenë shumë të varfra.

Lidhur me bujqësinë edhe ju qenkeni optimistë.

Këtu në rrethin tuaj ka pasur tradita për rritjen e orizit të kuq. Por tani nuk po e arrini prodhimin e orizit. Mos është një pengesë shpërndarja e tij në parcela të vogla?

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Jo, shoku Enver, e kemi përqendruar, 250 hektarë i kemi në fushë, por na ka dalë grami.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa do ta realizoni planin e misrit sivjet? Ju thatë se në disa zona nuk ka burime ujitjeje. Po ato që janë ujitur, nga janë furnizuar me ujë?

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Nga disa kanale, siç është, për shembull, kanali «Naum Panxhi».

*SHOKU ENVER HOXHA:* Keni bërë kërkime për ujëra për vaditje?

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Kemi bërë, por na del ujë i kripur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si shkojnë punët në Kombinatin Metalurgjik? Më kanë thënë se ka disa probleme për transportin, për ushqimin etj.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Tani jemi mobilizuar të gjithë në këto punë. Unë po bëj punën fizike bashkë me punëtorët në metalurgjik.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Prania e sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit atje është e nevojshme, se bën që të mobilizohen shokët. Rëndësi ka



që në metalurgjik të ketë rregull. Ju forca keni, por keni, gjithashtu, edhe shumë objekte për të përfunduar. Janë 162 objekte që duhet të dorëzohen deri në fund, apo jo?

*SHOKU HAJREDIN ÇELIKU*<sup>1</sup>: Po, por nga këto 72 i kemi përfunduar.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Për hapjen e kanaleve dhe shtrimin e tubacioneve duhet të bashkëpunoni mirë me shokët e shfrytëzimit.

*SHOKU HAJREDIN ÇELIKU*: Në përgjithësi paraqitemi mirë, por kemi edhe disa mosmarrëveshje që na kanë lindur gjatë punës.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Ka pasur një rast që është raportuar se do të realizohen detyrat. Pastaj mua më tha Hakiu [Toska] se plani nuk do të realizohej aq sa ishte parashikuar.

Edhe në shfrytëzim ka dobësi në punë. Shokët më kanë raportuar që atje thuhet: «Punoni njëherë ju të ndërlimit e pastaj të fillojmë ne!».

*SHOKU HAJREDIN ÇELIKU*: Edhe ne e kemi pasur pikë të dobët çështjen e sigurimit të fuqisë punëtore. Tani kemi bërë një studim të hollësishëm për këtë qëllim. 18 për qind të vendeve të punës i kemi caktuar si vende të përshtatshme për vajza e gra. Deri tani 1 200 forca na i dhanë rrethet, të tjerat do t'i gjejmë përsëri po nga rrethet. Kemi bërë studimin se ku do t'i gjejmë. Studimi është kryer në përputhje me objektet që nuk i kemi bërë.

---

1. Në atë kohë drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit në Kombinatin Metalurgjik.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo është një punë shumë e vlefshme. Që të ndërtohet mirë, duhet ditur jo një, por disa zanate, domethënë nuk mjafton të jesh vetëm montator, por edhe ndërtues etj. Njerëzit që vijnë nga rrethet e kanë të vështirë ta realizojnë këtë, se ata kanë ardhur të punojnë për specialitetet e tyre. Sa punëtorë mund t'ju japë rrethi i Korçës?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Plani i Korçës është për 100 veta, por nuk po na i japin. «Kemi për të mënjanuar dëmet e shkaktuara nga breshëri», na thonë kur i kujtojmë për këtë detyrë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pavarësisht nga kjo, ata duhet t'i dërgojnë forcat për Elbasan. Ju keni shpënë forca në fshat edhe kur nuk ka pasur breshër, gjë që nuk ju ka penguar në zbatimin e detyrave të tjera. Vit për vit keni organizuar aksione dhe kjo është një eksperiencë e mirë juaja, që duhet përgjithësuar.

Kombinati Metalurgjik është vepra më kryesore e industrisë. Ndërtimin e furnaltës do ta përfundoni në tetor?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Po, kështu mendojmë, por këtë e kemi akoma si plan të brendshëm.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtë plan që e keni të brendshëm duhet ta ktheni në «të jashtëm»<sup>1</sup>. Mobilizim keni, organizimin e punëve duhet ta forconi akoma më tepër. Rëndësi ka që Partia t'i vërë të tëra forcat për ta ndërtuar veprën në kohën e duhur, prandaj nga

---

1. Punimet e ndërtim-montimit të furnaltës së parë në Kombinatin Metalurgjik përfunduan në prag të 16 Tetorit, ditë-llindjes së udhëheqësit të Partisë e të popullit.

të gjithë punëtorët, në të gjitha punët, kërkohen disiplinë proletare dhe mobilizim, sepse këta faktorë ndikojnë në ndërtimet. Secili të qëndrojë në punën e vet. Duhet vënë një kufi, se vijnë e marrin makineri prej këtej dhe i çojnë gjetkë. Këtë nuk e them kot, por nga eksperiencia, se gjëra të tilla na kanë ngjarë mjaft herë.

Të gjitha këto kërkesa realizohen me një punë të madhe politike të Partisë. Në qoftë se puna politike çalon, detyrat nuk do të plotësohen siç duhet.

Në kombinat ka objekte të mëdha e të shumta, prandaj të vihen forcat për arritjen e objektivave në afatet e caktuara. Domethënë, të ndërtohen tani ato objekte që janë të kësaj faze; në qoftë se keni objekte që janë të fazës së mëvonshme, duhet të lihen për më vonë.

Në gjithë vendin ka me dhjetëra objekte të pambaruara, të tjera janë në themele, nuk janë vazhduar më tej punimet etj. Pse jemi shpërndarë si vaji në lakra në ndërtimet, në një kohë që Komiteti Qendror i Partisë ka porositur të mos shpërndahemi? Sabotoi Abdyl Këllezi, kjo është e vërtetë, por këtu ndikojnë edhe neglizhencat e rretheve që nisin punë të pallogaritura mirë. Këto qëndrime jo të drejta Abdyl Këllezi i shfrytëzoi për qëllimet e tij armiqësore.

Kur i thuhet rrethit të Korçës të japë kaq punëtorë që janë në plan, kjo kërkesë nuk duhet të refuzohet, se bëhet sipas direktivave të Partisë. Nuk përjashtohet të ketë ndonjë repart që diçka nuk i ka ardhur akoma, por kjo nuk pengon që të fillohet një punë tjetër, dhe ajo që mungon, të mbetet për më pas. Është ndryshe në qoftë se pa të nuk bën dot më tutje.

**SHOKU HAJREDIN ÇELIKU:** Uzina mekanike akoi

ma nuk është mbaruar, por aty kemi përfunduar furrnaltën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si bëhet furnizimi i materialeve që i prodhojmë brenda vendit, furnizoheni rregullisht me çimento, me qymyr etj.?

*SHOKU HAJREDIN ÇELIKU:* Për sa i përket ndërtim-montimit nga brenda nuk ka pengesë, nga jashtë ka disa mungesa. Ka gjëra që akoma nuk na kanë ardhur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe ju të luftoni në këtë drejtim, se disa sende i keni këtu e nuk ju dërgohen në kohë, jo më pastaj ato që vijnë nga larg.

Si kurdoherë ne duhet të kemi një politikë të drejtë në marrëdhëniet me të huajt. Kinezët nuk na i plotësuan të gjitha kërkesat që iu bënë. Janë një sërë objektesh të reja që kemi për të ndërtuar, si dhe objektet e filluara që nuk kanë përfunduar akoma. Plani i gjashtë pesëvjeçar do të jetë i gërshetuar me çështjet e ndërtimit dhe me ato të industrisë.

Për sa i përket industrisë së petrokimisë, ne vetë e lamë atë për pesëvjeçarin tjetër, sepse zhvillimi i saj ka të bëjë me naftën. Industria, natyrisht, ka rëndësi të madhe, por vendin e parë në këtë degë të ekonomisë e zë nafta. Humbjet që patëm nga sabotimi që bënë tradhtarët në këtë drejtim duhen zëvendësuar me prodhim më të madh naftë. Ne kemi zbuluar se pikësynimi i armiqve ka qenë likuidimi i Partisë me anë të demoralizimit të ushtrisë, izolimit të udhëheqjes dhe shkatërrimit të ekonomisë.

Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi ishin për vijën revizioniste jugosllave në ekonomi. Këta të dy ishin për decentralizimin e ekonomisë. Ne flitnim që baza të ki-

shte kompetenca, kurse ata punonin nën rrogos për të arritur «liri të plotë ekonomike», që ndërmarrjet ekonomike të bënin si të donin vetë, pa qenë të lidhura aspak me zhvillimin e planifikuar e të centralizuar të ekonomisë, duke vepruar si në Jugosllavi, duke hyrë drejtpërdrejt në tratativa me firmat tregtare të huaja. Përveç punës armiqësore në ekonomi e në tregti, grupi armiqësor punoi me zell për përhapjen e burokratizmit me anë të rëndimit të aparateve administrative me shumë njerëz, duke rritur kështu koston e aparateve. Grumbullimin e shumë kuadrove në institute dhe heqjen e tyre nga industria e bujqësia, për të krijuar aristokracinë e klasës dhe mentalitetin borgjez, armiqët e bënin me sistem.

Edhe në planifikim Abdyl Këllezi ka sabotuar. Duke u hequr si «koka e madhe e ekonomisë», ai synonte të pengonte zbatimin e planit dhe vepronte jo ashtu siç thoshte Partia, që të hartoheshin plane reale, por inkurajonte shpenzimet për gjëra të paparashikuara e të planifikuara.

Veprimtaria e armiqve në ekonomi del se është e lidhur me atë të tradhtarëve në ushtri. Nafta është sabotuar sepse ata që e drejtonin kanë qenë agjentë të shërbimit të huaj. Vetë komplotistët e arrestuar kanë deklaruar në hetuesi se ata janë agjentë të sovjetikëve, të cilët i kanë urdhëruar të mos japin fusha të reja nafte në Shqipëri. Me veprimtarinë e tyre armiqësore, ata na kanë dëmtuar vlera materiale të mëdha në industrinë e naftës dhe na kanë humbur shumë kohë. Prandaj duhet të punojmë në këtë drejtim që të zëvendësojmë humbjet.

Edhe për vazhdimin e luftës kundër burokratizmit duhet bërë një punë e madhe, duhen parë stili dhe metoda në punë. Mund të mbeten pak njerëz në punë, por, megjithëkëtë, po të mos jenë në gjendje «ta nxjerrin gomarin nga balta», po nuk ndryshuan stilin dhe metodën e punës, nuk mund të arrihen synimet që i kemi vënë vetes. Kjo duhet arritur me një punë të madhe bindëse nga Partia. Natyrisht, kur në punë janë vetëm ata njerëz që me të vërtetë nevojiten, atëherë secili prej tyre do të vrasë kokën, do të kërkojë rrugë dhe mënyra të reja pune. Ky proces do t'i revolucionarizojë njerëzit. Nevoja të shtyn të ecësh përpara.

Bujqësia ka rëndësi të madhe, për arsye se nuk do ta sjellim bukën nga jashtë, por do ta sigurojmë në vend. Ne nuk jemi autarkikë, por edhe sytë s'duhet t'i mbajmë nga importi. Kina nuk na dha asnjë kokërr grurë, as sheqer, as vaj dhe as një sërë lëndësh të para. Prandaj neve na duhet të bëjmë një luftë të madhe e këmbëngulëse për tejkalimin e planit dhe të kursejmë shumë. Në qoftë se keni gjëra të tepërta që mund të ruhen pa e prishur nivelin e jetesës së njerëzve, i ruani!

Çështja është të luftojmë që të mos kemi mungesa për bukën, për artikujt e tjerë ushqimorë, secili të marrë pjesën që i takon dhe të përpiqemi që mungesat e përkohshme të mos ndihen shumë. Në këto situata, pra, ka rëndësi të sigurojmë devizën, të realizojmë planin dhe të kursejmë. Edhe plotësimi i planit në bujqësi është çështje politike e ideologjike, se ka të bëjë drejtpërdrejt me jetën e popullit. Bujqësia është një furnizuese e eksportit që shërben për sigurimin e devizës apo të kleringut. Mund të ndodhë që një vit bujqësor të

mos jetë i mbarë, por, që kjo gjë të mos na bllokojë ekonominë, lypset të krijojmë rezerva.

Neve do të na duhen edhe materiale të tjera ndërtimi. Prandaj, për sigurimin e materialeve që the ti, shoku Hajredin, duhet të zhvillojmë minierat, të zbulojmë naftë, të rritim prodhimet bujqësore e blegtorale në një nivel të tillë sa të eksportojmë me leverdi. Mundësi për këto arritje kemi.

U thashë edhe shokëve në Korçë se, me gjithë dëmet e mëdha që na shkaktuan armiqtë sabotatorë, zbulimi dhe demaskimi i veprimtarisë së tyre na kanë shërbyer për forcimin e Partisë e të ekonomisë, për një kuptim më të drejtë e më të thellë të disa gjërave. Pavarësisht nga disa gabime që vërtetohen, rëndësia e madhe e ruajtjes dhe e zhvillimit të pronës socialiste kuptohet drejt, sepse njerëzit tanë janë ngritur nga ana politike, ideologjike, kulturore dhe teknike. Këtë zhvillim e kanë arritur jo vetëm inxhinierët e agronomët, por të gjithë. Edhe teknikët e mesëm i njohin dhe dinë t'i përdorin më mirë mekanizimet, plehrat etj.

Industria jonë mekanike duhet të ndërtohet mirë e me kujdes. Ne kemi dhënë direktivën që të ngremë me forcat tona një fabrikë të sodës, po kështu mund të bëjmë vetë një uzinë si atë të Laçit. Në këto kushte mund të themi se na hapen perspektiva për ngritjen e industrisë duke u bazuar në forcat tona, por, sidoqoftë, metalurgjia do të jetë mëma e industrisë mekanike.

Nga këto që thamë del detyra që planin pesëvjeçar ta bëjmë real, të ngjeshur, të realizueshëm e të tejkalueshëm, se për këtë gjë i kemi të gjitha mundësitë, prandaj të përpiqemi që çdo njeri të mendojë për mi-

rëqenien e atdheut dhe për mbrojtjen e tij. Mbrojtja e vendit është e lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik. Po të zhvillohet ekonomia, mbrojtja forcohet. Është detyrë e Partisë që të drejtojë në mënyrë të organizuar, që të mos u mbetet asgjë mangët ndërtimit, montimit të objekteve, ndërtimit të furnaltave, edukimit të punonjësve, frekuentimit të shkollave etj. Ne jemi në luftë, kështu e shikojmë ne marksistë-leninistët gjendjen, prandaj duhet të punojmë shumë. Koha e pushimit që mbelet pas punës është e njëaftueshme për shëndetin, sepse atdheu kërkon sakrifica nga ne. Kjo duhet të bëhet e qartë për të gjithë.

Ata që vijnë për të punuar e për të jetuar në Elbasan duhet ta ndiejnë veten shumë të lumtur dhe të mos mendojnë se bëjnë sakrifica. Elbasani do të bëhet qytet akoma më i bukur e i rëndësishëm me bujqësi e me industri të përparuar.

Politika e Partisë në të ardhmen do të jetë që njerëzit të shkojnë për të punuar e për të jetuar në fshat, prandaj qëndrimi në Elbasan është një privilegj për cilindo. Neve na del përpara një problem me rëndësi për shfrytëzimin e forcave të lira të qytetit. Aktualisht mund të bëjmë si të bëjmë, por duke parë çdo vit të dhënat e demografisë, del se në perspektivë do të kemi me mijëra të rinj e të reja, për shembull, nga Tirana, Elbasani e nga qytete të tjera të vendit, që do të kërkojnë punë, dhe vendi i punës për këta do të jetë fshati. Prandaj duhet t'i përgatitim politikisht, ideologjikisht dhe shpirtërisht të rinjtë dhe prindërit e tyre që të mos ngurrojnë të shkojnë në fshat. Në qytet do të banojnë aq njerëz sa ka mundësi e jo më tepër.



Nga ana tjetër, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë duhet të përgatiten t'i presin të rinjtë që do të venë të punojnë e të jetojnë në fshat, prandaj duhet të merren një sërë masash organizative për këtë qëllim e jo vetëm t'u thuhet të rinjve: «Shkoni në fshat!». Në radhë të parë duhet të ndërtojmë atje shtëpi ku të banojnë të rinjtë e të rejat. Kjo kërkon që të bëhen më shumë investime për ndërtimet në fshat.

Desha të theksoj se duhet të përhapet eksperiencia juaj dhe e rrethit të Dibrës për organizimin e aksioneve me goditje të përqendruar. Kjo eksperiencë na ka dhënë rezultate të mira. Edhe eksperiencia juaj dhe e rrethit të Korçës për organizimin e aksioneve masive është e madhe. Korça e fitoi këtë eksperiencë tashti që u dëmtua nga breshëri, kurse ju e keni pasur edhe më parë. Prandaj ka rëndësi që këto eksperiencia të zbatohen mirë. Për shembull, punëtorët, pensionistët e të tjerë nga qyteti mund të shkojnë një muaj në mënyrë të organizuar për të ndihmuar në punët e stinës në bujqësi. Natyrisht, këta nuk do të shkojnë të gjithë në një kohë, por në faza të ndryshme, kur e kërkon nevoja e bujqësisë për korrjet, prashitjet, vjeljet etj. Mund të shkojnë në fshat për tri ose pesë ditë në fazën e mbjelljes së misrit në kubikë nxënësit e shkollave dhe nëpunësit. Le të mbyllen shkollat e zyrat për disa ditë, se nuk prishet shumë punë. Ata që kanë punuar pesë ditë në bujqësi, le të punojnë edhe më pas pesë ditë të tjera, ose të shkojnë në fshat punonjës që mund të mos kenë vajtur radhën e parë.

Kur qytetarët të venë për të punuar bashkë me kooperativistët, kooperativa do t'u japë për të ngrënë

e për të pirë, por atyre që nuk do të realizojnë normën e caktuar do t'u vihet gërshërë në pagë. Ky mendoj se do të ishte një organizim që do t'i shërbente ekonomisë dhe do të rriste ndërgjegjen e të rinjve e të prindërve të tyre. Këtë çështje shikojeni, studiojeni dhe jepni mendimin tuaj, sepse një gjë e tillë do të praktikohet.

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Ju faleminde-rit shumë, shoku Enver, për të gjitha këto që na thatë. Porositë tuaja ne do t'i kemi parasysh kurdoherë në punën tonë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## DY PROBLEME TË RËNDËSISIME PËR PARTINË

Shënime

11 shtator 1975

Bisedova me shokët sekretarë të Komitetit Qendror për dy probleme me rëndësi: për kontrollin punëtor dhe për ndihmën e organizuar për fshatin nga qyteti. Këto probleme i kam trajtuar edhe herë të tjera, por shokët nuk kanë konkluduar definitivisht, prandaj kërkova të di çfarë po bëhet.

Shoku Hekuran Isai, që është ngarkuar të ndjekë këto probleme, më tha sot se janë bërë konsultime paraprake me shokë të Partisë e të Qeverisë dhe nesër do të bëjnë një mbledhje konkluzive, ku do të marrin pjesë edhe disa sekretarë partie rrethesh.

E pyeta Hekuranin nëse janë në dijeni pjesëmarrësit e kësaj mbledhjeje për problemet që do të diskutohen. Ai m'u përgjigj se u është dërguar materiali.

U ritheksua shokëve edhe disa çështje që duhet t'i kenë parasysh.

Në radhë të parë u foli për stilin dhe metodën e punës që duhet përdorur për shtruarjen dhe zbatimin veçanërisht të këtyre dy problemeve. Propaganda se

«këto probleme duhet të zgjidhen drejt» etj. të lihet mënjandë në mbledhjen e kuadrove që do të bëhet në të. Të fillojnë e të vazhdojnë të flasin për të mirat politike etj., një gjë e tillë është humbje kohe, mund të fshihet mungesën e përgatitjes së tyre. Mbledhja e në të duhet të diskutojë konkretisht problemet.

Të marrim problemin e kontrollit punëtor e fshatar. Ky është i njohur, bazohet në tezat e Leninit. Ne duhet ta zhvillojmë më tej dhe ta organizojmë më mirë nga sa e kemi organizuar deri tash. Kam udhëzuar më parë se duhet të zgjerohet kontrolli punëtor e fshatar, duke e koordinuar punën me kontrollin shtetëror.

Kontrolli është i shumanshëm. Ekziston Inspektimi i Shtetit, inspektimi financiar (nga Ministria e Financave, nga çdo ministri, nga Banka e Shtetit, nga ajo bujqësore, nga komiteti ekzekutiv dhe nga ndërmarrjet). Por të gjithë këta kontrollojnë dhe anët e tjera të problemeve, përveç asaj financiare. Kam theksuar se këtu ka me siguri përplasje.

Me të vërtetë ka ligje, urdhëresa e rregullore, por ka edhe vjedhje, ka edhe prishje, edhe abuzime kompetencash. Atëherë pse ngjasin gjëra të tilla? Njerëzit e Partisë dhe të pushtetit duhet të vijnë në mbledhje për këto probleme jo me duar në xhepa, por me të dhëna për anët e mira dhe për dobësitë e këtyre kontrolleve që shkaktohen nga kuptimi jo i drejtë i ligjeve, nga të metat në zbatimin e tyre, në jetë. Ata të thonë nëse u duhet bërë ndonjë ndryshim ose jo disa ligjeve, ku janë pikat e dobëta të tyre, nga të cilat mund dhe përfitojnë njerëzit e këqij; të tregojnë si veprojnë këto kontrole në lidhje me njëri-tjetrin, si

janë koordinuar, si qëndrojnë politikisht njerëzit përpara kontrollit shtetëror etj. Të gjitha këto kuadrot që vijnë në mbledhje, mjaft herë i përmbledhin në pak fjalë: «Kemi ligje, këto zbatohen me të mira dhe me gabime». Të flitet kështu, në përgjithësi, s'ka asnjë vlerë dhe në këtë mënyrë nuk ndihmon për zgjidhjen e problemit dhe për përmirësimin e gjendjes.

Njohja e këtij problemi të madh konsiston në ndjekjen, në korrigjimet e vazhdueshme dhe jo vetëm në marrjen e masave të çdollojshme ndaj fajtorëve, por edhe në nxjerrjen e konkluzioneve të rëndësishme, që shërbejnë për përmirësimin e punës, për luftën kundër rutinës dhe burokratizmit, ku fshihen dëmtuesit, pse ata kanë gjetur «qetësi dhe shtrat të ngrohtë», domethënë kanë gjetur ose kanë sajuar pika të dobëta dhe vepronë. Armiku bën hile, shtrembëron me mjeshteri, pse do që të mos zbulohet. Kontrolli duhet ta zbulojë e ta demaskojë atë dhe një gjë të tillë ta bëjmë mësim.

K kontrolli, pra, duhet të jetë revolucionar, prandaj këtij kontrolli shtetëror, funksionar, ne po i ngjitim edhe kontrollin punëtor e fshatar, jofunksionar. Në shënimet që kam bërë, duke u bazuar te mësimet e Leninit, kam shkruar se si duhet organizuar ky kontroll punëtor. Ai, pra, duhet organizuar mirë dhe të fillojë nga puna. Të mbahen parasysh ana organizative e kontrollit, në mënyrë që të funksionojë në shkallë të gjerrë dhe në drejtime të ndryshme; zgjedhja e njerëzve në të; edukimi i tyre teknik, politik; varësia; kompetencat që duhet t'u japin; bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë së tyre me kontrollet shtetërore.

E gjithë kjo veprimtari, po të organizohet mirë, do të sjellë një përparim të madh, një zhvillim të ekonomisë, një forcë të madhe të drejtimit, një ngritje politike të masave të gjera, të cilave u zgjerohet pjesëmarrja në pushtet jo vetëm teorikisht, por drejtpërdrejt.

Prandaj u thashë shokëve sekretarë, dhe veçanërisht shokut Hekuran, që këtë problem ta përfundojnë me sukses, të mos zvarritet dhe të qortohen ata që vijën të papërgatitur në mbledhjet për këtë problem.

Për ndihmën e qytetit për fshatin prapë u ritheksova shokëve sekretarë se kjo është një çështje e rëndësishme politike, organizative dhe ekonomike. Me zgjidhjen e saj ne synojmë shumë objektiva: ndihmojmë bujqësinë, shtojmë dashurinë e qytetarëve për fshatin dhe për bujqësinë, forcojmë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, realizojmë më mirë parullën: «Bujqësia — çështje e gjithë popullit», ngulitim ndjenjën e pronës kolektive dhe bindjen që ngritja para masës e problemeve të ndryshme për zgjidhje është një forcë kolosale e ideve komuniste. Pra, duke marrë parasysh këto të mira, duhet që çdo gjë të organizohet.

Komisionet në qytete e në fshatra dhe kushdo që do t'i ngarkohet kjo barrë, duhet të planifikojnë shkencërisht, duke pasur parasysh se plani në fabrika e në ndërmarrje duhet të realizohet; se plani i mësimeve në shkollë nuk duhet të cungohet; se në zyra do të mbeten aq njerëz, sa puna të mos pengohet; se pensionistët, invalidët, gratë shtatzëna ose me kalamanë të vegjël e të shumtë, nuk duhet të sforcohen, prandaj të shihet sa do të punojnë e ku.

Duke pasur parasysh këto, duhen nxjerrë kontin-

gjentet e llogaritura mirë si numër i përgjithshëm dhe në detaje, të caktohet sa do të punojnë në fshat nga kategoritë e ndryshme, si do të hanë dhe do të flenë atje.

Vajtja duhet të organizohet me turne, në kohën kur është piku i punës. Forcat e kooperativës duhet të organizohen «citë më citë» dhe të ndalohet rreptësisht që kooperativistët të bredhin në pazare ose të pushojnë apo të shesin fiq, kur qytetarët shkojnë e punojnë në fshat.

Punën e qytetarëve, që venë punojnë kështu të organizuar në fshat, gjatë mungesës së tyre e plotëson kolektivi. Kështu i këshillova shokët për këtë problem.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# SPECIALISTËT DHE PUNËTORËT TË JENË SHUMË TË PREOKUPUAR PËR NEVOJAT E VENDIT PËR NAFTË

Shënime

12 shtator 1975

Pata një bisedë me shokun Pali Miska, ministër i Industrisë dhe i Minerave, për planet e ardhshme të nxjerrjes dhe të kërkimeve të naftës e të gazit. Pasi më vuri në korent për këto plane, i bëra disa vërejtje dhe sugjerime, me të cilat ai ishte plotësisht dakord dhe do të veprojë, duke marrë masa të mëtejshme.

1. Plani i nxjerrjes së naftës për vitin 1976 është shumë i ulët dhe duhet rishikuar, sidomos fusha e Gorisht—Koculit. Inxhinierët dhe punëtorët e kësaj fushe ta shikojnë problemin sipas mundësive dhe trajtimit të drejtë teknik të shfrytëzimit, si edhe të nevojave të vendit për naftë. Ulja e prodhimit, që ata parashikojnë, është e madhe. Kam mendimin se druben e duan të jenë brenda, shkojnë nga një shfrytëzim joracional në një shfrytëzim shumë të shtrënguar. Këto pikëpamje duhet t'ua luftojmë dhe t'i inkurajojmë që t'u liqet druajtja, të shikojnë më me guxim dhe teknikisht mu-



ndësitë, duke pasur parasysh edhe nevojat e mëdha. Puset, natyrisht, nuk lejohet të inondohen, por aq sa lejohet, sipas studimeve shkencore, duhet të veprohet dhe të merret naftë qoftë dhe me ujë shtresor, por që të ndahet nga uji në impiantet e dekantimit të naftës.

2. Problemi i shpim-kërkimeve duhet të marrë rrugë të drejtë. Të shpojme dhe të verifikojmë shtresat ranore, nga të cilat është nxjerrë nafta deri tash dhe që nga armiqtë sabotatorë u la pas dore. Këto shtresa sabotatorët i injoruan fare. Jo vetëm kaq, por jashtë çdo rregulli shkencor, nuk mbajtën asnjë të dhënë teknike të puseve në këto shtresa. Orientimi i sabotuesve ishte: «Të arrijmë gëlqerorët» dhe kjo «për t'i arritur» dhe jo për të zbuluar naftë në gëlqerorë. Ku mundnin armiqtë taposnin edhe gëlqerorët, ku s'mundnin, nafta dilte.

Duke ndjekur këtë rrugë sabotuese, ata thoshin: «Naftën në shtresat jogëlqerore e atakojmë më vonë; tani për tani të shkojmë në gëlqerorë» dhe ranorët i taposnin me argjil e me barit. Duke mos ruajtur asnjë të dhënë dhe asnjë kampion nga ranorët, ne tash nuk dimë ku të atakojmë. Por, me duar lidhur nuk duhet të rrimë. Të mbledhim informata nga kujtesat aproksimative të të gjithë punëtorëve dhe të specialistëve që kanë punuar në puse dhe të nxjerrim të dhëna që të zëvendësojnë ato që s'janë mbajtur, si edhe të dhënat e kampioneve inekzistuese. Të gjitha këto qëmtime rigorozë dhe studimet që janë bërë kur u caktua pika e shpimit, të shërbejnë për një orientim dhe verifikim për rishpime të reja në këto shtresa. Pra, këto shtresa nuk

duhet të lihen pas dore, por të ristudiohen dhe, atje ku kemi të dhëna, të rishpojmë.

Shpimet në gëlqerorë, natyrisht, duhet të vazhdohen, pse atje është perspektiva, por këto të mos bëhen në kurriz të ranorëve. Jo të shpohet «për të arritur shtresat e gëlqerorëve», siç vepronin sabotatorët, por të arrihet nxjerrja e naftës nga gëlqerorët. Kalimi në këto shtresa duhet të bëhet jo vetëm me një teknikë më të përsosur, por edhe me studime më të thella shkencore, pse kalohet nga një stad pune dhe diturie në një stad të ri pune më të ndërlikuar dhe me të panjohura më të shumta. Prandaj inxhinierët, specialistët dhe punëtorët duhet ta kenë parasysh këtë hop dhe të jenë shumë të preokupuar për nevojat e atdheut për naftë.

Duhet, pra, të luftojmë frymën armiqësore. Punojnësit e naftës të zhdukin druajtjen, të jenë revolucionarë, të kujdesshëm dhe të disiplinuar në punë.

3. Shpimet në thellësi mbi 4 mijë metra duhet të bëhen, por jo në kurriz të ranorëve dhe të gëlqerorëve në cektësi. Për ne këto shpime janë përsëri me perspektivë. Por gëlqerorët dhe ranorët janë rezervat industriale të njohura dhe që duhet t'i shtojmë në radhë të parë duke zbuluar të reja, si dhe duke punuar shkencërisht për zgjerimin e kontureve. Të na bëhet mësim puna armiqësore që «la ranorët për gëlqerorët», por dhe tash të mos entuziazmohemi për thellësitë e mëdha dhe të lëmë mënjanë ranorët dhe gëlqerorët në thellësi të vogla. Të gjitha këto lloj shpimesh duhet të jenë të balancuara dhe të proporcionuara.

4. Vërejtja tjetër që bëra ishte planifikimi joreal i zbulimit të fushave të reja për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Arsyetimet e druajtura me mungesë kuraje revolucionare duhet të zhduken.

Sabotatorët na sabotuan duke na dhënë pika shpimi të vdekura. Grupet e gjeologëve duhet të nxjerrin të dhëna të studiuara mirë të këtyre fushave, të na japin pika të sakta dhe me siguri do të na dalë naftë. Unë jam optimist se në vitet e para të pesëvjeçarit do të kemi fusha të reja, po të punohet dhe të luftohet me frymë revolucionare.

I thashë Palit që armiku Abdyl Këllezi na raportonte se «në këtë pesëvjeçar ne do të arrijmë në 4-5 milionë tonë naftë, se në bazë të kësaj ne duhet të ngremë petrokiminë etj.». Natyrisht, ai na mashtronte, duke menduar të krijonte një eufori për të mbuluar sabotimin që po i bëhej nxjerrjes së naftës. Këto «perspektiva» Abdyl Këllezi i krijonte vetë, apo në akord me sabotatorët në naftë? Plane të tilla sabotuese bëheshin në mes tyre në mënyrë gojore, apo ekzistojnë raporte ose të dhëna me shkrim? Prandaj për këtë problem duhet kontrolluar dokumentacioni në Komisionin e Planit të Shtetit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës. Po ashtu të pyeten edhe shokët e Komisionit të Planit e të sektorit të naftës që mund të kenë dëgjuar vetë për këto «plane perspektive».

Kjo duhet të bëhet jo vetëm për të vërtetuar blëfin dhe armiqësinë e sabotatorëve, që janë të qarta, por edhe se mos në ato raporte gjejmë të dhëna aproksimative të fushave të naftës, që komplotistët i ruanin për t'i shfrytëzuar kur t'ia kishin arritur qëllimit armiqësor që mendonin.

5. Problemi i fundit është gazi metan i Bishtit

të Pallës. Për të është bërë sabotim i hapët. Sabotatorët jo vetëm që nuk shpuan në kraterin e madh në det, por edhe dy puse që shpuan në tokë, dhanë gaz fontanë dhe i mbytën me sasi të mëdha argjili e bariti, duke gënjyer e duke na thënë: «S'ka gaz». Gaz atje ka dhe ne, më parë se të venim gjetkë, më shpejt duhej të kishim zbuluar dhe shfrytëzuar gazin e Bishtit të Pallës dhe pastaj me radhë në vende të tjera, ku kemi dalje natyrale të gazit.

Fakt është se na kanë sabotuar hapur edhe gazin në malësinë e Tiranës. Gazi del nga vrimat e tokës, kurse sabotatorët shkuan e shpuan një pus dy-tre kilometra larg. Ata raportuan se nuk doli gaz, kurse gazi u thoshte: «Ja ku jam!». Ky rajon duhet studiuar mirë nga specialistët tanë, për t'i vlerësuar drejt daljet e gazit në sipërfaqe.

Burimi i gazit të Durrësit duhet të zbulohet dhe të vihet në shfrytëzim. Të shpohet për gaz edhe në rajone të tjera, ku ka të dhëna të tilla. Gazi duhet të konsiderohet naftë, një pasuri e madhe.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**EKSPERIENCA E KOOPERATIVËS SË KËMISHTAJT  
TË BËHET FLAMUR, PËR TË DHËNË NJË HOV  
TË RI ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË  
SONË SOCIALISTE**

*Letër drejtuar kooperativisteve të Këmishtajt  
dhe kooperativisteve të dalluara të rrethit të Lushnjës*

**22 shtator 1975**

Të dashura shoqe të kooperativës së tipit të lartë të Këmishtajt,

Të dashura shoqe kooperativiste të dalluara të rrethit të Lushnjës,

Lexova me interesim e me kënaqësi të veçantë letrën që më dërguan 250 kooperativistet e dalluara të rrethit të Lushnjës, si dhe raportin shumë të qartë, instruktiv e frymëzues të kryetares së kooperativës së Këmishtajt, Heroinës së Punës Socialiste, shoqes Themie Thomai. U gëzova pa masë për përfundimet shumë të mira që ka arritur rrethi i Lushnjës në korrjet e sivejme të grurit, dhe veçanërisht për rezultatet e shkëlqyera që kanë arritur anëtarët e kooperativës së tipit të lartë të Këmishtajt. Në emër të Komitetit

Qendror të Partisë i përgëzoj dhe u shtrëngoj duart atyre për faktin që morën rendimentin më të lartë në grurë nga të gjitha ekonomitë bujqësore të rrethit dhe që prej disa vjetësh me radhë i plotësojnë e i tejkalojnë detyrat e planit edhe në prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale.

Ju, të dashura shoqe, u mblodhët në Këmishtaj jo për të bërë paradë suksesesh, por për të diskutuar me frymë të lartë luftarake, siç na mëson Partia, dhe për të treguar e për të argumentuar në mënyrë shkencore bazat e sukseseve tuaja, duke goditur konceptet e praktikat e prapambetura, që të gozhdojnë në vend ose të tërheqin prapa, dhe duke i lidhur detyrat tuaja me kërkesat e ndërtimit të socializmit e të mbrojtjes së atdheut. Kjo është një praktikë me të vërtetë revolucionare, që nxit dhe inkurajon ecjen përpara, drejt sukseseve gjithnjë e më të mëdha.

Rezultatet e kooperativës së Këmishtajt në të gjitha prodhimet bujqësore e blegtorale të entuziazmojnë: brenda 4 vjetëve të fundit u rrit afro dyfish rendimenti i grurit dhe i misrit, duke arritur përkatësisht 43,6 dhe mbi 50 quintalë për hektar, afro dyfish ai i pambukut, mbi trefish i fasules dhe 1,7 herë i qumështit të lopëve. Është fare e qartë se këtyre përfundimeve u hapi rrugë më të gjerë edhe forma e re e organizimit në kooperativë të tipit të lartë, e cila harmonizoi më mirë interesat e të gjithë shoqërisë me ato të kooperativistëve, përsosi më tej organizimin shkencor të prodhimit, duke vendosur mbi baza të shëndosha drejtimin ekonomik kryesor të kooperativës, bashkërendimin racional të degëve të ndryshme të prodhimit, sidomos të bujqësisë e të

blegtorisë, dhe duke përcaktuar radhën e mbjelljeve dhe të ndërrimit të kulturave bujqësore në mënyrë të organizuar. Të gjitha këto vërtetojnë në jetë drejtësinë e vijës së Partisë, të politikës së saj largpamëse ekonomike për zhvillimin e fshatit tonë socialist, me pikësynimin e madh për të ngushtuar e për të zhdukur dallimet esenciale midis qytetit e fshatit.

Shembulli i kooperativës së Këmishtajt, sukseset e saj të mëdha të gëzojnë e të frymëzojnë shumë edhe për faktin se atje në drejtim të punëve ka shumë gra, siç janë kryetarja e talentuar Themie Thomai, brigadieret e palodhura Athina Andoni, Prenda Liço, Ana Qorri, komunistet, këshilltarët dhe kooperativistët e dalluara Themie Pjetri, Donika Prifti, Sila Allkanjari, Konxhe Dhima, Marie Lena e të tjera. Partia jonë e dashur ka edukuar e ka përgatitur gra të tilla revolucionare, punëtore të palodhura edhe në të gjitha kooperativat e tjera, siç janë Vangjeli Shani, Pavlina Prendi, Nazmie Ibrahimllari, Anthulla Akulli e shumë të tjera si këto, që me vullnet të madh e me këmbëngulje mësojnë dhe luftojnë për të përvetësuar e për të vënë në jetë eksperiencën e përparuar e të rejtat e shkencës, për revolucionarizimin dhe për të çuar përpara prodhimin bujqësor. Kjo dëshmon edhe një herë se porosia e Partisë për ta ngritur sa më lart rolin e grave në ndërtimin socialist, për t'u besuar atyre pa druajtje dhe në çdo fushë vende me përgjegjësi, ka qenë plotësisht e drejtë.

Siç thonë edhe ju, të dashura shoqe, faktorë me rëndësi shumë të madhe në marrjen e rendimenteve të larta janë bërë pasioni dhe kujdesi për të mësuar me këmbëngulje, për të zotëruar shkencën dhe për ta zba-

tuar atë në mënyrë krijuese, në bazë të kushteve konkrete, në përputhje me kërkesat e tokës, të bimëve dhe të kafshëve. Dhe këto rrjedhin nga kuptimi juaj i drejtë se nuk mund të ketë bujqësi moderne të prodhimit të zgjeruar socialist pa dituri dhe pa shkencë, pa i bërë këto pronë të masave të gjera punonjëse. Duke e kombinuar drejt eksperimentimin shkencor me përvojën e përparuar në të gjitha bimët bujqësore, ju u keni kushtuar një vëmendje të veçantë sistemimit dhe nivelimit të tokës, kullimit dhe ujitjes, plehërimit racional mbi bazën e të dhënave agrokimike, zgjedhjes e përdorimit të farërave më të mira dhe kryerjes së rregullt të shërbimeve, gjer në mbledhjen e shpejtë e pa humbje të prodhimit.

Kooperativa e Këmishtajt zbatoi një agroteknikë të lartë në kultivimin e grurit. Të tërë e mbolli pas bimëve prashitëse e bishtajore, zgjidhi drejt strukturën e llojeve të farërave në përshtatje me kushtet konkrete të tokës e ato atmosferike, siguroi një kullim shumë të mirë të tokave, duke kombinuar drenazhimin me vijat kulluese, përdori gjerësisht lesimin. Gruri u plehërua sipas normave dhe i kombinuar me plehërim të lëngshëm, duke u mbështetur në hartat agrokimike. Dhe, më në fund, ujitja gati në tërë sipërfaqen tregoi se kooperativistët, në kushtet e thatësisë së këtij viti, nuk qëndruan duarlidhur, por i mposhtën vështirësitë e natyrës.

Si revolucionarë të vërtetë kanë punuar e kanë drejtuar në këtë kooperativë komunistët, me sekretarin e palodhur të byrosë së Partisë, shokun Llazi Liko në krye, si dhe brigadierët e dalluar, mjeshtrit e vër-



tetë të prodhimit bujqësor e blegtoral Hilli Mile, Llazit Cauli, Koli Llupo, Lili Maka, Kadri Pirra, Nasi Saveta, Josif Maka e të tjerë.

A nuk përbëjnë të gjitha këto një shembull shumë të mirë që tregon se çfarë rezultatesh të mrekullueshme arrihen kur bujqësia organizohet e drejtohet mbi baza shkencore, kur njerëzit, të udhëhequr e të edukuar nga Partia, shkrijnë në punë të gjitha energjitë, mendjen dhe zemrën e tyre, kur parashikohen dhe planifikohen të gjithë treguesit e faktorët që përbëjnë kompleksin e prodhimit bujqësor, duke përfshirë edhe kushtet atmosferike? Ja pse eksperiencia e kooperativës së Këmishtajt duhet të shërbejë si shkollë e madhe dhe të bëhet flamur për të gjitha ekonomitë bujqësore të vendit, burim i madh frymëzimi, për t'i dhënë një hov të ri zhvillimit të bujqësisë sonë socialiste.

Çfarë begatie do të krijohet dhe sa do të fuqizohet atdheu ynë kur të arrihen treguesit e Këmishtajt dhe të ekonomive të tjera të përparuara në zona të ndryshme të vendit! Kjo nuk është thjesht një dëshirë, por një mundësi reale, e bazuar shkencërisht, e vërtetuar në praktikë. Këto mundësi i kanë të gjitha kooperativat e tjera të rrethit tuaj, si dhe ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori», me një bazë më të fuqishme materialo-tekniqe dhe me kushte të tjera të favorshme, por që kanë marrë 7 deri 12 quintalë grurë për hektar më pak se ajo e Këmishtajt. Këto mundësi i kanë edhe kooperativat e ndërmarrjet bujqësore të rretheve të tjera, të cilat kanë pranë tyre ekonomi të tilla të dalluara, si kooperativa «Agimi» në rrethin e Fierit, e Pojanit në rre-

thin e Korçës, e Çërravës në rrethin e Pogradecit, e Dropullit të Poshtëm në rrethin e Gjirokastrës, e Llugajt në rrethin e Tropojës, që në grurë e në prodhime të tjera kanë marrë rendimente të larta.

Për këtë duhet të mendojmë thellë të gjithë e të luftojmë që, duke shfrytëzuar në maksimum rezervat e mëdha që ekzistojnë kudo, të arrihet Këmishtaj, të konkurrohen kjo dhe ekonomitë e tjera të përparuara, ndërsa të dalluarit, pa u dehur nga sukseset, të gjejnë rrugë e mundësi të reja për të konsoliduar fitoret e arritura e për të ecur edhe më përpara.

Zhvillimi është një proces i pandërprerë. Mundësitë dhe rezervat në bujqësi për të ecur me ritme të shpejta përpara janë të pakufishme. Prandaj lufta dhe përpjekjet duhen ngritur në një shkallë më të lartë për të arritur rezultate më të mëdha. Ndërtimi socialist dhe mbrojtja e atdheut kërkojnë që të prodhojmë sa më shumë drithëra buke, ta sigurojmë bukën në vend, jo vetëm për sot, por të krijojmë edhe rezerva. Të shtojmë në maksimum prodhimin dhe përdorimin e patateve, të perimeve, të fasuleve e të thjerrëzave, që janë aq të domosdoshme dhe me vlera shumë të mëdha për ushqimin e popullsisë në qytet e në fshat. T'i sigurojmë gjithmonë e më mirë nevojat e vendit me yndyrna, sheqer, oriz, pambuk e të tjera. Të hapim toka të reja. Të zhvillojmë blegtorinë, duke treguar kujdes të veçantë për shtimin dhe për përmirësimin e lopëve me racat më të mira, duke shtuar e duke përmirësuar dhentë e dhitë, për të cilat ka kudo mundësi në vendin tonë, duke shtuar kafshët e punës e pendët e qeve dhe duke bërë një kthesë

rrënjësore në sigurimin e bazës ushqimore për bagëtinë. Të zgjerojmë mbjelljen e ullinjve, të pemëve e të vresh-tave. Të vëmë në jetë porosinë e Partisë, që kodrat e malet t'i bëjmë pjellore e të begatshme si edhe fushat.

Realizimi i këtyre detyrave duhet të jetë objekt i një studimi të thellë nga çdo ekonomi dhe institucion kërkimor-shkencor, nga të gjithë punonjësit dhe specialistët e bujqësisë, të cilët, duke u mbështetur në treguesit e ekonomive të përparuara, përmes një analize të hollësishme, të nxjerrin në dritë çfarë është bërë, çfarë nuk është bërë dhe çfarë duhet bërë, me synim që të parashikojnë dhe të arrijnë detyra mobilizuese e revolucionare për vitin 1976 dhe për krejt pesëvjeçarin e ardhshëm.

Për të siguruar rendimente të larta në bujqësi janë të nevojshëm njohja e zbatimi i shkencës bujqësore dhe i eksperiencës së përparuar në prodhimin e gjerë. Kjo kërkon njerëz të arsimuar, sepse edhe kooperativisti i thjeshtë duhet të jetë në gjendje të vërë në zbatim të dhënat e shkencës bujqësore. Traktoristët, kombajnerët dhe gjithë mekanizatorët e bujqësisë, gjithashtu, të thellojnë dijet e tyre dhe të bëhen mjesh-tër të vërtetë të prodhimit bujqësor. Përprjekje të mëdha e të vazhdueshme duhet të bëjnë posaçërisht specialistët e bujqësisë, për të rritur njohuritë e tyre teknike, për t'i pasuruar përditë ato me të dhënat praktike të zhvillimit të ekonomisë bujqësore. Studimet agrokimike e pedologjike, të bonifikimit e të sistemit të tokave, të strukturës e të llojeve të farërave, të fidanëve e të gjësë së gjallë, studimet për organizimin dhe për forcimin e brendshëm ekonomik-organizativ

të ekonomisë bujqësore të përdoren më mirë nga të gjithë dhe të përsosen e të thellohen më tej.

Nga zhvillimi dhe nga modernizimi i bujqësisë varret shumë rritja e vazhdueshme e mirëqenies së mbarë popullit tonë. Prandaj, shoqe e shokë kooperativistë, të shtoni mobilizimin dhe të luftoni me të gjitha forcat për t'i dhënë një hov të fuqishëm rritjes së prodhimit bujqësor, duke filluar qysh tani me vjeljen e të vonave dhe me mbjelljet e vjeshtës. Punonjësit e qytetit të përfshihen gjithmonë e më shumë në këtë mobilizim për të ndihmuar fshatin me aksione masive, të vazhdueshme e të organizuara mirë. Në ballë të kësaj pune të qëndrojnë, si kurdoherë, klasa punëtore. Rinia jonë, që i është përgjigjur me gatishmëri çdo thirrjeje të Partisë, të shkojë me dëshirë për të punuar e për të jetuar në fshat, të ndër marrë aksione të rëndësishme, që do ta bëjnë fshatin më të begatshëm dhe jetën më të bukur.

Organizatat e Partisë dhe komunistët të bëhen promotorë të fuqishëm për t'i ngritur të gjithë njerëzit në këmbë, për të rritur tek ata sedrën, besimin dhe optimizmin revolucionar se s'ka detyrë që nuk përmbushin, s'ka kala që s'marrin njerëzit e rinj të Shqipërisë socialiste, të edukuar dhe të udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme.

Edhe një herë ju përgëzoj, të dashura shoqe, dhe ju uroj t'i vini sa më parë në jetë ato që mësuat në takimin tuaj, duke punuar e duke luftuar me trimëri e dituri, ashtu siç dinë të punojnë e të luftojnë gratë tona heroike. Le të bëhet shembulli i Këmishtajt një shkëndijë që të ndezë një zjarr të madh të ri, për t'i

ngrohur akoma më shumë zemrat e mbarë popullit shqiptar me prodhime bujqësore e blegtorale gjithnjë e më të bollshme!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën "Zëri i popullit", nr. 227 (8458), 23 shtator 1975*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, "Raporte e fjalime 1974-1975", f. 364*

## PËR EDUKIMIN E KËSHILLTARËVE TË GJENDEN FORMA TË PËRSHTATSHME

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

23 shtator 1975

Jam dakord me diskutimin e shoqes Naunka<sup>2</sup>, që tha se edukimi ideopolitik e profesional i këshilltarëve popullorë ka rëndësi të madhe. Komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, për zgjidhjen e problemeve të pushtetit, t'i aktivizojnë gjallërisht këshilltarët, mendimi i këtyre të merret parasysh për çështjet e qeverisjes së vendit, këta të marrin kontakt të vazhdueshëm me masat, të dëgjojnë zërin e tyre dhe ta shpien në organet e pushtetit popullor.

Ne kemi mijëra këshilltarë popullorë të instancave të ndryshme. Është e domosdoshme që kjo masë e madhe njerëzish të zgjedhur të edukohet edhe nëpërmjet

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën për edukimin e këshilltarëve popullorë».

2. Naunka Bozo, në atë kohë anëtare e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

bashkëndimit të shumë formave të punës edukuese, politike, ideologjike.

Në vlerësimin e këshilltarëve, për një pjesë të të cilëve në raport thuhet se janë me shkollë 8-vjeçare, duhet të kemi parasysh se këta nuk janë 18-vjeçarë, por 25, 30 e më shumë vjeçarë. Përveç shkollës 8-vjeçare, këta kanë një eksperiencë të mirë në punën e në luftën që bëhet për ndërtimin e socializmit, pra, janë të rrahur në jetë me vaj e me uthull. Ka njerëz që në moshën e këtyre këshilltarëve janë bërë edhe ministra, sepse te ne zhvillohet një punë e madhe revolucionare për formimin dhe kalitjen e gjithanshme të njeriut me vetitë e larta të moralit komunist.

Kam përshtypjen se format e edukimit që praktikohen për këshilltarët, me gjithë punën e bërë në këtë drejtim, janë një çikë burokratike. Mua më duket se në to derdhen shumë fraza të zbrazëta. Për frazeologjinë e përdorur kam një vërejtje edhe lidhur me raportin e paraqitur këtu «Mbi punën për edukimin e këshilltarëve popullorë». Duhet të hiqet dorë nga frazat pa bukë, sepse këto janë një shfaqje e teknokratizmit dhe e intelektualizmit. Ka njerëz që u jepet për të shkruar, si të thuash, u ecën pena, dhe dinë të ujdysin fraza. Nuk thotë kot populli që «llafet e shumta janë fukarallëk», prandaj duhet të shmangen frazat e tepërta në informacione, në raporte, në analiza, në studime etj. Të kihet parasysh që Presidiumi i Kuvendit Popullor, si organ i lartë i pushtetit shtetëror, të mos ngopet me fraza boshe ose me të dhëna e materiale të përsëritura shumë e shumë herë gjatë 30 vjetëve. Kur bëhet një raport si ky që na paraqitet, shokët, të cilët shkojnë

për ta studiuar problemin, të mendojnë thellë e të konkludojnë në ato probleme që paraqesin interes të madh për Presidiumin. Në raportet që na paraqiten, ne duhet të gjejmë mendime të shprehura qartë, saktë dhe drejt.

Seminaret disaditore janë të mira, por me heq një-rëzit nga puna për shkak të organizimit të tyre nuk është e rekomandueshme. Jam dakord që seminarët, mundësisht, të bëhen jashtë orarit të punës, por ajo që paska organizuar rrethi i Elbasanit për këshilltarët, të cilët i shkëput nga puna e zakonshme dhe i vë të punojnë paradite në kooperativë sa për të përballuar shpenzimet e ushqimit të tyre, nuk më duket se është ndonjë formë organizimi për t'u rekomanduar. Unë nuk jam i mendimit që këshilltarët t'i heqim shumë kohë nga puna që t'u bëjmë seminare nga pesë ose nga dhjetë ditë. Edukimi i këshilltarëve nuk mund të reduktohet vetëm në një ose në dy seminare me kohë të zgjatur, ai është një proces i tërë i përbërë nga një larmi formash të kombinuara me të gjithë punën e Partisë. Këshilltarët edukohen edhe në organizatën ku militojnë, sepse ata janë ose komunistë, ose punëtorë apo nëpunës që bëjnë pjesë në organizatën e bashkimeve profesionale, të gruas, të rinisë etj.

Në organizimin e seminareve ka rëndësi të shikohet se çfarë temash studiohen. Ç'bëjnë në këto seminare disaditore këshilltarët, kur në Elbasan kooperativistëve nuk u zgjidhet problemi i bukës? Ata që venë në seminarët e rrethit të Elbasanit dhe marrin mësim se si të drejtojnë pushtetin e të zbatojnë drejt ligjet, ka raste që e lënë fshatin pa bukë! Unë nuk them kurrë që këshilltarët të mos mësohen, se është e padiskutueshme



që edukimi i tyre ka rëndësi të madhe, por theksoj se për këtë edukim duhen gjetur forma më të përshtatshme, më të efektshme, më pak të kushtueshme dhe duhet me ditë qfarë t'u mësojmë.

Të gjithë këshilltarëve nuk mund t'u mësojmë të njëjtën gjë. Nuk duhet të flasim njësoj si me një këshilltar të qytetit të Tiranës, ashtu edhe me atë të Staravekës, që ka probleme të tjera. Në qoftë se instruktori i seksionit të organizimit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës, për shembull, vete dhe i flet këshilltarit popullor të një fshati për dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor «Mbi qarkullimin në rrugët e qyteteve dhe në rrugët e tjera» apo për diçka tjetër, që s'ka lidhje aspak me punën e tij, kjo do të ishte një kohë e humbur. Këshilltarin e fshatit duhet ta mësojë, bie fjala, për dekretin «Mbi mbrojtjen e bujqësisë», «Mbi mbrojtjen e tokës» etj., pra për çështjet e fshatit. Në zgjedhjen e temave për seminaret me këshilltarët duhet t'u adaptohemi mirë problemeve dhe situatës.

Këto kisha për të thënë unë për këtë çështje.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verball i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

# TË RUHEMI NGA SH TREMBËRIMET QË MUND T'U BËHEN DIREKTIVAVE TË PARTISË DHE LIGJEVE TË SH TETIT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

23 shtator 1975

Në projektdekretin «Mbi një shtesë në nenin 56 të Kodit të Punës» thuhet se komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit vendos që punëtori ose nëpunësi i ardhur nga fshati të kthehet në fshat për nevojat e ekonomisë socialiste. Një formulim i tillë më duket shumë i papërcaktuar. Kjo frazë mund të sjellë si pasojë edhe veprime arbitrare. Kështu nuk parandalohet rreziku që ndonjë kryetar komiteti ekzekutiv, duke ndikuar në mbledhjen e komitetit, t'u thotë punëtorëve ose nëpunësve që kanë ardhur nga fshati: «Kthehuni përsëri në fshat!», dhe të pretendojë se ka vepruar duke u mbështetur në ligj. Si keni menduar ta parandaloni këtë fenomen që mund të duket, shoku Xhafer<sup>2</sup>? Keni

---

1. Në pikën e dytë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje u shqyrtua projektdekreti «Mbi një shtesë në nenin 56 të Kodit të Punës».

2. Xhafer Spahiu, në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, i ftuar në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

parashikuar ndonjë projektudhëzim për të sqaruar kup-timin e vërtetë të dispozitës ligjore apo jo? Si përcak-tohen kriteret që duhen zbatuar për vënien në jetë të kësaj dispozite që propozoni?

Ne kemi thirrur shumë njerëz nga fshati për ne-vojat e ndërtimit të socializmit. Këta kanë zënë vend me punë e banim në qytete e në qendra industriale, ka-në fituar eksperiencë e dituri në punë etj. Atëherë si do të veprohet me ta që të mos na vërtetohen veprime arbitrare e të pamenduara mirë? E theksoj këtë çështje, shokë të Presidiumit, se kam vërejtur që, kur jepet një direktivë, e cila është e drejtë, siç është vajtja për të punuar e për të jetuar në fshat, që të ndihmohet fshati, përnjëherësh ministritë japin urdhër: «150 veta të lëvizin nga puna!», pa e sqaruar më parë politikisht masën e punonjësve dhe pa menduar se ku do të dër-gohen ata që largohen nga qyteti. Partia jonë nuk i le-jon qëndrime të tilla pa pikë përgjegjësie në trajtimin e njerëzve, prandaj unë kërkoj disa shpjegime rreth interpretimit të projektdekretit para se të vendosim miratimin e tij.

*Pasi dëgjoji sqarimet përkatëse, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Me cilët do të zëvendësohen punëtorët që largoh-en? Mos mendohet të zëvendësohet punëtori që ka 10 vjet punë në qytet me një djalë të ri, me qëllim që ky të mos ikë nga qyteti? Kushtet e zbatimit të afatit 10-vjeçar, që është caktuar nga viti 1964 e këtej, duhet të sqarohen mirë. Në qoftë se ka në qytet 50 të rinj që kërkojnë punë, atëherë nuk mundet që, për hatër të tyre, të kthehen në fshat ata njerëz që kanë 10 vjet

në qytet e që janë bërë shoferë apo kanë marrë ndonjë profesion tjetër të nevojshëm. Unë këtu po flas për rastet që na paraqiten në praktikë. Ja, për shembull, 20 shoferë më kanë shkruar se i urdhëruan të ikin në fshat. «Ne jemi gati të shkojmë në fshat, thonë ata, po a është e drejtë kjo?». Është me vend t'i kthejmë shoferët në kooperativat bujqësore, në një kohë që ne kërkojmë 120 shoferë për të punuar në Fierzë? Në këto drejtime duhet të ruhem nga shtrembërimet që mund t'u bëhen direktivave të Partisë dhe ligjeve të shtetit. Direktivat e lëshuara nga Partia, ligjet e dekretet që miratohen, apo vendimet që merren nuk duhet të vijnë në kundërshtim me vendimet e mëparshme që janë në fuqi, se ndryshe krijohen turbullira dhe çorientime në zbatimin e tyre.

Mendoj se shtesa e propozuar në nenin 56 të Kodit të Punës që komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit të vendosë që punëtori ose nëpunësi i ardhur nga fshati të kthehet në fshat për nevojat e ekonomisë socialiste nuk duhet të jetë kaq afirmative. Një formulim i tillë, më duket mua, nuk është as i drejtë, as i rekomandueshëm, sepse është shumë arbitrarisht. Kjo dispozitë duhej formuluar në një mënyrë që, kur komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit e shikon të nevojshme, le të veprojë, por të mos kryejë arbitraritet, duke e marrë tjetrin nga fshati në qytet ose anasjelltas sipas qejfit, duke shkëlur kështu Kushtetutën e Republikës për të drejtën e banimit. «Hajde dhe ik! Kështu do të më lëvizësh kur të duash nga fshati në qytet?», ka të drejtë të pyesë shtetasi. Pra, mendoj që në rastin konkret duhet një formulim më tepër politik.

Nga presioni që ushtrohet për të dërguar njerëzit në ndihmë të fshatit, disa nga organet shtetërore, duke u prirur jo nga bindja, por nga masat me karakter administrativ, thonë: «Mirë, ne i çojmë, por të dalë një ligj». Pikërisht këtë ligj kërkojnë ata dhe pastaj janë gati që menjëherë të formojnë radhën e makinave për t'i nisur njerëzit në fshat. Në fillim u japin një muaj afat që të mendohen dhe, po nuk u bindën, i hipin «vullnetarisht» në makina! Kjo nuk është në përputhje me demokracinë tonë proletare, prandaj unë jam i mendimit që kjo dispozitë të shikohet me kujdes.

Ne dimë se ka punëtorë në Minierën e Bulqizës që, kur marrin një ditë leje, venë në fshatrat e tyre dhe qëndrojnë atje dhjetë ditë, sepse kanë dashuri për fshatin. Atëherë si propozohet që komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit t'i heqë nga miniera e t'i dërgojë këta në fshat në bazë të ligjit? «Pse të më dërgojë komiteti ekzekutiv, vete vetë unë në fshatin tim», thotë fshatari. Ai erdhi vullnetarisht nga fshati në qytet, se ne i bëmë thirrje, se Partia e bindi. Kurse tani komiteti ekzekutiv vendos ta kthejë detyrimisht në fshat. Prandaj duhet parë një çikë ky projekt; në rast se është i nevojshëm, duhet formuluar më mirë e më saktë.

*Dotohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverballi i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor, që gjendet në AQP*

## NE KEMI MUNDËSI TË VËMË EMRA TË RINJ, TË BUKUR E ME KUPTIM

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH*

23 shtator 1975

Për të ndihmuar shtetasit në zgjedhjen e emrave është ngarkuar Instituti i Gjuhësisë i Akademisë së Shkencave të hartojë një fjalor emrash të përshtatshëm. Në qoftë se sektori përkatës i institutit do të punojë edhe në të ardhmen për emrat e njerëzve, jam i mendimit që t'i thuhet të ketë kujdes kur nxjerr lista me emra «ilirë», sepse ka nga këta emra që mbajnë erë romake. Popujt e vjetër, gjatë historisë, janë dyndur nga një vend në tjetrin, prandaj kanë ndikuar reciprokisht edhe në emrat. Kështu ka ngjarë edhe me pushtimin e vendit tonë prej osmanllinjve, që na futën emrat e tyre në njerëzit e besimit mysliman. Disa që hiqen si specialistë të gjuhësisë, bëjnë diskutime akademike të mëdha dhe shikojnë me «mikroskop» nëse ky apo ai është gur ose mur, nëse këta emra janë apo s'janë ilirë etj.

Mua më duket se nuk është e drejtë që një popull

si ky yni, të cilit nuk i është mohuar prejardhja ilire, të përdorë emra të vjetër për hir të antikitetit. Ne e kemi quajtur Ilir djalin e madh jo në kuptimin e prejardhjes së shqiptarëve, por në kuptimin e të qenit njeri i lirë. Kështu e kemi menduar në familje kur i vumë këtë emër.

Ne shqiptarët jemi një popull që, duke ndërtuar socializmin, kemi krijuar tradita e zakone të reja. Edhe sikur emrat e rekomanduar të jenë me të vërtetë ilirë, për hir të këtij fakti nuk mund të kthehemi 3 000 vjet prapa në periudhën e antikitetit. Ç'kuptim ka kjo, kur kemi mundësi të vëmë shumë emra të rinj, të bukur e me kuptim si, bie fjala, emra vendesh, malesh etj., etj. Ky problem nuk zgjidhet vetëm duke dhënë lista me rekomandime emrash nga zyrat e gjendjes civile. Të punohet me njerëzit që të zgjedhin vetë emra shqip, që kanë kuptim e tingëllojnë bukur, me qëllim që të ruhen e të forcohen traditat kulturore përparimtare. Unë jam dakord që duhen ndryshuar emrat qesharakë e përçmues, që përmenden në materialin e paraqitur. Në vend të tyre është mirë që njerëzit, sipas dëshirës, të vënë emra dhe mbiemra me përmbajtje të shëndoshë politike, ideologjike e morale.

*Dotohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

# PUNONJËSIT QË TREGOJNË TRIMËRI NË KRYERJEN E DETYRËS, MERITOJNË TË DEKOROHEN

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

23 shtator 1975

Është përcaktuar drejt me ligj se dëshmorë të atdheut mund të quhen ata që kanë dhënë jetën duke luftuar kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, për lirinë, pavarësinë, demokracinë ose për kauzën e proletariatit ndërkombëtar; ata që kanë dhënë jetën për çlirimin e Shqipërisë, duke luftuar në forma të organizuara të Lëvizjes Nacionalçlirimtare; si dhe ata që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e kufijve të atdheut e të fitoreve të revolucionit popullor.

Punonjësit e policisë, për të cilët bëhet fjalë këtu, u vranë nga një kriminel që, në kundërshtim me ligjin, e kishte ngritur shtëpinë jashtë vijës së verdhë. Kur organet kompetente shtetërore dërguan punonjësit e po-

---

1. Një ndër pikat e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje ishte lidhur me propozimin për shpalljen si dëshmorë të atdheut të dy punonjësve të policisë.



licisë të ekzekutonin vendimin për ta prishur shtëpinë e ngritur arbitrarisht, ky kriminel zuri një qoshe, i goditi me armë dhe i la të vrrarë. Punonjësit e policisë treguan trimëri në kryerjen e detyrës së ngarkuar, prandaj meritojnë të dekorohen me urdhrin apo medaljen që u takon sipas ligjit. Unë nuk jam dakord që këta të quhen dëshmorë për sa kohë që propozimi nuk gjen mbështetje në dekretin «Mbi dëshmorët e atdheut». Po të shpallnim dëshmorë këta, atëherë do të duhej t'u ktheshim për këtë qëllim shumë patriotëve që kanë luftuar me kriminelët e që janë vrrarë në ndeshje me ta. Kuptohet se tërë këta nuk mund t'i quajmë dëshmorë të atdheut. Njerëz të tillë do të dekorohen me urdhrat apo medaljet që u takojnë, emrat e tyre do t'i kujtojmë me respekt, shtypi do të shkruajë për ta dhe familjet e tyre do të ndihmohen sipas ligjit mbi Sigurimet Shoqërore Shtetërore.

Po u shikua mirë e me kujdes këtu çështja e dekorimeve, nuk do të na bëhen propozime që s'përputhen me kërkesat e ligjit dhe ky nuk do të shkelet. Çdo institucion, ndërmarrje ose organizatë ka të drejtë të propozojë çfarë të dojë, por barrikada duhet të jetë në organin shtetëror kompetent. Këtu duhet të jetë vendi ku të pengohet çdo gjë që nuk përputhet me ligjin dhe me politikën e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diut të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

## DREJTËSIA JONË GJYKON NË BAZË TË PROVAVE E RRETHANAVE TË GJITHANSHME

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

23 shtator 1975

Krimi është kurdoherë i shëmtuar dhe i dënueshëm, por në caktimin e llojit të dënimit, në çdo rast, duhen parë edhe rrethanat e kryerjes së tij. Këtë ta kemi parasysh edhe ne këtu në Presidium kur shqyrtojmë kërkesat për faljen e dënimeve, por duhet ta kenë parasysh, gjithashtu, edhe gjykatat kur japin vendime dënimi. Republika jonë Popullore është kundër ligjit të talionit, sipas të cilit, po vrave, të vrasin. Drejtësia jonë nuk vepron sipas këtij ligji, por e gjykon çështjen në bazë të provave e rrethanave të gjithanshme.

Ata që kanë kryer krime, janë shtyrë nga shumë arsye, natyrisht, të dënueshme, por edhe në raste të tilla duhen parë rrethanat rënduese e lehtësuese. Këto

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe lidhur me shqyrtimin e disa dënimeve.

rrethana gjykata t'i hetojë me kujdes, t'i analizojë me metodën dialektike marksiste dhe të marrë vendime në përshtatje me shkallën e rrezikshmërisë së krimit, të personit dhe të fajit. Ajo nuk duhet të gjykojë kurrë nën presionin e një grupi njerëzish, të cilin, në raste të tilla, e përgatitin disa nga të afërmit e viktimës. Është e natyrshme që këta ndiejnë një hidhërim të jashtëzakonshëm për humbjen e njeriut të vet dhe në momente dëshpërimi u turbullohet ndërgjegjja edhe nga ndjenjat e dënueshme të hakmarrjes së vjetër, megjithëse mund të thonë se nuk ndikohen aspak nga hakmarrja. Në qoftë se dikush kryen një vrasje, ky është një krim shumë i rëndë, për të cilin ai do të ndëshkohet, por, siç thashë, duke marrë parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës, të personit e të fajit, si dhe tërësinë e rrethanave rënduese e lehtësuese.

I shikojnë të gjithë gjykatësit kurdoherë kështu çështjet që gjykojnë për këto krime? Unë mendoj se i shikojnë, por ka raste që edhe nuk i shikojnë tamam kështu. Kjo neglizhencë në caktimin e drejtë e me përgjegjësi të llojit dhe të masës së dënimit vihet re jo vetëm në gjykimin e çështjeve penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, por edhe në çështje të tjera penale me rrezikshmëri më të vogël, për të cilat njerëzit mund të mos dënohen me heqje të lirisë, sepse ligji parashikon për to edhe dënim me qortim shoqëror, me gjobë, me punë korrektuese etj. e pastaj me hoqjen e lirisë. Për dënimin ligji me të drejtë ka parashikuar një minimum dhe maksimum, që t'u japë mundësi gjyqtarëve të individualizojnë masën e dënimit. Kështu, për zhembull, për hoqjen e lirisë është caktuar minimumi

një muaj dhe maksimumi 25 vjet. Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit gjykata duhet të respektojë kërkesat e Kodit Penal.

Është e ditur se armiku na lufton me të gjitha mundësitë dhe mjetet, prandaj ne duhet të zhvillojmë e të thellojmë luftën e klasave. Po nuk e zhvilluam këtë luftë, po nuk e forcuan diktaturën e proletariatit, atëherë nuk mund të ndërtohet e të mbahet në këmbë socializmi. Por të zhvillosh luftën e klasave nuk do të thotë aspak që, kur ndonjëri bën qoftë edhe një faj të vogël, të dënohet me privim lirie. Lufta e klasave duhet kuptuar dhe zhvilluar sipas mësimëve të Partisë. Në zhvillimin e saj gjyqtari, prokurori dhe hetuesi nuk duhet të tregohen as ekstremistë, as liberalë ose oportunistë. Që ta kuptojnë mirë dhe ta zhvillojnë drejt luftën e klasave, ata të studiojnë me vëmendje mësimet e Partisë për diktaturën e proletariatit etj. Duke dhënë dënime të rrepta, që nuk përputhen me shkallën e fajit etj., ndonjë gjyqtar do të tregojë sikur është mbrojtës fanatik i ligjeve të diktaturës së proletariatit! Të mendosh dhe të veprosh kështu, gabon, sepse shkel ligjet e shtetit socialist dhe, kur shkelen ligjet, nuk mbrohet, por rrezikohet diktatura e proletariatit. Këtë porosi Partia jonë e ka dhënë vazhdimisht. Unë nuk them që gjyqtarët të tregohen liberalë, se kështu shteti, Partia dhe populli pësojnë dëme shumë të mëdha, por e kam fjalën që ata të jenë kurdoherë objektivë e të drejtë në gjykime dhe t'i zbatojnë me përpikëri e me ndërgjegje të lartë direktivat e Partisë e ligjet e shtetit. Partia na mëson se duhen luftuar edhe dogmatizmi e sektarizmi, edhe liberalizmi, ndryshe nuk

mund të kuptohen si duhet qëllimet dhe detyrat e drejtësisë sonë socialiste.

Të gjykosh drejt do të thotë t'i hetosh e t'i çmosh provat sipas ligjit, në mënyrë të tillë që, kur të lexohet vendimi gjyqësor, e gjithë masa e dëgjuesve dhe vetë personi që gjykohet të kuptojnë e të binden se dënimi që u dha është me të vërtetë i drejtë. Prandaj gjykatësit kanë përgjegjësi të madhe, të cilën nuk duhet ta harrojnë, sidomos në momentet e dhënies së vendimit.

Këtu u vumë në dijeni për një krim. Viktima, siç del nga materiali që disponojmë, ka braktisur banesën bashkëshortore dhe bashkëshortin e vet, sepse e paska qortuar kujdestarja e çerdhes që fëmija i saj është e papastër! Pas largimit të viktimës nga banesa bashkëshortore, i gjykuari ka vajtur dhe e ka ftuar atë që të kthehet në shtëpi, por ajo pa arsye nuk ka pranuar. Nën ndikimin e këtyre rrethanave familjare, i pandehuri kreu krimin. Me largimin arbitrar nga familja dhe me refuzimin për t'u kthyer atje, nuk paska kryer edhe viktima ndonjë faj, që ndikoi në vendimin e padrejtë të të shoqit? Unë mendoj se po. Ajo paska vajtur në familjen e saj, duke marrë edhe fëmijën me vete. Ja, pra, që edhe viktima nuk është pa faj. Faji i saj nuk e shkarkon aspak të gjykuarin nga përgjegjësia penale, por është një rrethanë që, në rastin konkret, duhet pasur parasysh në caktimin e llojit të dënimit. Për rrahjet që pretendohet se ka kryer i dënuari në dëm të viktimës, kur ata bashkëjetonin, kjo duhej të ishte ankuar në organet kompetente. Pra, kishte plot rrugë që, po t'i ndiqte ajo, do të shmangej krimi. Për të gjitha sa përmenda, mua më duket se të pandehurit du-

het t'i falet jeta. Të dënosh me vdekje një njeri vetëm për faktin se ai vrau dikë, pa marrë parasysh rrethanat e vrasjes, do të thotë të udhëhiqesh nga ligji i talionit. Të afërmit e viktimës ndoshta nuk do të jenë të kënaqur nga vendimi për faljen e jetës së të dënuarit, por, megjithëkëtë, ne duhet të gjykojmë objektivisht dhe me përgjegjësi. Gjykimi im personal dhe bindja ime, si anëtar i Presidiumit, nuk më lejojnë të mos propozoj për faljen e dënimit me vdekje. Ky dënim mendoj të zëvendësohet me 25 vjet heqje të lirisë. Vuajtja e 25 vjetëve heqje të lirisë nuk është pak, apo jo? I dënuari është 27 vjeç dhe në këto rrethana ka mundësi të riedukohet.

Nga dënimet e dhëna del se ka dobësi në punën e propagandës kundër kriminalitetit nga ana e komiteteve të Partisë, e organizatave të masave, e komiteteve ekzekutive, e gjykatave, e prokurorive dhe e organeve të Punëve të Brendshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

## **DISA MENDIME PËR PROJEKTKUSHTETUTËN E RPSSH**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**25 shtator 1975**

Siç e dini, çështjen e projektkushtetutës e kemi marrë në shqyrtim edhe një herë tjetër dhe, pasi janë bërë plotësimet e korigjimet e nevojshme, në bazë të vërejtjeve të bëra, u paraqit përsëri në Byro. Tani mund të kemi edhe vërejtje të tjera, vërejtje do të bëjë edhe Plenumi i Komitetit Qendror, mund të bëjë edhe populli, edhe Kuvendi Popullor. Kështu që do të kemi një kushtetutë të përshtatshme për Republikën tonë Popullore Socialiste.

Tani të diskutojmë çfarë kemi për këtë material që na është paraqitur. Ju, shokë, që punuat për projektkushtetutën, keni ndonjë gjë për të shtuar? Unë kisha disa vërejtje të vogla.

---

1. Në këtë mbledhje, mldis të tjerash, u diskutua rreth raportit «Mbi projektkushtetutën e RPSSH», që do të mbahej në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH.

Këtu në hyrje, më duket mua, nuk del roli i klasës punëtore, mbasandaj nuk spikatin krijimi dhe fuqizimi i industrisë dhe kolektivizimi i bujqësisë, prandaj, qoftë edhe me pak fjalë, mund të vihen në dukje sa për t'i përmendur në hyrje, megjithëse në dispozitat e projektit ata trajtohen.

Në një faqe të projektkushtetutës thuhet: «Organizatat shoqërore bashkojnë masa dhe shtresa të ndryshme të popullit...». Në vend të fjalës «të ndryshme» mendoj të përdorim fjalën «të gjera».

Në një faqe tjetër të projektkushtetutës thuhet: «pronë e shtetit është gjithashtu çdo pasuri tjetër që shteti fiton sipas ligjit...». Po sikur të shtohet: «që krijohet në sektorin shtetëror ose që shteti fiton sipas ligjit»? Duhet shtuar edhe fjala «krijohet» apo nuk duhet, pa shikojeni një herë edhe këtë.

Është bërë një vërejtje për të shënuar termin «realizmi socialist» në nenin që flet për përkrahjen nga shteti të letërsisë dhe të artit. Mua më duket se është me vend përdorimi i këtij termi.

Në faqen 11 të projektkushtetutës, aty ku thuhet se nga e drejta e zgjedhjes përjashtohen vetëm personat të cilëve «u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar», të kemi parasysh se kjo terminologji përdoret në gjuhën juridike për ata shtetas që kanë të meta mendore. Por njerëzit që nuk i njohin këta terma, mund ta interpretojnë një shprehje të tillë me kufizimin ose me mungesën e zotësisë për punë, pra, për invalidët. Kështu të mos kujtohet sikur invalidët kanë zotësi të kufizuara për të vepruar.

Në faqen 14 thuhet: «Ndalohet krijimi i çdo orga-



nizate me karakter fashist, antidemokratik dhe anti-socialist». Unë mendoj që këtu duhet shtuar edhe fjala «fetar».

Në vend të fjalës «e pajetërsueshme» pse të mos vihet një fjalë tjetër shqipe më e përshtatshme? Pra, mund të zëvendësohet me ndonjë fjalë tjetër që të kuptohet mirë, por jo me fjalë të huaj.

Në relacionin shpjegues për projektkushtetutën, thuhet se «Shtetasit më aktivë dhe më të ndërgjegjshëm bashkohen në Partinë e Punës të Shqipërisë...». Unë jam i mendimit që këtë ide të mos e shprehim në asnjë mënyrë në projektkushtetutë. Partia ka rregullat dhe normat e saj, të parashikuara në statutin e vet, për pranimin e anëtarëve të Partisë, e s'ka pse të parashikohen këto edhe në Kushtetutë.

Kisha edhe një vërejtje për raportin që do t'i paraqitet Plenumit të Komitetit Qendror. Në faqen 2 të këtij raporti thuhet: «Në vitet 60-të u zgjidhën plotësisht detyrat e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit». Kjo mund të jetë e vërtetë, po ne ta përmendim pa shënuar vitin.

Unë mendoj të mos futemi në shumë hollësi. Këshilli i Ministrave, për shembull, është i ngarkuar nga Kuvendi Popullor për të vazhduar veprimtarinë e vet sipas ligjit, pse duhet ta vëmë këtë edhe në Kushtetutë?

Kush ka vërejtje të tjera?

*Pasi folën edhe shokë të pranishëm në mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:*

Në përgjithësi mendoj se projektkushtetuta është punuar mirë.

Pasi ta diskutojmë çështjen në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, duhet të vendosim që projekt-kushtetuta të diskutohet gjerësisht në popull. Diskutimi në popull duhet të përgatitet mirë dhe të merren e të klasifikohen të gjitha vërejtjet e masave.

Kur komisioni i zgjedhur nga Kuvendi Popullor t'i marrë, t'i kontrollojë e t'i sheshojë të gjitha vërejtjet, mendimet e sugjerimet do t'ia paraqesë Byrosë Politike, e cila do të mblidhet që t'i shikojë.

Në Kongresin e Partisë, mendoj që të shtrojmë në përgjithësi çështjen për pranimin e Kushtetutës së re dhe, së fundi, kjo t'i kalojë Kuvendit Popullor për miratim. Në raportin e Kongresit të ardhshëm të Partisë çështja e Kushtetutës mendoj të jetë një problem kryesor që do të shtrohet.

Me këto që u thanë jemi dakord. Atëherë të vendosim kur do ta mbledhim Plenumin, se shokët duhet ta marrin me kohë materialin, që t'u lëmë mundësi ta studiojnë me kujdes.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verballi i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## PERGJEGJËSIA E ORGANIZATAVE TË PARTISË NË DIKASTERE ESIHTË SHUMË E MADHE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 shtator 1975

Diskutimet që bënë shokët në këtë mbledhje të Byrosë Politike kanë një vlerë të madhe ideologjike, politike e organizative dhe, pavarësisht se shoku Manush [Myftiu]<sup>2</sup> mbajti shënime, propozoj që Byroja Politike të mos mjaftohet me një raportim qoftë edhe të zgjeruar që ai mund t'i bëjë plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës. Prandaj këtu në aparatin e Komitetit Qendror të hartohet një dokument i bazuar në analizat e thella kritike që i bënë shokët e Byrosë Politike problemit që shqyrtuam, pastaj të mblidhet

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit «Mbl gjendjen dhe masat për forcimin e rolit udhëheqës të organizatave të Partisë në dikastere dhe në institucionet qendrore» të paraqitur nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës.

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

Komiteti i Partisë i Rrethit dhe komitetet e Partisë të rajoneve të Tiranës e t'u lexohet ky dokument, në të cilin të bëhet vlerësimi i punës së organizatës së Partisë të rrethit të Tiranës dhe të vihen në dukje të metat e gabimet e saj etj., etj. Pas kësaj, i njëjti material të kalojë për t'u punuar edhe në organizatat-bazë të Partisë të dikastereve.

Sigurisht, nga ana e Qeverisë janë bërë analiza të thella për punën e dikastereve në rrugë shtetërore, problemet atje janë rrahur dhe njerëzit kanë dalë me autokritika. Të gjitha këto, në mos kanë shkuar, duhet t'u shkojnë dikastereve në rrugë shtetërore. Kështu, kur t'u vejë edhe ky material nga Byroja Politike, tok me ato të Qeverisë, të bëhet një «qilizmë» me të vërtetë serioze dhe jo vetëm në dikastere e në organizatat-bazë të tyre, por më parë në Komitetin e Partisë të Rrethit dhe në ato të rajoneve të Tiranës.

Kam menduar të flas edhe unë diçka për problemin që po shqyrtojmë, por meqë në diskutimet e tyre shokët e Byrosë Politike i trajtuan problemet drejt dhe thellë, nuk do të zgjatem, veç dëshiroj të them disa mendime e vërejtje.

1. Organizatat-bazë të Partisë të dikastereve mundet që reagueshin dhe kritikuan pasi u zbuluan punët armiqësore, që zihen brenda, po përse nuk e bënë këtë gjë më përpara, përse nuk nuhatën këto organizata, përse nuk ishin vigjilente dhe nuk reagueshin që më parë?

2. Në asnjë mënyrë nuk duhen shfajësuar organizatat e Partisë dhe komunistët për fajet dhe për miopinë e tyre, duke thënë se roli i tyre udhëheqës në disa dikastere që mënjanuar, siç shprehet në raport Komi-

teti i Partisë i Rrethit të Tiranës. Kjo do të thotë se, po të dalin dy ose tre njerëz të këqij dhe armiq në dikastere, ata qenkan në gjendje ta mënjanojnë rolin udhëheqës të organizatës së Partisë dhe të komunistëve!

Ky arsyetim i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës është i gabuar. Duhet thënë më hapur: Disa organizata-bazë partie në dikastere iu nënshtroan punës armiqësore, atyre u munguan vigjilenca dhe guximi komunist; mjaft komunistë nuk mësonin marksizëm-leninizmin, nuk studionin dhe nuk zbatonin mësimet e Partisë. Për të gjitha këto ata janë fajtorë dhe këto faje të rënda duhet t'i njohin e jo të shfajësohen. Disa organizata partie të Tiranës gabuan në kohën e punës armiqësore të Fadil Paçramit, gabuan në çështjet ushtarake, gabuan edhe tani në çështjet ekonomike. Duhet konstatuar se pësimet atyre nuk iu bënë mësim. Në mjaft organizata partie dhe komunistë mbizotërojnë burokratizmi, rutina, indiferentizmi. Të gjitha këto e të tjera, duke mos bërë edhe përpjekjet e duhura për t'i sqaruar dhe për t'i luftuar me anën e teorisë së Partisë, kanë bërë që ato të humbasin vigjilencën dhe të lejojnë zhvillimin e punës armiqësore. Pas çdo analize që i është bërë një pune armiqësore, e njëjta gjë është thënë: «Reaguan drejt... , kur u zbulua». Por ky ishte një reagim i përciptë, sepse nuk iu vu thellë gishti plagës.

**3. Është e vërtetë se Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës ka një përgjegjësi të madhe për këtë punë «të dobët», që «nuk u vajti çështjeve deri në fund» e të tjera konstatime që numërohen me radhë në raport. Po përse ngjanë këto? Shkaqë politike, ideologjike, organizative o teknike nuk na thuhën dhe as që analizohen**

përpara Byrosë Politike nga ana e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

Ne duhet të dimë në ç'pozita ka qenë Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës, pse i mungoi vigjilenca, pse nuk merrte masa, pse nuk nxirrte konkluzione të rëndësishme nga një mori shfaqjesh, pse nuk bënte sintezat e tyre dhe këto t'ia paraqiste Byrosë Politike. Ai duhet ta konsiderojë këtë punë të dobët, të rrezikshme, që është përsëritur dhe që ka konsekuenca të rënda. . .

4. Numërohen një sërë shkaqesh përse roli i organizatave-bazë nuk printe dhe përse ato nuk udhëhiqnin. Këto shkaqe janë përcaktuar drejt. Po përse e humbën këto organizata-bazë rolin drejtues, përse nuk përpiqeshin të shihnin anën politike dhe ideologjike të çdo problemi? Kushedi sa herë ua ka theksuar këtë Komiteti Qendror. Pse nuk u diktuan shtrembërimet në vijë që u bëheshin direktivave organizative, zgjidhjeve teknike të problemeve që zbatoheshin në rrugën shtetërore? A nuk e dinin organizatat e Partisë se komunistët në shumicën dërrmuese janë në prodhim dhe në zbatim, kurse një përqindje shumë e vogël e tyre duhet të jetë dhe është në administratë? Atëherë përse kjo shumicë lejoi që një pakicë e vogël e administratës t'i impononte pikëpamje armiqësore, shtrembërimet të vijës etj.? Kjo çështje duhet shpjeguar thellë, politikisht dhe ideologjikisht. Po ashtu duhen shpjeguar thellë deformimet që armiqtë u bënë formave organizative të punës për zbatimin e direktivave, duhet thelluar në shkaqet pse ka munguar kontrolli gjatë zbatimit, duhet shpjeguar pse «fletët nuk i lanë komunistët të shihnin pyllin» etj.

Një analizë e tillë ka shumë rëndësi të bëhet dhe

është e domosdoshme të bëhet, dhe jo një herë e për të gjitha problemet, por për çdo problem që hidhet në tavolinë për diskutim dhe sa herë që merret vendim për organizimin e punës e për zbatimin e vendimeve dhe të kontrollit.

5. Veprimtaria e dikastereve dhe realizimi si duhet i funksioneve të instancave më të larta të tyre nuk mund të kuptohen pa pjesëmarrjen drejtpërdrejt të komunistëve dhe pa udhëheqjen e organizatave-bazë të Partisë. Instancat e larta të dikastereve nuk mund të veprojnë jashtë direktivave të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë. Këto direktiva dhe kompetenca duhet t'i njohin dhe t'i zbatojnë të gjithë, në radhë të parë Partia në dikaster. Te ne, në çdo sektor, drejton Partia, drejtuesit kryesorë të dikastereve dhe të ndërmarrjeve janë komunistë, prandaj veprimet dhe kompetencat e tyre janë e duhet të jenë konform direktivave të Partisë. Udhëheqja «e lartë» e dikasterit është e barabartë me gjithë komunistët e tjerë para organizatës-bazë. Nga Partia nuk lejohet që udhëheqja e dikasterit të jetë teknokrate dhe jashtë kontrollit të Partisë. Sepse pati udhëheqje dikasteresh që qëndruan jashtë kontrollit të Partisë, prandaj na ngjanë gjërat që kritikojmë. Në këtë vështrim ideja që shfaqet në raport për këtë çështje nuk më duket ekzakte, bile ajo është e gabuar, sepse Partia, baza dhe udhëheqja e saj, po ashtu edhe masat, kanë të drejtë dhe detyrë të formulojnë rektifikime, të avancojnë propozime dhe të bëjnë kritika. Ndryshe nuk kuptohet roli drejtues i Partisë. Demokracia e vërtetë proletare është e lidhur ngushtë me centralizmin demokratik, si në parti edhe në shtet, ndry-

she nuk mund të ndërtohet socializmi. Këtë e theksoj si një parim të madh teorik që na mëson marksizëm-leninizmi.

Shprehja e këtij mendimi në raport natyrisht lejon ato të meta dhe dobësi që numërohen më poshtë, se «komunistët e ndiejnë edhe në organizatën-bazë hierarkinë shtetërore», se «kanë frikë të shprehen» etj.

6. Në raport ka dhe analiza të drejta të sukseseve, të të metave dhe të problemeve të zgjidhura. Është e kuptueshme dhe urgjente që problemet të zgjidhen dhe të zgjidhen drejt. Për punën e dikastereve veçanërisht ndihma konkrete dhe e vazhdueshme nga aparati i Komitetit Qendror, nga Qeveria, si dhe nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës duhet të shtohet. Kjo ndihmë duhet të jetë shumë e afërt dhe kontrolli të jetë më shumë efektiv. Me këtë unë nuk kuptoj t'u merren dikastereve kompetencat, as të merremi me çikërrima ose të mendojmë të mos ndërhyjmë me kohë kur shkelet vija.

Theksoj edhe një herë se funksionarët e shtetit veçanërisht dhe gjithë anëtarët e Partisë duhet të mësojnë thellë marksizëm-leninizmin dhe të bindemi se gabimet që bëhen e kanë burimin në mosstudimin dhe në mosthellimin në teorinë tonë marksiste-leniniste dhe në mësimet e në eksperiencën e madhe të Partisë sonë.

7. Është e vërtetë se dikasteret kanë shumë probleme për të zgjidhur, objektiva për të arritur, udhëzime për t'i dhënë bazës, por ato duhet të bëjnë më shumë punë për të kontrolluar zbatimin e tyre. Prandaj nga ana e funksionarëve kryesorë shtetërorë problemet e ndryshme dhe vendimet që merren duhet të bëhen ob-



jekt i një studimi të thellë, me qëllim që të gjenden zgjidhje të drejta, të matura e të koordinuara me ligjet dhe me urdhëresat, me vendimet dhe me direktivat e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Funkionarët të kenë parasysh që vendimet që merren të mos ngatërronjë dhe të mos futin në vështirësi të papritura sektorë të tjerë që preken nga vendimi i marrë.

Vendimi që merret kërkon edhe organizimin e mirë të punës për zbatimin e tij dhe t'u shkohet deri në fund masave të parashikuara ose të paparashikuara. Marrja e vendimeve të shpejtuara, të pastuduara, unilaterale, qofshin këto edhe të bazuara në direktiva të drejta, mund të shkaktojë çrregullime, vështirësi organizative, politike, financiare, materiale etj. Që të mos ndodhin këto është e domosdoshme që rektifikimet e herëpashershme që mund të bëhen për probleme e vendime të ndryshme, të bëhen në bazë konsultimesh me të gjitha ato organe partie dhe shtetërore që kanë lidhje me problemin.

8. Më në fund, dua të ritheksoj se dikasteret janë nga aparatet kryesore drejtuese, organizuese, kontrolluese e zbatuese të shtetit që zbatojnë direktivat e Partisë. Prandaj përgjegjësia e tyre është shumë e madhe. Kuptohet se përgjegjësia e organizatave-bazë të Partisë në këto dikastere është po ashtu shumë, shumë e madhe, pse ato nuk kanë përgjegjësinë e një ndërmarrjeje të vogël, pasi puna e kuadrove që punojnë në dikastere ndikon për të mirë ose për të keq në gjithë punën në aparatet e bazës, në zhvillimin e ekonomisë, të kulturës dhe të mbrojtjes së vendit. Nga kjo rrjedhin edhe de-

tyrat e përgjegjësitë shumë të mëdha, veçanërisht të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# RRETHET KANË FORCA QË TË PËRMIRËSOJNË SHUMË PUNËN E ORGANEVE TË SHTYPIT TË TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 shtator 1975

Kisha disa pyetje për shokun Xhelil Gjoni<sup>2</sup> dhe për shokët e rretheve. Ti, shoku Xhelil, ngahera vjen në mbledhjet e Sekretariatit, por nuk ke folur. Unë kam dëshirë të të dëgjoj. E studioni ju shtypin e rretheve apo kënaqeni me të dhënat e një apo dy korrespondentëve vullnetarë që keni atje? Në ç'mënyrë e ndihmoni shtypin e rretheve? Botoni në gazetën «Zëri i popullit» artikuj interesantë nga gazetatat lokale?

Po ju shokët e rretheve botoni në gazetatat tuaja artikuj të shtypit qendror? Mbani lidhje të vazhdueshme me këto organe? I kujtojnë me ndonjë shkrim gazetatat tuaja shokët shkrimtarë e gazetarë të qendrës, apo nuk

---

1. Në këtë mbledhje u mor në shqyrtim ngritja e nivelit ideopolitik të gazetave lokale dhe drejtimi i tyre nga komitetet e Partisë të rretheve.

2. Në atë kohë kryeredaktor i gazetës «Zëri i popullit».

begenisin, se ato janë të rretheve e dalin me tirazh të vogël?

Organizojnë redaksitë e gazetave tuaja anketa me lexuesit për të konstatuar se si shfrytëzohen shkrimet e shtypit e se çfarë vërejtjesh kanë ata për artikujt kryesorë ose për informatat që botohen etj.?

Atëherë fillojmë diskutimet.

*Kur po diskutonte shoqja Lenka Çuko, në atë kohë sekretare e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës, shoku Enver Hoxha tha:*

Unë nuk dua t'ju mburr ngahera ju lushnjarët, por më duket se gazeta juaj është pak më ndryshe nga të tjerat. Shikojeni një çikë përvojën e kësaj gazete ju shokët e rretheve të tjera.

Nga Lushnja je ti, shoqja Lenkë?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Po, shoku Enver, nga Krutja.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ke qenë ti në Krutje kur kam ardhur unë atje?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Po, shoku Enver, në shëpinë tonë keni ardhur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Posi, më kujtohen plaku yt dhe plaka.

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Ata ishin vjehrrri dhe vjehrra.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ke dhe një motër më të madhe?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Jemi shumë moltra, shoku Enver, por ajo që takuat ju në shtëpi dhe që keni dalë në fotografi është vajza e kunatit

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vajza e kunatit ka qenë

ajo! Po kemi ngrënë edhe bukë atje. Më kujtohet se qëndruam në një dhomë që vinte një çikë si e gjatë. Po ne qenkemi miq të vjetër, moj shoqja Lenkë, prandaj aq më tepër duhet të luftojmë për këto që thamë. Më kujtohet që atje kam vizituar edhe stallat. Po lopëve ua vazhdoni muzikën, që e pëlqejnë aq shumë, apo jo? Lopët e kanë shumë qejf muzikën.

Këtu në Sekretariat, për çlodhje, bëjmë nganjëherë edhe nga një muhabet të tillë.

*Në fund të diskutimeve shoku Enver Hoxha tha:*

Unë, shokë, nuk do të zgjatem shumë mbi nevojën e ngritjes së nivelit ideopolitik të gazetave lokale, për arsye se jam dakord me materialin e paraqitur, me mendimet që shprehën këtu shoku Ramiz [Alia], shokët sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve, që janë ftuar në këtë mbledhje, dhe shoku Xhelil Gjoni.

Siç dihet, gazetat e rretheve e kanë për detyrë të zbërthejnë vijën e përgjithshme të Partisë dhe direktivat e saj, duke i lidhur ngushtë këto me kushtet dhe me nevojat konkrete të rrethit dhe me karakteristikat e tij. Me fjalë të tjera, unë dëshiroj të shpreh mendimin që organet e shtypit lokal të shmangin sa më shumë spontancitetin dhe të mos shkruajnë vetëm për çka t'u dalë përpara. Ato duhet të synojnë arritjen e objektivave të caktuar me karakter edukues për disa probleme të rëndësishme që shqetësojnë rrethin. Gazeta «Zëri i popullit» vazhdimisht analizon e zbërthen direktivat e Partisë, por këtë detyrë me shumë rëndësi nuk e kryejnë çdo ditë në mënyrë sistematike edhe organet e shtypit të rretheve që u morën në shqyrtim.

Për problemet kryesore që do të trajtojnë, organet

lokale të shtypit duhet të orientohen nga vendimet e Partisë e të Qeverisë dhe të ndihmohen nga organet qendrore të shtypit, e veçanërisht nga gazeta «Zëri i popullit». Ju, shokë të rretheve, duhet të botoni në gazetën tuaj edhe disa nga artikujt e shtypit qendror dhe të mbani lidhje të vazhdueshme me këto organe. Edhe organet qendrore duhet të botojnë artikujt tuaj. Sot pashë në shtyp një shkrim kritik, marrë nga «Ushtima e maleve»<sup>1</sup>. Ai ishte shumë i bukur dhe mund t'u shërbente të gjitha estradave, sepse të tërë gabojnë kur përdorin humorin banal në skenë. Estrada ka karakter edukues, prandaj nuk duhet të përdorë shprehje banale.

Në gazetën e rretheve të shkruhet për problemet që kanë më shumë nevojë Partia dhe populli, duke parashtruar gjërat realisht, pra as në mënyrë krejt kritike, të zeza, as në mënyrë shumë lavdëruese. Në këto organe do të ketë doemos edhe kritikë për dobësitë e punës, do të ketë edhe lavdërime për sukseset që arrihen, por para së gjithash në to të shkruhet për thelbin ideologjik, politik dhe ekonomik të problemit që trajtohet. Këtë thelb e përgjithëson komiteti i Partisë i rrethit, duke vepruar kolegjisht. Problemi thelbësor, qoftë edhe një herë në muaj, përcaktohet nga rrethi i atyre çështjeve që shqyrton komiteti i Partisë dhe nga përfundimet që arrihen prej analizës së tij. Në këtë analizë do të dalë nëse problemi duhet rishikuar, nëse çështjet janë shtruar apo s'janë shtruar drejt, nëse detyrat zbatohen me përpikëri apo jo, nëse shtre-

---

1. Organ i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

mbërohet apo nuk shtrembërohet vija e Partisë etj.

Gazeta, si organ i komitetit të Partisë të rrethit, nuk duhet të jetë e mënjanuar nga puna e këtij komiteti. Nga gazetate lokale ne kemi mundësi të shikojmë edhe çështjen se si i trajton komiteti i Partisë i rrethit këto ose ato probleme. Se si drejtohen konkretisht gazetate në rrethe, këtë na e thanë shokët, nga diskutimet e të cilëve rezultoi se komitetet e Partisë interesohen në këtë drejtim.

Nga mënyra e të shtruarit të problemeve në gazetate e rretheve varet shumë kuptimi i drejtë i shkrimeve të tyre prej masës së komunistëve dhe të punonjësve, prandaj këto organe të shtypit duhet të jenë të vëmendshme në këtë drejtim, se janë një ndihmë e madhe për Partinë, për organet e saj udhëheqëse dhe për gazetën «Zëri i popullit», që, si organ i Komitetit Qendror të Partisë, përgjithëson direktivën në shkallë republike. Kjo gazetë ka një orientim të caktuar, se shkruan për të gjitha problemet: për kulturën, shkencën, arsimin, historinë, letërsinë, teatrin etj. dhe del çdo ditë. Gazetate e rretheve dalin dy herë në javë, kanë një tirazh më të kufizuar dhe faqet e tyre janë më të vogla, prandaj ju, shokë të rretheve, duke pasur parasysh këto rrethana, mos botoni artikuj të gjatë që t'u zënë tërë gazetën, ju nuk mund të shkruani për gjithçka që shkruan «Zëri i popullit», prandaj duhet të zgjidhni me kriter ata artikuj të shtypit qendror që mund t'i ribotoni.

Në gazetën «Shkëndija»<sup>1</sup> dhe në disa gazeta të rretheve të tjera, veçanërisht në gazetën «Pararoja» të

---

1. Organ i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

Gjirokastrës, nuk shikojmë të shkruhet, për shembull, për muzikën popullore. Muzika e rrethit të Lushnjës është e bukur dhe gazeta e rrethit tuaj, shoqja Lenka, duhet të shkruajë për të. Nuk them se ju nuk shkruani për festivalet, por e shtroj problemin që të shkruani më shpesh e më mirë për artin dhe për muzikën popullore.

Në qoftë se nuk gabohem, në gazetën «Drita» kam lexuar një shkrim interesant, i cili tregon për këngën e Myzeqesë që këndon Vaçe Zela, bashkë me të vëllanë. Ajo këndon me aq dashuri për Lushnjën e për lushnjarrët, për njeriun myzeqar dhe për fitoret e mëdha që janë arritur, sa njeriu emocionohet. Ju nuk e keni botuar në gazetën «Shkëndija» këtë shkrim, që do të shërbente, në radhë të parë, për të nxitur ngritjen e mëtejshme të nivelit të muzikës dhe, pastaj, për të propaganduar edhe artistin, edhe kompozitorin me shumë talent, Tish Daija, që e ka kompozuar këtë këngë. Kur them se ky është me shumë talent, këtë konkluzion e kam nxjerrë nga dëgjimi i shumë këngëve të kompozuar prej tij. Unë kam shumë këngë lushnjare të regjistruara, që i dëgjoj shpesh, por mbi të gjitha më pëlqen kompozimi i kësaj kënge. Në këtë këngë kompozitori, megjithëse është shkodran, ka përdorur me mjeshtëri intonacionet e të gjitha këngëve të bukura lushnjare, pra, ka përgjithësuar dhe ka ngritur në art këngën e popullit. Ky kompozim kaq i bukur duhet të shërbejë si një ndihmë e madhe, të cilën ju mund ta shfrytëzoni për t'i dhënë një hov krijimtarisë në fushën e muzikës.

Në Gjirokastrë, si kudo gjetkë, ka njerëz të specializuar në disa drejtime. Këta mund të shkruajnë në



gazetat për gjëra që janë interesante. I tillë është Lefter Diloja<sup>1</sup>, që merret me muzetë dhe me gjurmimet në këtë fushë. Mua më duket se bën mirë «Zëri i popullit» që boton shkrime të këtyre specialistëve. Lexova një ditë në gazetën «Zëri i popullit» artikullin që kishte shkruar Lefter Diloja për muzetë. Ai shkrim ishte shumë instruktiv dhe bënte fjalë si mund të pasurohen muzetë tona.

Kam lexuar edhe në gazetën «Pararoja» shkrime, që kanë një orientim të përcaktuar për të përshkruar gjallërisht jetën dhe historikun e një fshati apo të një krahine. Këto përshkrime janë aq të këndshme e tërheqëse, sa mund t'i lexosh me kënaqësi. Nga ato njeriu nuk mëson vetëm për urdhra e direktiva, të cilat janë të nevojshme, por zgjeron edhe horizontin kulturor.

Ka shumë këngë që këndohen në popull për njerëz të shquar të së kaluarës, pa ditur të gjithë se ç'kanë bërë e në ç'kushte kanë vepruar këto personalitete, të cilat populli i ka përjetësuar në këngën e tij gjatë shumë dekadave. Ndonjë historian e folklorist mund të mos i çmojnë disa që shkruajnë për këta njerëz të shquar të popullit, por, me aq sa munden, ata kanë gjetur njëfarë rruge për t'i bërë më të njohura figurat historike, që populli u këndon me dashuri. Kjo është një iniciativë që duhet inkurajuar. Ka njerëz që i vëzhgojnë me pasion këto këngë, duke kërkuar shumë materiale andej-këtej. Të dhënat historike për jetën e këtyre trimave të popullit dhe vargjet popullore më duket se ata i paraqitin mirë. Në këtë drejtim gazetat,

---

1. Në atë kohë drejtor i muzeve në Gjirokastër.

veçanërisht ato të rretheve, duhet të botojnë mjaft shkrime, se kështu bëhen interesante. Ndonjë historian mund të thotë se në disa shkrime nuk janë studiuar e nuk janë trajtuar thellë këto figura, atëherë le ta bëjnë më mirë këtë punë ata që janë më kompetentë, të cilët të ulen që të shkruajnë e të botojnë studimet e tyre për t'u njohur me to punonjësit e veçanërisht rinia.

Këngët popullore me të dhëna historike janë shumë odukuese, prandaj ato duhen bërë të njohura edhe nëpërmjet shtypit. Ja një ndër këngët e bukura të popullit që mbaj mend unë:

*«Qajnë malet e rënkojnë  
për hajdutët që venë e shkojnë,  
shkojnë e venë në Mesallonjë.»*

Këta hajdutë, siç quheshin luftëtarët popullorë në ato kohë, për të cilët qajnë e rënkojnë edhe malet, ishin patriotë, komitë, që vepronin në Shqipëri dhe në tërë Ballkanin për lirinë e popujve nga zgjedha turke.

Historia nuk është e pasur me figura të shquara vetëm për Gjirokastrën, për Dibrën apo për Elbasanin, por edhe për Lushnjën e për tërë rrethet e Shqipërisë. Lushnja ka me të vërtetë figura të reja të shquara, të cilat duhet t'i popullarizojmë, siç i kemi popullarizuar, por ka edhe ajo figura të njohura të kohëve të kaluara që janë dalluar në luftërat e zhvilluara kundër bejlerëve e feudalëve. Pra, si kudo, edhe ky rreth ka historikun e vet. Po në gazetën «Shkëndija» nuk më ka zënë syri shkrime me karakter historik, megjithëse kam mendim të mirë për të, sepse ajo boton artikuj me vlerë

dhe nuk merret me çikërrima. Edhe faqosja e kësaj gazete bëhet më mirë nga ajo e gazetave të tjera.

Pas gazetës suaj më duket se vjen «Kastrioti» i Krujës, që, ashtu si dhe shokëve të tjerë, edhe mua më pëlqen. Gazetat e rretheve të tjera, pa mohuar aspak vlerën e tyre edukuese, shkruajnë për një mijë gjëra, që nuk shërbejnë sa duhet, prandaj mendoj se redaksitë e tyre mund të organizojnë anketa me lexuesit për të konstatuar se si shfrytëzohen shkrimet e shtypit, çfarë vërejtjesh kanë ata për artikujt kryesorë ose për informatat që botohen etj.

Të tërë pamë në televizor një emision të posaçëm për Dedë Gjo Lulin. Në ekran na u paraqitën pleq patriotë, bashkëluftëtarë të këtij heroi, të cilët shprehën kujtimet e tyre interesante për të. Kjo është historia e gjallë e luftërave të mëdha të malësorëve tanë për liri e për pavarësi. Por, në gazetën «Jeta e re»<sup>1</sup>, nuk kam parë të shkruhen rubrika me tregimet e pleqve të mocëm, rreth njëqindvjeçarë, sepse nuk merr njeri mundimin të shkojë në fshatrat ku banojnë ata për të biseduar dhe për t'ua botuar kujtimet në gazetë. Unë u kënaqa kur i pashë e i dëgjova të flisnin aq shtruar këta pleq patriotë. Të gjithë sa ishim rreth e rrotull në shtëpinë time dëgjuam me vëmendje dhe na vinte keq që zëri nuk ishte regjistruar qartë dhe nuk kuptonim dot aty për aty ndonjë shprehje të tyre plot figura të bukura popullore. Njëri nga bashkëluftëtarët i kujtonte mirë fjalët e Dedës, të vëllait të këtij, si dhe të gjitha

---

1. Organ i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës.

ndodhitë e atyre viteve luftë kundër pushtuesve të huaj. Sa e thellë, e pasur dhe e lashtë është historia e popullit tonë! Gazeta, që e lexon çdo njeri, e ka për detyrë të shkruajë edhe për kujtimet e njerëzve që kanë marrë pjesë në ngjarjet historike.

Prandaj, shoqja Lenkë dhe ju shokë të tjerë, duhet të bëni më shumë përpjekje për ta trajtuar në shtyp temën historike, se njerëz që mund të shkruajnë keni, historinë plot luftëra të mëdha gjithashtu e keni. Luftë nuk është vetëm ajo që ka bërë populli kundër armiqve të huaj, por edhe ajo që është zhvilluar kundër bejlerëve e feudalëve, sidomos në Myzeqe. Në rast se gjeni njerëz të pasionuar, që të qëmtojnë nëpër arkivat, goftë edhe vetëm regjistrat e fajdeve e të vendimeve të gjyqeve që janë bërë në favor të feudalëve e të agallarëve për të grabitur fshatarët e Myzeqesë, ju do të jeni në gjendje të nxirrni fakte historike aq të rëndësishme e me vlerë edukuese, sa i riu apo e reja, kur t'i lexojnë në gazetë, do të kuptojnë çfarë vuajtjesh kanë hequr paraardhësit, gjyshërit dhe prindërit e tyre gjersa arritën në këto ditë të lumtura që jetojmë! Kështu ata do të kuptojnë se të mirat që gëzojmë sot nuk kanë rënë nga qiejt.

Për këto arsye ju, shokë të komiteteve të Partisë në rrethë, duhet të aktivizoni njerëz edhe në këtë drejtim, sepse shtypi qendror nuk ka mundësi të botojë në faqet e veta të gjitha sa ju nevojiten. Shtypi qendror do t'ju ndihmojë, por edhe ju ta ndieni veten si ndihmës të tij.

Në gazetatat lokale duhet të begenisin të shkruajnë edhe shokët shkrimtarë e gazetarë të qendrës, pavarë-

sisht se këto janë të rretheve e dalin me një tirazh të kufizuar prej 2 000 apo 3 000 kopjesh.

Shoku Xhelil Gjoni, gjatë diskutimit të tij, tha se i njeh mirë çështjet e rrethit të Dibrës, se andej është dhe ka përshtypjen që shpesh në gazetën e këtij rrethi nuk bëhet një trajtim i mirë ideor i problemeve që analizohen. Midis të tjerash, Xhelili zuri në gojë edhe çështjen e kolektivizimit në Dibër. Shoku Hekuran Isai, që ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës, na ka ndihmuar shumë për ta njohur më mirë situatën në atë rreth. Në këtë drejtim na kanë ndihmuar edhe disa raporte që kemi marrë për situatën në Dibër.

Si në tërë Shqipërinë edhe në Dibër kolektivizimi i bujqësisë ka ecur përpara. Atje janë bërë edhe bashkime kooperativash, por nuk është punuar në mënyrë të tillë që këto bashkime t'i kuptojë drejt tërë masa e fshatarësisë kooperativiste, sepse nuk janë pasur parasysh mentalitetet e ndryshme politike dhe ideologjike të kooperativistëve të kooperativave që janë bashkuar. Mua më duket se nuk është shikuar drejt që në fillim çështja nëse kanë qenë të përgatitur plotësisht kooperativistët për këtë bashkim, apo duhej bërë më parë një punë politike më e gjerë, më e shtruar e më këmbëngulëse. Këto të meta nuk mund të ndreqen me masa administrative, por me punë bindëse, prandaj gazeta e rrethit të Dibrës duhet t'i pasqyrojë më mirë problemet e kolektivizimit, mendimet e drejta që jepen dhe analizat e përpjekjet që duhet të bëjnë komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit për t'i konsoliduar këto kooperativa. Duhet të veprohet kështu, pse aktualisht ekzistojnë keqkuptime të karak-

terit politiko-ideologjik, që pasqyrohen edhe në praktikë. Këto keqkuptime pengojnë zhvillimin e drejtë dhe normal të kooperativave bujqësore.

Konkretisht ekziston mentaliteti i përgjithshëm që kooperativistët e malësisë, që janë bashkuar me ata të fushës, mund të ushqehen nga këta të fundit! Ky mentalitet është i dëmshëm dhe frenues për ecjen përpara të kolektivizimit. Shokët e Partisë dhe të pushtetit në rrethet ku ka shfaqje të tilla nuk ua kanë bërë të qartë që në fillim malësorëve që u bashkuan me fushën, se ata nuk duhet ta presin shtimin e të ardhurave nga shokët e tyre të fushës. Shokët drejtues të këtyre rretheve nuk i kanë trajtuar këto çështje ideologjike politike edhe në gazetatat lokale.

Në rrethanat e sipërme duhet kuptuar drejt problemi i punës kolektive, që të trajtohet në gazetë në platformën ideologjike e politike, bile jo një herë, por shumë herë. Kini kujdes që kritikën në drejtim të shfaqjeve negative të punës së veçuar, të parazitizmit etj. t'i drejtoni edhe kundër koncepteve prapanike e jo vetëm kundër bartësve të tyre, me qëllim që ato të mos kuptohen si fyerje nga ky apo ai malësor, nga kjo apo ajo kooperativë e malësisë. Duhet të veproni kështu, sepse ju e njihni fare mirë ndjeshmërinë e malësorëve tanë. Të mos mendojmë se të tërë malësorët janë të edukuar si marksistë-leninistë në qëndrimin ndaj kritikës. Jo, ata preken shumë lehtë, prandaj duhet pasur parasysh që, në marrëdhëniet me ta, pa hequr dorë nga kritika, të gjejmë formën e përshtatshme të komunikimit, me qëllim që t'i bindim, duke goditur anët negative dhe duke çmuar anët e mira të tyre.

Vjedhja nuk është një karakteristikë e popullit shqiptar. Megjithëkëtë, për fat të keq, vërtetohen përvetësime e dënime të pasurisë socialiste në kooperativat bujqësore. Ky fenomen negativ duket në disa fshatra. Ne kurdoherë do t'i kritikojmë dhe do t'i ndëshkojmë vjedhjet dhe vjedhësit, por e kemi për detyrë të gjejmë edhe shkaqet e vërteta përse vidhet, veçanërisht kur dihet që në vendin tonë ka fshatra që nuk kanë vjedhur kurrë, mbasi akti i vjedhjes për ta ishte një turp i madh.

Në disa krahina të Shqipërisë, para Çlirimit, ishte e përhapur vjedhja. Kjo kishte arsyet e veta. Sipas të dhënave që ka Partia, në këto krahina tash vjedhjet kanë rënë shumë, por nuk mungojnë raste kur në disa fshatra ka njerëz që dëmtojnë pasurinë kooperativiste, bile në këtë drejtim shtyjnë më shumë fëmijët. Çfarë vidhet? Çfarë dëmtohet? Prodhimet bujqësore, diku pemët, diku ca kallinj misri, këtu ca fasule, atje fiq, rrush etj. Këto janë probleme shoqërore që, siç u tha këtu, e shqetësojnë njaft Partinë. Për këto shfaqje antisocialiste shumë herë bëhen mbledhje dhe analiza, por të mos kënaqemi vetëm me numrin e mbledhjeve dhe të analizave. Puna është të shikojmë çfarë nxjerrim prej tyre.

Le të marrim edhe një çështje tjetër, për shembull, atë të pjesëmarrjes së pamjaftueshme në punë në kooperativat bujqësore. Në rrethe, si Dibra etj., janë mijëra veta në marrëdhënie pune me shtetin, që realizojnë më shumë të ardhura për çdo vit sesa kooperativistët.

Kooperativisti që ka dy ose edhe tre pjesëtarë të familjes në marrëdhënie pune me shtetin, në kooperativë vete të punojë, siç i thonë fjalës, sa për «tabako»,

sa për të blerë duhanin, kurse bagëtitë e tij i lëshon natën për të kullotur në arat e kooperativës! Shumë nga dëmtimet në bujqësi shkaktohen nga bagëtitë vetjake të kooperativistëve, që kullotin në arat e kooperativës. Këto bëjnë të ulet vlera e ditëve të punës. Nga oborri kooperativist, që i kushtohet vëmendje më tepër, merren prodhime bujqësore me vlerë rreth 7 000 lekë në vit, prandaj, në vend që kryesore për ekonominë familjare të jenë të ardhurat nga prona kooperativiste, këto bien në plan të dytë dhe dobësohet në këtë mënyrë kuptimi politik-ideologjik i kolektivizimit. Këtej del nevoja e marrjes së masave me karakter edukativ, me përmbajtje të thellë ideopolitike dhe jo me karakter administrativ.

Ju, sigurisht, shkruani të gjithë në gazetën lokale për problemet e bujqësisë e të blegtorisë, por nuk shpjegoni si është e mundur që, gjatë vitit 1974, në një rreth si Dibra, me më shumë se 126 000 krerë dhen e dhi, vetëm rreth 30 000 krerë kanë kooperativat, kurse mbi 95 000 prej tyre janë të oborreve kooperativiste!! Mund të na thuhej se këto bagëti nuk janë mbajtur në kundërshtim me Statutin tip të Kooperativave Bujqësore (pavarësisht se ka edhe familje që i kanë mbajtur në kundërshtim me statutin), por tani nuk diskutohet kjo çështje. Bagëtitë e shumta të oborreve mbahen në kurriz të kooperativës bujqësore. Ky është një konstatim i vërtetë, se është e pamundur që një sasi kaq e madhe e tyre të ushqehet vetëm me prodhimet e sipërfaqeve të oborreve.

Partia ka lëshuar direktivën për organizimin e tuftave kolektive të bagëtive të oborreve kooperativiste



dhe për kullotjen e tyre nga dy-tre çobanë. Këtë gjë e kanë pasur traditë sidomos në Jug të Shqipërisë, por edhe në Dibër. (Po marr më shumë shembuj për Dibër, se kam parasysh një raport që i ka ardhur Komitetit Qendror. Dibra ka edhe shumë anë të mira për të vënë në dukje dhe e vërteta është se dibranët kanë ecur përpara, por po përmend disa fenomene që duken atje, se dua t'i lidh me ngritjen e nivelit idcopolitik të shtypit.) Kjo direktivë e Partisë, që deri diku është harruar, duhet të vazhdohet të zbatohet. Ka rrethe, dhe sidomos disa krahina, që e kanë vënë në jetë këtë direktivë të Partisë. Shoku Hekuran [Isai] na paraqiti shembullin e kooperativës bujqësore të Pogonit, ku atë e kanë zbatuar në mënyrë, bile, të përsosur, duke i shkuar deri në fund kësaj çështjeje me rëndësi të madhe jo vetëm ekonomike.

Mbajtja e përbashkët e bagëtive të oborreve ndikon në rritjen e prodhimit blegtoral dhe të mirëqenies së kooperativistëve e të popullit, por ajo që ka edhe më shumë rëndësi, heq kujdesin e tepruar të kooperativistëve nga ato 10 krerë dele dhe e përqendron vëmendjen e anëtarëve, në radhë të parë, te puna në kooperativë, që është burimi kryesor i të ardhurave për jetesën e familjes kooperativiste. Kështu oborri i vogël do të shërbejë sa për ta ndihmuar ekonominë e kooperativistit me disa prodhime plotësuese, si grurë, misër, elb, patate e të tjera e jo për të siguruar jetesën e tij. Ana tjetër e çështjes, që ka, gjithashtu, shumë rëndësi për një përdorim të drejtë të punës në kooperativë, është ajo që, nëpërmjet saj, forcohet ndjenja e kolektivitetit. Vetë kooperativa do t'i furnizojë anëtarët e saj

me qumësht, lesh e mish më shumë nga ç'kanë këta tash që i mbajnë kafshët në pronësi vetjake. Kooperativistëve do t'u jepen para për bagëtitë e oborrit, sepse kooperativa do t'i shumojë bagëtitë e saj, sidomos duke blerë bagëtitë e shtuara edhe të këtyre oborreve. Kështu do të zhduket fryma mikroborgjeze e fshatarit, që ngrihet nga fshati e shkon në qytet për të shitur në pazar kecat e qengjat e oborrit.

Këto probleme duhen trajtuar në mënyrë politike, teorike, organizative, në shtypin e rretheve që analizohen këtu dhe në atë të rretheve të tjera. Duhet marrë masa me karakter edukimi për një sërë çështjesh. Në këtë drejtim një rol të madh duhet të luajnë gazetat e rretheve, të cilat, e përsëris, nuk duhet të merren vetëm me informacione të vogla. Shembujt pozitivë duhet të bëhen të njohur në shtyp jo duke i shtruar në mënyrë thjesht kronikale, por duke i zgjedhur me kujdes dhe duke i ngritur në një pedestal politiko-teoriko-organizativ.

Kam bindjen e plotë se gazetat lokale do të ecin edhe më shumë përpara. Aktualisht rrethet kanë forca mendore e organizative të fuqishme që ta përmirësojnë shumë punën e organeve të shtypit. Ne do t'i ndihmojmë ato edhe teknikisht, siç tha shoku Ramiz.

Këto kisha për të thënë, shokë. Jemi dakord?

Atëherë, mirë, مبارام.

*Botuar për herë të parë me ndonjë shkurtim, në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 373*

*Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbalu i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## KOOPERATIVAT E TIPIT TË LARTË NGRIHEN PËR TË SHTUAR PRODHIMET

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 shtator 1975

Vërehen në rrethin tuaj, shoqja Lenka [Çuko], fenomene të dhënies llogari më pak nga kuadrot kryesorë? Në rast se po, pse ngjet ky fenomen? Mos ekziston akoma ideja që «Unë jam më lart, jam i paprekshëm»? Natyrisht, unë e kuptoj se kjo shfaqje nuk manifestohet në mënyrë flagrante.

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Edhe në rrethin tonë ka fenomene të tilla. Ka kuadro të cilët nuk e kuptojnë se janë shërbëtorë të popullit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dëshiroj të të pyes për diçka jashtë këtij problemi. E kam fjalën për kooperativat e tipit të lartë, në investimet e të cilave merr pjesë edhe shteti. Çfarë mendimi ekziston në bazë për

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe se si po realizohet ideja e shokut Enver Hoxha në fjalimin e mbajtur në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit për dhënien llogari të kuadrove para masës.

pjesëmarrjen e shtetit dhe për ndihmën nga ana e tij për kooperativat bujqësore të tipit të lartë? Çmohet e mjaftueshme nga kooperativistët kjo ndihmë e shtetit apo, meqenëse është e vogël ose meqenëse nuk jepen materialet e nevojshme në investime e të tjera, nuk çmohet dhe mendohet se asgjë nuk u fitua, por u ndërruan vetëm tabelat?

Çfarë mendimi keni formuar ju, është efektive kjo ndihmë, a përdoret kjo për investimet prodhuese? Bëhet propagandë nga Partia në radhët e kooperativistëve për vlerën e ndihmës shtetërore për fuqizimin e bazës materialo-teknike e për përsosjen e drejtimit organizativo-ekonomik? Natyrisht, kontributi i shtetit në investime edhe për mjaft kohë nuk mund të barazohet me atë të kooperativës, se të ardhurat e kooperativës janë shumë të mëdha. Mund të na thuash ndonjë ide për sa të pyeta që të na ndihmohet? Unë po të pyes se na kanë ardhur disa raporte sikur kjo ndihmë nuk para duket. Mund të mos duket kjo tani, sepse shteti ynë akoma nuk i ka ato pozita ekonomike sa pjesëmarrja e tij me mjete të pakthyeshme të arrijë për këto kooperativa gjysmë për gjysmë e më shumë, por kjo ndihmë, sidoqoftë, duhet të ndihet. Ajo do të vijë duke u fuqizuar për të shpejtuar zhvillimin dhe intensifikimin e prodhimit bujqësor, por edhe për të pleksur e për të çuar përpara marrëdhëniet ekonomike në kooperativat. Mundësitë më të mëdha të shtetit t'i përdorim duke i hedhur sytë edhe nga perspektiva e rendit kooperativist.

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Me aq sa di unë, atje ku kam qenë, te masat kooperativiste është formuar bindja se ndihma e shtetit, aq sa është dhënë, ka qenë e kon-

siderueshme në kooperativat e tipit të lartë në krahasim me kooperativat e zakonshme. Vetë kooperativistët e ndiejnë që këtu, me të vërtetë, ka vënë dorë shteti.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Prandaj, siç e thashë, ju, sigurisht, po shpjegoni që t'i bindni edhe ato «kokat e sëmura» se kjo ndihmë e shtetit nuk është si «gozhda e Nastradinit». Ngritja e zhvillimi i kooperativave të tipit të lartë është një hap novator i Partisë sonë. Investimet që i jep, për shembull, kooperativës bujqësore të Krutjes shteti, nuk i merr në fund të vitit, por i lë prapë atje. Në qoftë se ju përpara linit në fondin e paprekshëm të kooperativës 25 për qind të të ardhurave, tani, me gjithë investimet e shtetit, bëhen 29 ose 32 për qind. Këtu është edhe kuota e shtetit, i cili nuk e merr më atë nga kooperativa, por e lë atje për zhvillimin e mëtejshëm e me ritme më të shpejta të prodhimit. Interesi i shoqërisë, por edhe i kooperativistëve, është që t'i marrim sa më shumë prodhime tokës dhe mbi këtë bazë të përmirësohen kushtet e jetesës në zonat fushore, por të krijohen edhe mundësi më të mëdha financiare për të ndihmuar përparimin e zonave kodrinore e mallore.

Kini kurdoherë parasysh mësimet e Leninit se duhet luftuar vazhdimisht kundër pikëpamjeve e mbeturave mikroborgjeze të fshatarësisë. Fshatarësia me shekuj i ka urreyer bejlerët, feudalët, fajdexhinjtë, nëpunësit gjakpirës, prandaj ruhej nga borxhet. Ai mentalitet, ai atavizëm nuk i është zhdukur akoma kooperativistit. Ka njerëz që thonë se kjo pjesëmarrje e shtetit është një «gozhdë e Nastradinit», ashtu siç ka të tjerë që thonë se investimet e shtetit në formën e pjesëmarr-

jes janë të vogla! Mua më kanë thënë se një ish-kryetar kooperative është shprehur se kjo punë është vetëm «ndërrim tabelash». Por kjo nuk është ashtu si thotë ai, përkundrazi, është një perspektivë e ndritur që u hapet kooperativave. Forma e kooperativave të tipit të lartë do të shtrihet më tej kryesisht në fushë, por edhe në zonat e tjera. Ky proces do të plekset me tërë përpjekjet e synimet e Partisë për intensifikimin e bujqësisë dhe për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në fshat. Në pesëvjeçarët e ardhshëm këto procese ekonomiko-shoqërore në fshat do të zgjerohen dhe do të fuqizohen. Por kjo varet shumë edhe nga kuptimet e drejta sot, nga efektiviteti i investimeve që po bëjmë, nga hapat praktikë për përsosjen e marrëdhënieve në kooperativa.

Desha të vë në dukje se në disa rrethe (nuk flas për rrethin e Lushnjës) e kanë shkelur një çikë gazin për ngritjen e kooperativave bujqësore të tipit të lartë. Në të ardhmen do të bëjmë më shumë, sepse është më e favorshme që te prona e të gjithë popullit të vemi nëpërmjet pleksjes së marrëdhënieve shtet-kooperativë. Por unë e kam fjalën për sot që të ecim me hapa të matur mirë. Direktiva ka qenë që të formohen kooperativa bujqësore të tipit të lartë në fusha dhe, nevojisht, më vonë, mund të futim në këtë formë edhe kooperativa kodrinore apo malore. Po të ecim me kaq nxitim, natyrisht, edhe ndihma e shtetit aktualisht nuk mund të jetë aq sa duhet. Gjithashtu lypset të kenë parasysh se kooperativat e tipit të lartë nuk u krijuan që të zhvillohet një diferencim i madh artificial në mirëqenien e kooperativistëve, por që kooperativistët të shikojnë

se kooperativa e tipit të lartë u jep më shumë mundësi për të shtuar prodhimet e për të rritur të ardhurat për vete e për shoqërinë. Kështu, në qoftë se vitin e kaluar morën, fjala vjen, në Krutje 14 lekë për ditë-punë, tani duhet të marrin 15 lekë, kurse vitin tjetër — 16 lekë. Por edhe në këtë drejtim duhet të orientohemi nga një kufi, siç është paga që japim në ndërmarrjet bujqësore. Kjo do të thotë se në kooperativat e tipit të lartë, siç jep ndihmë shoqëria për prodhimin, do të tërhiqet më shumë edhe produkt për shoqërinë, ose do të përsoset ndonjë formë tjetër e shpërndarjes që lidhet me kushtet sociale të kooperativistëve.

Kisha edhe një pyetje tjetër: Mos ka mosmarrëveshje në mes kooperativave bujqësore të tipit të lartë dhe SMT-ve, në kuptimin që këto të fundit të mos zbatojnë detyrat e tyre sipas agroteknikës që kërkojnë kooperativat? Domethënë, a ka raste të tilla që SMT-ja të refuzojë plotësimin e kërkesave të kooperativës, duke pretenduar se ajo ka planin e vet?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Ne nuk kemi pasur. SMT-ja u nënshtrohet urdhrave të agronomit që të bëjë punimet siç i kërkojnë rregullat agroteknike.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, të mos zgjatemi në këtë drejtim, por të vijmë në problemin tonë, se kjo çështje, siç thashë, ishte jashtë temës.

*Pasi diskutuan edhe pjesëmarrës të tjerë të mbledhjes, në fund, shoku Enver Hoxha tha:*

Kontrolli i zbatimit të vendimeve duhet të bëhet i vazhdueshëm. Kur themi kontroll i zbatimit të vendimeve, kjo do të thotë që të japësh llogari pse nuk u bë kjo ose ajo punë në afat, se nuk mund të presësh

vetëm fundin e vitit për të kontrolluar e për të raportuar.

Atëherë me kaq i dhamë fund diskutimit të problemeve që kishim në rendin e ditës. Ju urojmë suksese në punë!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*



## **DREJTUESIT TË MERREN ME ÇËSHTJET MË TË RËNDËSISHME, JO ME HOLLËSIRA**

*Nga biseda në takimin ditor me sekretarët  
e KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**30 shtator 1975**

Në raportin e përgatitur nga disa kuadro të sektorit të naftës bëhet përsëri autokritikë për të njëjtat çështje. Kam mendimin se kështu spekulohet me autokritikën. Ajo është një formë pune e mirë, por, natyrisht, kur ruhet masa. Kryesorja për të punuar si duhet nuk është autokritika, kërkohet të mos bëhen gabime ose të bëhen sa më pak që të jetë e mundur. Pra, rëndësi ka të mos përsëriten gabimet, pse edhe autokritika prej tyre rrjedh. Kështu, sa më pak gabime, aq më pak autokritikë, kurse sa më shumë gabime, aq më shumë autokritikë. Kjo e dyta nuk është aspak e mirë, pse një-rëzit pastaj pandehin se gabimet i lajnë me autokritikë.

Kam marrë një letër ku autori më njofton se të

---

1. Në këtë takim u diskutua rreth një informacioni të dhënë nga shoku Haki Toska, ku flitej edhe për problemet e naftës.

afërmit që ai ka me biografi të keqe na i paska shkruar në biografi dhe këtë e quan justifikim, «autokritikë». Një gjë të tillë nuk e thotë vetëm ai, por edhe njerëzit rreth tij. Si rrjedhim, të gjithë e flenë mendjen, gjë që nuk është hiç e drejtë. Vërtet ky njeri e ka shkruar në dokumente këtë fakt, por ai vete dhe vjen me të afërmit që i ka shkruar në biografi. Atëherë ç'na hyn në punë kjo e shkruar?

Shokët e sektorit të ushtrisë thonë se për zbatimin e rregulloreve po i pengon Ministria e Mbrojtjes, që nuk i ka aprovuar. Së pari, kjo ministri nuk duhet ta zvarritë çështjen. Por veç mungesa e rregulloreve të mos i bëjë kuadrot në bazë që të presin e të mos veprojnë, duke thënë: «E po dale, se s'kemi rregulloret», «s'kemi çdo gjë të kodifikuar». Ata le të vazhdojnë të punojnë me projektet që janë përgatitur dhe të mos justifikohen se punët gjoja nuk po u shkojnë mirë ngaqë mungojnë rregulloret, për daljen e të cilave, sigurisht, mban përgjegjësi Ministria e Mbrojtjes.

**Qëllimi i rregulloreve duhet të jetë kontrolli i zbatimit të detyrave dhe zhvillimi i iniciativës, se më duket që jemi të njëanshëm në hartimin e rregulloreve, duke kërkuar që të vihet në to çdo gjë, deri edhe lëvizjet e sondës. Kjo do të thotë t'i bësh njerëzit robotë. Mund të aprovosh një rregullore shumë të detajuar, me një mijë e nëntëqind e kusur nene, duke iu referuar asaj për çdo gjë, që të mos të të lejojë të lëvizësh as gishtin pa pasur parasysh atë. Një material i tillë nuk do të ishte më një rregullore. Rregullorja duhet të japë parimet e përgjithshme, orientimet bazë të punës që duhet kryer. Prandaj jo çdo hollësi, që s'të lë asnjë lloj inicia-**

tive, duhet futur në të. Në rregulloret për punën e sektorit të naftës e të minierave, për shembull, nuk duhet dhënë çdo hollësi për karotazhin, se si duhet të hyjë e të lëvizë dhe ku duhet të ruhet një sondë, deri edhe se si duhen shtrënguar bulonat e saj. Rregullore të tilla do të pengonin punën dhe me këtë do të justifikonim veten se çdo gjë e kemi parashikuar.

Të gjitha këto që kanë ngritur shokët e sektorit të naftës a ia kanë raportuar më parë ministrin të Industrisë dhe të Minierave? Këtë e them se shokët vijnë e na zbrazen këtu, në Komitetin Qendror të Partisë, për gjithë ato hollësi që u thanë, pa biseduar vetë me ministrin. Kjo konkretisht do të thotë: «Fol ti me ministrin» ose ta bëjmë ne punën e tyre.

Tani që kuadrot e Institutit të Naftës janë pakësuar, drejtorja e këtij instituti ankohet se «Ata që kanë ikur nuk vazhdojnë të bëjnë studime», se «nuk aktivizohen në këtë drejtim» e të tjera. Mirëpo shokët e institutit duhet të thonë më përpara se si e bëjnë vetë këtë punë, si e kanë organizuar dhe si i caktojnë temat; cilët janë ngarkuar dhe për çfarë temash; kur dhe ku e çfarë ndihme u kanë dhënë shokëve. Mendoj që këtyre njerëzve u duhet vënë fre në raportimet që bëjnë. Si mund të kërkojnë të caktohen tema, kur nuk është organizuar kjo punë? Një kuadri do t'i ngarkosh një temë që ka lidhje me vendin dhe me territorin ku punon dhe jo t'i vihet gishti një inxhinieri gjeolog, për shembull, në Lushnjë, të përgatitë tema e studime për zonën e Vlorës.

Kur kërkojmë nga baza për të na raportuar për gjendjen, u duhet thënë atyre që të vijnë të na flasin për dy-tri çështje dhe të porositen në mënyrë të qartë

që, për sa do të na informojnë, t'i çojnë gjërat deri në fund. Ne nuk mund të lejojmë që të na vijnë e të na raportojnë këtu për çdo gjë, deri edhe për grumbullimin e hekurishteve të vjetra, kur këto fare mirë mund të mblidhen me anë aksionesh nga populli i rrethit. Udhëheqësit nuk duhet të merren me të gjitha gjërat e vogla.

Neve nuk na duhen llafe, po të na bëhet e qartë se cilat janë fushat e reja të naftës për vitin 1976. Të mos lejohen shokët e sektorit të naftës të flasin pa baza se paskan 15-16 fusha të reja në studim, po të na thonë se cilat janë konkretisht këto fusha dhe sa tonë do të marrim prej tyre gjatë vitit 1976.

Ajo që ju kanë thënë se në drejtorinë e Institutit të Naftës s'ka debate, nuk duhet lejuar. Atje duhet të ketë patjetër debate, dhe bile këto të organizohen shkencërisht. Debatet shkencore duhet të çojnë në konkluzione. Për shembull, për të përcaktuar sasinë e naftës që do të merret në vitin 1976, duhet diskutuar gjerësisht e mbas debateve të shumta të thuhet konkretisht se sa tonë naftë do të merren. Po nuk u bë kështu, atëherë për çfarë na duhen debatet? Jo, këto të mos zhvillohen për gjëra të vogla, ashtu si bëheshin përpara, por që, me sa duket, kështu po bëhen edhe tani. Kjo gjë nuk duhet lejuar. Të ndryshohen fryma, metoda e stili në punë, pastaj të flitet për rregulloret. Me një metodë e stil revolucionar në punë duhen kapur gjërat më kryesore e më të domosdoshme, si: e para, të ulim deficitin e vitit 1975; e dyta, si do ta realizojmë planin e vitit 1976; e treta, si do të studiojmë dhe të saktësojmë planin perspektiv pesëvjeçar dhe si do ta sigurojmë plotësimin

e nevojave për karburant, jo vetëm të vendit, por edhe të eksportit.

Mos mendoni, shokë, që të gjitha këto materiale të Partisë<sup>1</sup> që u lexuan, që u studiuuan e u ristudiuuan, u kuptuan nga të gjithë.

Pse na ndodhën gjithë këto gjëra? Një nga konkluzionet e rëndësishme është se ka ndikuar praktika që kanë ndjekur dhe ndjekin armiqtë për të na tërhequr vëmendjen në gjëra të vogla e për të harruar të mëdhatë, çështjet parimore. Në këtë rrugë vepronin armiqtë Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Beqir Balluku e të tjerë. Ata na mbytnin me vogëlsira dhe donin që ne, duke u marrë me gjëra të vogla, të harronim kështu të mëdhatë. Ja, e njëjta praktikë vazhdon të ndiqet në naftë, duke na nxjerrë çështjet e vogla në plan të parë. «Po mbledhim hekurishtet», thonë atje, të cilat, siç theksova, mund të mbliidhen fare mirë me aksione nga rrethi, nga vetë populli. Por, duke u marrë drejtuesit e këtij sektori jetik me çështje të tilla, atëherë kush do të merret me punën për realizimin e planit të naftës?!

Ne duhet të kërkojmë të informohemi për gjëra që janë të rëndësishme dhe që qëndrojnë. Armiku Abdyl Këllezi, kur u kthye nga Kina, informoi Byronë Politike se të gjitha pjesët që nevojiten për naftën i kemi siguruar. Në fakt, deklaroi tani armiku Koço Theodhosi, kur erdhën listat nga Kina, pamë se ato nuk ishin siguruar. Atëherë, sipas tij, Koçoja paska shkuar tek Abdyl Këllezi dhe i ka thënë se ato që kishte de-

---

1. Materialet që bëjnë fjalë për punën armiqësore në sektorin e naftës.

klaruar në mbledhjen e Byrosë Politike nuk figurojnë në listë. Abdyl Këllezi e porositi Koçon të mos bënte zhurmë, se ato do të siguroheshin me valutë të lirë në Perëndim. Pra, Koço Theodhosi e paskësh kuptuar dallaveren e Abdyl Këllezit, por për arsye se ishte vetë armik, ai nuk bëri zë. Po organizata e Partisë pse nuk na informoi, pse nuk e zbuloi këtë dallavere? Koço Theodhosi tash e thotë troç se nuk ka pasur besim tek organizata, nuk ka pasur besim te vija e masave, nuk ka pasur besim tek udhëheqja. Konkluzioni që duhet të nxjerrim nga e gjithë kjo ngjarje është që të mos mbulohen gjërat e mëdha me vogëlsira.

Udhëheqja e Partisë duhet të zbërthejë direktivat në formë orientimesh, sepse ajo nuk mund të parashikojë gjithçka për çdo sektor e ndërmarrje. Edhe sikur të donte, nuk do të ishte në gjendje ta bënte dot këtë, po edhe po të përpiquej, do ta bënte të çalë dhe nuk do t'u linte të tjerëve mundësi që të mendonin. Udhëheqja kryesore e Partisë dhe e shtetit nuk mund të caktojë edhe gjërat më të imëta, konkretisht për çdo ndërmarrje, fabrikë apo uzinë.

Udhëheqja e Partisë në qendra pune e prodhimi, pasi merr direktivën, mendon, në radhë të parë, për njerëzit që do ta zbatojnë atë. Ajo duhet të mbajë parasysh çfarë kanë pozitive punonjësit, që janë optimistë e të papërtuar. Atëherë çfarë mbetet për të bërë? Mbetet që të studiojë më shumë marksizëm-leninizmin. E keqja është se në këtë çështje kryesore disa e fillojnë studimin nga Marksi, nga «Kapitali». Kjo, natyrisht, ka të mirën e saj, por mendoj që nëpërmjet «Kapitalit», derisa të vijnë te direktiva konkrete për ta

kuptuar atë drejt, do t'u duhen disa vjet. Për këtë arsye studimin secili duhet ta fillojë nga përvetësimi me rrënjë i mësimëve të Partisë, që janë, gjithashtu, zbërthime të mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

Pra, direktiva duhet të studiohet teorikisht dhe praktikisht, në lidhje të ngushtë me mësimet e Partisë. Pas kësaj, sekretari që e di ku «i dhemb» ndërmarrjes së tij, cakton metodën dhe stilin e punës për të realizuar në jetë direktivën. Kjo metodë dhe ky stil pune nuk mund të jenë të njëlojtë për çdo ndërmarrje, kooperative, kolektiv. E përbashkët është vetëm çështja që kudo duhet të ketë metodë dhe stil revolucionar pune. Kushtet në secilin kolektiv janë të ndryshme. Një ndërmarrje ka makineri më shumë, tjetra më pak; njëra e realizon planin me pak mundim, tjetrës i duhet më shumë mobilizim; njëra përdor disa mjete, tjetra përdor të tjera. Pra direktiva realizohet nga të gjithë, por në rrugë e forma të ndryshme. Metoda, stili dhe fryma revolucionare kanë rëndësi të dorës së parë.

Konstatoj se po shkruhet shumë për letrën që u dërgova grave kooperativiste të kooperativës së tipit të lartë të Këmishtajt dhe grave të dalluara të kooperativave bujqësore të rrethit të Lushnjës, por duhet pasur parasysh që detyrat e parashikuara në këtë letër të zërthehen dhe të bëhen përpjekje për t'i realizuar gjatë punës për plotësimin e planit të vitit 1976. Po nuk ndryshuan punët drejt ecjes përpara, atëherë kjo gjë s'do të jetë aspak e mirë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## ARMIKUN TA GODASIM PA HEZITIM

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës*

30 shtator 1975

*Me rastin e 26-vjetorit të themelimit të RP të Kinës, ambasada kineze dha një pritje në hotel «Dajti». Gjatë darkës shoku Enver Hoxha, pasi uroi ambasadorin për festën, zhvilloi me të një bisedë, ku, ndër të tjera, tha:*

Nëpërmjet agjencisë HSINHUA kemi marrë vesh se moti sivjet ka qenë i mbarë dhe keni marrë përsëri të korra të bollshme, megjithëse në disa zona ka pasur edhe thatësirë. Këtë vit te ne moti ka qenë më i nxehtë. Mirëpo duhet shi, se kjo kohë me thatësirë që po vazhdon, nuk bën mirë për bujqësinë. Vetëm për pambukun është i mirë moti me diell.

Me grurin, me gjithë thatësirën e këtij viti, jemi më mirë se vjet, kurse me misrin nuk jemi aq mirë. Por realizimi i prodhimit sivjet varet shumë edhe nga misri. Thatësira na ka shkaktuar dëme. Dimrin e kaluar moti ishte pa shi dhe rezervuarët nuk u mbushën si zakonisht. Pothuaj gjatë gjithë dimrit nuk pati fare dëborë dhe, po nuk ra dëborë në male, nuk ka ujë të mjaftueshëm në verë për të ujitur bimët bujqësore. Si



rrjedhim, gjatë gjithë verës patëm rënie të konsiderueshme të nivelit të ujërave në rezervuarët. Megjithatë nuk dëshpërohem, po luftojmë me të gjitha forcat kundër thatësisë. Komunistët kurrë nuk duhet të dëshpërohen. Te ne ka ujëra nëntokësore, por ato janë të pamjaftueshme. Në disa rrethe, si në Korçë etj., ka ujë, kurse në disa të tjera, me gjithë kërkimet, rezulton se nuk ka në sasi të mjaftueshme.

Shqipëria, me përjashtim të zonës bregdetare, është vend malor. Duke qenë e tillë, ne bëjmë përpjekje për të siguruar ujë, por duhet të krijojmë edhe mundësi të tjera që atë që kemi ta vëmë në dispozicion të bujqësisë. Për këtë qëllim na vihet detyrë të sigurojmë edhe tubacione, të bëjmë investime etj. Është e vërtetë se, kur bën thatësi, bujqësia rrezikohet, por edhe shirat e shumtë asaj nuk i bëjnë mirë. Megjithatë ndonjë rrezik të madh nuk kemi pasur prej shirave, sepse tash kemi bërë kudo bonifikime, kemi hapur kanale kulluese që evitojnë ujin e tepërt dhe dëmtimin e bimëve. Ne kemi këtu afër Italinë, ku shohim që çdo vit bëhen përmytje. Kjo, natyrisht, ndodh sepse ajo është një vend kapitalist, ku shteti nuk tregon interesim në këtë drejtim.

Për sa i përket bujqësisë, ne punojmë edhe në një drejtim tjetër, në atë të krijimit të rezervave për të përballuar çdo të papritur, duke shfrytëzuar për këtë jo vetëm prodhimin e kooperativës bujqësore, që përbën drejtimin kryesor, por edhe oborrin kooperativist, nga i cili kooperativisti duhet të marrë rendiment të lartë. Kjo, mendojmë ne, është gjë shumë e mirë dhe po luftojmë për ta realizuar, megjithëse oborri kooperati-

vist tani është më i vogël, më përpara ai ka qenë më i madh. Në të ardhmen, duke krijuar kushte më të mira furnizimi, do të vijë koha që oborri nuk do të jetë më i nevojshëm. Natyrisht, çdo gjë do të bëhet dialektikisht, derisa të pihen situatat.

Rëndësi ka të mbahemi fort pas parimit që objektivat e caktuar patjetër të arrihen, sepse edhe atëherë kur kushtet nuk janë të favorshme, mobilizimi dhe mendja e njerëzve bëjnë që punët të shkojnë mirë. Për shembull, në një parcelë në Pogradec gruri u mboll në kushte jo të mira, por, duke zbatuar si duhet agroteknikën dhe duke e sistemuar mirë tokën, u siguroa një rendiment prej 72 kuintalësh për hektar. Kur puna për arritjen e objektivave ecën në rrugën e marksizëm-leninizmit dhe të diktaturës së proletariatit, atëherë gjithë sektorët zhvillohen drejt e përparojnë. Përndryshe, edhe për prodhime bujqësore do të detyrohesh t'u lutesh kapitalistëve, siç po bën Bashkimi Sovjetik. Gjithë bota bën krahasime e shikon se si po zhvillohet atje kapitalizmi.

*Gjatë bisedës, mbasi ambasadori kinez foli për probleme të ndryshme ekonomike të Kinës dhe për çështje të tjera, shoku Enver Hoxha, midis të tjerave, theksoi:*

Siç e dini, ne na kanë sabotuar në naftë, po kështu dhe në sektorë të tjerë të ekonomisë. Tani po bëjmë përpjekje të mëdha të zhdukim pasojat e këtij sabotimi. Doli se sabotatorët, bashkë me bandën e Beqir Ballukut, kanë qenë agjentë të vjetër, vegla të revizionistëve sovjetikë e të tjerë, të imperialistëve, gjë që tash është vërtetuar. Ata ishin elementë shpifës,

gënjeshtarë dhe hipokritë. Ndryshe na raportnin neve në udhëheqje, ndryshe vepronin në praktikë. Ai ka qenë një komplot i organizuar, që Partia e zbuloi dhe e demaskoi. Kjo është një nga fitoret e saj. Pra, duhen vigjilencë e madhe, luftë dhe punë për forcimin e vazhdueshëm të diktaturës së proletariatit. Armiku punon. Gjatë veprimtarisë së tij, ai lë njolla, të cilat, po nuk u fshinë, trashen. Prandaj Partia jonë i vë rëndësi studimit të teorisë marksiste-leniniste. Ajo e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë këtë gjë, që është detyrë për të gjithë marksistë-leninistët. Partia kurdoherë na mëson që sidomos ne të qindfishojmë përpjekjet, se jemi të rrethuar nga imperialistë dhe revizionistë. Të gjithë ata që kemi rreth e rrotull, me rrethë koncentrikë, luftojnë me egërsi kundër nesh. Në etapa të ndryshme pas Çlirimit të vendit, është vërtetuar intensifikim i veprimtarisë së egër të armiqve kundër Shqipërisë. Kështu na ndodhi edhe me hrushovianët pas vdekjes së Stalinit.

Populli ynë është i vogël dhe ka vuajtur shumë nga armiqtë. Ekzistenca e tij është siguruar vetëm me luftë. Po të mos luftonte, ai rrezikohet të zhdukej. Vetëm në sajë të qëndresës së tij të fortë gjatë shekujve, armiqtë nuk e zhdukën dot. Edhe tash, me luftë po çan përpara populli ynë. Miq besnikë ai ka gjithë ata që vuajnë nën shtypjen e egër imperialisto-revizioniste e që bëjnë revolucionin. Partia jonë e ka të qartë se rruga që duhet të ndjekim është rruga e luftës kundër çdo lloj armiku. Armikun ta kritikojmë, por edhe ta luftojmë, se vetëm me kritikë ai nuk do t'ia dijë. Populli ynë ka një shprehje që thotë: «Derri do plumb!».

Çështja e popullit është çështje e shenjtë. Armikun

ta godasim pa hezitim, t'i bëjmë luftë të pamëshirshme, kurse popullin ta edukojmë, ta bëjmë të ndërgjegjshëm. Kur mbështetesh te populli, kur masat popullore luftojnë me vendosmëri për çështjen e Partisë, atëherë mund të themi se puna edukative e Partisë, vija e saj e drejtë janë kuptuar dhe kanë zënë rrënjë të thella dhe populli është i përgatitur të përballojë çdo të papritur e të mbrojtjes së vendit e kemi pasur gjithmonë në qendër të vëmendjes, sepse jetojmë në kushte rrethimi nga armiq që manovrojnë e kanë plane të na sulmojnë. Këta armiq, imperialistët dhe revizionistët, janë me qindra flamurë në xhep. Ata, sa futin njërin, nxjerrin tjetrin. Aftësia jonë mbrojtëse duhet të jetë gjithmonë në lartësinë e duhur, sepse situata në Evropë dhe në Ballkan është e ndërlikuar. Revizionistët sovjetikë kërcënojnë, përpiqen, kudo që mundin, të shtien në duart e tyre porte detare, të vendosen në vendet e tjera me lloj-lloj formash, të hapëta e të maskuara. Këtë po bëjnë edhe në Jugosllavi, ku anijet e tyre shkojnë me pretekstin për të pushuar ose për t'u riparuar. Prandaj, popullin ne e përgatitim të jetë i gatshëm për çdo të papritur, të jetë i gjithi i armatosur, se në kushtet e Shqipërisë nuk ka si bëhet ndryshe. Për luftë duhen njerëz të stërvitur, në radhë të parë, por duhen edhe armë. Për t'i përdorur këto në rast agresioni, ne punojmë në të gjitha drejtimet që t'i stërvitim njerëzit tanë si ushtarë të vërtetë dhe marrim masa mbrojtëse. të cilat kanë qenë e janë të vlefshme edhe për popujt e tjerë që luftojnë dhe duan të luftojnë.

Tash, shoku ambasador, më lejoni të largohem. Ju uroj nga zemra me rastin e festës suaj dhe ju lutem t'u transmetoni urimet tona të gjithë shokëve!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

# POLITIKA E JASHTME E KINËS NUK ËSITË REVOLUCIONARE

Shënime

2 tetor 1975

Partia Komuniste e Kinës në politikën ndërkombëtare mban qëndrime të gabuara, jomarksiste. Politika e saj është jorevolucionare, joklasore, joproletare, nuk është pro revolucionit. Deri dje Republika Popullore e Kinës dhe politika e saj e jashtme ishin mbyllur në guaskë, por tani janë hapur si vaji në lakra, dhe hapja, sipas mendimit tonë, ka marrë drejtim të gabuar.

Cili është drejtimi i tyre i gabuar?

Partia Komuniste e Kinës hiqet sikur ndihmon revolucionin botëror dhe partitë komuniste e punëtore marksiste-leniniste, por në realitet një gjë të tillë nuk e bën.

Partia Komuniste e Kinës pretendon se «Kina bën pjesë në botën e tretë», në vend që të afirmohet si një vend socialist dhe të ndihmojë popujt e botës dhe jo klikat sunduese të tyre, sidomos klikat gjakatarë të borgjezisë reaksionare, që shiten te çdo imperialist për të sunduar mbi popullin e vet. Kina propagandon miqësinë

dhe aleancën me gjithë «botën e tretë», pa bërë dallime politike, por sidomos pa bërë asnjë dallim klasor, pa luftuar dhe pa bërë asgjë për thellimin e kontradiktave në mes klasës punëtore të këtyre vendeve dhe borgjezisë reaksionare shtypëse të tyre. Partia Komuniste e Kinës dhe politika e shtetit kinez i injorojnë këto kontradikta dhe veprojnë që t'i zbutin, duke mbrojtur haptazi klika, si ajo e Pinoçetit, e Frankos, e Mobutus dhe e shumë të tjerëve. Kjo nuk është politikë marksiste-leniniste, por antimarksiste, sepse orvatet të shuajë luftën e klasave në planin ndërkombëtar. Pra, Partia Komuniste e Kinës dhe shteti kinez harrojnë aleatin e tyre klasor, proletariatit botëror, e nënvleftësojnë atë dhe vënë në dukje aleancën me krerët e borgjezisë që sundojnë mbi proletariatit dhe mbi popujt. Dhe kjo farë aleance, e shikuar jo me sy klasor, lëkundet sipas rasteve.

Politika e jashtme kineze udhëhiqet nga dy kriteret bazë:

**Kriteri i parë:** Je dashamirës i Kinës apo jo? Po të jesh ose të hiqesh sikur je, cilido qofsh, ti je aleati dhe miku i Kinës dhe «unë, Kina, e harroj anën klasore të politikës dhe të mbroj, të pres me gongë, të jap edhe kredi. Po më këndove shumë, të dua shumë, qofsh kush të duash; më deshe mesatarisht, e rregalloj miqësinë me këtë diapazon; të dëgjova se më kundërshton ose më këtheve fletën, atëherë e kthej zhiruetën nga fillon armiqësia». Pra, miqësi e lëkundshme, miqësi me karakter borgjez.

**Kriteri i dytë:** Po që kundër revizionistëve sovjetikë, je miku i Kinës, qofsh kush të duash. Përfini që ndjek politika kineze është: armiku kryesor i saj dhe

i gjithë botës është socialimperializmi sovjetik, se ky «është i pademaskuar, se është luftënxitës, se kërkon hegjemoni botërore». Prandaj, sipas politikës kineze, kundër Bashkimit Sovjetik duhet të krijohet «aleanca e shenjtë» me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilat kinezët thonë se «janë imperialiste», por «armiqtë dorës së dytë, pas Bashkimit Sovjetik. Kjo thuhet sa për të thënë, se kinezët synojnë të lidhen në një aleancë socialdemokrate me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata e kanë pakësuar propagandën për demaskimin e imperializmit amerikan, e kanë zbutur ose, më konkretisht, e kanë shuar luftën e tyre kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, bile kanë shkuar edhe më tej në konsolidimin e kësaj aleance të rreme dhe të përbindshme. Në çdo parti që hiqet se është komuniste marksiste-leniniste ose në shtetet që e mbajnë veten për socialiste, kinezët propagandojnë, këshillojnë dhe ndihmojnë çdo rrymë proamerikane dhe ndikojnë që të flitet pak ose të mos flitet fare për veprimet agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës; ata i gënjejnë e i detyrojnë lëvizjet revolucionare, çlirimtare, ato marksiste-leniniste që të veprojnë sipas drejtimit të politikës kineze. Edhe atje ku imperializmi amerikan ka futur thellë kthetrat e tij të gjakosura dhe klikat e atij vendi janë bërë agjenturë e amerikanëve, lëvizjet përparimtare dhe revolucionare këshillohen, frymëzohen që, duan s'duan, të thonë se «armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik».

Kjo është e tmerrshme. Kësaj i thonë të gënjest proletariatin, të shuash revolucionin e të nxitësh një luftë botërore imperialiste, në vend që të ecësh në rru-



gën marksiste-leniniste, duke luftuar për të dobësuar imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, duke ndihmuar revolucionin dhe jo duke e shuar atë, duke ndihmuar luftërat nacionalçlirimtare të popujve kundër dy superfuqive, që të shkatërrosh kështu planet e tyre të luftës grabitqare imperialiste dhe, po nuk munde ta evitosh këtë luftë, atëherë ta kthesh atë në luftë civile, në luftë çlirimtare e në revolucion.

Por Kina nuk ecën në këtë rrugë. Ajo ka deklaruar, dhe për këtë ka nënshkruar Komunikatën e Shangait, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë hegjemone dhe nuk do të luftojnë për hegjemoni. Të mendosh kështu dhe të besosh një «copë letër», siç i quajti Fordi në Pekin të tilla deklarata, do të thotë të kesh devijuar nga teoria marksiste-leniniste dhe të ecësh në një rrugë të kundërt.

Kina përdor disa parulla si «kombet duan çlirim», «popujt duan revolucion», ndërsa në realitet luftërat nacionalçlirimtare dhe revolucionin ajo nuk i ndihmon, por i shuan. «Bota është e turbullt, por situata është e shkëlqyer», thonë kinezët. Të thuash se «situata është e shkëlqyer» kur të dyja superfuqitë po shtypin e po robërojnë popujt, kur përgatiten për luftë imperialiste, kur i nxitin popujt të gjakosen me njëri-tjetrin etj., etj. dhe kur ti, Kinë, mban anën dhe kërkon ndihmën e njërit shtet imperialist për të luftuar tjetrin dhe për këtë politikë të dënueshme sakrifikon revolucionin, lëvizjen marksiste-leniniste dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve, do të thotë të gënjeshtrosh e t'i bësh një tradhti të madhe revolucionit. Këtë gjë tregon loja e rrezikshme e Kinës.

Dëmaskimi i Bashkimit Sovjetik, i Traktatit të Varshavës e i KNER-it, duke treguar se Bashkimi Sovjetik po futet, për shembull, në Bolivi, ku ka bërë një fabrikë çimentoje etj., të gjitha këto bëhen nga propaganda kineze dhe me këto jemi dakord. Kemi qënë kurdoherë dakord për luftën kundër socialimperializmit sovjetik. Por të pranosh që imperializmi amerikan është zbutur, siç bën Kina, se NATO-ja duhet, se Tregu i Përbashkët Evropian duhet, se duhet thënë: «Rroftë Evropa borgjeze kapitaliste e bashkuar», «Rrofshin Frankoja dhe Pinoçeti», me këto pikëpamje e qëndrime dhe me të tjera si këto, ne s'kemi qënë e s'do të jemi kurrë dakord me Kinën. Bile, jemi e do të jemi kundër dhe do t'i luftojmë haptazi të gjitha pikëpamjet e kësaj natyre, sepse ato janë në favor të imperializmit amerikan, të kapitalizmit botëror dhe kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit e socializmit.

Kriza e botës kapitaliste dhe revizioniste është aq e madhe, aq e thellë, sa s'është parë kurrë ndonjëherë. Po Kina ç'bën? I ndihmon ajo miliona proletarë që hidhen në greva? I ndihmon ajo të papunët, që janë me miliona në botë? I ndihmon vallë Kina këto masa kolosale që janë ngritur në këmbë, dhe me ndihmën e saj të thellojë krizën e imperializmit amerikan e të revizionizmit sovjetik? Jo, aspak! Kina, për fat të keq, ndihmon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet kapitaliste perëndimore që ta kalojnë pa dhimbje krizën; i ndihmon ato politikisht e ideologjikisht. Ajo u ka hapur atyre tregun e vendit të vet dhe lejon investime të kapitaleve të huaja në Kinë. E tërë kjo bëhet nën maskën e një politike «marksiste-leniniste» dhe gjoja për

të luftuar armikun numër një, Bashkimin Sovjetik, i cili nesër ka mundësi të bëhet edhe miku numër një i saj.

Kina në fakt gjithë masat e grevistëve e të të papunëve i lë t'i manipulojnë revizionistët, socialdemokracia, që janë të gjithë në shërbim të kapitalit vendas dhe të atij ndërkombëtar. Lëvizjet revolucionare dhe partitë komuniste e punëtoresh marksiste-leniniste Kina as i përkrah dhe as i ndihmon, por i ka ndarë në kategori: ato që flasin mirë për Kinën dhe ndjekin politikën e saj, janë të mira; të tjerat s'janë gjë.

Por tragjedia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare qëndron në faktin që Kinën ajo e ruan dhe nuk flet kundër saj, e mbron edhe kur ajo gabon. Ne shqiptarët hapur nuk e atakojmë, se interesi i përgjithshëm nuk na e do akoma. Por politika jonë e jashtme dhe e brendshme është e hapur, e vendosur dhe në kundërshtim me atë të Kinës, në të gjitha çështjet që përmenda më lart. Kina këtë e di, popujt e botës e dinë, marksistë-leninistët, gjithashtu, e dinë, se gojën ne as e kemi mbyllur dhe as do ta mbyllim. Asgjë, asnjë ndërhyrje apo presion nuk do të lejojë që të cenohet e të shtrembërohet vija e Partisë sonë, e cila njihet botërisht. S'janë të paktë njerëzit dhe ata burra shteti e borgjezë përparimtarë në botë, që flasin me shumë simpati për politikën e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Pse e shfaqin ata këtë simpati?

Së pari, sepse ne flasim hapur, me guxim dhe drejt kundër dy fuqive të mëdha, flasim dhe në të njëjtën kohë veprojmë. Kjo politikë e drejtë u pëlqen, sepse shumë të tjerë s'e bëjnë dot, mbasi dy superfuqitë ua kanë lidhur duart dhe gojën.

Së dyti, se politika jonë ndaj qeverive borgjezo në fuqi nuk është as liberale, as sektare. Ne dimë të dallojmë cilat qeveri janë përparimtare, cilat jo, dhe të gjithë e kanë kuptuar dhe e shohin se politika jonë mbron, në radhë të parë, interesat e klasës punëtore dhe të popullit të këtyre vendeve e se nën prizmin e këtyre çështjeve ne i mbështetim ato qeveri ose ata qeveritarë që, në vija të përgjithshme, kanë sadopak kërkesa të tilla në programin e tyre qeveritar.

Së treti, se ata shohin në politikën e guximishtme të Partisë sonë një shembull që edhe ata e popujt e tyre, qofshin të vegjël si ne ose të mëdhenj, duan ta ndjekin. Në momente krize e dhune nga ana e dy superfuqive, shumë qeveri ose qeveritarë borgjezë, për të dalë nga dara e hekurt, kujtojnë Shqipërinë dhe marrin zemër nga shembulli i saj.

Kinën, si një vend të madh socialist, ne e kemi dashur dhe e duam sinqerisht, e kemi mbrojtur dhe do ta mbrojmë në rrugë marksiste-leniniste, por këto gabime të sajat në vijë na hidhërojnë, nuk i pëlqejmë dhe nuk mund t'i pranojmë. Ne duam t'i diskutojmë këto, por kinezët nuk pranojnë. Ata kanë gjetur «rehat» që ne nuk flasim hapur për ta, pa çka që botërisht duket se qëndrimet tona s'puqen. Pozita të tilla nuk duhet të ekzistojnë në mes dy partive dhe dy shteteve tona. Po bëhen dy vjet dhe tri herë e kemi përsëritur kërkesën e vajtjes në Pekin të një delegacioni të Partisë dhe të Qeverisë sonë, por kinezët të tri herët e kanë shtyrë, duke bërë veshin e shurdhër. Nga ana tjetër po presin të gjithë burrat e shtetit, të çfarëdo kategorie, imperialistë, borgjezë, mbretër e princesha, që nga Fordi e deri

te kryeministri revizionist jugosllav, Bijediç. E si mund ta quajmë këtë përbuzje e mospërfillje përveçse shprehje të pikëpamjeve të shtetit të madh që në mes nesh dhe me zë të ulët thotë se «ju kemi miq», por brenda vetes thotë: «miq që nuk më sillni shporta me fiq», domethënë «nuk mbështetni politikën time ndërkombëtare». S'ka se si ta interpretojmë ndryshe këtë qëndrim jomiqësor të Kinës ndaj Shqipërisë. Por Partia e Punës e Shqipërisë di të mbajë gjakftohtësinë dhe të mos e humbasë durimin.

Shumë kemi vuajtur e shumë vështirësi kemi ndeshur, por i kemi kapëreyer me sukses, se kemi mbrojtur dhe kemi ndjekur marksizëm-leninizmin, kemi qenë të drejtë e të matur, kemi ditur të lidhim ngushtë çështjen tonë nacionale me interesat ndërkombëtarë të punonjësve. Partia e Punës e Shqipërisë e di se forca e saj qëndron në popull, në atdheun e lirë e sovran socialist. Ky faktor është i pari dhe vendimtar. Ndihma ndërkombëtare vjen në radhë të dytë. Gjendjen ndërkombëtare ne e ndjekim me vigjilencë, po kështu ndjekim edhe manovrat e panumërta koniunkturale të shteteve të ndryshme në botë dhe përpigemi të nxjerrim mësimë dhe konkluzione të drejta që të na shërbejnë në politikën e shtetit tonë. Por politika e shtetit tonë nuk mund as të bazohet, as të lëkundet sipas këtyre koniunkturave. Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë ka në bazë një strategji dhe taktikë të saj, të bazuar në teorinë marksiste-leniniste, të zbatuar në kushtet e vendit dhe në ato ndërkombëtare. Shumë që hiqen se janë marksistë, por s'janë të tillë, mund ta thonë këtë formulë, por marksizmi duhet zbatuar në mënyrë ko-

rrekte. Për ne koniunkturat janë në politikë diçka anësore, jo e qëndrueshme, ku nuk mund të mbështetesh. Sot synimi i një politike koniunkturale mund të ketë një drejtim, nga i cili taktikisht mund të përfitosh, po të dish ta shfrytëzosh; kurse nesër ajo ndërron krejt drejtim, në disfavorin tënd. Pra, politika e Partisë dhe e vendit tënd nuk duhet futur në labirintin e errët e me kurthe që ngrenë shtetet kapitaliste, borgjçe dhe revizioniste.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 157*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 157*

## FILOZOFËT «FILOZOFOJNË»

### Shënime

4 tetor 1975

Ç'është diktatura e proletariatit? Partia, duke u bazuar në tezat e mësuesve tanë të mëdhenj, e ka shpjeguar atë teorikisht dhe *de facto* e *de jure* shteti shqiptar është diktatura e klasës punëtore.

Na del «filozofi» dhe thotë: «Por, meqë diktatura e proletariatit është diktatura e klasës punëtore, fshatarësia ngel pa gjë» dhe shton që «pushteti te ne është i gjithë popullit». Me sa duket, ky «filozof» nuk e ka plotësisht të qartë filozofinë marksiste për diktaturën e proletariatit.

«Filozofi» tjetër ngrihet, «filozofon» dhe ia ngatërron fare mendjen «filozofit» të parë, duke i thënë se «diktatura e proletariatit është vetëm e klasës punëtore dhe e asnjë klase tjetër». Formula është në rregull, por ai vazhdon duke thënë që «pushteti i diktaturës së proletariatit nuk mund të jetë pushtet i të gjithë

popullit» se «po të pranosh këtë, del tek teza e revizionistëve sovjetikë». Duke i bërë këtë shtojcë, ai mendon se e shtroi drejt çështjen, por në fakt e komplikoi më shumë dhe e bëri të errët.

«Filozofi i parë» donte të dinte, me fjalë të tjera, cili ishte vendi i fshatarësisë në pushtetin tonë popullor dhe, si vazhdim, merret me mend, edhe i inteligjencias popullore.

«Filozofi i dytë» duhej t'i thoshte se diktatura e proletariatit, megjithëse është diktaturë e një klase, mbrohet interesat edhe të fshatarësisë, edhe të inteligjencias, të gjithë popullit shqiptar. Te ne pushteti është diktaturë e proletariatit dhe s'ka pushtet tjetër. Fshatarësia si klasë, si alcatë e klasës punëtore, dhe shtresat e tjera të popullsisë kanë pranuar me vullnet diktaturën e klasës punëtore me të gjitha funksionet dhe arsyet e qenies së saj. Në krye dhe në udhëheqje të diktaturës është partia e klasës punëtore. Pra, pushteti te ne i përket gjithë popullit shqiptar, por nga përmbajtja dhe nga karakteri është diktaturë e proletariatit.

«Filozofi i dytë» ka frikë të përdorë thënien «pushteti i përket gjithë popullit», se atëherë, mendon ai, bie në revizionizëm, meqë revizionistët sovjetikë flasin për «shtet të të gjithë popullit» dhe «parti të të gjithë popullit».

«Filozofi i dytë» trembet nga definicionet dhe nuk i shpjegon këto definicione. Ai nuk është në gjendje të dallojë se ka ndryshim si dita me natën midis realitetit tonë, që pushteti i përket gjithë popullit, dhe tezës revizioniste të «shtetit të gjithë popullit».



Ky ndryshim, që duket inekzistues në fjalë, është, përkundrazi, i madh, pse nuk ka të bëjë thjesht me formulimin, por me përmbajtjen klasore të pushtetit. Diktatura e proletariatit lidhet me periudhën e shoqërisë me klasa. Vetëm kur të arrihet në shoqërinë pa klasa dhe të zhduket rrethimi kapitalist, atëherë shuhet edhe diktatura e proletariatit.

Te ne, siç e shpjegoja më lart, ekziston dhe do të ekzistojë pushteti i diktaturës së proletariatit, por ky është pushteti më demokratik, që siguron pjesëmarrjen më të gjerë të masave punonjëse në zgjedhjen e drejt-përdrejtë dhe në drejtimin e organeve shtetërore, që zhvillon në kulm iniciativën revolucionare dhe energjitë krijuese të tyre.

Në Bashkimin Sovjetik dhe në shtetet revizioniste, që kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, nuk ekziston më diktatura e klasës punëtore, as *de facto*, as *de jure*. Në këto vende thuhet se diktatura e proletariatit është shndërruar në «pushtet të të gjithë popullit», që do të thotë se atje gjoja janë zhdukur klasat, është zhdukur edhe partia e klasës punëtore dhe është kthyer në «parti të të gjithë popullit», është zhdukur lufta e klasave dhe shkohet në komunizëm, kurse në realitet diktatura e proletariatit është shndërruar në diktaturë të borgjezisë së re.

Nga «filozofi i dytë» duhej të shpjegohej se në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet revizioniste është vendosur diktatura fashiste burokratiko-borgjeze, se partia është shndërruar në një parti borgjeze kapitaliste, se klasa punëtore dhe masat punonjëse janë zhve-

shur plotësisht nga pushteti, se atje jo vetëm është shkatërruar socializmi, por është zëvendësuar me një regjim kapitalist-teknokratik, se atje nuk shkohet në komunizëm, por drejt shoqërisë së konsumit. Këtë shoqëri revizionistët modernë e paraqesin si një shoqëri ku «klasat janë shkrirë dhe s'ka më veçse konsumatorë», se «nuk ekzistojnë më pronarë mbi mjetet e prodhimit, por ka vetëm aksionarë», ku edhe punëtorët gjoja mund të jenë aksionarë, se në këtë oligarki koncernesh, kapitalistësh, «udhëheqja është teknokratike, jopolitike, joklasore». Kështu që, sipas tyre, «në këtë shoqëri të konsumit po zhduken antagonizmat e klasave», ashtu siç paska ndodhur edhe në Bashkimin Sovjetik.

Janë të njohura tezat revizioniste të policentrizmit të Toliatit. Ato nuk kishin për qëllim vetëm çlirimin nga zgjedha e partisë «mëmë», por deklaratat e toliatistëve ndoqën njëra-tjetrën: «Mund të shkohet në socializëm pa diktaturën e proletariatit», «mund të shkohet në socializëm tok me partitë borgjeze», «mund të shkohet në socializëm me rrugë paqësore, parlamentare», «mund të merret, natyrisht, pjesë në qeveritë borgjeze, pra të shuhet lufta e klasave, të hyjmë në shoqërinë e konsumit» etj., etj.

Filozofët tanë të gjitha këto duhet t'i shpjegojnë drejt e jo me formula dhe çdo gjë duhet të argumentohet teorikisht, por edhe të ilustrohet teoria me praktikën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe me devijimet e revizionistëve, të cilët, për t'u maskuar, marrin nga një ide të drejtë të Marksit e të Leninit dhe

e deformojnë. Në deformime revizionistët shkëlqejnë, prandaj duhet t'u çjerrim maskat vazhdimisht.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Për shkencën» (Përmbledhje  
veprash), vëll. I, f. 553*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për shkencën»  
(Përmbledhje veprash),  
vëll. I, f. 553*

## KONTROLLI ZBULON DOBËSITË, KORRIGJON, EDUKON NJERËZIT

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë  
të Partisë*

7 tetor 1975

Meqenëse shokët s'po e marrin fjalën, po e filloj unë për të vënë në lëvizje «motorin» e diskutimeve. Kërkoj fjalën, shoku sekretar i organizatës-bazë.

Në diskutimin tim nuk jam bazuar në raportin që është paraqitur, për arsye se nuk e kisha. Ai m'u dha sot, bile para se të shkoja të haja drekë, prandaj arrita vetëm sa ta këndoja. Megjithatë rendin e ditës e kam marrë në kohë, kështu që pata mundësi të reflektoja për të diskutuar në këtë mbledhje të organizatës-bazë.

Shoku Hekuran Isai që drejtonte ekipin në Sarandë, në Sekretariatën e Komitetit Qendror na i shpjegoi qartë problemet që dolën në organizatën e Partisë të këtij rrethi. Ai na vuri në korent për gjendjen politike, ideologjike dhe ekonomike të rrethit, për punën e udhëheqjes së Partisë në Sarandë në lidhje me zgjidhjen e problemeve etj., që janë përmbledhur në mënyrë sintetike në raportin e kësaj mbledhjeje.

Në përgjithësi, mendoj se stili dhe metoda e punës që kanë përdorur shokët e aparatit të Komitetit Qendror është e mirë. Këta, natyrisht, duhet të ndiqen dhe të perfeksionohen gjithnjë e më shumë, sepse vetë eksperiencia çon vazhdimisht drejt perfeksionit. Ashtu sikurse u tha këtu, ka gjëra që më përpara nuk ishin bërë si duhej, mirëpo me dërgimin e ekipeve që fitojnë eksperiencë, puna përmirësohet, megjithëse mund të ketë akoma gjëra të tjera që nxjerrin jeta e lufta dhe për të cilat baza ka nevojë dhe duhet t'i njohë e të mësojë se si të zgjidhen gjithnjë mirë e më mirë problemet.

Për çka do të diskutoj, idenë ma dha rendi i ditës i kësaj mbledhjeje të organizatës-bazë. Besoj se mendimet që do të parashtroj, në përgjithësi, i kemi trajtuar edhe herë të tjera.

Kontrolli është i domosdoshëm të bëhet në të gjitha punët e Partisë e të pushtetit, në të gjitha hallkat e tyre dhe për shumë probleme që ndërmarrin dhe zgjidhin ato.

Kontrolli ka qëllime të mëdha: Të verifikojë vijën politike, ekonomike, kulturore, arsimore, atë të mbrojtjes etj. Të verifikosh vijën e Partisë nga ana ideologjike, do të thotë të shikosh nëse direktiva e lëshuar nga çdo instancë e Partisë ose e pushtetit është e drejtë ideologjikisht dhe zbatohet drejt apo ka ndonjë gabim, i cili duhet të vihet menjëherë në dukje dhe të korrigjohet.

Partia na mëson të mos lejohen gabime në vijë, por edhe kur ngjet një gjë e tillë, me dashje ose pa dashje, nuk duhet lejuar të ndërtohen kala mbi rërë, nuk

duhet lejuar që gabimet të trashen dhe të ecet me sy mbyllur, duke thënë se kjo direktivë ka dalë nga ky ose ai organ partie. Kontrolli duhet të ushtrohet nga të gjithë, pa përjashtim, nga individë dhe forume. Vetëm indiferentët, frikamanët, karrieristët, burokratët e përjashtojnë vetveten nga një kontroll i tillë revolucionar. Të kontrollosh dhe të kërkosh që të vihen drejt çështjet është një detyrë partie me rëndësi, por as nuk duhet të lejohet që, nën mbulesën e gjoja përpjekjeve për të ndrequr diçka, të krijohet anarki, pse nuk duhet harruar që ka dhe kritizera të sëmurë që përpiqen për një qime të ndalojnë zbatimin e një direktive të drejtë.

Duhet pasur besim në shokët, në forumet dhe në udhëheqësit, por edhe duhen kontrolluar qëndrimet e tyre ndaj vijës së Partisë dhe zbatimit korrekt të saj. Të gjithë duhet ta kuptojmë ideologjikisht rëndësinë e kontrollit. Kur kontrollohen vija, zbatimi i saj, mendimet dhe veprimet e njerëzve, në radhë të parë, nuk shkohet nga qëllimi i «dyshimit», i «kapjes me presh». Jo, qëllimi kryesor është që problemi të shtrohet dhe të zbatohet drejt për të arritur objektivin e caktuar nga Partia dhe shteti. Prandaj askush nuk duhet të ofendohet pse kontrollohen puna dhe qëndrimi i tij nga shokët. Kjo është një detyrë e domosdoshme dhe reciproke.

Kush nuk e dëshiron kontrollin? Pikërisht ata persona ose instanca që nuk janë në rregull me vijën, që e shtrembërojnë atë. Kontrolli ka kurdoherë karakter edukues, ai është kundër degjenerimit moralo-politik të njerëzve, kundër abuzimeve nga ana e njerëzve me pozita shtetërore ose partie, kundër dëmtimeve, vjedhjeve e sabotimeve të pasurisë shtetërore dhe indivi-

duale. Pra, kontrolli korrigjon, edukon dhe zbulon të këqijtë dhe të këqijat.

Siç e shohim, rëndësia e kontrollit është shumë e madhe. I shikuar me syrin marksist-leninist, ai është një nga mjetet më të fuqishme që çon punën përpara. I shikuar, nga ana tjetër, me syrin mikroborgjez, ai është diçka i padëshirueshëm, ngacmues, prishës i qetësisë së liqenit me ujë të qelbur. Të këqijtë, megalomanët, mashtruesit, vjedhësit, sabotatorët e të tjerë të këtij lloji jo vetëm nuk e duan kontrollin, por e luftojnë me shumë mjete dhe mënyra.

Kontrolli i mirë e i drejtë parashikon, në radhë të parë, që njerëzit që e ushtrojnë të jenë të pastër ideologjikisht, të jenë të ndershëm dhe të drejtë, gjakftohët në mendime dhe të dinë t'i paraqesin objeksionet me qëllim korrigjimi dhe jo ofendimi, kur nuk ka ardhur çështja në trashje dhe atëherë duhen përdorur ashpërsia e dhuna.

Kontrolli në këto rrethana kërkon nga njerëzit të njohin direktivën, orientimet e dhëna, zbatimin e mirë ose të keq të tyre, të kapin rrënjën e së keqes, pastaj të dalin te njerëzit që kanë gabuar dhe që duhen korrigjuar ose dënuar. Kontrolli i mirë dhe vigjilent nuk duhet të lërë vende të errëta pa sqaruar që mund edhe të mos kenë lidhje të drejtpërdrejtë, por të kenë lidhje të padukshme me çështje më të koklavitura e me dëme të mëdha.

Kontrolli i mirë dhe vigjilent kërkon që njerëzit të mos mjaftohen vetëm me njohjen e direktivës, por edhe me anën organizative të ndërtuar për ta zbatuar atë, kërkon që ata ta kenë ndjekur në teori dhe në

praktikë këtë zhvillim dialektik dhe nëpërmjet kontakteve me shokun afër punës, nëpërmjet analizave, të korigjiojnë gabimet dhe ata që i bëjnë.

Kontrolli i punës së shokëve duhet të shërbejë si kriteri më i sigurt dhe më i drejtë i vlerave të atyre që punojnë në bazë ose që janë zgjedhur apo emëruar në udhëheqje. Ky është kontrolli bazë. Kontrollat e tjera në forma të ndryshme do të jenë të mira në qoftë se kontrolli bazë është i shëndoshë, ndryshe nuk do të japë rezultatet e dëshiruara.

Kontrolli punëtor dhe fshatar, që jemi duke e përpunuar në bazë të tezave të Leninit dhe të eksperiencës së Partisë sonë, duhet ditur se bazohet në kontrollin bazë që shpjegova më lart. Ky kontroll punëtor do të fuqizojë të parin, do të specializohet më mirë, do të ketë kompetenca më të gjera, do të zhvillohet i organizuar dhe i drejtuar dhe do të instruktohet e do të ndihmojë Inspektimin e Shtetit dhe një sërë formash të tjera inspektimi që kanë ministrinë, ndërmarrjet, kooperativat bujqësore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.

Siç po e shohim, nuk na mungojnë as mjetet, as format e kontrollit. Vetëm Partia duhet t'i edukojë masat dhe instancat për ta kuptuar e për ta zbatuar si duhet kontrollin, qoftë si individë, qoftë si grup, qoftë si funksionarë të emëruar. Prandaj këto funksione duhet të sqarohen politikisht dhe ideologjikisht, të sqarohet në teori dhe në praktikë mekanizmi i funksionimit, domethënë ana organizative dhe ajo teknike e tyre.

Pikërisht ekipet e ndihmës dhe të kontrollit që dërgohen në bazë nga ana e Komitetit Qendror dhe e ko-



miteteve të Partisë në rrethe kanë një detyrë të madhe sqaruese, rektifikuese dhe edukuese. Kjo ndihmë e ky kontroll nuk duhet të jenë burokratikë e teknokratikë dhe, duke u bazuar në jetën e gjallë që zhvillohet në Parti dhe në organet e pushtetit, të dalin me konkluzione jo vetëm organizative, por edhe politiko-teorike. Kjo është e domosdoshme të bëhet seriozisht dhe, kur them seriozisht, nuk kuptoj vetëm sa për t'i përdorur fjalët «teorikisht» e «politikisht».

Shokët që formojnë ekipin e ndihmës dhe të kontrollit nuk janë të panjohur me problemet që preokupojnë Partinë dhe rrethin. Ata jo vetëm që nuk janë të huaj (dhe me këtë më duhet të tërheq vëmendjen e disave që, duke mos qenë të huaj, nuk përgatiten mirë), por çështjen e theksoj në atë drejtim që, pavarësisht se i dërguari nga qendra është në korent të problemeve të rrethit, nga ana e tij duhet të bëhet një përgatitje serioze para se të nisët për ndihmë e kontroll. Ekipet e Komitetit Qendror ose të komiteteve të Partisë të rretheve që shkojnë në bazë duhet të kenë të qarta disa probleme kyç, hallka të rëndësishme, dhe të përgatiten nga të gjitha anët, duke i trajtuar këto probleme në nivel të lartë dhe jo të humbasin në çikërrima. Shokët e ekipeve që shkojnë në bazë kanë eksperiencë partie, shumë prej tyre kanë mbaruar Shkollën e Partisë, kanë lexuar dhe kanë studiuar shkrimet e mësuesve tanë të mëdhenj, prandaj nuk lejohet që këtë eksperiencë dhe dituri ata të mos e materializojnë dhe të mos e shkrijnë me problemet që ndjekin ose me ato që nuk i kanë parashikuar.

Puna e ekipeve duhet të lërë mbresa të thella atje

ku zhvillohet, të jetë e ngritur mbi nivelin e atyre që u jepet ndihma dhe u bëhet kontrolli. Ca më shumë ata duhet të përgatiten mirë, duke pasur parasysh se baza është ngritur tash nga çdo pikëpamje dhe kërkon një ndihmë të kualifikuar.

Të kontrollosh punën do të thotë të ballafaqosh rezultatet me detyrat e lëna, me angazhimet e marra. Këndej del si kanë punuar njerëzit dhe udhëheqësit e ndryshëm, si kanë qëndruar këta përpara direktivës, planit dhe organizimit të zbatimit të tyre. Kjo, siç e shohim, lyp konfrontim dhe, që të mund të konfrontosh, duhet të njohësh mirë problemin, ligjet, rregulloret, anën teknike të problemit, anën morale, profesionale dhe politiko-teorike. Ja pse duhet shkuar drejt specializimit në kontroll, ja pse ekzistojnë disa lloje kontrollesh shtetërore dhe partie, ja pse kalojnë këto kontrole nga ai individuali, kur themi që «Te shoku ki besim, po punën e tij kontrolloje!», nga kontrolli punëtor, rreth të cilit duhet të grumbullohet një shumicë e madhe njerëzish jo nëpunës dhe jo funksionarë, të cilët duhet të ndahen në grupe dhe të specializohen, domethënë të njohin çdo gjë që organizon dhe drejton punën që kontrollohet, dhe deri te kontrollet e ndryshme shtetërore të emëruara e me funksionarë, kontrole që janë, përveç të tjerave, edhe kontrole tekniko-financiare.

Të kemi parasysh gjërat e këqija që na kanë ngjarë dhe na ngjasin. Kjo është lufta e klasave që zhvillohet e rreptë në mes së mirës, progresives dhe armiqësores. Kuptohet sa rëndësi marrin ndihma dhe kontrolli masiv dhe i organizuar nën udhëheqjen e direktivave të Partisë. Atje ku nuk veprojnë dhe ku nuk kanë vepruar

kontrolli dhe ndihma e shëndoshë, atje i ushtë lënë fushë veprimi çdo lloj armiku e sabotatori.

Kini parasysh plenumet e Komitetit Qendror të mbajtura kohët e fundit, dhe konkluzionet e tyre për një sërë veprimesh armiqësore nga grupi i Beqir Ballukut, i Abdyl Këllezit, i sabotatorëve të naftës dhe të tregtisë shtetërore. Ka pasë humbur vigjilenca e Partisë dhe ajo shtetërore, kontrollet ishin inekzistuese, si me thënë, ose qenë të dobëta, të sipërfaqshme, formale. Natyrisht, në këtë mënyrë nuk mund të ecet më. Duhet ndërruar stili dhe metoda e punës në drejtimin revolucionar dhe tok me ta edhe në atë të edukimit e të kontrollit. Stili dhe metoda revolucionare e punës kanë në vetvete, përveç të tjerave, edhe kontrollin e shëndoshë punëtor e fshatar dhe atë dikasterial e shtetëror, kontrollin politik-ideologjik, organizativ, teknik e financiar.

Si konkluzion dëshiroj të theksoj se të gjithë ne duhet jo vetëm të kemi parasysh këto mësimet të Partisë, por t'i perfeksionojmë dhe çdo njeri, komunist ose i paorganizuar në Parti, të bëhet mjeshtër i pakorrupsueshëm dhe i palëkundur në zbatimin e tyre.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Për Partinë» (Përmbledhje  
veprash), vëll. i 3-të,  
f. 257*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përmbledhje veprash), vëll. i  
3-të. f. 257*

## KINA DHE JUGOSLLAVIA

Shënime

7 tetor 1975

Udhëheqjet e këtyre dy shteteve kanë rënë në «dashuri»! Njohje dhe simpati e vjetër. Kinezëve dhe vetë Maos u ka pasë pëlqyer shumë lufta që ka zhvilluar Titoja kundër Stalinit, ata e kanë brohoritur këtë luftë dhe e kanë quajtur të drejtë. Nga goja e Maos dolën fjalët: «Titoja nuk ka gabuar, por ka gabuar Stalini». Që Maoja e ka thënë këtë, është plotësisht e vërtetë, jo vetëm pse na e ka thënë neve, por sepse ende edhe sot Çu En Lai, Gën Biaoja e të tjerë po propagandojnë kundër Stalinit. «Po, — thonë kinezët (për galerinë), — Stalini është njeri i madh, por ka bërë gabime». Çfarë gabimesh ka bërë? «Nuk e kishte parë drejt çështjen e Kinës»; «edhe çështjen e Titos nuk e kishte parë drejt», «edhe të Bashkimit Sovjetik», «edhe të komunizmit ndërkombëtar» etj.

Atëherë kur paska bërë këto gabime, siç thonë kinezët, pse shprehen këta se «Stalini ishte një marksist-leninist i madh»? Po Hrushovi kush ishte, që kinezët tash e futin në gjirize? «Lenini i kohërave tona»!

ka pasë thënë Maoja në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957. Vlerësim «gjenial» për tradhtarin nga ana e Maos!

Qëndrim joparimor kinezët kanë mbajtur edhe ndaj Titos e titizmit. Në rast se në vijën kineze shohim zigzage të theksuara mbi përcaktimin politik dhe ideologjik të veprimtarisë revizioniste të Titos dhe të titizmit, kjo buron nga politika oportuniste e kinezëve. Duhej folur mirë për Titon, sepse e tillë ishte bindja e tyre, por duhej bërë edhe «demaskimi», se e demaskonin edhe të tjerë, deri edhe Hrushovi lëshonte ndonjë gur kundër tij. Erdhi koha që kinezët e pushuan polemikën kundër Titos dhe filloi afrimi politik e ideologjik *de facto* (ndonëse lidhje ideologjike dhe partie, në dukje, akoma nuk mbajnë).

Kur Kina zuri pozitën proamerikane dhe antisovjetike, kjo politikë u shfaq në të gjitha marrëdhëniet e saj me botën e jashtme. Amerika imperialiste, fashistët Pinoçeti dhe Franko, Titoja dhe Çausheku, renegatë dhe aventurierë, revanshistë gjermanë dhe fashistë italianë janë miqtë e saj. Për Kinën s'ka rëndësi ideologjia. Asgjë nuk shikohet prej saj me syrin klasor, asgjë nuk shikohet në prizmin e revolucionit botëror dhe të çlirimit të popujve! Sipas udhëheqjes kineze, për Kinën dhe për botën ekziston vetëm një armik — socialimperializmi sovjetik. Fakt i hidhur, tragjik, që harrojnë armikun tjetër, imperializmin amerikan.

Taktika kineze, antimarksiste, është: aleancë me gjithë reaksionin botëror, deri edhe me fashistët e deklaruar e me patentë, por që janë kundër sovjetikëve. Kjo jo vetëm është antimarksiste, por tregon se analizat e zhvillimit të çështjeve botërore bëhen prej tyre

në mënyrë aq të gabuar dhe aq të marrë, sa të habit. Çdo veprim politik i kinezëve çon ujë në mullirin e imperializmit dhe të reaksionit botëror.

Kinezët kujtojnë (dhe s'ka si interpretohen ndryshe veprimet e tyre) se gjithë bota është e bindur dhe mendon se Kina është e kuqe, revolucionare. Kjo politikë që bën Kina, ka një qëllim «revolucionar»: të bashkojë «botën e tretë», «botën e dytë» dhe imperializmin amerikan kundër socialimperialistëve sovjetikë. Dhe nga veprimet e tyre del se për ta bërë e për ta arritur këtë «ideal», nuk duhet shikuar shumë në parimet. «Shtetet e Bashkuara të Amerikës i mbrojmë tani, — justifikohen kinezët, — sepse janë më të dobëta nga Bashkimi Sovjetik, por me këtë ne duhet të thellojmë edhe kontradiktat në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës». Idera gjeniale!! Bota ecka ashtu siç do Kina!! Rrotullimi i tokës, politika e kontinenteve me popujt dhe me shtetet e tyre u bëkan ashtu siç do Kina!! Ç'marrëzira! Gjithë reaksioni botëror, me përjashtim të reaksionit sovjetik, e shtyn Kinën në këtë rrugë të gabuar dhe e duartroket. Dhe udhëhoqja kineze fryhet si gjeldeti, por, gjoja, si një gjel... modest.

Duke u larguar nga një politikë klasore dhe parimore marksiste-leniniste, është e natyrshme që Kina të bazohet në koniunkturat politike, në dredhitë dhe në intrigat e qeverive reaksionare.

Le të vijmë te miqësia kinezo-jugosllave. Kjo është tash reale, por do të pësojë disfatë në rast se kinezët do të shohin tendenca prosovjetike në politikën jugosllave. Siç e dimë, politika e Titos, në thelb, është anti-sovjetike dhe proamerikane. Por Titoja dredhon; kurdo-

herë ai ka dredhuar dhe është treguar një aventurier akrobat. Titoja bën një politikë antipopullore, antisocialiste, pra antimarksiste dhe ka zënë pozitat e «liderit» të bllokut pa kuptim të «të paangazhuarve». Në të vërtetë Titoja bën politikën e këtyre shteteve, që në fakt janë të lidhura me superfuqitë, pavarësisht se nuk bëjnë pjesë në traktatet dhe në paktet e tyre ushtarake.

Titoja bie dhe shpie, merr çeqe e favore nga të gjithë. Ai e robëroi Jugosllavinë, krijoi atje shtresën e pasanikëve të rinj, ai rron si një mbret, hiqet vetë dhe e mbajnë si një «kokë politike të madhe». Të gjithë nuk i hanë dokrrat e Titos, por, kur u duhet ta përdorin, e pompojnë dhe, kur s'u vlen më, e hedhin e do ta hedhin tej si limon të shtrydhur.

Sovjetikët, s'ka asnjë dyshim, duan ta kenë nën zgjedhën e tyre Jugosllavinë dhe për këtë përdorin çdo mjet, çdo politikë, çdo konspiracion, çdo manovër; e përkëdhelin Titon, shkruajnë e flasin mirë për të, i premtojnë e i japin kredi. Titoja, si një dhelpër plakë, u avitet dhe u buzëqesh. Kur s'ia arrijnë dot plotësisht qëllimit, sovjetikët i shtrëngojnë dhëmbët. Titoja merr atëherë pozën e maces, që mpreh thonjtë dhe ngre mustaqet kundër sovjetikëve, por në të vërtetë bën mjau në drejtim të amerikanëve.

E tillë është politika titiste, e cila u pëlqen shumë kinezëve. Pse? E para, se ata janë në një mendje me Titon; e dyta, se ky në thelb është proamerikan dhe antisovjetik, dhe e treta, se kinezëve u duhet ta shtojnë miqësinë me Titon që «të thellojnë kontradiktat në mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik». Taktikë gjeniale!!

Xhemal Bijediçi, kryeministri jugosllav, arriti dje

në Pekin, ku u prit «me dashuri, me ngrohtësi», me popull, me gongce, me pllakata e me parulla. Me siguri që atë do ta presë edhe Maoja. Krycartikulli i «Zhenminzhibaos» i bënte hosana «Barabait» dhe Jugosllavisë titiste. Për të maskuar lojën, nuk e përdorte termin «Jugosllavia socialiste», por, duke theksuar sukseset e mëdha ekonomike dhe qëndrimet e udhëheqjes jugosllave kundër kapitalizmit, imperializmit, hegjemonizmit, nënkuptojë fare qartë ky emërtim. Pra, sipas kinezëve, titizmi është në një pozitë «politike progresiste» me Kinën.

Kina e ka futur veten në «botën e tretë», kurse Titoja është në «botën e të paangazhuarve». Në mes tyre është edhe Rumania, sepse është gjoja antisovjetike. Kjo, duke qenë e angazhuar, hiqet si «e paangazhuar» edhe nga kinezët, edhe nga Titoja, edhe nga sovjetikët. Diferenca e «botës së tretë» me «botën e të paangazhuarve» është si ndryshimi që ka veja nga kockeja.

Në artikullin në fjalë të «Zhenminzhibaos» tiritet analiza e famshme «Imperializmi sovjetik kërcënon me luftë dhe me agresion Evropën dhe veçanërisht Ballkanin». Kinezët bëjnë «thirrjen»: «Evropë dhe Ballkan, jeni në rrezik iminent, prandaj bashkohuni me njëri-tjetrin, lini grindjet dhe çfarëdo divergjence që keni, mbështetuni te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te NATO-ja, te Tregu i Përbashkët Evropian. Ju, vende të Ballkanit, jeni në gojën e ujkut, prandaj bashkohuni me Jugosllavinë e me Titon në krye!». Me fjalë të tjera, na thonë neve shqiptarëve: «Ju gaboheni që s'keni besim, siç kemi ne, te Jugosllavia e Titos, te Rumania e



Çausheskut, te Greqia e kolonelëve, te Turqia e Demirelëve, e pse jo, edhe te Bullgaria e Zhivkos. Ju, shqiptarë, s'bëni mirë që nuk merrni pjesë në këtë valle ballkanike». Kinezët me këto qëndrime që mbajnë duan të na thonë: «Ç'ju duhet juve shqiptarëve të shihni thelbin e çështjeve, shihni dhe kënaquni me tabelën e dyqanit».

Atasheu ushtarak kinez në Beograd i tha një diplomatit tonë se «delegacioni kinez u prit përzemërsisht nga ushtarakët jugosllavë»; këta «u treguan çdo gjë», u folën «haptazi dhe sinqerisht», «u treguan dhe armatime» etj. Atasheu ushtarak kinez do që të na mbushë mendjen se ujku qenka bërë qengj, por harron se ujku kardoherë ujk mbetet, bile ka edhe raste, si në romanet e Xhek Londonit, që edhe qeni kthehet në ujk.

Ndërsa shtyjnë datën e vizitës së delegacionit tonë për më tepër se dy vjet, kinezët presin kryeministrin jugosllav Bijediç. Me këtë qëndrim ata duan të na thonë: «Nuk duam t'ju pranojmë, se kemi kontradikta politiko-ideologjike me ju, kurse me jugosllavët (dhe faktet e tregojnë këtu me vizitën e Bijediçit) ne kinezët nuk kemi asnjë kontradiktë».

Natyrisht, revizionistëve sovjetikë dhe këlyshëve të tyre nuk u pëlqen vajtja e Xhemal Bijediçit në Kinë dhe, duke e ditur këtë, Ten Hsiao Pini, në darkën që dha, bëri aluzion si ngaherë «për një superfuqi që do luftën» apo diçka të tillë. Atëherë sovjetikët dhe miqtë e tyre u ngritën nga salla dhe ikën. Kinezët mendojnë se me këtë i thelluan kontradiktat. Po ata gabohen. Punët i ndreq Titoja nga ana tjetër. Vetëm ti, kinez, rro me iluzione, plotëso kërkesat materiale të jugoslla-

vëve dhe vazhdo rrugën që po ndjek, pa sa ka parë të tilla lodra Tитоja, nuk numërohen! Tитоja është mjeshër i të tilla fokuseve.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Shënime për Kinën», vëll.  
II, f. 164*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha. «Shënime për  
Kinën», vëll. II, f. 164*

## ARMIKU VEPRON KUR HUMBET VIGJILENCA

*Fjala në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

10 tetor 1975

Kisha për të thënë edhe unë disa fjalë për veprimtarinë armiqësore, diversioniste e sabotuese të Kiço Ngjelës. Këto çështje ky armik i popullit dhe i Partisë i ka pasë dëgjuar me qindra herë, por nuk i kanë shërbyer, prandaj ato që kërkoja të vija në dukje dëshiroj t'ia them tash Plenumit.

Nga analizat që bëri Komiteti Qendror i Partisë dhe nga kontrolli shtetëror, vërtetohet katërcipërisht se edhe në dikasterin e tregtisë është zhvilluar veprimtari armiqësore, diversioniste dhe sabotuese nga spiunë dhe elementë në shërbim të të huajve. Ky sabotim në fushën e tregtisë është i koordinuar me ish-drejtnesit e Komisionit të Planit të Shtetit dhe të Ministrisë së Industrisë e të Minierave, Abdyll Këllezi e Koço Theodhosi, si edhe me sektorin e rëndësishëm të naftës, që u

---

1. Ky Plenum diskutoi rreth çështjes së Kiço Ngjelës dhe konkluzioneve që duhej të nxirreshin nga puna armiqësore diversioniste e sabotuese në Ministrinë e Tregtisë.

sabotua nga një grup spiunësh e diversantësh në shërbim të fuqive të huaja armike.

Në parantezë dëshiroj t'i them Plenumit se hetuesia gati e ka mbaruar punën me tradhtarët Beqir Balluku me shokë, të cilët, së shpejti, do t'i kalojnë gjyqit ushtarak për gjykim.

Kiço Ngjela, ish-ministër i Tregtisë, dhe Vasil Kati, ish-zëvendësministër i po këtij dikasteri, janë përgjegjësit kryesorë të kësaj pune armiqësore, diversioniste e sabotuese. Prandaj ne morëm vendim këtu për Kiço Ngjelën që ky të përjashtohet nga Komiteti Qendror dhe nga Partia.

Faktet që zbuluam duhet ta bëjnë Partinë të ndër-gjegjshme se armiku i klasës, i brendshmi dhe i jashtmi, po na luftojnë egërsisht. Ata po na futin spiunë dhe diversantë jo vetëm në organizatat-bazë, por deri edhe në instancat e larta të Partisë dhe të shtetit.

Si qe e mundur që ngjau kjo? Nuk është hera e parë që ne ndeshemi me veprimtari të tilla. Edhe herë tjetër ka ndodhur që disa anëtarë partie të dehen nga sukseset e brendshme e të jashtme dhe të humbin vigjilencën. Edhe kësaj here mjaft anëtarëve të Partisë iu rrit mendja sa arritën të thonë: «Titizmin jugosllav e shtypëm tok me agjenturën e tij; revizionistët hrushovianë i dërrmuam e i demaskuam; ata s'mundën të kishin asnjë rezultat te ne!». Pra, te këta shokë u ngjall e u zhvillua megalomania, u nënvlerësua armiku. Flitej për vigjilencën, për luftën e klasave, për rrethimin e egër kapitalisto-revizionist, por arrihej në konkluzionin e gabuar: «Armiku s'ka ç'na bën, ne jemi të fortë!». Armiku u fsheh prapa këtyre sloganeve; ai iu adaptua ekzal-

tacioneve, psikologjisë së sëmurë e dobësive të tjera të një sërë anëtarësh të Partisë e funksionarësh të shtetit dhe arriti të zhvillojë kështu punën minuese.

Thuhej: «Të kemi besim te shokët dhe t'i kontrollojmë!». Mirëpo puna e gjithsecilit nuk kontrollohej si duhej dhe harrohej se të vetmin vlerësim të drejtë të njërit ose të tjetrit e bën kontrolli i punës. Shkohej më shumë nga parimi «Ky është shok i vjetër, ministër, anëtar i Komitetit Qendror apo i Byrosë Politike, prandaj është i imunizuar nga gabimet». Jeta na ka vërtetuar se konsiderata të tilla, që dalin jashtë normave të Partisë, janë të gabuara dhe mund të shkaktojnë dëme të mëdha për atdheun tonë socialist.

Sa herë na e ka theksuar Komiteti Qendror detyrën për rritjen e vigjilencës revolucionare?! Sa herë na është theksuar të forcojmë punën organizative të Partisë dhe të shtetit?! Sa herë na është folur për edukimin tonë me teorinë e Partisë?! Por përvoja tregon se ka pasur shokë, organizata-bazë, komitete partie dhe organizma shtetërorë që nuk i kanë zbatuar si duhet këto detyra. Faktet dëshmojnë se pikërisht në këto dobesi e të çara ka mundur të depërtojë edhe armiku.

Në Ministrinë e Tregtisë armiku ishte në kokë të saj. Elementë spiunë mbanin atje lidhje me agjencura armike, jepnin informata dhe sabotonin ekonominë. Ndërkohë, ç'bënte organizata-bazë e Partisë e këtij dikasteri? Gjumë të rëndë! Atë e kishte nënshtruar arroganca e Kiço Ngjelës dhe e shokëve të tij sabotatorë e spiunë. Shumë komunistë të këtij dikasteri filluan të hapnin gojën kur iu zbulua peta lakrorit. Po ku e kishin gojën më parë? Ku i kishin kurajën dhe guximin që ata s'ka-

në munguar të flasin për to? Kjo organizatë-bazë dhe këta komunistë që bëjnë pjesë në të, a nuk duhej të ishin në gjendje më parë nga të gjithë për ta zbuluar diversionin që zhvillohej nën mjekrën e tyre? Raporti që dërgoi Kryesia e Këshillit të Ministrave nëpërmjet Inspektimit të Shtetit, të jep një ide të qartë se sa fajtorë janë komunistët dhe punonjësit e paorganizuar në Partitë të këtij dikasteri që i lanë të livadhishnin këta banditë.

Kuadrot e punonjësit e Ministrisë së Tregtisë flasin për rrethimin kapitalisto-revizionist, po harronin se shumë prej tyre jo vetëm punonin e jetonin në botën kapitaliste e revizioniste, por kishin edhe marrëdhënie e allishverishe me armiq kapitalistë e revizionistë. Këta njerëz jo vetëm nuk mbaheshin nën kontroll të rreptë, por mbroheshin, ndihmoheshin e lavdëroheshin nga Kiço Ngjela, Vasil Kati e të tjerë. Vallë në këtë mënyrë luftohet rrethimi kapitalisto-revizionist? Kur ngjasin gjëra të tilla, a mund të thuhet se pësimet na janë bërë mësimet? A mund të thuhet, atëherë, se mbahen parasysh mësimet dhe gjithë eksperiencia e luftës së Partisë kundër armiqve?

Puna armiqësore nuk duhet konsideruar si një fatalitet, në rast se Partia lufton dhe u mbyll kështu rrugët armiqve. Puna e armiqve lë shenja, ajo të jep sinjale. Në qoftë se je vigjilent, atë mund ta diktosh menjëherë dhe ta godasësh. Në rast se për shumë arsye e humbet vigjilencën, puna e armiqve trashet, gjë që Partia vazhdimisht na e ka vënë në dukje.

Zhvillimi i tregtisë së jashtme me shtetet revizioniste dhe kapitaliste ishte shumë i dyshimtë; ai duhej të ndiqej me vigjilencë dhe sidomos kur dihet se këto

shtete kërkojnë t'i bëjnë varrin socializmit në vendin tonë. Në zhvillimin e tregtisë së jashtme shkohej me mendimin se «Tregtia është tregti, më jep të të jap». «Ç'hyn këtu politika?», predikonte Kiço Ngjela. Kjo është një pikëpamje reaksionare, pse në tregti ka politikë dhe kjo politikë varet nga fakti se si e bën dhe ç'objektiva ndjek ti e partneri yt në këtë tregti.

Kiço Ngjela përhapte përshtypjen dhe euforinë (gjë që u përpoq ta bënte edhe këtu) se me vendet revizioniste tregtia jonë është e stabilizuar; se ato kanë nevojë për mallrat tona; se ishte një fitore që me dikë nga këto shtete kjo tregti po rritej çdo vit; se po futeshim në vendet kapitaliste, mirëpo nuk shikohej se, bashkë me këto, po na futeshin edhe shërbimet e agjunkturës kapitalisto-revizioniste.

Karakteristike është se disa drejtues kryesorë të dikastereve merren me çikërrima që u përkasin të tjerëve dhe harrojnë çështjet më të rëndësishme. Këto i harrojnë në kuptimin që nuk kontrollojnë dhe nuk rektifikojnë vijën kryesore të problemeve; nuk organizojnë skeletin e shëndoshë të punës organizative dhe nuk insistojnë në edukimin politik e ideologjik të vartësve; nuk luftojnë për të arritur objektivat që kanë caktuar Komiteti Qendror dhe Qeveria.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë dhënë kurdoherë orientime, direktiva e udhëzime të drejta, në bazë të të cilave do të ecet. Ç'ngjau në praktikë gjatë zbatimit të tyre? Orientimet dhe direktivat e drejta në këta sektorë u shtrembëruan dhe u deformuan. Armiqtë fshiheshin prapa këtyre orientimeve të drejta dhe i zhvillonin ato në drejtimin e vetadministrimit ti-

tist, në sabotimin e planeve, në zhvillimin e burokratizmit, në fryrjen e aparateve dhe në krijimin e teknokratëve. Të gjitha këto shtrebrime e sabotime i mbulonin me zhurmën e sukseseve. Ata përpiqeshin dhe shumë herë arrinin që sukseset t'ua atribuonin personave të tyre dhe sistemit revizionist që orvateshin të vendosnin te ne nën maskën e socializmit.

Këtu qëndron gabimi i komunistëve, i organizatave-bazë dhe i komiteteve të Partisë që nuk shihnin veprimet sabotuese në vijë, të këtyre armiqve; nuk ballafaqonin direktivat e drejta me zbërthimin e zbatimin e tyre në praktikë, por merreshin vetëm me gjëra të dorës së dytë e të tretë dhe shumë herë cenin, pa u qederosur fare, në një rrugë të gabuar e plot rreziqe.

Kësaj pune armiqësore, këtij indiferentizmi, kësaj plogështie në punë dhe në luftë organizatat-bazë e komitetet e Partisë, ndër marrjet, kooperativat dhe dikasteret duhet t'i bëjnë një analizë të thellë politike, ideologjike, ekonomike dhe organizative.

Partia, në të gjitha instancat e saj dhe në çdo kohë, duhet të analizojë gjendjen ndërkombëtare, forcat që ndeshen në botën e jashtme, situatën te fqinjët kapitalisto-revizionistë etj. Kjo është absolutisht e domosdoshme të bëhet, përndryshe vetëm flasim për rrethimin kapitalisto-revizionist, por nuk dimë ç'është e si vepron ky rrethim; ku dhe si i drejton ai sulmet në botë, në përgjithësi, dhe kundër vendit tonë, në veçanti. Këtë gjë duhet ta njohim dhe ta riparojmë sa më shpejt. Partia dhe populli vërtet do të interesohen shumë për problemet ekonomike, por kjo nuk do të thotë të harrojnë problemet politike që ziejnë në botë dhe sido-



mos rreth nesh. Pra, a mund të lejohet që organizata-bazë e Partisë të merret me çikërrima, të bëjë llafe e pallavra pa mbarim dhe të lërë disa njerëz të veprojnë si të duan?!

Gjithmonë thuhet: «Nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë». Por a është vallë kurdoherë kështu? Jo! Po të dalë mirë puna, thuhet: «Rroftë organizata-bazë!», po të dalë keq, atëherë «Fajin e ka pushteti që s'mori masa, që nuk organizoi...» etj. Po kush është pushteti te ne? Diktatura e proletariatit. Kush e udhëheq këtë diktaturë? Partia. Atëherë a mjafton vetëm t'i afirmojmë me qindra herë këto parime dhe t'i zbatojmë dobët ose edhe t'i harrojmë fare?

Shokët duhet ta kenë të qartë se e para për çdo gjë është përgjegjëse Partia. Ata të kuptojnë se puna e pushtetit asnjëherë nuk është e shkëputur nga puna e Partisë, se puna për zhvillimin e ekonomisë është e lidhur ngushtë me punën politike, ideologjike dhe organizative të Partisë. Pa i kuptuar kështu dhe pa i lidhur ngushtë këto çështje kardinale, asgjë nuk mund të shkojë mirë.

Të gjithë anëtarët e Partisë, kuadrot dhe punonjësit duhet ta kenë kokën të ftohtë dhe zemrën të zjarrtë. Komunistët nuk duhet të marrin zjarr me një sukses, aq më tepër që ne s'kemi korrur një, por me mijëra suksese. Por në asnjë rast nuk duhet të na rrijë mendja sikur kemi arritur perfeksionin; nuk duhet të mendojmë se u arrit një sukses në një zë të planit dhe në këtë realizim nuk ka të meta, nuk ka defekte, nuk ka rezerva që janë lënë apostafat «për të qenë brenda» dhe për të dalë kështu mbi ujë, për t'u mburrur e për të ngjitur

shkallët. Suksese ne kemi e do të kemi vazhdimisht, po këto kurrë të mos na dehin dhe të mos na bëjnë të harrojmë rrethimin kapitalisto-revizionist. Ky rrethim ekziston, është real dhe vepron.

Beqir Balluku ishte agjent i vjetër i jugosllavëve dhe i sovjetikëve; Hito Çakoja e Petrit Dumja po kështu; Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Kiço Ngjela dhe të tjerë armiq e sabotatorë ishin në shërbim të të huajve. Pra, këta njerëz nuk ishin prej atyre që mund të bënin ndonjë gabim padashur. Jo! Këta ishin komplotistë, revizionistë, spiunë.

Partia jonë është një Parti e fortë dhe e kalitur, por armikun e brendshëm dhe të jashtëm nuk duhet ta nënvlerësojë. Nënvlerësimi i armikut është baras me shuarjen e luftës së klasave, që është burim i gjithë të këqijave dhe katastrofave.

Eksperienca e Partisë sonë është e madhe, politike dhe ideologjike. Ajo duhet të përvetësohet e të studiohet thellë nga komunistët, të vjetër e të rinj, nga klasa punëtore e nga rinia, se pa një ngritje të vazhdueshme ideologjike dhe politike të komunistëve e të punonjësve, punët nuk mund të na ecin mirë.

Aktualisht me dhjetëra mijë veta te ne zotërojnë shkencën dhe teknikën, po këto nuk mund të vihen në shërbim si duhet në rast se njerëzit që i zotërojnë nuk janë të edukuar edhe me marksizëm-leninizmin. Ne flasim për teknokracinë, por jemi akoma larg kuptimit të thellë të rrezikut që sjell ajo. Shihni Beqir Ballukun, Hito Çakon dhe Petrit Dumen: ata hiqeshin si ekspertë dhe teknikë ushtarakë. Edhe Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi hiqeshin si specialistë, si teknikë e

si ekonomistë. Sabotatorët e naftës ishin gjeologë, inxhinierë. Kiço Ngjela dhe Vasil Kati hiqeshin, gjithashtu, teknikë e specialistë të tregtisë. Mirëpo, ç'ngjau me ta? Ata ishin antimarksistë, kundër mësimeve të Partisë sonë dhe eksperiencës së saj, ishin antisocialistë. Por a flisnin, a lëshonin ata slogane për Partinë? Sa të duash! Po çfarë fshihnin prapa këtyre parullave? Helmin dhe thikën!

Prandaj vigjilencë, shokë, vigjilencë revolucionare! Edukim, edukim me marksizëm-leninizmin dhe me eksperiencën e Partisë sonë! Zbatim të plotë të detyrave, besim te shokët, por edhe kontroll të vazhdueshëm mbi ta! Kontroll s'do të thotë «dyshim, zënie me presh në duar», por luftë kundër degjenerimit, kalbëzimit, sabotimit, diversionit dhe shumë të këqijave të tjera. Përpara interesit të madh të Partisë, të popullit, të socializmit nuk duhet të vihet asgjë, as edhe jeta. Shokët që gabojnë duhet t'i korrigjojmë, kurse armiqve t'u shtypim kokën pa mëshirë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# KUSHTETUTA E RE KONFIRMON VIJËN E DREJTË TË PARTISË

*Fjala në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

10 tetor 1975

Sot Komiteti Qendror i Partisë ka në dorë Projekt-kushtetutën e re të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë; diskutoi për të, bëri vërejtje dhe përcaktoi procedurën më demokratike të diskutimit të saj në popull. Vërejtjet që do të bëhen nga masat e gjera të popullit, do të grumbullohen imtësisht dhe do të studiohen me kujdesin më të madh nga komisioni që do të caktojë Kuvendi Popullor.

Mendimi i Byrosë Politike është që Projektkushtetuta e re, e plotësuar me vërejtjet e popullit, të përbëjë një nga kapitujt kryesorë të raportit të Komitetit Qendror që do t'i paraqitet Kongresit të ardhshëm të Partisë. Pastaj, definitivisht, ajo do t'i dërgohet Kuvendit Popullor për diskutim dhe miratim.

Besoj se jeni dakord me këtë mendim të Byrosë Politike.

---

1. Ky Plenum, në zbatim të detyrës që shtroi Kongresi i 6-të i PPSH, diskutoi edhe për hartimin e Kushtetutës së re të RPSSH.

*Të gjithë, njëzëri, u shprehën dakord.*

Kushtetuta e re, që Partia e Punës e Shqipërisë i jep tani popullit, konfirmon në mënyrë të shkëlqyeshme vijën e drejtë që ka zbatuar ajo për më shumë se tri dekada. Nëpërmjet Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, Partia e udhëhoqi popullin shqiptar në fitore dhe i dha vendit Kushtetutën e Parë të Republikës, në vitin 1946. Me Partinë në krye, populli ynë po ndërton me sukses socializmin.

Kushtetuta e vjetër, që është në fuqi, është ligji themeltar i Republikës sonë të re Popullore, për të cilën u derdh gjak. Me një luftë heroike populli ynë theu pushtuesit e huaj të vendit, mundi dhe likuidoi klasën e feudalëve dhe të borgjezisë, shkatërroi pushtetin e vjetër feudo-borgjez të satrapit Zog dhe krijoi që nga themelet, qysh gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, pushtetin e demokracisë popullore, një formë e diktaturës së proletariatit. Kushtetuta e vitit 1946, nëpërmjet diskutimit të madh popullor, i konfirmoi të gjitha këto fitore dhe një sërë të tjerash të rëndësishme në lëmin e ekonomisë, të arsimit e të kulturës, në perfeksionimin dhe në forcimin e pushtetit të këshillave popullore, në organizimin dhe në forcimin e mbrojtjes së atdheut, në përcaktimin e të drejtave dhe të detyrave të qytetarëve. Të gjitha këto u zhvilluan edhe më tej.

Populli shqiptar, nën udhëheqjen e sigurt të Partisë së tij të Punës, pararojë e çeliktë e klasës punëtore, u bë zot i fateve të veta. Kushtetuta që aprovoi ai luajti një rol të rëndësishëm në ndërtimin e socializmit, në forcimin e unitetit të popullit në luftën kundër armiqve, të jashtëm e të brendshëm.

Partia e Punës e Shqipërisë, si një Parti e vërtetë marksiste-leniniste, me një hov revolucionar dhe me një frymë të lartë patriotike, duke u bazuar në Kushtetutën, diti të zhvillonte me zotësi programin e saj madhështor që kishte për synim lirinë dhe begatinë e popullit, sovranitetin dhe mbrojtjen e pavarësisë së atdheut, ndërtimin e shoqërisë socialiste. Ishte periudha e ndërtimit dhe e konsolidimit të fitoreve të Luftës Nacionalçlirimtare; ishte periudha kur populli ynë trim, i dalë nga kjo luftë, tregoi aq zotësi të rralla, aq mprehtësi në mendime, aq forcë fizike, shpirtërore e organizative, sa që në një kohë të shkurtër, rekord, rinjëtoi me forcat e veta vendin e shkatërruar. Populli ynë, i udhëhequr nga Partia e tij, eci me hov të madh përpara; përvetësoi me etje dhe me efikasitet diturinë e shkencën dhe i zbatoi ato me sukses, duke i mbrytur me eksperiencën e vet të madhe shekullore; ai ngriti një industri të fuqishme; ndërtoi bujqësinë socialiste në fshat; mbushi vendin me shkolla; mbrojti shëndetin e njerëzve; ngriti gruan shqiptare në piedestalin e historisë. Në këto fitore popullin e frymëzuan, e organizuan dhe e udhëhoqën klasa punëtore dhe Partia e saj.

Të gjitha këto u arritën me luftë dhe asnjëherë me qetësi. Lufta e Partisë dhe e popullit tonë kundër diversionit armik imperialist amerikan, kundër titizmit, kundër fraksionistëve e tradhtarëve, lufta kundër revizionizmit modern, me socialimperialistët e egër sovjetikë në krye, kanë qenë titanike. Në këto luftëra, ku luhej fati i çdo gjëje të fituar me gjak e me djersë, populli dhe komunistët u kalitën, mësuan si të luftonin

më mirë në situata të reja, kuptuan se regjimi i diktaturës së proletariatit është arma për të shtypur borgjezinë, kulakërinë, çdo tradhtar, çdo deviator, çdo armik të popullit dhe të socializmit. Në këto luftëra Partia e mësoi popullin se si të zhvillonte luftën e klasave, demokracinë popullore, proletare dhe centralizmin demokratik, pa të cilët nuk mund të ndërtohet socializmi.

Pra, siç po e shohim, Kushtetuta e vjetër luajti një rol të madh: Shqipërisë iu hapën rrugë të reja, nëpër të cilat populli çau përpara dhe bëri ndryshime të thella. Të gjitha këto përpertime të mëdha që arriti populli me forcat e veta, nën udhëheqjen e Partisë, duhet të shërbejnë si bazë e fuqishme për të ecur përpara, për të korrur fitore të tjera akoma më të mëdha.

Partia, në prizmin e dialektikës marksiste-leniniste, duke analizuar drejt situatën e zhvillimit të atdheut tonë, fazën më të përpeluar të ndërtimit të socializmit dhe perspektivën, mendoi dhe vendosi të hartohej një kushtetutë e re, që të ishte e përshtatshme për situatat shoqërore aktuale të krijuara në vend, një kushtetutë në zhvillim të së parës, por që t'u përgjigjej ndryshimeve shoqërore, ekonomike, kulturore dhe të mbrojtjes që janë kryer te ne.

Projektkushtetuta e re, siç po e shohim, është një dokument bazë me rëndësi të madhe politiko-ideologjike, juridike etj., është një nga kushtetutat më të përparuara e më revolucionare të një shteti socialist, për arsye të shumë parimeve themeltare të saj, që janë të bazuara në marksizëm-leninizmin.

Direktivat e Kongresit të 6-të të Partisë, që udhëhoqën Komitetin Qendror dhe komisionin që krijoi ky,

ishin të tilla që Kushtetuta e re, si ligji themeltar i Republikës sonë Popullore Socialiste, të udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, të theksojë realitetin e madh të ndërtimit të socializmit. Kjo për ne do të thotë që vetë emërtimi, nga «Republika Popullore e Shqipërisë» në «Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë», të pasqyrojë besnikërisht realitetin tonë të madh, zhvillimin e vërtetë të vendit tonë dhe të konkretizojë arritjen e një etape të re të programit të madh që realizoi me sukses populli ynë, nën udhëheqjen e pagabueshme të Partisë së tij marksiste-leniniste.

Kjo praktikë vërteton teorinë, sipas së cilës, pa udhëheqjen e klasës punëtore dhe të partisë së saj marksiste-leniniste nuk mund të ndërtohet socializmi. Në hartimin e Projektkushtetutës u zbatuan direktivat e Kongresit të 6-të, duke bërë që në përmbajtjen e çdo neni të saj të afirmohet teoria marksiste-leniniste, e zbatuar besnikërisht në mënyrë shkencore dhe me konsekuencë në kushtet e vendit tonë.

Në nenin dy të projektit të Kushtetutës përcaktohet se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është shtet i diktaturës së proletariatit. Kjo do të thotë se shteti te ne është makinë në duart e proletariatit, që shtyp borgjezinë. Ky është një fakt dhe një realitet historik në përputhje të plotë me shkencën marksiste-leniniste dhe me realitetin tonë të kalimit nga rendi kapitalist në rendin socialist.

Kushtetuta e re, duke ligjëruar se Republika jonë Popullore Socialiste është shtet i diktaturës së proletariatit, nuk krijon as më të voglin ekuivok dhe demas-



kon teorinë antimarksiste të revizionistëve sovjetikë që, në këtë etapë kalimtare, kanë zhdukur diktaturën e proletariatit dhe e kanë zëvendësuar atë me «shtetin e gjithë popullit». Për armiqtë e marksizëm-leninizmit e të socializmit kjo do të thotë shuarje e luftës së klasave, heqje dorë nga marrja e fuqisë prej klasës punëtore dhe dhënie e frenave të shtetit borgjezisë së re socialimperialiste fashiste.

Me Kushtetutën e re Partia riafirmon me forcë dhe ligjëron se diktatura e proletariatit duhet forcuar e kalitur dhe se në asnjë moment nuk duhet lejuar që kjo të dobësohet. Diktatura e proletariatit spikat thellë në të gjitha nenet e Projektkushtetutës së re, në thelbin dhe në esencën e tyre, pse Partia udhëhiqet dhe zbaton me konsekuencë marksizëm-leninizmin, i cili na mëson se çështja kryesore e revolucionit është çështja e pushtetit dhe ky pushtet për marksistë-leninistët është diktatura e proletariatit, me klasën punëtore në fuqi dhe me partinë e saj në krye.

Revizionistët modernë jo vetëm janë kundër diktaturës së proletariatit, siç thamë më lart, por, në vijim të kësaj, kanë shtrembëruar dhe kanë shkatërruar të gjitha mjetet, metodat, stilin, brendinë e ushtrimit të kësaj diktature, në të gjitha sferat: në ndërtimin dhe në funksionet e aparateve shtetërore; në organizimin dhe në drejtimin e ekonomisë socialiste, për ta kthyer këtë në një ekonomi kapitaliste; në likuidimin e ushtrimit të diktaturës mbi gjithë superstrukturën; në sferat e arsimit, të arteve dhe të kulturës në përgjithësi.

Të gjitha këto probleme kapitale, parimore, për

të cilat Partia ka luftuar dhe lufton me sukses, janë pasqyruar në Kushtetutën e re.

Partia e ka të qartë se lufta që bën për ruajtjen e pastërtisë ideologjike marksiste-leniniste në radhët e veta, është kalitja nga ana e saj e një uniteti sa më të madh, në mendim dhe në veprim. Këndeje varet edhe uniteti i popullit, kusht kryesor i forcës së shtetit tonë të diktaturës së proletariatit. Jeta ka provuar se Partia dhe ligjet që ajo ka vendosur frymëzohen nga një demokraci e gjerë proletare, e cila ndryshon katërcipërisht nga e ashtuquajtura demokraci borgjeze. Demokracia proletare përforcon frymën revolucionare të njerëzit, forcon centralizmin proletar, pa të cilët nuk mund të ndërtohet socializmi.

Këto parime figurojnë në nene të ndryshme të Projektkushtetutës së re që do të kthehen në ligje dhe nga më kryesoret. Nga kuptimi i thellë i këtyre parimeve bazë dhe nga zbatimi drejt e me konsekuencë i tyre pushteti shtetëror lidhet ngushtë me masat dhe këto, me klasën punëtore në krye, marrin pjesë fuqimisht në pushtet e njëkohësisht e kontrollojnë këtë për ta ruajtur nga devijimet dhe nga veprimtaritë armiqësore. Kuptohet, pra, se sa jetëdhënëse dhe shpëtimtare është këmbëngulja e Partisë në kërkesën e saj që njerëzit, klasa, masa dhe kuadrot të mësojnë marksizëm-leninizmin. Vetëm në këtë mënyrë ata do të kuptojnë drejt e thellë zhvillimin e vendit tonë në socializëm, arsyet e këtij zhvillimi pozitiv, si dhe anët negative që dalin si pengesë në rrugën e këtij zhvillimi. Vetëm në këtë mënyrë ata do të kuptojnë dhe do të zbatojnë drejt nënën e Kushtetutës së re të Republikës Popullore So-

cialiste të Shqipërisë. Republika jonë ecën dhe do të ecë përpara, revolucioni vazhdon dhe do të vazhdojë në kushtet e diktaturës së proletariatit dhe nëpërmjet luftës klasore.

Projektkushtetuta e re i vë rëndësi dhe përcakton si duhet detyrën e madhe të mbrojtjes së atdheut, forcimin dhe kalitjen e armëve të diktaturës: të Ushtrisë Popullore, të reparteve të ndryshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të organeve të Sigurimit të Shtetit. Ajo i vë këto armë, ashtu siç kanë qenë, në shërbim të popullit punonjës, në shërbim të Republikës Popullore Socialiste dhe, si gjithmonë, nën drejtimin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Partia, si çdo problem, edhe atë të mbrojtjes e trajton si një problem kapital, nga pozita klasore, në prizin e luftës së klasave si në organizimin, edukimin, armatimin dhe veprimet e tyre. I tërë populli duhet të jetë ushtar, të edukohet që të mbrojë atdheun dhe socializmin. Kjo do të thotë që me revolucionin popullor lufta e klasave zhvillohet në plan të brendshëm dhe të jashtëm, ashtu si është gërshetuar edhe veprimtaria e armiqve, që kanë qëllim të shkatërrojnë socializmin në Shqipëri dhe të rivendosin kapitalizmin.

Projekti i ri i Kushtetutës, duke sanksionuar paprekshmërinë e kufijve të shenjtë të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe sigurimin me çdo kusht të truallit tonë kombëtar, dënon si tradhti ndaj atdheut çdo akt që drejtohet nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm kundër lirisë dhe pavarësisë së tij. Për këtë arsye projekti në mënyrë kategorike parashikon që askujt të mos i njihet e drejta të nënshkruajë ose të.

pranojë në emër të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kapitullimin ose pushtimin e vendit.

Projektkushtetuta e re e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në nenet e saj mishëron mësimet e mëdha të Partisë, vigjilencën revolucionare, goditjen e shpartallimin e pamëshirshëm të armiqve, si dhe forcimin e kalitjen e edukimit klasor. Përcaktime shumë të qarta, me rëndësi të madhe janë bërë në projektin e ri lidhur me organizimin, me funksionet, me kompetencat, me varësinë e centralizuar, me zgjedhjen, me dhënien llogari përpara klasës e masës të të gjitha organeve ekzekutive e legjislative, duke filluar që nga këshillat popullore në bazë dhe deri te Kuvendi Popullor, që është organi më i lartë i pushtetit shtetëror, i udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë.

Të gjitha këto nene të rëndësishme të projektit të Kushtetutës sintetizojnë në mënyrë shkencore atë vijë të drejtë të Partisë sonë, atë eksperiencë kolosale prej dekadash të tëra që ka zhvilluar ajo për t'i përsosur organet e pushtetit dhe njerëzit që zgjidhen e punojnë në to, të cilët i ka hedhur vazhdimisht në luftëra e në revolucion, për t'i dhënë një zhvillim të madh ekonomisë, për të formuluar shkencërisht dhe për të zbatuar planin unik të përgjithshëm të shtetit. Me edukimin e pandërprerë të saj, Partia e Punës e Shqipërisë e ka bërë pushtetin e këshillave popullore të gjallë e revolucionar dhe e ka vënë atë plotësisht në shërbim të masave, duke bërë të mundur që te ne jo vetëm të kuptohet, por edhe të zbatohet me konsekuencë parulla e madhe e Kushtetutës «Pushteti buron nga populli dhe i përket popullit».

Dispozitat e projektit të Kushtetutës u hapin masave të gjera perspektivën e ndritur që ky pushtet të bëhet akoma më shumë revolucionar, veprues e luftarak kundër burokratizmit, rutinës, teknokratizmit, plogështisë dhe gjithë të këqijave të tjera që rrjedhin nga mbeturinat mikroborgjeze dhe nga veprimtaria e armiqve të jashtëm e të brendshëm. Qëllimi i këtyre armiqve është kurdoherë dobësimi dhe shndërrimi i pushtetit popullor në një pushtet të borgjezisë. Prandaj Partia na mëson (dhe projekti i Kushtetutës i ligjëron këto mësimë), që të punojmë vazhdimisht për ta ruajtur, për ta forcuar e për ta kalitur këtë pushtet, që ai të zhvillohet drejt dhe të modernizohen lidhjet e organeve të zgjedhura me ato të emëruara.

Një pushtet modern socialist nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të ekzistojë në rast se nuk zbatohen vija e masave, kontrolli punëtor e fshatar sipas mësimëve të Leninit, demokracia socialiste proletare dhe centralizmi demokratik.

Partia jonë në të gjitha këto fusha jetike të ndërtimit të socializmit ka një eksperiencë të gjerë dhe ka dhënë një kontribut të ri në zhvillimin e në zbatimin konkret të mësimëve të mëdha të mësuesve tanë të pavardekshëm në kushtet aktuale që po e ndërtojmë ne socializmin.

Projektkushtetuta e re përcakton dhe zhvillon më tej perspektivën e zhvillimit të ekonomisë së planifikuar dhe të centralizuar. Ajo bën përcaktime të drejta, shkencore, marksiste-leniniste për pronësinë socialiste në dy format e saj: shtetërore dhe kooperativiste, dhe për pronën vetjake të shtetasve, të cilat ekzistojnë ak-

tualisht të ne, dhe hap horizonte të reja për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre lloj pronave, drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë pa klasa.

Këto përcaktime të drejta shkencore do t'i japin një hov të madh zhvillimit të harmonishëm të industrisë, të bujqësisë e të kulturës sonë socialiste, gjë që u shërben direkt përmirësimit të vazhdueshëm të mirëqenies së popullit dhe mbrojtjes së atdheut. I tërë ky zhvillim i harmonishëm, i pandalshëm, siç na mëson Partia dhe siç e përcakton edhe Projektkushtetuta, do të mbështetet në forcat e popullit tonë.

Projektkushtetuta e re, me qartësinë më të madhe, pasqyron vijën e Partisë në lidhje me parimet që duhet të udhëheqin marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit tonë proletar. Vija e Partisë së Punës të Shqipërisë është bazuar dhe do të bazohet kurdoherë në teorinë tonë të pagabueshme marksiste-leniniste dhe çdo veprim do të shkojë në këtë shoshë, duke mbrojtur, në radhë të parë, interesat e popullit tonë dhe të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Me shekuj popullin tonë heroik armiqtë e kanë robëruar, e kanë vrarë, e kanë djegur, i kanë shkelur e i kanë copëtuar atdheun, e kanë mashtruar, duke u hequr si miq, por, në fakt, kanë vepruar si ujq. Veçse një gjë nuk kanë arritur të bëjnë dot armiqtë tanë shekullorë e të shumtë: kurrë nuk e kanë zhdukur dhe as e kanë përgjunjur dot popullin tonë heroik. Për një popull të tilië ne bijtë dhe bijat e tij duhet të punojmë brez pas brezi me të gjitha forcat, të japim edhe jetën, pa e kursyer aspak, në çdo moment që ta lypë nevoja. Përvoja e hidhur dhe e tmerrshme e së kaluarës është

bërë mësim i madh për popullin dhe për Partinë tonë. Prandaj Projektkushtetuta e re përcakton drejt vijën që duhet të ndiqet. Në nenet e saj thuhet: «Ndalohej dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe i institucioneve të tjera ekonomike e financiare të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe me shtete kapitaliste borgjeze e revizioniste dhe marrja e kredive prej tyre».

Jo vetëm në të kaluarën, kur armiqtë e popullit tonë, me njëqind flamurë në xhep, e kishin bërë atdheun monedhë tregu, por dhe sot, në të gjitha vendet ku nuk zbatohen këto parime të mëdha, popujt robërohen nga kapitalistët dhe imperialistët, humbin lirinë dhe pavarësinë, kridhen në mjerime, në uri dhe kërcënohen nga vdekja. Për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë këto kohë kanë perënduar, kanë hyrë në histori dhe nuk do të përsëriten kurrë më, pse atë e mbrojnë Partia dhe populli.

Statuti themeltar i Republikës sonë Popullore Socialiste përcakton se Shqipëria është vendi i të drejtave të barabarta në mes burrit dhe gruas, vendi ku të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit, vendi ku respektohen me rreptësi marksiste-leniniste të drejtat e pakicave kombëtare, vendi ku puna është nder dhe burimi kryesor i mirëqenies ekonomike dhe shpirtërore, vendi i vëllazërimit të ngushtë të qytetarëve me fshatarët, vendi ku, me një hov të papërshtkruar revolucionar, me një patriotizëm të flaktë, i frymëzuar nga Partia jonë e dashur, tërë populli lufton për ngushtimin e dallimit thelbësor fshat-qytet, të dallimit midis punës mendore dhe punës fizike.

Rrojmë në momente frymëzuese dhe heroike që

i krijoi Partia, ushtarë besnikë të së cilës jemi edhe ne. Prandaj, ashtu si ju, edhe unë jam dakord me Projektkushtetutën e re.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



# KONTRADIKTAT MIDIS ARMIQVE T'I SHIKOJMË NË PRIZMIN E INTERESAVE TË POPUJVE E TË REVOLUCIONIT

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës*

16 tetor 1975

*Pasi i uroi mirëseardhjen dhe u përshëndet me ambasadorin, duke folur për disa detyra internacionale të partive marksiste-leniniste, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Të gjithëve na bie detyra t'i ndihmojmë popujt në revolucionin që bëjnë kundër imperializmit, kundër socialimperializmit dhe borgjezisë.

«Popujt duan çlirim», thotë Mao Ce Duni. Po kush i shtyp popujt? Klikat imperialiste, socialimperialiste dhe borgjezia kapitaliste, prandaj kundër këtyre klikave ne duhet të luftojmë.

Ne i ndihmojmë popujt që duan revolucionin dhe që luftojnë për çlirimin e tyre. Ndhima jonë është dhe duhet të jetë e atillë që të ndihet nga ana e tyre. Ne nuk e eksportojmë revolucionin, por duhet të luftojmë njëkohësisht edhe eksportimin e kundërrevolucionit. Hrushovi bërtiste shumë se «nuk e eksportonte revolu-

cionin», por ai me shokët e tij punonin «për të importuar» në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera kundërrevolucionin.

Këtë armiqtë e bëjnë për të shtypur popujt, për të krijuar situata të vështira për ta. Për marksistë-leninistët ka rëndësi të madhe që gjithë politika jonë në revolucion të shikohet në përmbajtjen e vet klasore, sepse ky, siç na mësojnë Marksi dhe Lenini, është qëndrimi më i drejtë për ne.

Luftën e klasave duhet ta zhvillojmë edhe brenda vendit, por edhe jashtë, sepse armiqtë e brendshëm tek ata të jashtëmit gjejnë mbështetjen e tyre, bile tek ata e kanë shpresën, pse, përpara oqeanit të pafund të popujve, të popullit të madh kinez, të popullit shqiptar dhe të të gjithë popujve të tjerë, ata janë një grusht i vogël. Këtë e dinë edhe vetë, prandaj, për të na luftuar ne, marrin iniciativë, mundohen të përfitojnë nga rrethanat dhe nga koniunkturat. Megjithatë nuk kanë çfarë të na bëjnë po të jemi vigjilentë. Ama, në qoftë se na zë gjumi, atëherë po, do të na hipin në kurriz. Por marksistët kurrë nuk duhet t'i zërë gjumi apo t'u shkojë në mendje që të prehen. Ata në asnjë rast dhe për asnjë minutë nuk duhet të mendojnë dhe të veprojnë kështu. Marksistët e vërtetë rrinë edhe pa gjumë, me të vetmin qëllim që populli të punojë e të rrojë i qetë, ndryshe atij mund t'i ndodhin fatkeqësi të mëdha.

Sot morëm një sihariq të gëzueshëm: përfundoi me sukses furrnalta në Elbasan. Ky është një sukses i madh për Shqipërinë. Do të përpiqemi që të zbulojmë në vendin tonë antracit të koksifikueshëm. Këtë detyrë i kemi vënë vetes. Po kërkohet në këtë drejtim dhe disa

shenja kemi. Qymyri i këtij lloji ka 8-9 mijë kalori për kilogram, por akoma nuk është vërtetuar nëse ka apo jo në sasi të që nevojiten, se është një çikë e zorshme kjo punë. Megjithatë ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet për të gjetur, ndryshe do të na duhet të importojmë koks, meqenëse qymyret tona janë të dobëta, jo të mira për nevojat e metalurgjisë. Në Evropë qymyr të tillë ka me shumicë në Poloni dhe në Gjermaninë Perëndimore, sidomos në rajonin e lumit Rin, ka pastaj edhe në Luksemburg. Firmat e mëdha kapitaliste, si ato të Krupit e të tjerëve, me atë qymyr punojnë. Ata kanë kështu qymyrin e tyre, po ata janë armiqtë tanë.

Polonia është, si të thuash, e okupuar, populli atje vuan nën thundrën e ushtrisë sovjetike dhe të tradhtarëve revizionistë polakë. Revizionistët modernë flasin për të ashtuquajturën Republikë Socialiste të Polonisë në Evropë, por kjo në fakt është nën sundimin dhe shtypjen koloniale të socialimperialistëve sovjetikë. Është karakteristike se revizionistët sovjetikë ushtarët që kanë në vendet që dikur ishin demokraci popullore përpiqen më tepër t'i mbajnë për të nënshtruar popujt e këtyre vendeve sesa për t'i përdorur në një luftë të afërt në Evropë.

Bashkimit Sovjetik i duhet ta ruajë me kujdes gjithë territorin që shtrihet nga kufiri i Gjermanisë Perëndimore deri në atë të vetin. Bëhen përpjekje që gjithë kjo hapësirë të jetë nën thundrën e ushtrisë sovjetike, e cila, po të rrezikohet Bashkimi Sovjetik prej ndonjë sulmi nga perëndimorët, të ketë fushë veprimi, përpara se kundërshtari të arrijë në territorin sovjetik. Por vendet Perëndimore, tash për tash, nuk do të sul-

mojnë. Mund të thellohen kontradiktat midis vendeve kapitaliste të Perëndimit e Bashkimit Sovjetik dhe dialektikisht këto do të thellohen patjetër, por të gjitha vendet perëndimore, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të përpiqen t'i shpartallojnë forcat ushtarake sovjetike në vendet e ish-demokracisë popullore, duke përgatitur terrenin që ta krimbin gjendjen nga brenda në këto vende, derisa të arrijnë që hungarezët, polakët e të tjerë ta luftojnë vetë Bashkimin Sovjetik.

Ne shikojmë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik po bëjnë sot një luftë të ashpër për zona të influencës. Sipas mendimit tonë, amerikanët kanë në plan ta likuidojnë influencën sovjetike nga gjithë Lindja e Mesme, nga bregdeti verior i Afrikës dhe të arrijnë që gjithë shtetet e Evropës Perëndimore të jenë në aleancë vetëm me ta. Në pamjen e jashtme duket sikur Shtetet e Bashkuara të Amerikës po tërhiqen, por në fakt ato sulmojnë, duke korrur fitore, por, natyrisht, duke pësuar edhe disfata. Edhe sovjetikët kështu veprojnë, sulmojnë me fitore, por pësojnë edhe disfata. Prandaj mendojmë që popujt duhet të ndihmohen për t'i dobësuar akoma më tepër të dyja superfuqitë, sepse e vetmja forcë që i tmerron ato janë popujt. Superfuqitë kanë frikë grevat dhe demonstratat e vazhdueshme që bëhen nga klasa punëtore dhe nga masat e tjera punonjëse në të katër anët e botës. Ne mendojmë se për të gjitha këto imperialistët, me ata amerikanë në krye, socialimperialistët sovjetikë dhe të gjitha klikat e tjera borgjeze kapitaliste reaksionare që sundojnë popujt në vende të ndryshme, janë në krizë të

madhe, jo vetëm ekonomike, por edhe ushtarake, edhe politike, në drejtim të grupimeve të forcave, partive e të tjera. Në këtë krizë, me anën e socialdemokracisë, me disa elementë që gjoja hiqen socialdemokratë, ata përpigën të gënjejnë masat.

Në Spanjë masat po ngrenë krye dhe po luftojnë; në Portugali ndodh e njëjta gjë; në Itali bëhen greva të mëdha; në Francë po kështu. Çfarë rezulton? Si socialdemokracia, edhe revizionistët përpigën të gënjejnë masat.

Është kështu, shoku ambasador?

Ka kontradikta të mëdha midis armiqve të popujve dhe pikërisht këto kontradikta ne duhet t'i shfrytëzojmë. Por midis tyre nuk ekzistojnë vetëm kontradikta. Brenda në vendet kapitaliste ekzistojnë edhe fraksione, disa nga të cilat përbëhen nga revizionistë dhe hiqen me sovjetikët, ka të tjerë që janë me amerikanët, siç janë socialistët e djathtë. Por në vendet kapitaliste jetojnë e luftojnë edhe marksistët, si fjala vjen ata të Spanjës. Atje ka, gjithashtu, falangistë, demokristianë e revizionistë, por mbi të gjithë këta, në vendet kapitaliste, ka popuj që punojnë dhe luftojnë kundër shfrytëzimit kapitalist.

Ja një shembull konkret: Në Spanjën e Frankos pushkatohen pesë veta, tre nga të cilët ishin marksistë-leninistë dhe dy të tjerë patriotë baskë. Me ta ishin edhe dy gra, të cilat u falën. Gjithë populli spanjoll u ngrit në këmbë në mbrojtje të këtyre luftëtarëve anti-frankistë, u ngritën në këmbë edhe popujt e vendeve të tjera. Në përkrahje të tyre doli bile edhe borgjezia. Po pse borgjezia doli në mbrojtje të patriotëve spanjollë?

Sepse ajo kërkon të përfitojë nga heroizmi i popullit dhe i komunistëve. Kur përpigjet të përfitojë ajo, atëherë ne, që jemi revolucionarë, çfarë duhet të bëjmë? Ne duhet të jemi patjetër në ballë të këtyre protestave për liri, demokraci, pavarësi<sup>1</sup>.

E kam këtu çështjen, që kontradiktat e armiqve duhet t'i shikojmë në prizmin e madh të interesave të popujve dhe të revolucionit. Për të realizuar synimet kundërrevolucionare, armiqtë kanë edhe këlyshët e tyre, që luajnë rolet e veta, si instrumentistët nëpër orkestrat: njëri i bie «violinës së parë», tjetri «së dytës» etj., prandaj na bie detyra që ne t'i vulosim «violinat» e armiqve. Kështu, po të arrijmë që me luftë të shterojmë burimet që fuqizojnë imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, ata do të mbeten me siguri si peshku pa ujë. Dihet që sovjetikët kanë plane agresive në Evropë, por ata plane të tilla kanë edhe në Azi, sidomos për Kinën, në kufijtë e së cilës kanë përqendruar një milion ushtarë, kanë vendosur atje edhe raketa. Ata janë futur në Indi, përpigjen të futen në Singapor, në Tajvan, gjithashtu, përpigjen shumë të futen në Kamboxhia.

Armiqtë nuk i hedhin armët. Ata bëjnë luftë të pjesshme, pse kjo u shërben atyre për të forcuar më parë pozitat, për të siguruar tregje. Edhe këtu midis

---

1. Shoku Enver Hoxha ia thotë këto fjalë ambasadorit kinez sepse, siç shkruan ai në veprën e tij «Shënime për Kinën», ndërsa e gjithë bota u ngrit në këmbë, «...«Kina socialiste revolucionare e Maos» nuk tha asnjë fjalë për heronjtë spanjollë!». (Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 153.)

tyre ka një kontradiktë të madhe. Si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik nuk arrijnë të shpërthejnë luftën botërore, se këtë e kanë frikë të dy. Në mendojmë se kontradiktat midis tyre do të acarohen, por aktualisht, krahas kontradiktave me njëri-tjetrin, ata ndjekin edhe taktikën e bashkëpunimit.

Dje lexova një fjalim që kishte mbajtur Henri Kissinger, i cili u kishte thënë astronautëve sovjetikë: Është e vërtetë që dy vendet tona kanë kontradikta me njëri-tjetrin, por e shikoni se si bashkëpunuan astronautët tanë me ju? Kemi edhe kontradikta midis nesh, por edhe bashkëpunojmë, kemi gjëra që na ndajnë, por kemi edhe të tjera që na bashkojnë «për mbrojtjen e paqes».

Në Lindjen e Mesme tash amerikanët luftojnë për Egjiptin, sovjetikët për Sirinë. Siria ngrihet kundër Egjiptit, siç bëri ministri i Jashtëm sirian në Organizatën e Kombeve të Bashkuara që sulmoi atë të Egjiptit, duke e akuzuar se egjiptianët kanë tradhtuar, pastaj ngrihet ky i Egjiptit dhe sulmon ministrin e Sirisë. Të tilla ngjarje kontradiktore ndodhin atje, sepse nga njëra anë veprojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik, që përpiqen t'i vënë bërnylin njëri-tjetrit. Por kur e do interesi i përbashkët, të dy këto shtete i vijnë edhe në ndihmë njëri-tjetrit. Kjo tregon se midis këtyre dy fuqive të mëdha ka kontradikta, por me luftë dhe me përpjekje arrijnë në ujdi midis tyre.

Revizionistët sovjetikë kanë nënshkruar traktate të reja me Poloninë, Hungarinë dhe Gjermaninë Lindore,

me të cilat i kanë hedhur këto vende në kthetirat e tyre. Kështu bënë ata edhe me Çekoslllovakinë, edhe me Bullgarinë. Klika brezhnjeviane në Bashkimin Sovjetik shtyp popullin e vet e të vendeve të tjera, ashtu siç bëjnë përfaqësuesit e monopoleve të mëdha imperialiste amerikane, Niksonët e Fordët, e kështu me radhë, siç bën dhe borgjezia e madhe franceze, angleze etj. në vendet e tyre. Detyra jonë është t'i demaskojmë këto veprime kundër popujve.

Natyrisht, popujt do të fitojnë, por në luftën që bëjnë, duhet edhe të ndihmohen.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
"Kundër revizionizmit mo-  
dern 1971-1975" (Përmbledhje  
veprash), f. 603*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, "Kundër rev-  
zionizmit modern 1971-1975"  
(Përmbledhje veprash), f. 603*



# STUDIMET PËR NAFTËN TË VAZHDOHEN NË RRUGË TË DREJTË, ME FRYMË PARTIE DHE ME METODA SHKENCORE

Shënime

17 tetor 1975

Shokëve sekretarë dhe shokut Pali Miska, që më raportuan për shpimin e puseve për gaz në Bishtin e Pallës, u rekomandova këto çështje:

**Për naftën:** Studimet duhet të vazhdohen në rrugë të drejtë, në frymë partie dhe me metoda shkencore. Asnjëherë të mos harrohen disa gjëra: zbulimi i punës armiqësore krijoi një traumë të madhe. Po s'u shërua kjo në rrugë dhe me metoda partie, mund të mos e marrin veten si duhet dhe sa më shpejt kuadrot e punëtorët.

Të mos harrojmë se ka kuadro që kanë gabuar e që duhen ndrequr dhe edukuar. Këta t'i njohin dhe t'i korrigjojnë me punë gabimet e tyre. Ka kuadro që kanë gabuar vetëm në disa çështje dhe janë «të vrarë»; edhe këta duhet të njohin gabimet dhe të gjallërohen, të punojnë më mirë. Ka të tjerë që s'kanë gabuar, por janë të mefshtë, indiferentë, kanë frikë të flasin se

mos gabojnë, s'marrin përgjegjësi. Këtyre duhet t'u lutim frymën revolucionare. Më në fund janë të mirët, punëtorët, teknikët e mesëm dhe kuadrot me arsim të lartë. Këtyre të mos u rritet mendja, të mos kthehen në arrogantë dhe prepotentë ndaj kategorisë së kuadrove të mësipërm. Partia duhet të kujdeset shumë për të gjithë, të mbështetet tek të mirët që të ndreqë e të edukojë edhe të tjerët dhe të gjithë të bëhen të mirë.

Çështja tjetër: Në bazë të të dhënave tona shkencore dhe të literaturës botërore, duhet të përcaktohen botëkuptime dhe aksioma të drejta për gjeologjinë e vendit tonë. Kam frikë se ekziston një mendim i përgjithshëm i gabuar se «ndërtimi gjeologjik i vendit tonë është diçka i veçantë, shumë i thyer» etj., etj. Nga kanë dalë këto teori dhe si janë rrënjësuar këto koncepte gjoja shkencore? Këto rrjedhin nga shkolla sovjetike ku kanë mësuar njerëzit e parë të sektorit të naftës të ne, shkollë që nuk e njihin strukturën gjeologjike të vendit tonë, si dhe nga specialistët sovjetikë të naftës që erdhën gjoja të na ndihmonin, por në të vërtetë na sabotuan. Këta rrënjësën në kokën e kuadrove tanë të rinj lloj-lloj konceptesh joekzakte për strukturën gjeologjike të vendit tonë, koncepte të bazuara në interpretime të gabuara dhe joshkencore të studimeve të fushave tona të naftës. Studime të tilla janë bërë shkel e shko dhe mendoj se në sovjetikët ka predominuar tendenca për të sabotuar, siç na sabotuan më vonë. Ata u përpoqën që të bindnin njerëzit tanë (dhe kësaj të disa ia arritën), se «ndërtimi gjeologjik i vendit tonë paraqitet shumë i thyer, nuk ka fusha, ekzistojnë vetëm pellgje e linza» etj., etj., prandaj, edhe në rast se

shpojmë e nuk gjejmë naftë, faji s'qëndron në shkencën, as në shkencëtarët, por në «ndërtimet gjeologjike speciale të terrenit tonë». Në fakt, kur ishin specialistët sovjetikë te ne, nafta dilte në fushat e njohura më parë: në Qytetin Stalin, Patos e Marinzë. Sovjetikët nuk na zbuluan fusha të reja përveç atyre që kishin zbuluar të tjerët.

Ky është problemi bazë që duhet të argumentohet drejt. Të dhëna kemi shumë, por duhet të bëhen debate shkencore e të hidhen poshtë konceptet e gabuara. Kjo të bëhet seriozisht, ndryshe do të ecet në tym, pse këndej kanë rrjedhur një sërë gabimesh të rënda:

a) Studimet gjeologjike të pikave ku do të shpohej s'janë bërë hiç mirë, jo vetëm se na kanë sabotuar, siç dihet, por edhe sepse janë bazuar në koncepte gjeologjike të përgjithshme e të gabuara. Pra këto studime, në shumë raste, rezultuan jo të sakta, edhe kur nuk ka pasur qëllim sabotimi.

b) Një formë tjetër sabotimi konsistonte në mosstudimin si duhej të pikës ku do të shpohej, nisur nga mendimi se «është e natyrshme që mund të shpojmë edhe 16 puse dhe të biem në një», pse terreni ynë «është special», «është i vështirë». Prandaj këtu duhet të hapim sytë, se është fillimi i punës, kryesorja.

Studimet gjeologjike të puseve duhet të bëhen absolutisht të mira, me të gjitha mjetet e format dhe me përgjegjësi, deri me përgjegjësi personale për gjeologët në fjalë që studiojnë pikat, dhe gjithçka të pasqyrohet në dokumentet. Po të veprohet kështu, zbulohen sabotatorët, injorantët dhe konformistët.

c) Sabotimi tjetër që na është bërë ka qenë në shpi-

nin e puseve. Projektohej pusi jo për të nxjerrë naftë, por për të arritur metrazhin e caktuar. Dilte apo s'dilte naftë, nuk kishte rëndësi; edhe po të dilte naftë më lart nga objekti final i shpimit, as kjo nuk kishte rëndësi, por lihej se gjoja do të shihej më vonë. Pastaj vulosej me barit, ngaqë duhej t'i vihej pusit patjetër në fundin e caktuar. Kur nuk dilte naftë në fund, atëherë thuhej: «Pusi s'dha naftë!». «Po ai dha shenja nafte më lart», thoshte ndonjëri. Dakord, po ku? Asgjë s'mbahej mend, se mostrat e shtresave hidheshin në lumë; matjet gjeofizike të pusit s'bëheshin, prandaj «Hiqe sondën dhe çoje gjetkë!». Në këtë fazë të procesit ne duhet të kemi shumë mendjen. Sipas mendimit tim, nuk duhet të arrihet medoemos metrazhi i paracaktuar e të bëhet kjo qëllim në vetvete. Në atë thellësi që na jep shenja nafte ne duhet të ndalemi, të bëjmë vlerësimin dhe, po na leverdisi, ta marrim naftën. Por kjo nuk do të thotë që të mos vazhdojmë më thellë, sipas projektit. Po nuk u vazhdua aty, mund të shpohet përbri dhe të vërtetohet nëse dalin apo jo parashikimet e projektit.

Kështu shfrytëzojmë çdo shtresë të pusit dhe, ajo që ka rëndësi më shumë, verifikojmë parashikimin e projektit të pikës me të dhënat konkrete të shpimit. Këtë proces duhet ta ndjekim me vigjilencë dhe me kujdesin më të madh, se pikërisht këtu ka qenë një nga objektivat kryesorë të sabotimit.

d) Fushë sabotimi kanë qenë e mund të jenë edhe avaritë në puse. Këto mund të bëhen me qëllim ose pa qëllim, por që të dyja dëmtojnë rëndë ekonominë, prandaj nuk duhet të ketë qetësi, butësi dhe mungesë vigjilence.

e) Fushë tjetër e veprimtarisë armiqësore ka qenë e mund të jetë përvetësimi i pusit. Këtu na kanë sabotuar shumë.

Siç po e shihni, u thashë shokëve, nxjerrja e naftës është një proces unik, zinxhir; po u këput një hallkë e këtij zinxhiri, prishet e gjithë puna, dhe naftë s'ka.

Për çdo proces apo hallkë të zinxhirit duhet të ketë debate e diskutime serioze, të sillen fakte e argumente bindëse dhe cilido të mbajë përgjegjësi personale e kolektive. Para se të fillojnë punën e tyre plot përgjegjësi, që të gjithë kanë të drejtë t'u bëjnë vërejtje e korigjime shokëve që kanë caktuar pikat e shpimit apo që kanë projektuar pusët. Por edhe këta e kanë për detyrë të vëzhgojnë nëse zbatohen si duhet të dhënat e tyre.

Kur mbaron gjithë puna, atëherë bëhet ballafaqimi i gjithë procesit, në të gjitha hallkat. Kjo duhet të jetë stil e metodë e përhershme pune. Por këtu s'ka rëndësi vetëm ana studimore-shkencore, ose tekniko-organizative. Mbi të gjitha këtu kanë rëndësi analiza e trajtimi politiko-ideologjik i veprimtarisë së njerëzve dhe i vetë proceseve të punës.

Këto gjëra të përgjithshme që ju shtrova dhe që nuk janë të huaja për ju, u thashë shokëve, i thelloni më tej, i ilustroni me fakte e shembuj konkretë dhe i diskutoni me punëtorët e me kuadrot e sektorit të naftës në frymë partie, me urtësi dhe pjekuri. Të evitohen tonet e ashpra e format administrative. Mos lejoni as sektarizëm e as oportunistizëm në gjykime dhe në veprime! Jini të matur e të ngrohtë me punëtorët e me kuadrot.

Çështja tjetër që u thashë shokëve, kishte lidhje

me kërkimin dhe nxjerrjen e mineraleve të rënda nga rërat bregdetare e të lumenjve. Këto grimca mineralësh të rënda vijnë nga thellësitë e tokës së gërryer në shekuj nga ujërat nëntokësore dhe mbitokësore. Kjo do të thotë se mineralet e rënda ndodhen diku në tokë dhe ujërat i kanë sjellë tok me rërën. Tash, duke i përpunuar këto rëra për t'u marrë mineralet, duhet të ndalemi e të krijojmë kartela të veçanta për çdo sektor. Në këto kartela të shënohen llojet dhe sasi të mineraleve. Pse duhet kjo gjë? Për të orientuar gjeologët në kërkimet e tyre në tokë, për të zbuluar vendburimet e këtyre mineraleve të rënda. Pra, jo vetëm shfrytëzojmë rërat, por edhe ndihmojmë në studimet tematike orientuese.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## POPULLI ËSHTË EDHE KËNGËTAR E VALLTAR I TALENTUAR

*Nga biseda<sup>1</sup> me një grup artistësh  
të ansamblit artistik kinez «Liaonin»*

19 tetor 1975

*Shoku Enver Hoxha u përshëndet me artistët kinezë, u interesua për shëndetin e tyre dhe, pasi shprehu kënaqësinë për takimin me ta, vazhdoi:*

Ju keni ardhur në Shqipëri si përfaqësues të popullit kinez, me të cilin na lidh prej kohësh një miqësi e madhe. Ardhja juaj po na jep mundësi të shikojmë artin e mrekullueshëm kinez. Veç kësaj, tani që jeni te ne, me veprimtarinë tuaj ju do të ndihmoni të forcohet akoma më shumë miqësia midis dy popujve dhe vendeve tona.

Dëshiroj të përgëzoj me këtë rast të gjithë shokët dhe shoqet e ansamblit për shfaqjen e bukur që dhanë. Është një art i bukur ky juaji në fushën e këngëve, valleve e të melodive. Të gjitha pjesët u interpretuan

---

1. Biseda u zhvillua para fillimit dhe në pushim të koncertit që dhanë artistët kinezë për punonjësit e Tiranës.

nga ju shumë mirë, bile është një meritë e madhe juaja që edhe pjesët shqiptare i interpretuat bukur.

Ju jeni një ansambël që interpretoni me ndjenja, ashtu siç e kërkon arti i vërtetë popullor me përmbajtje të lartë.

Ne i dëgjuam dhe i shijuam të gjitha pjesët që shfaqët sot këtu. Si pjesët kineze, ashtu edhe ato shqiptare janë të bukura sa njëra dhe tjetra e të gjitha u luajtën me pasion dhe me ndjenja të holla. Po ta ekzekutonit në malësitë e Veriut vallen shqiptare që luajtët sot, kjo valle luhet në rrethin e Tropojës, atje do t'ju merrnin për shqiptarë, për malësorë të Shqipërisë së Veriut.

Ardhja juaj do të kujtohet si një ngjarje me rëndësi për artin tonë shqiptar dhe për forcimin e miqësisë sonë. Me artin tuaj ju do të rritni akoma më shumë dashurinë e madhe e të sinqertë që ushqen populli ynë për popullin tuaj. Këtu qëndron forca e artit tonë revolucionar. Larg jemi me njëri-tjetrin si vende, por si popuj, me zemër, jemi afër. Ndihmën për njëri-tjetrin duhet ta japim si në të gjitha fushat e veprimtarisë e të jetës së vendeve e të popujve tanë, ashtu edhe në art e në kulturë.

*Drejtuesi i ansamblit kinez, ndër të tjera, falënderoi shokun Enver Hoxha për fjalët e ngrohta që tha në adresë të artistëve kinezë dhe për ndihmën që u kishin dhënë shokët e Teatrit të Operës dhe të Baletit shqiptar. Ai vlerësoi lart këngët dhe vallet shqiptare, si dhe nivelin interpretues të artistëve tanë. Pastaj fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:*



Ju<sup>1</sup> keni kënduar shumë mirë, keni një zë të bukur. Edhe ju i binit bukur veglës, me të cilën imitonit aq mirë zërat e zogjve, sa që na u duk sikur ishim në mes të pyllit. Pyllin e njohim mirë, se, kur ishim partizanë në kohën e luftës kundër pushtuesve italianë e gjermanë, edhe nëpër pyje kemi jetuar e kemi luftuar. Shumë mirë, urime të gjithëve! Të gjithë kënduat dhe interpretuat shumë bukur çdo pjesë të programit. Të bukura ishin edhe vallja e Mongolisë së Brendshme, vallja me pushkë e me shpatë, si dhe vallja e milicione-reve. Edhe artisti që i binte daulles na pëlqeu shumë, është një mjeshtër i vërtetë i daulles. Tani na mbetet për të parë edhe pjesën e dytë të programit me numra të rinj. Edhe ata me siguri do të jenë të bukur.

Arti luan rol të rëndësishëm në ndërtimin e socializmit, pse ngre peshë masat në revolucion, i frymëzon ato për ndërtimin e shoqërisë socialiste, për të qenë kurdoherë të gatshme e të patundura në mbrojtje të atdheut socialist, në luftë kundër armiqve të popullit, të atdheut e të socializmit. Prandaj zhvillimi i artit dhe i kulturës ka rëndësi të madhe. Ata i ngre lart dhe i udhëheq gjithmonë përpara partia.

Në gjirin e popullit ka talente të mrekullueshme. Në art masat shprehin në mënyrë të mrekullueshme ndjenjat dhe aspiratat e veta, shprehin qëllimet e tyre të mëdha. Edhe këtu shfaqen vitaliteti i marksizëm-leninizmit dhe forca e partisë marksiste-leniniste, që futen në shpirtin e gjerë të popullit, vlerat morale të të cilit i zbukurojnë dhe i nxjerrin në dritë në forma

---

1. Shoku Enver Hoxha u drejtohet dy artistëve kinezë.

të bukura. Populli, që është artizan i revolucionit, populli, që është artizan i ndërtimit të socializmit, është edhe këngëtar dhe valltar gjithë talent. Prandaj minierat, fabrikat e çdo vepër tjetër që ndërton populli, janë të mbujtura edhe me artin, me këngët dhe me vallet e tij.

Partia, që ka për qëllim ndërtimin e një jete sa më të gëzueshme për popullin, çdo ditë e më shumë i vë rëndësi artit të tij, që ky të bëhet sa më i bukur, sa më revolucionar. Prandaj ajo i ndihmon dhe i inkurajon këngëtarët, valltarët, instrumentistët dhe gjithë artistët e tjerë, të cilët janë njerëz të nderuar e të respektuar.

Ju faleminderit shumë për fjalët e mira që thatë në adresë të artit shqiptar dhe të shokëve tanë! Tash le të shkojmë në sallë të shikojmë pjesën e dytë të programit.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

# **TË ECIM ME KUJDES, PA RENË AS NË LIBERALIZËM, AS NË SEKTARIZËM**

## **Shënime**

**20 tetor 1975**

Nga raportet, letrat dhe ankesat që vijnë nga populli dhe nga komitetet, shikoj disa shenja që meritojnë vëmendje dhe nga të cilat duhet të nxjerrim mësim.

Studimi i materialeve të plenumeve të kohëve të fundit, që nga i 4-ti e tëhu, bëhet kudo, në forma të ndryshme, në mënyrë kolektive dhe individuale. Njerëzit sqarohen, shohin vijën e drejtë të Partisë, armatosen për të luftuar dhe për të dënuar armiqtë e klasës, bëhen më vigjilentë dhe është shtuar tek ata hovi revolucionar në punë e në mbrojtjen e vijës së Partisë. Kjo është gjendja e përgjithshme pozitive që konstatohet. Por ka dhe të meta lidhur me kuptimin e direktivave dhe me zbatimin e tyre në jetë.

a) Ka shfaqje sektarizmi në kuptimin e në zbatimin e direktivave. Këto vërehen në disa kuadro e komitete dhe shtrihen edhe në masa. Në direktivat e Partisë demaskohen dhe dënohen armiqtë kryesorë, ndaj të cilëve janë marrë me të drejtë masa të rënda, deri edhe masa penale dhe përjashtime nga Partia. Por

direktivat e Komitetit Qendror përcaktojnë drejt që në veprimtarinë e këtyre armiqve, pa dashje, janë komprometuar dhe kuadro të tjerë, që nuk e meritojnë një dënim të rëndë, që duhet t'u vihen në dukje gabimet, t'i njohin këto dhe Partia t'i ndihmojë me ngrohësi për t'i korrigjuar, me një fjalë, t'i mbajë afër, të mos i futë në një thes të gjithë, të bëjë diferencim. Këtë metodë të drejtë e ka praktikuar ngaherë Partia dhe sidomos në kohën e në momente kur janë zbuluar grupe armiqsh.

Pse Partia insiston në këtë metodë të drejtë? Sepse ajo i vë rëndësi shpëtimit të njerëzve nga të këqijat, pse ka parasysh natyrën e tyre, se udhëhiqet nga parimi i Marksit se është mënyra e prodhimit në jetën materiale që determinon në përgjithësi në zhvillimin e jetës materiale, politike dhe intelektuale dhe jo mënyra e mendimit të njerëzve influencon në mënyrën e jetesës, pra e kundërta, mënyra e jetesës shpjegon mënyrën e të menduarit. Të dalë nga një shoqëri e vjetër me klasa, njerëzit tanë nuk janë zhveshur plotësisht nga botëkuptimet e vjetra idealiste, ende socializmi te ne, brenda një periudhe të shkurtër, nuk ka arritur të likuadojë mendimet fisnore, pikëpamjet metafizike për shoqërinë, vënien e interesit të përgjithshëm mbi atë personal. Të mbahet parasysh se mënyra e prodhimit përcakton gjendjen e zhvillimit material të njerëzve. Mirëpo jo të gjithë i kuptojnë këto gjëra, prandaj dhe bëhen gabime; ka që i kuptojnë deri diku, por nuk i zbatojnë drejt parimet, në kompleksin e gjërë dhe të koklavitur të çështjeve që përplasen në luftën e jetës.

Ka njerëz që, në momentet kur zbulohen dhe dënohen armiq, bien në sektarizëm. Njerëz të tillë gjykojnë dhe veprojnë ashpër, pa bërë diferencime dhe pa u udhëhequr si duhet nga direktiva e Partisë për këtë qëllim, që, tok me dhunën, duhet përdorur dhe metoda e edukimit. Këta mendojnë se vetëm duke goditur janë më revolucionarët, janë në vijën e Partisë, mbrojtës të flaktë të saj dhe të socializmit etj. Ka nga këta që veprime të tilla i bëjnë me ndërgjegje dhe mendojnë se e kanë drejt, por në fakt veprojnë gabim; ka të tjerë që i bëjnë, por nuk janë të bindur, këta veprojnë gabim me sektarizmin e tyre dhe në të vërtetë janë oportunistë ndaj vijës së Partisë që mendojnë se ka vetëm anën e ashpërsisë dhe jo, njëkohësisht, të diferencimit e të edukimit. Kjo kategori njerëzish mendon se, po të veprojë drejt, do të cilësohet liberale dhe do të humbasë funksionet e besimin që i ka dhënë Partia. Ekziston dhe një kategori tjetër sektarësh, që hiqen sikur mbrojnë vijën, por, në fakt, me bindje janë armiq të maskuar dhe godasin djathtas e majtas për të shtuar të goditurit, për të bërë sa më shumë njerëz të pakënaqur, kundër Partisë dhe shoqërisë socialiste.

b) Të gjitha këto pikëpamje dhe veprime duhet të konsiderohen si kuptim e zbatim jokorrekt i vijës së Partisë, që kanë konsekuenca të rënda dhe të rrezikshme, prandaj të luftohen.

Me veprime të tilla të pamenduara mirë, krijon në masat një shqetësim të paarsyetuar, pse këto veprime venë në kundërshtim me direktivat e Partisë për diferencimin dhe edukimin, për marrjen parasysh të aktivitetit dhe të qëndrimit politik të personit ndaj të

cilit merret një vendim dënimi i pamatur në krahasim me fajin ose ngaqë ka pasur të njohur, miqësi a krushqi me një element që vodhi, vrau ose tradhtoi atdheun. Po të veprohet pa mend dhe jashtë vijës së Partisë, shtohen radhët e të pakënaqurve, të cilët bëhen gjaku i armiqve të klasës, të brendshëm e të jashtëm.

Ne jemi një vend i vogël, me një popull të vogël, ku njerëzit e familjet janë gërshetuar me forma dhe me mënyra të ndryshme. Midis këtyre ka edhe që gabojnë dhe që duhen ndrequr ka që shkelin ligjet dhe që duhen dënuar, ka që komplotojnë e tradhtojnë dhe që duhen ndëshkuar rëndë e përjashtuar nga Partia.

Por ndodh që njerëzit nuk edukohen se si duhet të sillen me ata që gabojnë ose dënohen. Ka raste që izolohet totalisht jo vetëm personi fajtor, por edhe farefisi i tij, kështu «digjet i njomi me të thatin», disa tregohen «të rreptë» ndaj një fajtori, por kur ky del nga burgu, venë e urojnë, e ngushëllojnë, dhe me këtë sjellje i thonë: «Dënimi yt qe pa vend, ti je njeri i mirë». Ka nga ata që hiqen si armiq me kulakun, por, nga ana tjetër, bëjnë krushqi, shkojnë pinë raki me të, e afrojnë vjedhësin ose ish-ballistin, e rekomandojnë edhe të zërë funksione të mira, bile të futet dhe në Parti. Veprime të këtij lloji, sektare, pseudosektare, oportuniste dhe liberale ka mjaft. Ato i kryejnë jo vetëm njerëz të paorganizuar në Parti, por edhe disa komunistë, ndonjëherë edhe punonjës komitetesh.

Duhet, pra, t'i ritheksojmë Partisë dhe çdo anëtarit të saj që t'i studiojë e t'i bluajë mirë materialet dhe direktivat e Partisë, që në to të mos shohë vetëm disa anë të problemit, por të gjitha anët e tij. Rëndësi ka

që këto mësimë t'i udhëheqin komunistët që edhe në problemin më të koklavitur që u nxjerr jeta, ata të dinë të gjejnë zgjidhjen më të drejtë. Dhe këtë mund ta bëjnë vetëm duke u bazuar në eksperiencën e Partisë. Por kjo eksperiencë duhet përvetësuar. Njeriu nuk bëhet dot mjek pa studiuar medicinën, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë; pa praktikë mjeku nuk vlen, siç nuk mund të vlejë edhe pa teori.

Anëtarët e Partisë të mos harrojnë se janë në pararojë, se roli i Partisë është i tillë, pra duhet të jenë aktivistët më të zjarrtë revolucionarë, në punë dhe në jetë, të jenë shembull të gjithë pa përjashtim, secili të jetë një punëtor partie. Të mos kuptohet se të qenët punëtor partie është funksion i veçantë për disa kadro. Ky u takon të gjithë anëtarëve të Partisë. Çdo komunist, duke studiuar marksizëm-leninizmin dhe direktivat e Partisë sonë, duhet të mësojë për vete, por edhe për të edukuar të tjerët.

Eksperienca e Partisë sonë është shumë e madhe, por duhet thënë se nuk përvetësohet dhe nuk shfrytëzohet e tëra si duhet dhe nga të gjithë. Shumë probleme zgjidhen nga organet e Partisë dhe të pushtetit, por këto zgjidhje nuk shfrytëzohen sa duhet si mësim, si edukim për të gjithë. Referate bëhen, por në përgjithësi perifrazohen direktivat e përgjithshme dhe këto të fundit pak ilustrohen me problemet e jetës dhe me zgjidhjet e tyre. Një metodë e tillë pune duhet braktisur, neve na duhen punëtorë partie revolucionarë, të përgatitur teorikisht, të lidhur me Partinë, me jetën e gjallë, dhe jo papagallë.

Partia dhe diktatura e proletariatit i shtypin ar-

miqtë, por edukojnë dhe shërojnë të sëmurët, bëjnë të gjitha përpjekjet që t'i ngushtojnë rrethin e vepri- mit dhe të ndikimit armikut. Këtu bëhet lufta kush të fitojë njeriun, Partia apo armiku. Njerëzit e mirë duhet të mendojnë seriozisht për këtë problem të madh që u del atdheut dhe Partisë sonë në këto momente të rrethimit të egër kapitalisto-revizionist, të mendojnë drejt, as në mënyrë sektare, as në mënyrë liberale, pse të dyja janë të rrezikshme, por kurdoherë në mënyrë marksiste-leniniste revolucionare. Them marksiste-leniniste revolucionare, pse ka momente që vigjilenca dhe goditja duhet të jenë të mëdha e të ashpra kundër armiqve dhe përkrahësve të tyre, por kurrë nuk duhet të kalohet në qëndrime ekstreme ndaj atyre që nuk meritojnë goditje të rëndë, por forcim vigjilence dhe shtim edukimi. Momente të tilla Partia duhet t'i peshojë mirë, siç duhet të peshojë mirë dhe liberalizmin e rrezikshëm në situatat pseudo të qeta.

U theksova shokëve sekretarë çështjen e ndërrimit të dokumenteve që po bëjnë aktualisht në Parti. Duhet të ecim me prurëncë dhe me vigjilencë të madhe partie, pse të dyja tendencat mund të shfaqen, edhe sektarizmi, edhe liberalizmi. Mund të përjashtohen ose të mbeten në Parti njerëz të mirë ose njerëz të këqij, mund të gjykohet ndonjë shok pse ka një të afërm të keq, pa marrë parasysh vetë personin në fjalë, prejardhjen e tij të mirë dhe një tog njerëzish të tij të mirë e besnikë, ose mund të qëndrojnë në Parti një që ka hyrë aksidentalisht, që është i plogësht e pa vlerë, por s'ka njeri të keq në të afërmit e tij. Ky është një operacion shumë delikat i Partisë, pse mund të krijohen,



po s'u veprua drejt e me kujdes, shumë të pakënaqur, sikundër të lihen në Parti njerëz që nuk e meritojnë të jenë.

Në të gjitha rastet duhet bindur komunisti që përjashtohet nga Partia, duhet punuar me të dhe me të afërmit e tij, pse në këtë mes mund të bëhen të pakënaqur familje të tëra që kanë lidhje me të përjashtuarin nga Partia. Të përjashtohesh nga Partia është baras me një dënim kapital. Në këtë rast ndërhyjnë dhe vepron ndjenja e fisit, familja ose e mbrojnë të përjashtuarin, ose e izolon si murtajën, edhe kur nuk është murtajë, por një njeri që s'që dhe s'është i pjekur për në Parti. Këto situata duhet të sqarohen mirë, të mos nënvleftësohen dhe të mos mendohet se ligjet e vjetra të fisit dhe të familjes nuk veprojnë te ne. Edukata revolucionare ka nevojë të përsoset vazhdimisht. Pjekuria e Partisë dhe e komunistëve konsiston pikërisht në atë që të bëjnë analiza të drejta e në bazë të tyre të marrin vendime dhe të mos i lënë pa i shpjeguar e pa i sqaruar drejt këto vendime.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



**TREGUESIT**



## A

*Aksionet revolucionare të masave, aksionet me goditje të përqendruar* — 129-131, 173-175, 339-340.

*Aleanca, bashkëpunimi dhe rivaliteti sovjeto-amerikan*

*Shih: Superfuqitë...*

*Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë* — 182-183, 286, 306, 308-309.

*Aparati shtetëror, organet shtetërore dhe punonjësit e tyre* — 36, 183-184, 367, 470.

*Armiqtë; lufta kundër vepërimtarisë armiqësore* — 142-143, 216-217, 303, 304-305, 343, 421-422, 454-456, 460, 471, 472, 473, 498.

*Arsimi në RPSH — arsimi i lartë; shkollat profesionale; nxënësit dhe studentët, kriteret e pranimit të nxënësve në shkollat e larta* — 3-4, 36-37, 46-47, 50, 123-124;

— edukimi dhe përgatitja ushtarake në shkollë — 45-52.

*Arti, arti popullor — muzika, këngët, estrada* — 392, 394, 395-396, 491-492.

## B

*Ballkani — gjendja e brendshme; politika «ballkanike» e superfuqive* — 21, 60-71, 396, 422, 450-451.

*Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë — lidhjet dhe bashkëpunimi ndërmjet organizatave të rinisë të terrenit dhe të ushtrisë* — 49, 54.

*Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — ardhja në fuqi e revizionizmit, degjenerimi i diktaturës së proletariatit* — 197, 198-199, 420, 435-436, 466-467;

— politika e jashtme. Përpjekjet për të forcuar hegjemoninë mbi vendet dhe partitë revizioniste. Kontradiktat me Kinën — 18-19, 24-25, 62-63, 86-88, 89, 97, 99, 208-209, 212-213, 263, 422, 449, 477.

- 473, 480, 481-482;
- veprimtaria armiqësore kundër RP të Shqipërisë — 80, 209, 257, 484-485.
- Blegtoaria në RPSH — zhvillimi i saj. Lopa dhe bagëtitë e imëta; shpendë:* — 113, 117, 124-125, 175-176, 356-357, 402-404.
- Borgjezia, borgjezia e re revisioniste* — 18-19, 26, 65-66, 153, 259, 263, 297, 467, 479-480.
- Botëkuptimi marksist-leninist; lufta kundër botëkuptimit borgjez e mikroborgjez* — 31-32, 491.
- Bujqësia në RPSH*
- politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë në baza shkencore; vendi dhe roli i saj në ekonomi — 107-108, 113, 149, 167, 220, 253-254, 255-256, 280, 281-285, 288-291, 305-306, 308-309, 352-354, 355, 356-357, 419-420;
  - agroteknika dhe kodë agroteknik, intensifikimi i shërbimeve dhe rritja e rendimenteve dhe e efektivitetit në bujqësi — 117-119, 120-121, 164-165, 319-320, 221-222, 253-256, 273, 273, 277, 278, 282-284, 307, 320, 353-354, 357;
  - toka; trajtimi shkencor dhe rritja e pjellorisë së saj; hartat pedologjike dhe agrokimike — 103, 115-119, 164-166, 185-186, 290-291, 292-293;
  - ujët, veprat ujëtare dhe bonifikimet; plehërimi dhe mekanizimi — 117, 165-166, 170-171, 185-186, 193-199, 221, 282-283, 330, 418-419;
  - drithërat, sigurimi i bukës në vend. Patatja. Pemëtaria. Farërat — 112-113, 114-115, 165-169, 187-188, 221, 336, 354, 418-419;
  - kundrot dhe specialistët e bujqësisë; kualifikimi i tyre — 119-120, 160-161, 165-166, 256, 273, 282-284, 290, 357;
  - studimet në fushën e bujqësisë. Propaganda bujqësore — 124-126, 274, 275, 282-284, 290, 293-294, 357-358.
- Burokratizmi dhe lufta kundër tij* — 30-33, 36-38, 126-127, 175, 233-239.

## D

- Dekretet* — 370-371.
- Demokracia socialiste* — 153-154, 172, 198, 259-260, 385-386, 468, 473.

Dënimi (ndëshkimi) penal;  
qëndrimi ndaj të dënuarve —  
199, 372-376, 493, 495-496.

Dëshmorët — 370-371.

Dialektika marksiste-leniniste;  
zhvillimi dialektik në shoqëri  
dhe në natyrë — 172-173,  
299, 465.

Diktatura e proletariatit, shteti  
socialist — 241-242, 433-435,  
465, 466-467, 469, 497-498.

Drejhtësia, organet e drejtësisë  
— 372-376.

## E

Edukimi komunist — edukimi  
ideopolitik, arsimor dhe profesio-  
nial — 111-112, 230-231, 289;

— studimi i dokumenteve  
dhe i materialeve të Partisë —  
49, 110-111, 140-141,  
217, 230-231, 250,  
416-417, 460-461, 493, 496-  
497;

— edukimi me qëndrimin  
socialist ndaj punës e  
pronës dhe lufta kundër  
shfaqjeve të huaja ndaj  
tyre — 34-36, 131-132,  
180-183, 287, 400, 403-404,  
407-408;

— edukimi me ndjenjën e  
sëdrës revolucionare; luf-  
ta kundër vetëkënaqësisë  
dhe të kënaqurit me pak  
— 117-118, 218-219, 277,

279, 280-281, 459-460;

— bindja; harmonizimi i saj  
me masa administrative  
— 128-129, 132-133, 285-  
286, 287, 400, 495.

*Ekonomia popullore* — politi-  
ka e Partisë për zhvillimin e  
saj — 218-219, 227-228, 234-  
235, 264;

— shfrytëzimi i burimeve,  
i rezervave dhe i mundë-  
sive të brendshme — 110,  
113-115, 233-234, 252-254,  
281-282, 305-306, 356;

— ekonomistët, specialistët;  
gjallërimi i mendimit  
ekonomik dhe forcimi i  
llëgarisë ekonomike —  
120-121, 165-166, 294-296;  
— masat dhe detyrat për  
shëndoshtjen e gjendjes  
në ekonomi dhe në sek-  
torin e naftës — 175, 246,  
303-305, 337, 483-484.

*Engels, Friedrich* — 77, 155, 198,  
215, 216, 226, 230, 261, 417.

*Enver Hoxha* — të dhëna au-  
tobiografike — 105-106, 151-  
152, 156, 158, 177-178, 187,  
226-227, 231-232, 263-269, 284,  
312-313, 315, 316, 322, 327-328,  
369, 390-391, 428.

*Evropa*, «Evropa e bashkuar»,  
sigurimi evropian, Konferenca  
për sigurimin evropian në  
Helsinki (korrik—gusht 1975)

— 18, 19-21, 25, 26, 84-96, 104, 108-109, 144, 209, 211-212, 213-214, 262-263, 422, 450.

## F

*Faktori objektiv dhe faktori subjektiv, faktori i brendshëm dhe faktori i jashtëm; roli i tyre në jetën e shoqërisë* — 229, 230.

*Franca — politika e jashtme* — 15, 19-21, 25, 26, 92, 211, 219, 254, 255, 263, 479, 482.

*Fshatarësia — traditat patriotike; roli dhe pjesëmarrja e saj në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit* — 182-183, 275, 281, 285-288, 307-308, 407, 434.

*Fshati socialist — politika e Partisë për zhvillimin e tij* — 127-128, 131-132, 177-178, 306-307.

*Fuqia punëtore — nevojat për fuqi punëtore dhe sistemimi; shpërndarja e saj qytet-fshat* — 33-35, 127-129, 131-132, 176-179, 275, 332, 338-339, 364-367.

## G

*Gruaja; emancipimi i saj* — 41, 274-275, 353-354.

*Grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes,*

*H. Çakos etj. në ushtri dhe lufta për shpartallimin e tij*

— strategjia, taktikat dhe metodat e grupit — 133, 134, 135-137, 138-139, 141, 169, 193, 199-200, 202-203, 204, 245, 247-249, 300, 301, 302, 445, 469;

— puna e tij për të sabotuar vijën ushtarake të Partisë, ushtrinë dhe mbrojtjen — 132-133, 134, 138-140, 169, 193, 201-202, 203-204, 247-248, 300-301, 302;

— lidhjet me grupet e tjera; agjenturë në shërbim të shteteve revizioniste — 142-143, 204, 206, 244, 245, 247, 301-302, 420, 460;

— zbulimi, gjykimi e dënimi i grupit dhe i punës së tij armiqësore — 133-134, 143, 199, 203, 206, 245, 249-250, 301-302, 303, 304.

*Grupi armiqësor, sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit e K. Ngjelës në ekonomi e në sektorin e naftës dhe lufta për shpartallimin e tij*

— veprimtaria sabotuese në ekonomi — 139, 164, 170, 200, 204-206, 242-244, 267, 296-297, 333, 334-335;

— veprimtaria sabotuese në shpim-kërkime, në zbulimin e vendburimeve të



- reja dhe në shfrytëzimin e naftës — 134-135, 147, 184, 205, 245-246, 299-300, 303, 334, 335, 347-348, 349-350, 415-416, 420-421, 445, 453-454, 483-487;
- veprimtaria sabotuese në fushën e tregtisë — 138, 139, 187, 303, 335, 445, 453-457;
- metodat dhe taktikat e grupit — 184, 204-206, 235-236, 237, 239, 242-244, 247, 297, 309, 415-416, 420-421;
- tendencat vetadministruese, burokratike e teknokratike — 138, 204, 205, 236-239, 242, 293-299, 334-335, 457-458, 460-461;
- lidhjet dhe bashkëpunimi me grupet e tjera armiqësore. Agjenturë në shërbim të shteteve revizioniste e imperialiste — 134-135, 139, 142-143, 204, 205, 296, 244, 245, 247, 309, 335, 420, 453-454, 455, 456, 457, 460;
- zbulimi, gjykimi e dënimi i grupit dhe i punës së tij armiqësore — 143, 206, 241, 299-300, 303.

## I

*Industria e rëndë në RPSH*  
— politika e Partisë për

- zhvillimin, rritjen e efektivitetit dhe automatizimin e saj — 123, 146-149, 176-177, 220-221, 228-230;
- industria energjetike (elektrike dhe e qymyrgurit) — 147, 476-477;
- industria minerale dhe ajo metalurgjike — 148-149, 191-192, 253, 412-413, 476-477, 487-488;
- industria mekanike: prodhimi në vend i pjesëve të ndërrimit, i makinerive dhe i fabrikave — 146, 188-192, 251-252, 337;
- industria kimike dhe ajo e petrokimisë — 147, 252, 334.

*Shih edhe: Nafta dhe gazi, gjeologjia e naftës... Institutet e studimeve dhe të kërkimeve shkencore* — 238-239, 299, 335.

*Investimet — politika e Partisë për rritjen e efektivitetit të tyre* — 122, 123-124, 310-312, 406-408.

## J

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — gjendja e brendshme, vetadministrimi jugosllav, Politika e jashtme; qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë* — 13, 64-67, 68-70, 237, 297, 448-450.

## K

*Kapitalizmi; varfërimi i masave punonjëse, papunësia* — 25, 223, 255, 262.

*Këshillat popullorë dhe këshilltarët, komitetet ekzekutive dhe aparatet e tyre* — 37-38, 42-43, 339-342, 360-363, 364, 366-367, 470-471.

*Këshilli i Mbrojtjes; Tezat e Këshillit të Mbrojtjes; lufta kundër përpjekjeve për sabotimin dhe revizionimin e tyre* — 193, 200-201, 202, 203, 301.

*Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave* — 30, 33, 39, 42, 116, 242, 309, 319, 382, 456, 457.

*Kina — gjendja e brendshme; Revolucioni Kulturor dhe lufta e grupeve për pushtet* — 72, 103, 418;

— politika e jashtme koniunkturale, proimperialiste dhe kundërrevolucionare. Përpjekjet për t'u bërë superfuqi — 17, 20, 22, 23-26, 62, 63, 70, 71, 72-75, 97-102, 213-214, 262-263, 424-428, 447-443, 450;

— kontradiktat me BS dhe aleanca me ShBA. Afrimi dhe bashkëpunimi me Jugosllavinë — 22, 23-26, 63-64, 70, 73-74, 97-100,

213-214, 261, 425-426, 428, 446, 447, 443-450, 451-452;

— presionet politike dhe ekonomike kundër RP të Shqipërisë — 62, 64, 68-70, 75-77, 102, 103-104, 334, 336, 430-431, 450-451, 489.

*Klasa punëtore — roli udhëheqës dhe pjesëmarrja e saj në ndërtimin socialist* — 197-198, 225, 226, 252-253, 286, 306, 303, 466.

*Klasat dhe lufta e klasave* — 138, 150, 199, 218, 228, 232-233, 301, 303, 304-305, 374-375, 435-436, 444-445, 451-455, 460, 465, 469, 476, 495-496, 498.

*Komunisti — cilësitë, roli pararojë dhe edukimi i tij; zhvillimi i kritikës, i autokritikës dhe i luftës së klasave* — 154-155, 230-231, 241, 354-355, 358, 382-383, 497.

*Kontrolli i Partisë, i shtetit dhe i klasës punëtore* — 39, 42, 385, 409-410, 439-444, 461;

— kontrolli i shtetit — 8-9, 39-40, 42-43, 342-344, 444, 453, 455;

— kontrolli punëtor e fshatar — 9-11, 40-42, 43-44, 194-196, 264, 342-344, 442, 444, 471.

*Kooperativat bujqësore — politika e Partisë për shndërrimin socialist të fshatit — 132, 281-282, 285-287, 393-400, 402-404;*

— kooperativat bujqësore të bashkuara dhe ato të tipit të lartë; ndihma e shtetit për zhvillimin e tyre — 265, 352-353, 399-400, 405-409;

— të ardhurat, fondet; pjesëmarrja e kooperativistëve në punë dhe shpërblymimi i punës — 121-123, 274, 310-312, 345, 401-402, 408-409.

*Kritika dhe autokritika; kërkesa e llogarisë — 152-155, 239-240, 305, 400, 411-412.*

*Kriza dhe kontradiktat në botën kapitaliste e revizioniste — 18-27, 91-93, 103-109, 211-213, 214-215, 223, 261, 428, 477-482.*

*Kuadrot — politika e Partisë me kuadrin; vendi dhe roli i tyre në shoqëri; përgatitja, kualifikimi, vendosja, shpërndarja dhe qarkullimi i tyre — 1-5, 32-33, 38, 158, 252-253, 405, 483-484.*

*Kushtetuta e RPSH. Projekt-kushtetuta e RPSSH — 127, 366, 377-380, 462-474.*

*Kuvendi Popullor. Presidiumi i Kuvendit Popullor — 361-362, 372, 380, 462, 470.*

## L

*Legjislacioni, ligjet — njohja, interpretimi, zbatimi dhe përsosja e tyre — 342-343, 361-367, 371, 373, 374-375, 386-387.*

*Lenin, Vladimir Iliç — 9, 23, 40-41, 42, 43, 77, 155, 192, 194-193, 197, 198, 210, 213-214, 215, 216, 226, 230, 261, 262, 292, 342, 343, 407, 417, 435-437, 442, 471, 476.*

*Letrat, kërkesat dhe ankesat e popullit; puna me letrat — 35-36, 136-137, 155-156, 209-203, 411-412, 493.*

*Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare — strategjia dhe taktikat e partive marksiste-leniniste — 22-23, 26-27, 101-102, 218, 262-263, 426-427, 429, 475-476, 479-480.*

*Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare dhe revolucionare të klasës punëtore dhe të popujve — 15, 26-27, 94, 96, 98, 214-215, 427, 478-480.*

*Liberalizmi, sektarizmi dhe lufta kundër tyre — 493-496, 498.*

## M

*Marksizëm-leninizmi — busulli për udhëheqje e veprim; studimi dhe zbatimi i tij në kushtet konkrete — 149-150, 194-*

- 195, 197-198, 210, 216, 230-231, 287, 386, 416-417, 421, 431-432, 466, 468-469.
- Marks, Karl* — 76, 155, 194, 197, 198, 210, 215, 216, 226, 230, 261, 416, 417, 436-437, 476, 494.
- Mbështetja në forcat tona* — 109-110, 191, 229, 252, 336.
- Mbrojtja e atdheut — përgatitja e ushtrisë, e popullit dhe e vendit për mbrojtje* — 49-50, 68, 81, 112, 133, 143, 192-193, 211, 217-218, 227-228, 291-292, 333, 422, 469-470, 472-473.
- Metoda dhe stili në punë* — 56, 140-141, 176, 336, 341-342, 414-415, 417, 439, 445, 487, 494, 497.
- Ministritë* — 33, 342, 365, 382-388, 457;
- *Ministria e Punëve të Brendshme dhe organet e Punëve të Brendshme* — 141;
- *Ministria e Mbrojtjes Popullore* — 193, 201, 248, 412;
- *Komisioni i Planit të Shtetit* — 2, 4, 37, 242-243, 295, 309, 310, 349;
- *Komisioni i Kontrollit të Shtetit; Inspektimi i Shtetit* — 9, 39, 342, 442, 456;
- *Ministria e Eujqësisë* — 116, 161-162, 163, 168, 171-

- 172, 184, 186, 295;
- *Ministria e Tregtisë* — 139, 453, 454, 455-456;
- *Ministria e Arsimit dhe e Kulturës* — 2, 4, 46, 47.
- Mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste* — 112, 125-126, 223-224, 235, 306-308, 358.
- Monumentet e kulturës* — 152, 316-317.

## N

- Nafta dhe gazi, gjeologjia e naftës; studimet dhe shpim-kërkimet* — 245-246, 346-350, 412-415, 493-487.
- Ndërtimet, arkitektura, urbanistika, gjelbërimi i qytetit* — 123-124, 177, 178, 310, 311-312, 315-326, 332-333, 334.
- Ndërtimi i socializmit në Shqipëri; politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit* — 12-13, 379, 465-466.
- Ngushtimi i dallimeve ndërmjet fshatit e qytetit; lidhjet dhe ndihma ndërmjet tyre* — 127-128, 130-132, 179, 180-183, 306-309, 339-340, 344-345, 353, 358.

## O

- Opinionet publikë botërorë dhe qëndrimi i tij ndaj RP të Shqipërisë* — 145-146, 210-211, 257.

*Organikat; përsosja dhe shkurtimi i tyre* — 31-32, 36, 38, 43, 126-127, 175, 176.

*Organizata-bazë e Partisë; roli udhëheqës; puna e saj për zbatimin e vendimeve dhe të direktivave të Partisë* — 114-115, 142-143, 240, 358, 382-383, 384-385, 458, 459;

- organizatat-bazë të Partisë në dikastere — 382-383, 455-458.

## P

*Paqja; bashkëkzistenca paqësore* — 93-96, 99.

*Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore e lokale*

- Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 111, 380, 462;
- Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ — 28-30, 54, 58, 106, 111, 116, 129, 133, 134, 135, 136, 160, 174-175, 183-184, 185, 194, 199, 200, 239, 241, 242, 243, 244, 246, 249, 266, 277, 279, 285, 296, 293, 300, 306, 310, 312, 333, 381, 384, 415-416, 438, 442-443, 453, 455, 457, 462;
- Plenumi i 8-të i KQ (10 tetor 1975) — 379, 453-461, 462-474;

— aparat i KQ të Partisë — 58, 59, 361, 336, 438-439;

— komitetet e Partisë në rrethe — 31, 392-393, 398, 442-443, 458;

— organizatat dhe komitetet e Partisë të rretheve të Dibrës, të Fierit, të Pogradecit e të Sarandës — 105-107, 246, 399, 438;

— organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 361-388;

— organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës — 159-160, 171-172, 224, 227-228, 230, 279;

— organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri — 48, 54, 55, 56, 57-58, 201;

— studimet, raportet, materialet për organet udhëheqëse — 4-5, 31, 37, 47-48, 361-362, 413-414.

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet dhe direktivat; organizimi dhe jeta e brendshme*

— vija, vendimet e direktivat e Partisë; lufta për zbatimin dhe mbrojtjen e tyre — 111, 175-176, 261, 306, 307-308, 384-385, 387-388, 391-392, 416-417, 439-442, 457-458, 493-495;

— roli udhëheqës dhe forcimi i Partisë — 114, 149-

- 150, 197, 215-216, 226, 459, 464, 466;
- karakteristikat marksiste-leniniste revolucionare. Uniteti në Parti dhe në udhëheqje — 29, 30, 149, 150, 226, 297, 303;
- lidhjet e Partisë me masat; informimi i masave nga Partia — 57-58, 105-106, 152-153, 158-159, 160, 196-197;
- puna e Partisë, përmbajtja e saj; kapja pas hallkës kryesore — 196, 392, 415-416, 443, 457, 459, 496-497, 498, 499;
- informacioni, informimi në Parti — 136-138, 183-185, 302;
- pranimet në Parti; rritja numerike e Partisë — 6-7, 379;
- përvoja, mësimet dhe masat për të çuar përpara revolucionin e ndërtimin e socializmit dhe për t'i prerë rrugën revizionizmit në Shqipëri — 111-112, 150, 199, 216-217, 239-241;
- qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementëve që gabojnë e bëjnë faje — 142, 154-155, 239-241, 244-245, 249-250, 305, 439-440, 441-442, 494-495, 498;
- ndërrimi i dokumenteve në Parti; përjashtimet nga Partia — 7, 498-499.
- Peshkimi; popullimi me peshq i liqeneve* — 125.
- Përvoja e përparuar dhe shkencore; njohja dhe përgjithësimi i saj* — 167, 184-185, 220, 256-257, 339, 352-356, 357.
- Planifikimi, planet — metodologjia e planifikimit* — 114-115, 116, 121-122, 161, 163-164, 165-166, 171-173, 218-220, 233-234, 242-243, 284, 294-296, 309-310, 337-338;
- projektplani i gjashtë pesëvjeçar; planet perspektive — 4, 114-115, 116, 146-147, 159-160, 161-162, 218-219, 220, 250-251, 277, 334;
- planifikimi, planet në bujqësi dhe lufta për plotësimin e tyre — 114-115, 116, 121-122, 161-162, 165-166, 171-173, 234-235, 277, 281, 288, 294-296, 336.
- Politika e jashtme parimore marksiste-leniniste e RPSH* — 15, 60, 69, 79-83, 95-96, 213-214, 257-259, 260-261, 363, 429, 431-432, 472;
- solidariteti dhe përkrahja internacionaliste për

lëvizjet dhe luftërat çlirimtare dhe revolucionare të popujve — 12, 15, 16, 82-83, 214, 426-427, 475-476;

— rritja e prestigjit dhe e autoritetit të RPSH në botë. Të huajt për Shqipërinë — 80, 109, 143-146, 150, 152, 210-211, 257-258, 263, 307, 429-430;

— lufta për demaskimin e imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit — 83, 87, 232-233, 261, 262-263, 428, 464, 475;

— qëndrimi parimor ndaj Kinës dhe BS — 77-78, 79-80, 102-103, 213, 262, 428, 430-431, 490.

*Politika në plan të parë; kuptimi politik i problemeve; politika dhe ekonomia* — 31-32, 110, 140, 222-223, 230, 456-457, 459.

*Populli shqiptar — virtytet moral-politike; luftërat për liri; roli dhe pjesëmarrja e tij në ndërtimin socialist* — 228, 235, 368-369, 395-398, 421-422, 463-464, 465, 472-473, 491-492;

— të dhëna demografike dhe onomastike — 37, 126, 127, 324-325, 338-339, 368-369.

*Prodhimi material — politika e Partisë për zhvillimin e përndërprerë të tij* — 114, 125-126, 147-148, 190-191, 307-308.

*Prona socialiste—ruajtja dhe fuqizimi i saj; lufta kundër dëmtuesve dhe shpërdoruesve* — 43, 337, 342-343, 378, 401, 471-472;

— oborri kooperativist — 402-404, 419-420.

*Pushteti popullor—formë e diktaturës së proletariatit. Karakteri demokratik, pjesëmarrja e klasës punëtore dhe e masave në qeverisjen e vendit* — 10-11, 198, 435, 463, 468-469, 471, 473.

## Q

*Qenia shoqërore dhe ndërgjegjja shoqërore* — 494.

## R

*Regjimi i kursimit* — 188, 224.  
*Revizionizmi modern—lufta e tij kundër socializmit, partive marksiste-leniniste dhe luftërave çlirimtare të popujve* — 67, 436-437, 467, 479.

*Revolucioni proletar* — 22-23, 27, 426-427, 475-476.

*Rinia — pjesëmarrja dhe roli i saj në ndërtimin socialist të*

vendit. Aksionet e rinisë. Lëvizja e rinisë: Të shkojmë për të punuar dhe jetuar në fshat dhe ku të ketë nevojë atdheu — 31-36, 126-129, 174, 177-179, 180-182, 275-276, 325-326, 332-339, 358.

## RR

Rrethimi, presioni borgjezo-revizionist dhe lufta për përballimin e tyre — 109, 232-233, 421, 456, 458-459, 460.

## S

Stalin, Josif Visarionoviç — 26, 40, 77, 155, 195, 198, 215, 216, 226, 230, 261, 304, 417, 446.

Superfuqitë — politika hegjemoniste, demagogjike dhe e ekspansionit; rivaliteti ndërmyet tyre — 19, 20, 21, 85-96, 109, 203, 209, 211, 215, 257, 427, 478-479, 480-481.

## SII

Shfaqjet e huaja, zakonet prapanike; lufta kundër tyre — 155, 207-208.

Shkenca — 256, 290.

Shkolla e Lirë Ushtarake — 50, 192.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës—strategjia dhe taktikat. Përpjekjet për të forcuar hegjemoninë në Evropë — 18, 22, 24-25, 86-87, 88-89, 99-100, 145, 209, 257, 478.

Shtypi dhe propaganda borgjezo-revizioniste — 69-70, 79, 144, 146, 153.

Shtypi qendror dhe shtypi lokal; përmbajtja dhe shfrytëzimi i tyre — 104, 213, 263, 359-404.

## T

Teoria dhe praktika; uniteti dialektik i tyre — 119, 208-209, 290, 436-437, 441-442, 497.

Tregtia e brendshme—shpërndarja e mallrave, furnizimi i popullsisë — 122-123, 280-231, 307-308.

Tregtia e jashtme; eksporti, importi — 115, 148, 132, 187-188, 234, 337, 456-457.

## U

Uniteti i popullit, uniteti Partii-popull — 143, 149, 150-151.

Ushtria Popullore

— roli udhëheqës i Partisë; vendimet dhe direktivat e Partisë për ushtrinë — 54, 57-58, 140, 192, 193, 200-201, 248;



- edukimi, përgatitja politike dhe ushtarake; programet, leksionet — 48-51, 53-54, 55-56, 57-58, 140-141, 192-193, 291-292;
- rregulloret dhe disiplina ushtarake; higjiena në ushtri — 51, 56-57, 412-413;
- komanda, komandiml. Kuadrot politikë dhe ushtarake; marrëdhëniet kuadër-ushtar — 48-49, 50, 51-52, 55-53, 135, 140-141, 192-194, 203, 248;
- njohja e terrenit tonë. Njohja e armikut (e strukturës, e armatimit, e strategjisë dhe e taktikës së tij) — 192-194, 291-292;
- masat dhe puna për shëndoshjen e gjendjes në ushtri pas zbulimit të grupit komplotist të B. Ballukut, P. Dumes, H.

Çakos etj. — 55, 58-59, 138, 139-142, 175, 218, 303-305.

*Shih edhe:* Grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. në ushtri dhe lufta për shpartallimin e tij.

## V

*Vendet revizioniste—gjendja e brendshme. Ndërrhyrja e kapitalit të huaj. Qëndrimi demagogjik dhe presionet ndaj RP të Shqipërisë* — 67, 77, 79-80, 86, 212-213, 435-436, 467.

*Vështirësitë dhe lufta për kapërcimin e tyre* — 129-130, 174-175, 223, 276, 280, 413-419.

*Vigjilenca revolucionare* — 135, 138, 142-143, 211, 236-237, 304-305, 343, 454-455, 456-457, 459-461, 476, 493.

*Vija e masave* — 57-58, 236-237, 295-296, 326, 471.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alla, Ramiz — 53, 391, 404.  
 Adenauer, Konrad — 19.  
 Ago, Hiqmet — 278-279.  
 Akulli, Anthulla — 353.  
 Allkanjari, Sila — 353.  
 Andoni, Athina — 353.

### B

- Baqi, Filloreta — 274.  
 Balluku, Beqir — 133, 134,  
 136, 138-139, 175, 193, 193,  
 260, 202, 203, 244, 245, 246,  
 249, 300, 302, 415, 420, 445,  
 454, 460.  
 Bekteshi, Sadik — 136.  
 Bijediç, Xhemal — 431, 449-  
 -450, 451.

- Boris III — 63.  
 Bozo, Miti — 185.  
 Bozo, Naunka — 360.  
 Brezhnev, Leonid — 92, 94,  
 299.

### C

- Cauli, Llazi — 355.

### Ç

- Çarçani, Adil — 76.  
 Çeliku, Hajredin — 321, 333-  
 -334, 337.  
 Çuko, Lenka — 390-391, 393,  
 495, 496-497, 499.  
 Çako, Hito — 133, 136, 138-  
 -139, 169, 175, 193, 198, 200,  
 202-203, 244, 249, 309, 460.  
 Çausheku, Nikolae — 61, 67,  
 447, 451.

- Çerçill, Winston — 259.  
 Çomo, Maço — 186.  
 Çu En Lai — 25, 62, 63, 64, 67,  
 68-69, 70, 71, 73, 76, 77, 446.

### D

- Daija, Tish — 394.  
 Deliana, Thoma — 4, 36.  
 Demirei, Sulejman — 451.  
 D'Estèn, Zhiskar — 20, 25, 26.  
 Dezh, George Georgiu — 67.  
 Dë Gol, Charl — 19, 21.  
 Dilo, Lefter — 395.  
 Dimitrov, Gjergj — 63.  
 Dodbiba, Pirro — 168.  
 Dume, Petrit — 133, 136, 136-.

-139, 175, 193, 198, 200, 202-  
-203, 244, 246, 249, 300, 460.

## DH

Dhima, Konxhe — 353.  
Dhimitri, Skënder — 267

## E

Etli, Klement — 259.  
Ezopi — 235, 266.

## F

Ford, Xherald — 88-89, 92,  
427, 430, 482.  
Franko, Françisko — 74, 425,  
428, 447, 479.

## G

Gegpriifti, Llambi — 28-29, 247.  
Gën Biao — 446.  
Gomulka, Vladislav — 67.  
Gromiko, Andrei — 87, 94  
Gurra, Sotir — 231.  
Gusho, Pirro — 135, 175, 246.

## GJ

Gjino, Vaskë — 203.  
Gjoni, Xhelil — 389, 391, 399.

## H

Hoxha, Nexhmije — 157, 158,  
177-178, 179-180, 226, 267 269,

313, 317, 318, 319, 320, 321-  
-323, 324, 326, 328.

Halili, Enver — 268.  
Hitler, Adolf — 26, 92.  
Hrushov, Nikita — 67, 77, 80,  
99, 299, 304, 446-447, 475-478.

## I

Isai, Hekuran — 28-29, 341,  
344, 399, 403, 438.  
Ibrahimllari, Nazmie — 353.

## K

Kapo, Hysni — 58, 105, 166,  
167, 156, 168.  
Koleka, Spirō — 39.  
Kanapari, Shyqyri — 190.  
Kati, Vasil — 454, 456, 461.  
Katro, Petraç — 231.  
Këllezi, Abdyl — 133, 134, 138,  
139, 154, 170, 175, 204-205,  
235-238, 239, 242, 243, 244,  
245, 246, 296-297, 298, 299-  
-300, 308, 309, 333, 334-335,  
349, 415-416, 445, 453, 460-  
461.  
Kisinger, Henri — 87, 88, 94,  
481.  
Koli, Vaskë — 276-278.  
Kotmilo, Gjergj — 315-316,  
319, 321, 322, 325.  
Krup — 477.

## L

- Lako, Miha — 226, 231, 313.  
 Lena, Marie — 353.  
 Lera, Spiro — 188, 190, 265.  
 Liço, Prenda — 353.  
 Li Hsien Nien — 76, 77.  
 Liko, Llazi — 354.  
 Lin Biao — 103.  
 Liu Shao Çi — 73.  
 London, Xhek — 451.  
 Lubonja, Todi — 206.  
 Luli, Dedë Gjo — 397-393.

## LL

- Llupo, Koli — 355.

## M

- Marko, Rita — 246.  
 Mihali, Qirjako — 28-29, 247.  
 Miska, Pali — 28-29, 44, 246-  
 -247, 267, 346, 349, 483.  
 Myftiu, Manush — 32, 331.  
 Maka, Josif — 355.  
 Maka, Lili — 355.  
 Mao Ce Dun — 20, 23-24, 72,  
 97, 103, 446, 447, 450, 475.  
 Markos, Ferdinand — 74.  
 Marshe, Zhorzh — 67.  
 Mborja, Nuçi — 318, 322.  
 Menzelxhiu, Jashar — 329,  
 330-331, 332, 340.  
 Mikojan, Anastas — 30.  
 Mile, Hilli — 355.  
 Mio, Vangjush — 316.  
 Mobutu, Sese Seko — 425.

## N

- Nashi, Lipe — 134, 175, 287.  
 Ngjela, Kiço — 133, 139, 187,  
 308, 453, 455, 456, 457, 460,  
 461.  
 Nikson, Riçard — 94, 145, 482.  
 Novotni, Antonin — 67.

## O

- Orgocka, Dhorkë — 268-269.

## P

- Peristeri, Pilo — 157, 158, 160,  
 188, 189, 226, 231, 232, 246,  
 264-266, 269, 313, 315, 318,  
 326.  
 Paçrami, Fadil — 206, 383.  
 Perillaku, Rahman — 126, 244,  
 249.  
 Pinoçet, Augusto — 74, 425,  
 428, 447.  
 Pirra, Kadri — 355.  
 Pjetri, Themie — 353.  
 Plaku, Koço — 267.  
 Pompidu, Zhorzh — 20, 21.  
 Prendi, Pavlina — 353.  
 Prifti, Donika — 353.  
 Prifti, Ilo — 157, 162, 163, 164,  
 278.  
 Prodani, Muhamet — 203.  
 Profiri, Jorgji — 315, 317-313,  
 320, 321.

## Q

- Qorri, Ana — 353.

## R

Raidhi, Pandi — 268-269.

## S

Spahiu, Xhafer — 364-365.

Saveta, Nasi — 355.

Selenica, Maksut — 106.

Sihanuk, Norodom — 12, 15.

Smit, Jan — 74.

## SH

Shani, Vangjeli — 353.

## T

Toska, Haki — 331, 411.

Tartari, Teki — 161.

Ten Hsiao Pin — 25, 26, 73,  
451.

Tito, Josip Broz — 64, 65, 66-  
67, 68, 69, 299, 446, 447, 448-  
449, 450, 452.

Toliati, Palmiro — 67, 436.

Torez, Moris — 67.

Turtulli, Thoma — 231-232.

## TH

Theodhosi, Koço — 133, 138,  
170, 175, 184, 204, 235, 237,  
242, 244, 246, 247, 266, 267,  
299, 334-335, 415-416, 453,  
460-461.

Thimjo, Andon — 272-274, 278.

Thomai, Themie — 351, 353.

## U

Ulbricht, Valter — 67.

## Y

Ylli, Kahreman — 1.

## Z

Zagorçani, Bexhet — 106.

Zela, Vaçe — 394.

Zogu, Ahmet — 63, 463.

## ZH

Zhivkov, Todor — 63, 67, 452.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Afrikë — 20, 90, 91, 213, 478.  
Ambasadat e RPSH në vende të ndryshme — 258, 451.  
Ambasadat e RP të Kinës në vende të ndryshme — 77, 451.  
Amerika Latine — 92, 214.  
Ansambli artistik kinez «Lionin» — 489-492.  
Austri — 85.  
Azi — 20, 92, 480.

### B

- Banka Eujqësore — 342.  
Banka e Shtetit Shqiptar — 342.  
Bashkimi Sovjetik (1917-1953) — 40, 41.  
Belgjikë — 85, 92.  
Berat — 152, 318.  
Eishti i Pallës (Durrës) — 319-350, 483.  
Bitinckë (Korçë) — 318.  
Bolivi — 428.  
Bosnjë-Hercegovinë — 65.  
«Bota e dytë», «bota e tretë», «bota e të paangazhuarve» — 67, 73, 98, 424-425, 443, 449, 450.

- Bratislavë (Çekosllovakia) — 92.  
Eritania e Madhe — 20, 21, 24, 26, 60, 215, 259, 482.  
Bulevardi «Lenin», Sheshi kryesor (Korçë) — 318-319, 320, 323.  
Bullgari — 61, 62-63, 66, 70, 212, 482.

### Ç

- Çekosllovakia — 25, 92, 208-209, 212, 482.  
Çërravë (Pogradec) — 131, 177.

### D

- Devoll (Korçë) — 254, 275.  
Dibër — 129-130, 173, 339, 396, 399-400, 401-402, 403.  
Dibër (Jugosllavi) — 68.  
Dishnicë (Korçë) — 189.  
Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe e Gazit — 349.  
«Drita» (gazeta ~) — 394.  
Durrës — 350.

### E

- Egjipt — 481.

Elbasan — 129, 268, 317, 327,  
328, 338, 362-363, 396.

## F

Fabrika e Pasurimit të He-  
kur-nikelit, Pogradec — 148.

Fabrika e Sodës Kaustike,  
Vlorë — 191, 252.

Fabrika e Uresë [Uzina e pro-  
dhimeve të azotuarra «Gogo  
Nushi»], Fier — 147, 251.

Fier — 135.

Finlandë — 85.

Fusha naftëmbajtëse e Go-  
risht-Koculit (Vlorë) — 346.

## G

Greqi — 70, 92.

Grupi Komunist i Korçës —  
226.

Gurakuq (Librazhd) — 330.

## GJ

Gjenevë (Zvicër) — 87.

Gjermania Lindore (RD Gjer-  
mane) — 169, 212, 481.

Gjermania Perëndimore (RF  
e Gjermanisë) — 19, 20, 25,  
169, 219, 254, 307, 477.

Gjiri Arabik — 92.

Gjiri Persik — 214, 256.

Gjirokastër — 152, 181, 318,  
394-395.

## H

Hajd Park (Londër) — 259.

Hanxhou (Kinë) — 103.

Helsinki — 84, 85.

Hidrocentrali i Fierzës [Hid-  
rocentrali «Drita e Partisë»]  
— 147, 220, 251, 366.

Hidrocentrali i Komanit [Hid-  
rocentrali «Enver Hoxha»] —  
147, 220, 251.

Holandë — 92, 254-255.

Hoxharë (Fier) — 186.

HSINHUA (agjencia ~) —  
418.

Hungari — 481.

## I

Illirët — 368.

Indi — 480.

Indokinë — 101.

Instituti i Gjuhësisë dhe i Let-  
ërsisë — 368.

Instituti i Kërkimeve Gjeo-  
logo-minerare — 247.

Instituti i Lartë Bujqësor, Ti-  
ranë — 254.

Instituti i Naftës [Instituti i  
Studimeve dhe i Projektime-  
ve Gjeologjike të Naftës e të  
Gazit], Fier — 413, 414.

Internacionalja e Dytë — 23.

Itali — 219, 223, 254, 255, 398,  
307, 419, 479.

## J

Japoni — 20.



«Jeta e re» (gazeta ~) — 397.

## K

Kalabri (Itali) — 255.

Kamboxhia — 12, 13-16, 20, 88, 92, 480.

«Kapitali» (vepra ~, K. Marks) — 416-417.

«Kastrioti» (gazeta ~) — 397.

Këneta e Durrësit — 186.

Këneta e Nartës (Vlorë) — 186.

KGB — 199.

Kili — 74, 101.

KNER (Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke) — 79, 213, 262, 428.

Kodi i Punës, Kodi Penal — 364, 366, 374.

Kolonjë — 169.

Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 146, 191, 220, 251, 253, 330-331, 332-334, 476.

Komisioni i Partisë dhe i shtetit për përgatitjen e kuadrit — 4.

Komonuelth (vendet ~) — 21.

Komunikata e Shangait — 427.

Konferenca Kombëtare e Shkencave Bujqësore (29—31 janar 1975) — 160-161.

Kongresi i 25-të i Partisë Komuniste (revizioniste) të BS (1976) — 88.

Kooperativa bujqësore «Agimi», Fier — 355-356.

Kooperativa Bujqësore e Çërravës, Pogradec — 117, 254, 356.

Kooperativa Bujqësore e Dropullit të Poshtëm, Gjirokastër — 356.

Kooperativa Bujqësore e Krutjes, Lushnjë — 390-391.

Kooperativa Bujqësore e Lapidhasë, Berat — 122, 250, 311.

Kooperativa Bujqësore e Llugajt, Tropojë — 356.

Kooperativa Bujqësore e Mokrës, Pogradec — 124.

Kooperativa Bujqësore e Panaritit, Korçë — 181.

Kooperativa Bujqësore e Plasës, Korçë — 181, 183-184, 221.

Kooperativa Bujqësore e Pogonit, Gjirokastër — 403.

Kooperativa Bujqësore e Pojanit, Korçë — 271-276, 313-314, 328, 329, 355-356.

Kooperativa Bujqësore e Poshnjës, Berat — 311.

Kooperativa Bujqësore e Tiptit të Lartë e Bilishtit, Korçë — 187, 275-279, 329.

Kooperativa Bujqësore e Tiptit të Lartë e Këmishtajt, Lu-

shnjë — 351-359, 417.  
 Kooperativa Bujqësore e Vlo-  
 çishtit, Korçë — 185, 186.  
 Korçë — 129, 130, 156, 157-  
 -158, 159-160, 161-163, 168,  
 169, 170, 171-172, 174-175,  
 177, 181, 183-184, 189, 224,  
 225-228, 231, 232, 253, 254,  
 265, 268, 269-270, 271, 275,  
 279-280, 291, 313-314, 315-  
 -326, 327, 332, 333, 337, 419.  
 Koreja e Veriut (RDP e Ko-  
 resë) — 92, 101.  
 Kosovë — 65, 66, 68, 69.  
 Kronci — 65, 66.  
 Kukës — 182.

## L

Laos — 15, 161.  
 Liban — 92.  
 Ligji i talionit — 372, 376.  
 Lindja e Afërt — 214.  
 Lindja e Largme — 20.  
 Lindja e Mesme — 20, 33, 90,  
 213, 478, 481.  
 Lin (Pogradec) — 125.  
 Luksemburg — 477.  
 Lunxhëri (Gjirokastër) — 132.  
 Lushnjë — 139, 351-352, 358-  
 -359, 394, 396, 405-403, 417.

## M

Malësia e Tiranës — 350.  
 Mali i Zi — 65, 66, 68.  
 Maliq (Korçë) — 103.

Maqedoni — 63, 65, 66, 68.  
 Marinzë (Fier) — 485.  
 Mbledhja e partive komunis-  
 te e punëtorë në Moskë (nën-  
 tor 1957) — 447.  
 Mesdhe (zona, deli ~) — 90.  
 Miniera e Hekur-nikelit e Gu-  
 rit të Kuq Pogradec — 107,  
 103.  
 Miniera e Kromit e Batrës,  
 Mat — 247.  
 Miniera e kromit «Todo Ma-  
 nço» e Bulqizës, Dibër — 367.  
 Miniera e Qymyrgurit e Ala-  
 rupit, Pogradec — 107.  
 Mokër (Pogradec) — 123, 124,  
 327.  
 Myzeqe — 394, 393.

## N

NA'IO (Pakti i Atlantikut Ve-  
 rior) — 19, 25, 61, 428, 450.  
 Ndërmarrja Bujqësore e Mali-  
 qit, Korçë — 272.  
 Ndërmarrja bujqësore «8 Nën-  
 ttori» e Sukthit, Durrës —  
 186, 187.

## O

Oqeani Indian — 91, 214.  
 Orenjë (Elbasan) — 330.  
 Organizata e Kombeve të Ba-  
 shkuara — 92, 431.  
 Osmanllinjë — 368.

## P

- Pallati i Kulturës, Korçë — 318-319, 320, 323.  
 «Pararoja» (gazeta ~) — 313-394, 395.  
 Partia Komuniste (revizioniste) e Çekoslovakisë — 209.  
 Partia Konservatore e Anglisë — 259.  
 Partia Laboriste e Anglisë — 259.  
 Patos (Fier) — 267, 485.  
 Pekin — 76, 427, 450.  
 Pogradec — 105-108, 124-126, 150, 151, 164, 267, 327, 420.  
 Poloni — 25, 169, 212, 213, 263, 477, 481.  
 Portugali — 479.  
 Pragë — 92, 123.  
 Pularia, Tiranë — 175-176.

## Q

- Qyteti Stalin — 485.

## R

- Reforma Agrare — 132, 287.  
 Rehovë (Korçë) — 267.  
 Rilindja Kombëtare Shqiptare — 319.  
 Rin (lumi ~) — 477.  
 Rodezi — 74.  
 Romë — 320-321.  
 Rumani — 25, 61-62, 212, 213, 450.

## RR

- Rrogozhinë (Durrës) — 178.

## S

- Santo-Domingo — 92.  
 Sarandë — 438.  
 Seman (Fier) — 135.  
 Serbi — 66, 68.  
 Sigurimet Shoqërore Shtetërore — 371.  
 Singapor — 480.  
 Siri — 481.  
 Skandali i Uotergejtit (ShBA) — 94, 145.  
 Skrapar — 123, 170.  
 Slloveni — 65, 66.  
 SMT (Stacioni i makinave dhe i traktorëve) — 409.  
 Socialdemokratët, socialistët — 479.  
 Spanjë — 73-74, 479-480.  
 Stamboll (Turqi) — 63.  
 Starovë (Pogradec) — 125.  
 Sudetët (Çekoslovaki) — 92.

## SH

- Shangai (Kinë) — 103.  
 Sheper (Gjilrokastër) — 170.  
 Sheshi «Shën Pjetër» (Romë) — 320-321.  
 Shën-Naum (Jugosllavi) — 63.  
 Shishtavec (Kukës) — 169.  
 «Shkëndija» (gazeta ~) —

390, 393-394, 396-397.  
 Shkodër — 152, 318.  
 Shkolla e Lartë e Partisë  
 «V. I. Lenin», Tiranë — 443.  
 Shkolla e mesme e përgjith-  
 shme «Ramiz Aranitasi», Ço-  
 rovodë — 123.  
 Shmll (Elbasan) — 330.  
 Shqipëria e Jugut — 403.  
 Shqipëria e Veriut — 490.

## T

Tajlandë — 15.  
 Tajvan — 480.  
 Tiranë — 33, 34, 36, 38, 160,  
 175-176, 318, 338.  
 Traktati i Varshavës — 428.  
 Tregu i Përbashkët Evropian  
 — 17-18, 19, 213, 262, 428,  
 450.  
 Tropojë — 36, 490.  
 Tuneli i Klosit — 247.  
 Turqi — 21, 68, 70.

## TH

Thrakë (Greqi) — 63.

## U

Universiteti i Tiranës [Univer-  
 siteti i Tiranës «Enver Hoxha»]  
 — 3, 47.  
 «Ushtima e maleve» (gaze-  
 ta ~) — 392, 399.

Uzina e instrumenteve të pre-  
 cizionit «Petro Papi», Korçë  
 — 225, 227, 229-231, 233-234,  
 267-268, 328.

Uzina e Përpunimit të Thellë  
 të Naftës e Ballshit, Fier —  
 220, 251.

Uzina e Superfosfatit [Kombi-  
 nati Kimiko-metalurgjik],  
 Laç — 147, 252, 337.

Uzina «Traktori» [Kombi-  
 nati i autotraktorëve  
 «Enver Hoxha»], Tiranë —  
 189, 265.

## V

Vatikan — 319.  
 Vermosh (Shkodër) — 68.  
 Vietnam — 15, 20, 88, 92.  
 Vranisht (Korçë) — 187.

## Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~)  
 — 211, 214, 380, 391, 392,  
 392, 395.  
 «Zonja nga qyteti» (drama ~,  
 R. Pulaha) — 268-269.  
 Zvicër — 85.

## ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~)  
 — 450.

## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 55-TË ..... V—IX

1975

KUADROT T'I PËRGATITIM SIPAS NEVOJAVE AKTUALE E PERSPEKTIVE TË VENDIT — Shë- nime (4 qershor 1975) .....	1—5
TË LUFTOJME PËR CILËSI NË PRANIMET NË PARTI — Shënime (5 qershor 1975) .....	6—7
PËR KONTROLLIN — Shënime (6 qershor 1975) .....	8—11
GJAKU I DËRDHUR ÇIMENTON THEMELET E ATDHEUT — Nga biseda me një delegacion kambo- xhian (16 qershor 1975) .....	12—18
KINA PO FUTET NË INGRANAZHIN E LOJËS POLITIKE TË TË DYJA SUPERFUQIVE — Shë- nime (21 qershor 1975) .....	17—27
LUFTA KUNDËR BUROKRATIZMIT — PROBLEM I MASAVE TË GJERA TË POPULLIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 qershor 1975) .....	28—44
NË EDUKIMIN USHTARAK TË RINISË TË KEMI PARASYSH VEÇORITË PSIKOLOGJIKE TË MO- SHËS SË SAJ — Diskutim në mbledhjen e Sekre- tariatit të KQ të PPSH (28 qershor 1975) .....	45—53

KËRKESAT PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE SY- NOJNË NË PËRGATITJEN POLITIKO-USHTARA- KE TË USHTARËVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 qershor 1975) .....	53—59
BALLKANI, SUPERFUQITË, KINA DHE NE — Shënime (2 korrik 1975) .....	60—71
KINA KA HYRË NË VALLEN POLITIKE TË BOR- GJEZISË — Shënime (4 korrik 1975) .....	72—78
PRESIONET E LAJKAT E REVIZIONISTËVE NUK SHKOJNË NË SHQIPËRI — Artikull i botuar në ga- zetën «Zëri i popullit» (25 korrik 1975) .....	79—83
KONFERENCA E PASIGURISË SË EVROPËS — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (29 ko- rrik 1975) .....	84—98
POLITIKA KINEZE NUK KA BOSHT KLASOR PROLETAR — Shënime (31 korrik 1975) .....	97—104
TOKËN DHE PRODHIMET E SAJ T'I NDJEKIM NË ZHVILLIMIN E TYRE SHKENCOR — Nga bi- seda me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë dhe me drejtuesit e organizatave të masave të rre- thit të Pogradecit (16 gusht 1975) .....	105—156
TË GJYKOJMË MË GJERË, TË VËSHTRJOMË MË LARG, TË SHOHIM INTERESAT E LARTË TË ATDHEUT — Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë dhe me kuadro të tjerë drej- tues të organeve të Partisë, të pushtetit, të organi- zatave të masave dhe të ushtrisë të rrethit të Korçës (19 gusht 1975) .....	157—224

- DY JANË ÇËSHTJET KRYESORE: MBROJTJA E  
ATDHEUT DHE FORCIMI I EKONOMISË — Bi-  
sedë me kuadro e me punëtorë të uzinës së instru-  
menteve të precizionit «Petro Papi» dhe të uzinave  
e fabrikave të tjera të rrethit të Korçës (20 gusht  
1975) ..... 225—270
- TË THELLOJMË NJOHURITË SHKENCORE PËR  
ZHVILLIMIN E BUJQËSISË — Nga biseda me  
kooperativistët e Pojanit të rrethit të Korçës (21  
gusht 1975) ..... 271—314
- TA DONI QYTETIN TUAJ DHE TË NDËRTONI ÇDO  
GJË ME SHIJE — Bisedë me shokët Jorgji Profiri  
dhe Gjergji Kotmilo (21 gusht 1975) ..... 315—326
- NË TË GJITHA PUNËT KËRKOHEN DISIPLINË  
PROLETARE DHE MOBILIZIM — Nga biseda me  
disa kuadro drejtues të rrethit të Elbasanit (23 gusht  
1975) ..... 327—340
- DY PROBLEME TË RËNDËSISHME PËR PARTINË  
— Shënime (11 shtator 1975) ..... 341—345
- SPECIALISTËT DHE PUNËTORËT TË JENË SHU-  
MË TË PREOKUPUAR PËR NEVOJAT E VENDIT  
PËR NAFTË — Shënime (12 shtator 1975) ..... 346—350
- EKSPERIENCA E KOOPERATIVËS SË KËMISH-  
TAJT TË BËHET FLAMUR, PËR T'Ë DHËNË NJË  
HOV TË RI ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË SONË SO-  
CIALISTE — Letër drejtuar kooperativisteve të Kë-  
mishtajt dhe kooperativisteve të dalluara të rrethit  
të Lushnjës (22 shtator 1975) ..... 351—359

- PËR EDUKIMIN E KËSHILLTARËVE TË GJENDEN FORMA TË PËRSHTATSHME — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (23 shtator 1975) ..... 360—363
- TË RUHEMI NGA SH TREMBËRIMET QË MUND TË BËHEN DIREKTIVAVE TË PARTISË DHE LI-GJEVE TË SH TETIT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (23 shtator 1975) ..... 364—367
- NE KEMI MUNDËSI TË VËMË EMRA TË RINJ, TË BUKUR E ME KUPTIM — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (23 shtator 1975) ..... 368—369
- PUNONJËSIT QË TREGOJNË TRIMËRI NË KRYERJEN E DETYRËS, MERITOJNË TË DEKOROHEN — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (23 shtator 1975) ..... 370—371
- DREJTËSIA JONË GJYKON NË BAZË TË PROVAVE E RRETHANAVE TË GJITHANSHME — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (23 shtator 1975) ..... 372—376
- DISA MENDIME PËR PROJEKTKUSHTETUTËN E RPSSH — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 shtator 1975) ..... 377—380
- PËRGJEGJËSIA E ORGANIZATAVE TË PARTISË NË DIKASTERE ËSHTË SHUMË E MADHE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 shtator 1975) ..... 381—388



RRETHET KANË FORCA QË TË PËRMIRËSOJNË SHUMË PUNËN E ORGANEVE TË SHYTYTIT TË TYRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 shtator 1975) .....	389—404
KOOPERATIVAT E TIPIT TË LARTË NGRIHEN PËR TË SHTUAR PRODHIMET — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 shtator 1975) .....	405—410
DREJTUESIT TË MERREN ME ÇËSHTJET MË TË RENDËSISHME, JO ME HOLLËSIRA — Nga biseda në takimin ditor me sekretarët e KQ të PPSH (30 shtator 1975) .....	411—417
ARMIKUN TA GODASIM PA HEZITIM — Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës (30 shtator 1975) .....	418—423
POLITIKA E JASHTME E KINËS NUK ËSHTË REVOLUCIONARE — Shënime (2 tetor 1975) .....	424—432
FILOZOFËT «FILOZOFOJNË» — Shënime (4 tetor 1975) .....	433—437
KONTROLI ZBULON DOBËSITË, KORRIGJON, EDUKON NJERËZIT — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë (7 tetor 1975) .....	438—445
KINA DHE JUGOSLLAVIA — Shënime (7 tetor 1975) .....	446—452
ARMIKU VEPRON KUR HUMBET VIGJILENCA — Fjala në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH (10 tetor 1975) .....	453—461
KUSHTETUTA E RE KONFIRMON VIJËN E DREJTË TË PARTISË — Fjala në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH (10 tetor 1975) .....	462—474

KONTRADIKTAT MIDIS ARMIQVE TI SHIKOJME NË PRIZMIN E INTERESAVE TË POPUJVE E TË REVOLUCIONIT — Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës (16 tetor 1975) .....	475—482
STUDIMET PËR NAFTËN TË VAZHDOHEN NË RRUGË TË DREJTË, ME FRYMË PARTIE DHE ME METODA SHKENCORE — Shënime (17 tetor 1975) .....	483—488
POPULLI ËSHTË EDHE KËNGËTAR E VALLTAR I TALENTUAR — Nga biseda me një grup artistësh të ansambllit artistik kinez «Liaonin» (19 tetor 1975) .....	489—492
TË ECIM ME KUJDES, PA RËNË AS NË LIBERA- LIZËM, AS NË SEKTARIZËM — Shënime (20 tetor 1975) .....	493—499
Treguesi i lëndës .....	503
Treguesi i emrave .....	517
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	521

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1987